



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT “PËR AUDITIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE, GJASHTË
MUJORI I DYTË I VITIT 2023”**

RAPORT I KONSOLIDUAR I AUDITIMIT “MBI AUDITIMIN TEMATIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E VITIT 2023 (GJASHTËMUJORI I DYTË)”

Tiranë, Nëntor 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqja
1	Përmbledhje ekzekutive	3 - 4
1.1	Hyrje	4
1.2	Objektivat	4
1.3	Qëllimi	5
1.4	Metodologjia	5
1.5	Konkluzione	5
2	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	5
3	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 2023 (gjashtë mujori i dytë)	2 - 261
3.1	Universiteti Mjekësisë, Tiranë	5 - 50
3.2	Universiteti Sporteve, Tiranë	50 - 60
3.3	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	60 - 78
3.4	Spitali Universitar i Traumës	78 - 136
3.5	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	136 - 158
3.6	Operatori Sistemit të Transmetimit	158 - 175
3.7	Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	175 - 234
3.8	Hekurudha Shqiptare Sh. A	234 - 256
3.9	Posta Shqiptare Sh. A	256 - 303
3.10	Albpetrol Sh. A	303 - 414
4	Anekse	414 - 418
4.1	Rekomandimet për përmirësime/ndryshime legjislativi / Masa organizative	418
4.2	Masa shpërblim dëmi	418
4.3	Masa për eliminimin e efekteve negative (3E)	418
4.4	Masa disiplinore / Masa administrative	418
4.5	Shkalla e pranueshmërisë dhe zbatimit të rekomandimeve sipas llojit të masës për secilin subjekt të audituar	418
5	Dokumentacioni shoqërues	418



1. Përmbledhje ekzekutive

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara në vitin 2023, në zbatim të Programeve të Auditimit nr. 792/1 prot., datë 01.07.2024 në institucionet:

- Universiteti Mjekësisë, Tiranë
- Universiteti Sporteve, Tiranë
- Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
- Spitali Universitar i Traumës
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor
- Operatori Sistemit të Transmetimit
- Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
- Hekurudha Shqiptare SHA
- Posta Shqiptare SHA
- Albpetrol SHA

ka rezultuar si në vijim:

Konstatohet se nga 10 auditimet e kryera:

- **10 subjekte kanë respektuar afatin prej 20 ditë** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Konstatohet se nga 10 auditimet e kryera:

- 5 subjekte (*Universiteti Sporteve Tiranë; Operatori Sistemit të Transmetimit SHA; Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike*), **kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor** në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- 5 subjekte (*Universiteti Mjekësisë, Tiranë; Spitali Universitar i Traumës; Posta Shqiptare SHA; Albpetrol SHA dhe Hekurudha SHA*), **nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor** në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Niveli i realizimit të masave sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

Masa për përmirësime/ndryshime legjislacioni: Nga 2 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 2 rekomandime ose 100%.

- Nga masat e pranuar 2 rekomandime ose 100 % janë zbatuar pjesërisht.

Masa organizative: Nga 314 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 310 rekomandime ose 98 % dhe 4 rekomandime nuk janë pranuar ose 2 %.

- Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 131 rekomandime ose 39 %; janë zbatuar pjesërisht 128 rekomandime ose 38 % si dhe 41 rekomandime rezultojnë të pa zbatuara ose 23 %.

Masa me efekt negativ financiar (3E) “Të ardhura të munguara”: Nga 80 masa të rekomanduara në vlerën 2,409,219,159.8 lekë, 9,579 Euro dhe 60,620,807 Dollar janë pranuar plotësisht 79 rekomandime ose 99 % e tyre (në vlerën 2,409,219,159.8 lekë dhe 9,579 Euro dhe 60,620,807 Dollar).

- Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 20 rekomandime ose 25 % në vlerën 234,226,014.8 lekë dhe 9,579 Euro, janë zbatuar pjesërisht 19 rekomandime ose 24 % e tyre (në vlerën 496,303,816 lekë, 39,247,000 \$ dhe 2,356,730 Euro), dhe rezultojnë pa zbatuar 40

rekomandime ose 51 % e tyre (në vlerën 2,261,491,685.8 lekë dhe 21,373,807 \$).

Masa shpërblim dëmi: Nga 64 masa të rekomanduara në vlerën 4,954,702,000 lekë, janë pranuar plotësisht 61 rekomandime ose 96 % e tyre (në vlerën 4,939,870,302 lekë) dhe nuk janë pranuar 3 rekomandime ose 4 % (në vlerën 14,831,698 lekë).

- Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 13 rekomandime ose 21 % me vlerën 3,547,275 lekë; janë zbatuar pjesërisht 20 rekomandime ose 33 % me vlerën 3,282,021,282 lekë, si dhe 28 rekomandime rezultojnë të pa zbatuara me vlerën 1,754,301,745 lekë ose 46 %.

Masa disiplinore: Nga 11 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 10 rekomandime ose 91 % dhe 1 rekomandim nuk është pranuar ose 9 %.

- Nga masat e pranuar 2 rekomandime ose 20 % e tyre janë zbatuar plotësisht, 6 rekomandime ose 60 % e tyre janë zbatuar pjesërisht dhe 2 rekomandime ose 20 % e tyre rezultojnë të pa zbatuara.

Masa administrative: Nga 2 masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht 2 rekomandime ose 100 % e tyre.

- Nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1 rekomandim ose 50 % dhe 1 rekomandim rezulton i pa zbatuar ose 50 %.

1.1 Hyrje

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme në subjektet e lartpërmendur mbështetur në programin e auditimit nr. 792/1 prot., datë 01.07.2024 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me objekt: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2023 (gjashtë mujori i dytë)”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrin elektronik institucional.

Auditimi u krye nga:

1. A.K, përgjegjës grupi
2. A.R,
3. E.S,
4. J.B,
5. J.M,
6. E.K.

Auditimi filloi më datë 03.07.2024

Auditimi përfundoi më datë 02.08.2024

1.2 Objektivat

1. Hartimi i programit (Planit të veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ.

4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik.

5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet.

6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative.

7. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

1.3 Qëllimi

Vlerësimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna, nga auditimet e mëparshme, koherencës së tyre dhe përgjegjshmërisë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

1.4 Metodologjia

Duke pasur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit dhe dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, u auditua niveli i zbatimit të secilit rekomandim në subjektet e përzgjedhura, vlerësuar sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së kryerjes së auditimit në terren.

1.5 Konkluzione

Për çështjet e shqyrtuara janë zhvilluar ballafaqime gjatë fazës së auditimit në terren dhe në përfundim të tij janë mbajtur akt verifikime për çdo subjekt të audituar, mbi rezultat e të cilit është përgatitur ky Raport Auditimi.

2. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel të konsiderueshëm, konkretisht ku nga 474 masa të rekomanduara gjithsej janë pranuar 465 masa ose 98 %, si dhe nuk janë pranuar 9 masa ose 2 %.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezulton në, zbatuar plotësisht 168 masa ose 36 %, zbatuar pjesërisht 185 masa ose 40 %, si dhe rezultojnë 112 masa të pa zbatuara ose 24 %.

3. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 2023

Të analizuar dhe të detajuara sipas çdo subjekti dhe sipas llojit të masave të rekomanduara, niveli i zbatimit të tyre paraqitet si vijon:

3.1 UNIVERSITETI MJEKËSISË, TIRANË

PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Universitetin e Mjekësisë, Tiranë** mbi “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023*” për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr.401/19 Prot., datë 22.12.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve;

ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 792/1 prot., datë 01.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.K, (Përgjegjës grupi)
2. J.M

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr.401/19 Prot., datë 22.12.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Universiteti Mjeksisë, Tiranë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr. 401/19 Prot., datë 22.12.2023, rezulton se, nga **45** masa të rekomanduara (përmirësim ligjor, organizative, shpërblim dëmi, 3-E dhe Disiplinore), janë pranuar nga subjekti **44** masa të rekomanduara ose 98 %. **Nga të pranuarat (44):** janë zbatuar plotësisht **19**, ose 43.5 % e tyre, janë pjesërisht zbatuar **19** masa ose 43.5 % dhe nuk janë zbatuar **6** masa ose 13%.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit		
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
1	Përmirësim Ligjor	2 masa	-	2 masa	-
2	Organizative	37 masa	17 masa	16 masa	4 masa
3	Shpërblim dëmi	1 masë 513,552 lekë	-	1 masë 513,552 lekë	-
4	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	3 masa 34,230,119.8 lekë	1 masë 3,426,419.8 lekë	-	2 masa 30,803,700 lekë
5	Masa Disiplinore	1 masë	1 masë	-	-
	Gjithsej	44 masa 342,813,671.8 lekë	19 masa 3,426,419.8 lekë	19 masa 513,552 lekë	6 masa 30,803,700 lekë

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i rekomandimeve të zbatuara plotësisht është 44%, zbatuar pjesërisht 43.5% dhe ato të pazbatuara në masën 13%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Universiteti Mjekësisë, Tiranë, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën Nr.1421/41 Prot. datë 17.01.2024.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga ana e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezultojnë si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultojnë pa pajtueshmëri me legjislacionin specifik për arsimin e lartë. Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, zhvillojnë/kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin specifik nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH” dhe akteve nënligjore në fuqi të dalë në zbatim të tij. Në këtë ligj, në nenin 91 “Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës”, në pikën 1, është përcaktuar se “Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin”. Nga ky rezultat rezultojnë se nuk është parashikuar si e drejtë e studentit pajisja me diplomë nga institucion tjetër përveç IAL në të cilën studenti ka përfunduar studimet.

Në ligjin nr.60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, në nenin 1, “Objekti”, është përcaktuar se “Ky ligj përcakton rregulla të veçanta për trajtimin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë”.

Në nenin 4 të ligjit nr.60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, përcaktohet se kandidati "pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit 5/3/2- vjeçar, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit të tërheqë diplomën universitare”.

Në përfundim të sa më lart, konstatojmë se neni 4, i ligjit 60/2023, është në kundërshtim me nenin 91, pika 1, të ligjit 80/2015.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.15. faqe 221 -232 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe organet kolegjiale të tij, të marrin masat për dërgimin e propozimeve të nevojshme ligjore tek Ministria e Arsimit Sporteve, për shmangien e konfliktit ligjor të krijuar nga dy ligje për të njëjtin qëllim.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Pasi është njohur me Rekomandimet e lëna nga KLSH, UMT i është drejtuar MAS me shkresën nr. 1421/64 prot., datë 15.04.2024, me anë të së cilës ka informuar MAS mbi përcaktimet e ndryshme ligjore lidhur me procesin e tërheqjes së diplomave në ligjin nr. 80/2015 krahasuar me ligjin nr. 60/2023. Në këtë UMT sqaron se, bazuar në nenet 23 dhe 24 të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, iniciativa propozuese për përmirësime ligjore është e Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Përpos kësaj, ky detyrim për MAS ka lindur edhe në zbatim të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 25.01.2024.

Në pikën 4 të këtij vendimi, gjykata ka parashikuar *detyrimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë që të miratojë ndryshimet e nevojshme ligjore brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi*. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është publikuar në Fletoren Zyrtare të RSH nr. 40, datë 4 mars 2024.

Sa më sipër, UMT mbetet në pritje të miratimit të ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe plotësimit të kuadrit ligjor, nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Ministria përgjegjëse për arsimin, me qëllim zbatimin e tyre në UMT si dhe zbatimin në një afat kohor sa më të shpejtë të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e UMT, në kushtet kur UMT mbetet në pritje të miratimit të ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe plotësimit të kuadrit ligjor, nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Ministria përgjegjëse për arsimin, me qëllim zbatimin e tyre në UMT nga grupi auditimit konsiderohet pjesërisht zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e ligjit nr.60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, i cili është miratuar në datë 21.07.2023, botuar në Fletoren Zyrtare nr.123, datë 16.08.2023 rezulton se ai në zbatim të nenit 11 të tij, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare (datë 31.08.2023). Të gjitha detyrimet e studentëve që regjistrohen për herë të parë në mjekësi të përgjithshme, duhet të fillojnë me nënshkrimin e një deklaratë (neni 4, pika 1/a ligji 60/2023) para zhvillimit të testimit të informatizuar. Testimi i informatizuar është zhvilluar në datat 14-23 gusht 2023 (burimi i të dhënës: njoftimi në faqet zyrtare të QSHA dhe UMT), para datës së hyrjes në fuqi të ligjit 60/2023 (31 gusht 2023, neni 11 i ligjit). Para zhvillimit të testimit të informatizuar për pranimin në programin “Mjekësi e Përgjithshme” maturantët nuk

kanë nënshkruar deklaratën sipas nenit 4, pika 1/a, e për pasojë dhe plotësimin e pikave b (marrëveshja) dhe c (kalimi i diplomës një institucioni tjetër) të këtij neni. Konstatohet se regjistrimi i maturantëve fitues në programin Mjekësisë ka filluar që në datën 29 gusht 2023, sipas akteve nënligjore të MAS dhe institucioneve të varësisë të saj (deri me 30 gusht janë regjistruar 95% të studentëve fitues në mjekësi).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.15. faqe 221 -232 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe organet kolegjiale të tij, të marrin masat për dërgimin e propozimeve të nevojshme ligjore tek Ministria e Arsimit Sporteve, për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore për maturantët fitues në programin e mjekësisë, të cilët kanë përfunduar procedurat përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.60/2023, i cili është miratuar në datë 21.07.2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Pasi është njohur me Rekomandimet e lëna nga KLSH, UMT i është drejtuar MAS me shkresën nr. 1421/64 prot., datë 15.04.2024, me anë të së cilës ka informuar MAS mbi përcaktimet e ndryshme ligjore lidhur me procesin e tërheqjes së diplomave në ligjin nr. 80/2015 krahasuar me ligjin nr. 60/2023.

Sa më sipër, UMT mbetet në pritje të miratimit të ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe plotësimit të kuadrit ligjor, nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Ministria përgjegjëse për arsimin, me qëllim zbatimin e tyre në UMT si dhe zbatimin në një afat kohor sa më të shpejtë të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e UMT, në kushtet kur UMT mbetet në pritje të miratimit të ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe plotësimit të kuadrit ligjor, nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Ministria përgjegjëse për arsimin, me qëllim zbatimin e tyre në UMT nga grupi auditimit konsiderohet pjesërisht zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemeve të MFK në UMT, rezultoi se, nuk janë zbatuar si duhet kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi:

- “Mjedisi i kontrollit” nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen; mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm; nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korigjuese, përkrahimi i punës nuk është i plotë për të gjithë stafin e Rektoratit; mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaxhimit Strategjik rezultoi se: Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të UMT-së, në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- “Menaxhimi i riskut”: nuk ka përfunduar asnjë mision auditimi nga Njësia e Auditimit të Brendshëm ku trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut, nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin, nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë. Nga institucioni është mjaftuar me Rregulloren e Brendshme për hetimin

administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjes së konfidencialitetit dhe me Kodin Etik të UMT-së.

- “Veprimtaritë e Kontrollit”: nuk ka përfunduar asnjë mision auditimi nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, sipas kërkesave të pikës 3, neni 22, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. Nuk ka sistem back-up, RASH për sistemet e instaluar prej tij ka back-up e tij. Serveri kryesor gjendet në RASH i cili menaxhon dhe mban përgjegjësi për të. Domine i faqes zyrtare të UMT-së është e hostuar në AKSH dhe mirëmbahet nga një specialist IT. Mirëmbajtja e hardwëare dhe softwëare bëhet nga një specialist në Drejtorinë e Administrimit Akademik dhe Kurrikulave, pozicion i cili është vakant për gjithë periudhën e auditimit. Aktualisht rezulton që këto detyra i ka realizuar specialisti IT web. Konstatohet se, nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT.

- “Informacioni dhe Komunikimi”: Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- “Monitorimi”: mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produktit; raportet e monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë; aktiviteti i Auditimit të Brendshëm, rezulton me asnjë mision auditimi i cili të jetë përfunduar me Raport Përfundimtar Auditimi e i cili do të mund të dilte me opinion në lidhje me MFK dhe aktivitete të UMT-së, e për pasojë niveli drejtues i njësisë publike nuk mund të monitorojë në mënyrë të plotë statusin e veprimeve korrigjuese në mënyrë që ato të përfundojnë në kohën e duhur dhe të sjellin rezultatin e pritur kjo realizohet vetëm nëpërmjet planeve të veprimit .

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2,1. faqe 21 -39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: UMT, Grupi i Menaxhimit Strategjik, të marrë masa për plotësimin e mangësive të evidentuara si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, sipas përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe akteve nënligjore e rregullatore në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale të UMT-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Është hartuar raporti vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe pyetësori i vetvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2023. Materiali është raportuar në MAS me shkresë nr.428/3 prot., datë 16.02.2024.

Në zbatim të Urdhërit të Administratorit të UMT-së nr.71 datë 21.03.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e Ekipit të Menaxhimit të Riskut (EMR), në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, ndryshuar me Urdhërin nr.105 datë 16.05.2024 “Për një ndryshim në Urdhërin nr.71 datë 21.03.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e Ekipit të Menaxhimit të Riskut (EMR), në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, njësitë kryesore të UMT-së, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në EMR, të janë njohur me përgjegjësitë, detyrimet dhe afatet e kryerjes së aktiviteteve. Njësitë shpenzuese kanë hartuar planet e punës, mbi bazën e objektivave dhe detyrave për çdo punonjës, si dhe përmbledhëset për çdo strukturë (drejtori, sektor, zyrë). Gjithashtu u hartuan regjistrat e riskut për çdo strukturë dhe njësi kryesore së bashku me planin e masave. Në përfundim të këtij procesi u hartua regjistri përmbledhës i riskut për UMT-në, matrica e riskut dhe plani i masave.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e UMT, rezulton se prej institucionit është hartuar raporti vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe pyetësori i

vetvlerësimi për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit i cili është dërguar në MAS, është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Riskut (EMR), janë hartuar regjistrat e riskut për strukturë dhe njësi kryesore së bashku me planin e masave dhe regjistri përmbledhës i riskut për UMT-në, matrica e riskut dhe plani i masave.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm në UMT, rezultoi se: Struktura dhe organizimi i njësisë së auditit të brendshëm është e përbërë nga tre punonjës, nga të cilat një përgjegjës i njësisë së auditimit dhe dy specialist. Njësia e auditit të brendshëm sipas Statutit të UMT-së, pika 2, nen 53 dhe pika 3, neni 90, është në varësi direkte të Bordit të Administrimit të UMT-së, duke siguruar kështu pavarësinë organizative të NJAB dhe krijuar kushtet për pavarësi funksionale nëpërmjet zhvillimit të veprimtarisë të NJAB bazuar në kuadrin rregullator ligjor në fuqi.

Për vitin 2020 njësia e auditit të brendshëm ka funksionuar me një përgjegjës dhe një specialist dhe **për vitin 2021** ka patur në përbërje dy specialist, por gjatë këtij viti ka dhënë dorëheqjen përgjegjëse e kësaj njësie duke bërë që deri në datë 01.07.2022, kjo njësi të ketë patur vetëm dy specialistët dhe më datë 01.07.2022 është caktuar një përgjegjës i cili aktualisht është larguar me dorëheqje të datës 22.05.2023 e në këtë pozicion është komanduar një nga specialistët duke qenë aktualisht struktura e pa plotësuar që ndikon në funksionimin e njësisë së auditit të brendshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 39 -50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandim: Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në cilësinë e titullarit të Njësisë së Auditit të Brendshëm, të marrë masat me qëllim plotësimin e strukturës me personelin e nevojshëm.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka marrë masat për plotësimin e strukturës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Me Urdhrin e Administratorit të UMT-së nr. 1, datë 03.01.2024, “Për emërimin e personelit administrativ “Përgjegjës/Drejtuës i Njësisë së Auditimit të Brendshëm”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, është emëruar përgjegjësi i kësaj njësie, ndërkohë me Urdhrin e Administratorit të UMT-së nr. 142, datë 04.07.2024, “Për emërimin e personelit administrativ “Specialist” në Njësinë e Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, është emëruar specialisti në këtë njësi, duke plotësuar kështu plotësisht strukturën në Njësinë e Auditimit të Brendshëm në UMT.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion rezultoi se, me Urdhrin e Administratorit të UMT-së nr. 1, datë 03.01.2024 është emëruar përgjegjësi i NJAB dhe me Urdhrin e Administratorit të UMT-së nr. 142, datë 04.07.2024 është emëruar specialisti në këtë njësi.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në UMT të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm, rezultoi se, për vitin 2020 nuk është përfunduar e evaduar asnjë mision auditimi. Në lidhje me këtë periudhë, auditimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm është realizuar dhe një vlerësim i jashtëm i cilësisë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, sipas Programit të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë, në përfundim të të cilës me Raportin Përfundimtar të marsit 2021 është konkluduar me opinionin e përgjithshëm të veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm duke e cilësuar: “se veprimtaria e NJAB ka qenë në mos përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi”.

Për vitin 2021 me Vendimin e Bordit të Administrimit nr.2, datë 14.01.2021 (me nr.84/2 prot., datë 14.01.2021) është miratuar plani vjetor, për veprimtarinë e NJAB të UMT, ku janë parashikuar 8 angazhime auditimi, nga auditimi rezultoi se nuk është përfunduar e evaduar asnjë mision auditimi.

Për vitin 2022 nga auditimi rezulton se, nuk ka patur të miratuar as plan pune nga Bordi Administrimit të UMT nga muaji gusht i vitit 2021 deri në shtator të 2022 si dhe nuk ka patur asnjë mision auditimi të realizuar. Megjithëse nga Përgjegjësi i Njesisë së Auditit të Brendshëm, i emëruar në korrik 2022 (tashmë i larguar me dorëheqje), është arritur të paraqitet e të miratohet një plan pune për periudhën e mbetur shtator –dhjetor 2022 i miratuar me VBA nr.53 datë 27.09.2022 për dy misione auditimi të tipit financiar të vlerësuar me risk të lartë në subjektet FM dhe FSHMT rezulton se (edhe sipas Raportit të veprimtarisë së NJAB për vitin 2022): të dy angazhimet e filluara e të planifikuara në planin e punës janë ndërprerë duke mos patur një punë normale raportimi përfundimtar auditimi, duke bërë që kjo NJAB prej tre vjetësh nuk arrin të përfundojë asnjë mision auditimi dhe njëkohësisht nuk arrin as të përmbushë detyrat ligjore funksionale në përmbushje të misionit e qëllimit për të cilën është krijuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 39 -50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandim: Bordi i Administrimit i Universitetit të Mjekësisë Tiranë, në cilësinë e titullarit të NJAB të marrë masat me qëllim jo vetëm plotësimin e strukturës së NJAB me personelin e nevojshëm por dhe të vlerësimit pas një analizimi të thellë të gjendjes së veprimtarisë së kësaj Njësie Auditimi, me qëllim zbatimin (si nga Bordi i Administrimit dhe nga NJAB) të detyrave funksionale ligjore në përmbushje të misionit e të qëllimit nëpërmjet realizimit të misioneve audituese të nisura, realizuara e të evaduara sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Bordi i Administrimit (BA), në vijimësi gjatë periudhës 2022-2023 ka mbikëqyrur dhe monitoruar nga afër veprimtarinë e NJAB në UMT dhe ka dhënë rekomandime për përmirësimin duke kërkuar zbatimin e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe Standardeve të Auditimit të Brendshëm.

Të gjitha rekomandimet dhe kërkesat e Bordit të Administrimit ndaj NJAB-së janë të reflektuara në Vendimet e BA-së për këtë qëllim, konkluzionet e mbledhjeve të përcjella tek NJAB për zbatim dhe të dokumentuara në protokollin e mbledhjeve të BA-së.

Në vijim, në muajin Janar 2024, në përputhje me Rregulloren e Brendshme të UMT-së, BA do të bëjë vlerësimin e performancës të stafit të NJAB-së si dhe vlerësimin e veprimtarisë së NJAB-së për vitin 2023 sipas raportit vjetor të paraqitur nga kjo Njësi brenda datës 15 shkurt. Sa më sipër, BA si organ kolegjal vendimmarrës ka marrë çdo vendim të nevojshëm për mirëfunksionimin e NJAB-së.

Komenti i grupit të auditimit.

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues provues të statusit të zbatimit të rekomandimit, ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për vitet 2020, 2021 dhe 2022, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka pasur dhe vazhdon të ketë mungesë të theksuar të stafit akademik. Konkretisht për vitin 2020, UMT ka mosplotësim organike për 71 nëpunës (punonjës akademike dhe ndihmës) ose 13% më pak se plani, për vitin 2021 ka 53 punonjës më pak ose 10% më pak dhe për vitin 2022 ka 73 punonjës më pak ose 13%, në kundërshtim me strukturën organike të miratuar. Kjo mangësi në stafin akademik dhe ndihmës akademik të Universitetit

të Mjekësisë, Tiranë, në vlerësim të grupit të auditimit, mund të ketë sjellë pasoja në zhvillimin me kohë të plotë të orëve mësimore sipas programeve studimore me rezultat mosarritjen e pritshmërive në mësimdhënie. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 dhe 2.4 faqe 50 -61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandim: Nga ana e UMT, të merren masa për plotësimin e strukturës me qëllim pakësimin e stafit akademik të kontraktuar me kohë të pjesshme, për rritjen e pritshmërive në mësimdhënie.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtorja e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, me Relacionin nr. 1421/62 prot., datë 26.02.2024, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në UMT”, drejtuar Rektorit të UMT- së, ka informuar se KLSH në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ndryshuar, ka të drejtë t’u rekomandojë drejtuesve të njësisë të audituara, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, marrjen e masave strukturore dhe organizative, në institucionet ku është kryer auditimi.

Ndërkohë UMT, brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenin 30, pika 2 e këtij ligji, 6 muaj nga data e njoftimit të raportit të auditimit, duhet të marrë masat e nevojshme organizative për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Në përfundim, në relacionin e saj Drejtorja Juridike ka sugjeruar që:

1. Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të UMT-së, të marrin masa për ndryshimin e vendimeve respektive për miratimin e strukturës organizative të UMT-së, ose
2. Grupi i Punës ngritur me Urdhrin e Përbashkët të Rektorit dhe Administratorit nr. 108, datë 07.08.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për riorganizimin e strukturës së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, të listprezencave dhe listpagesave për periudhën e auditimit, rezultoi se Rektori, figuron në Fakultetin e Mjekësisë, Departamentin e Kirurgjisë, si staf akademik me kohë të plotë.

Nga auditimi i listprezencës së ndodhur në dosjet respektive të pagave për Fakultetin e Mjekësisë dhe për stafin administrativ të Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në listprezencat e stafit të Rektoratit, është paraqitur si prezent në punë me orar me kohë të plotë Rektori. Nuk ka asnjë mundësi fizike që Rektori, pjesë e stafit administrativ të Universitetit Mjekësor të Tiranës, në pozicionin si drejtues i IAL-së publike, të jetë prezent në detyrat e tij të ngarkuara me ligj sipas pozicionit të emërimit, në të njëjtën kohë që është angazhuar me kohë të plotë në mësimdhënie në departamentin përkatës të fakultetit. Ligji për arsimin e lartë, i ngarkon Rektorit, të kryejë detyrat në funksion të miradministrimit të institucionit të UMT-së. Rektori kryen në realitet, detyrat e pedagogut dhe jo detyrat që i janë ngarkuar me ligj. Nga sa është konstatuar nga grupi i auditimit, rezulton se Autoritetet Drejtuese të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, paguhen për funksione dytësore dhe jo për funksione parësore ndërkohë që ligji i ka ngarkuar përmbushjen e detyrave në funksionet parësore, kjo edhe për vetë rëndësinë në nivel kombëtar që ka Universiteti i Mjekësisë në

Shqipëri, i cili obligon një nivel menaxhimi me kohë të plotë sipas kërkesave të ligjit. Angazhimi i Stafit Drejtues administrativ të UMT-së, në mësimdhënie, me kohë të plotë, në gjykim të grupit të auditimit ka krijuar/mund të ketë krijuar pasoja në miradministrimin e detyrave që ligji i ngarkon këtyre pozicioneve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 & 2.4 faqe 50 -61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Financës, të marrin masat, që stafi drejtues i institucionit, të pasqyrohet në listpagesat e Rektoratit të Universitetit sipas pozicioneve të tyre ligjore dhe jo në listpagesat e fakulteteve të cilat janë në varësi të Universitetit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, me Relacionin nr. 1421/62 prot., datë 26.02.2024, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në UMT”, drejtuar Rektorit të UMT- së, ka informuar se KLSH në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ndryshuar, ka të drejtë t’u rekomandojë drejtuesve të njësisë të audituara, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, marrjen e masave strukturore dhe organizative, në institucionet ku është kryer auditimi.

Ndërkohë UMT, brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenin 30, pika 2 e këtij ligji, 6 muaj nga data e njoftimit të raportit të auditimit, duhet të marrë masat e nevojshme organizative për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Në përfundim, në relacionin e saj Drejtoria Juridike ka sugjeruar që:

1. Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit i UMT-së, të marrin masa për ndryshimin e vendimeve respektive për miratimin e strukturës organizative të UMT-së, me qëllim pasqyrimin e titullarëve të institucionit (Rektor dhe Zëvendësrektor) në listën e personelit të Rektoratit të UMT-së, pavarësisht se janë të punësuar edhe si personel akademik me kohë të plotë, në njësitë kryesore të UMT-së.

ose

2. Grupi i Punës ngritur me Urdhrin e Përbashkët të Rektorit dhe Administratorit nr. 108, datë 07.08.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për riorganizimin e strukturës së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, të cituara më sipër.

Komenti i grupit të auditimit.

Për shkak të periudhës së zgjedhjeve për organet drejtuese të Institucioneve të Arsimit të Lartë, ky proces nuk rezulton i finalizuar ende. Nuk mund të shprehemi me siguri mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, por ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*

5.2 Rekomandim: Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Bordi i Administrimit, Senati Akademik, Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masat që Rektori, të angazhohet me kohë të plotë në detyrat e tij parësore, të ngarkuara nga ligji dhe në mësimdhënie, si detyrë dytësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, me Relacionin nr. 1421/62 prot., datë 26.02.2024, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në UMT”, drejtuar Rektorit të UMT- së, ka informuar se KLSH në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 “Për

organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ndryshuar, ka të drejtë t’u rekomandojë drejtuesve të njërive të audituara, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, marrjen e masave strukturore dhe organizative, në institucionet ku është kryer auditimi. Ndërkohë UMT, brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenin 30, pika 2 e këtij ligji, *6 muaj nga data e njoftimit të raportit të auditimit*, duhet të marrë masat e nevojshme organizative për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Ndërkohë sqarojmë se:

Sipas përcaktimeve në nenin 58 të ligjit nr. 80/2015, personeli akademik gëzon status dhe trajtim të veçantë, status i cili miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Po kështu, sipas nenit 59, pika 1, personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit të arsimit të lartë, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera. Sipas pikës 8 të kësaj dispozite, ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik në institucionet publike të arsimit të lartë përcaktohet nga institucioni, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

Në zbatim të detyrimit ligjor, Ministria e Arsimit dhe Sportit, me Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, ka vendosur rregullat për normimin e ngarkesës mësimore për personelin akademik.

Konkretisht, sipas pikës 2 të këtij Udhëzimi, personeli akademik në IPAL kryen këto veprimtari:

2. Personeli akademik në IAL, ushtron veprimtarinë e tij sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, si dhe statutit dhe rregulloreve të IAL-së.

3. Veprimtaritë që kryen personeli akademik në IAL, janë:

- a) Mësimdhënie;
- b) Kërkimi shkencor ose artistik;
- c) Kontribut institucional;
- d) Kontribut profesional.

Sipas Kreut III, pika 1 të këtij Udhëzimi, çdo anëtar i personelit akademik i punësuar me kohë të plotë në IAL duhet të përmbushë detyrimet për kohën vjetore të punës prej 1536 orë por kjo ngarkesë mësimore shpërndahet tek të gjithë elementët e cituar më sipër. Pra, veçantia e statusit të personelit akademik ka të bëjë me faktin se, një pedagog nuk ka detyrimin e orarit 8 orë në ditë në punë, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës, sepse ngarkesa e plotë mësimore e tij përbëhet nga elementët e përcaktuar në pikën 3 të Udhëzimit nr. 29/2028 e konkretisht:

- a) Mësimdhënie;
- b) Kërkimi shkencor ose artistik;
- c) Kontribut institucional;
- d) Kontribut profesional.

Ky Udhëzim në kreun II, pika 5, ka përcaktuar reduktim ngarkese në auditor, për autoritetet Rektor dhe Zv. Rektor, krahasuar me ngarkesën që ka personeli tjetër akademik në një IPAL, pikërisht për shkak të funksioneve administrative që ata kryejnë e konkretisht, mësimdhënia vjetore në auditor është për:

- a) Rektorin 50 orë mësimore.
- b) Zëvendësrektorin 60 orë mësimore.

Ky përcaktim do të thotë që të qenit në funksionin e Rektorit të një IPAL-je nuk të shkarkon nga detyrimet që ka ai si personel akademik me kohë të plotë. I vetmi element që reduktohet tek ngarkesa mësimore është mësimdhënia në auditor që nga 140 orë në auditor bëhet 50 orë. Po kështu, të qenit në këtë funksion përkthehet edhe në pagë më të lartë, pikërisht për shkak të kësaj ngarkese të ndërthurur si personel akademik me kohë të plotë, si Shef të Shërbimit të

Kirurgjisë së Përgjithshme në Departamentin e Kirurgjisë, me atë të funksionit administrativ si Rektor i UMT-së. Ligji nr. 80/2015, në nenin 39, pika 1, ka përcaktuar Rektorin si autoritetin më të lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Sipas pikës 3 të kësaj dispozite, Rektori në institucionet e arsimit të lartë mban titullin “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij. Në rastin konkret, Rektori i UMT-së, ka ardhur nga radhët e personelit akademik të FM-së, dhe si i tillë ka qenë i miratuar brenda numrit të personelit akademik të FM-së. Fakti ka qenë i përfshirë edhe në listëprezencën e Rektoratit të UMT-së, nuk sjell dhe nuk ka sjellë asnjë pasojë, në të kundërt do të ishte konstatuar si shkelje në auditimet e mëparshme.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar Ligjit nr. 80/2015, në nenin 39, pika 1, i cili përcakton Rektorin si autoritetin më të lartë akademik të institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Sipas pikës 3 të kësaj dispozite, Rektori në institucionet e arsimit të lartë mban titullin “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij. Në rastin konkret, Rektori i UMT-së, ka ardhur nga radhët e personelit akademik të FM-së, dhe si i tillë ka qenë i miratuar brenda numrit të personelit akademik të FM-së. Ndërkohë neni 59, pika 1, specifikon se ...personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit të arsimit të lartë, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, u konstatuan parregullsi në mënyrën e ndjekjes së procedurave për largimin e punonjësve nga puna. Në dy raste, nuk është vepruar sipas dispozitave të Kodit të Punës. Në të dy rastet, nuk u evidentua në dosjen personale të secilit punonjës, ndonjë dokument ligjor tek i cili të cilësoheshin shkaqet lidhur me vendimet e marra nga UMT për ndërprerje të marrëdhënieve të punës ose ndërprerje të kontratës së punës me punëmarrësit. Tek vendimet për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, cilësohet korrespondenca me e-mail midis punonjësve dhe UMT-së por tek kjo korrespondence nuk ka asnjë të dhënë që punonjësit të jenë njoftuar paraprakisht për shkëputje të marrëdhënieve të punës, sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 & 2.4 faqe 50 -61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Rektori, Administratori, Drejtorja e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të marrin masat që në vazhdimësi, për shkëputje të marrëdhënieve të punës me punonjësit e Universitetit të Mjekësisë, të respektohen procedurat e duhura ligjore dhe hapat e nevojshëm për të shmangur çdo lloj dëmshpërblimi në dëm të buxhetit të shtetit, që punonjësit e larguar padrejtësisht, mund të kërkojnë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

UMT që prej periudhës së përfundimit të auditimit nga KLSH dhe përcjelljes së Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve të dhëna për UMT-në, ka respektuar me korrektësi procedurat ligjore dhe nuk rezultoi në asnjë rast të jenë larguar punonjës nga puna, vetëm në disa raste kur punonjësit kanë mbushur moshën e pensionit të pleqërisë ose janë larguar me dëshirën e tyre nga puna.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion u evidentuan 8 raste largimi nga të cilat 1 rast për pension pleqërie dhe 7 raste largimi me dëshirë (me motivacion arsye personale, shkresat me ekstremite si vijon: nr.3251/2 prot., datë 15.12.2023, nr.3860/2 prot., datë 01.02.2024, nr.3765/1 prot., datë 26.01.2024, nr.297/1 prot., datë 14.02.2024, nr. 607/1 prot., datë 07.03.2024, nr.957/1 prot., datë 02.04.2024, nr.1037/1 prot., datë 07.04.2024).

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i disa praktikave lidhur me mbledhjet që ka zhvilluar Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, u konstatua se prezenca e anëtareve të Bordit të Administrimit, është e konfirmuar me një shkresë të vetme në fund të çdo muaji, pa datë, pa numër protokolli dhe pa listë prezencat me datat përkatëse për çdo mbledhje të zhvilluar. Nga auditimi, nuk rezultoi që sekretari i Bordit të Administrimit, të ketë mbajtur ndonjë procesverbal për listë prezencën ditore të zhvillimit të mbledhjes nga Bordi i Administrimit, por vetëm atë mujore duke mos respektuar nenin 16, pikën (1) dhe pikën (2), të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*”.

Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të ndjekura nga Sekretari i Senatit Akademik, për periudhën objekt auditimi, nuk u konstatua ndonjë procesverbal i mbajtur në orarin e mbajtjes së mbledhjes. Procesverbalet e zbardhura të mbledhjeve të zhvilluara për periudhën objekt auditimi, janë të nënshkruara vetëm nga Kryetari i Senatit Akademik dhe Sekretari. Nuk dokumentohet nëse kanë qenë prezent në mbledhje, anëtarët e Senatit Akademik. Gjithashtu, mungesa e dokumentacionit vërtetues për listë prezencën në çdo mbledhje të zhvilluar, nuk është në përputhje me pikën 7, të VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “*Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillave, Bordeve ose Komisioneve të Përhershëm*”.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 61 -76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

7.1 Rekomandim: Sekretari i Bordit të Administrimit dhe i Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, të marrë masat që në të ardhmen, të dokumentohet prezenca e të gjithë anëtareve pjesëmarrës në çdo mbledhje të zhvilluar nga Bordi i Administrimit, në respektim të ligjeve dhe rregullave në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për çdo mbledhje të organeve kolegjiale dokumentohet prania e anëtarëve nëpërmjet nënshkrimit të listëprezencës së pjesëmarrjes në mbledhje.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion, konkretisht mbledhje e Bordit të Administrimit me nënshkrime të anëtarëve pjesëmarrës.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje të vendimeve të Bordit të Administrimit, u konstatua një vendim për marrjen me qira të ambienteve mësimore në një universitet tjetër. Konkretisht: Vendimi nr. 10, (nr. 200/10 Prot., datë 26.10.2022), me objekt “*Miratimin e pagesës së qirasë mësimore, për Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Tiranë, për vitin akademik 2019-2020*”. Në lidhje me këtë praktikë, u konstatua se Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Universiteti i Tiranës, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Në nenin 3 të marrëveshjes së nënshkruar, cilësohet se: “*Bashkëpunimet e mbështetura në këtë marrëveshje do të përcaktohen në detaje në anekse të veçanta. Këto anekse do të nënshkruhen nga Drejtuesit e Njësisë Kryesore të secilës palë të cilët do të pajisen me autorizimin përkatës nga Titullari i institucionit, si dhe pasi Njësitë Kryesore përkatëse brenda universiteteve, të kenë përcaktuar*

detajet e tyre në praktikë”. Aneks Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Fakultetit të Shkencave të Natyrës së Universitetit të Tiranës dhe FMD të Universitetit të Mjekësisë, është nënshkruar në datën 30.06.2020. Aneks Marrëveshja nuk i referohet në përmbajtje Marrëveshjes Bazë të nënshkruar nga Rektori i Universitetit të Tiranës dhe Rektori i Universitetit të Mjekësisë pasi në Marrëveshjen Bazë, nuk bëhet fjalë për bashkëpunim në kuptimin e marrjes me qira ambientesh nga njëra palë me përfitim monetar vetëm të njëjës palë por për bashkëpunim mbi bazën e shkëmbimit të personelit akademik. Pra Marrëveshja Bazë është një Marrëveshje e cila shpreh dy vullnete që përcaktojnë një sërë rregullash ose veprimesh që duhen respektuar dhe ekzekutuar nga palët për përfitim reciprok. Aneks Marrëveshja, është nënshkruar nga Dekani i Fakultetit të Mjekësisë Dentare, pa pasur më parë një autorizim me shkrim nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë, në kundërshtim me nenin 3 të Marrëveshjes Bazë. Në Akt Marrëveshjen bazë, nuk justifikohet dhe as bazohet në ndonjë ligj apo rregullore, pagesa e punonjësve jo mësimorë të Universitetit të Shkencave të Natyrës apo përcaktimi në Akt Marrëveshje i pagesës së këtyre punonjësve për punë jashtë orarit (neni 1 i Akt Marrëveshjes) në të njëjtën kohë që këta punonjës (jo mësimorë) nuk janë pjesë e stafit të Universitetit Mjekësor të Tiranës por as nuk është kërkuar nga Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, staf ndihmës por vetëm ambiente dhe laboratorë. FM, FMD dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Teknike, nuk kanë në përbërje të stafeve të tyre administrative, punonjës apo konsulent të jashtëm me profesion jurist e si të tilla, nuk kanë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar me rigorozitet ligjin dhe rregullat në fuqi. Është detyrë e Universitetit të Mjekësisë (Rektoratit) për të asistuar në konceptimin dhe hartimin e Akt Marrëveshjeve apo kontratave të ndryshme që mund të kenë nevojë të nënshkruajnë Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë me palët e treta.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 61 -76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në Universitetin e Mjekësisë, Sektori i Shërbimeve Juridike, të marrë masat që përpara nënshkrimit nga Rektori apo Drejtuesit e Njësive Kryesore të Universitetit të Mjekësisë të konceptojnë Marrëveshjet, Aneks Marrëveshjet, Kontratat apo çdo akt administrativ që nxirret për të krijuar një marrëdhënie bashkëpunimi ose jo, midis Universitetit të Mjekësisë / Fakulteteve përkatëse dhe kujtdo institucioni tjetër publik ose privat.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Me shkresën e Rektorit të UMT-së nr. 1421/65 prot., datë 15.04.2024, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH pas auditimit të përputhshmërisë në UMT”, drejtuar Njësive Kryesore të UMT-së, është kërkuar që me qëllim zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, përpara nënshkrimit nga autoritetet drejtuese përkatëse të UMT-së, nevojitet të vendoset në dispozicion të Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në Rektoratin e UMT-së, çdo projekt-marrëveshje apo akt tjetër administrativ, i cili synon të krijojë marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet UMT-së dhe institucioneve të tjera publike ose private, me qëllim realizimin e kontrollit të ligjshmërisë së tyre.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikës së dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me zbatimin e Aneks Marrëveshjes nr. 26/6 Prot., datë 30.06.2020, nga Fakulteti i Mjekësisë

Dentare, që në fillimet e saj, atë të procesit të rekrutimit të stafit pedagogjik me kohë të pjesshme dhe zhvillimit të orëve mësimore për lëndët e fizikës, kimisë dhe biologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2019-2020, rezultoi se kjo Aneks Marrëveshje, është nënshkruar pasi Dekani i FMD ka bërë publikimin e vendeve vakante për personel akademik me kohë të pjesshme për lëndët formuese, në datën 20.09.2019. Senati Akademik ka marrë vendimin nr. 43, për miratimin e personelit akademik me kohë të pjesshme dhe të ftuar për vitin akademik 2019-2020 për Fakultetin e Mjekësisë. Kontratat individuale të punës për punonjësit me kohë të pjesshme personel akademik, në total 18 të tilla, janë me nr. 949/10 Prot., deri nr. 949/27 Prot., datë 12.10.2020. Sa më sipër, konstatohet se kontratat e nënshkruara midis Universitetit të Mjekësisë dhe pedagogëve të shpallur fitues të procedurave të rekrutimit për vitet përkatëse akademike, janë nënshkruar pas përfundimit të vitit akademik. Pra, pedagogët e jashtëm të kontraktuar nga Fakultetet përkatëse, kanë dhënë mësim tek studentët përkatës sipas cikleve të studimit dhe njëkohësisht janë likuiduar për këto orë mësimi, pa pasur në fillim një kontratë pune me Fakultetin përkatës. Miratimi dhe vendimi i shpalljes së fituesve për vendet vakante për pedagogë me kohë të pjesshme, është bërë në Muajin Maj 2020 kur pedagogët kanë qenë të domosdoshëm në Tetor 2019. Pra logjikisht, pedagogët e kontraktuar me vonesë nga Rektorati, rezultojnë ligjërisht të kenë dhënë orë mësimi dhe të kenë kryer vlerësimet respektive për orët e mësimdhënies të zhvilluara, pa patur më parë një kontratë punësimi me Universitetin Mjekësor të Tiranës. Pedagogët e jashtëm, të kontraktuar nga UMT, kanë kryer punën e pedagogut dhe njëkohësisht kanë certifikuar studentët për lëndët mësimore të dhëna ndaj tyre, pa patur marrëdhënie pune ligjore (pasi kontratat rezultojnë të nënshkruara pas kryerjes së mësimdhënies me efekt prapaveprues) me UMT. Kjo gjë, përveç faktit që sjell parregullsi të karakterit ekonomiko-administrativ në Universitetin e Mjekësisë, njëkohësisht, mund të krijojë dhe probleme juridike në të ardhmen, lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies. Gjithashtu, ky shërbim, i ligjësuar pas kryerjes së tij, e bën të pamundur kontrollin në përputhje me legjislacionin në fuqi për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si nga Auditimi i Brendshëm ashtu edhe nga ai i Jashtëm, në kohën e ofrimit të këtij shërbimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.13. faqe 143 -146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandim: Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore në UMT, të marrin masat që në të ardhmen, kontratat individuale të punës, të nënshkruhen brenda afateve ligjore me qëllim, eliminimin e problemeve juridike, lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, me qëllim mbarëvajtjen e procedurave të përzgjedhjes dhe punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme dhe zbatimin e rekomandimit të lënë nga KLSH-ja, me Udhëzimin e Rektorit të UMT-së nr. 4, datë 02.07.2024, “Për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme dhe mbikëqyrës klinikë për vitin akademik 2024-2025, në UMT”, , në pikën IV ka përcaktuar se, Listat e personelit akademik me kohë të pjesshme dhe mbikëqyrës klinikë që do të përzgjidhen nga komisionet e vlerësimit ad hoc në njësitë kryesore respektive, të përcillen në Rektoratin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë brenda *muajit shtator 2024* me qëllim kryerjen e procesit të miratimit dhe nënshkrimit të kontratës individuale të punës përpara fillimit të procesit mësimor/vitit akademik 2024 - 2025. Sa më sipër, për vitin e ri akademik 2024-2025, UMT ka marrë masat që përzgjedhja e personelit akademik me kohë të pjesshme dhe mbikëqyrës klinikë të përfundojë nga komisionet ad hoc në fakultete brenda muajit shtator, me qëllim që të vijohet me procesin e miratimit dhe nënshkrimit të kontratës individuale të punës përpara fillimit të procesit mësimor.

Sqarim: Rekomandimi lidhur me kontratat individuale të punës për personelin akademik me kohë të pjesshme dhe nënshkrimin e tyre brenda afateve ligjore me qëllim, eliminimin e problemeve juridike, lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies, vlerësojmë se, nuk përfshihet brenda funksioneve dhe kompetencave të Bordit të Administrimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

9.2 Rekomandim: Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Senati Akademik, referuar të marrin masa për nxjerrjen e përgjegjësive të stafit administrativ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, lidhur me shkeljet e konstatuara në lidhje me nënshkrimin e kontratave individuale të punës për pedagogët me kohë të pjesshme, kontrata të cilat janë nënshkruar me efekte prapavepruese pas kryerjes së shërbimit të mësimdhënies.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë në zbatim të rekomandimit të KLSH-së, me Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr. 15, datë 06.02.2024, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, ka urdhëruar dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” për z. E.H, në pozicionin e punës Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore” në UMT.

Lidhur me dhënien e masës disiplinore për z. E.H, UMT ka gjykuar se, masa e propozuar nga KLSH nuk është proporcionale me gjetjen, bazuar në faktin se procedura e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme është procedurë komplekse, në të cilën marrin pjesë shumë struktura dhe punonjës të ngarkuar nga ligji nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe aktet e brendshme rregullatore të UMT-së, Statuti dhe Rregullorja e Brendshme. Nisur nga ky argument, këtij punonjësi i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me Shkrim”.

Komenti i grupit të auditimit.

Me Urdhër të Rektorit të UMT-së nr. 15, datë 06.02.2024, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, është vendosur masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” për z. E.H, në pozicionin e punës Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore” në UMT.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me Rregulloren e Brendshme të Universitetit të Mjekësisë dhe të fakulteteve respektive, u konstatua se institucioni ka përditësuar Statutin, sipas vendimit të Senatit Akademik me nr. 11, datë 11.02.2019 dhe rregulloren e brendshme sipas vendimit nr. 59, datë 27.06.2022. Nga auditimi u konstatua se mungonin përshkrimet e punës dhe përgjegjësitë apo detyrat e Drejtorive dhe Sektorëve përkatës. Me vendimin nr. 63, datë 08.10.2021, Senati Akademik ka miratuar kriteret e punësimit të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë me përshkrimet e punës & kriteret e punësimit për personelin administrativ të UMT-së, por këto nuk janë pjesë e rregullores së brendshme të UMT-së. Nga auditimi i vendimit nr. 63, datë 08.10.2021 të Senatit Akademik, u konstatua se përshkrimet e punës & kriteret e punësimit për personelin administrativ të UMT-së, nuk janë bërë për të gjitha Drejtoritë apo sektorët e Rektoratit por vetëm për një pjesë të stafit administrativ. Konkretisht, referuar organigramës së

UMT-së, janë miratuar përshkrimet e punës & kriteret e punësimit, për Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin e Tiranës, por mungojnë këto përshkrime për Drejtorinë e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës, për Drejtorinë e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit dhe për Drejtorinë e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore. Për rrjedhojë detyrat dhe të drejtat e personelit të stafit administrativ të UMT-së, nuk janë përcaktuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Mungesa e përshkrimeve të punës & kriteret e punësimit për personelin administrativ të UMT-së kufizon ndjeshëm nxjerrjen e përgjegjësive të stafit në rast të mos përmbushjes së detyrave të ngarkuara. Nuk u konstatua të ketë rregullore të brendshme ndonjë fakultet i Universitetit të Mjekësisë, në kuptim të ligjeve dhe rregullave respektive. Rregulloret e brendshme të fakulteteve, nuk janë rishikuar për tu përshtatur kërkesave të kuadrit të ligjor, konkretisht ligjit 80/2015, datë 17.09.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Nga auditimi konstatohet se Rregullorja Universitetit të Mjekësisë “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës”, nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë rishikimin, përditësimin apo dhe hartimin e një rregulloreje të re e cila të përmbajë të gjitha rregullat dhe normat për veprimtarinë e Universitetit të Mjekësisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqe 50 -61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në funksion të kryerjes së përgjegjësive ligjore dhe realizimit të objektivave, të marrë masa për të rishikuar dhe përmirësuar Rregulloren e Brendshme të Rektoratit, duke reflektuar ndryshimet e ndodhura në kuadrin ligjor dhe aktet e tjera nënligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të këtij rekomandimi, me Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr. 103, datë 18.07.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e draft rregullores së funksionimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, është ngritur grupi i punës që do të përgatisë draft-rregulloren për funksionimin e Rektoratit të UMT-së, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijim, grupi i punës me shkresën nr. 1888 prot., datë 05.07.2024, “Përcillet për njohje Projekt Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, i ka përcjellë Rektorit të UMT-së projekt rregulloren e Rektoratit të UMT-së.

Në vijim kjo projekt rregullore do t’i dërgohet drejtorive/strukturave përkatëse në Rektoratin e UMT-së, përpara miratimit të saj nga organet kolegjiale kompetente.

Sqarojmë se, në kushtet kur UMT sapo ka përfunduar procesin zgjedhor për zgjedhjen e autoriteteve dhe organeve të reja drejtuese dhe për faktin se UMT-ja është në proces ristrukturimi/riorganizimi, momentalisht kjo rregullore do të mbetet projekt deri në miratimin e strukturës së re organizative të UMT-së.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, u konstatua se nuk është bërë një analizë e mirë strukturuar për planifikimin e nevojave buxhetore. Nga auditimi konstatohet ndryshim (transferim) i fondeve, pa patur një analizë të detajuar

argumentuese të situatës apo arsyeve që çojnë në këto vendimmarrje. Kjo dëshmon për një sistem të menaxhimit financiar jo të mirë konsoliduar, veprime jo në përputhje me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 3, pika 29 dhe ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 76 -86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë Ekonomike të merren masa, për të kryer planifikimin e buxhetit të pritshëm për t’u akorduar nëpërmjet një analize të mirë strukturuar të situatës faktike dhe nevojave të departamenteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara nga ana e departamentit të menaxhimit të programeve, që figurojnë me përqindje të ulët realizueshmërie në disa raste. Nga auditimi u konstatua se janë parashikuar zëra në llogarinë 602 “Shpenzime operative”, të cilat nuk janë realizuar siç është planifikuar. Prandaj, llogaria 602 në vitin 2020 është realizuar në masën 54.96%, në vitin 2021 është realizuar në masën 36.90% dhe në vitin 2022 në masën 43.19%. Zbatimi i buxhetit për vitin 2020 është realizuar në masën 81%, për vitin 2021 në masën 86% dhe për vitin 2022 në masën 87%, veprime jo në përputhje me ligjin nr.57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 3, pika 29

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 76 -86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë Ekonomike të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve brenda artikujve buxhetorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Procesi i hartimit të Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe rishikimit të buxhetit vjetor në UMT është një proces gjithëpërfshirës. Në përputhje me nenin 41 “Grupet e hartimit të buxhetit”, të rregullores “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” pranë çdo njësie (fakultet) ngrihet Ekipi i Menaxhimit të Nënprogramit, të cilët mbledhin kërkesat nga departamentet e njëjësive dhe përcaktojnë objektivat në fushën e investimeve. Në Rektorat ngrihet Ekipi i Menaxhimit të Programit, i cili harton materialet si më poshtë vijon:

1. Propozimin e drejtuesve të programeve buxhetore në njësitë shpenzuese të UMT-së;
2. Kalendarin për përgatitjen e PBA-së 2025-2027;
3. Deklarata e politikës së PBA-së 2025-2027;
4. Tavanet Buxhetore për PBA 2025-2027;
5. Udhëzuesin për plotësimin e treguesve;

Pasi miratohen nga GMS këto materiale dërgohen për zbatim në njësitë e UMT-së. Po ashtu rishikimi i buxhetit vjetor në fillim të çdo viti (pas akordimit të grantit vjetor nga MAS dhe trashëgimit të fondeve të papërdorura të vitit paraardhës) është një proces gjithëpërfshirës. Ngrihen ekipet e punës të cilët mbledhin nevojat nga çdo departament/drejtori/sectorë.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion, nga ana e UMT, pranë çdo njësie (fakultet) ngrihet Ekipi i Menaxhimit të Nënprogramit, të cilët mbledhin kërkesat nga departamentet e njësive dhe përcaktojnë objektivave në fushën e investimeve. Në Rektorat ngrihet Ekipi Menaxhimit të Programit i cili konsolidon të dhënat për efekt të buxhetit të plotë. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk janë miratuar brenda afateve të përcaktuara PBA-të, e konkretisht: Programi Buxhetor Afatmesëm për vitet 2021-2023 (me një diferencë prej 84 ditë kalendarike); PBA për vitet 2022-2024 (me një diferencë prej 8 ditë kalendarike) dhe PBA për vitet 2023-2024 (me një diferencë prej 4 ditë kalendarike). Ndërkohë, miratimi i Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2023-2025 është realizuar jashtë afatit të përcaktuar, si dhe është dërguar fillimisht në MAS, pa kaluar hapat për miratim sipas radhës kronologjike të përcaktuar me ligj, duke kaluar si fillim në Senat, GMS, Bord Administrimi, e së fundmi në MAS, në mospërputhje me: Ligjin nr.57 date 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”; Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”, Neni 38, pika 1/h dhe neni 49, pika 1/c.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 76 -86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandim: Nga Organet Drejtuese të merren masa për miratimin e programit buxhetor afatmesëm brenda afateve të përcaktuara dhe respektimin e radhës kronologjike e hierarkike duke u miratuar fillimisht në Senat, GMS, Bord Administrimi, e së fundmi në MAS, në mënyrë që të mos pengohen proceset e punës në UMT.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Programi Buxhetor Afatmesëm për vitet 2024-2026 është hartuar dhe është miratuar në afat. PBA është miratua nga Bordi i Administrimit të UMT-së me Vendimin nr.49, datë 14.08.2023 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe treguesit e vitit 2024, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”. Materiali është dërguar në MAS me shkresë nr.1692/26 prot., datë 15.08.2023.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit, realizimit dhe përdorimit të të ardhurave rezultoi se:

-Në zërat “tarifa regjistrimi” dhe “të ardhura të tjera”, realizimi në vitet objekt auditimi është në kufijtë 114 – 205%, fakt që flet për një planifikim jo të saktë të të ardhurave.

- Zërat e shpenzimeve nga të ardhurat rezultojnë me një realizim mesatar 39.8%. Për artikullin 602 “mallra dhe shërbime të tjera”, ka një realizim mesatar vjetor 42.1%, ku % më e madhe e mosrealizimit është e vitit 2020. Zëri i shpenzimit “Investime, art. (230+231)”, paraqitet me një nivel realizimi viti 2020 në 38% dhe vitet 2021 e 2022 përkatësisht me 9%, ku ka ndikuar shumë anulimi i procedurave të prokurimit apo zgjatja e procedurave të prokurimit. Në nivele të ulëta paraqiten shpenzimeve nga të ardhurat në shpenzimet e pagave në planin buxhetor të miratuar të vitit 2020, 2021 e 2022. Një nga arsyt është mungesa stafit akademik dhe administrativ, 71 vende vakante për vitin 2020, 53 vende vakante për vitin 2021 dhe 73 vende vakante. Gjithashtu nuk janë paguar të gjitha shpenzimet për ngarkesën mësimore pedagogë të

brendshëm e të jashtëm, shpenzimet për pagat nga të ardhurat për pedagogët me kontratë, situata e krijuar nga COVID 19 (viti 2021) si dhe në vitin 2022 nuk janë paguar të gjitha shpenzimet për ngarkesën mësimore pedagogë të brendshëm e të jashtëm, pagesat e udhëheqësve dhe oponentëve për procesin e mbrojtjes së doktoraturave.

- Përdorimi i të ardhurave është me mosrealizime, janë trashëguar të ardhurat nga viti 2019 në vitin 2020 në shumën 711,593,504 lekë, nga viti 2020 në vitin 2021 në shumën 704,162,196 lekë dhe nga viti 2021 në vitin 2022 në shumën 802,513,792 lekë, ndërkohë që në ligjin nr. 80/2015, neni 118 “Institucionet publike të pavarura të arsimit të lartë”, në pikën 5, është përcaktuar se: “IALPP-të nuk kanë qëllim fitimin dhe të ardhurat e përfituara nga veprimtaria dhe pasuritë e tyre përdoren për realizimin e misionit të institucionit”.

- Ndërkohë që të ardhurat e trashëguara të papërdorura janë në shumën 802,513,792 lekë, nga auditimi rezulton se UMT merr ambiente me qira, shfrytëzon ambiente të QSUT, merr staf akademik me kohë të pjesshme, etj., nga ku rezulton se UMT, ka pasur buxhet të trashëguar nga të ardhurat gjatë viteve, buxhet të cilin nuk e ka mirë administruar për zhvillimin e misionit të saj, si krijimin e departamenteve të reja, duke pasur njëkohësisht mundësinë edhe të plotësimit me staf akademik dhe rritjen e investimeve në funksion të përmirësimit të shërbimit të mësimdhënies ndaj studentëve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7. faqe 86 -94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandim: Nga ana e UMT, Drejtorisë Ekonomike dhe organeve kolegjiale të merren masa për planifikimin e përdorimit të të ardhurave për nevojat institucionale në shërbim të mësimdhënies dhe rritjes së cilësisë së arsimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Është planifikuar në buxhetin vjetor të miratuar të UMT-së për vitin 2024 përdorimi i rreth 87% të të ardhurave totale (vjetor dhe të trashëguara). Këto të ardhura janë detajuar në të gjithë zërat buxhetorë: paga, sigurime, mallra dhe shërbime, investime, bashkëfinancime për projekte të kërkimit shkencor etj.. Një vëmendje të veçantë ka marr rindërtimi i godinave të dëmtuara nga tërmeti (vlera totale sipas projekt-preventivave është 353,528,249 lekë) të cilat janë parashikuar të ndërtohen nga të ardhurat e UMT-së.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

14.2 Rekomandim: MAS, në bashkëpunim me UMT të marrin masat për të analizuar situatën me qëllim vënien në përdorim të fondeve të mbartura për zhvillimin e mëtejshëm të UMT, duke u fokusuar në realizimin e misionit të institucionit, pse jo në hapjen e fakulteteve të reja në fushën e mjekësisë, në hapjen e laboratorëve etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Është planifikuar në buxhetin vjetor të miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të UMT-së, nr. 21, datë 18.04.2024 “Për miratimin e treguesve të buxhetit për vitin 2024, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” për vitin 2024 përdorimi i rreth 87% të të ardhurave totale (vjetor dhe të trashëguara). Këto të ardhura janë detajuar në të gjithë zërat buxhetorë: paga, sigurime, mallra dhe shërbime, investime, bashkëfinancime për projekte të kërkimit shkencor etj.. Një vëmendje të veçantë ka marr rindërtimi i godinave të dëmtuara nga tërmeti (vlera totale

sipas projekt-preventivave është 353,528,249 lekë) të cilat janë parashikuar të ndërtohen nga të ardhurat e UMT-së, si dhe ndërtimi i laboratorëve të rinj.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i blerjeve me vlerë të vogël rezultoi se:

- Dosjet e procedurave të prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, në shumicën e rasteve nuk janë të inventarizuara. Ndërsa në disa raste, kërkesa për realizim prokurimi nuk është e protokolluar, ka dokumente të fotokopjuara në dosje, për marrjen në dorëzim të mallit nuk ka të dhëna mbi faturën tatimore (numër datë vlerë), vlerën, veprime në mospërputhje me: Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, *neni 21*, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 8. faqe 94 -106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

15.1 Rekomandim: Nga Komisioni i marrjes në dorëzim të merren masa për evidentimin e datave të skadencave të kiteve në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe plotësimin e të dhënave të faturave tatimore (numër, datë, vlerë), për të arritur objektivat dhe respektimin e afateve të skadencave të kiteve në përputhje me ligjin.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Prokurimeve ka marrë të gjitha masat për evidentimin e datave të skadencës në të gjitha procedurat e prokurimit. Në procesverbalin e Komisionit të Marrjes në Dorëzimit të mallrave apo shërbimeve është përfshirë numri, data dhe vlera e faturës, e cila i bashkëngjitet procesverbalit. (Bashkëngjitur praktika “Procesverbal për marrjen në dorëzim të mallit, nr.2513/59 prot., datë 11.03.2024 dhe nr.3073/34 prot., datë 05.04.2023).

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi mbi disa kampionë të përzgjedhur për të marrë siguri të arsyeshme mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, Procesverbal për marrjen në dorëzim të mallit, nr.2513/59 prot., datë 11.03.2024 dhe nr.3073/34 prot., datë 05.04.2023, nga ku u konstatua se, në procesverbalin e Komisionit të Marrjes në Dorëzimit të mallrave apo shërbimeve është përfshirë numri, data dhe vlera e faturës, e cila i bashkëngjitet procesverbalit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***

16. Gjetje nga auditimi: Në Fakultetin e Mjekësisë, të Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në disa raste likuidimi i faturave tatimore energjisë elektrike, të ujit dhe të shërbimit telefonik nuk është bërë brenda afatit 30 ditor. Fondet e buxhetit janë të ndara për 12 muaj dhe likuidimi i faturave duhet të bëhet për çdo muaj sipas afatit të përcaktuar. Mos likuidimi në kohë i tyre, nuk nxjerr në pah realizimin e buxhetit mujor dhe K premisa për lindjen e penalteteve, të cilat rëndojnë mbi buxhetin e shtetit, veprime në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. (Bashkëngjitur Urdhër Shpenzime nr.174 dt 10.10.2023, U.Shpenzim nr. 158 dt 19.09.2023, U.Shpenzim nr. 159 dt

19.09.2023, U.Shpenzim nr. 245 dt 15.01.2024, U.Shpenzim nr. 218 dt 06.12.2023, U.Shpenzim nr.173 dt 10.10.2023).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 8. faqe 94 -106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masa për likuidimin në kohë të faturave tatimore të energjisë elektrike, ujit dhe shërbimit telefonik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Nga ana e Fakultetit të Mjekësisë ky rekomandim është zbatuar dhe është në vëmendje në vijimësi zbatimi i tij.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, u përzgjedhën disa praktika urdhër shpenzimesh për të vlerësuar afatin e likuidimit të tyre. Konkretisht Urdhër Shpenzime nr.174 dt 10.10.2023, U.Shpenzim nr. 158 dt 19.09.2023, U.Shpenzim nr. 159 dt 19.09.2023, U.Shpenzim nr. 245 dt 15.01.2024, U.Shpenzim nr. 218 dt 06.12.2023, U.Shpenzim nr.173 dt 10.10.2023.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***

17. Gjetje nga auditimi: Në FSHMT, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në shumicën e rasteve nuk ka dokumentacion të plotë justifikues lidhur me evidentimin e shpenzimeve të karburantit, nuk kanë bërë planifikim të nevojave për shërbim/mirëmbajtje të sistemit të ngrohjes me kaldaja. Në shumicën e rasteve, në dosje ka vetëm një fletë-dalje për karburantin dhe nuk ka bashkëngjitur dokumentacionin justifikues lidhur me situacionin, kartelat për konsumin, normën e konsumit për çdo orë ndezje të kaldajës, nuk ka informacion se sa orë është ndezur kaldaja apo se kush e ka ndezur atë. Nuk ka urdhri transferimi për daljen e karburantit nga magazina dhe destinacionin e tij. Nuk ka evidenca, lidhur me periudhën e pandemisë COVID-19, gjatë së cilës kaldajat nuk janë ndezur. Nuk kanë bërë një planifikim se sa karburant (sa litra) shpenzohet në vit për kaldajat, pasi vlerat e konsumuara sipas kontratave me kompaninë “Resuli-ER” sha janë të ndryshme. Nuk kanë bërë planifikim të nevojave për shërbim/mirëmbajtje të sistemit të ngrohjes me kaldaja. Lidhur me procesverbalet apo situacionet të FSHMT, për konsumin mujor të kaldajave të vitit 2022, (për muajt janar, shkurt dhe dhjetor 2022), ky dokument është i firmosur nga dy anëtarë të komisionit për ndjekjen e kontratës nga 3 anëtarë. Veprime jo në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 16, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, neni 20, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 8. faqe 94 -106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17. Rekomandim: Nga ana e Administratorit të FSHMT, të dokumentohet çdo veprim lidhur me shkarkimin e karburantit dhe të bëhet planifikimi i nevojave për shërbim/ mirëmbajtje të sistemit të ngrohjes me kaldaja, pasi kjo sjell mungesën e evidentimit dhe transparencës lidhur me përdorimin e karburantit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Planifikimi i nevojave për shërbim/ mirëmbajtje të sistemit të ngrohjes me kaldaja dhe nevojave për lëndë djegëse, zëra këto të parashikuar në Buxhetin e vitit 2024 dhe u vijua me parashikimin e këtyre zërave në PBA 2025-2027 nga Shefi i Shërbimeve. Për sa i përket konsumit të karburantit, përgjegjësi i shërbimeve, punonjësi i mirëmbajtjes dhe magazinieria janë personat përgjegjës për hyrjet, daljet dhe evidentimin e konsumit dhe orët e funksionimit të sistemit të ngrohjes.

Komenti i grupit të auditimit.

Në mungesë të dokumentacionit justifikues mbështetës për të verifikuar me siguri të arsyeshme statusin e zbatimit të rekomandimit, konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i inventarëve për vitet objekt auditimi rezulton se nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset (produkt), edhe pse duke u nisur nga vitet dhe nga norma e amortizimit, ekzistojnë asete të cilat janë plotësisht të amortizuara. Në fletë hyrjen e magazinës dhe në dokumentacionin e marrjes në dorëzim të mallrave, nuk regjistrohen numrat serial/identifikimit përkatës të mallrave, duke e bërë të vështirë identifikimin e tyre, veprime jo në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik te aktiveve”, pika 73 – 120.

Inventarët nuk kanë të përfshirë zërat (toka, ndërtesa, rikonstruksione), në mënyrë që të bëhet verifikimi i vlerës së aseteve, amortizimit të duhur të tyre duke përfshirë edhe shtesat, si dhe të ardhurat e gjeneruara nga përdorimi i tyre, nëse ka. Pronat e Universitetit të Mjekësisë Tiranë janë të regjistruara në Agjencinë e Kadastrës, në emër të Bashkisë Tiranë dhe jo të UMT-së, me përjashtim të shtesave, të cilat janë në emër të UMT-së. Për periudhën objekt auditimi, në lidhje me inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të UMT, nuk ka gjurmë mbi kryerjen e inventarizimit, për pasojë informacioni mbi procedurat e ndjekura për inventarizimin e pasurive të paluajtshme është i pjesshëm, veprim jo në përputhje me pikën 74, të kapitullit IV, “Sistemi i kontrollit periodik te aktiveve” të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 9. faqe 106 -112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandim: Nga Sektori i Financës, të merren masat që asetet plotësisht të amortizuara të nxirren jashtë përdorimit; të përfshihen në inventar zërat si: toka, ndërtesa, rikonstruksione dhe për secilin mall që merret në dorëzim nga institucioni si dhe të përcaktohet dhe regjistrohet numri serial për të bërë të mundur identifikim e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sa i takon procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit, nuk janë ndërmarr nisma për inicimin e tij.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

18.2 Rekomandim: Nga Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe atë Juridik, të merren masa për regjistrimin e pronave të UMT-së në Agjencinë e Kadastrës, në emër të saj, pasi ka vështirësi në evidentimin e plotë të aktiveve në pronësi dhe për llogaritjen e amortizimit vjetor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Sa i talon procesi i regjistrimit të pronave në UMT është duke u kryer pranë Agjencisë së Kadastës. Janë bërë aplikimet përkatëse të cilat janë dërguar në ASHK me anë të shkresës Nr. 1300/2 Prot., datë 19.04.2023 ku përfshihet dokumentacioni i plotë si:

- Kopje e statusit juridik për secilën pronë
- Planimetritë për secilën godinë
- Gentplanet për secilën pasuri
- Relacionet teknike

- Formularin për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore
- VKM nr. 655, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Tiranë
- VKM nr. 656, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Tiranë
- VKM nr. 658, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë
- VKM nr. 657, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të Spitalit Universitar të Traumës” Tiranë
- VKM nr. 654, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare “Nënë Tereza”.

Ka patur komunikime të vazhdueshme me institucionet shtetërore si Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të cilat kanë shprehur angazhimin e tyre për përmbushjen e këtij rekomandimi dhe përfundimin e procedurave të regjistrimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga ana e UMT janë ndërmarr nismat e inicimit të regjistrimit të pronave të UMT-së në ASHK duke kryer aplikimin pranë kësaj zyre me shkresën Nr. 1300/2 Prot., datë 19.04.2023

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrave të aktiveve në UMT, u konstatua se në Fakultetin e Mjekësisë nuk ka një regjistër të plotë të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, në të cilin të evidentohet qartësisht data e hyrjes në institucion, amortizimi i akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur, sipas formatit të regjistrit të aktiveve. Nuk është trashëguar dokumentacioni nga punonjësi që është larguar, pasi ka ikur pa bërë dorëzimet, veprime jo në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 28 dhe 30 dhe Rregulloren e Brendshme e UMT, e ndryshuar “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, neni 9, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2. 9. faqe 106 -112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandim: Nga Drejtoria e Ekonomike, të merren masa për nxjerrjen e një regjistri të plotë të aktiveve që zotëron, sipas llojit, grupit dhe formatit të dispozitave ligjore në fuqi në funksion të evidentimit të jetëgjatësisë së përdorimit të aktiveve nga institucioni dhe monitorimit të llogaritjes së amortizimit vjetor .

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Nga fakulteti i Mjekësisë, në zbatim të rekomandimit nga ana e KLSH, është duke u hartuar regjistri i aktiveve që disponon dhe ka në administrim, në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, në të cilin evidentohet data e hyrjes në institucion, përshkrimin e aktivitetit, vlera e blerjes, nr.serie, nr. llogarisë ekonomike, vendndodhjen, data e marrjes dhe personi përgjegjës i aktivitetit , dhe puna po vazhdon të kryhet me intensitet dhe me rigorozitet.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga ana e UMT (personi përgjegjës) po kryhet procesi i hartimit të regjistrit të aktiveve, duke evidentuar data e hyrjes në institucion, përshkrimin e aktivitetit, vlera e blerjes, nr.serie, nr. llogarisë ekonomike, vendndodhjen, data e marrjes dhe personi përgjegjës i aktivitetit ,etj., bashkangjitur praktika me foto të këtij procesi.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

20. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të konsoliduar të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për Fakultetin e Mjekësisë vlera e llogarisë nën rubrika “Gjendje e inventarit qarkullues” llogaria 31 “Materiale”, si dhe nën rubrika “Aktive afat gjata materiale”, llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e pajisje si dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik,” vlera neto kontabël e tyre është e pa rakorduar me vlerën fizike. Si UMT për periudhën nga viti 2013 e në vazhdim, veprimet për ndryshimet e gjendjeve të këtyre llogarive janë të rakorduar, për hyrje daljet, por gjendja fillestare në çelje në fillim të vitit 2013 (vit i bashkimit), nuk ka një listë të artikujve gjendje, nuk vërtetohet gjendja kontabël me atë fizike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10. faqe 112 -127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandim: Nga ana e Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të merren masa për ngritjen e një grupi pune për vlerësimin kontabël dhe fizik të nën rubrikave “Gjendje e inventarit qarkullues” llogaria 31 “Materiale”, nën rubrika “Aktive afat gjata materiale”, llogaria 214 “Instalime elektrike, makineri e pajisje si dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik,” dhe zgjidhjen e situatës për sistemimin e llogarive.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Pa përgjigje

Komenti i grupit të auditimit.

Mungon informacion (përgjigje nga ana e institucionit dhe dokumentacion justifikues bashkangjitur) për të marr siguri të arsyeshme mbi statusin e zbatueshmërisë së këtij rekomandimi.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 2018 “Inventar ekonomik” rezultoi se pakësimi konsiston në transferimin e aktiveve të projekteve me financim të huaj, në bankat e nivelit të dytë vetëm për ato institucione të cilat kanë sjellë konfirmim që i kanë marrë në dorëzim dhe i kanë përfshirë në kontabilitetin e tyre. Konkretisht: Për projektin Euscreen, bazuar në shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Drejtorisë së Administrimit Spitalor, me nr.5202 prot., datë 13.10.2016, “Për bashkëpunim me projektin për fushën e depistimit neonatal të dëgjimit dhe depistimit femënor të shikimit paragrafi i fundit citohet: “Në përfundim të këtij projekti aparaturat depistuese/diagnostikuese të vëna në dispozicion nga projekti, do të mbeten në administrimin e institucioneve pjesëmarrës në këtë projekt, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë”. Gjithashtu dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhur nëpërmjet Rektorit të UMT-së dhe drejtuesve të institucioneve pjesëmarrës në projekt, në nenin 7 “Dhurimi i aparaturave”, është përcaktuar që në përfundim të kësaj marrëveshje aparaturat diagnostikuese të vëna në dispozicion nga ky projekt do të dhurohen Institucionit. Nuk janë transferuar vlerat e aktiveve të institucioneve që nuk kanë sjell konfirmim institucionet në vitin 2021 e konkretisht e Spitalit "Distrofik" në vlerë fillestare 1,877,538 lekë & amortizimi në vlerë 401,848.6 lekë, si dhe spitalit Kukës në vlerë fillestare 2,788,951 lekë dhe amortizim 583,576 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10. faqe 112 -127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1 Rekomandim: UMT-ja të marrë masa dhe të kryejë transferimin e aktiveve të vëna në dispozicion në kuadër të zbatimit të projektit EUSCREEN, të spitalit “Qendra kombëtare e mirërritjes, zhvillimit dhe rehabilitimit të fëmijëve”, Tiranë (Distrofik) në zbatim të marrëveshjeve të lidhura.

Përgjigja e institucionit:

Është konfirmuar marrja në dorëzim e aseteve nga “Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët”, Tiranë (Distrofik), nëpërmjet shkresës nr.32 prot., datë 27.02.2024, protokolluar në UMT me nr.560, datë 28.02.2024. Vlera totale e aseteve të konfirmuara është 1,877,537.6 lekë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kuotave të mbuluara rezultoi se specializanti i cili përzgjedh kuotë të mbuluar ka detyrimin që brenda 2 javëve të bëjë regjistrimin pranë fakultetit përkatës, ku duhet të paraqesë kontratën që lidh specializanti me ministrinë e cila mbulon kuotën përkatëse. Në këtë kontratë janë të parashkruara të drejtat dhe detyrimet e të dy palëve (evidencë: *Kontrata për ndjekjen e specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë pranë Universitetit të Mjekësisë, ndërmjet Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe specializantit*). Gjithashtu specializanti ka detyrimin e kryerjes së pagesës së tarifës së shkollimit për llogari të fakultetit përkatës (115.000 lekë, tarife e miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të UMT-së), si dhe ndjekjes së detyrimeve akademike të programit.

Nga auditimi i kuotave të lira, rezultoi se specializanti i cili përzgjedh kuotë të lirë ka detyrimin e pagesës së tarifës së shkollimit për llogari të fakultetit përkatës (115.000 lekë, tarifë e miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit të UMT-së), si dhe ndjekjes së detyrimeve akademike të programit, duke mos lidhur kontratë. Mos përcaktimi i saktë kontratave të shërbimit me specializantët (të drejtat dhe detyrimet), mund të sjellë risk potencial në mosplotësimin e detyrimeve të përcaktuara në rregulloren përkatëse për specializantët. Veprime jo në përputhje me VKM nr.824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”, shtojca 7, standardi II/6, kriteri 10; Statuti i UMT-së, neni 26; Rregullorja e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, neni 6, neni 45.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.11. faqe 127 -133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, të marrë masa për hartimin e kontratës së shërbimit me specializantin pavarësisht llojit të kuotës.

Përgjigja e institucionit:

Sa i përket këtij rekomandimi, rezulton që Universiteti Mjekësisë, Tiranë e ka pasur një kontratë shërbimi për ciklin e tretë të studimeve të specializimeve afatgjata. Konkretisht, me shkresën nr. 7604 prot., datë 16.11.2022 MAS ka kërkuar një listë dokumentacioni nga të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë.. Në pikën 8 të kësaj liste është edhe kontrata tip e sstudentit për të të gjitha nivelet e studimit.

Në përgjigje të saj, me Urdhrin nr. 143, datë 21.11.2022 Rektori i UMT-së ka ngritur një grup pune për nxjerrjen dhe plotësimin e informacionit lidhur me sa është kërkuar nga MAS.

Me shkresën nr. 4142/5 prot., datë 05.12.2022, i është kthyer përgjigje MAS, bashkëngjitur së cilës është përcjellë në formë të shkruar dhe elektronike dokumentacioni kërkuar, ndër të cilat është edhe dokumenti nr. 8, Draft Kontrata tip e studentit për të gjitha nivelet e studimit. Në nenin 1 të saj është përcaktuar edhe cikli i tretë Specializime Afatgjata.

Komenti i grupit të auditimit.

Është përcjellë në formë të shkruar dhe elektronike në MAS Draft Kontrata tip e studentit (dokumenti nr. 8) për të gjitha nivelet e studimit. Në nenin 1 të saj është përcaktuar edhe cikli i tretë Specializime Afatgjata.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i mosrealizimit të kuotave të planifikuara rezultoi se realizimi i kuotave të planifikuara për specializimet afatgjata është në masën 65% për tre vitet në audimi përkatësisht: 66% për vitin 2020-2021; 56% për vitin 2021-2022 dhe 73% për vitin 2022-2023. Referuar rregullores se specializimeve të UMT, neni 21, përcaktohet se: “Kandidati aplikon sipas formularit të aplikimit bashkëlidhur kësaj rregulloreje (shtojca nr. 2) dhe i nënshtrohet konkursit të pranimit për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit. Kriteret specifike shtesë për t'u pranuar në programin e specializimeve afatgjata janë kompetencë e UMT. Zgjedhja e programit specializues bëhet në bazë të renditjes së kandidatit sipas pikëve të përfituara (listës së meritës)”. Në nenin 34 të Rregullores të specializimeve, përcaktohet se: “Vlerësimi i kandidatëve bëhet me sistem pikëzimi (maksimumi 1000 pikë), ku 30% e pikëve (300 pikë të konvertuara) përlllogariten bazuar në notën mesatare të ponderuar dhe 70% e pikëve (700 pikë të konvertuara nga testimi i informatizuar që zhvillohet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Po në këtë nen është përcaktuar kriteri cilësor minimal nëpërmjet sistemit të pikëzimit për të patur mundësi për përzgjedhjen e programit. Konkretisht, “kandidatët që kanë grumbulluar jo më pak se 380 pikë nga numri i pikëve totale të konvertuara (maksimumi 1000 pikë), kualifikohen për procesin e përzgjedhjes së programit të specializimit sipas sistemit të meritës”. Kjo ka bërë s kualifikimin e kandidatëve që nuk kanë arritur pragun e pikëve. Gjithashtu në nenin 20, pika 4, është përcaktuar se “Nuk mund të konkurrojnë kandidatët që janë duke kryer ose që kanë kryer një program specializimi afatgjatë”, dhe ky është një tjetër kufizim që pavarësisht kalimit të pragut minimal të pikëve (380 pikë) kandidati tërhiqet në rastin kur nuk ka më kuota për programin që dëshiron. Janë këto kufizime që bëjnë mosrealizimin 100% të kuotave të pranimit. Me këto veprime nuk sigurohen kapacitetet njerëzore profesionistë të specializuar në fushën e sektorit shëndetësor publik, si dhe nuk realizohen plotësisht të ardhurat dytësore të planifikuara për UMT nga kjo kategori. Në kontekstin e politikave të qeverisë e cila nëpërmjet ligjit 60/2023 ka përcaktuar detyrime për studentët e mjekësisë së përgjithshme për qëndrimin në vend, në plotësim të kërkesave të sektorit shëndetësor, dhe nuk mundëson mbulimin e kuotave të specializantëve për të garantuar shërbim shëndetësor të specializuar nëpërmjet specializantëve. Sa më sipër është jo në përputhje me ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 25, pika 7, neni 38, neni 42, neni 69; Statuti i UMT-së, neni 26, neni 89, Rregullore e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë në fushën e mjekësisë, neni 5-6; neni 38-47.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.11. faqe 127 -133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1 Rekomandim: Me qëllim realizimin e plotë të kuotave të planifikuara, si dhe në kuadër të sigurimit dhe garantimit me burime njerëzore me profesionistë të specializuar në mjekësi, për kryerjen e shërbimeve të shëndetit publik në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të planifikohen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe me ministrinë e tjera vetëm kuota të mbuluara, ku të përcaktohet dhe periudha e shërbimit të diplomuarit në sistemin shëndetësor publik.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 "Per arsimin e lartë....", neni 69, *kuotat e pranimit në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të organeve kolegjiale të Universitetit në përputhje me*

standardet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, të cilat verifikohen dhe certifikohen nga Ministria Përgjegjëse për Arsimin.

UMT, ka adresuar rekomandimet e KLSH (nr. 24 dhe nr.25) me shkresën nr 1421/ 63 prot., datë 01.03.2024 për Ministrinë Përgjegjëse për Shëndetësinë (pasi rekomandimet e lëna janë në kompetencë të kësaj ministrie).

Lidhur me rekomandimin sa më sipër: Pas miratimit të kuotave të specializimeve për vitin akademik 2023-2024, UMT me shkresën nr.241 prot., datë 29.01.2024 i ka kërkuar MSHMS-së të sjellë propozimet për kuotat që do të mbulojë kjo ministri, dhe me shkresën nr.556/1 prot., datë 26.02.2024, MSHMS ka përcjellë propozimin për mbulimin e 103 kuotave/252 kuota të miratuara në total (për FM)

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

24. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e marra në vendimet e Senatit Akademik, për miratimin e kuotave të pranimit për tri vitet në auditim rezulton se UMT, ka miratuar 13 kuota për transferim nga IAL e tjera përkatësisht: 5 për vitin 2020-2021; 3 për vitin 2021-2022 dhe 5 për vitin 2022-2023. Nga 13 kuota janë realizuar 8 kuota (1; 3 dhe 4 kuota të realizuar sipas viteve). Në vendimet e Senatit Akademik janë miratuar dhe kuota për transferim studimesh të kërkuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale bazuar në nevojat e shërbimit shëndetësor për mjekë të specializuar. Këto kuota nuk janë përfshirë në numrin total të pranimeve të reja, pasi për këto kuota aplikojnë specializantë të UMT që janë të regjistruar dhe kanë të përfunduar të paktën 1 vit akademik. Referuar vendimeve përkatëse të Senatit Akademik janë miratuar 10 kuota për çdo vit akademik në auditim, si dhe një kuotë transferimi në vitin 2022-2023 në zbatim të Vendimit nr.50, datë 29.04.2022 të Senatit Akademik të UMT. Kuota të realizuara janë 28 nga 30 të miratuara. Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh në kuotat e MSHMS, janë specializantë të regjistruar në UMT dhe që kanë përfunduar të paktën vitin e parë. Këta specializantë (dy vitet e fundit kanë qenë më shumë se numri i kuotave) i janë nënshtruar dhe këta procesit të testimit të informatizuar dhe në bazë të listës së meritës bëhet regjistrimi i tyre. Këto veprime mund të kenë ndikim apo efekt në mosrespektimin e barazisë në përzgjedhjen e programit të studimit; Ulja e numrit të specializantëve (sipas kuotave për transferim studimesh të) të planifikuar për sektorin shëndetësor publik dhe vinë si rezultat i mos rregullimit në aktet e brendshme të UMT. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.11. faqe 127 -133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

24.1 Rekomandim: Kuota për transferim studimesh të propozuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të planifikohen si kuota të mbuluara nga kjo ministri.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Lidhur me rekomandimin e mësipërm, MSHMS ka mbuluar të gjitha kuotat e transferimeve të studimeve të miratuara me Vendim nr.44, date 03.04.2024 të Senatit Akademik të UMT, referuar shkresës së MSHMS-së nr. 1504/3 prot., datë 11.04.2024.

Në përfundim: Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, UMT miraton kuotat e pranimit në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore, ndërsa MSHMS mbulon kuotat për specializimet në përputhje me fondin e pagave që ka në dispozicion. Në këto kushte nuk është

në përgjegjësi të UMT realizimi i dy rekomandimeve të KLSH, por në frymen e bashkëpunimit (siç është cituar në Raportin e KLSH) ka komunikuar zyrtar me këtë ministri.

Bashkëlidhur gjeni të skanuar:

1. Shkresa nr 1421/ 63 prot., datë 01.03.2024 e UMT
2. Shkresa nr. 241 prot., datë 29.01.2024 e UMT
3. Shkresa nr.556/1 prot., datë 26.02.2024 e MSHMS
4. Shkresa nr. 1504/3 prot., datë 11.04.2024 e MSHMS.

Komenti i grupit të auditimit.

Në kushtet UMT miraton kuotat e pranimit në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore, ndërsa MSHMS mbulon kuotat për specializimet në përputhje me fondin e pagave që ka në dispozicion, e nga ana e UMT është mbajtur korrespondencë zyrtare me MSHMS por nuk është finalizuar procesi, ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se janë dërguar akte administrative shkresore nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe anasjelltas, por pa finalizuar këtë proces me miratimin e listës së pronave dhe procedimin për regjistrimin e tyre pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Konstatohet se ka mosveprim nga ana e strukturave përgjegjëse pranë dy institucioneve respektive të ngarkuara nga ligji. Sa më sipër, në kushtet që nga ana e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, nuk janë regjistruar pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme si dhe nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar, ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nenit 2, pika 10, nenit 24 të Kodit Civil “Regjistrimi fillestar” si dhe në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat e çdo akti që përcakton pronësinë ose të drejta të tjera reale që ekzistojnë për pasuritë e paluajtshme, si nenit 45/1 dhe nenit 46/1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.13. faqe 143 -146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

25.1 Rekomandim: Administratori i Universitetit të Mjekësisë Tiranë, të marrë masat për të ngritur një grup pune, me qëllim pasqyrimin e dinamikës dhe lëvizjet e objekteve respektive në administrim të Universitetit, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të këtyre pasurive, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, dhe pas saktësimin të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për transferimin e pronave që ky Universitet ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore me qëllim pasqyrimin e situatës së duhur në pasqyrat financiare të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në përmbushje të rekomandimit të mësipërm janë marrë masa për të evidentuar dinamikën e lëvizjes së objekteve respektive në administrimin e Universitetit të Mjekësisë. Ka patur ndërveprime edhe me insitucionet shtetërore dhe në përgjigje të Urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr.701, datë 26.12.2023 “Për realizimin e procesit të regjistrimit të pronave shtetërore në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të cilat përdoren për ushtrimin e veprimtarisë nga institucionet publike të arsimit të larë”, me anë të shkresave Nr. 20/1 Prot, datë 31.01.2024 dhe Nr. 20/2 Prot., datë 31.01.2024 janë përcaktuar për secilën pronë zona kadastrale, indeksi i hartës, numrin e pasurisë, llojin e pronës, adresën e pronës, emërtesën e pronës, sipërfaqen e pasurisë, sipërfaqen e gjurmës së pasurisë, funksionin për të cilën

përdoret prona, institucionin me përgjegjësi administrative dhe të dhëna të tjera lidhur me pronën. Pas kërkesës për informacion të Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me nr. 1742 Prot., të dhënat janë përcjellë në MAS me anë të shkresës nr. 20/4, datë 29.03.2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

25.2 Rekomandim: Nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë, të ri aplikohet pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e pronave që Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka në administrim, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura duke rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listën analitike të aktiveve, në pasqyrat financiare të vitit 2023.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Aplikimi i fundit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës është nisur me anë të shkresave nr. 1300 Prot., datë 19.04.2023 dhe nr. 1302 Prot., datë 20.06.2023 dhe është në pritje të përfundimit të procedurave të regjistrimit. Pas dorëzimit të dokumentacionit, kontaktet me specialistët e ASHK dhe zyrtarët e MAS kanë qenë të shpeshta, për të përmbyllur sa më shpejt këtë proces.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratës së lidhur midis “2N” shpk dhe FM , me nr. 502/19 Prot., datë 31.08.2020, me objekt “Rikonstruksion i tarracës së godinës së para klinikut dhe bodrumeve të godinës së Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë”, me afat 4 muaj kalendarikë nga dita e marrjes së lejes ndërtimore tek Bashkia Tiranë nga Autoriteti Kontraktor dhe më vlerë 15,347,539 lekë me tvsh, rezultoi se tarraca nuk është bërë rikonstruksion për arsye të ndryshimit të projektit pasi godina ku ishte parashikuar rikonstruksioni i tarracës, është vlerësuar nga Instituti i Ndërtimit, si godinë e dëmtuar pas tërmetit të vitit 2019. Në këto kushte, kontrata e nënshkruar duhej të anulohet e të rifillonte një procedurë e re prokurimi me objekt të ndryshëm nga objekti fillestar pra pa kërkuar rikonstruksionin e tarracës. Procedura e prokurimit e zhvilluar në vitin 2020, sipas urdhër prokurimi nr. 1422/3 Prot., datë 15.08.2019, ka pasur kritere edhe për punime të tarracës, të cilat i janë referuar zërave të punimeve sipas preventivit të parashikuar për punime në lartësi për rikonstruksionin e tarracës. Me ndryshimin e zërave të punimeve në atë masë që është ndryshuar objekti i prokuruar, pra janë hequr punime në lartësi për të cilat ka konkuruar dhe është shpallur fitues operatori ekonomik, FM, Administratori znj. Zh.D., duhej të anulonte kontratën e nënshkruar dhe të kërkonte nga Universiteti i Mjekësisë, zhvillimin e një procedure të re prokurimi, me një preventiv të ndryshëm nga ai i pari si pasojë e ndërhyrjes në punime të cilat kanë qenë bazë për përzgjedhjen e operatorit fitues. Në grupet e punës të ngritura nga FM për ndjekjen e zbatimit të kontratës, nuk ka asnjë inxhinier apo specialist të fushave inxhinierike që të mund të arsyetojë teknikisht ndryshimin e zërave të punimeve apo edhe staf të fushës juridike, që të vlerësojë rëndësinë e lartë të këtyre ndryshimeve dhe njëkohësisht të propozojë korrigjimet e nevojshme ligjore. Struktura të tilla inxhinierike dhe juridike, ka vetëm Universiteti i Mjekësisë i cili ka staf administrativ në ndryshim nga Fakultetet të cilat kanë

kryesisht staf akademik në strukturat e tyre. Zërat e preventivit të punimeve, nuk mund të miratohen nga Dekanati i FM i cili s'ka asnjë specialist të fushave përkatëse por vetëm pedagogë të Fakultetit të Mjekësisë. Si rezultat, procedurat e ndjekura nga FM, janë me mangësi si nga ana teknike por dhe nga ajo juridike pasi në njërin rast kemi të bëjmë me miratime zërash të rinj të preventivit (të ndryshëm nga ata të prokuruar) të detyruar nga Instituti i Ndërtimit dhe në rastin tjetër, kemi mosfunksionim të stafit administrativ ose strukturave juridike dhe teknike të Universitetit të Mjekësisë pasi duhej që normalisht të propozonin ndryshimin e objektit të procedurës së prokurimit pasi janë hequr punimet në lartësi dhe si rezultat edhe kriteret e kualifikimit për këto lloj punimesh ose dhe fondi limit, duhej të ndryshoheshin duke i propozuar Administratorit të Universitetit të Mjekësisë fillimin e një procedure të re prokurimi me objekt të ndryshëm nga ai i pari.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14/1. faqe 212 -221 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

26.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Fakultetet respektive, gjatë fazës së ekzekutimit të kontratave publike, të marrin masa që mos të ndryshojnë në atë masë specifikimet teknike dhe zërat për ekzekutim, saqë këto të fundit, të ndikojnë në kriteret e përzgjedhjes së fituesit të procedurës së prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria e Shërbime Mbështetëse gjatë ekzekutimit të kontratave publike nuk ka ndryshuar specifikimet teknike dhe zërat për ekzekutim, në mënyrë që këto të fundit të ndikojnë në kriteret e përzgjedhjes së fituesit. Ndryshimi i specifikimeve teknike është bërë vetëm në rastet e pajisjeve/materialeve të cilat mund të orientonin në një markë të caktuar. Marr dy kampion për procedurat e realizuara gjatë vitit. (Bashkangjitur praktika për ndryshim / orientim nr.1176/11 prot., datë 31.05.2024 Shtojcë në DST dhe nr.3782/4 prot., datë 26.12.2023 Urdhër prokurimi nr.315 datë 26.12.2023)

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi mbi disa kampionë të përzgjedhur për të marrë siguri të arsyeshme mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, u konstatua se, në kampionet e përzgjedhur është operuar rast pas rasti për të kryer ndryshim vetëm në rastet e pajisjeve/materialeve të cilat mund të orientonin në një markë të caktuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

26.2 Rekomandim: Fakultetet respektive të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, gjatë fazës së ekzekutimit të kontratave publike, të marrin masa që për çdo ndryshim të zërave të punimeve, të bashkëpunojnë me Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorinë e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore të UMT-së, për marrjen e një asistence profesionale nga specialist të fushave përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Gjatë procedurave të prokurimit në UMT pjesë e komisioneve përkatëse të përcaktimit të fondit limit, vlerësimit të ofertave apo të marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve janë vendosur specialist të fushave përkatëse. (Bashkangjitur praktika shkresa nr.2513/3 prot., datë 29.09.2023 Urdhër prokurimi nr.201 datë 29.09.2023 dhe shkresa nr.3074/14 prot., datë 26.10.2023 Urdhër prokurimi nr.236 datë 26.10.2023).

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi mbi disa kampionë të përzgjedhur për të marrë siguri të arsyeshme mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, u konstatua se, në kampionet e përzgjedhur është operuar rast

pas rasti për të kryer ndryshim vetëm në rastet e pajisjeve/materialeve të cilat mund të orientonin në një markë të caktuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

27. Gjetje nga auditimi: Në Autoritetin Kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, gjatë periudhës objekt auditimi rezulton se ka 24 anulime procedurash, të cilat shkojnë deri në tre herë anulim, në vlerën 216,010,127.35 lekë, duke sjellë mospërdorim të fondeve si nga buxheti ashtu dhe nga të ardhurat e veta, me ndikim në realizimin e misionit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Në përgjithësi kriteret e veçanta për kualifikim nuk janë të argumentuara dhe në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, dhe më të theksuara në procedurat e prokurimit: “Furnizim - vendosje dritare dhe dyer për Dekanatin e FM”; “Blerje të pajisjeve mjekësore laboratorit për Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë”; “Rikonstruksion i tarracës së godinës “Galileo Galilei” brenda QSU “Nene Tereza”; “Vlerësimi i protezave fikse metal qeramike të mbështetura mbi implante, për FMD”; “Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”; “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”; “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”.

Janë konstatuar në disa raste vonesa në lidhjen e kontratës nga Fakulteti i Mjekësisë; në disa raste që raporti përmbledhës mban datë përpara procesverbalit të vlerësimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues;

Gjithashtu u konstatua neglizhencë e nëpunësve të caktuar për zbatimin e procedurave të prokurimit apo për marrjen në dorëzim të mallrave, punëve apo shërbimeve, nëpërmjet dorëheqjeve nga komisionet përkatëse duke shkaktuar zgjatje të procedurave.

Në shumë raste u konstatua se nga asistenca teknike e APP kërkohet rishikim i kriterëve, e cila nuk është bërë sipas kësaj asistence.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14. faqe 146 -212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

27.1 Rekomandim: Nga Autoritetit Kontraktor, të merren masat e duhura që të analizohet situata në drejtim të realizimit të investimeve, në drejtim të hartimit të saktë të preventivave, në drejtim të përcaktimit në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit të kërkesave të veçanta për kualifikim, në shpalljen e fituesve, në marrjen në dorëzim të punëve, mallrave dhe shërbimeve si dhe në zbatimin e urdhrave nga nëpunësit për pjesëmarrje në komisione.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktor ka marrë masat që çdo procedurë të realizohet në kohë dhe sipas dispozitave ligjore të prokurimit publik, duke mos pasur anulime dhe duke dorëzuar çdo dokumentacion pjesë përbërëse të procedurave në kohën e duhur.

Për të gjitha procedurat e kryera për këtë vit (2023) të gjitha projektet kanë qenë të realizuara nga studio e projektimit “A4”.

Komenti i grupit të auditimit.

Në kushtet kur, për të gjitha procedurat e kryera për këtë vit (2023) të gjitha projektet kanë qenë të realizuara nga studio e projektimit “A4”, ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

28. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, gjatë vitit 2022 ka zhvilluar disa procedura prokurimi në rolin e Autoritetit Kontraktor qendror blerës,

për të cilat i është deleguar e drejta për prokurim nga 3 fakultete që janë pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë: Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Theksojmë se nuk ka dokument ku nga ana e këtyre njësive shpenzuese të delegohet e drejta për zhvillimin e procedurave të prokurimit, jo vetëm për këto raste por edhe për raste të tjera të trajtuara. Nga auditimi rezulton se këto fakultete janë njësi shpenzuese (autoritete kontraktore) më vetë, të pajisura me llogari personale për prokurimin elektronik, si dhe fondet buxhetore për realizimin e procedurave të prokurimit menaxhohen nga ana e tyre (likuidimet për çdo blerje malli, realizim shërbimi, kryerje pune realizohen nga vetë fakultetet).

Në lidhje me 4 procedura të prokurimit me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”; “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”; “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”; “Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”.

Rezulton se pasi është publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik njoftimi i fituesit (në përfundim të afateve të ankimit), nga ana e administratorit të mëparshëm është proceduar me nënshkrimin e kontratës për të gjitha njësitë në total (Rektorati dhe 3 fakultetet), duke cituar në kontratë fondet respektive të secilës njësi.. Nga ana e Administratorit të UMT, S.Sh., nuk është bërë autorizim për lidhje kontrate për tre fakultetet për pjesën takuese të tyre, por kontrata për çdo procedurë (4) është lidhur nga AK, UMT, në kushtet kur fondet në dispozicion nuk janë të vetat por të tre AK të tjera, të cilët i kanë deleguar të drejtën për prokurim UMT. Nga administratori i UMT është ngritur Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Mallrave për të gjitha njësitë në total (Rektorati dhe 3 fakultetet), të ndara sipas secilës njësi.

Kontrata nga Administratori i UMT, është nënshkruar në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, nenet: 4 Përkufizime, pika 9, neni 14. “Kontratat publike”, neni 33. “Organ qendror blerës” , Neni 21, “Autoriteti ose enti kontraktor”, Neni 53, “Blerja e përqendruar” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 7, neni 67, “Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit”, pikën 4, neni 106, “Kohëzgjatja e kontratës”, nga ku rezulton se afërsisht pas 8 muajsh nga lidhja e kontratave, situata paraqitet:

- Është realizuar (dorëzuar malli dhe likuiduar) vetëm për Rektoratin për të katër kontratat; Për kontratën “Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të UMT”, gjendja është: FMD, ka marrë në dorëzim mallrat më datë 27.01.2023. Nga ana e FMD nuk është likuiduar. FSHMT, ka marrë në dorëzim mallrat nga kontraktori “S.” shpk, nuk është realizuar likuidimi. FM, nuk e ka zbatuar kontratën me nr. 2925/35 Prot., datë 19.01.2023, nuk i ka marrë në dorëzim mallrat brenda afatit të caktuar në kontratë, pasi nuk ka lidhur kontratë vetë si AK.

Për kontratën “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të UMT”, gjendja është: FMD, ka marrë në dorëzim mallrat më datë 30.01.2023. Nga ana e FMD nuk është realizuar likuidimi. FSHMT, ka marrë në dorëzim mallrat më datë 30.01.2023. Nga ana e FSHMT nuk është realizuar likuidimi. FM, nuk e ka zbatuar kontratën me nr. 4223/16 Prot., datë 30.12.2022, nuk i ka marrë në dorëzim mallrat brenda afatit të caktuar në kontratë.

Për kontratën “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të UMT”, gjendja është: FSHMT janë marrë në dorëzim diplomat por nuk janë likuiduar. FM, nuk e ka zbatuar kontratën. FMD, nuk është bërë marrja në dorëzim, nuk e ka zbatuar kontratën.

Për kontratën “Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, gjendja është: FMD, nuk është bërë marrja në dorëzim, nuk e ka zbatuar kontratën.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14. faqe 146 -212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

28.1 Rekomandimi: Nga ana e Autoritetit Kontraktor, UMT, për zgjidhjen e situatës, të merren masa të bashkëpunojnë me APP, e cila jep këshilla dhe asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirë zbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik; verifikon zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit ose anulimit të procedurës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore; monitoron nëse zbatimi i kontratave është bërë në përputhje me kushtet e prokuruar bazuar në raportet periodike të autoriteteve ose enteve kontraktore.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Përfundimin e hetimit administrativ të kryer nga Agjencia e Prokurimit Publik në UMT, me Vendimin nr. 71, datë 27.10.2023;

Projekt Raportin e Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, përcjellë me shkresën nr. 401/11 prot., datë 30.10.2023 "Dërgohet projekt raporti i auditimit" protokolluar në institucion me nr. 1421/14 prot., datë 01.11.2023;

Shkresën drejtuar APP-së nr.2243 prot., datë 13.07.2023 "Kërkesë për dhënie mendimi lidhur me zbatimin e disa kontratave të nënshkruara nga Administratori i mëparshëm i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë";

Shkresën e APP-së "Në lidhje me shkresën tuaj nr.2243 prot., datë 13.07.2023";

Shkresën drejtuar APP-së nr.2243/2 prot., datë 13.11.2023 "Mbi zbatimin e disa kontratave të prokurimit publik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë";

Shkresat e APP-së me nr. 8677 prot., datë 24.11.2023 "Në lidhje me shkresën tuaj Nr. 2243/2 prot., datë 13.11.2023", protokolluar në institucion me nr. 2243/3 prot., datë 06.12.2023;

Për të gjitha kontratat e prokurimit të cilat janë nënshkruar midis Operatorëve ekonomik dhe Administratorit të UMT-së në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe që janë të pazbatuara plotësisht, janë nënshkruar "Marrëveshje Mirëkuptimi" midis operatorët ekonomikë përkatës, njërive kryesore të UMT-së dhe Administratorit të UMT-së, me objekte si më poshtë vijon:

1. "Marrëveshje Mirëkuptimi" për vijimin e procedurës së prokurimit me objekt "Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë" ;
2. "Marrëveshje Mirëkuptimi" për vijimin e procedurës së prokurimit me objekt "Furnizim-vendosje kondicioner për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë" ;
3. "Marrëveshje Mirëkuptimi" për vijimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë";
4. "Marrëveshje Mirëkuptimi" për vijimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje pajisje stomatologjike për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë".

Këto marrëveshje janë lidhur me qëllim zgjidhjen e ngërçit të krijuar dhe realizimin e plotë të procedurës së prokurimit, shmangien e penaliteteve që burojnë nga kontratat të cilat do të rëndonin financiarisht institucionin, pranimin e mallit të nevojshëm për njësitë e UMT-së, si dhe përmbushjen e detyrimeve nga Autoriteti Kontraktor për pagesën e mallrave/pajisjeve në përputhje me buxhetin vjetor të miratuar.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga ana e UMT është mbajtur korrespondencë me APP, është kryer prej kësaj të fundit hetim administrativ dhe në përfundim është lidhur Marrëveshje mirëkuptimi mes AK dhe OE, me qëllim zgjidhjen e ngërçit të krijuar dhe shmangien e penaliteteve potenciale nga kontratat.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Furnizim vendosje kondicionerësh për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me urdhër prokurimi nr.267, datë 23.11.2022, me fond limit 7,479,462.55 lekë, me lloj procedure “e hapur e thjeshtuar mallra”, rezultoi se pavarësisht se është hartuar procesverbali i argumentimit të kriterëve për NJHDT nuk i ka argumentuar këto kriterë, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 4. Ndërkohë procedura e prokurimit është mallra ndërsa kriteret e kualifikimit janë vendosur për procedurë prokurimi punë, kërkesa të tejkaluara të LPP e RRPP si dhe akteve ligjore e nënligjore që kanë lidhje me procedurën e prokurimit. Kriteret e përcaktuara nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, duke sjellë mosbarazi në procedurën e prokurimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14. faqe 146 -212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

29.1 Rekomandimi: Nga Autoriteti Kontraktor, UMT të merren masa për zbatimin e drejtë të akteve ligjore e nënligjore në lidhje të ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me specifikimet teknike, ato vijnë të përcaktuara qartë nga specialistë të fushës, të cilat argumentohen sipas ligjit të prokurimit publik dhe VKM – ve përkatëse. Autoriteti Kontraktor në procedurat e realizuara në vijimësi, ka argumentuar çdo kriter të vendosur, duke i thjeshtësuar këto kriterë dhe duke shmangur konfuzionin e duke lënë tregun të hapur, në mënyrë që pjesëmarrja të jetë sa më e gjerë për operatorët ekonomik. Bashkangjitur praktika “Procesverbal - Tip i kontratës Mallra, nr.3058/16 prot., datë 30.10.2023 dhe nr.3262/20 prot., datë 31.10.2023).

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi mbi disa kampionë të përzgjedhur për të marrë siguri të arsyeshme mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, u konstatua se, në kampionet e përzgjedhur Autoriteti Kontraktor ka argumentuar kriteret e vendosur, duke i thjeshtësuar dhe duke shmangur konfuzionin e duke lënë tregun të hapur, në mënyrë që pjesëmarrja të jetë sa më e gjerë për operatorët ekonomik.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontrata së lidhur midis “K” shpk dhe Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë, me nr. 1392/4 Prot., datë 26.10.2018, me objekt “*Blerje materialesh laboratorit farmacie dhe mikrobiologjike*”, me afat 30 ditë kalendrike nga dita e nënshkrimit ose me datë përfundimi datën 24.11.2018, me vlera 2,054,205.6 lekë me tvsh, rezultoi se procesverbali i marrjes në dorëzim të pajisjeve, është me nr. 1392/12 Prot., datë 04.01.2019. Tek ky procesverbal, cilësohet se materialet janë dorëzuar në dy data të ndryshme dhe konkretisht në datën 06.11.2018 sipas faturës nr. 18905 dhe në datën 19.11.2018 sipas faturës nr. 18B004. Nga auditimi i praktikës së ndjekur për marrjen në dorëzim të materialeve dhe likuidimin e faturave përkatëse, u evidentua se: Procesverbali i mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve, është me nr. 1392/12 Prot., datë 04.01.2019. Komisioni, cilëson se materialet, kanë ardhur bashkë me faturat në dy data të ndryshme, pra në datën 06.11.2018 sipas faturës me nr. 18905 dhe në datën 19.11.2018 sipas faturës me nr. 18B004. Komisioni, nuk ka mbajtur ndonjë dokument të përkohshëm sipas faturës së parë pra të datës 06.11.2018 ose dhe të faturës së dytë atë të datës 19.11.2018, por ka mbajtur një procesverbal përmbledhës, me datë 04.01.2019 duke cilësuar se materialet kanë ardhur përpara datës së mbajtjes së

procesverbalit pa asnjë dokument të përkohshëm bashkëlidhur praktikës. Në vazhdim, në dosje u gjend fatura me nr. serial 69146278, nr. fature 18905 dhe datë 06.11.2018 dhe fatura me nr. serial 70943180, nr. Fature 18-B004 dhe datë 19.11.2018. Deri këtu, është dokumentuar fakti se kontraktori ka lëshuar faturat në këto data (brenda afatit të përcaktuar në kontratë) por jo që të ketë dorëzuar mallin i cili, dokumentohet me Fletë-Hyrjen (total 5 fletë për faturën e parë) me nr. 3, datë 04.01.2019 dhe Fletë-Hyrjen (total 2 fletë për faturën e dytë) me nr. 4, datë 04.01.2019. Urdhër shpenzimi është me nr. 78, datë 04.04.2019 dhe vlerë 2,054,206 lekë. Nga dokumentacioni i mësipërm, grupi i auditimit, vlerëson se materialet e prokuruar, nuk janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në kontratë pra brenda datës 24.11.2018, por janë dorëzuar në datën që janë bërë hyrje në magazinën e institucionit dhe konkretisht në datën 04.01.2019. Komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve, duhej të propozonte mbajtjen e penalitetit nga kontraktori “K” shpk, për dorëzimin e materialeve jashtë afateve të përcaktuara, në referencë të pikës 24.1, të nenit 24 “Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar”, të kontratës nr.1392/4 Prot., datë 26.10.2018 ku cilësohet se “Për kontratat me periudhë zbatimi jo me shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”. Megjithatë nuk është e dokumentuar se është vepruar konform pikës 36, pikës 37 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, dhe pikës 44 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, kontraktorit “K” SHPK, duhej ti mbahej penaliteti nga FM në vlerën 2,054,206 lekë / 4 = **513,552 lekë**.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14/1. faqe 212 -221 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: Nga FM të Universitetit të Tiranës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **513,552 lekë**, nga “K” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të kontratës jashtë afateve të përcaktuara.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Administratori i UMT-së me shkresën nr. 746 prot., datë 11.03.2024, “Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimit kontraktor (dëmit ekonomik) për llogari të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, i është drejtuar shoqërisë “K” shpk dhe e ka informuar mbi rekomandimin e KLSH-së dhe detyrimin për të arkëtuar vlerën prej **513,552 lekë** (pesëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë për llogari të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. “K” shpk me shkresën nr. 60 prot., datë 15.03.2024, “Kthim përgjigje”, ka informuar UMT-në se ka përmbushur detyrimet kontraktuale brenda afatit të përcaktuar në kontratë si dhe ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacion (procesverbali i mbajtur nga FM me nr. 1392/12 prot., datë 04.01.2019). Administratori i UMT-së me shkresën nr. 746/2 prot., datë 19.03.2024, i është drejtuar Fakultetit të Mjekësisë për t’i kërkuar vendosjen në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës së shoqërisë “K” shpk. Në përgjigje, Fakulteti i Mjekësisë me shkresën nr. 927/1 prot., datë 17.04.2024 (protokolluar në Rektorat me nr. 746/3 prot., datë 18.04.2024) ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar nga shoqëria “K” shpk.

UMT me shkresën nr. 746/4 prot., datë 24.04.2024, i ka përcjellë shoqërisë “K” shpk dokumentacionin e kërkuar. Shoqëria “K” shpk me shkresën nr. 93 prot., datë 30.04.2024, (protokolluar në institucion me nr. 746/5 prot., datë 18.04.2024), ka informuar se dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga UMT nuk është ai i kërkuar dhe se mbeten në pritje të procesverbalit të FM-së me nr. 1392/12 prot., datë 04.01.2019. Administratori i UMT-së me shkresën nr. 746/6 prot., datë 14.05.2024, i është drejtuar FM-së dhe i ka përcjellë kërkesën e Shoqërisë “K” shpk për t’i vendosur në dispozicion procesverbalit e mbajtur nga FM me nr. 1392/12 prot., datë 04.01.2019. Fakulteti i Mjekësisë me shkresën nr. 927/3 prot., datë 03.07.2024 (protokolluar në Rektorat me nr. 746/7 prot., datë 03.07.2024), ka përcjellë në Rektorat dokumentacionin e kërkuar.

Administratori i UMT-së me shkresën nr. 746/8 prot., datë 05.07.2024, i është drejtuar shoqërisë “K” shpk, dhe i ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar, *Procesverbal nr. 1392/12 prot., datë 04.01.2019* si dhe ka sqaruar se ky procesverbal i është vendosur në dispozicion nga UMT edhe më herët me shkresën nr. 746/4 prot., datë 24.04.2024, por për shkak të shumëfishimit të tij disa herë numri i protokollit është bërë i palexueshëm.

Sa më sipër, UMT, pas korrespondencës shkresore me shoqërinë “K” shpk, ka kërkuar që brenda 30 ditëve nga marrja e dokumentacionit të kërkuar, të arkëtohet nga kjo shoqëri vlera prej **513,552 lekë** (pesëqind e trembëdhjetë mijë e pesëdhjetë e dy) lekë për llogari të universitetit në të dhënat bankare të vendosura në dispozicion. Në rast të mosarkëtimit të kësaj vlere brenda afatit të sipërcituar, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë do i drejtohet Gjykatës kompetente.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion, mes UMT (Administratori i UMT-së) dhe shoqërisë “K” shpk është mbajtur korrespondencë e cila daton prej muajit mars 2024, bazuar në shkresën e fundit nr. 746/8 prot., datë 05.07.2024 të Administratorit të UMT-së drejtuar shoqërisë “K” shpk është vendosur afati 30 ditor për akëtimin e vlerës. Sa më sipër ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i projektit: “Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore në mënyrë simulante me rivaskularizimin kirurgjikal tek zemrat humane të infarktuara nëpërmjet implantimit të qelizave staminale autologe në rrugë të ndryshme, një studim eksperimental”, rezultoi se:

Për këtë projekt fondet e miratuara për vitin 2019, janë mbështetur në kontratën nr.2179/2 prot., datë 16.09.2019, të lidhur ndërmjet UMT-së dhe AKKSHI-së, si dhe planit financiar shoqërues, dhe do të përdoren për blerje aparaturash për zhvillimin e projektit, ndërkohë këto fonde janë detajuar në llogarinë 602 “Mallra dhe shërbime” nga AKKSHI dhe jo sipas kontratës së lidhur në llogarinë investime.

Nga auditimi rezulton se pajisja është blerë në vlerë totale 8,304,000 lekë, është bërë hyrje në Fakultetin e Mjekësisë nëpërmjet fletë-hyrjes nr.7 datë 16.10.2020 dhe është likuiduar pranë Degës së Thesarit në datën 12.11.2020 nëpërmjet urdhër-shpenzimit nr.164, në llogarinë e të ardhurave të institucionit dhe jo në llogarinë përkatëse të projektit, pra duke përdorur si burim financimi të ardhurat e institucionit në buxhetin e vitit 2020, ndërkohë që kjo pagesë duhet të ishte kryer në llogarinë përkatëse të projektit.

Për këtë projekt vetëm sa janë blerë pajisjet, në shumën 8,3 milion lekë që në datë 16.10.2020 dhe deri në përfundimin e auditimit në terren, pajisjet nuk janë vënë në punë, për një periudhë 3 vjet, duke kaluar të gjitha afatet e garancive dhe mirëmbajtjes. Gjithashtu nuk është vazhduar me procedurat e tjera për shpenzimet për mallra që duhen për vënien në punë të tyre, duke sjellë mos efektivitet në përdorimin e fondeve në shumën **8,304,000 lekë**.

Nga auditimi i bazës ligjore mbi të cilën vepron UMT, rezulton se ky sistemimi i fondeve është detyrë e Rektoratit, kjo bazuar në: kontratën e lidhur nr.2179/2, datë 16.09.19, të lidhur midis AKKSHI dhe për përfituesin Drejtuesi projektit e Rektori i UMT, nenet: 6, “Detyrimet e përfituesit”, neni 13, “Ndryshimet e kontratës”, Neni 16, “Sanksionet”, Neni 17, “Zgjidhja e

konflikteve”, si dhe bazuar në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.659/5, datë 03.03.2020, Vendim nr.16, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme të ndryshuar, “për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në UMT”, neni 49, “Rishpërndarja (rishikimi)”, pika 2/a. Nga mosveprimet e Rektoratit të UMT, nga ana e AKKSHI është kërkuar rikthimi i fondeve në llogarinë e saj, duke ndërprerë projektin.

Në marrjen në dorëzim rezultoi se: Certifikata e instalimit, testimi dhe trajnimit, datë 16.10.2020 e subjektit “F” shpk, e firmosur edhe nga grupi i marrjes në dorëzim, shkruan: “Unë i nënshkruari, O S, në cilësinë e përfaqësuesit të OE “F” shpk, deklaroj se janë instaluar, testuar dhe është bërë trajnimi i stafit përgjegjës për përdorimin e produkteve të ofertuar për prokurimin”.

Ndërkohë në DST e procedurës përkatëse të prokurimit në lidhje me trajnimin, flitet vetëm në kapacitetin teknik (pika 2.3/8) ku është përcaktuar se: 2.3/8: Për kapacitetin teknik: 8-Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 2 inxhinier njëri prej tyre i diplomuar në profilin Inxhinieri Klinike dhe tjetri Inxhinier Elektronik\ Elektrik, të cilët duhet të jenë përgjegjës për instalim dhe trajnim të stafit mjekësor.”. Nuk ka asnjë të dhënë se kush do të trajnohet, sa ditë do të zgjasë ky trajnim. Faktikisht rezultoi se:

- nuk ka asnjë të dhënë nëse 2 pajisjet janë instaluar pasi ato ndodhen në pavijon, thuhet se nuk janë vënë në punë, në gjendjen sipas fotos sa vijon:

- vëmë në dukje faktin se procesverbali i marrjes në dorëzim, fletë hyrja e FM (nr.7, datë 16.10.2020.), fatura tatimore e kontraktorit (nr.460, datë 16.10.2020,) dhe certifikata e instalimit, testimi dhe trajnimit, mbajnë të njëjtën datë 16.10.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.12. faqe 133 -143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: Nga ana e UMT të analizohet situata e krijuar, të nxirren përgjegjësitë si dhe të merren masa të menjëhershme për vënien në funksion të pajisjeve mjekësore.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Nga ana e Fakultetit të Mjekësisë ky rekomandim është në vëmendje dhe është në proces trajtimi pasi institucioni ka qënë në proces zgjedhesh dhe në vazhdim do të merren masa të mëtejshme për vendosjen në punë të kësaj pajisjeve mjekësore nga personat përgjegjës.

Komenti i grupit të auditimit.

Përsa i takon këtij rekomandimi nga ana e UMT nuk rezultoi prania e gjurmës së marrjes së masave të nevojshme dhe të mjaftueshme për ta zbatuar (pavarësisht situatës së zgjedhjeve). Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues ky rekomandim konsiderohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje të pajisjeve mjekësore laboratorit për Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë”, të zhvilluar me urdhër prokurimi nr. 175, datë 31.10.2019, me fond limit 32,285,492 lekë, nga vlerësimi jo në përputhje me kriteret e veçanta për kualifikim të DST, në kushtet kur asnjë OE nuk është i vlefshëm KVO duhet të anulonte procedurën e prokurimit, bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 73, “Mungesa e konkurrencës”. Me veprimet e mosveprimet e KVO ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve në shumën **22,499,700 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14. faqe 146 -212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandim: Nga ana e Administratorit të UMT, të nxirren përgjegjësitë, të analizohet vlera e efektit ekonomik financiar dhe të marrë masa që në të ardhmen fondet të shpenzohen sipas parimeve të eficensës, economicitetit dhe efikasitetit.

Përgjigja e institucionit:

Rekomandim i pranuar pjesërisht pasi është e pamundur të përcaktohet vlera e efektit ekonomik financiar. Pranohet pjesa e mbetur e rekomandimit, që në të ardhmen fondet të shpenzohen sipas parimeve të eficensës, ekonomicitetit dhe efikasitetit.

Komenti i grupit të auditimit.

Përsa i takon pjesës së pranuar të këtij rekomandimi nga ana e UMT nuk është vendosur në dispozicion dokumentacionit justifikues për të provuar statusin e zbatueshmërisë së tij.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt: “*Rikonstruktion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT*”, të zhvilluar sipas urdhër prokurimit nr.307, datë 30.12.2022, me fond limit 18,059,998.7 lekë rezultoi se: Kjo procedurë prokurimi është anuluar 3 herë datat 14.10.2021 dhe 10.12.21, 11.05.2022. Herën e tretë është anuluar me vendim të KPP nr.404/2022, me nr. 713/6, datë 29.04.2022.

Në të tre herët, si dhe në procedurën me Urdhër Prokurimi nr. 307, datë 30.12.22, në asnjë rast nuk është kryer oponenta teknike për projektin që do të prokurohet, në kundërshtim me: ligjin nr. 120/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, Neni 2. Nisur nga fakti që objekti ku do të bëhet investimi është monument i kategorisë së të II-të, në dosje nuk ka asnjë dokumentacion që të vërtetojë zbatimin e ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Preventivi i hartuar paraqitet si përmbledhje e tre preventivave Nuk ka një dokument që të vërtetojë se çfarë zërash janë hequr nga preventivat e zbatimit të punimeve të tenderuar më parë, për të cilët është bërë dhe pagesa, me efekt negativ, pasi detyrat e projektimit të prokuruar kanë dalë pa efektivitet në shumën totale 915,000 lekë. Nuk ka asnjë urdhër Titullari për bashkimin e këtyre preventivave, për zërat e hequr apo të shtuar. Për projektin dhe preventivin për punimet e h/izolim tarrace dhe punime rrufepritësi, rezulton të jenë kryer nga Drejtoria e shërbimeve. Nga auditimi rezulton se projekti nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse, në kundërshtim me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Nuk ka dokument se kush ja ka dhënë njësisë së prokurimit dokumentacionin. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim është kërkuar paraqitja e dokumentacionit ligjor administrativ dhe jo me vet deklaram, kërkesë kjo e ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 82, “Formulari përmbledhës i vetë deklaramit”. NJHDT nuk i ka argumentuar kriteret të cilat janë të paargumentuara dhe jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 4.

Në fazën e vlerësimit KVO ka shpallur fitues BOE “I” shpk & “K..” shpk & “S” shpk me ofertë ekonomike 18,037,348.8 lekë, dhe ka s`kualifikuar me të padrejtë OE “2N” shpk me vlerë të ofertës 14,610,929 lekë, me një diferencë 3,426,419.80 lekë, duke mos konstatuar faktin se NJHDT nuk ka kërkuar vetëdeklarime por dokumentacion në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 75, “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, pika 4. KVO, nuk ka zbatuar aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik, duke mos i njohur ato.

Nga veprimet dhe mosveprimet e NJHDT dhe KVO është shpallur fitues BOE "I" shpk "K.." shpk, "S" shpk, me vlerë të ofertës 18,037,348.8 lekë në kushtet kur nuk plotëson kriteret dhe është s'kualifikuar OE "2..N.." shpk, me ofertë 14,610,929 lekë ose 3,426,419.80 lekë më pak, në kushtet kur NJHDT i ka kërkuar në kundërshtim me LPP vërtetimin e kriterëve dhe KVO ka vlerësuar pa njohur aktet ligjore dhe nënligjore të LPP, duke shkaktuar dëm me efekt negativ në shumën **3,426,419.8 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.14. faqe 146 -212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, të analizojë situatën e krijuar dhe të ndër marrë masat e duhura për zbatimin e procedurave të prokurimit publik, në të gjitha fazat që nga planifikimi e deri në lidhjen e kontratës.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Autoriteti Kontraktor me anë të grupeve përkatëse si njësi dhe komisionet administrojnë dosjen, deri tek lidhja dhe realizimi i kontratës. Personat përgjegjës të dosjes, përveç administrimit të saj, mbajnë kontakte me Agjencinë e Prokurimit Publik dhe Komisionin e Prokurimit Publik në rast të ankesave, për zgjidhjen e problematikave dhe zbatimin në mënyrë rigorozë të Ligjit për prokurimin publik, VKM dhe akte të tjera nënligjore. Është anuluar kontrata e zbatimit dhe supervizimit me Akt Marrëveshje nr.3014/3 prot., datë 11.01.2024 bashkangjitur dokumentacioni.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga ana e AK UMT me Akt Marrëveshje mes palëve (UMT me T shpk , BOE I" shpk "K.." shpk, "S" shpk), shkresa me nr.30147/3 prot., datë 11.01.2024 protokolluar në UMT, është anuluar kontrata e zbatimit dhe supervizimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***e zbatuar***.

D. MASA DISIPLINORE

PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

Mbështetur në nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1996, "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në Urdhrin e Administratorit të UMT-së "*Për emërim me kontratë me afat të pacaktuar të personelit administrativ në administratën e Rektoratit të UMT-së*", neni 10, "Masat disiplinore", pika2/d, të kontratës individuale të punës, i kërkojmë Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit të japë masën:

a- "Largim nga puna", për punonjësit e mëposhtëm:

- 1. N.D,** Anëtar e komisionit të vlerësimit të ofertave të tenderit "Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT", sipas urdhrin të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 308, 30.12.2022.
- 2. M.C,** Anëtar e komisionit të vlerësimit të ofertave të tenderit "Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT", sipas urdhrin të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 308, 30.12.2022.
- 3. E.T,** Anëtar e komisionit të vlerësimit të ofertave të tenderit "Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT", sipas urdhrin të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 308, 30.12.2022.

4. **P.L.**, Anëtar e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”, sipas urdhër prokurimit nr. 307, datë 30.12.2022

b- “Vërejtje me paralajmërim” – deri në “Largim nga puna”

1. **E.H.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore.

Pedagogët e jashtëm të kontraktuar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, kanë dhënë mësim tek studentët përkatës sipas cikleve të studimit dhe njëkohësisht janë likuiduar për këto orë mësimi, pa pasur në fillim një kontratë pune me fakultetin përkatës. Miratimi dhe vendimi i shpalljes së fituesve për vendet vakante për pedagogë me kohë të pjesshme, është bërë në Muajin Maj 2020 kur pedagogët kanë qenë të domosdoshëm në Tetor 2019. Pedagogët e kontraktuar me vonesë nga Rekorati, rezultojnë ligjërisht të kenë dhënë orë mësimi dhe të kenë kryer vlerësimet respektive për orët e mësimdhënies të zhvilluara, pa patur më parë një kontratë punësimi me Universitetin Mjekësor të Tiranës. Pedagogët e jashtëm, të kontraktuar nga UMT, kanë kryer punën e pedagogut dhe njëkohësisht kanë certifikuar studentët për lëndët mësimore të dhëna ndaj tyre, pa patur marrëdhënie pune ligjore (pasi kontratat rezultojnë të nënshkruara pas kryerjes së mësimdhënies ose me efekt prapaveprues) me Universitetin e Mjekësisë. Kjo gjë, përveç faktit që sjell parregullsi të karakterit ekonomik-administrativ në Universitetin e Mjekësisë, njëkohësisht, mund të krijojë dhe probleme juridike në të ardhmen, lidhur me vlefshmërinë e shërbimit të mësimdhënies. Gjithashtu, ky shërbim, i ligjëruar pas kryerjes së tij, e bën të pamundur kontrollin në përputhje me legjislacionin në fuqi për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si nga Auditimi i Brendshëm ashtu edhe nga ai i Jashtëm, në kohën e ofrimit të këtij shërbimi.

c- Për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

Përgjigja e institucionit:

Arsyeja e rekomandimit të KLSH-së për marrjen e masës disiplinore “Largim nga Puna” për punonjësit në marrëdhënie Pune, konkretisht, N.D, M.C, E.T dhe P.L, ka qenë procedura e prokurimit të nisur nga UMT me objekt “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”. Duke qenë se kjo procedurë nuk është zhvilluar dhe kontratat përkatëse janë anuluar dhe dëmi është shmangur, këtyre punonjësve do ju jepet masa disiplinore “Vërejtje me Shkrim”.

Për punonjësin E.H gjerëse se, masa e propozuar nuk është proporcionale me gjetjen, bazuar në faktin se procedura e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme është procedurë komplekse, në të cilën marrin pjesë shumë struktura dhe punonjës të ngarkuar nga ligji nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe aktet e brendshme rregullatore të UMT-së, Statuti dhe Rregullorja e Brendshme. Këtij punonjësi do t’i jepet masa disiplinore “Vërejtje me Shkrim”. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë në zbatim të rekomandimit të KLSH-së, me Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr. 15, datë 06.02.2024, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, ka urdhëruar dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” për z. E.H, në pozicionin e punës Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore” në UMT.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë në zbatim të rekomandimit të KLSH-së, me Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr. 14, datë 06.02.2024, “Për dhënien e masës disiplinore “Tërheqje vëmendje”, ka urdhëruar dhënien e masës disiplinore “Tërheqje vëmendje” për z. F.E, në pozicionin e punës “Specialist IT” në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, në UMT.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë në zbatim të rekomandimit të KLSH-së, me Urdhrin e Administratorit të UMT-së nr. 35, datë 06.02.2024, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje

me shkrim”, ka urdhëruar dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” për znj. M.C, në pozicionin e punës “Specialiste në Drejtorinë Ekonomike në Rektoratin e UMT-së.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë në zbatim të rekomandimit të KLSH-së, me Urdhrin e Administratorit të UMT-së nr. 36, datë 06.02.2024, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, ka urdhëruar dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” për znj. E.T, në pozicionin e punës “Specialiste në Sektorin e Koordinimit Institucional” në Rektoratin e UMT-së.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë në zbatim të rekomandimit të KLSH-së, me Urdhrin e Administratorit të UMT-së nr. 37, datë 06.02.2024, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, ka urdhëruar dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” për z. P.L, në pozicionin e punës “Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse” në Rektoratin e UMT-së.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë në zbatim të rekomandimit të KLSH-së, me Urdhrin e Administratorit të UMT-së nr. 38, datë 06.02.2024, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, ka urdhëruar dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” për znj. N.D, në pozicionin e punës “Drejtore në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse” në Rektoratin e UMT-së.

Arsyeja e rekomandimit të KLSH-së për marrjen e masës disiplinore “Largim nga Puna” për punonjësit në marrëdhënie Pune, konkretisht, N.D, M.C, E.T dhe P.L, ka qenë procedura e prokurimit të nisur nga UMT me objekt “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”. Duke qenë se kjo procedurë nuk është zhvilluar dhe kontratat përkatëse janë anuluar dhe dëmi është shmangur, UMT ka vendosur që këtyre punonjësve t’ju jepet masa disiplinore “Vërejtje me Shkrim”.

Lidhur me dhënien e masës disiplinore për z. E.H, UMT ka gjykuar se, masa e propozuar nga KLSH nuk është proporcionale me gjetjen, bazuar në faktin se procedura e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme është procedurë komplekse, në të cilën marrin pjesë shumë struktura dhe punonjës të ngarkuar nga ligji nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe aktet e brendshme rregullatore të UMT-së, Statuti dhe Rregullorja e Brendshme. Nisur nga ky argument, këtij punonjësi i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me Shkrim”. *Rekomandim pjesërisht i pranuar.*

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion dhe argumentimit të kryer nga ana e UMT (personat përgjegjës për trajtimin e zbatimit të rekomandimeve) rezulton se, masat disiplinore “Largim nga Puna” për punonjësit në marrëdhënie Pune, janë parashikuar për procedurën e prokurimit të nisur nga UMT me objekt “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”. Duke qenë se kjo procedurë nuk është zhvilluar dhe kontratat përkatëse janë anuluar duke bërë që vlera e dëmit të shmanget, UMT ka vendosur që këtyre punonjësve t’ju jepet masa disiplinore “Vërejtje me Shkrim”.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

D.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte:

“Largim nga puna” përkatësisht për:

1. S.Sh, në cilësinë e ish Administratorit të UMT.

2. **L.LI**, Anëtar e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”, sipas urdhër prokurimit nr. 307, datë 30.12.2022
3. **A.L**, Anëtar e njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit “Rikonstruksion i sallave të Rektoratit dhe çatisë së UMT”, sipas urdhër prokurimit nr. 307, datë 30.12.2022
4. **F.Zh**, me detyrë ish Shef i Sektorit të shërbimeve, për përgatitjen e preventivave.
“Vërejtje me paralajmërim” përkatësisht
 1. **E.D**, me detyrë Specialiste, Drejtoria e Shërbimeve, për periudhën 01.06.2018-01.09.2023;
 2. **G.N**, me detyrë Përgjegjës, Sektori Prokurimeve për periudhën 23.08.2021-09.02.2022
 3. **G.A**, me detyrë Sekretare mësimore/Specialiste Finance, për periudhën 01.01.2016-20.12.2021
 4. **L.K**, me detyrë Drejtor, Drejtoria Shërbimeve, për periudhën 17. 04.2018-10.08.2022
 5. **Zh.D**, me detyrë Administratore e FM, për periudhën 15.01.2015-10.11.2021

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (Administratori), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar

Përgjigjja e institucionit:

Rekomandimi nuk pranohet.

Marrëdhëniet e punës për personelin ndihmësakademik dhe administrativ në institucionet publike të arsimit të lartë rregullohen nga Kodi i Punës, për këtë arsye, ky personel nuk i nënshtrohet zbatimit të dispozitave për punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkretisht, ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 2, Fusha e veprimit, përcakton se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës (në vazhdim “nëpunës civil”), që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, me përjashtim të: ...ë) personelit të njësive publike direkte të shërbimit; Referuar nenit 4, Përkufizime, në pikën 1, shkronja “dh”, janë përcaktuar se, cilat subjekte do të quhen në kuptim të këtij ligji “Njësi publike direkte shërbimi” e konkretisht “Njësi publike direkte shërbimi” është njësi administrative që kryen drejtpërdrejt për qytetarët shërbimet publike të arsimit parauniversitar e universitar, kujdesit shëndetësor, kulturës, sportit, artit, ndihmës sociale dhe shërbimet e tjera shoqërore.

Në këto kushte, UMT-ja nuk ka detyrimin që të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Bazuar në aktet e brendshme rregullatore të UMT-së, pasi jepet një masë disiplinore për një punonjës, ajo depozitohet në dosjen personale të punonjësit.

Komenti i grupit të auditimit.

Ky rekomandim *nuk është pranuar*

G-TË TJERA

Bazuar në gjetjet nga auditimi i ushtruar, gjatë faktit dhe referuar ankesës së ardhur nga një grup studentësh të Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, e protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 738/1, datë 12.09.2023, rekomandojmë sa vijon:

1. Gjetje nga auditimi: UMT, për tarifën e programeve të studimit, nuk ka kryer një metodologji për llogaritjen e tyre deri në shtator 2023 (periudhë e përfundimit të auditimit në terren). Bazuar në VKM nr. 288, datë 23.07.2018, i cili parashikon një tavan kufi për tarifën e ciklit të parë dhe të dytë të integruar të studimit, UMT-ja, mjaftohet duke vendosur në kufijtë e këtij tavani, tarifën për program studimi, pa i nxjerrë ato mbi bazën e një analize profesionale tekniko-ekonomike. Sipas parashikimeve të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, Bordi i Administrimit duhet të vendosi tarifën e shkollimit pasi të ketë ndjekur një metodologji të llogaritjes së tyre, duke respektuar kufirin maksimal të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Tarifën e aplikuar nga UMT dalin mbi bazën e një reference në lidhje me shpenzimet hipotetike të vitit koherent, duke marrë për bazë shpenzimet e vitit të mëparshëm. Këto tarifa në asnjë rast nuk janë rishikuar pas përfundimit të vitit akademik, nëse ato bazohen në një analizë reale të vitit koherent. Aktualisht me miratimin e VKM nr. 527, datë 07.09.2023 “Për caktimin e metodologjisë së kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi”, është dërguar dhe lista e zërave të përfshira në analizën e kostos, ku një nga zërat është dhe zëri “Shpenzime për bursa”. Vlen të theksohet fakti se, vendosja e kësaj vlere në tabelën e kalkulimit të kostove direkte, **rrit riskun për një llogaritje jo reale të saj**. Rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga UMT-ja dhe vlerësimi i tarifave mbi bazën e një analize kostoje reale, mund të ndikonin pozitivisht në uljen e tarifave të studimit dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të këtyre shërbimeve ndaj studentëve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.15. faqe 221 -232 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Bordi i Administrimit të tij, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, të marrin masa për rishikimin e tarifës së studimit për ta hartuar atë mbi bazën e një analize profesionale tekniko-ekonomike, duke pasur parasysh rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve, të përcaktojnë tarifën e studimit referuar kostove reale, pa përfshirë koston e studentëve ekselencë, e cila duhet të paguhet nga buxheti i shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

UMT me shkresën nr. 1421/64 prot., datë 15.04.2024, i është drejtuar MAS në vijim të rekomandimit të KLSH se , Universiteti i Mjekësisë, Tiranë nuk ka parashikuar një metodologji për përcaktimin e tarifave të programeve të studimit, por bazuar në VKM nr. 288, datë 23.07.2018 (i cili parashikon një tavan kufi për tarifën e ciklit të parë dhe të dytë të integruar të studimit), mjaftohet duke vendosur në kufijtë e këtij tavani, tarifën për program studimi, pa i nxjerrë ato mbi bazën e një analize profesionale tekniko-ekonomike.

Në ligjin nr. 80/2015, në nenin 6, pika 31 përcaktohet se, tarifa e studimit përfshin tarifën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit. Ndërkohë, në nenin 7, pika 2, shkronja f) të këtij ligji përcaktohet se, Ministria përgjegjëse për arsimin i propozon Këshillit të Ministrave kufirin maksimal të tarifës së shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë në institucionet publike të arsimit të lartë.

Aktualisht, me VKM-në nr. 527, datë 07.09.2023, është miratuar metodologjia e përcaktimit të kostos së studimeve vetëm për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë.

Në përfundim, kemi kërkuar nga MAS marrjen e masave të nevojshme, për plotësimin e kuadrit ligjor për përcaktimin e tarifave për programet e studimit, me qëllim zbatimin e kësaj metodologjie për përcaktimin e tarifave të studimit, edhe për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, të ofruara nga UMT.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

1.2 Rekomandim: Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Bordi i Administrimit të tij, të marrin masat për dërgimin e propozimeve të nevojshme ligjore tek MAS, lidhur me tarifimin e studentëve për çdo vit akademik, pasi viti akademik të ketë përfunduar, me qëllim që tarifa që do të paguajnë studentët të jetë në përpjesëtim të drejtë me shpenzimet reale të kryera gjatë vitit akademik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

UMT me shkresën nr. 1421/64 prot., datë 15.04.2024, i është drejtuar MAS në vijim të rekomandimit të KLSH-së, dhe ka kërkuar nga MAS marrjen e masave të nevojshme, për plotësimin e kuadrit ligjor për përcaktimin e tarifave për programet e studimit, me qëllim zbatimin e kësaj metodologjie për përcaktimin e tarifave të studimit edhe për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, të ofruara nga UMT.

Komenti i grupit të auditimit.

UMT në rolin e zbatuesit i është drejtuar MAS (me shkresën nr. 1421/64 prot., datë 15.04.2024) dhe ka kërkuar prej saj marrjen e masave të nevojshme, për plotësimin e kuadrit ligjor për përcaktimin e tarifave për programet e studimit, me qëllim zbatimin e kësaj metodologjie për përcaktimin e tarifave të studimit edhe për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, të ofruara nga UMT.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit, kryer prej grupit të auditimit të KLSH-së rezulton se niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) 2 Masa për Përmirësim të Legjislacionit në fuqi, nga ku 2 rekomandime, janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit 2 pjesërisht zbatuar ;
- b) 30 Masa Organizative nga ku 37 rekomandime, janë pranuar plotësisht kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 17 zbatuar, 16 pjesërisht zbatuar dhe 4 pazbatuar;
- c) 1 Masë Shpërblim Dëmi nga ku 1 rekomandim, është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit 1 pjesërisht zbatuar;
- d) 3 Masa për Menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, nga ku 3 rekomandime, janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit 2 të pazbatuar dhe 1 i zbatuar;
- e) 2 Masa Disiplinore nga ku 2 rekomandime, është pranuar plotësisht 1 dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit 1 zbatuar ;

Për sa më sipër, ri kërkojmë që, Universiteti Mjekësisë, Tiranë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar, brenda 3 muajve të parë të vitit 2025 si dhe kërkojmë analizimin dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.2 UNIVERSITETI I SPORTEVE, TIRANË

PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST)** mbi *“Zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023”* për auditimin tematik të kryer në vitin 2023, përcjellë me shkresën Nr.399/20 Prot., datë 21.12.2023 duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

- a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
- b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
- c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efizienz dhe ekonomikitet të fondeve;
- ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, si dhe manualit *“Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”*.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 792/1 prot., datë 01.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. E.S, (*Përgjegjës grupi*)
2. J.B

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr.399/20 prot., datë 21.12.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditimi i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Spitali Universitar i Traumës, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr.1200/8 Prot., datë 19.07.2023, rezulton se, nga 7 masa të rekomanduara (*organizative dhe disiplinore*), janë pranuar nga subjekti 7 masa të rekomanduara ose 100 %. **Nga të pranuarat (7):** janë zbatuar plotësisht 4 masa, ose 57.2 % e tyre, si edhe janë zbatuar pjesërisht 3 masa ose 42.8 %

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit		
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
1	Organizative	6 masa	4 masa	2 masa	-
2	Masa Disiplinore	1 masë	-	1 masë	-
	<i>Gjithsej</i>	7 masa	4 masa	3 masa	-

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 57.2 % dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve që mbajnë statusin pjesërisht zbatuar është 42.8 %

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1- Hartim i programit (Plan veprimi) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Universiteti Sporteve, Tiranë (UST), ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën Nr. 152 Prot., datë 15.01.2024.

III/2- Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna dhe dërguar me shkresën Nr.3608/1 Prot., datë 26.06.2024, në zbatim të Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, **Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre**, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje profesionale”, me REF -066325-04-30-2018, viti 2018, u konstatuan parregullsi në hartimin e regjistrave të prokurimeve dhe identifikimin e nevojave të institucionit për pajisjet e tenderuara. Për këtë procedurë nuk janë administruar kërkesat apo procesverbalet e inicimit të procedurës për të justifikuar nevojën e kryerjes së saj. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM 914, datë 24.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 12, pika 2.a, “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor” si dhe me Udhëzimin nr. 09 datës 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

1.1 Rekomandim:

Nga UST të merren masa për administrimin e kërkesave për identifikimin e nevojave reale të institucionit për mallra dhe shërbime, duke i pasqyruar në projektbuxhetet përkatëse dhe në regjistrat e parashikimeve për prokurimet publike, sipas përcaktimeve të ligjeve në fuqi.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Universiteti i Sporteve të Tiranës në zbatim të vendimeve dhe shkresave të mësipërme ka nxjerrë Urdhërin e Brendshëm të Administratorit nr.14 datë 22.01.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve për auditimin tematik të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Për vitin 2024 hartimi i Rregjistrat të Prokurimeve Publike, është hartuar duke u mbështetur në kërkesat buxhetore të njëjësive dhe drejtorive përkatëse të pasqyruara në PBA për periudhën 2024-2026, si dhe Grantin e vitit 2024 miratuar me vendime të organeve kolegjiale të UST-së.

Në vijim të procesit të përgatitjes së PBA për vitet 2025-2027, është nxjerrë Urdhër i Përbashkët nr.7, datë 03.04.2024, nr.100 prot “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Afatmesëm Puxhetor për periudhën 2025-2027 për UST”. Në bazë të këtij urdhëri janë depozituar kërkesat buxhetore nga njësitë dhe drejtoritë e UST-së përkatësisht:

shkresa nr.1194/3 prot, datë 26.03.2024 “Përcjellje e propozimeve të PBA për vitet 2025-2027 për FSHL”, shkresë e FSHR me nr.1223/4 prot, datë 16.05.2024 “Përcjellje e propozimeve të PBA për vitet 2025-2027”, shkresë e FVFR me nr.1223/3 prot., datë 30.04.2024 “Përcjellje e propozimeve të PBA për vitet 2025-2027”, shkresë me nr. 1493 prot datë 31.05.2024 e sektorit të prokurimeve “Përcjellje e propozimeve të PBA për vitet 2025-2027”, shkresë e Drejtorisë marrëdhënies me jashtë publikun e studentët me nr. 1496 prot, datë 31.05.2024, “Kthim përgjigje”, shkresë e IKSHS me nr. 1539 prot, datë 06.06.2024 “IKSHS-Program buxhetor 2025-2027”, shkresë e Drejtorisë Juridike dhe Zhvillimit të Kurikulave me nr. 1367 prot, datë 16.05.2024, shkresë e Drejtorisë së Burimeve Njerzore dhe Arkiv Protokollit nr.1229 prot datë 29.04.2024, shkresë nr. 1248 datë 30.04.2024 “Kthim përgjigje”, shkresë nr.1495 datë 31.05.2024, shkresë nr.1248 datë 30.04.2024. Vazhdon procesi i përpunimit të të dhënave nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të UST-së.

Për vitin 2024 hartimi i Rregjistrat të Prokurimeve Publike është kryer duke u mbështetur në kërkesat buxhetore të njëjësive dhe drejtorive përkatëse të pasqyruara në PBA për periudhën 2024, si edhe në Grantin e vitit 2024 miratuar me Vendime të organeve kolegjiale të UST-së.

Komenti i grupit të auditimit

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, nr.399/20 datë 21.12.2023, nga ana e Administratorit është nxjerrë Urdhëri i Brendshëm nr.14, datë 22.01.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve për auditimin tematik të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

Nga auditimi, për procedurën e prokurimit REF-03808-05-07-2024 me objekt: “Kurs mësimor sporte ujore, për Studentët Bachelor dhe Metodika e Organizimit të Sporteve Ujore, për Studentët e Masterit Profesional - Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit”, parashikuar në zërin nr.48 të Regjistrat të Prokurimeve Publike të miratuar me Vendimin nr.12,

datë 15.02.2024 të Bordit të Administrimit, janë kryer procedurat si më poshtë:

-Kërkesë e Fakultetit Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit (FVFR) nr 1160/1 prot, datë 22.04.2024, përcjellje e dokumentacionit mbi zhvillimin e programeve outdoor në Jalë me studentët e ciklit të parë Bachelor dhe ciklit të dytë Master Profesional, si edhe “Aktivitet Fizike dhe Rekreacioni-Trajner Fitnesi” për vitin akademik 2023-2024.

-Kërkesë e departamentit të FVFR nr.1160, datë 22.04.2024 “Për materialet e nevojshme për zhvillimin e moduleve outdoor në Jalë” dhe itinerari, lista e pedagogëve pjesëmarrës sipas grupeve studentore, mjetet e transportit, të mbështetura sipas rregullores së brendshme për zhvillimin e aktiviteteve të grupuara etj.

- Kërkesë nr.1160/2 prot, datë 25.04.2021 e Administratorit, drejtuar FVFR për specialistë të fushës për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit.

-Urdhër i Brendshëm nr.31, datë 25.04.2024, nr.1160/4 prot, për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit.

-Procesverbal nr.1160/5 prot, datë 29.04.2024 i komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit.

- Urdhër Prokurimi nr.18, datë 30.04.2024, nr.1160/8 prot.

- Urdhër i Brendshëm nr.33, datë 30.04.2024, nr.1160/9 prot, për ngritjen e komisionit për vlerësimin e ofertave.

Në vijim të procesit të përgatitjes së PBA për vitet 2025-2027, është nxjerrë Urdhër i Përbashkët nr.7 i Rekorit dhe Administratorit, nr.100 prot, datë 03.04.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit Afatmesëm Puxhetor për periudhën 2025-2027 për UST”. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

1.2 Rekomandimi:

Nga UST të merren masa për trajnimin e punonjësve që angazhohen në realizimin e procedurave të prokurimit me synim realizimin e tyre me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka bërë përpjekje të vazhdueshme në këtë drejtim.

Me shkresë nr.1251 prot, datë 30.04.2024 të Administratorit i jemi drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, për trajnim të stafit për ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmit të tyre, në kuadër të zbatimit me rigorozitet të legjislacionit të prokurimit publik. Po ashtu i jemi drejtuar Departamentit të Administratës Publike me shkresë Nr.1485 prot, datë 30.05.2024 “Kërkesë për trajnimin e stafit të UST”.

Po ashtu kemi patur komunikime zyrtare me email, me Komisionin e Prokurimeve Publike, ku dy punonjëse të Sektorit të Prokurimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në UST-së, ishin pjesë e një ëorkshop të organizuar më datë 27.03.2024.

Nga ana e Administratorit, është nxjerrë Urdhër i Brendshëm nr.52 datë 29.05.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH”. Me qëllimin realizimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të procedurave të prokurimit publik, është ngarkuar Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Prokurimeve në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, që të shikojnë të gjitha mundësitë dhe të ndjekin faqet e APP, DAP etj, për trajnimin e punonjësve që angazhohen në realizimin e prokurimeve publike në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

Komenti i grupit të auditimit

Me ftesën nr.393 prot, datë 19.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, nga sektori i prokurimit në UST kanë marrë pjesë dy punonjës në Workshop-in e datës 27.03.2024.

Me kërkesën nr.1251 prot, datë 30.04.2024 të Administratorit, nga ana e UST i kërkohet Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, për trajnim të stafit për ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmit të tyre në kuadër të prokurimit publik.

Me Urdhërin e Brendshëm Nr.52, dhe nr.1463 prot, datë 29.05.2024 ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Prokurimit Publik të ndjekë trainimin e punonjësve të UST në fushën e prokurimit publik.

Me kërkesën nr.1485 prot, datë 30.05.2024 të Administratorit të UST i kërkohet Departamentit të Administratës Publike për trajnim të stafit për ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmit të tyre në kuadër të prokurimit publik.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit “Blerje pajisje profesionale”, të administruar në dosjen përkatëse, u konstatuan parregullsi në zhvillimin e procedurës së prokurimit. Në dokumentacionin e administruar për këtë procedure mungon llogaritja e fondit limit e dokumentuar. Fondi limit është përcaktuar nga autoriteti kontraktor në urdhrin e prokurimit pa ngritjen e një grupi të posaçëm për hartimin e fondit limit ose lënien e hartimit të këtij fondi njësisë së prokurimit veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Neni 57 “Personi përgjigjes për prokurimin dhe njësia e prokurimit dhe neni 59 “Për llogaritja e vlerës limit të kontratës”.

2.1 Rekomandim:

Nga UST, njësia e prokurimit në të gjitha rastet të ndjek në mënyrë rigorozë etapat e zhvillimit dhe dokumentimit të procedurës së prokurimit me qëllim transparencën e plotë dhe arritjen e objektivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Referuar pikës 2.1: Njësia e prokurimit të UST-së, në të gjitha procedurat e prokurimit, nga janari i vitit 2024 e në vazhdim, ka ndjekur në mënyrë rigorozë të gjitha etapat e dokumentimit të procedurave të prokurimit duke filluar nga depozitimi i kërkesave përkatëse e deri në lidhjen e kontratave dhe njoftimin e zbatimit të tyre pas shlyerjes së detyrimeve financiare.

Komenti i grupit të auditimit

Nga auditimi, për procedurën e prokurimit në vlerë të vogël REF-99071-03-21-2024 me objekt “Shpenzime për prodhim dokumentacioni-Diploma”, janë kryer procedurat si më poshtë:

-Kërkesa për diploma nr.791 prot, datë 12.03.2024 e Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore në UST.

-Procesverbal nr.801 prot, datë 13.03.2024 i komisionit për argumentimin e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e fondit limit.

-Urdhër Prokurimi nr.10 datë 20.03.2024.

-Ftesë për ofertë nr.801/3 prot, datë 21.03.2024.

-Njoftim i fituesit datë 25.03.2024.

-Procesverbal i datës 26.03.2024 për kalim tek operatori i radhës.

-Dokumentacioni i operatorit fitues nr.801/4 datë 27.03.2024.

-Fatura fiskale 73/2024, datë 12.04.2024.

-Urdhër i Brendshëm, nr.801/5 prot, datë 15.04.2024 i Administratorit, për marrjen në dorëzim.

-Aktmarrje në dorëzim nr.801/6 prot, datë 15.04.2024.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

3. Gjetje nga auditimi: Kërkesa kualifikuese të cilat zvogëlojnë konkurrencën në procedurë. Specifikimet e vendosura kanë kufizuar ndjeshëm konkurrencën dhe orientuar procedurën drejt një produkti specifik duke favorizuar vetëm një operator ekonomik.

Nga verifikimi i produkteve të ofertuar nga OE i shpallur fitues u konstatua se, karakteristikat teknike të produkteve të përshkruara në specifikimet teknike janë njësoj me katalogun e produkteve të OE fitues, duke orientuar procedurën e prokurimit drejt OE të shpallur fitues, me pasojë kufizimin e pjesëmarrjes dhe ngushtimin e konkurrencës. Kjo në kundërshtim me Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 20 dhe neni 23, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61.

3.1 Rekomandim:

Nga UST, njësia e prokurimit, në çdo rast të këtë në vëmendje maksimale hartimin e specifikimeve teknike të cilat të jenë në harmoni me natyrën dhe vlerën e kontratës në mënyrë që të stimulohet konkurrenca dhe që çdo kriter i veçantë të jetë në përputhje me natyrën e kontratës.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Referuar rekomandimit 3.1: Njësia e prokurimit të UST-së duke filluar nga janar 2024 gjatë procedurave të prokurimit ka mbajtur procesverbalet përkatëse për hartimin e specifikimeve teknike, të cilat kanë qenë në harmoni me natyrën dhe vlerën e kontratave.

Komenti i grupit të auditimit

Në procedurën me objekt “Materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit public” dhe kodin CPV 38000000-5, 33696200-7, 33140000-3 në Sistemin Elektronik të prokurimeve, nga ana e autoritetit kontraktor UST janë zbatuar masat si më poshtë:

-Urdhër i Brendshëm Nr.28, nr.856/3 prot, datë 03.04.2024 i Administratorit për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, nga ku të tre anëtarët e komisionit janë caktuar specialist të fushës.

-Procesverbali nr.856/7 prot, datë 14.05.2024, nga ku sipas specifikimeve teknike dhe ofertave të tregut është hartuar preventive përkatës dhe fondi limit.

- Procesverbali nr.856/17 prot, datë 23.05.2024, nga ku janë argumentuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

4. Gjetje nga auditimi: Mungesë të eficiencës, efektivitetit dhe ekonomikitet në përdorimin e fondeve publike. Nga verifikimi i pajisjeve u konstatua se dy nga artikujt e furnizuar gjenden në magazine të pa përdorura prej rreth 5 vitesh duke mos e përmbushur qëllimin e këtij shpenzimi dhe indirekt mos justifikuar blerjen e tyre, për vlerën 2,124,000 lekë, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 12.

4.1 Rekomandim:

UST, autoriteti kontraktor të marrin masa për argumentimin e saktë të nevojave të institucionit arritjen e një prokurimi me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet, duke respektuar parimin e konkurrencës.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit

Autoriteti Kontraktor i UST-së ka marrë masa për argumentimin e saktë të nevojave të institucionit për arritjen e një prokurimi efektiv, eficientë dhe me ekonomikitet. Të gjitha mallrat e prokuruarra janë vënë në funksion të institucionit sipas kërkesave dhe nevojave përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit

Lidhur me rekomandimin 4.1, ashtu si edhe rekomandimi 1.1 po ndiqet një procedurë e rregullt nga ana e UST për planifikimin dhe kërkesat për nevojat për shpenzime.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

4.2 Rekomandim:

UST, për artikujt e papërdorur të marra masa për vlerësimin e tyre dhe ti vendos në funksion të nevojave dhe shërbimeve që ka universiteti.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka nxjerrë Urdhër të Brendëshëm të Administratorit nr.13, datë 19.01.2024 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të magazinës për vitin 2024” ku u inventarizua gjithë baza materiale gjendje në magazinën e UST-së.

Administratori i është drejtuar Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, përkatësisht me shkresë nr.263 prot, datë 22.01.2024, shkresës nr.264 prot, datë 22.01.2024 “Kërkesë lidhur me plotësimin e rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresë nr.399/20 datë 21.12.2023”, për propozim të dy specialistëve për vlersimin të artikujve të papërdorur që janë gjendje në magazinë.

Bazuar në shkresën nr.61/1 prot, datë 25.01.2024, “Përcjellje e specialistëve për vlersimin e artikujve që janë gjendje në inventarin e magazinës së UST-së” të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, shkresës së FVFR nr.264/1 prot, datë 26.01.2024 “Propozim i emrave të specialistëve për vlersimin e artikujve të papërdorur”, është ngritur komisioni me Urdhër të Brendëshëm nr.20, datë 01.02.2024 “Për ngritjen e komisionit në zbatim të rekomandimeve të kontrollit të lartë të shtetit për vlersimin e artikujve gjendje në magazinën e UST-së” të Administratorit. Ky komision arriti në konkluzionin për materialet që janë të vleshme për procesin mësimor dhe materialet që janë për jashtë përdorimit, duke hartuar dhe përcjellë Procesverbalin me nr.402/1 prot, datë 15.02.2024, si dhe Relacionin e Drejtoreshës së Financës dhe Buxhetit me nr.402/2 prot, datë 19.02.2024.

Bazuar në Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 ” Për manaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, si dhe pas vlersimit të inventarëve nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, është ngritur Urdhëri i Përbashkët Nr.4, datë 07.02.2024 i ndryshuar, “Për ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të inventareve në departamente, administratë dhe magazinën e Universitetit të Sporteve të Tiranës”. Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit pas përfundimit të procedurës ka hartuar dhe përcjellë relacioninin përkatës me nr. 1081 prot, datë 12.04.2024” Relacion Teknik për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme dhe të trupzuara për vitin 2023 për UST-ën”, si dhe procesverbalin me nr.1081/1 prot, datë 18.04.2024 “Procesverbal për nxjerrjen nga përdorimi i aktiveve për vitin 2023 në UST”.

Në paragrafin 3 të këtij procesverbali thuhet: Në lidhje me softëerin e Biblotekës Komisioni i jashtë përdorimit, ka vlerësuar se nuk ka kompetenca teknike për vlerësimin e këtij softëueri dhe ka propozuar teknik profesional për vlerësimin e kësaj paisje dhe për hartimin e raportit teknik.

Për këtë duke qenë se, UST nuk ka në strukturë staf softëarë i jemi drejtuar Agjensisë Kombëtare të Shërbimit të Informacionit (AKSHI) me shkresë nr. 1532 prot, datë 06.06.2024 “Kërkesë për vlerësim programesh (Softëare)” për vlersim të softeve të cilat janë aktualisht në inventarët e punonjësve të UST-së, por janë jashtë funksionit.

Jemi në pritje të përgjigjes nga AKSHI.

Dajla nga përdorimi e materialeve dhe paisjeve të propozuara nga komisioni për jashtë përdorimit janë miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.29 datë 31.05.2024.

Komenti i grupit të auditimit

Universiteti i Sporteve të Tiranës ka nxjerrë Urdhër të Brendëshëm të Administratorit nr.13 datë 19.01.2024 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të magazinës për vitin 2024” ku u inventarizua gjithë baza materiale gjendje në magazinën e UST-së.

Me kryerjen e inventarizimit të bazës materiale në magazinën e UST, Administratori i është drejtuar Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, përkatësisht me shkresë nr.263 prot, datë 22.01.2024, shkresë nr.264 prot, datë 22.01.2024 “Kërkesë lidhur me plotësimin e rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresë nr.399/20 datë 21.12.2023”, për propozim të 2 specialistëve për vlersimin të artikujve të papërdorur që janë gjendje në magazinë.

Me shkresën nr.261/1 prot, datë 25.01.2024, të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes është kërkuar vlersimi i artikujve që janë gjendje në inventarin e magazinës së UST. Gjithashtu, me shkresën e FVFR nr 264/1 prot, datë 26.01.2024 janë propozuar emrat e specialistëve për vlersimin e artikujve të papërdorur.

Me Urdhër të Brendëshëm nr.20, datë 01.02.2024 të Administratorit është ngritur komisioni “Për ngritjen e komisionit në zbatim të rekomandimeve të kontrollit të lartë të shtetit për vlersimin e artikujve gjendje në magazinën e UST-së”.

Komisioni, pas kontrollit të ushtruar në magazinën e UST-së të bazës materiale, gjëndje në inventarin e magazinës, konstatoi dhe arriti në konkluzionin për materialet që janë të vleshme për procesin mësimor dhe materialet që janë për jashtë përdorimit, dhe ka hartuar dhe përcjellë procesverbalin me nr. 402/1 prot, datë 15.02.2024. Gjithashtu, është hartuar edhe Relacioni i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nr.402/2 prot, datë 19.02.2024.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 të MF ” Për manaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, si dhe pas vlersimit të inventarëve nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, është ngritur Urdhëri i Përbashkët Nr.4 datë 07.02.2024 i ndryshuar, “Për ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të inventareve në departamente, administratë dhe magazinën e Universitetit të Sporteve të Tiranës”.

Nga ana e Komisionit të Nxjerrjes Jashtë Përdorimit është hartuar relacionini përkatës me nr. 1081 prot, datë 12.04.2024 për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme dhe të trupzuara për vitin 2023 për UST, bashkëngjitur procesverbali me nr.1081/1 prot, datë 18.04.2024. Në paragrafin 3 të këtij procesverbali thuhet se: “Në lidhje me softëerin e Bibliotekës Komisioni ka vlerësuar se nuk ka kompetenca teknike për vlerësimin e këtij softëueri”.

UST nuk ka në strukturë për staf softwarë dhe është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shërbimit të Informacionit (AKSHI) me shkresë nr. 1532 prot, datë 06.06.2024 për vlersim të softëve të cilat janë aktualisht në inventarët e punonjësve të UST por janë jashtë funksionit. Jemi në pritje të përgjigjes nga AKSHI, por kërkesa nuk ka gjetur zbatim

Dajla nga përdorimi e materialeve dhe paisjeve të propozuara nga komisioni për jashtë përdorimit janë miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr.29 datë 31.05.2024.

Në zbatim të vendimit të mësipërm është nxjerrë Urdhëri i Brendëshëm i Administratorit me nr.57 datë 04.06.2024 “Për ngritjen e komisionit për asgjësimin e disa aktiveve dalë jashtë përdorimit me Vendim Bordi të Administrimit nr 29 datë 31.05.2024” e cila është në proces.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** dhe ***pjesërisht zbatuar***.

5. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vëne në dispozicion rezulton që nuk ka dokumentacion për funksionimin e pajisjeve (për periudhën që kane funksionuar),dhe nuk ka dokumentacion për zëvendësimin e tyre dhe nxjerrjen jashtë funksionit, veprime në

kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik” pikat 5, 6, 7, 8 dhe 10.

5.1 Rekomandim:

UST, administratori, në çdo rast dhe për çdo element të aseteve të institucionit të ndërmarrë hapat dhe të hartojë dokumentacionin përkatës për çdo lëvizje të aseteve të blera, dhuruara apo ekzistuese të tij, pasi është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe duhet të dokumentojë veprimet e ndërmarra për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aktivitetit që ka në pronësi.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit

Mbështetur në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, kreu III, pika 26, 27, 28, 36,37,38,39 57, UST ka të krijuar rregjistrin kontabël të aktiveve, që ka në administrim në formën e kartelave dhe në formë të sintetizuar dhe ka të ngarkuar Nëpunësin Zbatues, për mbajtjen e rregjistrit të Aktive. Lëvizja e Aktiveve në çdo rast, pasqyrohet kurdoherë në dokumentat përkatëse. Hyrja e aktiveve në magazinën e UST-ës në çdo rast dokumentohet me fletëhyrjen përkatëse.

Po ashtu dalja e aktiveve nga magazina e UST-ës bëhet mbi bazën e, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes etj dhe në çdo rast dokumentohet me fletëdaljen përkatëse.

Për të gjitha rastet kur UST-së i dhurohen aktive merret për bazë dokumentacioni shoqërues, Marrëveshja, Akti i Dhurimit, Sshkresa Zyrtare e Njësisë Donatore; Fatura përkatëse për mallrat dhe vlerën e tyre; Dokumentat e zhdoganimit; Çertifikatën e origjinës; Proçesverbali i marrjes ne dorezim.

Komenti i grupit të auditimit

-Universiteti i Sporteve të Tiranës në zbatim të vendimeve dhe shkresave të mësipërme ka nxjerrë Urdhërin e Brendshëm të Administratorit nr.14 datë 22.01.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve për auditimin tematik të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

Sa më sipër, nga ana e nëpunësit zbatues apo drejtori i financës dhe buxhetit nuk është vepruar akoma për hartimin e dokumentacionit, i cili duhet të miratohet dhe të zbatohet.

-Gjithashtu, nga auditimi është konstatuar se për zhvillimin e procesit mësimor përdoren pajisje të ruajtura në magazinën e UST, siç është rasti i biçikletave për turet mësimore. Nga ana e UST janë ndjekur procedurat e lëvizjes së tyre si më poshtë:

-Kërkesë nr.573/1 prot, datë 16.02.2024 e Dekonit të FVFR.

-Urdhër Magazine nr.57, datë 16.02.2024.

-Fletë – Dalje nr.57, datë 16.02.2024.

-Flëtë – Hyrje nr.13, datë 29.02.2024.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** dhe ***pjesërisht zbatuar***.

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; germat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, **i rekomandojmë Administratorit të UST**, që bazuar në performancën e punonjësve dhe të shkeljeve të konstatuara

në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Përgjigjja e institucionit

Referuar germës së mësipërme, Administratori si përfaqësues i Autoritetit Kontraktor Universiteti i Sporteve të Tiranës dhe në cilësinë e punonjësit urdhërues, është larguar nga detyra me Vendim të Bordit të Administrimit Nr. 19, datë 15.03.2023 “Për shkarkimin e Administratorit të UST Znj.M.G”.

Drejtori i Drejtorisë Juridike në cilësinë e drejtuesit të Njësisë së Prokurimit është larguar nga detyra.

Komenti i grupit të auditimit

-Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, nr.399/20 datë 21.12.2023, nga ana e Administratorit është nxjerrë Urdhëri i Brendshëm nr.14, datë 22.01.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve për auditimin tematik të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

-Sipas konstatimeve nga auditimi i mëparshëm dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion është konstatuar si më poshtë:

1. Janë shkarkuar nga detyra:

- znj.M.G me vendimin e Bordit të Administrimit Nr.19, nr.840 prot, datë 16.03.23

-z. F.M me Vendimin e Rektoratit Nr.52, datë 17.02.2023, nr 601 prot.

2. Kanë dalë në pension:

-znj.R.M me Vendimin Nr.91, datë 27.09.2012, nr.512 prot.

-z.V.R me Vendimin Nr.22, datë 18.03.2015, nr.252 prot.

-z.I.M me Vendimin Nr.64, datë 04.04.2017, nr.481 prot.

-znj.F.J me Vendimin Nr.177, datë 27.09.2022, nr.1398 prot.

3. Janë shkëputur nga puna:

-z.A.P me Vendimin Nr.123, datë 18.10.2011, nr.546 prot.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit, kryer prej grupit të auditimit të KLSH-së rezulton se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) 6 Masa Organizative, nga ku 6 rekomandime, janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 4 zbatuar dhe 2 pjesërisht zbatuar;

b) 1 Masë Disiplinore, nga ku 1 rekomandim është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit 1 pjesërisht zbatuar;

Për sa më sipër ri kërkojmë që, Universiteti i Sporteve, Tiranë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë pjesërisht zbatuar brenda 3 mujorit të pare të vitit 2025. Gjithashtu, kërkojmë analizimin dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.3 QENDRA KOMBËTARE E URGJENCËS MJEKËSORE

PËRMBLEDHJE

K Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Qendrën Kombëtare**

të Urgjencës Mjekësore (QKUM) mbi “Zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023” për auditimin e kryer në vitin 2023, për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr. 1200/8 prot., datë 19.07.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
 - a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
 - b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
 - c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve;
 - ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 792/1 prot., datë 01.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. J.B, (Përgjegjës grupi)
2. E.S

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr.1200/8 Prot., datë 19.07.2023 së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr. 1200/8 Prot., datë 19.07.2023, rezulton se, nga **17** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi, 3-E dhe Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **16** masa të rekomanduara ose 94 %. **Nga të pranuarat (16):** janë zbatuar plotësisht **12**, ose 75 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht **4** masa ose 25 %.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit		
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
1	Organizative	12 masa	9	3	-
2	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	3 masa 65,125,210 lekë	2	1	-
3	Masa Disiplinore	1	1	-	-
	Gjithsej	16 masa 65,125,210 lekë	12	4	-

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht është në masën 75 % , niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht është 25 %.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartim i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM), ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën Nr. 214/3 Prot., datë 11.08.2023.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, dërguar me shkresën 214/5 datë 17.01.2024 në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i kërkesave buxhetore të vitit 2021, u konstatua se QKUM, ka programuar zëra shpenzimesh të cilët nuk i shërbejnë qëllimit dhe natyrës së aktivitetit të punës, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktin konkret të projektit dhe programit buxhetor, si edhe një analizë e detajuar prioritarizmi duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara, duke cenuar kështu përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe produktivitet të fondeve në dispozicion të institucionit, të cilat nuk janë të mirë argumentuara si: kërkesat për shpenzime për anëtarët e parlamentit në shumën 960 mijë lekë; për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna” në shumën 900 mijë lekë; Pajisje për përdorim policor në shumën 960 mijë lekë; Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore dhe rrjeteve hidraulike në shumën 2,700 mijë lekë; Shpenzime për mirëmbajtjen

e rezervës shtetërore në shumën 960 mijë lekë; Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore në shumën 1,500 mijë lekë; Shpenzime gjyqësore në shumën 960 mijë lekë, të cilat janë në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 neni 29, ligji 137/2020 “Për Buxhetin e vitit 2021” dhe udhëzimi nr.4, datë 25.01.2021.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 6 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: QKUM, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të domosdoshëm dhe të nevojshëm të kërkesave buxhetore duke argumentuar të gjitha kërkesat, lidhjen e objektivave të tyre me produktin e programit buxhetor, bazuar në një analizë buxhetore prioritarizmi të dokumentuar, me qëllim parandalimin e keq planifikimit të fondeve të institucionit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

QKUM ka marrë parasysh rekomandimin dhe e ka zbatuar në përgatitjen e PBA 2024-2026 bazuar në të gjitha kërkesat dhe nevojat e sektorëve, si dhe kërkesat bazuar në nevojat konkrete të shërbimit të urgjencës mjekësore në terren, për kompletimin e tyre me gjithë pajisjet e nevojshme, duke u mbështetur në prioritetet e institucionit me qëllim arritjen e objektivave të QKUM dhe është plotësuar dokumentacioni sipas kërkesave buxhetore të vitit 2023.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2. Gjetje nga Auditimi: Për periudhën objekt auditimi parashikimi i “shpenzimeve për personelin” përfshin pagat bruto për punonjësit e përhershëm dhe të përkohshëm, (punonjësit e përkohshëm, janë kërkuar personel mjekësor shtesë për shkak të pandemisë). Punonjësit e përhershëm i përkasin strukturës së QKUM pra 86 punonjës (punonjësit e përkohshëm janë kërkuar shtesë 45 punonjës (personel mjekësor për shkak të pandemisë 10 mjekë, 20 infermierë dhe 15 shoferë mjekë) janë miratuar 49 punonjës me kontratë nga MSHMS.

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore për përbalimin e fluksit të urgjencave mjekësore si edhe dinamikës në rritje (për shkak të tërmetit, pandemisë) në vitet 2020-2021-2022, ka parashikuar rritje të burimeve njerëzore të cilët nuk janë miratuar në strukturën e QKUM, por çdo vit është shtuar me 49 punonjës me kontrata 1 vjeçare sipas VKM përkatëse të çdo viti.

Konstatohen ndryshime të shpeshta të stafit mjekësor me përfundimin e kontratës, të cilat sjellin mangësi në kryerjen e detyrës si edhe investimi që kryhet nga QKUM për përgatitjen profesionale të kësaj kategorie punonjësish, nuk është i qendrueshëm dhe ndikon në shërbimin cilësor ndaj qytetarëve. Parashikimi i shpenzimeve për paga, ka ndryshim të fondit të pagave në PBA e viteve 2021-2023 dhe 2022-2024, është më i lartë për arsye të kërkesës për shtim personeli me kontratë të përkohshme si dhe zbatimit të vendimit nr. 207, datë 10.03.2020 “Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe Punonjës të tjerë” Megjithëse kërkesa buxhetore për vitin 2021 është për 86 punonjës, MSHMS ka miratuar 88 punonjës, në kundërshtim me Ligjin 147/2014 “Për Shërbimin e Urgjencës Mjekësore”, nenet 5 “Organizimi i Shërbimit të Urgjencës” dhe 8 “Përgjegjësitë e QKUM”, VKM nr.933, datë 29.12.2014 “Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 8-19 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: QKUM, të adresojë pranë MSHMS kërkesën për rishikim të menjëhershëm të strukturës organizative të institucionit, shoqëruar me relacionin përkatës argumentues mbi domosdoshmërinë e limitimit të pozicioneve të punës me kontratë afatshkurtër (aktualisht 57% e stafit) në një institucion me rëndësi jetike për qytetarët dhe pa natyrë pune me karakter sezonal, me qëllim që investimi i kryer për përgatitjen profesionale të kësaj kategorie

punonjësish, të jetë i qendrueshëm dhe afatgjatë për shërbim profesional dhe cilësor ndaj qytetarëve.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Nga ana e QKUM është dërguar, propozimi për rishikim të strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore në MSHMS me propozim projekt-vendimi për ndryshimin e VKM-së, me shkresën Nr.748 Datë.29.12.2023 i shoqëruar me relacionin përkatës për domosdoshmërinë e kalimit të punonjësve me kontratë afatshkurtër, në punonjës në organikë. Gjithahstu QKUM i ka dërguar shkresë MSHMS si organ qëndror, për përfshirjen e punonjësve me kontratë të përkohshme në organikën e QKUM-së, për shkak të rritjes së efektivitetit të shërbimit dhe shtimit të fluksit të thirrjeve (kërkesa nr.656 prot, datë 04.12.2023 drejtuar MSHMS).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3. Gjetje nga Auditimi:

Në pasqyrën e flukseve monetare (Cash Flow) deklarohen të hyra nga të ardhurat jotatimore në vlerën 16,542 lekë për vitin 2021, të cilat nuk janë pasqyruar në Pasqyrën e performancës financiare.

Në llogarinë 423,429 (Personeli, paradhënie, deficite, gjoba) e cila paraqitet në vlerën 3,529,735 për vitin 2021 dhe 78,404 për vitin 2020, si vlera të cilat duhet të arkëtohen nga punonjës të cilët nuk janë në marrëdhënie pune, vlerë e cila pas konsultimeve duket e vështirë për tu arkëtuar.

Në llogarinë 215 (Mjete transporti), për vitin 2021 paraqitet në vlerën 0 lekë, e cila paraqitet si vlerë negative nga amortizimi i akumuluar i aktivitetit, por nga historiku i llogarisë, ka nxjerrje jashtë përdorimi të aktivitetit përfundimisht dhe shuma në llogarinë e akumuluar të amortizimit që lidhet me atë aktiv kthehet mbrapsht. E njëjta gjë ndodh dhe me llogarinë 218 (Inventarë ekonomik).

Përsa i përket llogarisë 466 (Kreditorë në mjete në ruajtje) nuk pasqyrohet si vlerë në Pasqyrën e flukseve monetare (Cash floë), në mospërputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit SKK

Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjin Nr. 25/2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe ligjin nr. 9920, Datë 19.5.2008 Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i Ndryshuar.

Përsa i përket kreditorëve, nuk shfaqen anomali si dhe likuidimi i tyre ndodh në kohë dhe sipas një rradhe të caktuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 20-25 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: QKUM, të marrë masat të bëjë korrigjimet dhe rregullimet përkatëse në pasqyrat financiare të llogarive të sipërpërmendura si dhe të bëjë të mundur arkëtimin e vlerës prej 3,529,735 lekë për vitin 2021 dhe vlerën prej 78,404 lekë për vitin 2020 nga punonjës të cilët nuk janë më në marrëdhënie pune.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Është arkëtuar vlera e debisë për punonjës të organikës të QKUM. Në Vitin 2023 vlera e mbetur për tu arkëtuar, që duhet të arkëtohen nga punonjës të cilët nuk janë në marrëdhënie pune është 59.676 lekë .

Këto punonjës janë njoftuar, për shlyerje detyrimi me shkresat nr. Prot. 610, datë 02.11.2023

dhe nr prot 604, datë 31.10.2023.

- Përsa i përket ndjekjes së Vlerës debitore për subjektin “E shpk” me vlerë 1.530.724 lekë, praktika është në proces gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit (pas apelimit të bërë nga shoqëria “E” sh.p.k) dhe nga QKUM po ndiqen procedurat dhe konkretisht është njoftuar në datë 22.06.2021 me kërkesën ankimore ku Subjekti “E Shpk, i është adresuar për ankimim të vendimit nr.1175, datë 19.04.2021 Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe QKUM është në pritje të njoftimit nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë për zhvillimin e procesit gjyqësor.

Vlera 70.404 lekë që i përket subjektit “ O...” është likuiduar plotësisht.

-Përsa i përket llogarisë 466 (Kreditorë në mjete në ruajtje) është pasqyruar si vlerë në Pasqyrën e flukseve monetare (Cash floë), si sistemimet e amortizimit të akumuluar për llogarinë 215 (Mjete transporti), në përputhje me Udhëzimin Nr. 25/2018 ”Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022, jane bërë sistemimet e duhura në Pasqyrat Financiare të Vitit 2023.

Sa me siper trajtuar rekomandimi i adresuar është ndjekur dhe zbatuar për debitoret dhe është në vazhdimësi për ndjekje, bazuar në zhvillimin e proceseve gjyqësore.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

4. Gjetje nga Auditimi:

Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat” 2022, gjatë verifikimit të testimit të tregut dhe ofertave të marra në treg, vihet re që formati i marrjes së ofertave është i njëjtë për të gjithë operatorët dhe nuk mund të merret oferta në treg duke u nisur vetëm nga objekti i kontratës “Shërbim GPS dhe monitorim për Autoambulancat”, duke mos qenë në dijeni se në përshkrimin e mallrave përfshihen GPS për automjete, sistemi audio-video, kamera, software, PC për monitorimin të cilat kanë specifikime të veçanta teknike. Pra, nga NJ.P. nuk është për bërë përshkrim i plotë i procedurës së prokurimit përpara marrjes së ofertave. Gjithashtu, nga NJ.P., njëkohësisht grupi për llogaritjen e fondit limit të kontratës, nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë Institucioni sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike për GPS dhe kamera të vendosura nga A.K. kanë një ngjashmëri të theksuar me specifikimet e katalogut të OE fitues. Gjithashtu një pjesë e specifikimeve teknike janë të ekzagjeruara dhe nuk mund të verifikohen nga anëtarët e KVO-së dhe të atyre të marrjes në dorëzim si dhe kanë një vlerë fikse duke mos përdorur termat ekuivalente.

Në hartimin e specifikimeve teknike nga A.K. në një pikë citohet “Në çdo qendër spitalore kompania do të krijojë mundësinë e monitorimit të ambulancave që i përkasin çdo drejtorie” dhe nuk jepen shpjegime më të detajuara se si do të krijohet ky monitorim në çdo qendër spitalore.

Në hartimin e specifikimeve teknike për suportin, konstatohet se afati për implementimin e shërbimit të GPS është brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Duke u nisur nga numri i lartë i autoambulancave, i qendrave spitalore dhe vendodhjes së tyre, grupi i auditimit mendon që është e vështirë realizimi i shërbimit brenda 5 ditëve, duke e konsideruar si kriter diskriminues për O.E. të tjerë, në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin

dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përllorarit drejtë fondi limit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Specifikimet teknike të procedurës së GPS për vitin 2024, publikuar në datë 04.07.2024, me Urdhër Prokurimi nr.144, datë 04.07.2024, janë rishikuar. Për përlloraritjen e fondit limit të kësaj procedure janë marrë parasysh tre kontratat e fundit të GPS, dhe sipas përlloraritjes çmimi për njësi për një GPS është 2.120 lekë pa TVSH. Gjithashtu në procedurën e re afati i implementimit të shërbimit nga 5 ditë që ka qenë, është bërë 10 ditë.

Në çdo qender spitalore kompania do të krijojë mundësinë e monitorimit të ambulancave që i përkasin çdo drejtorie. Në specifikimet e reja teknike është saktësuar që: *“Sistemi GPS funksionon si ëeb aplikacion për të cilin mjafton një broësor për aksesimin e sistemit. Userat mund të hapen për secilin nga entet shëndetësore dhe mund të bëjnë logimin dhe monitorimin e ambulancave të tyre në sistem”*.

Komenti i grupit të auditimit.

Për verifikimin e statusit të këtij rekomandimi u përzgjedh procedura e GPS 2024, për përlloraritjen e fondit limit të kësaj procedure janë marrë parasysh tre kontratat e fundit të GPS, vërtetuar me relacionin e përlloraritjes së fondit limit dhe afati i ri i implementimit të shërbimit nga 5 ditë që ka qenë, është bërë 10 ditë (verifikuar nga Dokumentat Standarte të Tenderit të publikuara në SPE).

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5. Gjetje nga Auditimi: Përsa i përket dokumentacionit për marrjen në dorëzim të GPS dhe vendosjes së tyre, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni origjinal i procesverbaleve mbi instalimin e pajisjeve por ishin kopje të tyre si dhe këto të fundit rezultuan me korrigjime për sa i përket datës së mbajtjes së tyre.

A.K. ka lidhur kontratë shërbimi nr. 193/9 dt. 11.05.2022 për 12 muaj për 347 GPS në vlerën 8,744,400 lekë pa tvsh, në të cilën nuk cilësohet afati prej 5 ditësh për implementimin e shërbimit sipas procesverbalit të hartimit të specifikimeve teknike.

Me qëllim verifikimin mbi funksionimin e sistemit dhe kohën e implementimit të tij, grupi i auditimit kërkoi nga A.K. t'i vihet në dispozicion sistemi i databazës për dy vitet, 2021 dhe 2022. Nga A.K. është vënë në dispozicion databaza për vitin 2022 në formatin Excel, i cili është një format mbi të cilin mund të bëhen ndryshime dhe nuk lihen gjurmë gjatë këtyre ndryshimeve, duke u konsideruar nga grupi i auditimit si një burim jo i besueshëm për të provuar funksionimin e tij. Problematika e tillë i ka fillimet që në hartimin e specifikimeve teknike dhe në lidhjen e kontratës, që për të garantuar vazhdimin e shërbimit duhej të ishte përpiluar në formën e një SLA, Marrëveshje në Nivel Shërbimi.

Gjatë analizimit të databazës së mësipërme vihet re që edhe pse janë mbajtur procesverbalet në data 12, 13, 14, 15 dhe 16 Maj, shërbimi me GPS për Autoambulancat ka rekorde që datojnë nga 11 Maj, ku O.E. fitues ka përdorur të njëjtët GPS të huazuar nga O.E. i mëparshëm.

Gjatë analizimit të databazës vihet re që ½ e autoambulancave gjatë periudhës nën shërbim nuk kanë lëvizur ose kanë rekorde lëvizjeje disa metra në muaj, ku pas intervistimit me komisionin e ndjekjes së kontratës, pjesa më e madhe shprehen se janë në servis dhe është e vështirë kontrolli i tyre pasi nuk janë në pronësinë e QKUM-së, gjë që vështirëson ndjekjen dhe zbatimin e kontratës si dhe pagesat e kryera për ambulancat të cilat nuk janë në funksion, ku pagesa mujore për një autoambulancë është në vlerën 2,100 lekë pa TVSH, në mospërputhje me nenin 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për

Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: QKUM, në rastet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, përveç hartimit të procesverbaleve dhe firmosjes së tyre, të bëjnë të mundur verifikimin e detajuar të mallrave/shërbimeve nëse janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara dhe brenda datës së kërkuar për implementimin e shërbimit në këtë rast. Gjithashtu, përsa i përket funksionimit të ambulancave duke mos krijuar hapësira për përdorim të fondeve pa 3E (efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet), për një menaxhim sa më të mirë dhe më efektiv, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të bëjnë të mundur alokimin e urgjencave mjekësore (Staf + Ambulanca) në pronësi dhe menaxhim të QKUM.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të procedurës së prokurimit “Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat”, procedurë e hapur, marrëveshje kuadër me afat 24 muaj, është bërë implementimi i shërbimit brenda afatit të caktuar në kontratën në lidhur gjatë vitit 2023, si dhe hartimi i procesverbaleve përkatëse.

- Është dërguar nga ana e QKUM propozimi për rishikim të strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (rishikimi i VKM nr.933, datë 29.12.2014 “Për miratimin e strukturës organizative të QKUM-së”) në MSHMS me propozim projekt-vendimi për ndryshimin e VKM-së, me shkresën Nr.748 Datë.29.12.2023 i shoqëruar me relacionin përkatës për domosdoshmërinë e kalimit të urgjencës mjekësore paraspitalore të Tiranës pranë QKUM-së, si sektor më vete.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

6. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimi të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Set Urgjence” për vitin 2021 konstatohet se:

- Bashkëlidhur kërkesës për zhvillimin e procedurës së prokurimit, nuk ka asnjë procesverbal të mbajtur, lidhur me nevojat e ambulancave për sete urgjence. Për disa nga artikujt, mungojnë certifikatat e ISO 9001:2015 apo ISO 13485:2016 ose ekuivalente të prodhuesit. Konkretisht nga prodhuesi Romed mungon certifikata për artikullin fasho autoadezive, ndërsa nga Gima mungon certifikata për artikujt paketa dizifektuese dhe chlorhexidine. Gjithashtu, në certifikatat e paraqitura nga OE për produktet e prodhuesit Romed, mungon përkthimi në gjuhën shqipe të emrit të artikullit, gjë që e vështirëson identifikimin korrekt të artikullit të certifikuar, në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

- Në katalogun e paraqitur nga fituesi, nuk përcaktohet përqindja e kërkuar në specifikimet teknike të AK të artikullit klorhexidin 5%. Nuk gjenden në katalogun e paraqitur nga OE fitues artikujt piastra adulte dhe piastra pediatrike të përputhshme për defibrilatorët Primedic dhe Rescue Life. Për artikullin maska silikoni, nga AK janë kërkuar 6 përmasa të ndryshme, ndërkohë në katalog janë paraqitur vetëm 4 përmasa. Për artikullin maskë oksigjeni me rezervuar, është kërkuar nga AK me përqindje të mesme, ndërkohë në katalogun e OE fitues është paraqitur maskë silikoni me përqindje të lartë. Për artikullin mushama (telo) janë kërkuar nga AK Përmasat 200X150cm, ndërkohë në katalogun e fituesit është paraqitur mushama telo me përmasa 180X76 cm. Nga AK, për artikullin doreza sterile janë kërkuar në përmasa të ndryshme, ndërsa në katalog është paraqitur vetëm në masën S (masë e vogël), në mospërputhje me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50

, të Raportit Përfundimtar të Auditimit) (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: QKUM, në të ardhmen të marrë parasysh që zhvillimi i procedurave të prokurimit iniciohet fillimisht nga një nevojë që i lind institucionit e cila hartohet në mënyrë të detajuar dhe regjistrohet në regjistrin e parashikimeve ku në bazë të fondeve dhe rëndësisë që ka kjo nevojë zhvillohet nga ana e institucioni si dhe në rastin e vlerësimit të ofertave të tregohet kujdes që mallrat/shërbimet e ofruara nga O.E. pjesëmarrës të përkojnë me ato të kërkuara në specifikimet teknike nga ana e A.K.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Gjatë parashikimit të PBA 2024-2026 janë marrë parasysh rekomandimet duke u bazuar në kërkesat e paraqitura nga sektoret, apo institucionet e tjera me urgjencë mjekësore paraspitalore, sipas nevojave për ecurinë normale të punës, si brenda institucionit ashtu edhe në terren për ekipet e urgjencës mjekësore paraspitalore. Gjithashtu është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Blerje sete urgjence” për vitin 2024 dhe gjatë procesit të vlerësimit të ofertave janë marrë parasysh rekomandimet e grupit të auditimit të KLSH. Procedura ka përfunduar dhe është shpallur njoftimi i fituesit përfundimtar.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

7. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Sete urgjence” për vitin 2022, nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në hartimin e specifikimeve teknike një pjesë e madhe e artikujve të ilustruara me foto ka ngjashmëri absolute me artikujt e paraqitur në katalogun e sjellë nga O.E. fitues.

Për artikujt të paraqitur në katalogun e OE fitues të Kompanisë Teleflex (artikujt 67-68) mungon përkthimi në gjuhën shqipe, për të cilat mungojnë certifikatat e ISO 9001:2015 apo ISO. Gjithashtu, nga prodhuesi Romed mungon certifikata për artikullin fasho autoadezive, ndërsa nga Gima mungon certifikata për artikujt paketa dizifektuese dhe chlorhexidine.

Disa nga specifikimet teknike nuk përputhen me ato të sjella nga OE fitues, sipas katalogut përkatës. Konkretisht, në katalogun e paraqitur nga fituesi, nuk përcaktohet përqindja e kërkuar në specifikimet teknike të AK të artikullit klorhexidin 5%. Nuk gjenden në katalogun e paraqitur nga OE fitues artikujt piastra adulte dhe piastra pediatrike të përputhshme për defibrilatorët Primedic dhe Rescue Life. Për artikullin maska silikon, nga AK janë kërkuar 6 përmasa të ndryshme, ndërkohë në katalog janë paraqitur vetëm 4 përmasa. Për artikullin maskë oksigjeni me rezervuar, është kërkuar nga AK me përqindje të mesme, ndërkohë në katalogun e OE fitues është paraqitur maskë silikon me përqindje të lartë. Për artikullin mushama (telo) janë kërkuar nga AK Përmasat 200X150cm, ndërkohë në katalogun e fituesit është paraqitur mushama telo me përmasa 180X76 cm. Nga AK, për artikullin doreza sterile janë kërkuar në përmasa të ndryshme, ndërsa në katalog është paraqitur vetëm në masën S (masë e vogël), në mospërputhje me nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”

Gjatë zhvillimit të procedurës së auditimit me objekt “Blerje Pajisje mjekësore”, në kërkesat për kualifikim “Specifikimet teknike” për pajisjet mjekësore, konkretisht pika II.5 dhe II.6 për manekin PCR infant/perdiatrik dhe ventilator për autoambulanca rezulton se ka një ngjashmëri absolute midis specifikimeve teknike të pajisjeve mjekësore të hartuara nga A.K., me specifikimet teknike të katalogut të sjellë nga Operatori Ekonomik fitues.

Në pikën 2.2 nga AK kërkohet që operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3(tre) viteve të fundit, ku vlera e xhiros

mesatare vjetore për tre vitet e fundit duhet të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet në mospërputhje me shkronjën c të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në pikën 2.3. nga AK kërkohet që OE të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë sa 20% të vlerës së përlogaritur të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit në mospërputhje me shkronjën b¹ të pikës 4 në nenin 55 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke krijuar hapësirë për zhvillimin e një gare të ndershme dhe konkurruese.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në procedurën “Blerje sete urgjence” të vitit 2024 kriteret e xhiros dhe furnizimeve të ngjashme janë hartuar si më poshtë: “Xhiroja mesatare vjetore për 3 vitet e fundit duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit.” “Furnizime të ngjashme në një vlerë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit”. Në procedurën e vitit 2024 “Blerje sete urgjence” janë marrë parasysh rekomandimet e grupit të auditimit, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Procedura ka përfunduar dhe është shpallur njoftimi i fituesit përfundimtar.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

8. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së auditimit me objekt “Blerje Pajisje mjekësore”, nga shqyrtimi i dokumentacionit për sa i përket vlerësimit të ofertës konstatohet se:

Për disa nga pajisjet mjekësore, disa nga specifikimet teknike të karrocës me katër rrota me zinxhir dhe fluksometrit nuk përputhen me ato të sjella nga OE fitues, sipas katalogut përkatës *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi: QKUM, në rastet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, përveç hartimit të procesverbaleve dhe firmosjes së tyre, të bëjnë të mundur verifikimin e detajuar të mallrave/shërbimeve nëse janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Ky rekomandim ngelet të vlerësohet në auditimet e radhës, e për këtë arsye konsiderohet në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

9. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së auditimit me objekt “*Mirëmbajtje objekti ndërtimor*”, rezulton se në specifikimet teknike të hartuara nga A.K., mungojnë të dhënat kryesore si nr., sasi, m2 etj... si më poshtë:

- Plintusa metalik për rrëshkitje 1

- Mirëmbajtje dhe riparim i pompës thithëse 1
- Piston për derën kryesore me presion vaji 1
- Vijat e verdha të parkimit 1

Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pa mundur studimin e tregut dhe pamundëson dhënien e ofertave nga operatorët pjesëmarrës.

- Realizimi i punimeve për zërat mësipërme në afatin 5 ditor është e pamundur të realizohet me 5 punëtorë të kërkuara në kriteret e veçanta që duhet të përmbushë O.E. sipas A.K. Procesverbali i kryerjes së punimeve nuk është shoqëruar me foto që të tregohen qartë realizimi i zërave të mësipërm, në mospërputhje me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 50-59 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse, në përputhje me volumin e kontratës dhe të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përllogaritet drejtë fondi limit dhe ofertat e dhëna si dhe të dokumentohet i gjithë zbatimi i kontratës.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në procedurën “Shërbim pastrim-gjelbërimi” të vitit 2023, me Urdhër prokurimi nr.7, datë 04.10.2023 janë përcaktuar zërat me njësitë matëse përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

10. Gjetje nga Auditimi: QKUM nuk ka zhvilluar ende një sistem komunikimi dhe informimi të përshtatshëm dhe efektiv si është parashikuar edhe në Rregulloren e brendshme të QKUM, ku në formë eksplicite është përcaktuar mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda strukturave.

Sistemi i IT i QKUM aktualisht nuk është pajisur me një procedurë të përshtatshme rezervë (back-up) nga ku të mundësojë gjithashtu ri-përfitim të të dhënave në rastin e një aksidenti në sistem ose ndaj rrezikut të një sulmi kibernetik në kundërshtim me Nenin 23 , Ligji 10 296 dt. 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 50-59 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: QKUM, të marrë masat që të plotësojë rregulloren e brendshme me mënyrat e komunikimit dhe të informimit të informacionit, sipas niveleve të hierarkisë së institucionit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Rregullorja e Brendshme e QKUM-së është dërguar për rishikim në MSHMS me shkresën nr.50/1, datë 15.01.2024, në të cilën janë përfshirë format e komunikimit të brendshëm institucional.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

11. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje set uniforme dhe elementët përbërëse të tyre”, nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se një pjesë e madhe e specifikimeve të uniformave janë tejet të detajuara, duke cituar një sërë variablash të cilat janë të ekzagjuruara për funksionin që do të kryejnë uniformat, të paargumentuara si dhe të vështira në momentin e vlerësimit nga Komisioni i vlerësimit të

Ofertave dhe Grupi i marrjes në dorëzim.

Specifikimet teknike të uniformave janë diskriminuuese, në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: QKUM, në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Ky rekomandim ngelet të vlerësohet në auditimet e radhës, e për këtë arsye konsiderohet në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

12. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të Procedurës së Prokurimit me objekt “Mirëmbajtje objekti ndërtimor viti 2022” Për sa i përket kryerjes së shërbimit është kryer në datën 19.12.2022, ndërkohë që shpallja fitues e O.E. është bërë me datë 09.12.2022. Sipas specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta lëvrimi i mallit duhej bërë brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (njoftimi i fituesit), ndërsa sipas A.K. është kryer pas 10 ditësh.

Procesverbali i mbajtur mbi realizimin e shërbimit nuk është i shoqëruar me foto që të dokumentohet procesi dhe realizimi i plotë i shërbimit.

Realizimi për 5 ditë i zërave të mësipërm dhe me dy punonjës është i pamundur, në mospërputhje me Nenin 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 50-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: QKUM, të bëjë të mundur llogaritjen dhe alokimin e penalitetit sipas kushteve të kontratës mbi ditët jashtë afatit të lëvrimit të mallit dhe në të ardhmen të kryejë lëvrimin e mallit/shërbimit sipas kushteve të kontratës.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

QKUM ka njoftuar me shkresën nr.712 Prot, datë 21.12.2023 subjektin “Pastrime Silvio sh.p.k., me Nipt K91413010N, për shlyerjen e kamat vonesës për ditët e kryerjes së shërbimit jashtë afatit, në shumën 18,828 (tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njezet e tetë) lek. Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës. Është bërë arkëtimi i vlerës prej 18,828 lekë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Në hartimin e Specifikimeve Teknike nuk janë detajuar zërat të cilët do të mbulohen nga siguracioni (ndërtesa, instalime teknike e makineri, inventari ekonomik), si minimum për përcaktimin e vlerës që mbulon çdo kategori si dhe dhënien e ofertave nga O.E. të interesuar.

Oferta e sjellë nga O.E. fitues është në shumën 4,427,000 lekë pa tvsh, shumë e cila ndryshon nga oferta e sjellë nga i njëjti O.E. në shumën 4,380,000 lekë pa tvsh gjatë përlllogaritjes së fondit limit, me diferencë prej 47,000 lekë pa tvsh, duke mos dhënë arsyet përkatëse, gjë që faktin dhe gjetjen cituar nga grupi i auditimit mbi atë se çfarë përfshihet në kategoritë ndërtesa, zyra dhe pajisje mjekësore.

Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit se çfarë mbulojnë kategoritë (ndërtesa, instalime teknike e makineri, inventari ekonomik) rezultoi që në kategorinë instalime teknike e makineri që përkon me llogarinë 214 në pasqyrat financiare përfshihen softëare (program financiar; sistem virtualizimi; sistem operimi për server; fireëall; softëare për back up; softëare për database; softëare për sistem kartografis; softëare aplikativ për urgjencë; instrumente përktimi, konfigurimi, trajnimi; softëare për raport statistika; realizimi i faqe ëeb) të cilat janë programe që në kategorinë e rrezikut nuk mbulohen nga siguracioni, gjë që konstatohet edhe në policen e sigurimit të operatorit fitues nr. serial 220904668 datë 06.04.2022. Vlera e softëare që është përfshirë në kategorinë pajisje mjekësore është në vlerën 102,934,464 lekë, ndërkohë vlera e sigurimit të saj është 1,235,213 lekë (102,934,464 lekë X 0.012), që përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: QKUM, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke krijuar hapësirë për zhvillimin e një gare të ndershme dhe konkurruese QKUM, si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përlllogaritet drejtë fondi limit dhe ofertat e dhëna, ku duke u nisur nga kjo i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm në vlerën prej 1,235,213 lekë dhe të bëhet e mundur alokimi i kësaj shume.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

QKUM ka vepruar në zbatim të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nënpunësit autorizues “, germa c ku citohet: “monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë që menaxhojnë, germa ë) “përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i papranuar nga subjekti.**

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi: Ngjyra e uniformave nuk korrespondon me ngjyrën e caktuar në Specifikimet Teknike me kod HV EN 20471, ku pas verifikimit nga grupi i auditimit dhe mostrat e sjella, ngjyra është jo sipas kodit. I njëjti kod ngjyre është dhe për këpucët të cila nga mostrat e sjellë kanë një ngjyrë tjetër nga uniformat (Lejla) dhe përsëri jo të kuqë sipas kodit. Garancia e produkteve të sjella janë 2 vjeçare por nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit në terren, pjesa fosforeshente e produkteve është pothuajse e fshirë, edhe pse nuk është përmbushur afati 2 vjeçar.

Gjatë verifikimit të mostrave të sjellë për produktin “Këpucë”, viti i prodhimit të tyre të shënuar

ishte viti 2020, ndërkohë që procedura e prokurimit është realizuar në vitin 2021 ndërkohë ato supozohet që të prodhohen sipas specifikimet teknike dhe ekzistenca e tyre (viti 2020), përbën fakt për paracaktimin e O.E. fitues.

Nga dokumentacioni rezulton një deklaratë e datës 20.09.2021 nga OE “U.P” sh.p.k për dorëzim malli. Nga grupi i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbal në datë 20.09.2021, pa nr. protokollit, gjithashtu dhe për vitin 2022.

QKUM, nuk ka përmbushur misionin e tij mbi marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve ashtu sic i ka kërkuar në specifikimet teknike, kryesisht ngjyrën dhe cilësinë, ku i gjithë fondi në total prej 63,250,000 lekë pa tvsh (11,350,000 këpucët + 51,900,000 uniformat), përbën fond të përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet, në mospërputhje me Nenin 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: QKUM, të marrë masat për ngritjen e një grupi të posacëm për ndjekjen dhe zëvendësimin e produkteve të marra në mospërputhje me specifikimet teknike të kërkuara me ato që duhet të ishin dorëzuar nga O.E. fitues.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

QKUM, ka dërguar kërkesa për interpretim, Universitetit Politeknik të Tiranës, Dega Tekstil, me shkresën nr.721/1 Prot, datë 22.12.2023, për vlerësimin e mostrave me të gjithë elementët (cilësi, ngjyrë etj), i cili ka kthyer përgjigje me shkresën nr.721/2 prot me të QKUM, datë 29.12.2023, me anë të së cilës kryen adresim te inxhinieri tekstil.

QKUM ka dërguar kërkesën për interpretim nr.40, datë 09.01.2024 Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike (specialistit inxhinier tekstil). Si dhe i është drejtuar kontraktorit “U.P” sh.p.k, njoftuar me shkresën me nr. nr.721 Prot, datë 22.12.2023, për verifikimin e problematikave të adresuara nga grupi auditues. Subjekti “U.P” sh.p.k, me shkresën nr 721/3 Prot dt 29.12.2023, ka argumentuar sipas tij levrimin e mallit sipas kontratave të lidhura me QKUM.

Pas argumentimit të ekspertit të fushës i njëjti kod ngjyre pasqyrohet ndryshe në tekstile të ndryshme, si në rastin e tekstilit që përbën uniformën me tekstilin që përbën këpucët. Nuk shikohet i nevojshëm ndërrimi i mallit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

2. Gjetje nga Auditimi: Copëzim i fondeve në 2 raste, në vitin 2022, duke shmangur procedurën e prokurimit, si më poshtë:

1. Shërbim telefonik EI PRI ISDN - me vlerë 985.000 lekë pa tvsh.

2. Shërbim interneti 2023- me vlerë 470.000 lekë pa tvsh.

Sa më sipër, shërbimi i ngjashëm “Shërbim telefonie dhe interneti”, me të njëjtin operator ekonomik A. Të dy procedurat së bashku rezultojnë në vlerën 1.455.000 Lekë pa TVSH, që tejkalojnë me 455.000 Lekë pragun e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël. Me tejkalimin e pragut të prokurimit në vlerë të vogël, QKUM duhet të kalojë në procedurën e kufijve të ulët monetar prokurimit.

Materialet e sipërcituara janë pjesë e linjave teknologjike në ushtrimin e veprimtarisë.

Për arsyen e mësipërme procedurat e sipërcituara të prokurimit konsiderohen tejkalim i pragut të prokurimit në vlerë të vogël dhe QKUM duhej të kalonte në procedurën kufijve të ulët monetar të prokurimit, me qëllim ruajtjen e konkurrencës në prokurim, duke klasifikuar fondit prej **1,455,000** lekë pa tvsh si fond i përdorur pa parimin e 3E, në mospërputhje me Pikën 3 të

Udhëzimit Nr.05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” si dhe nenin 56, pika 2 dhe pika 11, e Vendimit Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për Prokurimin publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 50-59 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: QKUM, të marrë të gjitha masat që në hartimin e regjistrit të prokurimeve të parashikohen të gjitha procedurat e blerjes së mallrave, punëve dhe shërbimeve, që do të prokurohen në vlerë të vogël, me qëllim që të shmangë përdorimin e paplanifikuar dhe të parregulluar të fondeve publike.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

QKUM ka marrë parasysh rekomandimin dhe në hartimin e regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin 2023 ka parashikuar si zë regjistri “Shërbim interneti dhe ISDN për QKUM për vitin 2024”, prokurim i cili inicioi me urdhrin nr.226, datë 14.12.2023, procedurë e hapur e thjeshtuar.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3. Gjetje nga Auditimi: Nga ofertat e sjella nga O.E. garues, oferta e sjellë nga O.E. “A” sh.p.k., prej 1,199,960 lekë pa tvsh, u shpall ofertë anomalisht e ulët dhe me anë të kërkesës nr. 26.05.2021 nga K.V.O, u kërkuar sqarim për çmimet dhe koston e propozuar në ofertë. O.E. “A” sh.p.k. me anë të shkresës nr. 2905 Prot., datë 29.05.2021 ka paraqitur shpjegimin përkatës me të gjithë dokumentacionin e plotë mbi arsyet e dhënies së ofertës .

Nga ana e K.V.O. nuk ka dokumentacion në lidhje me analizimin e shkresës së sjellë nga O.E.. Pas analizimeve të dokumentacionit të sjellë nga O.E. i mësipërm, grupi i auditimit mendon që oferta e sjellë nga O.E. duhej të ishte marrë për bazë pas shpjegimit të saj dhe O.E. i mësipërm duhej të ishte shpallur fitues. Nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, vlera prej **420,210 lekë pa tvsh**, si diferencë midis O.E. fitues dhe këtij të fundit që duhej të ishte shpallur fitues, është përdorur pa 3E.

Gjatë analizimit mbi mënyrën e likuidimit dhe zbatimit të kontratës vihet re që vlera e kontratës është likuiduar nga dy pagesa, ku pagesa e fundit mban datën 28.10.2021, që nënkupton që për periudhën e mbetur deri në 06.07.2022 mbetet e pa mbuluar me shërbim.

Kjo vjen për arsye se mënyra e likuidimit dhe procesverbaleve duhej të ishte hartuar sipas specifikimeve teknike të kërkuar në fillim, të cilat nuk janë cituar në kontratat respektive, si më poshtë:

Kryerja e shërbimit dhe mirëmbajtjes profilaktike për pastrimin, larjen e filtrave të kondicionerëve dhe serpentinave të fankoilave çdo tre muaj. Kontrolli i presionit të gazit dhe mbushja me gaz sipas nivelit të kërkuar, do të jetë sipas nevojave

Kontrolli i chillerave dhe sistemit të tyre, shërbimet e mirëmbajtjes preventive të tyre janë parashikuar një herë në katër muaj.

Hapja e chillerave, pastrim me solucion, pastrim i filtrit të ujit dhe të gazit, kontroll i presionit të gazit çdo 4 muaj në kundërshtim me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 23-50 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: QKUM, të marrë masat në të ardhmen, në përlllogaritjen e fondit limit të përdorin mënyrën më efektive të mundshme dhe në rastin kur merren oferta në treg të merren nga O.E. të cilët kanë eksperiencë, për të hartuar një fond limit të saktë dhe vlerësimin e drejtë dhe transparent të ofertave mbështetur në bazën ligjore dhe udhëzimet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjia e institucionit:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, në procedurat e prokurimit të vitit 2023 është bërë studimi i tregut nga O.E të cilët nga eksperiencë në treg (Procedura e pastrim gjelbërimit 2023)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

D. PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe konstatimeve të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe vërejtjeve, komenteve dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitura nga subjekti i audituar, *mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”* dhe bazuar në ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 107, pika 7 dhe 8, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljen e konstatuara, fillimin e procedimit administrativ, për operatorin ekonomik “U.P” shpk, për sa më poshtë:**

Në procedurën e “Hapur” të prokurimit me objekt “Blerje set uniforme dhe elementë përbërëse të tyre” për urgjencën mjekësore Marrëveshje Kuadër 2021-2022, me vlerë të fondit limit 79,290,000 lekë pa tvsh, procedurë për të cilën është shpallur fitues O.E “U.P” sh.p.k., për vlerën prej 51,900,000 lekë, me diferencë nga fondi limit prej 27,390,000 lekë pa tvsh.

Në procedurën e “Kërkesë për Propozim” të prokurimit me objekt “Blerje këpucë uniforme për urgjencën mjekësore” për urgjencën mjekësore, me vlerë të fondit limit 11,983,333 lekë pa tvsh, procedurë për të cilën është shpallur fitues O.E “U.P” sh.p.k., për vlerën prej 11,350,000 lekë, me diferencë nga fondi limit prej 633,333 lekë pa tvsh.

Përshkrimi i shkakut për fillimin e procedimit administrativ të O.E.

Marrja në dorëzim e mallrave të cilat nuk kanë karakteristikat e njëjta të kërkuara nga ana e specifikimeve teknike.

Ngjyra e uniformave nuk korrespondon me ngjyrën e caktuar në Specifikimet Teknike me kod HV EN 20471, ku pas verifikimit nga grupi i auditimit dhe mostrat e sjella, ngjyra është jo sipas kodit të kërkuar. I njëjti kod ngjyre është dhe për këpucët të cila nga mostrat e sjellë kanë një ngjyrë tjetër nga uniformat dhe jo sipas kodit HV EN 2047 .

Gjatë verifikimit të mostrave të sjellë nga A.K. për grupin e auditimit, për produktin “Këpucë”, viti i prodhimit të tyre të shënuar ishte viti 2020, ndërkohë që procedura e prokurimit është realizuar në vitin 2021 dhe që supozohet që këpucët të prodhohen sipas specifikimet teknike dhe ekzistenca e tyre (viti 2020), përbën fakt për paracaktimin e O.E. fitues.

Nga dokumentacioni rezulton një deklaratë e datës 20.09.2021 nga OE “U.P” sh.p.k për dorëzim malli. Nga grupi i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbal në datë 20.09.2021, pa nr. protokoll, gjithashtu dhe për vitin 2022.

D. MASA DISIPLINORE:

D.1. Për punonjësit në marrëdhënie pune

D.1.2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuara në ligje të veçanta

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe

funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; germat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, **i rekomandojmë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisionit Disiplinor**, pranë Institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e Drejtorit të Përgjithshëm të QKUM-së dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; germat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, i rekomandojmë Titullarit të Institucionit, Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të marrë masat disiplinore si më poshtë:

Masë disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Paralajmërim për largim nga puna” për punonjësit e mëposhtëm:

z. K.R, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt

- “Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat” 2022
- “Siguricioni i godinës, zyrave dhe pajisjeve të QKUM-së”

në mospërputhje me Nenin 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së kontratës për mallrat, në mospërputhje me Nenin 77, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”.

znj. J. R. në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt

- “Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat” 2022

në mospërputhje me Nenin 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së kontratës për mallrat, në mospërputhje me Nenin 77, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”.

znj. J.H. në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt

- “Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat” 2022

në mospërputhje me Nenin 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së kontratës për mallrat, në procedurën e prokurimit me objekt

- “Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat” 2022
- “Blerje set uniforme dhe elementë përbërëse të tyre për urgjencën mjekësore Marrëveshje Kuadër 2021-2022”
- “Blerje këpuce uniforme për urgjencën mjekësore”

në mospërputhje me Nenin 77, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”.

znj. L.M, në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt

· *“Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi te sistemit te pajisjeve teknologjike te QKUM”*

në mospërputhje me Nenin 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 914 *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar

dhe në cilësinë e anëtarit komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt

· *“Blerje Set urgjence 2021”*

· *“Blerje set uniforme dhe elementë përbërëse të tyre për urgjencën mjekësore Marrëveshje Kuadër 2021-2022”*

· *“Blerje këpucë uniforme për urgjencën mjekësore” 2021*

në mospërputhje me Nenin 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

znj. A.R në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt

· *“Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi te sistemit te pajisjeve teknologjike te QKUM”*

në mospërputhje me Nenin 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 914 *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar dhe

në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt

· *“Blerje set urgjence 2021”*

· *“Blerje set uniforme dhe elementë përbërëse të tyre për urgjencën mjekësore Marrëveshje Kuadër 2021-2022”*

· *“Blerje këpucë uniforme për urgjencën mjekësore”*,

në mospërputhje me Nenin 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

z. B.A, në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt

· *“Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi te sistemit te pajisjeve teknologjike te QKUM”*

në mospërputhje me Nenin 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 914 *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

znj. G.V, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit me objekt

· *“Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi te sistemit te pajisjeve teknologjike te QKUM*

· *“Blerje pajisje mjekësore 2021”*

në mospërputhje me Nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*”, i ndryshuar

znj. N.D, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit me objekt

· *“Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi te sistemit te pajisjeve teknologjike te QKUM*

në mospërputhje me Nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*”, i ndryshuar

dhe në cilësinë e anëtarit të Njesisë së hartimit të specifikimeve teknike dhe përlogaritjes së fondit limit për procedurën e prokurimit

· *“Siguracioni i godinës, zyrave dhe pajisjeve të QKUM-së”*

· *“Blerje Pajisje Mjekësore 2021”*

në mospërputhje me Nenin 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

znj. L.ZH, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për

procedurën me objekt

- *“Siguracioni i godinës, zyrave dhe pajisjeve të QKUM-së”*
në mospërputhje me Nenin 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

z. K.C në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt

- *“Blerje set urgjence 2021”*

- *“Blerje pajisje mjekësore”,*

në mospërputhje me Nenin 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim të mallit ne procedurën e prokurimit me objekt

- *“Blerje set uniforme dhe elementë përbërëse të tyre për urgjencën mjekësore Marrëveshje Kuadër 2021-2022”*

- *“Blerje këpucë uniforme për urgjencën mjekësore”*

në mospërputhje me Nenin 77, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”.

znj. F.S në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt

- *“Blerje pajisje mjekësore”,*

në mospërputhje me Nenin 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

z. I.J në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt

- *“Blerje Pajisje Mjekësore 2021”*

në mospërputhje me Nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

z. A.Q në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procedurën e prokurimit me objekt

- *“Blerje Pajisje Mjekësore 2021”*

në mospërputhje me Nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

znj. A.K në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së kontratës për mallrat, në procedurën e prokurimit me objekt

- *“Blerje set uniforme dhe elementë përbërëse të tyre për urgjencën mjekësore Marrëveshje Kuadër 2021-2022”*

- *“Blerje këpucë uniforme për urgjencën mjekësore”*

në mospërputhje me Nenin 77, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”

Përgjigjja e institucionit:

QKUM ka marrë masat disiplinore sipas Kodit të Punës për punonjësit (urdhri nr.194, datë 18.09.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të QKUM-së):

K.R, J.R, J.H, L.M, A.R, B.A, G.V, N.D, L.ZH, K.C, I.J, A.K dhe janë njoftuar punonjësit që nuk janë në marrëdhënie pune pranë QKUM-së.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit kryer prej grupit të auditimit të KLSH-së rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) 12 Masa organizative nga ku 12 rekomandime, janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 9 zbatuar dhe 3 zbatuar pjesërisht.
- b) 1 Masë shpërblim dëmi nga ku 1 rekomandim dhe nuk është pranuar.
- c) 3 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike nga ku 3 rekomandime, janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 2 zbatuar dhe 1 zbatuar pjesërisht.
- d) 1 Masë Disiplinore nga ku 1 rekomandim, ka statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1 zbatuar.

Kërkojmë që, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë pjesërisht zbatuar, brenda 3 mujorit të pare të vitit 2025 si dhe kërkojmë analizimin dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.4 SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMËS

PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Spitalin Universitar të Traumës (SUT)** mbi “*Zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023*” për auditimin e kryer në vitin 2023, për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr.1199/15 Prot., datë 02.08.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

- a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
- b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
- c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve;
- ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe manualit “*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve*”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 792/1 prot., datë 01.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. J.B, (*Përgjegjës grupi*)
2. E.S

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr. 1199/15 Prot., datë 02.08.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Spitali Universitar i Traumës, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr. 1199/15 Prot., datë 02.08.2023, rezulton se, nga **69** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi, 3-E dhe Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **69** masa të rekomanduara ose 100 %. **Nga të pranuarat (69):** janë zbatuar plotësisht **32**, ose 46 % e tyre, është zbatuar pjesërisht **29** masa ose 42 % dhe nuk janë zbatuar **8** masa ose 12 %.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit		
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
1	Organizative	54 masa	26 masa	20 masa	8 masa
2	Shpërblim dëmi	3 masë 1,877,155 lekë	1 masë 138,000 lekë	2 masa 101,739,155 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	11 masa 221,118,996 lekë	5 masë 598,460 lekë	6 masa 44,648,596 lekë	-
4	Masa Disiplinore	1 masë	-	1 masë	-
	<i>Gjithsej</i>	69 masa 222,996,151 lekë	32 masa 736,400 lekë	29 masa 146,387,751 lekë	8 masa

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 46 % , niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht është 42 % dhe ato pazbatuar 12 %.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartim i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Spitali Universitar i Traumës (SUT), ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr.2034/3 prot., datë 22.08.2023.

III/2- Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të

auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, SUT nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Titullari brenda afatit 6 mujor në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht si dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar mbi Zbatimin e Rekomandimeve me nr. 520/56 Prot. datë 04.12.2020, rezultoi se janë trajtuar rekomandimet e lëna si më poshtë:

- Nga 29 masa organizative të rekomanduara gjithsej, 20 masa janë zbatuar plotësisht dhe 9 masa janë në proces auditimi.
- Nga 2 masa shpërblim dëmi të rekomanduara, 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 1 masë tjetër është në proces zbatimi
- Nga 21 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej, 21 masa janë zbatuar plotësisht,. Rekomandimet e mbetura në proces zbatimi, paraqiten si më poshtë:
- Masa Organizative – Rekomandimet nr. 3.1, 6.1, 19.1, 20.1, 21.1, 21.2, 22.1, 28.1, 29.1
- Masa Shpërblim Dëmi – Rekomandimet nr. 2.1, në mospërputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “j”.

1.1.Rekomandim: SUT, të marrë masa për përshpejtimin e realizimit të rekomandimeve në proces zbatimi të lëna në auditimin e mëparshëm, me synim realizimin e objektivave dhe në përmbushjen e misionit të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024.

Pretendimi subjektit : “... Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimitmbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në SUT, ju paraqesim observacion si më poshtë:

-Rekomandim 1.1 Masa Organizative .. Rekomandimet e sipërcituara janë të zbatuara nga SUT dhe bashkëlidhur praktikat përkatëse.

Qëndrimi i grupit të auditimit : Grupi i Auditimi, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti vlerësoi se ka pjesërisht dokumentacion tjetër shtesë nga ai i paraqitur gjatë auditimit por, mbetet të verifikohet në auditimet e rradhës statusi përfundimtar i tyre.

Sa më sipër observacioni merret pjesërisht në konsideratë

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

2. Gjetje nga auditimi: Bordi i Spitalit Universitar të Traumës nuk ka funksionuar gjatë periudhës objekt auditimi dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ka miratuar pasqyrat financiare vjetore (miratimi i raportit vjetor të veprimtarisë financiare), për vitin 2021. Për sa i takon periudhës objekt auditimi, Bordi i SUT është mbledhur për herë të parë në qershor të vitit 2022, referuar shkresës nr. 1195 Prot., datë 03.06.2022 “Kërkesë për mbledhjen e Bordit Drejtues të SUT, në mospërputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”, pika 10 c).

2.1.Rekomandim: Nga Bordi i Spitalit Universitar të Traumës të merren masa në vijimësi për miratimin çdo vit të pasqyrave financiare vjetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Sipas SUT bazuar në Rregulloren e Brendshme dhe Statutin e SUT, janë të përcaktuara funksionet dhe përgjegjësitë e Bordit Drejtues dhe pasqyrat financiare nuk miratohen nga bordi. Bordi Drejtues i SUT nuk ka marrë asnjë veprim për këtë rekomandim.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024.

Prendimi subjektit : “... Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në SUT, ju paraqesim observacion si më poshtë:

-Rekomandim 2.1 Masa Organizative .. Rekomandimi është i zbatuar nga SUT, për faktin se pasqyrat financiare për vitin 2022 dhe 2023 janë miratuar nga Bordi Drejtues, bazuar në Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të SUT, me vendimin Nr. 3 datë 02.08.2023 dhe vendimin Nr. 7 datë 29.04.2024. Bashkëlidhur po ju dërgojmë kopje të vendimeve të Bordit Drejtues të SUT.

Qëndrimi i grupit të auditimit : *Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumenatacion e paraqitur nga subjekti përmes observacioneve dërguar me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024 vlerësoi se, nuk paraqiten fakte/prova të reja që të ndryshojnë statusin e zbatimit të rekomandimit. Për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.*

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

3. Gjetje nga auditimi: Në Spitalin Universitar të Traumës nuk janë përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara për vitin 2021, sipas udhëzimeve të MFE. Pasqyrat financiare janë përgatitur më vete, ku njëra është hartuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe një pasqyrë për Ministrinë e Mbrojtjes në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli IV, pika 98-111, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

3.1.Rekomandim: Nga sektori i financës të merren masa për të përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara dhe paraqitja e tyre të jetë në përputhje me standardet kontabël kombëtare, duke pasqyruar gjendjen e tyre financiare në aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit SUT.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria e Financës i është drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr.2580 Prot., datë 11.07.2024 për një interpretim se si mund të bëhet bashkimi

i pasqyrave financiare të konsoliduara duke qenë se SUT është në varësi nga dy ministri (është me dy nipte).

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024.

Pretendimi subjektit : “... Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në SUT, ju paraqesim observacion si më poshtë:

-Rekomandim 3.1 Masa Organizative .. Rekomandimi është i zbatuar nga SUT, për faktin se pasqyrat financiare për vitin 2022 dhe 2023 janë miratuar nga Bordi Drejtues, bazuar në Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të SUT, me vendimin Nr. 3 datë 02.08.2023 dhe vendimin Nr. 7 datë 29.04.2024. Bashkëlidhur po ju dërgojmë kopje të vendimeve të Bordit Drejtues të SUT.

Qëndrimi i grupit të auditimit : Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti përmes observacioneve dërguar me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024 vlerësoi se, nuk paraqiten fakte/prova të reja që të ndryshojnë statusinë e zbatimit të rekomandimit. Për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**

4. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare vjetore edhe pse janë depozituar në Degën e Thesarit Tiranë, nuk provohet nga ana shkrese të jetë bërë konfirmimi nga kjo e fundit. Pasqyrat kanë vetëm numër protokollimi në Degën e Thesarit, në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli V, pika 117, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

4.1.Rekomandim: Nga sektori i financës në SUT të merren masa që pasqyrat financiare vjetore të dërgohen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, pasi të jenë konfirmuar paraprakisht nga Dega e Thesarit të Rrethit Tiranë.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Drejtoria e Financës ia ka dërguar zyrtarisht pasqyrat financiare Ministrisë së Mbrojtjes si dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresat respektive nr. 2538 prot., datë 09.07.2024 dhe nr. 2538/1 prot., datë 09.07.2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se shënimet shpjeguese nuk janë të plotësuar me detaje dhe informacione që duhet të pasqyrohen në të dy bilancet, si për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ashtu dhe për Ministrinë e Mbrojtjes. Plotësimi i tyre është realizuar pjesërisht dhe nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, në të cilin jepen informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë dhe të qartë të pasqyrave financiare, në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale”, të ndryshuar me

Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

5.1.Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, shënimet shpjeguese të plotësohen në mënyrë të saktë dhe të detajuar, në përputhje me SKK, duke dhënë informacionin e nevojshëm dhe të domosdoshëm për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Drejtoria e Financës ka përgatitur relacion shpjegues për raportimin e pasqyrave financiare vjetore të SUT.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

6. Gjetje nga auditimi: Në pasivin e bilancit kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Mbrojtjes, nuk pasqyrohet në llogarinë 12 rezultat i mbartur nga viti i kaluar. Në këtë zë të pasqyrës së pasivit nuk është pasqyruar rezultat i mbartur për të bërë krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale, në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale”, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

6.1.Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pasqyrat financiare të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me SKK duke pasqyruar në pasivin e bilancit rezultatin e mbartur nga viti i kaluar të “Llogaria 12”, për të bërë të mundur krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Nga SUT nuk ka asnjë dokument që ka ndjekur vazhdimësinë e kësaj problematike.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024.

Pretendimi subjektiv : “... Rekomandimi 6.1 ...Në bilancin kontabël të SUT për Ministrinë e Mbrojtjes, nuk pasqyrohet në llogarinë 12, rezultat i mbartur nga viti i kaluar. Rekomandimi i sipërcituar do të zbatohet në bilancin kontabël të vitit ushtrimor.

Qëndrimi i grupit të auditimit : Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumenatacion e paraqitur nga subjekti vlerësoi se dokumentacioni i sjellë përmes observacioneve nuk paraqet fakte/prova të reja që të ndryshojnë statusinë e zbatimit të rekomandimit. Për këtë arsye ngelet të provohet në auditimet e ardhshme.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**

7. Gjetje nga auditimi: Gjatë analizimit të inventarëve rezultoi se, për vitet objekt auditimi nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset (produkt), edhe pse duke u nisur nga vitet dhe nga norma e amortizimit, ekzistojnë asete të cilat janë plotësisht të amortizuara. Gjithashtu të inventarët nuk janë përfshirë zërat (toka, ndërtesa, rikonstruksione), në mënyrë që të bëhet verifikimi i vlerës së aseteve, amortizimit të duhur të tyre duke përfshirë edhe shtesat, si dhe të ardhurat e gjeneruara nga përdorimi i tyre, nëse ka. Në fletë hyrjen e magazinës dhe në

dokumentacionin e marrjes në dorëzim të mallrave, nuk regjistrohen numrat serial/identifikimit përkatës të mallrave, duke e bërë të vështirë identifikimin e tyre, në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 73 – 120.

7.1.Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, asetet plotësisht të amortizuara të nxirren jashtë përdorimit. Gjithashtu duhet të përfshihen në inventar zërat si toka, ndërtesa, rikonstruksione dhe për secilin mall që merret në dorëzim nga institucioni, të përcaktohet dhe regjistrohet numri serial për të bërë të mundur identifikimin e tyre.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Edlira Bode me detyrë Drejtore e Përgjithshme në SUT, ka nxjerrë urdhrin Nr. 1268 datë 16.11.2023 për nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi në SUT.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar përgjigjes së dhënë nga institucioni (personat përgjegjës) rezulton se, është nxjerrë Urdhër nr. 1268 datë 16.11.2023 për nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi por më tej procedura nuk ka vijuar. Sa më lartë, sikundër edhe në afat është specifikuar koha e zbatimit “menjëherë” grupi auditimit mban qëndrimin se ky rekomandim nuk është zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

8. Gjetje nga auditimi: Projekt-Buxhetet për periudhën e auditimit nuk janë të miratuara nga Bordi Drejtues i Spitalit Universitar të Traumës, pasi Bordi Drejtues i Spitalit Universitar të Traumës është mbledhur vetëm një herë përgjatë gjithë periudhës së auditimit 01.01.2020-31.12.2022, në të cilën ka miratuar Strukturën, Organikën, Statutin dhe Rregulloren e Spitalit Universitar të Traumës me Vendim nr.1, datë 15.06.2022. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me VKM nr. 66, datë 3.2.2017 “Për përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimit e Shërbimeve dhe Strukturave Shëndetësore Universitare”, pika 10/a.

8.1 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa që projekt-buxhetet të miratohen nga Bordi Drejtues, pasi kjo mund të sjelli keqmenaxhim të burimeve dhe mosrealizim të objektivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Bordi Drejtues me Vendimin Nr. 3 datë 02.08.2023 ka vendosur Miratimin në parim të projektbuxhetit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

9. Gjetje nga auditimi: Duke iu referuar kërkesave buxhetore, u konstatua se Spitali Universitar i Traumës nuk ka kryer një planifikim të saktë të zërave në buxhet. Gjatë hartimit të Projekt Buxheteve nuk janë marrë në konsideratë kërkesat e kryera nga departamentet sipas strukturës organizative, pasi nuk ekziston asnjë shkresë e përgjegjësve të departamenteve dërguar Grupit për Menaxhimin Strategjik. Buxheti i planifikuar për vitin 2021 në MSHMS ka qenë 350,500,000 lekë, ndërsa faktiku është 413,395,000 lekë, duke tejkaluar planifikimin e buxhetit me 62,895,000 lekë. Buxheti i planifikuar i vitit 2021 në MM ka qenë 1,216,000,000 lekë, ndërsa faktiku është 1,305,350,000 lekë, duke tejkaluar planifikimin e buxhetit me 89,350,000 lekë. Buxheti i planifikuar i vitit 2022 në MSHMS ka qenë 430,500,000 lekë, ndërsa faktiku është 553,361,500 lekë, duke tejkaluar planifikimin e buxhetit me 122,861,500

lekë. Buxheti i planifikuar i vitit 2022 në MM ka qenë 1,135,076,000 lekë, ndërsa faktiku është 1,441,814,250 mijë lekë, duke tejkaluar planifikimin e buxhetit me 306,738,250 Lekë.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 3, pika 29, dhe Kontrata “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore” për vitin 2019 dhe 2020, miratuar me VKA të FSDKSH nr. 20, datë 19.12.2018, dhe nr. 37, date 19.12.2019, neni 11, pika 14, neni 12, pika 14.

9.1 Rekomandimi: Nga ana e Spitalit Universitar të Traumës të merren masa që raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit, të përmbajnë një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planifikuara të zërave në buxhet gjatë vitit ushtrimor, si në sasi dhe vlerë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse në fuqi për zbatimin e buxhetit.

Përgjigjja e institucionit:

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024.

Pretendimi subjektiv : “... **Rekomandimet 9.1-9.3** janë zbatuar nga SUT, i cili ka marrë masa që të protokollohen të gjitha kërkesat e sektorëve për të argumentuar planifikimin gjatë vitit, shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA-së dhe të buxhetit nga plani fillestar deri tek ai përfundimtar.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shembuj të kërkesave.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

9.2 Rekomandimi: Nga ana e SUT të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve Brenda artikujve buxhetorë.

Përgjigjja e institucionit:

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024.

Pretendimi subjektiv : “... **Rekomandimet 9.1-9.3** janë zbatuar nga SUT, i cili ka marrë masa që të protokollohen të gjitha kërkesat e sektorëve për të argumentuar planifikimin gjatë vitit, shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA-së dhe të buxhetit nga plani fillestar deri tek ai përfundimtar.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shembuj të kërkesave.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

9.3 Rekomandimi: Nga ana e SUT të merren masa që strukturat/struktura që do të merren me programimin dhe planifikimin buxhetor, të kryejnë analiza të hollësishme të gjithë treguesve të buxhetit referuar kuadrit rregullator ligjor përkatës, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024. **Pretendimi subjektiv :** “... **Rekomandimet 9.1-9.3** janë zbatuar nga SUT, i cili ka marrë masa që të protokollohen të gjitha kërkesat e sektorëve për të argumentuar planifikimin gjatë vitit, shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA-së dhe të buxhetit nga plani fillestar deri tek ai përfundimtar.
Bashkëlidhur po ju dërgojmë shembuj të kërkesave.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumenatacion e paraqitur nga subjekti përmes observacioneve dërguar me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024 vlerësoi se, paraqiten fakte/prova të reja që ndryshojnë statusinë e zbatimit të rekomandimit. Për këtë arsye observacioni merret në konsideratë.
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

10. Gjetje nga auditimi: Struktura, organika dhe statuti nuk janë të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Mbrojtjes. Referuar rregullores dhe akteve ligjore në fuqi, miratimi i tyre është detyrë funksionale e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Nga ana e Spitalit Universitar është kërkuar disa herë miratimi i tyre por nuk i është dhënë zgjidhje problemit. Struktura organike e re është e domosdoshme të miratohet sa më shpejt pasi rregullorja e re e protokolluar me nr. 1195/3 prot., datë 03.06.2022 përfshin pozicione të reja. Në këtë mënyrë nuk mund të implementohet ende rregullorja e re. Statuti i SUT vazhdon të jetë në fazë Projekt-Statuti. Në Vendimin nr. 1001, datë 2.12.2015 “Për integrimin e Spitalit Universitar të Traumës dhe Spitalit Ushtarak të Forcave të Armatosura në një strukturë të bashkuar”, ndër të tjera është përcaktuar edhe mënyra e hartimit të strukturës organike të Spitalit Universitar të Traumës, konkretisht pika 5 dhe 6. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje e Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu III, Neni 23/pika 2; VKM nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare” Pika 8 dhe 10; VKM Nr. 1001, datë 2.12.2015 “Për integrimin e Spitalit Universitar të Traumës dhe Spitalit Ushtarak të Forcave të Armatosura në një strukturë të bashkuar”, Pika 5 dhe 6; VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 “Për Përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e Shërbimeve dhe Strukturave Shëndetësore Universitare”, Pika 10/ a, b, c.

10.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucione varësie, të marrin masa bazuar në aktet ligjore në fuqi të bëjnë miratimin e strukturës së re, organikës dhe statutit të Spitalit Universitar të Traumës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Më urdhrin Nr.42 datë 24.01.2024 është vendosur miratimi i Statutit SUT dhe me urdhrin Nr.14 datë 12.01.2024 është vendosur miratimi i strukturës dhe organikës të SUT.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit, u konstatua se në dosjet e punonjësve: A.M dhe N.Q me detyrë elektrikistë nuk u gjetën dëshmi të kualifikimit të

sigurimit teknik. Referuar strukturës organizative të Spitalit Universitar të Traumës, të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 30, datë 13.03.2017, shkresë e cila është protokolluar me nr. 371 prot., datë 16.03.2017, ku është miratuar që numri i punonjësve të SUT të jetë 630 punonjës, ndër të cilët 4 pozicione janë për elektrikistë, ku konkretisht dy prej të cilëve nuk kishin dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, pika 1, germa “a”.

11.1 Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Universitar të Traumës në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për pajisjen me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për punonjësit të cilët punojnë në pozicionin elektrikistë, për të siguruar asetet e subjektit dhe jetën e punonjësve elektrikistë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Nga SUT janë paraqitur dëshimtë e kualifikimit për A.M dhe N.Q me detyrë elektrikistë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ka mospërputhje midis gradave dhe funksioneve organike në Forcat e Armatosura, pra gradës në Top dhe gradës në Fakt për personelin Oficer dhe Nënoficer të Njësisë Mjekësore Ushtarake, e cila konkretisht është në masën 13.3%.

Grada Top përcaktohet si grada për pranimin në pozicionin vakant. Kurse grada Fakt është grada që realisht punonjësi disponon. Mospërputhja gradë-funksion për Oficerët, ku konkretisht janë 5 Oficerë nga 40 në total të cilët kanë mospërputhje gradë funksion (pra kanë gradë më të lartë sesa grada top) në masën 12.5%. Ndërsa mospërputhja gradë-funksion për Nën Oficerët, ku konkretisht janë 5 nënoficerë nga 35 në total të cilët kanë mospërputhje gradë funksion (pra kanë gradë më të lartë sesa grada top) në masën 14%. E shprehur në përqindje mospërputhja gradë-funksion për Oficerët dhe Nën Oficerët është në masën 13.3%, siç e kemi paraqitur dhe në tabelat nr. 2, 3, 4 dhe 5, Aneksi 2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënie e pagave dhe shpërblimeve. Kjo problematikë ka ardhur si pasojë e ndryshimeve gradë-funksion të oficerëve, të cilët janë rritur në gradë gjatë ushtrimit të detyrës, pasi ushtarakët sipas Ligjit nr.59/2014 “Për karrierën ushtarake në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë” paguhen sipas gradës dhe jo sipas pozicionit ku aktualisht janë vendosur nga Ministria e Mbrojtjes. Referuar ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, Kreu III, Neni 32, pika 2: “Mospërputhja e gradave me funksionet organike në Forcat e Armatosura nuk duhet të kalojë masën 10 për qind të numrit të përgjithshëm të personelit ushtarak”.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me: ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, Kreu III, Neni 32, pika 2.

12.1 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të NJMU, në bashkëpunim me Drejtorin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, të lihet detyrë që në të ardhmen të ndiqet vazhdimësia e kësaj problematike dhe të shikohet mundësia e përzgjedhjes së punonjësve oficerë dhe nënoficerë, grada fakt e të cilëve përputhet me gradën top.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Nga NJMU nuk ka asnjë dokument që ka ndjekur vazhdimësinë e kësaj problematike.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024.

Pretendimi subjektit : “... Rekomandimi 12.1 ...Rekomandimi i sipërcituar është zbatuar nga SUT, e cila i është drejtuar shkresërisht Ministrisë së Mbrojtjes për zbatimin dhe realizimin e këtij rekomandimi. Bashkëlidhur shkresa drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti vlerësoi se dokumentacioni i sjellë përmes observacioneve paraqet fakte/prova të reja që të ndryshojnë statusin e zbatimit të rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i librit të arkës, për periudhën e objekt auditim, u konstatua se ka ndodhur tejkalim i limitit ditor të arkës së Spitalit Universitar të Traumës. Kjo gjë ka ndodhur, pasi shumat e arkëtuara në arkën qendrore tejkalojnë limitin ditor. Arkëtari i arkës qendrore çdo ditë ka mbledhur arkëtimet dhe ka bërë derdhjet për shumat e mbledhura. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se derdhjet në bankë nuk janë bërë çdo ditë, por një herë në 3-4 ditë.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me VKM nr. 290, date 14.06.1993 “Për limitin ditor të arkës për ndërmarrjet shtetërore”, pika nr. 3.

13.1 Rekomandimi: Nga Shefi i Financës dhe arkëtari të merren masa për respektimin e limitit ditor të arkës për të ulur riskun e mbajtjes së Cash-it në SUT.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

SUT ka paraqitur raste te arkëtimeve ku në vijimësi nuk është kaluar limit sipas VKM nr. 290, date 14.06.1993 “Për limitin ditor të arkës për ndërmarrjet shtetërore”, pika nr. 3.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi mbi disa kompionë të përzgjedhur për të marr siguri të arsyeshme mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, u konstatua mos tejkalim i limitit ditor të arkës.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se:

- Në të gjitha rastet për vitet 2021 dhe 2022, procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve janë pa numër protokollit.

- Në disa raste u konstatua se referuar kontratave me operatorët ekonomikë, nga ana e Spitalit Universitar të Traumës ka vonesa në likuidimin e faturave me operatorët ekonomikë, duke mos respektuar afatet e parashikuara në detyrimet kontraktuale të kontratave dypalëshe respektive.

- Gjatë auditimit me zgjedhje të likuidimeve nëpërmjet bankës u konstatua se gjatë muajit shkurt dhe mars 2022 janë pranuar dhe likuiduar nga Komisioni i Pritjes së mallit “Blerje medikamente mjekësore”, të cilat e kanë pasur afatin e skadencës më të vogël se 1 vit. Kjo gjë është konstatuar në urdhër-shërbimin nr. 15, datë 15.02.2022 dhe në urdhër-shërbimin nr. 36, datë 10.03.2022.

Referuar urdhër shpenzimit nr. 15, datë 15.02.2022 “Blerje medikamente mjekësore” dhe urdhër shpenzimit nr. 36, datë 10.03.2022 “Furnizim medikamente mjekësore” u konstatua se janë marrë në dorëzim medikamente me afat skadence më të vogël se 1 (një) vit. Konkretisht, referuar urdhër shpenzimit të parë të cituar dhe procesverbalit për marrjen në dorëzim të medikamenteve të datës 17.01.2022, i cili nuk është i protokolluar, ku janë marrë në dorëzim medikamentet: Eptacog Alfa (Advanced) (1 mg/m i afterreconstitution; me nr. serial AG93) me skadencë 30.06.2022 në vlerën totale 4,818,000 lekë dhe Eptacog Alfa (Advanced) (1 mg/m i afterreconstitution; me nr. serial AX85) në vlerën 9,417,000 lekë. Ndërsa referuar urdhër

shpenzimit të dytë të cituar dhe procesverbalit për marrjen në dorëzim të datës 8.02.2022, i cili nuk është i protokolluar, ku janë marrë në dorëzim medikamentet: Serum Antitetanik (SAT) Human Antitetanusimmunoglobuline; me nr. serial L02R0720 me skadencë 01.02.2023 në vlerën totale 601,983 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me DST të paraqitura në procedurën e prokurimit dhe në kontratën e nënshkruar mes palëve si dhe në dokumentet standarde të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe APP; Kontrata dypalëshe e lidhur midis SUT dhe OE "PH.O" nr. 79/15, datë 17.01.2022; dhe Kontrata dypalëshe e lidhur midis SUT dhe OE "M" nr. 79/29, datë 10.02.2022 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

14.1 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa në të ardhmen, për plotësimin dhe sistemimin në mënyrë kronologjike të dokumentacionit justifikues, bashkëlidhur veprimeve të kryera me bankë në zbatim të përcaktimeve të dispozitave ligjore përkatëse.

Përgjigjja e institucionit:

Për Shërbimin e Farmacisë është hartuar rregullorja për "Procedurat operacionale standarte në shërbimin e farmacisë spitalore", e cila në faqen 39-40 ka të përcaktuar procedurën e ruajtjes dhe mënyrën e zëvendësimit të barnave etj, dhe datën e skadencës së të gjitha barnave.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion dhe përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit (personi përgjegjës) rezulton se, është hartuar draft rregullorja e cila vec të tjerash do të specifikoj procedurën e ruajtjes, mënyrën e zëvendësimit të barnave dhe datën e skadencës së të gjitha barnave por statusi i zbatimit të këtij rekomandimi mbetet për tu verifikuar në auditimet e ardhshme.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pjesërisht i zbatuar**.

14.2 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa që në rastet e marrjes në dorëzim të medikamenteve, afatet e skadencës të jenë brenda normave të lejuara, në mënyrë që të sigurohet shërbimi i duhur për pacientët e Spitalit Universitar të Traumës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për Shërbimin e Farmacisë është hartuar rregullorja për "Procedurat operacionale standarte në shërbimin e farmacisë spitalore", e cila në faqen 39-40 ka të përcaktuar procedurën e ruajtjes dhe mënyrën e zëvendësimit të barnave etj, dhe datën e skadencës së të gjitha barnave.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion dhe përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit (personi përgjegjës) rezulton se, është hartuar draft rregullorja e cila vec të tjerash do të specifikoj procedurën e ruajtjes, mënyrën e zëvendësimit të barnave dhe datën e skadencës së të gjitha barnave por statusi i zbatimit të këtij rekomandimi mbetet për tu verifikuar në auditimet e ardhshme.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pjesërisht i zbatuar**.

15. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, me për zgjedhje, u konstatua se:

-Në 5 raste Autorizimi për lëvizjen e mjetit nuk ndodhej në dosje.

-Nuk është bërë një planifikim mujor apo vjetor ku të ketë një plan shpërndarje për çdo sektor/degë/drejtori.

-Nga Organet Drejtuese nuk ka një udhëzim, manual dhe rregulla ku të jenë pjesë e rregullores së brendshme në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të gjithë procesit të konsumit të karburantit për automjetet e SUT, në të cilën të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive apo sektorëve.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19, neni 22, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 5, 10, 19 dhe 36.

15.1 Rekomandimi: Nga Titullari i SUT të merren masa për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë mjete në ngarkim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë gjendjen teknike të mjeteve dhe më pas të caktojë normativat mbi konsumin e karburantit, për mjetet që ushtrojnë aktivitetin në SUT pa normativa të miratuara.

Përgjigjja e institucionit:

Nga Drejtorja e SUT me Urdhrin nr.1182 datë 16.05.2023 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e normave të harxhimit të karburantit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

15.2 Rekomandimi: Nga Titullari i SUT të merren masa për miratimin e një udhëzimi, manuali apo rregullave lidhur me mënyrën e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të gjithë procesit të konsumit të karburantit për automjetet e SUT, ku të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive apo sektorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga Drejtorja e SUT me Urdhrin nr.1182 datë 16.05.2023 është ngritur grupi i punës për përllogaritjen e normave të harxhimit të karburantit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qirasë, në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, në lidhje me kontratat e qirasë me OE S-A si dhe pas verifikimit të pagesave, nuk u konstatua asnjë kontratë furnizimi me energji dhe ujë të pijshëm për ambientet marrë me qira nga O.E. i sipërcituar.

16.1.Rekomandim: Drejtorja e SUT, të marrë masa të hartojë dhe të finalizojë kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga ana e A.K.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

SUT me anë të Z.D.L me detyrë përgjegjës i sektorit teknik bazuar në kontratën e qirasë “Neni 6” i saj, llogarit pagesën përkatëse, dokumentuar me anë të procesverbalit të mbajtur nga ana e Z.D.L në të cilin evidentohen matjet për furnizimin me energji elektrike dhe ujë të pijshëm. SUT nuk ka finalizuar kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga SUT, por mban vetëm procesverbale.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024. Pretendimi subjektit : “... Rekomandimi është i zbatuar nga SUT dhe bashkangjitur relacioni nga grupi i monitorimit të kontratës së qerasë.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi i Auditimi, pasi shqyrtoi dokumenatacion e paraqitur nga subjekti përmes observacioneve dërguar me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024 vlerësoi se, nuk paraqiten fakte/prova të reja që të ndryshojnë statusin e zbatimit të rekomandimit. Për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**

17. Gjetje nga auditimi: Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe verifikimit të ambienteve fizike ekzistojnë makineri për të cilat nevojitet rrymë elektrike si dhe pajisje të tjera të cilat u nevojitet shërbimi i ujit. duhej të ishin cituar në specifikimet teknike dhe në hartimin e kontratave ku të përfshihej pajisja me kontrata furnizimi të energjisë elektrike dhe ujit.

veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me VKM nr.54, datë 05/02/2014 “për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

17.1.Rekomandim: SUT, të marrë masat të hartojë dhe të finalizojë kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga ana e A.K

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

SUT me anë të Z.D.L me detyrë përgjegjës i sektorit teknik bazuar në kontratën e qirasë “Neni 6” i saj, llogarit pagesën përkatëse, dokumentuar me anë të procesverbalit të mbajtur nga ana e Z.D.L në të cilin evidentohen matjet për furnizimin me energji elektrike dhe ujë të pijshëm. SUT nuk ka finalizuar kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga SUT, por mban vetëm procesberbale.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024. Pretendimi subjektit : “... Rekomandimi 17.1 Rekomandimi është i zbatuar nga SUT dhe bashkangjitur relacioni nga grupi i monitorimit të kontratës së qerasë.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi i Auditimi, pasi shqyrtoi dokumenatacion e paraqitur nga subjekti vlerësoi se dokumentacioni i sjellë përmes observacioneve nuk paraqet fakte/prova të reja që të ndryshojnë statusin e zbatimit të rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**

18. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i faqes Web për funksionimin dhe administrimin e saj, u konstatua që faqja ëeb nuk funksiononte dhe në nën-menut dhe faqja kryesore ishin të paplotësuara dhe pa të dhëna.

18.1.Rekomandim: SUT, të marrë masat për ngritjen e një komisioni të dytë për zbatimin dhe mbikëqyrjen e kontratës, në lidhje me faqen ëeb, për vënien e saj në përdorim sipas kushteve

të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga verifikimi u konstatua se faqja Web nuk ishte funksionale sipas kushteve të kontratës. Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024. Pretendimi subjektiv : “... Rekomandimi 18.1 ...Rekomandimi është i zbatuar nga SUT dhe mund të verifikohet në çdo moment duke klikuar në uebsiten www.sut.gov.al. Bashkëlidhur printime nga website.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar rekomandimit të mësipërm, nga ana e SUT, nuk është ndërmarr asnjë masë për verifikimin e mbikqyrjes së zbatimit të kontratës.

Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti përmes observacioneve dërguar me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024 vlerësoi se, nuk paraqiten fakte/prova të reja që të ndryshojnë statusin e zbatimit të rekomandimit. Për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

19. Gjetje nga auditimi: Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe pas verifikimit të pagesave, z. D.L (inxhinier elektrik) mban procesverbal për konsumin e energjisë si dhe çmimi i energjisë caktohet nga zyra e financës dhe i bashkëngjitet faturës së qirasë mujore por nuk u konstatua asnjë kontratë furnizimi me energji dhe ujë të pijshëm për ambientet marrë me qira nga O.E. i sipërcituar. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me VKM nr.54, datë 05/02/2014 “për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

19.1.Rekomandim: SUT, të marrë masat të hartojë dhe të finalizojë kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga ana e A.K.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

SUT me anë të Z.D.L me detyrë përgjegjës i sektorit teknik bazuar në kontratën e qirasë “Neni 6” i saj, llogarit pagesën përkatëse, dokumentuar me anë të procesverbalit të mbajtur nga ana e Z.D.L në të cilin evidentohen matjet për furnizimin me energji elektrike dhe ujë të pijshëm. SUT nuk ka finalizuar kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga SUT, por mban vetëm procesberbale.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024. Pretendimi subjektiv : “... Rekomandimi 19.1 ...SUT, të marrë masat të hartojë dhe të finalizojë kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga ana e A.K.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti vlerësoi se dokumentacioni i sjellë përmes observacioneve paraqet fakte/prova të reja që të ndryshojnë statusin e zbatimit të rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**

pjesërisht.

20. Gjetje nga auditimi: Gjatë verifikimi fizik të artikujve u has vështirësi pasi në inventarizimin e tyre, nuk regjistrohen me numrat serial/identifikimit përkatës të mallrave, duke bërë të vështirë identifikimin e tyre. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”..

20.1.Rekomandim: SUT, të marrë masat që në komisionet e pritjes së mallit ose marrjen në dorëzim të tij, magazinieri, që në momentin e pranimit të një malli/prodakti, të bëjnë regjistrimet përkatëse sipas natyrës, llojit dhe identifikimit të produktit/mallit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga komisioni i pritjes së mallit mbahet proces-verbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit, bëhet hyrja në magazinë me flete-hyrje nga magazinieri dhe shënohet numëri i serisë. Nga SUT janë paraqitur raste të cilat rekomandimi gjen zbatueshmëri.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi mbi disa kompjone të përzgjedhur për të marr siguri të arsyeshme mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, u konstatua se, hyrja në magazinë dokumentohej me fletë-hyrje nga magazinieri ku shënohet numëri i serisë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se në 2 (dy) raste kishim copëzim të fondeve apo kontratave gjatë përzgjedhjes së procedurave. SUT në llogaritjen e fondeve për procedurën e prokurimit në vlerë të vogël, nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngeshme, të cilat zakonisht duhet të prokurohen njëherësh dhe në asnjë rast, nuk duhet të ndahen gjatë përdorimit të kësaj procedure. Për këtë arsye, ato nuk përbëjnë shkak për ndërprerje të proceseve kryesore të shoqërisë, pra nuk janë objekt i avarive të cilat kërkojnë kryerjen e detyruar të procedurave të veçanta të prokurimit për çdo objekt.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje Pika 3 e Udhëzimit Nr.05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” si dhe nenin 56, pika 2 dhe pika 11, e Vendimit Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për Prokurimin publik”.

21.1.Rekomandim: SUT, të marrë të gjitha masat që në hartimin e regjistrimit të prokurimeve të parashikohen të gjitha procedurat e blerjes së mallrave, punëve dhe shërbimeve, që do të prokurohen në vlerë të vogël, me qëllim që të shmangë përdorimin e paplanifikuar dhe të parregulluar të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga SUT është hartuar regjistri i prokurimeve me shkresën nr. 1/6 prot datë 09.05.2024 e Drejtores së Përgjithshme.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

22. Gjetje nga auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurave “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT”, për nevoja emergjente në asnjë pikë të hartimit të kriterëve të veçanta dhe specifikimeve teknike nuk është përmendur minimumi i kriterëve që duhet të plotësojë një O.E., bazuar në praktikën më të mira, ku faktorët dietetikë-ushqimorë janë një shkak i parandalueshëm dhe i shërimit të sëmundjeve, pasi spitalet pritet të shërbejnë ushqime me vlera ushqyese në mënyrë që të trajtojnë sëmundjet dhe promovojnë një dietë të shëndetshme dhe të ekuilibruar. Për më tepër, ushqimet që spitalet zgjedhin të blejnë dhe mënyra në të cilën ato prodhohen, përpunohen dhe transportohen mund të kenë një ndikim të thellë në shëndetin e njeriut, si më poshtë:

Dëshmi mbi vendin se ku do përpunohet dhe ambalazhohet ushqimi dhe mjetet për shpërndarjen e tyre. Certifikatat dhe licencat mbi sigurinë, cilësinë dhe pastërtinë e ambienteve dhe ushqimeve që përdoren. Dëshmi mbi eksperiencën disa vjeçare në industrinë e përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit. Dëshmi mbi numrin e punonjësve të përfshirë dhe shefat e kuzhinës (Eksperiencat). Ambienti se ku do të pritet ushqimi, ambientet, punonjësit, Menaxhimi i stafit dhe trajnimi i tyre

Cilësia e ushqimit, menuja e pasur, mënyra e ambalazhit, servirja, në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

22.1.Rekomandim: SUT, grupi i hartimit të specifikimeve teknike, në zhvillimin e procedurave të prokurimit, gjatë hartimit të tyre, të marrë në konsideratë të gjitha praktikën më të mira që të orientojnë drejt një produkti/shërbimi që përmbush 3E (eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet), duke u mbështetur dhe në legjislacionin në fuqi.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Nga SUT nuk është zhvilluar procedurë tjetër me këtë objekt. Sa me sipër trajtuar rekomandimi i adresuar është ndjekur nga strukturat respektive.

Komenti i grupit të auditimit.

Ky rekomandim është pranuar dhe statusi i zbatimit të këtij tij do të verifikohet në auditimet e rradhës.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

23. Gjetje nga auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurave “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT”, zhvilluar në ABP, me O.E. fitues “D.Park 2.”, nga grupi i auditimit u konstatuan kushte dhe metoda të papërshtatshme për shpërndarjen e ushqimit. Zanafilla e problematikës së mësipërme është krijuar në përcaktimin e specifikimeve teknike, ku citohet dhe mënyra për shpërndarjen e ushqimit. Duke marrë në konsideratë çmimet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në lidhje për sa më sipër, metodat e tanishme të shpërndarjes së ushqimit nuk kanë ndonjë ndryshim me metodat e para disa viteve, ku ky shërbim ofrohej nga punonjësit dhe mjediset e spitalit, në mospërputhje me Nenin 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

23.1.Rekomandim: A.K., në këtë rast SUT, të rishikojë kushtet e kontratës dhe mënyrën e ambalazhimit dhe të shpërndarjes së ushqimit, si dhe të sigurojë ambiente dhe kushte të përshtatshme pranë spitalit duke u bazuar në praktikën më të mira si dhe të arrijë efektivitet të plotë të shërbimit nga O.E.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Nuk është kryer rishikim i kushteve të kontratës, do të merret parasysh rekomandimi i lënë nga KLSH. SUT ka krujuar kushte duke kryer punuime në ambientet e shpërndarjes së ushqimit

Komenti i grupit të auditimit.

Ky rekomandim është pranuar dhe statusi i zbatimit të këtij rekomandimi do të verifikohet në auditimin e radhes.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

24. Gjetje nga auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurave “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT”, zhvilluar në ABP, me O.E. fitues “D.P 2.”, nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit, në lidhje me gatimin e ushqimit, shfaqej e njëjta menu në të gjithë fletët e forcës ditore, ku edhe pse kaloritë dhe ingredientët janë të përcaktuar, mënyra e gatimit të tyre duhet të ndryshohet, në mospërputhje me Marrëveshjen kuadër nr. 97/26 Prot., datë 13.06.2022

24.1.Rekomandim: Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kërkojë penalizimin e tyre.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

SUT nuk ka asnjë dokumentacion për masat e marra për këtë rekomandim.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024. Pretendimi subjektit : “... Rekomandimi 24.1 ... Rekomandimi është i zbatuar nga SUT, pasi janë rishikuar dhe ndryshuar dietat të cilat janë të ndryshme çdo ditë të javës, sipas frutave dhe perimeve të stinës. Dietat për të sëmurët rëndë në shërbimin e reanimacionit, të cilët e marrin ushqimin nëpërmjet sondës (direkt në stomak) janë specifike dhe nuk mund të ndryshohet mënyra dhe lloji i gatimit. Bashkalidhur po ju dërgojmë menutë javore dhe dietat.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti përmes observacioneve dërguar me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024 vlerësoi se, nuk paraqiten fakte/prova të reja që të ndryshojnë statusin e zbatimit të rekomandimit. Për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

25. Gjetje nga auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurave “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT”, zhvilluar në ABP, me O.E. fitues “D.P 2”, nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit u konstatuan në ambientet e spitalit vetëm 2 punonjës për ambalazhimin dhe shpërndarjen e ushqimit nga 8 punonjës që duhej të ishin, në mospërputhje me Marrëveshjen kuadër nr. 97/26 Prot., datë 13.06.2022

25.1.Rekomandim: Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kërkojë penalizimin e tyre.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Shoqëria “D.P 2” shpk, ka vendosur në dispozicion listën e punonjësve të tyre.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

26. Gjetje nga auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurave “Kryerje e shërbimit të lavanderisë për një periudhë 48 mujore në SUT”, grupi i auditimit gjatë verifikimit të zbatimit të kontratës konstatoi që në ambientin, cilësuar si Ortopedia 1, në të gjithë katin kur numri total i shtretërve është 28, ku u konstatua që këto shtretër ishin të amortizuar dhe të pa rregulluar nga ana e O.E., në mospërputhje me Marrëveshjen kuadër nr. 97/26 Prot., datë 13.06.2022

26.1.Rekomandim: Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësim të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kërkojë penalizimin e tyre.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Komisioni i posaçëm, ka mbajtur proces verbalin datë 13.06.2024 dhe procesverbalin datë 17.04.2024, “Për monitorimin e marrëveshjes kuadër Nr.7/26 Prot, datë 17.07.2020 dhe zbatimin e kontratave me objekt “Kryerjen e shërbimit të lavanderisë për një periudhë 48 mujore në SUT”, janë marrë shtretër spitalor.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Trajtimi i mbetjeve spitalore” u konstatuar që pranë ambienteve të spitalit ishte i vendosur vetëm një kontejner ku brenda tij ishte i instaluar një frigorifer. Sipas kushteve të kontratës Operatori ekonomik, duhet të instalojë të paktën dy frigoriferë në ambientet e SUT të përshtatshëm për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme të buta dhe të ngurta, deri në momentin e transportimit për në impiantin e asgjësimit. Gjithashtu u konstatua se nuk ishte kryer dezinfektimi i mirë i frigoriferëve dhe ambientit brenda dhe përreth vendit ku ruhen mbetjet.

27.1.Rekomandim: Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kërkojë penalizimin e tyre.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Nga SUT janë vënë në dispozicion pamje të cilat vërtetojnë se brenda kontenierit janë vendosur 2 frigorifer dhe ambienti është i dezinfektuar.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore në SUT, gjatë hartimit të projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk bëhet analizë mbi gjendjen e ilaçeve, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë listën për nevojat e këtyre barnave. U konstatua se planifikimi nga shërbimet mjekësore është kryer pa marrë në konsideratë kërkesën dhe sasinë reale, sipas nevojës vjetore të secilit pavijon. Në dosje u konstatua vetëm inventari i farmacisë i datës 31.12.2019.

Gjithashtu në kontratat me FSDKSH nuk është përcaktuar procedura e planifikimit të barnave dhe medikamenteve. Nga grupi i auditimit u konstatua se: në Kontratat me FSDKSH nuk është përcaktuar proceduara e planifikimit të barnave dhe medikamenteve, ndërkohë që në të gjitha kontratat Tip kjo gjë është e përcaktuar. Përsa i përket Kontratës me FSDKSH me nr. 3, datë

06.01.2021 (nr. 9060 prot., datë 30.12.2020 i FSDKSH) dhe kontratës me nr. 172/1 prot., datë 26.01.2022 (nr. 6920 prot., datë 31.12.2021 të FSDKSH), duhet të bëhet një shtesë në lidhje me planifikimin e barnave dhe medikamenteve të SUT. Këtë gjë nuk e parashikon asnjë nga kontratat e sipërcituara, ndërkohë që në të gjitha kontratat tip ajo përcaktohet. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, UMF nr. 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit” dhe Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

28.1 Rekomandimi: Nga Strukturat drejtuese të merren masa në vazhdimësi për ngritjen e një grupi pune gjatë fazës së planifikimit dhe evidentimit të nevojave për medikamente dhe materiale mjekësore në mënyrë të tillë që ky planifikim të kryhet mbështetur në një analizë të konsumit dhe nevojës për barna.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Nga Drejtorja e SUT me Urdhër me Nr.1303 datë 1.12.2023 është specifikuar përgatitja për një periudhë 24 mujore kërkesat për barna dhe kërkesat për një periudhë 12 mujore për materiale mjekimi.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion dhe përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit (personi përgjegjës) rezulton se, është nxjerr Urdhër me Nr.1303 datë 1.12.2023 për përgatitjen e kërkesave për barna dhe materiale mjekimi, por në mbështetje të rekomandimit nevojitet që të shoqërohet me një analizë të mirëfilltë të konsumit dhe nevojave. Sa më sipër statusi i zbatimit të këtij rekomandimi mbetet për tu verifikuar në auditimet e ardhshme.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pjesërisht i zbatuar**.

28.2 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa në mënyrë që të bëhet një shtesë në kontratën me FSDKSH, ku të përcaktohet qartë procedura e planifikimit të barnave dhe medikamenteve në përputhje me ligjin.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Nga Drejtorja e SUT është bërë kërkesë për shtesë kontrate drejtuar FSDKSH me nr. 2541 prot. Datë 09.07.2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

29. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i punimeve sipas Kontratës “Ndërtim i Depos së ujit të SUT” janë konstatuar mangësi të cilat kanë të bëjnë me:

- Sipas zërit 1.1.10 “Rrethim i përhershëm me kolona b/a dhe rrjetë teli”, është certifikuar sasia 153 m², ndërsa nga matjet në objekt rezulton se për këtë zë punimi nuk është vendosur sasia 10 ml, ose 16 m², si dhe disa kolona betoni kanë pësuar devijim.

- Sipas zërit 1.1.24 “Ullukë shkarkimi vertikalë me llamarinë xinkato Ø 100 mm”, ulluqet vertikale janë vendosur material PVC, me diametër 65 mm dhe jo llamarinë xinkato.

- Sipas zërit “3.3.3 “Dyer të blinduara importi me akses kontrolli”, është certifikuar dhe realizuar sasia 2.46 m², por nuk është vendosur akses i kontrollit. Nga ana e subjektit është paraqitur material sipas të cilit të gjitha defektet e mësipërme janë riparuar, gjithsesi mbetet për t’u verifikuar në fazën e zbatimit të rekomandimeve. Veprimet e mësipërme janë në

kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 4.1

29.1 Rekomandimi: Mbikëqyrësi i punimeve të kërkojë nga kontraktori riparimin e defekteve dhe realizimin e plotë të sasisë për zërat e punimeve të konstatuara me mangësi, përpara përfundimit të periudhës së garancisë së tyre. Të bëhet verifikim për çdo zë punimi të realizuar, për identifikimin e defekteve të tjera të mundshme, në mënyrë që të merret në dorëzim të përhershëm një objekt me të gjitha punimet e realizuara sipas kontratës dhe kushteve teknike të zbatimit.

Brenda periudhës së garancisë

Përgjigja e institucionit:

Nga mbikëqyrësi i punimeve është kërkuar riparimi i defekteve dhe realizimi i plotë i sasisë për zërat e punimeve të konstatuara me mangësi. OE ka sjellë pamje të objekteve me realizimin e plotë të punimeve.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Procedura e prokurimit Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimet mjekësore Neurokirurgji, K. Vazale, K. Maksilofaciale, K. Retinale” rezulton se: Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, për kontratat e mësipërme dhe ato në vazhdim të kësaj Marrëveshje kuadër i referohet urdhrin nr.103 datë 25.01.2018 ndërkohë që furnizimi për këto kontrata është gjatë vitit 2021 dhe 2022. Për periudhën nga 01.01.2021–15.06.2022 drejtuesit respektiv të SUT nuk kanë ngritur komision të pritjes dhe marrjes në dorëzim për mallrat që ata kanë prokuruar, Në pikëpamjen formale urdhri nr.103 datë 25.01.2018 dhe nr. 317 Prot., datë 15.06.2022, nuk bazohen në akte ligjore në fuqi, pasi i referohen ligjit nr. 6942 date 15.12.1984 dhe VKM nr.70 datë 11.03.1985 të shfuqizuara. Për sa më lart, mungesa e identifikimit dhe zbatimit të akteve ligjore në fuqi, tregon që në SUT mungon kontrolli i brendshëm, duke e bërë jo efektiv zbatimin ligjit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK) nga strukturat përgjegjëse drejtuese në SUT.

30.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e SUT, të kërkohet që aktet administrative, të miratohen paraprakisht nga sektori juridik për të garantuar përputhshmërinë e bazës ligjore në fuqi mbi të cilën mbështeten aktet administrative të emetuara nga titullari i institucionit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Më urdhrin Nr.534 datë 09.05.2024 dhe urdhrin Nr. 1014 datë 06.07.2023 të Drejtorit të Përgjithshme është zbatuar rekomandimi duke ngritur komisione për pritjen, kontrollin dhe marrjen në dorëzim të mallrave dhe bazuar në ligjet në fuqi.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”, rezulton se: Në urdhrin e sipërcituar ka reference jo të saktë të numrit të protokollit për Marrëveshjen Kuadër, pasi urdhri i referohet marrëveshjes nr.78/8 Prot. Datë 12.12.202., ndërkohë që numri i protokollit të marrëveshjes është i korrigjuar dhe mbanë nr. 74/9 Prot datë 12.12.2022, ndërkohë që ky numër protokollit është përdorur në urdhrin për administrimin e dokumentacionit të shkruar që duhet të dorëzonte OE i kualifikuar dhe shpallur fitues para

lidhjes se marrëveshjes kuadër.

Numri i protokollit 74/8 datë 12.12.2022 që i referohet Urdhrit për ngritjen e komisionit të posaçëm për monitorimin e marrëveshjes kuadër, si dhe të minikontratave që do të lidheshin, rezulton të jetë nr. i protokollit edhe për raportit përmbledhës të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO).

Referenca e gabuar e nr. të protokollit të marrëveshjes kuadër reflektohet edhe në kontratën e lidhur me OE "O.. D" Nr.74/13 Prot Datë 15.12.2022. Referuar Urdhrit nr. 317 Prot., datë 15.06.2022, për krijimin e komisionit të pritjes dhe marrjes në dorëzim të vlerave materiale me të cilat do të furnizohet SUT për vitin 2021 e në vazhdim titullari i institucionit ka ngritur komisionin e pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit respektivisht, për neurokirurgjinë: I.H, N.B, A.S dhe për kirurgjinë maksilofaciale: L.B, M.S, A.T.

Referuar Proces verbalit të datës 16.12.2022 mbi marrjen në dorëzim të mallit të dorëzuar nga kontraktuesi sipas faturës tatimore elektronike nr. 1987/2022 date 16.12.2022, rezulton se komisioni i marrjes në dorëzim është ai i përcaktuar në Urdhrin nr. 317 prot., datë 15.06.2022 dhe jo ai i përcaktuar në urdhrin nr. 74/10 Prot. Datë 13.12.2022 të titullarit të institucionit.

Urdhri nr. 317 Prot., datë 15.06.2022 i referohet bazës ligjore të shfuqizuar duke ju referuar ligjit nr. 6942 date 15.12.1984 dhe VKM nr.70 date 11.03.1985.

Për sa më lart, titullari i institucionit për të njëjtin objekt të veprimtarisë dhe për të njëjtën periudhë kohore ka nxjerr dy urdhra me komisione të ndryshme. Kjo tregon që në SUT nuk është hartuar gjurma e auditit siç e përcakton baza ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe për rrjedhojë mungon kontrolli i brendshëm duke e klasifikuar jo efektiv menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK).

31.1 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës, të ngrejë grupe pune për hartimin e gjurmës së auditit për çdo proces dhe veprimtari që ushtrohet në SUT., për të përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm me qëllim që të sigurohet përdorimi me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë i fondeve publike.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga Drejtorja e SUT me Urdhër Nr.775 datë 02.07.2024 ku është ngritur grupi i punës për hartimin e gjurmës së auditimit për cdo proces dhe veprimtari që ushtrohet në SUT.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT" viti-2021 rezulton se:

AK për plotësimin e kapacitetit teknik, tek kriteri 2.3 pika "e", ka kërkuar që:

"OE duhet të paraqesë autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga MSHMS sipas ligjit 89/2014 "Për Pajisjet Mjekësore".

Vendosja e këtij kriteri është e pa plotë, pasi AK duhet të kërkoj certifikatën për regjistrimin e pajisjeve mjekësore në regjistrin kombëtar të AKBPM, kjo në referim të ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore", neni 13 (procesi i regjistrimit) pika 1, c dhe 2 ku parashikohet se:

1. Të gjitha pajisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohen në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore paraqitet nga:

c) tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore

2. AKBPM-ja lëshon një certifikatë për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar

të pajisjeve mjekësore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimi.

32.1 Rekomandimi: Drejtoria e SUT para miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të hartuara nga grupet e punës, duhet të kërkojnë që në kriteret e veçanta të përfshijë kërkesa që parashikohen në ligjin për pajisjet mjekësore në mënyrë që të prokurojë mallra/shërbime me cilësi të lartë duke optimizuar shpenzimet për këto mallra.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në kontratën e furnizimit për mallra (mini kontrata Nr. 12/2024) për “furnizim me materiale konsumi (implante ortopedike) për shërbimin e ortopedisë”, në Nenin 17 është e përcaktuar origjina e mallit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT" viti-2021, rezulton se: Komisioni për pritjen dhe administrimin e materialeve mjekësore, nuk ka dorëzuar formularin për realizimin e kontratës Nr.9/20 Prot Datë 01.06.2021, pranë Sektorit të Prokurimeve.

2. Referuar Deklaratave OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit për marrëveshjen kuadër, të cilët kanë deklaruar se:

a. OE T, do të vendosë në dispozicion për çdo operacion që do të kryhet, setet e montimit (minimumin një set montimi) dhe tre specialist të trajnuar për përdorimin e tyre. Specialistët e trajnuar nga kompania prodhuese e seteve dhe materialeve mjekësore janë: E.Gj, K.S dhe E.L.

b. OE L do të vendosë në dispozicion për çdo operacion që do të kryhet, setet e montimit (minimumin një set montimi) dhe 3(tre) specialist të trajnuar për përdorimin e tyre. Specialistët e trajnuar nga kompania prodhuese e seteve dhe materialeve mjekësore janë: Fation Sema, I.Sh, D.Sh dhe E. Gj

c. OE O 3.. do të vendosë në dispozicion për çdo operacion që do të kryhet, setet e montimit (minimumin një set montimi) dhe 1(një) specialist të trajnuar për përdorimin e tyre.

Specialisti i trajnuar nga kompania prodhuese e seteve dhe materialeve mjekësore është: M.K
Nga auditimi i regjistrave të bllokut operator qendror, rezulton se:

-Në sallën e operacionit sipas detyrimit të nenit 5 të kontratës së furnizimit, si përfaqësues të firmës kanë asistuar edhe z. I K, z. A M, R Z, R G, persona që nuk janë deklaruar nga OE itues të kësaj procedure me të cilët është lidhur marrëveshje kuadër.

-Shkëmbimi i materialeve ortopedike të grupit sinteza nuk është dokumentuar me proces verbal sipas përcaktimit të pikës 5 paragrafi i dytë i kontratës nr.1/2021 të furnizimit, por nga ana e mjekut kirurg operues është lëshuar recetë mjekësore për pacientin që do të operohet duke përshkruar materialet ortopedike që duhen për këtë operacion, siç pasqyrohet në faksimilen nr.5, 6 dhe 6/1 të Aneksit 2.8.1.

-Pajisjet mjekësore të marra në dorëzim nga komisioni përkatës nuk janë të shoqëruar me etiketën në gjuhën shqipe, veprim në mospërputhje me nenin 20 (Etiketimi dhe instruksionet për përdorim) të ligjit 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore”, ku parashikohet se:

a. Çdo pajisje mjekësore, që vendoset në treg dhe vihet në shërbim, duhet të përmbajë etiketën në gjuhën shqipe, e cila duhet të paraqitet në një formë të dukshme dhe të lexueshme.

b. Instruksione për përdorim nuk do të kërkojnë për pajisjet e klasave I dhe II.

c. Rregullat për etiketimin dhe instruksionet për përdorimin e pajisjeve mjekësore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

33.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të ngrejë grupe pune për të analizuar gjithë procesin e administrimit të materialeve ortopedike duke filluar nga planifikimi dhe qarkullimi

i tyre deri tek shërbimi i ortopedisë, gjithashtu për rastet e gjenerimit të recetave mjekësore për materialet sinteza të bëjë një analizë të hollësishme të këtij fenomeni dhe të nxjerr akte administrative mbi dokumentimin e tyre, të ngjashëm me rastin e administrimit të protezave me anë të proces verbaleve duke i identifikuar këto materiale me të dhënat që ato janë bërë hyrje në farmaci.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Nga titullari i institucionit ka dalë urdhëri Nr.825 datë 08.07.2024, “Për hartimin e rregullores së administrimit të materialeve të osteo-sintezës”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-viti 2022” rezulton se:

BOE T&L dhe OE O 3.. në cilësinë e kontraktuesit, gjatë dorëzimit të mallit sipas kontratave respektive nuk kanë shoqëruar mallin me certifikatën e regjistrimit pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Në këto kushte komisioni i pritjes dhe kolaudimit të mallit ka vepruar në mospërputhje me pikën j) të kriterit 2.3 paragrafi i dytë ku është përcaktuar se:

OE duhet të paraqesin një deklaratë ku të shprehet se do të vendosi në dispozicion të Ak, certifikatat e origjinës së mallit (implanteve) dhe certifikatat e regjistrimit të mallit pranë Institucioneve përkatëse në RSH. Certifikatat duhet të shoqërojnë mallin sipas kontratave të furnizimit që do të nënshkruhen përgjatë periudhës 24 mujore.

Në Kontratën nr. nr. 50/22 prot. datë 04.11.2022 dhe nr.50/27 prot., datë 16.12.2022 nuk kanë reflektuar kërkesat e parashikuara në DST të procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e ortopedisë në SUT” duke mos përfshirë në to, kërkesat e kriterit 2.3 pika “j”, konkretisht të paraqitjes së certifikatës së regjistrimit të mallit pranë AKBPM dhe certifikatës së cilësisë së mallit në fazën e dorëzimit të mallit.

Për sa më lart, hartuesit e kontratës për këtë procedurë kanë vepruar në mospërputhje me kërkesat e parashikuara dhe të miratuara nga titullari i AK.

34.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të marrë masa që komisioni i pranimit dhe drejtuesi i shërbimit të farmacisë qendrore, gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave, të kërkojnë që mallrat të shoqërohen me dokumentacionin e kërkuar nga AK, në rastin konkret të certifikatave të origjinës së mallit dhe të certifikatës së regjistrimit pranë AKBPM.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Të gjitha mallrat shoqërohen me fletë hyrje në farmacinë qendrore dhe bashkangjitur dokumentacionit është dhe certifikata e regjistrimit. Për këto mallra kemi evidencat përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

35. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me auditimin e pikës 2.8.1. Evidenca dokumentare e qarkullimit të materialeve ortopedike, rezulton se: Materialet ortopedike të tërhequra nga kryeinfermierja e bllokut operator qendror dhe që janë gjendje dhe inventar i shërbimit të ortopedisë për të 3 (tre) pavijonet e saj, qëndrojnë në ambientet e zyrës së kryeinfermieres të ndara e të vendosura në rafte/dollap sipas furnitorëve (T., L dhe O).

Në marrëveshjeve kuadër është përcaktuar që duhet të jetë prezent një specialist i këtyre firmave gjatë operacionit me setin e veglave që shërbejnë për montimin e implanteve.

Në asnjë nen apo klauzolë në kontratën e furnizimit apo të marrëveshjes kuadër nuk është parashikuar që përfaqësuesi i firmës kontraktuese përveç setit të veglave që shërbejnë për montimin e protezave me komponentët e saj, të ketë me vete edhe materialet ortopedike të sjella jashtë SUT-së.

Shkëmbimi i pretenduar i materialeve ortopedike, sipas strukturave përgjegjëse në SUT bëhet sepse këto materiale nuk janë gjendje sipas llojit dhe përmasave që kërkojnë mjekët kirurg operues gjatë realizimit të operacionit. Nga auditimi i sistemit të menaxhimit spitalor, rezulton se, të gjitha protezat dhe komponentët e tyre për 14 raste, ishin gjendje në bllokun operator qendror dhe në farmaci.

Për më shumë që shkëmbimet, nëse do të ishin të nevojshme duhet të ishin bërë vetëm nëpërmjet farmacisë, siç përcaktohet në nenin 5 të kontratës së furnizimit (Afatet e Lëvrimit dhe kushtet e lëvrimit), ku parashikohet se:

Të gjitha materialet do të sillen me anë të kontratës së furnizimit në SUT mund të ndërrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë të magazinuar në farmacinë e SUT) sipas përmasave dhe llojeve të kërkuara rast pas rasti. Çdo material që do të nderohet, duhet të pasqyrohet me anë të një procesverbali të cilin e firmosin përfaqësuesit e OE dhe përfaqësuesit e SUT që do të marrin pjesë gjatë operacioneve kirurgjikale rast pas rasti. Vlera e materialeve nuk do të ndryshojë nga ajo e kontratës së furnizimit.

Referuar të dhënave të tabelave të mësipërme të cilat janë nxjerr nga regjistrat e protezave të sipërcituar, rezulton se ka mospërputhje të numrave serial për 14 rastet (pacient) në lidhje me materialet që janë vendosur pacientit, numrat serial (Loti) të materialeve që janë kërkuar për pacientin dhe nr. serial në kartelën e elektronike të këtyre 14 pacientëve. Kampioni i përzgjedhur prej 14 pacientë është përfaqësues për të gjitha të dhënat e materialeve ortopedike të implantuara tek këta pacientët, pasi të gjithë pacientët që janë të regjistruar në 3 (tre) regjistrat që përfshijnë periudhën 2021 dhe 2022, rezulton se nr. serial (Loti) i materialeve ortopedike nuk kanë përputhje midis materialeve të vendosura, atyre të kërkuara dhe atyre të shkarkuara në kartelën elektronike për këta pacient në sistemin informatik të menaxhimit spitalor SIIS.

35.1 Rekomandimi: Drejtorja e financës, pranë SUT të krijojë dhe të llogarisë si zë më vete shpenzimet për materiale tek llogaria e shpenzimeve të materialeve të shërbimit të ortopedisë, për ti mundësuar sektorit të kostos që të llogarisë dhe të raportoj këto shpenzime të ndara nga njëra tjetra.

Përgjigjja e institucionit:

Për rekomandimin 35.1 nga drejtorja e financës ka përmbushur rekomandimin e lënë nga auditimi, pasi në analizën Nr.6021003/4 paraqiten shpenzimet për shërbimin e ortopedisë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

35.2 Rekomandimi:Drejtorja e financës të filloj të përgatisë një model bilanci mujor/vjetor dhe progresiv në lidhje me hyrjet daljet dhe gjendjen e materialeve ortopedike të identifikuar sipas kodit ATC dhe nr. serial (lote) dhe të raportoj për çdo muaj pranë Drejtorisë së Spitalit Universitar të Traumës, për të mundësuar ndjekjen dhe monitorimin e qarkullimit të materialeve ortopedike

Përgjigjja e institucionit:

Për rekomandimin 35.2, 35.3, 35.5, 35.6, 35.7, 35.8, dhe 35.9 nga Titullari i institucionit është ngritur grupi i punës, me urdhërin Nr.825 datë 08.07.2024, Për hartimin e rregullores së administrimit të materialeve të osteosintezës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

35.3 Rekomandimi:Drejtorja e SUT, në bashkëpunim me kryeinfermierin dhe shefin e shërbimit të bllokut operator qendror dhe sektorin juridik të fillojnë hartimin e modelit të Proces Verbalit mbi administrimin e materialeve ortopedike të grupit sinteza, dhe regjistrin e veçantë për këto materiale, për të mundësuar gjurmën e auditit.

Përgjigjja e institucionit:

Për rekomandimin 35.3 dhe 35.4 nga Drejtorja e SUT me Urdhër Nr.825 datë 08.07.2024 është ngritur grupi i punës për hartimin e rregullores së administrimit të materialeve të osteosintezës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

35.4 Rekomandimi:Titullari i institucionit të përcaktojë nëpërmjet akteve administrative procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me materialet e sintezës që nga momenti i fillimit të sterilizimit të tyre duke i identifikuar sipas hyrje daljeve dhe numrave identifikues për nevojat e bllokut qendror operator.

Nga ana e titullarit të institucionit të përcaktohet qartë gjithë procedura dhe të nxirren udhëzues se si do të dokumentohet ndërimi vetëm për rastet që në magazinën e farmacisë apo të pavijonit nuk gjendet materiali ortopedik që nevojitet gjatë ndërhyrjes kirurgjikale.

Përgjigjja e institucionit:

Për rekomandimin 35.3 dhe 35.4 nga Drejtorja e SUT me Urdhër Nr.825 datë 08.07.2024 është ngritur grupi i punës për hartimin e rregullores së administrimit të materialeve të osteosintezës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

35.5 Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Institucionit të emëtohen akte administrative në lidhje me sasitë e nevojshme dhe të domosdoshme që duhet të mbahen në ambientet e bllokut operator qendror në lidhje me materialet ortopedike, ku të përshkruhen procedura dhe udhëzues sesi ato do të lëvizin nga farmacia tek blloku operator qendror.

Përgjigjja e institucionit:

Për rekomandimin 35.2, 35.3, 35.5, 35.6, 35.7, 35.8, dhe 35.9 nga Titullari i institucionit është ngritur grupi i punës, me urdhërin Nr.825 datë 08.07.2024, Për hartimin e rregullores së administrimit të materialeve të osteosintezës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**

pjesërisht.

35.6 Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Institucionit nëpërmjet akteve (urdhër, udhëzim) të përcaktohen procedura të qarta që duhen të ndiqen mbi administrimin e materialeve ortopedike të sintezës pas heqjes nga pacienti, seleksionimin e tyre mbi mundësinë e ripërdorimit për ato materiale që janë në gjendje të mirë.

Përgjigjja e institucionit:

Për rekomandimin 35.2, 35.3, 35.5, 35.6, 35.7, 35.8, dhe 35.9 nga Titullari i institucionit është ngritur grupi i punës, me urdhërin Nr.825 datë 08.07.2024, Për hartimin e rregullores së administrimit të materialeve të osteosintezës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**

35.7 Rekomandimi: Drejtoria e financës të realizojë inventar të gjendjes së materialeve ortopedike në ambientin e kryeinfermierit, të ballafaqoj me daljet e farmacisë dhe gjendjes fillestare të tyre gjatë marrjes në dorëzim nga farmacia.

Përgjigjja e institucionit:

Për rekomandimin 35.2, 35.3, 35.5, 35.6, 35.7, 35.8, dhe 35.9 nga Titullari i institucionit është ngritur grupi i punës, me urdhërin Nr.825 datë 08.07.2024, Për hartimin e rregullores së administrimit të materialeve të osteosintezës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**

35.8 Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të marrë masa që materialet ortopedike që implantohen/vendosen tek pacienti të përputhen me materialet ortopedike sipas nr.serial (lotëve) që pasqyrohen në kartelën elektronike të pacientit tek moduli i kostos në sistemin e menaxhimit spitalor SIIS.

Përgjigjja e institucionit:

Për rekomandimin 35.2, 35.3, 35.5, 35.6, 35.7, 35.8, dhe 35.9 nga Titullari i institucionit është ngritur grupi i punës, me urdhërin Nr.825 datë 08.07.2024, Për hartimin e rregullores së administrimit të materialeve të osteosintezës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

35.9 Rekomandimi: Nga drejtoria e SUT, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë për mos dokumentimin në regjistrat e mbajtur në bllokun operator qendror të materialeve ortopedike të përdorura gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale, pasi për vitin 2021 nga ana e bllokut operator qendror, nuk janë dokumentuar **667** operacione dhe **811** për vitin 2022.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për rekomandimin 35.2, 35.3, 35.5, 35.6, 35.7, 35.8, dhe 35.9 nga Titullari i institucionit është ngritur grupi i punës, me urdhërin Nr.825 datë 08.07.2024, Për hartimin e rregullores së administrimit të materialeve të osteosintezës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**

36. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me piken 2.8.2. Inventarizimi i pajisjeve mjekësore, nga auditimi rezulton se në SUT gjendet një sasi e konsiderueshme e pajisjeve mjekësore në vlerën **38,731,930 lekë** që janë jashtë funksionit dhe të rrezikshme për shëndetin e pacienteve dhe personelit spitalor.

Asnjë nga pajisjet mjekësore pjesë e inventarit të SUT nuk janë regjistruar në sistemin Clingo të Qendrës Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore.

Titullarët e institucionit për periudhën objekt auditimi nuk kanë zbatuar dhe ndjekur politikat kombëtare për menaxhimin e pajisjeve mjekësore në Shqipëri, të cilat janë përcaktuar qartë në urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 3272, datë 11.09.2007 “Politika Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri, si më poshtë:

Është përgjegjësi e Drejtorit të spitalit për zhvillimin e procedurës për mënyrën e raportimit të ngjarjeve të padëshirueshme dhe marrjen e sinjaleve të alarmit nga pajisjet mjekësore si dhe njohjen e personelit mjekësor me këto procedura.

36.1 Rekomandimi: SUT në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore të bëjë vlerësimin mbi gjendjen aktuale të funksionimit të pajisjeve mjekësore dhe mundësisë së vënies së tyre në funksion për pajisjet mjekësore që nuk punojnë dhe njëkohësisht nga ana e SUT të ndiqen procedurat ligjore në fuqi për asgjësimin e pajisjeve mjekësore që janë jashtë përdorimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Është nxjerr urdhr Nr. 1268 datë 16.11.2023 “Për nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi në SUT” nga ana e DP. Për mundësinë e vënies në funksion të pajisjeve mjekësore që nuk punojnë nuk ka dokumentacion.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**

37. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës koncesionare të S S, rezulton se:

Koncesionari S S nuk ka dorëzuar pranë SUT dokumentacionin në lidhje me administrimin e mbetjeve të rrezikshme, e konkretisht:

- Nuk ka dorëzuar Rregulloren e Brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore brenda njësisë funksionuese, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, Kreu II, pika 7.1.

- Nuk ka dorëzuar Planin për administrimin e mbetjeve spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, Kreu II, pika 7.2.

- Nuk ka dorëzuar Regjistrin e veçantë për mbetjet spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010, Kreu III, pika 8.13 dhe Kreu VI, pika 12.2, germa ç.

- Nuk ka dorëzuar Formularin e veçantë “Dokumenti transferimit të mbetjeve të rrezikshme”,

në kundërshtim me VKM nr. 371, datë 11.06.2007.

37.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të kërkojë nga grupi i monitorimit të kontratës koncesionare me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale” informacion të plotë mbi ecurinë e saj, dhe të nxjerr përgjegjësitë për mosrespektimin të kushteve kontraktuale nga koncesionari.

Përgjigja e institucionit:

Nga ana e SUT nuk ka asnjë dokumentacion që provon zbatueshmërinë e këtij rekomandimi. Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024. Pretendimi subjektit : “... Rekomandimi 37.1 ... Rekomandimi është i zbatuar nga SUT, pasi është ngritur një Urdhër ku ngarkohet grupi i punës që monitoron kontratën e koncesionarit, për të zbatuar të gjitha rekomandimet e sipërcituara. Bashkëlidhur urdhëri.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti përmes observacioneve me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024 paraqet Urdhër për monitorimin e kontratës koncesionare, por referuar rekomandimit të lënë nga grupi i auditimit kërkohet informacion i plotë mbi ecurinë e kontratës koncesionare dhe nxjerrje e përgjegjëseve për mosrespektimin të kushteve kontraktuale nga koncesionari.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

37.2 Rekomandimi: Drejtori i Spitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për plotësimin nga Koncesionari S S SHPK të dokumentacionit të plotë mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

OE S S ka paraqitur dokumentacionin e plotë mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

38. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pikës 2.8.3. mbi kushtet e ruajtjes së barnave dhe materialeve të mjekimit, rezultoi se:

Në Farmacinë qendrore të SUT-së gjendej një sasi e madhe e medikamenteve që nuk kishin vulën e kuqe me mbishkrimin “për përdorim spitalor ndalohet shitja”, pasi bazuar në, në pikën 1 të Urdhrit nr. 287 datë 12.07.2022 të MSHMS parashikohet se:

Barnat që qarkullojnë në sistemin shëndetësor publik përveç pullës së sigurisë duhet detyrimisht të jene të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin “Përdorim Spitalor-Ndalohet Shitja” dhe në pikën 4 të këtij urdhri përcaktohet se:

Boja që përdoret për stampimin e vulës të jetë me ngjyrë të kuqe që nuk fshihet

Gjithashtu në magazinën e mallrave krahas tyre gjendeshin edhe barna, materiale të mjekimit dhe pajisje mjekësore jashtë përdorimit e me rrezikshmëri për shëndetin e njeriut.

Magazina e mallrave të SUT nuk plotëson në asnjë drejtim kushtet e ruajtjes së barnave duke

shtuar këtu se në këtë ambient gjenden dhe pajisje mjekësore jashtë përdorimit si radiografi etj., kjo në mospërputhje me urdhrin nr. 660 datë 20.09. 2018 të MSHMS, për miratimin e rregullores mbi praktikat e ruajtjes dhe shpërndarjes së mirë të barnave, neni 5 pika 2 dhe nenet në vijim të këtij urdhri ku parashikohet se:

Zonat e magazinimit duhet të jenë të përshtatshme për të siguruar kushte të mira të ruajtjes. Në veçanti, ato duhet të jenë të pastra, brenda kufijve të temperaturës dhe lagështirës. Kushtet e ruajtjes duhet të sigurohen, kontrollohen, monitorohen sipas specifikimeve në etiketën e barit. Barnat nuk duhet të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me dyshemenë dhe muret e të kenë hapësirë të përshtatshme për të lejuar pastrimin dhe inspektimin.

38.1 Rekomandimi: Drejtori i Spitalit të SUT, në raste të pa mundësisë për të magazinuar barna apo materiale mjekimi në Farmacinë qendrore duhet ti vendos ato në ambiente të sigurta dhe me kushte të mira të ruajtjes dhe në asnjë rast në magazinën e mallrave e cila është e pa përshtatshme për ruajtjen e këtyre barnave apo materiale mjekimi

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga Shefja e re në detyrë e farmacisë, cdo muaj bëhet inventar i gjendjes së farmacisë dhe dërgohet në drejtori. Nga momenti i marrjes së detyrës deri në fund qershori ka dorëzuar inventarin e farmacisë. Gjithashtu farmacisë i është shtuar ambient i ri për ruajtjen e medikamenteve, i cili i plotëson kushtet e ruajtjes sipas përcaktimeve të medikamenteve, si matës lagështirë dhe temperature etj.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pikës 2.8. të ndryshme rezulton se:

SUT nuk ka ambient dhe nuk është i pajisur me frigorifer-morg, për të bërë administrimin e trupave të pacientëve që ndërrojnë jetë në SUT.

Në vitin 2021 pranë këtij spitali kanë nderuar jetë 90 pacient.

SUT nuk ka krijuar ambiente të përshtatshme për të ushtruar veprimtarin e tyre ligjore strukturat përgjegjëse të parashikuara në legjislacionin në fuqi, duke vepruar në mospërputhje me parashikimet e Kreut IV -Kërkesat dhe klasifikimi i Spitaleve, neni 31, shkronja g, të Ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe të Aneksit II, pika 8, të VKM-së nr. 237, datë 06.03.2009.

39.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkëpunim me MSHMS dhe Ministrinë e Drejtësisë, të marrë masa dhe të krijoj ambiente të përshtatshme sipas standardeve të kërkuara për të bërë administrimin e trupave të pacientëve që ndërrojnë jetë në SUT.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në nenin 31/g të ligjit Nr.9106, datë 17.07.2003 Për shërbimin spitalor në republikën e shqipërisë parashikohet ekzistenca e këtyre ambjenteve, ndërsa në ligjin Nr.55/2022 “Për shërbimin spitalor në R.SH”, nuk ka asnjë parashikim në lidhje me ekzistencën e ambjenteve për administrimin e trupave të pacientëve që ndërrojnë jetë në SUT.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024. Pretendimi subjektit : “... Rekomandimi 39.1 ... Rekomandimi i sipërcituar është i pazbatuar pasi gjetja e KLSH nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi, ligjin Nr. 55/2022 “Për Shërbimin Spitalor në RSH”.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumenatacion e paraqitur nga subjekti vlerësoi se dokumentacioni i sjellë përmes observacioneve nuk paraqet fakte/prova të reja të cilat mund të ndryshojnë statusin e zbatimit të rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

40. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme e ndarë në dy lote” u konstatua nga verifikimi i urdhër shpenzimeve për kontratën 45/12 dt. 23.08.2022, brenda afatit 5 ditor për faturat e sjella gjendeshin:

Fatura nr. 1340/2022 datë 26.08.2022 në vlerën 5,188,710 lekë + TVSH

Fatura nr. 1327/2022 datë 25.08.2022 në vlerën 1,337,382 lekë + TVSH, që përbën 1/5 të sasisë totale dhe jo 1/3 që është kërkuar nga A.K. Nga A.K. nuk është kërkuar penalitet për O.E., pasi Fatura e 3 është Fatura nr. 1304/2022 dt. 31.08.2022 në vlerën 4,564,688 lekë e sjellë 3 ditë me vonesë. Duke qenë se materialet e mjekimit janë të një rëndësie të lartë dhe jetike, kalimi i afateve sado i vogël të jetë, sjell mos përmbushje të objektivave të spitalit.

40.1 Rekomandim: Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kryejë llogaritjen dhe kërkojë penalizimin e tyre.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me vendimin Nr.2925/10 Prot, datë 06.11.2022, ka vendosur masë disiplinore Znj.E R, bazuar në rekomandimet e lëna nga KLSH.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për automjetin 619 013 janë regjistruar dy urdhër shpenzime, ndërkohë që sipas fletë-udhëtimeve nuk ka informacion që ky automjet të ketë lëvizur përgjatë vitit 2021. Në Urdhër-shpenzimin nr. 122, datë 09.08.2021 janë likuiduar shërbim mirëmbajtje automjetesh sipas kontratës nr. 79/29, datë 23.04.2021 për automjetin me targë 619 013. Vlera e likuiduar në këtë urdhër shpenzim është **116,400 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik. Ndërsa në Urdhër-shpenzimin nr. 239/1, datë 31.12.2021 janë likuiduar shërbim mirëmbajtje automjetesh sipas kontratës nr.3/15, datë 08.10.2021 për automjetin me targë 619 013. Vlera e likuiduar në këtë urdhër shpenzim është **21,600 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Kontratën S/2021 Neni 11 pika 2, Kontrata S/2022 Neni 13 pika 2; Kontrata S/2021 Neni 11 pika 2, Kontrata S/2022 Neni 13 pika 2; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; si dhe Kontrata S/2021 Neni 11 pika 2, Kontrata S/2022 Neni 13 pika 2.

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Spitalit Universitar të Traumës të merren masa për arkëtimin e vlerës **138,000 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative.

Deri më datë 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Nga ana e SUT është kërkuar arkëtimi i kësaj vlere ku personat përgjegjës kanë arkëtuar vlerën përkatëse. SUT ka vënë në dispozicion urdhrat e pagesës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me Procedurën e Prokurimit me objekt “Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote”, rezulton se, në listën e barnave për përdorim spitalor të miratuara nga MSHMS për vitin 2022, bari me princip aktiv Nadroparine Calcium me formë dozë 5700 IU Axa/0.6ml është bar i regjistruar dhe pjesë e kësaj liste.

OE F F ka paraqitur ofertë për barin me principin aktiv Nadroparine Calcium me formë dozë 5700 IU Axa/0.6ml për njësi (një shiringe parapërgatitur) në shumën 455 lekë pa TVSH.

Anëtarët e Njesisë së prokurimit të AK, SUT., kanë përcaktuar fondin limit për barin tregtar Fraxiparine, nga studimi i tregut, duke mos marrë parasysh çmimin e përcaktuar nga KCB në MSHMS si i vetmi komision ligjor për përcaktimin e çmimeve të barnave të listës së barnave për përdorim spitalor. OE F Fka ofertuar për barin Faksiparine i cili ka për princip aktiv Nadroparine Calciumi çmimin për njësi 455 lekë (një shiringë e parapërgatitur), ndërkohë që ky çmim duhej të ishte 434,7 leke dhe vlera totale e kontratës për 50000 copë duhej të ishte **21,738,745 lekë.**

Në referim të shkresës nr.1775/3 prot datë 29.06.2023 të MSHMS çmimi CIF për barin Faksiparine me princip aktiv Nadroparine Calciumi është 3.5 euro për shiringë.

Në datën 31.08.2023 që është zhvilluar procedura, kursi i këmbimit zyrtar për 1 euro ka qenë 117.19 leke. Në zbatim të VKM nr.143 datë 18.02.2015 “Për përcaktimin e marzheve të tregtimit dhe fabrikimit të barnave” për grupin “Gjaku dhe organet formuese të gjakut” në të cilën bënë pjesë dhe bari me princip aktiv Nadroparine Calciumi do të zbatohet një marzh fitimi 6 %.

Si rezultat do të kishim: $(3.5 * 117.19) * 1.06 = 434.7$ lekë (një shiringë); $434.7 * 50,000$ shiringa = 21,738,745 lekë duhej të ishte vlera e kontratës së lidhur me kontraktuesin.

AK., SUT pas shpalljes fitues nga KVO, ka lidhur kontratë me OE F F për sasinë 50,000 copë (shiringa të parapërgatitura) në shumën 22,750,000 lekë. Për sa më lart, shuma prej **1,011,255 lekë,** e cila përfaqëson diferencën e çmimit të ofertuar dhe të shpallur fitues me atë të përcaktuar nga KCB të MSHMS duhej të ishte 434,7 lekë për njësi, përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të SUT.

2.1. Rekomandimi: Drejtuesi i institucionit të Spitalit Universitar të Traumës, të analizoj veprimtarinë e njesisë së prokurimit për këtë procedurë dhe kryesisht të komisionit të përcaktimit të specifikimeve teknike dhe të përllogaritjes së fondit limit për barin me princip aktiv Nadroparine Calciumi dhe të nxjerr përgjegjësitë për secilin prej anëtarëve të këtij komisioni, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e shumës prej **1,011,255 lekë** nga OE F F.

Deri më datë 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

SUT ka kërkuar arkëtimin e shumës prej 1,011,255 lekë nga OE F F duke ngritur kërkesë padi me Nr.3440/2 prot. Datë 31.01.2024 në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje materiale

konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT" viti-2021, rezulton se: Komisioni për zhvillimin e minikonkurseve, ka shpallur fitues OE O i cili nuk plotësonte kushtet e marrëveshjes kuadër pasi, për materialet e renditura në tabelën nr.1 aneksi 2.6.6 çmimi i ofruar nga OE O 3.. në minikonkursin rezulton që të jetë më i lartë se çmimi referent. Vlera totale prej **498,250 lekë** do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit. Kjo shumë përfaqëson diferencën midis çmimit të ofertuar dhe të shpallur fitues në minikonkursin e parë dhe çmimit referent të marrëveshjes kuadër për sasinë e furnizuar me faturën tatimore nr. 10011/2021 datë 07.06.2021 të mallrave të dorëzuar nga OE O pranë farmacisë qendrore të SUT.

Në këto kushte komisioni i posaçëm i ngritur për organizimin e minikonkurseve ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe akteve ligjore në fuqi duke shpallur fitues OE O , i cili ka ofertuar materialet e paraqitura në tabelën nr.1. me çmimin për njësi me të lart se ai referent.

Për të njëjtat arsye të sipërcituara, Komisioni për zhvillimin e minikonkurseve, ka shpallur fitues OE O i cili nuk plotësonte kushtet e marrëveshjes kuadër pasi, për materialet e renditura në tabelën nr.2 aneksi 2.6.6., çmimi i ofruar për materialet respektive ortopedike nga OE O në ofertën e shpallur fitues nga ky komision rezulton që të jetë më i lartë se çmimi referent i përcaktuar në marrëveshjen kuadër.

Vlera totale prej **229,650 lekë** do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit. Kjo shumë përfaqëson diferencën midis çmimit të ofertuar dhe të shpallur fitues në minikonkursin ku është lidhur kontrata Nr.9/42 Prot Datë 04.03.2022 dhe çmimit referent të marrëveshjes kuadër për sasinë e furnizuar me faturën tatimore nr. 71/2022 date 07.03.2022 të mallrave të dorëzuar nga OE O pranë farmacisë qendrore të SUT.

Në këto kushte komisioni i posaçëm i ngritur për organizimin e minikonkurseve ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe akteve ligjore në fuqi duke shpallur fitues OE O, i cili ka ofertuar materialet e paraqitura në tabelën nr.2 me çmimin për njësi më të lart se ai referent.

3.1.Rekomandimi: Drejtuesi i institucionit të Spitalit Universitar të Traumës, të analizoj veprimtarinë e Komisionit për zhvillimin e minikonkurseve për këtë procedurë dhe të nxjerr përgjegjësitë për secilin prej anëtarëve të këtij komisioni, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e shumës prej **727,900 lekë** nga OE O.

Deri më datë 31.12.2023

Përgjigjja e institucionit:

SUT ka kërkuar arkëtimin e shumës prej 729,900 lekë nga OE O duke ngritur kërkesë padi me Nr.98/1 prot. Datë 31.01.2024 në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021-2022, për kontratat lidhur me O.E. "S-A", "Për shërbimin dhe pastrimin e ambienteve të SUT-së për nevojat emergjente" është paguar në total për 10 muaj shuma prej 38,390,546 lekë pa TVSH.

Fondi limit është përlllogaritur duke përdorur çmimet e kontratës së fundit, atë të vitit 2018, ku dhe kjo e fundit është bazuar në çmimet e kontratës 7 vjeçare që është nënshkruar në vitin 2010. Duke marrë për bazë testimin e tregut, statistikave ndërkombëtare si dhe çmimet e ofruara nga O.E. fitues i procedurës së fundit "R." sh.p.k, të cilat janë sa ½ e çmimeve të ofruara nga O.E.

“S-A”, duke u konsideruar si një vlerë dhe diferencë e konsiderueshme prej **12,767,096 lekë** pa tvsh, shumë e cila përbën vlerë të përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet nga ana e SUT-së në mospërputhje me Nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, VKM Nr. 914, Datë 29.12.2014 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik, I Ndryshuar Me Vendimin Nr. 823, Datë 21.10.2020

1.1.Rekomandim: SUT, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të marrë në konsideratë parimin e ekonomicitetit gjatë përlllogaritjes së fondit limit për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen, duke përdorur metodat e duhura të përcaktuara në ligj.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

SUT nuk ka asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024. Pretendimi subjektiv : “... Rekomandimi 1.1 seksioni C. ... Rekomandimi është i zbatuar nga SUT në procedura të ngjashme pasi për procedurën “Për shërbimin dhe pastrimin e ambienteve të SUT-së për nevojat emergjente” nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi. Në procedurat e ngjashme ka zbatuar cdo rekomandim të KLSH-së dhe përlllogaritja e fondit limit është bërë në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjore në fuqi.

Bashkëlidhur shembull procedura e ngjashme për shërbimin e lavanderisë dhe relacioni shpjegues.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti përmes observacioneve dërguar me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024 vlerësoi se, paraqiten fakte/prova të reja që ndryshojnë statusin e zbatimit të rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të zbatimit të kontratës për procedurën “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme në SUT” zhvilluar nga ABP, u konstatuan problematika në lidhje me zbatimin e kushteve të kontratës, si më poshtë:

Pajisjet makineri pastrimi ishin të papërdorura, duke mos e kryer funksionin e tyre.

Ambienti i parkimit nga ana e djathtë e ndërtesës së SUT-së, e cila përbënte 1/3 të totalit të sipërfaqes së parkimit, ishte e papastruar dhe gjatë kohës së auditimit në terren nuk u provua pastrimi i tyre. Shuma e përlllogaritur për pastrimin e ambientit të parkimit deri në momentin e procesit të auditimit (faza në terren) përbën vlerën prej **278,460 lekë** ((1,092 m² x 5 x 30 x 0.8) + (1,092 m² x 5 x 30 x 0.9).

Ambientet e magazinimit të produkteve marrë me qira nga O.E. fitues, ishin jashtë standardeve dhe nuk plotësonin kushtet minimale higjienike, në mospërputhje me Nenin 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.1.Rekomandim: Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, në lidhje me konstatimet e kryera nga ana e grupit të KLSH-së, të marrë masat për zbatimin e plotë të kushteve të kontratës si dhe garantimin e ambienteve për O.E. me kushtet e duhura higjienike.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

SUT ka vënë në dispozicion pamje nga pajisjet e pastrimit dhe pamje ku tregohet se pajisjet e pastrimit janë funksionale dhe në gjendje pune.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote” për lotin 2, rezulton që dokumentacioni i ngarkuar në SEP, nga OE V kishte mangësi dhe nuk plotësonte kriteret e vendosura nga AK., SUT, të cilat paraqiten si më poshtë:

1. OE V ka ngarkuar në SEP si eksperiencia të ngjashme fatura tatimore shitje me subjekte private.
2. Në faturën tatimore të shitjes nr.2079/2021 për vlerën 373,774 lekë për palën blerëse subjektin C. Ph, gjendet bari Levofloxacin në vlerën 7,403 lekë, kjo shumë e këtij bari rezulton të jetë më e vogël se 20% i vlerës së fondit limit të kërkuar nga AK në DST në kriterin 2.3.2 tek kriteret e veçanta.
3. Faturat e tjerat tatimore të shitjes që ka ngarkuar OE V në SEP nuk kanë barin me principin aktiv Levofloxacin apo anti-infektivë të përgjithshëm të së njëjtës familje apo grup familje.
4. Autorizimi për tregtim nr.1785/1 Prot. datë 20.04.2018 lëshuar nga AKBPM për barin Lexacin me princip aktiv Levofloksacin hemihidrati nuk është i vlefshëm pasi ai ka përfunduar në muajin Prill të vitit 2019.
5. OE Vinipharma nuk e ka regjistruar këtë bar pranë AKBPM, kjo në mospërputhje me piken 4 të kriterit 2.3. të DST.

Në këto kushte OE V nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi për këtë lot duhet të ishte anuluar. Titullari nuk duhet të kishte miratuar dhe shpallur fitues OE “V”.

Konkluzion:

Kualifikimi dhe shpallja fitues nga KVO, i shoqërisë “V.” është në kushtet e mos plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk ky OE nuk plotëson disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte anuluar procedura për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur. Vlera e kontraktuar prej **410,300 lekë** do të konsiderohet si prokurim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{-të}).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të analizoj këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e KVO të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të SUT në shumën **410,300 lekë**.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

SUT nuk ka asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024. Pretendimi subjektit : “... Rekomandimi 3.1 seksioni C. ... Për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote” për lotin 2, informojmë se Ak nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi për furnizim me barna pasi këto procedura janë dërguar për prokurim të përqëndruar pranë MSHMS.

SUT bëri analizë sipas rekomandimit të KLSH nga e cila rezulton se anëtarët e KVO kanë vepruar në përputhje me ligjin. Në zbatim të rekomandimit të KLSH, AK ka vendosur masa disiplinore (vërejtje me shkrim) për anëtarët e KVO dhe dërgimin e punonjësve për kualifikim

dhe certifikim, pranë Shkollës së Administratës Publike, për tu njohur me “Ligjin e Prokurimit Publik” të ndryshuar. Bashkëlidhur relacioni shpjegues, masat disiplinore për anëtarët e KVO dhe emaili dërguar APP për trajnimin e stafit.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumenatacion e paraqitur nga subjekti vlerësoi se dokumentacioni i sjellë përmes observacioneve paraqet fakte/prova të reja të cilat mund të ndryshojnë statusin e zbatimit të rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote” për lotin 16 në SEP, rezulton se:

OE F F nuk ka paraqitur autorizimin e regjistrimit pranë AKBPM për barin me princip aktiv Hydrocortizone 100 mg.

Në këto kushte KVO, nuk duhej ta kualifikonte dhe shpallte fitues OE F F, sepse ky OE nuk plotëson disa nga kriteret e DST.

Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte anuluar procedurën për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur.

Vlera e kontraktuar nga AK., SUT në shumën **320,000 lekë** do të konsiderohet nga grupi i auditimit të KLSH, si një prokurim i fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{-të}). KVO me kualifikimin dhe shpalljen fitues të OE F F ka vepruar në kundërshtim me ligjin 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”. Neni pika

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të analizojë këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e KVO të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të SUT në shumën **320,000 lekë**.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Kjo procedurë prokurimi është anuluar dhe i është dërguar MSHMS për riplanifikim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”, rezulton se: OE “O.. D”, nuk e ka plotësuar këtë kriter, pasi dokumentacioni i ngarkuar në sistemin elektronik është i pa përkthyer dhe i pa noterizuar.

Për sa më lart, kualifikimi i shoqërisë “O.. D”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotëson disa nga kriteret e DST.

Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, KVO duhet të kishte anuluar procedurën për Loti 1 dhe Lotin 2 dhe tenderi duhej të ishte rishpallur, si dhe vlera e kontraktuar për LOTI 1 - **154,356,040 lekë** dhe LOTI 2 - **21,105,600 lekë** përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{-të}), në kundërshtim me ligjin nr. 162 /2020 “Për prokurimin publik.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të analizojë këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e KVO të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet për buxhetin e SUT në shumën **175,461,640 lekë**.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

SUT nuk ka asnjë dokumentacion për zbatimin e këtij rekomandimi.

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024. Pretendimi subjektit : “... Rekomandimi 5.1 seksioni C. ... Rekomandimi është i zbatuar nga SUT, i cili ka analizuar procedurën e sipërcituar dhe ka vendosur masa disiplinore (vërejtje me shkrim) për anëtarët e KVO.

Gjithashtu janë marrë masa që të kualifikohen dhe certifikohen punonjësit e SUT, pranë Shkollës së Administratës Publike, për tu njohur me “Ligjin e Prokurimit Publik” të ndryshuar. Bashkëlidhur relacioni shpjegues, masat disiplinore për anëtarët e KVO dhe emaili dërguar APP për trajnimin e stafit.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumenatacion e paraqitur nga subjekti përmes observacioneve dërguar me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024 vlerësoi se, paraqiten fakte/prova të reja që ndryshojnë statusinë e zbatimit të rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

6. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me shpenzimet për energji elektrike dhe ujë te koncesionarit Sani Service, rezulton se:

Për konsumin e energjisë elektrike

[200Khh*4 ore*22 dite*13.2 leke/këh (me TVSh)] * 64 muaj= **14,868,480 lekë**.

Pra në përllogaritjen e përafërt të konsumit të energjisë elektrike është supozuar që autoklava të punojnë 4 orë mesatarisht në ditë dhe çmimi i energjisë elektrike për 1KËh është 13.2 lekë (me TVSH) sipas faturës së energjisë elektrike që paguan SUT për periudhën 16.08.2017 deri 31.12.2022

Për konsumin e ujit:

Konsumi i përafërt i përllogaritur mbi bazën e të dhënave të SUT në mungesë të matësit të ujit, është: Konsumi i ujit: $10 \text{ m}^3/\text{dite} * 22 \text{ dite} * 64 \text{ muaj} * 156 \text{ leke}/\text{m}^3 = \underline{\underline{2,196,480 \text{ lekë}}}$.

Për sa më sipër, shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar nga koncesionari Sani Service SHPK, në vlerën 17,064,960 lekë, përbëjnë efekt financiar negativ për Buxhetin e SUT. Përllogaritja e përafërt u bë nga grupi i auditimit mbi bazën e të dhënave të siguruar nga sektori i teknik i SUT, tregon që koncesionari krahas kostove të seteve kirurgjikale ka rritur kostot e shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë nga buxheti i shtetit.

6.1. Rekomandimi: SUT të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore në vlerën **17,064,960 lekë**, si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5., ku shpenzimet e energjisë elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., të jenë detyrime të Koncesionarit dhe jo buxhetit të spitalit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

SUT ka kërkuar rinegocimin e kontratës me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për pikën 19.5 me koncesionarin S S SHPK. Konkretisht kjo kërkesë është bërë me datë 26.12.2023 me nr. 3426 prot. nga Drejtore Edlira Bode por nuk ka një përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**

pjesërisht

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të koncesionarit Sani Service në lidhje me përdorimin e ambienteve të SUT, konstatohet se: Sipërfaqja totale në përdorim të koncesionarit është 288.6 m² brenda ambienteve të SUT. Koncesionari e ka përdorur këtë ambient prej datës 16.08.2017 e në vazhdim, pa paguar qira. Në nenin 19.4, të kontratës koncesionare, ndër të tjera përcaktohet se: “Autoriteti duhet të japë në përdorim, kur është e nevojshme për arsye logjike, hapësirat në zonat spitalore që mund ti lejojnë operatorit koncesionar dhe operatorëve të saj akses dhe përdorim të të gjitha strukturave të ndërtuara si magazina ose aktivitete produktive të back-up, pa u kërkuar një qera dhe/ose rimbursim financiar”. Për periudhën në auditim, për sipërfaqen 288.6 m², mbi bazën e përcaktimeve të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. SUT nuk ka përfituar vlerën financiare nga qiraja e ambientit të përdorur nga koncesionari, e cila paraqitet sa me poshtë e llogaritur nga grupi i auditimit të KLSH: E ardhura e munguar për një muaj, ku çmimi për 1m² është 300 lekë, është: (288.6 m²*300 leke/m²=86,580 leke/muaj). Koncesionari prej fillimit të aktivitetit deri me datë 31.12.2022 ka përdorur këtë ambient prej 64 muaj. Pra e ardhura e munguar nga mos përfitimi i qeras mujore për këtë ambient në total është:

86,580 leke/muaj*64 muaj= 5,541,120 lekë

Për sa më lart, shuma 5,541,120 lekë, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e SUT.

7.1. Rekomandimi: SUT të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën **5,541,120 lekë** si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

SUT ka kërkuar rinegocimin e kontratës me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për pikën 19.5 me koncesionarin S S SHPK. Konkretisht kjo kërkesë është bërë me datë 26.12.2023 me nr. 3426 prot. nga Drejtore E B por nuk ka një përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

8. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me auditimin e pikës 2.8.3. mbi Planifikimin dhe hartimin e listës së barnave, materialeve të mjekimit dhe pajisjeve mjekësore për vitin 2021 dhe 2022, rezulton se:

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion dhe të dhënat e marra nga sistemi informarik SIIS, konstatohet se deri në fund të periudhës së auditimit në magazinën e farmacisë së SUT, gjendet një stok i konsiderueshëm medikamente dhe materiale mjekimi të skaduara, të shkaktuara si pasojë e planifikimit dhe menaxhimit jo eficient nga strukturat përgjegjëse të SUT dhe kërkesave të shefave të shërbimit.

Nga të dhënat e marra nëpërmjet programit informatik të farmacisë SIIS, më datë 06.02.2023 në magazinën e farmacisë së SUT u gjenden barna të skaduara.

Si pasojë e planifikimit dhe keqmenaxhimit përgjatë vitit 2021 dhe 2022 kanë skaduar dhe janë gjendje në farmacinë qendrore të SUT barna në vlerën totale 2,014,241 lekë.

Përveç barnave të skaduara në farmacinë qendrore një sasi e konsiderueshme e barnave të

skaduara gjendet dhe në shërbime që kap vlerën 7,261,179 lekë.

Në magazinën e farmacisë së SUT dhe në pavijone deri në fund të periudhës së auditimit, gjendet një sasi me medikamente të skaduara në vlerën totale **9,275,420 lekë**, e cila përbën një shpenzim jo eficient për SUT duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.

Mungesa e koordinimit të grupit të punës, përgjegjësit të farmacisë dhe shefave të shërbimeve për hartimin e listës së barnave dhe materialeve të mjekimit, gjatë fazës së planifikimit të nevojave të tyre për barna dhe materiale mjekimi, ka ndikuar në mos reflektimin e kërkesave reale të shërbimeve dhe si rezultat të mos tërheqjes së tyre nga shërbimet përkatëse.

Sa më sipër është në mospërputhje me Ligjin 9106 17.07.2013 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 “për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe kontratat për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore ndërmjet FDSKSH dhe SUT për vitet 2021 dhe 2022.

Për sa më lart, konstatohet se nga drejtuesit e institucionit, brenda periudhës së auditimit nuk janë marrë masat e nevojshme për mos krijimin e stokut të barna dhe materiale të skaduara, veprime në mospërputhje me rregulloren e spitalit dhe kontratën Spitalore me FSDKSH. (mungon neni pika)

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e SUT të analizoj shkaqet e krijimit të stokut të barnave dhe materialeve të mjekimit të skaduar në vlerën **9,275,420 lekë**, e cila përbën një shpenzim jo eficient për SUT duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit dhe gjithashtu të marrë masa e duhura për mos krijimin e stokut të ri në të ardhmen.

Përgjigja e institucionit:

Spitali Universitar i Traumës ka hartuar rregulloren për shërbimin e farmacisë sipas rekomandimeve por ende nuk është miratuar. Më urdhrin Nr.49 datë 25.01.2024 është vendosur lirimi nga detyra i Shefes së s Shërbimit të Farmacisë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

8.2. Rekomandimi: SUT të filloj hartimin e rregulloreve të reja për shërbimin farmaceutik, mbi bazën ligjore në fuqi duke përcaktuar qartë detyrimet dhe përgjegjësit e këtij shërbimi për gjithë fushën e veprimtarisë së vet sipas standardeve të miratuara për ruajtjen dhe qarkullimin e barnave.

Përgjigja e institucionit:

Spitali Universitar i Traumës ka hartuar rregulloren për shërbimin e farmacisë sipas rekomandimeve por ende nuk është miratuar. Më urdhrin Nr.49 datë 25.01.2024 është vendosur lirimi nga detyra i Shefes së Shërbimit të Farmacisë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**.

8.3. Rekomandimi: Drejtori i SUT të përcaktoj të drejtat dhe përgjegjësit e shefit të shërbimit duke i sanksionuar në aktet administrative (kontratë, urdhër ose udhëzim), dhe në rastet e barnave të skaduara të cilat janë kërkuar prej tyre, të propozoj masa dhe penalitete në masën e dëmit të krijuar.

Përgjigja e institucionit:

Spitali Universitar i Traumës ka hartuar rregulloren për shërbimin e farmacisë sipas rekomandimeve por ende nuk është miratuar. Më urdhrin Nr.49 datë 25.01.2024 është vendosur lirimi nga detyra i Shefes së s Shërbimit të Farmacisë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar pjesërisht**

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT” viti 2022, rezulton se: Referuar Proces verbalit të datës 07.10.2022 i mbajtur nga KVO, mbi dorëzimin dhe paraqitjen e mostrave të OE L shpk kishte mospërputhje të specifikimit teknike pasi ato nuk përmbanin elementet e ofertuar sipas të dhënave të katalogëve të ngarkuar në SEP.

Përshkrimi i këtyre artikujve për mostrat e dorëzuara nga ky OE L pjesë BOE”T&L” dhe të marra në dorëzim nga KVO, nuk kishin përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST nga AK në shtojcën 10, pasi mungonte kodi (S/N/Loti apo Ref.) vendi i origjinës së mallit, emri i kompanisë prodhuese, siç AK i parashikonte në kriterin 2.3 pika b të DST.

Kualifikimi i BOE “T&L” nga KVO bie ndesh me kërkesat dhe kriteret e vendosura dhe të miratuara nga titullari i autoritetit Kontraktor

Për sa më lart, anëtarët e KVO, kanë vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h e DST, duke kualifikuar padrejtësisht OE L shpk. Në këto kushte KVO, duhej të s’kualifikonte OE L shpk

Konkluzion:

- KVO ka kualifikuar OE L pjesë BOE”T&L” në kushtet kur ky OE, nuk i plotësonte kërkesat e AK në lidhje me listën e paraqitjes së mostrave, duke vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h në DST.

- OE L si pjesë e BOE nuk përmbush kriteret për kualifikim, në këto kushte AK duhej të skualifikonte BOE

-Pasi KVO ka skualifikuar me të drejtë OE C. Ph për mosparaqitjen e plotë të mostrave.

-Në kushte kur OE L, pjesë e BOE nuk përmbush kriteret për kualifikim, KVO duhej ta kishte Skualifikuar BOE, dhe duke qene se oferta e OE “O 3..” Shpk e kualifikuar por ekonomikisht me pak e leverdishme për AK SUT, duhej ta anulonte këtë procedurë.

Për sa më lart, KVO ka vepruar duke favorizuar BOE edhe pse në kushtet e skualifikimit.

Grupi i auditimit të KLSH vlerën 353.521.600 Lekë të kontratës së lidhur me BOE “T&L” e konsideron përdorim pa efektivitet të buxhetit të SUT. KVO, ka kualifikuar dy OE pjesëmarrës, respektivisht BOE “T” & “L” SHPK dhe “O 3..” SHPK

Pas kualifikimit të OE pjesëmarrës, KVO ka pranuar Ofertat ekonomike sipas klasifikimit të mëposhtëm.

1.BOE “T”Shpk dhe “L” Shpk me ofertën ekonomike 353.521.600 Lekë pa TVSH

2.O” Shpk me ofertën ekonomike 354.398.600 Lekë pa TVSH

Formulari i njoftimit të Operatoreve Ekonomik të suksesshëm në marrëveshjen kuadër është bërë me shkresën nr. 50/13 Prot., te datës 11.10.2022

Pas verifikimit edhe të dokumentacionit të shkruar nga OE të cilat sipas KVO përputheshin me ato të ngarkuara në SEP, është nënshkruar Marrëveshja Kuadër nr. 50/16 Prot., datë 25.10.2022, me objekt: “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT” midis SUT dhe BOE”T&L” dhe “O 3..” SHPK me vlerën e fondit limit

për një afat kohor dy vjeçar. Marrëveshje kuadër nuk është një kontratë më vete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen mbi bazën e saj.

Oferta ekonomike, sipas parimit të çmimit më të ulët e ofertuar nga BOE”T&L” në vlerën 353.521.600 leke pa TVSh, shërben si fond limit për minikonkurset që do të zhvillohen.

9.1.Rekomandimi: Titullari i AK t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Bazuar në rekomandimin e KLSH-së, sektori i prokuroimeve me procesverbalin-Tip i kontratës-Mall, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikimin”, datë 24.06.2024, ka shqyrtuar dhe vlerësuar dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

D. MASA DISIPLINORE

DI. Për punonjësit marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen me Kodin e Punës:

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës individuale të punës dhe Rregullores së Brendshme të institucionit, i rekomandojmë, Ministrin të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat për vendosjen e masave disiplinore si më poshtë, pas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, konkretisht:

“Ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës” për:

1.Znj. E.B, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i SUT-së:

1.Në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe njëkohësisht të Nëpunësit Autorizues nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditit për monitorimin dhe zbatimin e kontratave përgjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të Drejtorit të Përgjithshëm brenda periudhës së auditimit, duke mos siguruar kontrollin e brendshëm kryesisht për të gjitha proceset ekonomiko-financiare kryesisht për shërbimet e prokuruar dhe blerjet e barnave, materialeve të mjekimit dhe kryesisht të materialeve ortopedike.

Duke vepruar në mospërputhje me përcaktimet e nenit 5 të ligjit Nr.10296, datë 8.7.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, kreun III, pikën 2 të Rregullores së brendshme të SUT nr.1195/3 date 03.06.2022.

2.Në cilësinë e Titullarit të AK dhe miratuesit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022,. Në cilësinë e miratuesit të raportit përmbledhës nr. 50/14 Prot. Date 25.10.2022 të KVO, e cila ka kualifikuar OE L pjesë e BOE”T&L” në kushtet kur nuk i plotësonte kërkesat e AK në lidhje me listën e paraqitjes së mostrave, duke vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h në DST.

Në kushte kur OE L, pjesë e BOE”T&L” nuk përmbush kriteret për kualifikim, KVO duhej ta kishte Skualifikuar BOE, dhe duke qenë se oferta tjetër e kualifikuar e OE “O 3..” Shpk ishte ekonomikisht me pak e leverdishme për AK SUT, duke favorizuar BOE edhe pse në kushte skualifikimi.

Për sa më lart, AK ka vepruar duke favorizuar BOE edhe pse në kushtet e skualifikimit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 114-119.

3. Në cilësinë e Titullarit të AK për procedurën me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022”, nga ku ka rezultuar se miratimi i OE fitues është bërë në kushtet kur subjekti BOE”T&L” shpk nuk ka plotësuar kërkesat për kualifikim si dhe mostrat e paraqitura, (si pjesë e kriterëve të DST) nuk përputhen me specifikimet e vendosura nga AK në DST, duke kualifikuar dhe shpallur fitues një BOE i cili duhet të ishte skualifikuar dhe procedura e prokurimit duhej të ishte rishpallur, ose ti kalonte OE tjetër pjesëmarrës, edhe pse oferta ekonomike më pak e leverdishme, duke favorizuar BOE edhe pse në kushte skualifikimi.

Për sa më lart, AK ka vepruar duke favorizuar BOE edhe pse në kushtet e skualifikimit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 119-126.

4. Në cilësinë e Titullarit të AK për pikën 2.6.4. Procedura e prokurimit Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote, nga ku ka rezultuar një rritje artificiale të bërë nga NJP me pasoja financiare për institucionin dhe buxhetin e shtetit si dhe përfitim të padrejtë nga OE, *me dëm ekonomik për vlerën prej 1,011,255 lekë.*

5. Në cilësinë e Titullarit të AK për pikën 2.6.7. Procedura e prokurimit (“Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”), nga ku ka rezultuar se miratimi i OE fitues është bërë në kushtet kur subjekti BOE”T&L”shpk nuk ka plotësuar kërkesat për kualifikim si dhe mostrat e paraqitura, (si pjesë e kriterëve të DST) nuk përputhen me specifikimet e vendosura nga AK në DST, duke kualifikuar dhe shpallur fitues një BOE i cili duhet të ishte skualifikuar dhe procedura e prokurimit duhej të ishte rishpallur, ose ti kalonte OE tjetër pjesëmarrës, edhe pse oferta ekonomike më pak e leverdishme, duke favorizuar BOE edhe pse në kushte skualifikimi.

6. Në cilësinë e Titullarit të AK për pikën 2.6.7. Procedura e prokurimit “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”, nga ku ka rezultuar se miratimi i OE fitues është bërë në kushtet kur subjekti OE O shpk nuk ka plotësuar kushtet e marrëveshjes kuadër, pasi në dy raste për vlerat prej 498,250 lekë dhe 229,650 lekë, ka shkaktuar dëm ekonomik pasi Titullari i AK dhe Komisioni për zhvillimin e minikonkurseve, ka shpallur fitues OE O i cili nuk plotësonte kushtet e marrëveshjes kuadër pasi, për materialet e renditura në tabelën nr.1 aneksi 2.6.6 çmimi i ofruar nga OE O në minikonkursin rezulton që të jetë më i lartë se çmimi referent. Në këto kushte komisioni i posaçëm i ngritur për organizimin e minikonkurseve ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe akteve ligjore në fuqi duke shpallur fitues OE O, i cili ka ofertuar materialet e paraqitura në tabelën nr.2 me çmimin për njësi më të lartë se ai referent.

7. Në cilësinë e Titullarit të AK për pikën 2.6.8. Procedura e prokurimit “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për shërbimin e Ortopedisë në SUT, viti 2022”, nga ku ka rezultuar se miratimi i OE fitues është bërë në kushtet kur subjekti BOE”T&L” shpk nuk ka plotësuar kërkesat për kualifikim si dhe mostrat e paraqitura, (si pjesë e kriterëve të DST) nuk përputhen me specifikimet e vendosura nga AK në DST, duke kualifikuar dhe shpallur fitues një BOE i cili duhet të ishte skualifikuar dhe procedura e prokurimit duhej të ishte rishpallur, ose ti kalonte OE tjetër pjesëmarrës, edhe pse oferta ekonomike më pak e leverdishme, duke favorizuar BOE edhe pse në kushte skualifikimi.

8. Nga verifikimi fizik i kryer në zyrën e kryeinfermierit të bllokut operator qendror nga grupi i auditimit të KLSH, më datë 23.03.2023 rezultojë se në këtë ambient gjendej një sasi e konsiderueshme materialeve ortopedike të pajustificuara dhe të pa inventarizuara nga strukturat përgjegjëse të SUT.

Materialet ortopedike që gjendeshin në këtë ambient ishin materiale ortopedike te llojit Proteza dhe Sinteza, të cilat kishin vlerën ekonomike **35,228,087 lekë.**

Sasia edhe vlera e këtyre materialeve është pothuajse e barabartë me vlerën e materialeve ortopedike që prokurohen me Marrëveshje Kuadër nga SUT gjate një viti.

Këto materiale duhej të ishin në farmacinë e SUT dhe jo gjendje në zyrën e kryeinfermierit. Gjendja stok e këtyre materialeve në zyrën e kryeinfermierit dhe mungesa e informacionit për sasinë gjenden dhe vlerën financiare të tyre ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Përgjithshëm, pasi ka vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të SUT nr.1195/3 date 03.06.2022., kreu III pika 5.

9.Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për administrimin e pllakave dhe vidave dhe përbërësve të tyre, pjesë e grupi “sinteza” rezultoi se:

Për periudhën 2 vjeçare 2021 e 2022 mjekët e shërbimit të ortopedisë kanë gjeneruar **2,680** receta për pacientët e shtruar në pavijonin e ortopedisë, receta të njëjta me ato që lëshohen në sistemin parësor (për pacientët jo të shtruar në spital) për materiale ortopedike që nevojiten për këta pacientë sipas diagnozës që gjendet në kartelat mjekësore të tyre.

10.Shkëmbimi i materialeve ortopedike të grupit sinteza nuk është dokumentuar me proces verbal sipas përcaktimit të pikës 5 paragrafi i dytë i kontratës nr.1/2021 të furnizimit, por nga ana e mjekut kirurg operues janë lëshuar receta mjekësore për pacientin që do të operohet

11.Lëshimi i recetave për pacientet e shtruar që marrin shërbim spitalor është në kundërshtim të hapur me ligjin për shërbimin spitalor Nr.9106, datë 17.7.2003, ligjin për kujdesin shëndetësor nr. 10107 datë 30.3.2009, ligjin 10383 date 24.02.2011 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë, neni 10 pika 1/a ku parashikohet se: 1.Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

1/a Vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike

12.Në bllokun operator qendror nuk janë pasqyruar 811 operacione për vitin 2022 dhe 667 operacione për vitin 2021 në regjistrat e këtij shërbimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.1. faqe 137-153.

13.Si rezultat i planifikimit të gabuar të medikamenteve dhe materialeve të mjekimit nga shërbimet dhe mungesës së kontrollit nga strukturat përgjegjëse për qarkullimin e barnave dhe sinjalizimi për barnat në prag të skadencës, në SUT brenda periudhës së auditimit kanë skaduar barna dhe materiale mjekimi në shumën **9,275,420 lekë.**

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.3. faqe 160-164 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

14.Nga Titullari i institucionit nuk ka asnjë nisëm për krijimin e ambienteve për administrimin e trupave të pacientëve që ndërrojnë jetë në SUT.

SUT nuk ka krijuar ambiente të përshtatshme për të ushtruar veprimtarin e tyre ligjore strukturat përgjegjëse të parashikuara në legjislacionin në fuqi, duke vepruar në mospërputhje me parashikimet e Kreut IV -Kërkesat dhe klasifikimi i Spitaleve, neni 31, shkronja g, të Ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe të Aneksit II, pika 8, të VKM-së nr. 237, datë 06.03.2009.

Më hollësisht trajtuar në pikën të ndryshme. faqe 164-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

15.Në cilësinë e titullarit dhe nëpunësit autorizues të Spitalit Universitar të Traumës ka lejuar që krahas shërbimit të sterilizimit nga koncesionari Sani Service, në shërbimet Neurokirurgji, Salla e kirurgjisë plastike, Kabineti Maksilo Faciale dhe Reaminacion të SUT-së të përdoren autoklava sterilizuese, të cilat në inventarin e SUT gjenden 9 (nëntë) autoklava sterilizuese në vlerën totale 3,604,584 lekë, duke vepruar në kundërshtim me kushtet e kontratës koncesionare Nr. 1440/40 Prot., datë 24.12.2015

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.3. faqe 155-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

16.Nga titullari i institucionit nuk është zhvilluar procedura për mënyrën e raportimit të ngjarjeve të padëshirueshme dhe marrjen e sinjaleve të alarmit nga pajisjet mjekësore si dhe njohjen e personelit mjekësor me këto procedura. Nga ana e titullarit nuk janë marrë masa për asgjësimin e pajisjeve mjekësore që janë jashtë përdorimit por ato qëndrojnë në ambiente ku

dëmtohet shëndeti i njeriut.

Më hollësisht trajtuar ne pikën 2.8.2. faqe 153-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

17. Në mungese të efektivitetit të funksionimit të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në sallën e operacionit sipas detyrimit të nenit 5 të marrëveshjes Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021, kanë asistuar si përfaqësues të OE kontraktues z. I K, z. A M, R Z, R G, persona të paautorizuar që nuk janë deklaruar nga OE fitues në këtë procedurë me të cilët është lidhur marrëveshje kuadër me AK SUT.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7., faqe 105-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

2. Z. A.C, me detyrë Zv. Drejtor i Përgjithshëm Teknik i SUT-së

1. Në cilësinë e kryetarit të KVO, për procedurën Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.4. faqe 96-99)

2. Në cilësinë e anëtarëve të komisionit të monitorimit të marrëveshjes Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 117-119

3. Në cilësinë e anëtarëve të KVO për procedurën me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022”, nga ku ka rezultuar se miratimi i OE fitues është bërë në kushtet kur subjekti BOE”T&L” shpk nuk ka plotësuar kërkesat për kualifikim si dhe mostrat e paraqitura, (si pjesë e kriterëve të DST) nuk përputhen me specifikimet e vendosura nga AK në DST, duke kualifikuar dhe shpallur fitues një BOE i cili duhet të ishte skualifikuar dhe procedura e prokurimit duhej të ishte rishpallur, ose ti kalonte OE tjetër pjesëmarrës, edhe pse oferta ekonomike më pak e leverdishme, duke favorizuar BOE edhe pse në kushte skualifikimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 124-126

4. Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 124-126

5. Në cilësinë e anëtarëve të komisionit të posaçëm për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër nr. 50/16 Prot., datë 25.10.2022 dhe të Zv. Drejtorit Teknik në SUT

6. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për administrimin e pllakave dhe vidave dhe përbërësve të tyre, pjesë e grupi “sinteza” rezulton se:

Për periudhën 2 vjeçare 2021 e 2022 mjekët e shërbimit të ortopedisë kanë gjeneruar **2,680** receta për pacientët e shtruar në pavijonin e ortopedisë, receta të njëjta me ato që lëshohen në sistemin parësor (për pacientët jo të shtruar në spital) për materiale ortopedike që nevojiten për këta pacientë sipas diagnozës që gjendet në kartelat mjekësore të tyre.

7. Shkëmbimi i materialeve ortopedike të grupit sinteza nuk është dokumentuar me proces verbal sipas përcaktimit të pikës 5 paragrafi i dytë i kontratës nr.1/2021 të furnizimit, por nga ana e mjekut kirurg operues janë lëshuar receta mjekësore për pacientin që do të operohet

Lëshimi i recetave për pacientet e shtruar që marrin shërbim spitalor është në kundërshtim të hapur me ligjin për shërbimin spitalor Nr.9106, datë 17.7.2003, ligjin për kujdesin shëndetësor nr. 10107 datë 30.3.2009, ligjin 10383 date 24.02.2011 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë, neni 10 pika 1/a ku parashikohet se: 1. Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

1/a Vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor

publik dhe në spitalet publike

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.1. faqe 137-153

8. Në cilësinë e kryetarit të KVO në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022, ka kualifikuar OE L pjese BOE ”T&L” në kushtet kur nuk i plotësonte kërkesat e AK në lidhje me listën e paraqitjes së mostrave, duke vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h në DST.

Në kushte kur OE L, pjese e BOE “T&L” nuk përmbush kriteret për kualifikim, KVO duhej ta kishte Skualifikuar BOE, dhe duke qene se oferta tjetër e kualifikuar e OE “O.3..” Shpk ishte ekonomikisht me pak e leverdishme për AK SUT, AK duhej ta anulonte këtë procedurë.

Për sa më lart, KVO ka vepruar duke favorizuar BOE edhe pse në kushtet e skualifikimit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 114-119.

9. Në cilësinë e në cilësinë e anëtarëve të komisionit të monitorimit të marrëveshjes Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021, ne sallën e operacionit kanë asistuar si përfaqësues të OE kontraktues z. I K, z. A M, R Z, R G, persona të paautorizuar dhe që nuk janë deklaruar nga OE fitues në këtë procedure me të cilët është lidhur marrëveshje kuadër me AK SUT.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7., faqe 105-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Përgjigja e institucionit:

Me urdhërin Nr. 723 datë 20.06.2024 është bërë lirimi nga detyra i Zv.Drejtorit të Përgjithshëm Mjekësorë Z.A C.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3. Znj. E.R , me detyre Zv Drejtor i Përgjithshëm Ekonomik i SUT-së:

1.Në cilësinë zv.Drejtorit ekonomik dhe njëkohësisht nëpunësit zbatues nuk ka hartuar gjurmën e auditit për monitorimin dhe zbatimin e kontratave përgjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të zv.Drejtorit të përgjithshëm ekonomik brenda periudhës së auditimit, duke mos siguruar kontrollin e brendshëm kryesisht për të gjitha proceset ekonomiko financiare kryesisht për shërbimet e prokuruar dhe blerjet e barnave , materialeve të mjekimit dhe kryesisht të materialeve ortopedike.

Duke vepruar në mospërputhje me përcaktimet e nenit 5 të ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, kreun III, piken 5 të Rregullores së brendshme të SUT nr.1195/3 date 03.06.2022., ku parashikohet se Zv. Drejtori i përgjithshëm ekonomik:

a. Organizon, drejton dhe kontrollon të gjithë aktivitetin ekonomik dhe financiar të SUT duke mbajtur përgjegjësi për funksionimin e kësaj veprimtarie sipas legjislacionit në fuqi.

b. Pezullon çdo veprim që kryet në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe rregullat e caktuara në fushën ekonomiko financiare , ndërhyjnë në organet përkatëse për marrjen e masave.

c. Organizon, drejton e përgjigjet për sigurimin e bazës materiale të nevojshme për pacientet dhe sigurimin e shërbimit, për administrimin e shfrytëzimin racional të këtyre materialeve, plotëson nevojat e administratës së spitalit e shërbimeve me inventarin e pajisjet e nevojshme

d. Organizon punën dhe ndjek zbatimin e të gjitha detyrave për mënjanimin e krijimit të mallrave stoqe si medikamente, materiale mjekimi, konsumi etj.

2.Nga verifikimi fizik i kryer në zyrën e kryeinfermierit të bllokut operator qendror nga grupi i auditimit të KLSH, më datë 23.03.2023 rezultojë se në këtë ambient gjendej një sasi e konsiderueshme materialeve ortopedike e pajustifikuar dhe e pa inventarizuar nga strukturat përgjegjëse të SUT.

Materialet ortopedike që gjendeshin në këtë ambient ishin materiale ortopedike të llojit Proteza

dhe Sinteza, të cilat kishin vlerën ekonomike **35,228,087 lekë**.

Sasia edhe vlera e këtyre materialeve është pothuajse e barabartë me vlerën e materialeve ortopedike që prokurohen me Marrëveshjes Kuadër nga SUT gjate një viti. Këto materiale duhej të ishin në farmacinë e SUT dhe jo gjendje në zyrën e kryeinfiermerit.

Gjenda stok e këtyre materialeve në zyrën e dhe mungesa e informacionit për gjendjen fizike dhe vlerën financiare të tyre ngarkon me përgjegjësi Zv. Drejtorin e përgjithshëm ekonomik duke vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të SUT nr.1195/3 date 03.06.2022., kreu III pika 5.

3. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për administrimin e pllakave dhe vidave dhe përbërësve të tyre, pjesë e grupi “sintezë” rezultoi se:

Për periudhën 2 vjeçare 2021 e 2022 mjekët e shërbimit të ortopedisë kanë gjeneruar **2,680 receta** për pacientët e shtruar në pavijonin e ortopedisë, receta të njëjta me ato që lëshohen në sistemin parësor (për pacientët jo të shtruar në spital) për materiale ortopedike që nevojiten për këta pacientë sipas diagnozës që gjendet në kartelat mjekësore të tyre.

Lëshimi i recetave për pacientet e shtruar që marrin shërbim spitalor është në kundërshtim të hapur me ligjin për shërbimin spitalor Nr.9106, datë 17.7.2003, ligjin për kujdesin shëndetësor nr. 10107 datë 30.3.2009, ligjin 10383 date 24.02.2011 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë, neni 10 pika 1/a ku parashikohet se: 1.Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

1/a Vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike

4.Në bllokun operator qendror nuk janë pasqyruar 811 operacione për vitin 2022 dhe 667 operacione për vitin 2021 në regjistrat e këtij shërbimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.1. faqe 137-153.

5.Në cilësinë e Përgjegjësës së financës për periudhën nën auditim, ka vepruar në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

6.Për periudhën objekt auditimi në SUT nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset i cili përmbushte kushtet për nxjerrjen jashtë përdorimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

7.Për Kontratat e Qirasë me O.E. “S-A” Shpk dhe Kontrata e qirasë me O.E. “R” Shpk, në cilësinë anëtarit të komisionit të ndjekjes së kontratës ka lejuar vazhdimin e kontratës megjithëse kontraktuesit nuk kishin kontaktor për matjen e harxhimit të energjisë elektrike dhe të ujit duke vepruar në mospërputhje me kushtet e kontratës *Nenin 6 “Detyrimet e palëve” Pika 6.2 “Të drejtat dhe detyrimet e qeramarrësit”.*

Trajtuar më hollësisht pikën 2.7 faqe 121-127

8.Në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe detyrës se Zv.Drejtorit ekonomik ka lejuar që krahas shërbimit të sterilizimit nga koncesionari Sani Service, në shërbimet Neurokirurgji, Salla e kirurgjisë plastike, Kabineti Maksilo Faciale dhe Reaminacion të SUT-së të përdoren autoklava sterilizuese, të cilat në inventarin e SUT gjenden 9 (nëntë) autoklava sterilizuese në vlerën totale 3,604,584 lekë, duke vepruar në kundërshtim me kushtet e kontratës koncesionare Nr. 1440/40 Prot., datë 24.12.2015

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.3. faqe 155-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

9. Në cilësinë e zv. Drejtorit të përgjithshëm ekonomik nuk ka kryer detyrat funksionale në lidhje me *monitorimin e marrëveshjes Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021*, pasi në sallën e operacionit kanë asistuar persona të paautorizuar dhe që nuk janë deklaruar nga OE fitues në

këtë procedure me të cilët është lidhur marrëveshje kuadër me AK SUT, si përfaqësues të OE kontraktues z. I K, z. A M, R Z, R G,
Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7., faqe 105-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përgjigjja e institucionit:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me vendimin Nr.2925/10 Prot, datë 06.11.2022, ka vendosur masë disiplinore Znj.E R, bazuar në rekomandimet e lëna nga KLSH. Dhe me urdhërin Nr.10 datë 05.01.2024, Znj.E R, me detyrë Zv.Drejtor i Përgjithshëm Ekonomik, është liruar nga detyra.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar**.

Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit Universitar të Traumës të bëjë vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore ndaj:

1.Z.G.H, me detyrë shefi i sektorit të prokurimeve:

-Në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Për shërbimin dhe pastrimin e ambienteve të SUT-së për nevojat emergjente” me O.E. fitues “S A” në mospërputhje Nenin 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, VKM Nr. 914, Datë 29.12.2014 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik, i ndryshuar Me Vendimin Nr. 823, Datë 21.10.2020.

-Në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT” me O.E. fitues O.E. “D P” në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 66-74

-Në cilësinë e anëtarëve të njesisë së prokurimit dhe hartues të specifikimeve teknike për lotin 19 ne procedurën e prokurimit “Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.4. faqe 91-96

-Në cilësinë e përgjegjës të sektorit të prokurimeve, për procedurën e prokurimit Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.4. faqe 100-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

-Në cilësinë e anëtarëve të komisionit për zhvillimin e minikonkursit për procedurën me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 120-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Në cilësinë e anëtarit të KVO për pikën 2.6.7. Procedura e prokurimit (“Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”), nga ku ka rezultuar se miratimi i OE fitues është bërë në kushtet kur subjekti OE “O 3..” shpk nuk ka plotësuar kushtet e marrëveshjes kuadër, pasi në dy raste për vlerat prej 498,250 lekë dhe 229,650 lekë, ka shkaktuar dëm ekonomik pasi Titullari i AK dhe Komisioni për zhvillimin e minikonkurseve, ka shpallur fitues OE O i cili nuk plotësonte kushtet e marrëveshjes kuadër pasi, për materialet e renditura në tabelën nr.1 aneksi 2.6.6 çmimi i ofruar nga OE O 3..në minikonkursin rezultoi që të jetë më i lartë se çmimi referent. Në këto kushte komisioni i posaçëm i ngritur për organizimin e minikonkurseve ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe akteve ligjore në fuqi duke shpallur fitues OE O, i cili ka ofertuar materialet e paraqitura në tabelën nr.2 me çmimin për njësi më të lartë se ai referent.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

2. znj. M.P, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për procedure e prokurimit “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente” Gusht 2022

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 66-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit
Në cilësinë e anëtarit të grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës së procedurës procedurës “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 69-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit
Në cilësinë e anëtarit të grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Trajtimi i mbetjeve spitalore për SUT”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 78-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit
Në cilësinë e anëtarëve të KVO për procedurën me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 124-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit
Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022”, nga ku ka rezultuar se miratimi i OE fitues është bërë në kushtet kur subjekti BOE “T dhe L” shpk nuk ka plotësuar kërkesat për kualifikim si dhe mostrat e paraqitura, (si pjesë e kritereve të DST) nuk përputhen me specifikimet e vendosura nga AK në DST, duke kualifikuar dhe shpallur fitues një BOE i cili duhet të ishte skualifikuar dhe procedura e prokurimit duhej të ishte rishpallur, ose ti kalonte OE tjetër pjesëmarrës, edhe pse oferta ekonomike më pak e leverdishme, duke favorizuar BOE edhe pse në kushte skualifikimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 124-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit
Në cilësinë e anëtarëve të komisionit të posaçëm për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër nr. 50/16 Prot., datë 25.10.2022.

*-Nga verifikimi fizik i kryer nga grupi i auditimit të KLSH, më datë 23.03.2023 dhe pas inventarizimit të materialeve ortopedike që gjendeshin në këtë ambient rezultojë që sasia e këtyre materialeve ortopedike, Proteza dhe atyre të sintezës kishin vlerën ekonomike në shumën **35,228,087 lekë**.*

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.1. faqe 137-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit
Në cilësinë e Anëtarit të KVO në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022, ka kualifikuar OE L pjese BOE “T&L” në kushtet kur nuk i plotësonte kërkesat e AK në lidhje me listën e paraqitjes së mostrave, duke vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h në DST.

Në kushte kur OE L, pjese e BOE “T & L ” nuk përmbush kriteret për kualifikim, KVO duhej ta skualifikuar BOE, dhe duke qene se oferta tjetër e kualifikuar e OE “O 3..” Shpk ishte ekonomikisht me pak e leverdishme për AK SUT, AK duhej ta anulonte këtë procedurë.

Për sa më lart, KVO ka vepruar duke favorizuar BOE edhe pse në kushtet e skualifikimit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 114-119.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

3. Znj. R.J, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për procedure e prokurimit “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente” Gusht 2022

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 66-68

2.Në cilësinë e anëtarit të grupit për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, për nevoja emergjente” Prill 2022

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 73-74

3.Në cilësinë e anëtarit të grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës së procedurës “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 69-71

4.Në cilësinë e anëtarëve të KVO, për procedurën Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.4. faqe 96-99

5.Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën e prokurimit (“Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”)

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.6. faqe 108-110

6.Për procedurën e prokurimit me objekt blerje baze materiale për SUT në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla, ka bërë copëzim të fondit, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1. faqe 48-49

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

4. Z.V.S, në cilësinë e anëtarit të grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës së procedurës “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 69-71

Në cilësinë e anëtarit të grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Trajtimi i mbetjeve spitalore për SUT”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 78-83

Në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën “Trajtimi i mbetjeve spitalore”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 83-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Për Kontratat e Qirasë me O.E. “S-A” Shpk dhe Kontrata e qirasë me O.E. “R” Shpk, në cilësinë e anëtarit të komisionit të ndjekjes së kontratës ka lejuar vazhdimin e kontratës megjithëse kontraktuesit nuk kishin kontaktor për matjen e harxhimit të energjisë elektrike dhe të ujit duke vepruar në kundërshtim me kushtet e kontratës *Nenin “Detyrimet e palëve” Pika 6.2 “Të drejtat dhe detyrimet e qeramarrësit”.*

Trajtuar më hollësisht piken 2.7 faqe 121-127

Përgjigja e institucionit:

Me urdhërin Nr.485 datë 17.08.2022, mbështetur në Raportin Përfundimtar të KLSH-së, i është dhënë masë disiplinore “Vërejte me paralajmërim për largim nga puna” Z.V S.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar**.

5. Znj.K.B, në cilësinë e anëtarit të grupit për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, për nevoja emergjente” Prill 2022

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 73-74

-Në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Kryerja e Shërbimit të Gatimit dhe shpërndarjes të ushqimit për SUT” 2022.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 74-78

-Në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt “*Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT*” me O.E. fitues O.E. “D P” në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

dhe në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së kontratës për mallrat në mospërputhje me Nenin 77, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

6.Znj. V.X, në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Kryerja e Shërbimit të Gatimit dhe shpërndarjes të ushqimit për SUT” 2022 me O.E. fitues O.E. “D P” në mospërputhje me Nenin 77, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 74-78.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

7. Znj. M.M, në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Kryerja e Shërbimit të Gatimit dhe shpërndarjes të ushqimit për SUT” 2022

2.Në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së kontratës për mallrat me objekt:

“*Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT*” me O.E. fitues O.E. “D P” në mospërputhje me Nenin 77, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 74-78.

3.Për Kontratat e Qirasë me O.E. “S A” Shpk dhe Kontrata e qirasë me O.E. “R” Shpk, në cilësinë anëtarit të komisionit të ndjekjes së kontratës ka lejuar vazhdimin e kontratës megjithëse kontraktuesit nuk kishin kontaktor për matjen e harxhimit të energjisë elektrike dhe të ujit duke vepruar në kundërshtim me kushtet e kontratës Nenin 6 “Detyrimet e palëve” Pika 6.2 “Të drejtat dhe detyrimet e qeramarrësit”. Trajtuar më hollësisht pikën 2.7 faqe 121-127

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

8. Z. I.P, në cilësinë e anëtarit të grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Trajtimi i mbetjeve spitalore për SUT”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 78-83

Në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme e ndarë në dy lote”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 87-88.

Përgjigja e institucionit:

Me urdhërin Nr.1190 datë 05.10.2023, është zgjidhur kontrata e punës në mënyrë të menjëhershme për z.I.P.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **zbatuar**.

9.Z. A.Rr, në cilësinë e anëtarit të grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Trajtimi i mbetjeve spitalore për SUT”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 78-83

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

10. Z. M.S , në cilësinë e anëtarit të grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Trajtimi i mbetjeve spitalore për SUT”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 78-83

Në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe hartues të specifikimeve teknike për lotin 19 ne procedurën e prokurimit “Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.4. faqe 91-96

Në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 113-115

Në cilësinë e anëtarëve të komisionit për zhvillimin e minikonkursit për procedurën me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 120-121

Në cilësinë e anëtarëve të KVO për procedurën me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022”

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 124-126

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022”, nga ku ka rezultuar se miratimi i OE fitues është bërë në kushtet kur subjekti BOE “T & L” shpk nuk ka plotësuar kërkesat për kualifikim si dhe mostrat e paraqitura, (si pjesë e kriterëve të DST) nuk përputhen me specifikimet e vendosura nga AK në DST, duke kualifikuar dhe shpallur fitues një BOE i cili duhet të ishte skualifikuar dhe procedura e prokurimit duhej të ishte rishpallur, ose ti kalonte OE tjetër pjesëmarrës, edhe pse oferta ekonomike më pak e leverdishme, duke favorizuar BOE edhe pse në kushte skualifikimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 124-126

Në cilësinë e Anëtarit të KVO në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022, ka kualifikuar OE L pjesë BOE “T&L” në kushtet kur nuk i plotësonte kërkesat e AK në lidhje me listën e paraqitjes së mostrave, duke vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h në DST.

Në kushte kur OE L, pjesë e BOE “T&L” nuk përmbush kriteret për kualifikim, KVO duhej ta kishte skualifikuar BOE, dhe duke qene se oferta tjetër e kualifikuar e OE “O 3..” Shpk ishte ekonomikisht me pak e leverdishme për AK SUT, AK duhej ta anulonte këtë procedurë.

Për sa më lart, KVO ka vepruar duke favorizuar BOE edhe pse në kushtet e skualifikimit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 114-119.

Në cilësinë e anëtarit të KVO për pikën 2.6.7. Procedura e prokurimit (“Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”), nga ku ka rezultuar se miratimi i OE fitues është bërë në kushtet kur subjekti OE “O 3..” shpk nuk ka plotësuar kushtet e marrëveshjes kuadër, pasi në dy raste për vlerat prej 498,250 lekë dhe 229,650 lekë, ka shkaktuar dëm ekonomik pasi Titullari i AK dhe Komisioni për zhvillimin e minikonkurseve, ka shpallur fitues OE ON i cili nuk plotësonte kushtet e marrëveshjes kuadër pasi, për materialet e renditura në tabelën nr.1 aneksi 2.6.6 çmimi i ofruar nga OE O 3.. në minikonkursin rezulton që të jetë më i lartë se çmimi referent. Në këto kushte komisioni i posaçëm i ngritur për organizimin e minikonkurseve ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe akteve ligjore në fuqi duke shpallur fitues OE ON, i cili ka ofertuar disa materiale ortopedike me çmimin për njësi më të lart se çmimi referent.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

11. Z. P.S, në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën “Trajtimi i mbetjeve spitalore”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 83-87

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

12. Z. G.P në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën “Trajtimi i mbetjeve spitalore”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 83-87

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

13. z. D.C, në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme e ndarë në dy lote”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 87-88

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

14. z. K.S, në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme e ndarë në dy lote”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2. faqe 87-88

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

15. Znj. V.A, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe hartues të specifikimeve teknike për lotin 19 ne procedurën e prokurimit “Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.4. faqe 91-96

Në cilësinë e kryetarit të KVO, në procedurën e prokurimit (“Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”). Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.6. faqe 108-110

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

16. Znj. A.M. në cilësinë e ish kryeinfermieres,

-Nga verifikimi fizik i kryer nga grupi i auditimit të KLSH, më datë 23.03.2023 dhe pas inventarizimit të materialeve ortopedike që gjendeshin në këtë ambient rezultojë që sasia e këtyre materialeve ortopedike Proteza dhe atyre të sintezës kishin vlerën ekonomike në shumën **35,228,087 lekë**.

-Në bllokun operator qendror nuk janë pasqyruar **811 operacione** për vitin 2022 dhe **667 operacione** për vitin 2021 në regjistrat e këtij shërbimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.1. faqe 137-153

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

17.Z. K.K në cilësinë e shefit të shërbimit të Ortopedisë.

-Nga verifikimi fizik i kryer nga grupi i auditimit të KLSH, më datë 23.03.2023 dhe pas inventarizimit të materialeve ortopedike që gjendeshin në këtë ambient rezultojë që sasia e këtyre materialeve ortopedike Proteza dhe atyre të sintezës kishin vlerën ekonomike në shumën **35,228,087 lekë**.

-Në bllokun operator qendror nuk janë pasqyruar **811 operacione** për vitin 2022 dhe **667 operacione** për vitin 2021 në regjistrat e këtij shërbimi. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.1. faqe 137-153

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

18. Znj. M.M në cilësinë e anëtarëve të KVO, për procedurën Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.4. faqe 96-99.

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën e prokurimit (“Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”). Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.6. faqe 108-110.

Për procedurën e prokurimit me objekt blerje baze materiale për SUT në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla, ka bërë copëzim të fondit, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1. faqe 48-49

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

19.Znj. L.B, në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën e prokurimit (“Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”). Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.6. faqe 108-110

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

20.Z.I.H, në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën e prokurimit (“Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”). Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.6. faqe 108-110

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

21.Z.V.R, në cilësinë e kryetarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 113-115

Në cilësinë e anëtarëve të komisionit të monitorimit të marrëveshjes Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 117-119

Në cilësinë e anëtarëve të komisionit të posaçëm për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër nr. 50/16 Prot., datë 25.10.2022 dhe njëkohësisht të zv.Drejtorit ekonomik dhe shefit të shërbimit të Ortopedisë.

-Nga verifikimi fizik i kryer nga grupi i auditimit të KLSH, më datë 23.03.2023 dhe pas inventarizimit të materialeve ortopedike që gjendeshin në këtë ambient rezultojë që sasia e këtyre materialeve ortopedike Proteza dhe atyre të sintezës kishin vlerën ekonomike në shumën **35,228,087 lekë**.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për administrimin e pllakave dhe vidave dhe përbërësve të tyre, pjesë e grupi “sinteza” rezulton se:

Për periudhën 2 vjeçare 2021 e 2022 mjekët e shërbimit të ortopedisë kanë gjeneruar **2,680 receta** për pacientët e shtruar në pavijonin e ortopedisë, receta të njëjta me ato që lëshohen në sistemin parësor (për pacientët jo të shtruar në spital) për materiale ortopedike që nevojiten për këta pacientë sipas diagnozës që gjendet në kartelat mjekësore të tyre.

Lëshimi i recetave për pacientet e shtruar që marrin shërbim spitalor është në kundërshtim të hapur me ligjin për shërbimin spitalor Nr.9106, datë 17.7.2003, ligjin për kujdesin shëndetësor nr. 10107 datë 30.3.2009, ligjin 10383 date 24.02.2011 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë, neni 10 pika 1/a ku parashikohet se: 1.Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

1/a Vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike.

-Në bllokun operator qendror nuk janë pasqyruar 811 operacione për vitin 2022 dhe 667 operacione për vitin 2021 në regjistrat e këtij shërbimi. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.1. faqe 137-153.

Në cilësinë e në cilësinë e anëtarëve të komisionit të monitorimit të marrëveshjes Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021, në sallën e operacionit kanë asistuar si përfaqësues të OE

kontraktues z. I K, z. A M, R Z, R G², persona të paautorizuar dhe që nuk janë deklaruar nga OE fitues ne këtë procedurë me të cilët është lidhur marrëveshje kuadër me AK SUT. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7., faqe 105-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

22. Z.B.V, në cilësinë e anëtarit të KVO për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 113-115

Në cilësinë e anëtarëve të komisionit për zhvillimin e minikonkursit për procedurën me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 120-121

Për Kontratat e Qirasë me O.E. “S A” Shpk dhe Kontrata e qirasë me O.E. “R” Shpk, në cilësinë anëtarit të komisionit të ndjekjes së kontratës ka lejuar vazhdimin e kontratës megjithëse kontraktuesit nuk kishin kontaktor për matjen e harxhimit të energjisë elektrike dhe të ujit duke vepruar në kundërshtim me kushtet e kontratës Nenin 6 “Detyrimet e palëve” Pika 6.2 “Të drejtat dhe detyrimet e qeramarrësit”. Trajtuar më hollësisht pikën 2.7 faqe 121-127

Për procedurën e prokurimit me objekt blerje baze materiale për SUT në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla, ka bërë copëzim të fondit, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1. faqe 48-49

Në cilësinë e anëtarit të KVO për pikën 2.6.7. Procedura e prokurimit (“Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”), nga ku ka rezultuar se miratimi i OE fitues është bërë në kushtet kur subjekti OE “O 3..” shpk nuk ka plotësuar kushtet e marrëveshjes kuadër, pasi në dy raste për vlerat prej 498,250 lekë dhe 229,650 lekë, ka shkaktuar dëm ekonomik pasi Titullari i AK dhe Komisioni për zhvillimin e minikonkurseve, ka shpallur fitues OE O i cili nuk plotësonte kushtet e marrëveshjes kuadër pasi, për materialet e renditura në tabelën nr.1 aneksi 2.6.6 çmimi i ofruar nga OE O 3.. në minikonkursin rezulton që të jetë më i lartë se çmimi referent. Në këto kushte komisioni i posaçëm i ngritur për organizimin e minikonkurseve ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe akteve ligjore në fuqi duke shpallur fitues OE O, i cili ka ofertuar materialet e paraqitura në tabelën nr.2 me çmimin për njësi më të lartë se ai referent.

Përgjigjja e institucionit:

Me urdhërin Nr.541 datë 30.08.2022, është ndërprerë marrëdhënia e punës me Z. B.V.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

23. Z.B.G, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të monitorimit të marrëveshjes Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 117-119

² Date 04.10.2021 me nr. karteles A007206., etj.

Në cilësinë e në cilësinë e anëtarëve të komisionit të monitorimit të marrëveshjes Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021, në sallën e operacionit kanë asistuar si përfaqësues të OE kontraktues z. I K, z. A M, R Z, R G persona të paautorizuar dhe që nuk janë deklaruar nga OE fitues në këtë procedurë me të cilët është lidhur marrëveshje kuadër me AK SUT. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7., faqe 105-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

24. Z.E.Q në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve mjekësore, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 117-119

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

25. Z.I.H, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve mjekësore, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 117-119

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

26. Z.L.F në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve mjekësore, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 117-119

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

27. Z.K.S, në cilësinë e anëtarëve të komisionit për zhvillimin e minikonkursit për procedurën me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”, nga ku ka rezultuar se miratimi i OE fitues është bërë në kushtet kur subjekti OE “O 3..” shpk nuk ka plotësuar kushtet e marrëveshjes kuadër, pasi në dy raste për vlerat prej 498,250 lekë dhe 229,650 lekë, ka shkaktuar dëm ekonomik pasi Titullari i AK dhe Komisioni për zhvillimin e minikonkurseve, ka shpallur fitues OE O i cili nuk plotësonte kushtet e marrëveshjes kuadër pasi, për materialet e renditura në tabelën nr.1 aneksi 2.6.6 çmimi i ofruar nga OE O 3.. në minikonkursin rezulton që të jetë më i lartë se çmimi referent. Në këto kushte komisioni i posaçëm i ngritur për organizimin e minikonkurseve ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe akteve ligjore në fuqi duke shpallur fitues OE O, i cili ka ofertuar materialet e paraqitura në tabelën nr.2 me çmimin për njësi më të lartë se ai referent. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 120-121

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

28. Znj.E.K në cilësinë e shefit të shërbimit të farmacistë së SUT-së ka lejuar që ne farmaci të kete medikamenteve pa vulën e kuqe me mbishkrimin “për përdorim spitalor ndalohet shitja të verifikuara nga grupi i auditimit të KLSH, të pasqyruar në AKT Verifikimin nr.1 datë 13.01.2023. Me hollësisht trajtuar në piken 2.8.3 faqe 147-151.

Përgjigjja e institucionit:

Me urdhërin Nr.49 datë 25.01.2024, është bërë lirim nga detyra si shefe shërbimi dhe emërim në detyrë farmaciste në shërbimin e farmacistë Znj E.K.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

29. Znj.D.Ll, për Kontratat e Qirasë me O.E. “S A” Shpk dhe Kontrata e qirasë me O.E. “R” Shpk, në cilësinë anëtarit të komisionit të ndjekjes së kontratës ka lejuar vazhdimin e kontratës megjithëse kontraktuesit nuk kishin kontaktor për matjen e harxhimit të energjisë elektrike dhe te ujit duke vepruar në kundërshtim me kushtet e kontratës Nenin 6 “Detyrimet e palëve” Pika 6.2 “Të drejtat dhe detyrimet e qeramarrësit”. Trajtuar më hollësisht piken 2.7 faqe 121-127.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga SUT nuk janë marrë masat e kërkuara. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

30. Znj. A.D, për Kontratat e Qirasë me O.E. “S A” Shpk dhe Kontrata e qirasë me O.E. “R” Shpk, në cilësinë anëtarit të komisionit të ndjekjes së kontratës ka lejuar vazhdimin e kontratës megjithëse kontraktuesit nuk kishin kontaktor për matjen e harxhimit të energjisë elektrike dhe te ujit duke vepruar në kundërshtim me kushtet e kontratës Nenin 6 “Detyrimet e palëve” Pika 6.2 “Të drejtat dhe detyrimet e qeramarrësit”. Trajtuar më hollësisht piken 2.7 faqe 121-127

Përgjigjja e institucionit:

Me urdhërin Nr.665 datë 21.05.2021, është ndërprerë marrëdhënia e punës me Zj. A D.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është zbatuar**.

Përgjigjja e institucionit:

Për sa sipër, nga subjekti është bërë observacion ndaj Projektraportit, me shkresën Nr.3768, prot., datë 15.10.2024, protokolluar në KLSH me shkresën Nr. 792/16 prot., datë 16.10.2024. Pretendimi subjektiv : “... Rekomandimi seksioni D. ... Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e ka realizuar rekomandimin duke ngritur një komision disiplinor dhe ka vendosur masë disiplinore për Drejtorin e Përgjithshëm të SUT, Zv.Drejtorin Ekonomik dhe Zv.Drejtorin Teknik.

1) Rekomandimet për dhënie masë disiplinore për punonjësit është zbatuar nga SUT, përkatësisht për pikat 1, 2, 3, 5, 6, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 19, 20, 21, 24, 25, 26, 27, 29. Bashkëlidhur masat disiplinore.

2) Rekomandimi për pikën 7: Znj. M M, aktualisht është me raport mjekësor, prandaj procedimi disiplinor është pezulluar dhe do të vijojë sapo punonjësja të rikthehet në detyrë.

3) Rekomandimi për pikën 17 dhe 18 është zbatuar nga SUT, pasi Z. K K dhe Znj.M M.janë ulur në detyrë.

Bashkëlidhur urdhërat.

4) Rekomandimi për pikën 23 është i zbatuar nga SUT, pasi Z. B G me Vendimin Nr. 601 datë

31.05.2024 ka ndërprerë marrëdhënien e punës.
Bashkëlidhur urdhëri.

Komenti i grupit të auditimit.

Grupi i Auditimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti vlerësoi se dokumentacioni i sjellë përmes observacioneve nuk paraqet fakte/prova të reja të cilat mund të ndryshojnë statusin e zbatimit të rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.**

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit kryer prej grupit të auditimit të KLSH-së rezultoi se, niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) 40 Masa organizative nga ku 54 rekomandime, janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 26 Zbatuar, 20 pjesërisht zbatuar dhe 8 pa zbatuar.
- b) 3 Masa shpërblim dëmi nga ku 3 rekomandime, janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 1 Zbatuar dhe 2 pjesërisht zbatuar.
- c) 9 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike nga ku 11 rekomandime, janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon: 5 zbatuar, 6 pjesërisht zbatuar.
- d) 1 Masë disiplinore nga ku 1 rekomandim, është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë pjesërisht i zbatuar

Kërkojmë që, Spitali Universitar i Traumës të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar brenda 3 muajve të parë të vitit 2025, si dhe kërkojmë analizimin dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar dhe që efektivisht rezultojnë të pazbatuara.

3.5 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor** mbi “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023*” për auditimin e kryer në vitin 2023, për periudhën objekt auditimi 01.07.2021 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr. 409/8 Prot., datë 28.12.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
 - a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
 - b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
 - c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve;
 - ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 792/1 prot., datë 01.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.R (Përgjegjësi i Grupit)
2. E.K, anëtar

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr. 409/8, datë 28.12.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr. 409/8, datë 28.12.2023, rezulton se nga **26** masa të rekomanduara (organizative, 3-E dhe Disiplinore), janë pranuar nga subjekti **26** masa ose 100 %. **Nga të pranuarat (26):** janë zbatuar plotësisht **17**, ose 65 % e tyre, është zbatuar pjesërisht **8** masa ose 31 %, si dhe nuk është zbatuar **1** masë ose 4 %.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit		
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
1	Organizative	23 masa	17	6	-
2	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa 43,312,111 lekë	-	2	-
3	Masa Disiplinore	1	-	-	1
	Gjithsej	26 43,312,111 lekë	17 masa	8 masa	1 masë

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 65 % kurse ai i masave të zbatuara pjesërisht është 31 %.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/I-Hartimi i programit (Plan veprimt) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e

përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën Nr. 8295/40 Prot., datë 11.01.2024.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”).

Në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 12789 prot., datë 28.06.2024.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga **20 masa organizative** të rekomanduara gjithsej, **16** janë zbatuar plotësisht, **1** është në proces zbatimi dhe **3** nuk janë zbatuar.

-Nga **1** masë për shpërblim dëmi e rekomanduar dhe e zbatuar plotësisht.

-Nga **1** masë për eliminimin e efekteve negative konstatuar në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike e rekomanduar, por e pa zbatuar,

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të lëna nga KLSH, të hartojë një plan veprimi për detyrat e përcaktuara duke përcaktuar afatet dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre si më poshtë:

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me rekomandimin 1.1; Ju informojmë se, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me Urdhrin nr. 32, datë 08.01.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Raporti Përfundimtar i KLSH-së”, ka hartuar planin e veprimit i cili përmban: “masat e propozuara nga KLSH”, “afatin e trajtimit”, “sektorët përgjegjës” dhe “programe menaxhimi me afate”, për të gjitha masat për zbatimin e rekomandimeve sipas afateve të përcaktuara në raportin përfundimtar të auditimit me shkresën nr. 8295/40 Prot, datë 11.01.2024 “*Dërgojmë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve*

të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nr. 409/8 prot, datë 28.12.2023, protokolluar me tonën nr. 8295/39 Prot, datë 03.01.2024” ju bëjmë me dije për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*

8.2.Rekomandim: Drejtoria Ekonomike e DPSHTRR-së të marrë masa për krijimin e provizioneve për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, pasi të jenë evidentuar të dhënat për klientët/debitorët, si shuma e detyrimit, vjetërsia e tyre dhe situata aktuale e tyre, si dhe pasi të jenë kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me rekomandimin 8.2; Ju informojmë se: me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023, ku është analizuar “pasqyra e pozicionit financiar”, “pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse”, “pasqyra e ndryshimeve në kapital” dhe “pasqyra e flukseve të parasë”, Sektori i Financës në Drejtorinë Ekonomike do të marrë masat për zbatimin në vijimësi sipas SKK 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara”. Është krijuar provizioni në Programin Ekonomiko-Financiar të vitit 2024, miratuar me shkresën nr.10181/1 Prot, datë 16.01.2024, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi miratimin e Programit Ekonomiko-Financiar të DPSHTRR-së për vitin 2024”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*

9.1. Rekomandim: Drejtoria e Ekonomike e DPSHTRR-së të marrë masa të menjëhershme për njohjen në kontabilitet të vlerës së plotë të proceseve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë si shpenzime të periudhës në “Pasqyrën e performancës financiare” të institucionit dhe krijimin e provizioneve si një detyrim në pasqyrën e “Pozicionit financiar”.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me rekomandimin 9.1; Ju informojmë se, Sektori i Financës në Drejtorinë Ekonomike ka zbatuar njohjen në kontabilitet të vlerës së plotë të proceseve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë si shpenzime të periudhës në “Pasqyrën e performancës financiare” dhe është krijuar provizioni në Programin Ekonomiko-Financiar të vitit 2024, miratuar me shkresën nr.10181/1 Prot, datë 16.01.2024, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi miratimin e Programit Ekonomiko-Financiar të DPSHTRR-së për vitin 2024”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*

1.1.Rekomandim: Strukturat përgjegjëse të DPSHTRR-së të marrin masa për të kryer ekzekutimin vullnetar për vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë e si rrjedhojë minimizimin e kostove shtesë që vijnë si pasojë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë me anë të zyrës përmbarimore.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me rekomandimin 1.1 dhe rekomandimin 1.1; Ju informojmë se DPSHTRR ka zbatuar këto 2 rekomandime, duke treguar gadishmërinë që të ekzekutojë dhe me kërkesë

individuale, të palës kreditore titujt ekzekutiv dhe vullnetarisht pa kontraktuar shoqëri përmbare duke sjellë dokumentacionin e nevojshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor sipas ligjit, në vijim të së cilës ju informojmë se ky rekomandim është zbatuar plotësisht në praktikë, për ish punonjësit, me kërkesën e tyre vullnetare.

Ka raste, kur në vendimet gjyqësore nga gjykata është përcaktuar shprehimisht në dispozitiv ekzekutimit të tij nga shërbimi përmbare citojmë: *“Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe ngarkohet shërbimi përmbare është i ekzekutueshëm nga përmbaresi gjyqësor për ekzekutimin e tij”*, pra e ngarkon shërbimin përmbare si organ përgjegjës për të ndjekur procedurën e ekzekutimit të vendimit në referim të neneve 510, 511.. e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, ku përcaktohet se për të pasur efektshmëri të titullit ekzekutiv është e nevojshme pasja e një vendimi nga Gjykata kompetente për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit. Në të kundërt, ekzekutimi i titullit nuk mund të bëhet.

Pasi vendoset lëshimi i urdhërit të ekzekutimit nga Gjykata kompetente, vijohet me fazën e fundit të procedurës civile, pikërisht të ekzekutimit. Organi procedurës në këtë fazë është shërbimi përmbare i cili kontraktohet nga kërkuesi/kreditore në bazë të kërkesës së tij.

Gjithashtu, DPSHTRR ka marrë masa për zbatimin e titullit ekzekutiv konform kuadrit ligjor në fuqi duke njoftuar të gjitha drejtoritë rajonale në varësi, që në rast se bëhen pengesë në ekzekutimin e titullit ekzekutiv të sjellë nga shërbimi përmbare jashtë afateve, personat përgjegjës që bëhen pengesë në ekzekutimin e titullit ekzekutiv do të paguajnë shumën e detyrimit shtesë të përmbaremit.

Bazuar në nenin 511 “Urdhëri i Ekzekutimit” të Kodit të Procedurës Civile *“Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhërit të ekzekutimit, i cili: a) për rastet e parashikuara nga shkronja “a” dhe “b”, të nenit 510, të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin në dispozitivin e vendimit; b) për vendimet e gjykatave të shteteve të huaja e të gjykatave të arbitrazhit të huaj, që u është dhënë fuqi në zbatimin të dispozitave të këtij Kodi, urdhëri i ekzekutimit lëshohet nga gjykata që bën njohjen e vendimit, në dispozitivin e vendimit. Nuk lëshohet urdhër ekzekutimi për vendimin e sigurimit të padisë dhe për gjokat e dhëna nga gjykata, vendimet për marrjen e detyrueshme të provës, vendimin në pjesën që urdhëron shpenzimet gjyqësore, si dhe vendimet civile të gjykatës, të dhëna për ekzekutim të përkohshëm, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga shërbimi përmbare, pas njoftimit të vendimit. Shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit zhvillohet nga gjyqtari pa praninë e palëve. Gjykata lëshon urdhërin e ekzekutimit, bazuar mbi dokumentet e depozituara nga kërkuesi. Urdhëri i ekzekutimit përmban: a) gjenealitetet e debitorit dhe kreditorit; b) origjinën e detyrimit; c) detyrimin konkret që buron nga titulli ekzekutiv deri në momentin e lëshimit të urdhërit të ekzekutimit; d) kur titulli ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhëri i ekzekutimit, është akt për dhënie kredie bankare ose detyrime monetare, Gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.*

-Nenin 515 “Vënia në ekzekutim” të Kodit të Procedurës Civile: *“Urdhëri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbare gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbaresit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit. Kreditore, përveç kërkesës për ekzekutim, duhet të paraqesë: a) titullin ekzekutiv (origjinal ose i noterizuar); b) urdhërin e ekzekutimit (origjinal); c) pagesën e tarifës sipas paragrafit të parë të nenit 525 të këtij Kodi; ç) sipas rastit, prokurën e personit, që përfaqëson palën kreditore. Kur nuk plotësohen në rregull dokumentet e mësipërme për vënien në ekzekutim të urdhërit të ekzekutimit, përmbaresi i kërkuesit një afat 5-ditor për plotësimin e mangësive...”*

Gjatë kohës në pritje të gjykimit të rekursit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, njoftohemi me shkresë “Lajmërim për ekzekutim vullnetar” nga shërbimi përmbare për ekzekutimin e vendimit brenda afatit 5 (pesë) ditor, DPSHTRR para se të ekzekutojë vendimin brenda afatit

të përcaktuar nga shërbimi përmbarrimor në zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bën kërkesën për “Pezullim ekzekutimi të vendimit” duke qenë se DPSHTRR është institucion shtetëror me statusin e personit juridik publik me vetëfinancim, ka garancinë financiare për ekzekutimin e vendimit nëpërmjet kësaj kërkesë, citojmë nenin 479 të K.Pr.Civile: *“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit (Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017) 1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur: a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit...”*, si dhe duke i'u referuar nenit 469 “Pezullimi i ekzekutimit” citojmë: *“Kur prishet vendimi i shkallës së parë dhe çështja dërgohet për rigjykim, pezullohet ekzekutimi i vendimit. Gjykata e apelit me kërkesën e palës mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit edhe kur ajo le në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, kur kundër vendimit të saj bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë dhe nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit mund të vijjë pasoja të rënda ose të pariparueshme, si dhe kur pala që ka bërë rekursin jep garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit”* ku i takon Gjykatës së Lartë të shprehet mbi këtë kërkesë për ekzekutimin e vendimit apo pezullimin e tij për shkaqe të përlegjura.

Në rastet kur Gjykata e Lartë ka vendosur pezullimin e vendimit siç kemi pasur raste të tilla DPSHTRR ka pezulluar ekzekutimin e vendimit deri në shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë.

Theksojmë se kemi ndjekur me përpikmëri zbatimin dhe ezaurimin e të gjitha dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për ndjekjen e çështjes gjyqësore, ushtrimin e të drejtës ligjore të ankimit, Rekursit e deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda afateve të përcaktuara nga Shërbimi Përmbarrimor Shtetëror apo Privat në shkresën lajmërimin për ekzekutim vullnetar.

Për sa më lart, ekzekutimi i një titulli ekzekutiv vullnetarisht pa shërbimin përmbarrimor (shtetëror/privat) nga DPSHTRR pa kërkesë të kreditorit nuk është e bazuar në asnjë dispozitë të Kodit të Procedurës Civile që parashikon procedurën e ekzekutimit të titujve ekzekutiv. Pra, është e domosdoshme kërkesa e kreditorit për ekzekutimin vullnetar të vendimit.

Nuk është në diskrecion të DPSHTRR të ndjek procedurën e ekzekutimit pa pasur të gjitha të dhënat e domosdoshme të kreditorit si llogari bankare aktive për xhirimin e detyrimit, si dhe mbi të gjitha të destinojë vullnetin e kreditorit që të ekzekutojë vendimin gjyqësor duke sjellë kërkesë të thjeshtë pranë DPSHTRR me dokumentacionin përkatës apo të kontraktojë shërbimin përmbarrimor sipas ligjit dhe dispozitivit të vendimit të gjykatës që e ngarkon këtë të fundit shprehimisht.

DPSHTRR ka treguar gadishmërinë që të ekzekutojë dhe me kërkesë të palës kreditore titujt ekzekutiv dhe vullnetarisht pa kontraktuar shoqëri përmbarrimore duke sjellë dokumentacion e nevojshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor sipas ligjit, konkretisht: dokument identifikimi, kopje të vendimit të gjykatave respektive, dokumenta në lidhje me ekzekutimin, kërkesë individuale, të dhëna mbi numrin e llogarisë bankare, etj

Komenti i grupit të auditimit:

Në rastet kur në vendimet gjyqësore nga gjykata përcaktohet në dispozitiv ekzekutimin e tij nga shërbimi përmbarrimor DPSHTRR zbaton vendimin e gjykatës.

Në rastet me kërkesë të palës kreditore titujt ekzekutiv dhe vullnetarisht pa kontraktuar shoqëri përmbarrimore duke sjellë dokumentacion e nevojshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor sipas ligjit, konkretisht: dokument identifikimi, kopje të vendimit të gjykatave respektive, dokumenta në lidhje me ekzekutimin, kërkesë individuale, të dhëna mbi numrin e llogarisë bankare, DPSHTRR ka kryer ekzekutimin sipas kërkesës vullnetare.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

2. Gjetje nga Auditimi: Vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës në përgjithësi janë në përputhshmëri me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për sa i përket tematikave për të cilat janë marrë, por nga auditimi i praktikave të disa vendimeve të marra nga Këshilli Mbikëqyrës me dokumentacionin e plotë justifikues, vihet re një menaxhim jo i duhur financiar i institucionit për arsyt e mëposhtme:

- vendimi për marrjen me enfiteozë të sheshit funksional të Qendrës së Kontrollit Teknik dhe Fizik Fier, ku nuk është përdorur çmimi referencë për m² në vlerën 37 lekë/m² bazuar në VKM nr. 54 datë 05.04.2014, por një çmim tjetër më i lartë. Bazuar në korrespondencën e DPSHTRR-së me Bashkinë Fier, pengesë për vendosjen e çmimit të përcaktuar në VKM është bërë Bashkia Fier, edhe pse përmirësimi i kushteve të Qendrës së Kontrollit Teknik dhe Fizik Fier është në të mirë të banorëve të Bashkisë Fier. Gjithashtu nisur nga më sipër kontrata e mësipërme, nuk shihet si kontratë enfiteoze nga Bashkia Fier pasi Enfiteoza ka si qëllim jo vetëm përdorimin e sendit, por edhe përmirësimin e tij, i cili duhet të cilësohet në kontratë, gjë e cila nuk është marrë në konsideratë gjatë diskutimit të çmimit nga ana e Bashkisë Fier.

- Vendimi nr. 30 datë 22.07.2022 “Për miratimin e kërkesës për huadhënie për A sh.a.”, për mbështetje financiare në formën e huadhënies deri në shumën 936,000,000 lekë të ndara në këste mujore. Në dokumentacionin mbështetës jepen sqarime të detajuara që DPSHTRR nuk mund të mbulojë këtë shumë me fondet e veta, por gjithashtu jep si alternative marrjen e një overdrafti pranë bankave të nivelit të dytë. Në gjykimin e grupit të auditimit dhe praktikave më të mira nuk duket e arsyeshme marrja e një overdrafti për huadhënien drejt një shoqërie tjetër. Sa më sipër është në kundërshtim me Statutin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Rregulloren nr. 10562/1 Prot., datë 19.06.2018 dhe Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Organet Drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë marrjes së vendimeve të kenë në konsideratë menaxhimin e fondeve në proporcion me 3 E (efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet), marrjen e vendimeve në proporcion me objektivat e institucionit si dhe të krijimin e kushteve për arritjen e tyre sipas strategjive të institucionit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në lidhje me rekomandimin 2.1; Ju informojmë se, Grupi i Menaxhimit Strategjik ka zbatuar dhe do të zbatojë në vijimësi këtë rekomandimi duke u bazuar në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, nga verifikimi rezultoi që është shlyer overdrafti marrë pranë bankave të nivelit të dytë, por nuk është kryer tërheqja e huasë dhënë A sh.a..

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

3. Gjetje nga Auditimi: DPSHTRR kryen aktivitetin e saj në bazë të Rregullores së Brendshme dhe Statutit. Rregullorja e Personelit është miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 27, datë 23.11.2012, e cila nuk është azhurnuar me ndryshimet në Statut dhe strukturë dhe nuk i përgjigjet stadi të zhvillimit të drejtorisë. Me urdhrin e Drejtorit nr. 778, datë 19.06.2018 është hartuar dhe miratuar “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të transportit rrugor” por nuk është e miratuar nga Këshilli Drejtues. Rregullorja e Brendshme vijon të jetë e miratuar vetëm nga Drejtori dhe jo nga Këshilli Drejtues.

Statuti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ka ndryshuar referuar shkresës nr. 14825, datë 07.06.2022, drejtuar Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë me lëndë “Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor” dhe miratuar ndryshimet e kërkuara nga Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr.4572, datë 21.12.2022, ose miratuar 6 muaj me vonë. Edhe pse në DPSHTRR ka patur ndryshime të vazhdueshme të “Rregullores së brendshme” apo edhe të “Strukturës së DPSHTRR” si dhe në “Statutin e DPSHTRR” vihet re se “Rregullorja e Personelit të DPSHTRR-së” nuk është përditësuar dhe (përshkrimet e punës) nuk janë miratuar në Këshillin Drejtues. Sa më sipër në mospërputhje me Pikën “m”, neni 10 “Kompetencat e Këshillit Drejtues” i Statutit, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për përmirësimet në Rregulloren e Personelit duke reflektuar ndryshimet e vazhdueshme të Rregullores së Brendshme dhe Statutit të DPSHTRR, si edhe miratimin e saj nga strukturat drejtuese duke respektuar afatet kohore, me qëllim funksionimin e institucionit sipas kërkesave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme dhe Statut të Institucionit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në lidhje me rekomandimin 3.1; Ju informojmë se Drejtoria e Burimeve Njerëzore me Urdhrin nr. 33 datë 08.01.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm, ka ngritur grupin e punës për zbatimin e menjëhershëm të rekomandimit për përmirësimet në Rregulloren e Personelit duke i reflektuar ndryshimet e vazhdueshme të Rregullores së Brendshme dhe Statutit të DPSHTRR.

Grupi i punës i ka propozuar Drejtorit të Përgjithshëm përmirësimet në Rregulloren e Personelit dhe në zbatim të germës “q”, të nenit 12 të Statutit të DPSHTRR-së, Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr.33/1 datë 11.06.2024 ka miratuar Rregulloren e Personelit, të azhurnuar me ndryshimet në Statut.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi në lidhje me zbatimin e Strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për periudhën 01.07.2021 deri më 31.12.2022, u konstatua se struktura dhe pagat e punonjësve të DPSHTRR, kanë pësuar ndryshime referuar urdhrave të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Rekrutimi i punonjësve është kryer sipas procedurave të përcaktuara që nga njoftimet, aplikimet, paraqitja e dokumentacionit dhe vlerësimi nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Megjithëse është rritur numri i shërbimeve, konstatohet rritje e numrit të punonjësve si në përbërje të Kabinetit ashtu edhe në Njësi, Drejtori dhe Sektorë. Struktura e DPSHTRR (Administrata) përbëhet nga Kabineti me 12 persona, 5 Njësi me 10 Sektorë dhe 60 persona si edhe 10 Drejtori me 27 Sektorë dhe 142 persona. Pra, struktura është e organizuar në 1 Kabinet, 5 Njësi, 10 Drejtori dhe 37 Sektorë me numër punonjësish 214 persona.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të DPSHTRR dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të analizojnë dhe vlerësojnë nevojat për numrin e punonjësve referuar strukturës organike të DPSHTRR, me qëllim uljen e numrit të punonjësve dhe shfrytëzimin me efektivitet të kohës së punës në çdo Njësi, Drejtori dhe Sektorë, pa cenuar cilësinë e shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në lidhje me rekomandimin 4.1; Ju informojmë *se Grupi i Menaxhimit Strategjik, nëpërmjet shkresës nr. 5551/1 prot., datë 17.04.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në strukturën e DPSHTRR-së dhe Drejtorive Rajonale”, ka kërkuar reduktim të numrit të punonjësve, duke shkurtuar strukturat e DRSHTRR-ve, Durrës, Korçë dhe Laç.*

DPSHTRR me qëllimi mbulimin më të gjërë të territorit të Republikës së Shqipërisë duke ofruar shërbimet e saj pranë cdo qytetari, ka riorganizuar strukturën e saj duke krijuar Degën e Shërbimeve Burrel, në DRSHTRR Dibër, si dhe duke i ardhur në ndihmë banorëve të bashkisë Belsh, nëpërmjet shtimit të Zyrës së Shërbimeve Belsh, në DRSHTRR Elbasan. Si rrjedhojë e riorganizimit për një mbulim më të gjërë territori, rezulton një rritje të numrit të punonjësve.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

5. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi në lidhje me emërimin e punonjësve në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, “Forma e Kontratës së punës”, nenit 8 të vendimit nr. 27 datë 23.11.2012, të Këshillit Drejtues, Rregullores së Personelit të DPSHTRR dhe strukturën e miratuar për rekrutimin e punonjësve, nga verifikimi i administrimit të dosjeve të punonjësve të DPSHTRR-së, Drejtorive Rajonale dhe DTSH-së u konstatua se në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm nga 7 punonjës, 4 prej tyre kanë kryer detyrën pa u pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm, Gjithashtu, mangësi u konstatuan në emërimin e punonjësve nga ku në 5 raste rezultuan mospërputhje në nivelin arsimor të punonjësve krahasuar me nivelin arsimor të kërkuar nga DPSHTRR, si dhe në drejtim të administrimit të dokumentacionit të dosjeve të personelit. Konkretisht, nga auditimi i ushtruar në 112 dosje personeli të DPSHTRR dhe Degëve Rajonale për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin ligjor, u konstatua se 17 prej tyre nuk janë të plotësuar me dokumente si certifikata, vërtetime nga prokuroria dhe gjykata, si edhe në 3 dosje mungojnë vlerësimet vjetore të punës. Po kështu u konstatua se këto dosje nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin, renditjen sipas inventarit si edhe mënyrën e mbajtjes së dokumenteve pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Sa më sipër në kundërshtim me ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm” germa “ç”, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të DPSHTRR dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për emërimin e punonjësve sipas nivelit arsimor dhe profesional referuar kërkesave të miratuara për çdo vend pune si edhe plotësimin dhe arkivimin e dosjeve me dokumentacionin ligjor-profesional me qëllim rritjen e nivelit profesional dhe realizimin e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në lidhje me rekomandimin 5.1; Ju informojmë se, nga Strukturat Drejtuese e DPSHTRR-së dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, janë marrë të gjitha masat për emërimin e punonjësve sipas nivelit arsimor dhe profesional referuar kërkesave të miratuara për çdo vend pune si dhe janë plotësuar dhe arkivuar dosjet me dokumentacionin ligjor-profesional me qëllim rritjen e nivelit profesional dhe realizimin e objektivave të institucionit.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

6. Gjetje nga Auditimi: Të ardhurat dhe shpenzimet, mbi të cilat planifikimi i tyre nuk ka qene i saktë, dhe devijanca e tyre në lidhje me realizimin është e lartë.

Shpenzimet janë rritur ndërkohë që të ardhurat janë pakësuar. Shpenzimet për vitin 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 rezultojnë me rritje të shpenzimeve në masën 21% ose 479,994 mijë lekë ndërsa për të ardhurat për vitin 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim me 11% ose 323,652 mijë lekë më tepër.

Në 12/mujorin 2022, Fitimi bruto nga aktiviteti i Drejtorive Rajonale dhe DPSHTRR arriti vlerën 577,549 mijë lekë, duke u ulur me -49,951 mijë lekë ose me 8% më pak krahasuar me Programin Ekonomik për të njëjtën periudhë të vitit.

Zërat si “Shpërblime për vjetërsi ne pune” “Gjoha dëmshpërblime” dhe “Humbje nga kursi” nuk janë planifikuar, jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të DPSHTRR, gjatë hartimit të buxheteve, të analizojnë me kujdes situatën e institucionit, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive duke marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi si dhe të kryerjen e një planifikimi të saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u bazuar dhe në vitet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 6.1 Ju informojmë se Grupi i Menaxhimit Strategjik në bashkëpunim me Sektorin e Planifikimit Ekonomik në Drejtorinë Ekonomike, kanë analizuar me kujdes situatën e institucionit duke analizuar të ardhurat sipas aktiviteteve që mbulon DPSHTRR, që parashikohen të realizohen për vitin 2024, zërat e shpenzimeve që parashikohen për vitin 2024, rezultatin financiar që parashikohet për vitin 2024, investimet ndërtimore, informatike, makineri dhe pajisje, dhe inventar ekonomik që parashikohen të realizohen për vitin 2024 sipas VKD nr. 36, datë 22.12.2023 “Për miratimin paraprak të programit ekonomiko-financiar të vitit 2024 dhe për periudhën afatmesme 2024-2026”, miratuar me shkresën nr. 10181/1 Prot datë 16.01.2024, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

7. Gjetje nga Auditimi: Nga analiza e zërave të pasqyrës së “Pozicionit Financiar” dhe analizës së të drejtave dhe detyrimeve konstatohet se institucioni ka të drejta dhe detyrime të mbartura që nga vitet 2005-2016, për të cilat nuk janë krijuar provizionime. Të drejtat janë në vlerën 19,715,496 lekë, të cilat përbëhen nga gjendjet e llogarive në fund të vitit 2022 si:

- llog. 427 “Kërkesa të tjera të arkëtueshme” paraqitet në vlerën 2,979,035 lekë, që përfaqëson detyrimet e personelit të pa arkëtuar nga Drejtoritë ose në procese gjyqësore të krijuara që nga viti 2008, ku vlerën më të madhe të detyrimeve e kanë punonjësit e Drejtorisë Rajonale Tiranë, prej 2,111,919 lekë, për të cilat nuk është marrë asnjë masë për ndjekjen, arkëtimin dhe vlerësimin e tyre, duke tejkaluar afatet e kërimit të këtyre të drejtave, pasi janë parashkuar.

- llog. sintetike “Instrumente të tjera borxhi detyrime buxheti” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 6,096,620 lekë, e cila përbëhet nga gjendja e llogarisë 4664 “Derdhur gabimisht” në vlerën 5,809,740 lekë, që përfaqëson detyrimet që kanë për kthim DRT për sa paguar më tepër tatim fitimi për vitin 2022 dhe nga sistemimi i veprimeve për shpenzim për sa faturuar tepër në vlerën 286,880 lekë.

- llog. 468/467 “Debitorë të tjerë” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 10,639,841 lekë, me një zbritje prej 2,196,247 lekë nga viti 2021, që përfaqëson detyrimet e punonjësve të lindura nga rekomandimet e KLSH dhe Ministria e linjës si edhe nga proceset gjyqësore për largimet që janë të pa arkëtuara në kohë. Për disa raste nuk është ngritur padi me pretendimin për mungesë adresash të sakta si dhe detyrime të subjekteve private për detyrime të lindura ndaj DPSHTRR të cilat janë në ndjekje në shkallë të ndryshme të gjyqësorit, vlera të cilat janë të konsiderueshme, dhe ndikojnë negativisht në rritjen e të ardhurave. Sa më sipër është vepruar jo në përputhje me SKK 6. “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara” pika 3, si dhe Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale dhe Drejtorinë Juridike të marrin masa për analizimin e hollësishëm të debitorëve, për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizik (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizikë e juridik, duke identifikuar shumat pa mundësi arkëtimi të klientëve/debitorëve të ndryshëm, si dhe të sigurojë inicimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha të drejtat me palët e treta të analizohen sipas vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin dhe likuidimin e tyre, ku të propozohen masa konkrete, duke mos e përjashtuar masat administrative si dhe të gjitha rrugët ligjore për mbledhjen ose shuarjen e tyre.

-Drejtoria e Ekonomike të marrë masa për krijimin e provizioneve për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, pasi të jenë evidentuar të dhënat për klientët/debitorët, si shumën e detyrimit, vjetërsinë e tyre dhe situatën aktuale të tyre, duke kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 7.1; Ju informojmë se Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe Drejtorinë Rajonale ka ndjekur dhe ndjek në vijimësi të gjitha rastet ku DPSHTRR është palë kreditore duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e tyre, deri në daljen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë e më pas vijimin e veprimeve të mëtejshme sipas procedurave ligjore për ekzekutimin e tyre. Gjithashtu me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023, ku është analizuar “pasqyra e pozicionit financiar”, “pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse”, “pasqyra e ndryshimeve në kapital” dhe “pasqyra e flukseve të parasë”, Sektori i Financës në Drejtorinë Ekonomike do të marrë masat për zbatimin në vijimësi sipas SKK 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara”.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

8. Gjetje nga Auditimi: Gjendja e llogarisë 460 “Hua të dhëna dhe interesa për t’u paguar” në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 429,099,135 lekë, vlerë që përfaqëson detyrimin e Albcontrol Sha për huanë e dhënë sipas VKD nr. 30, datë 22.07.2022 “Për miratimin e huadhënies së Albcontrol Sha” miratuar nga MIE me shkresën 5646/1 datë 26.07.2022. Huaja është dhënë në shumën 421,200,000 lekë dhe interesat e huasë në vlerën 7,898,236 lekë. Në lidhje me këtë huadhënie u krye auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni nga ku rezultoi se, DPSHTRR për periudhën 01.08.2022-04.01.2023 ka tërhequr shumën 429,099,135 lekë nga “B C”, nga të cilat vlera 100,000 Euro në formën e overdraftit me interes 1.5%. Në nenin nr. 4 “Detyrimet e Huamarrësit” në pikën 4.5 përcaktohet se: “Kthimi i shumës së marrë do të kryhet menjëherë me përmirësimin e situatës ekonomike të Huamarrësit (A), në llogarinë bankare të Huadhënësit, brenda muajit Dhjetor të vitit 2023”

Pika 4.6, përcakton se, “Në rast pagese me këste, kësti i parë do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Shtator 2023 në vlerën 300,000,000 lekë. Kësti i dytë do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Tetor 2023 në vlerën 300,000,000 lekë. Pjesa e mbetur do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Dhjetor 2023. Nga auditimi konstatohet se ende nuk ka filluar shlyerja e huasë si edhe nga DPSHTRR, nuk ka komunikim shkresor me Huamarrësin për kthimin e Huasë. Sa më sipër është në kundërshtim me Kontratën e Huasë nënshkruar në datën 24.08.2022 neni 4 “Detyrimet e Huamarrësit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të DPSHTRR të marrin masa për shlyerjen e Huasë nga shoqëria “Albcontrol” në respektim të kushteve kontraktuale, me qëllim shlyerjen e overdraftit të marrë nga “C. B.” dhe arkëtimin e të ardhurave të krijuara nga DPSHTRR.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 8.1; Ju informojmë se është bërë amendim kontrate të huasë midis DPSHTRR-së dhe A Sh.A, amendim i cili është miratuar me shkresën nr. 19/1 Prot, datë 16.01.2024, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi miratimin e amendimit të kontratës së huadhënies për A sh.a”.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

9. Gjetje nga Auditimi: Sipas të dhënave dhe analizës së gjendjes së llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to (detyrime ndaj furnitorëve)” në fund të vitit 2022 në vlerën 229,997,821 lekë rezulton se, detyrimet e konstatuara ndaj furnitorëve dhe klientëve për parapagime në periudhën ushtrimore janë në vlera të konsiderueshme dhe nga Drejtoria e Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 12 “Përgjegjësia menaxheriale e nëpunësve zbatues” dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për shlyerjen në kohë të detyrimeve ndaj Furnitorëve dhe Klientëve me qëllim uljen e borxhit dhe eliminimin e penalteteve të mundshme nga pagesat e vonuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Ju informojmë se, Sektori i Financës në Drejtorinë Ekonomike ka zbatuar dhe është në vëmendje për shlyerjen në kohë të detyrimeve ndaj furnitorëve sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim uljen e borxhit dhe eliminimin e penalteteve të mundshme nga pagesat e vonuara.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

10. Gjetje nga Auditimi: Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 5,835,167 lekë, gjendje e cila është regjistruar nga DR Tiranë, dhe pasqyron detyrimet e punonjësve të Drejtorisë Rajonale Tiranë, që janë në procese gjyqësore, të trashëguara prej vitit 2016. Kjo gjendje krahasuar me vitin 2021 ka rritje në vlerën

2,164,476 lekë. Për detyrimet e proceseve gjyqësore, DR Tiranë duhej të Kte provizionin për vlerën e tyre 5,835,167 lekë, jo në përputhje me SKK 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara” pika 37. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike të marrë masa të menjëhershme për njohjen në kontabilitet të vlerës së plotë të proceseve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë si shpenzime të periudhës në “Pasqyrën e performancës financiare” të institucionit dhe krijimin e provizioneve si një detyrim në pasqyrën e “Pozicionit financiar”.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 10.1; Ju informojmë se Sektori i Financës në Drejtorinë Ekonomike ka zbatuar njohjen në kontabilitet të vlerës së plotë të proceseve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë si shpenzime të periudhës në “Pasqyrën financiare” dhe është krijuar provizioni në Programin Ekonomiko-Financiar të vitit 2024, sipas VKD-së nr. 36, datë 22.12.2023 “Për miratimin paraprak të programit ekonomik-financiar të vitit 2024 dhe për periudhën afatmesme 2024-2026”, miratuar me shkresën nr. 10181/1 Prot datë 16.01.2024, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi është realizuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

11. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”, oferta e dhënë nga O.E. "A" shpk me ofertë 23,600,000 lekë pa TVSH, është shpallur ofertë anomalisht e ulët, ku pas sqarimeve të dhëna nga O.E. është pranuar si ofertë e suksesshme, ku një prokat leje qarkullimi jepet me çmimin 59 lek. Nisur nga kjo, përllogaritja e fondit limit si dhe zhvillimi i procedurave të mëparshme të ngjashme mbi blerjen e prokatit të lejeve të qarkullimit është kryer mbi një përllogaritje jo të saktë të fondit limit, duke rritur kostot e institucionit, jo në përputhje me nenin 13 “Neni 13 “Studimi paraprak i tregut”, VKM Nr. 285, Datë 19.5.2021 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Organet Drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë përllogaritjes së fondit limit të përdorin mënyrën më efektive të mundshme, si dhe në rastin kur merren oferta në treg nga O.E., të merren nga ato subjekte të cilat kanë eksperiencë në treg, në mënyrë që të shmangen aludimet mbi rritjen e fondit limit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 11.1; Ju informojmë se Sektori i Prokurimeve dhe Komisionet për Hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës, kritereve teknike të kualifikimit si dhe fondit limit për prokurimet, kanë marrë në konsideratë rekomandimin, i cili është zbatuar dhe do të vijojë të zbatohet në vijimësi. Në të gjitha prokurimet e zhvilluara në vazhdimësi është zbatuar Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Për çdo procedurë prokurimi para dërgimit për publikim të DT është marrë asistencë teknike nga APP lidhur me DT.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

12. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës me objekt “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”, sipas Procesverbalit nr. 1 në marrjen në dorëzim të prokatit të lejeve të qarkullimit, mbajtur më datë 11.06.2022, u morën në dorëzim në total 17474 copë prokat leje qarkullimi. Nga grupi i auditimit u konstatua që numri serial i marrjes në dorëzim ishte 000000096402 dhe jo 000000000001 siç duhet të ishte, duke marrë në konsideratë që është dorëzimi i parë dhe numri serial të vazhdojë nga numri 1. Sa më sipër është në kundërshtim me Nenin 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të DPSHTRR-së, Komisioni i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës, të marrë në konsideratë të gjitha kushtet e kontratës dhe të garantojë zbatimin e tyre me përpikmëri nga të dyja palët.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 12.1; Ju informojmë se komisioni i ndjekjes dhe i zbatimit të Kontratës, ka marrë në konsideratë rekomandimin i cili është zbatuar dhe do të vijojë të zbatohet në vijimësi. Në të gjitha kontratat e nënshkruara pas realizimit të prokurimit përkatës është zbatuar Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në përfundim të realizimit të kontratës nga Komisioni i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës është hartuar Raporti përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe dhe *i zbatuar*.

13. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”, Specifikimet Teknike janë të detajuara dhe në grupin e hartimit të specifikimeve teknike konstatohet se nuk është asnjë specialist i fushës për hartimin e tyre si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim nuk është asnjë pjesëtarë specialist i fushës për verifikimin e tyre për marrjen në dorëzim si dhe laboratorë për verifikimin e tyre. Sa më sipër është në mospërputhje me nenin 74 “Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë zhvillimit të një procedure prokurimi, të kenë në konsideratë që në përbërje të njësisë së prokurimit është detyrimisht, personi përgjegjës për prokurimin, dhe të paktën një specialist fushe, në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në zbatim të rekomandimit 13.1; Ju informojmë se, Sektori i Prokurimeve ka zbatuar dhe vazhdon të zbatojë në vijimësi rekomandimin e sipërcituar. Në të gjitha prokurimet është zbatuar Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në të gjitha prokurimet është përcaktuar si pjesë përbërëse e njësisë së prokurimit edhe specialist i fushës. (Përcaktuar detyrimisht në Urdhërin e Prokurimit).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe dhe *i zbatuar*.

14. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje pajisjesh për qendrat e kontrollit teknik (Furnizim-Vendosje e Makinerive dhe Pajisjeve të Testimit të Q.K.T pranë Drejtorive Rajonale), është kërkuar në lidhje me përmbushjen e kriterëve, një inxhinier mekanik, ku në dokumentin e sjellë nga O.E. “kontratë individuale”, që mban datën 06.12.2021, O.E. V A sh.p.k. me administrator z. A Z në rolin e punëdhënësit merr në punë njëkohësisht z. A Z në rolin e punëmarrësit. Sa më sipër është në mospërputhje me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të DPSHTRR-së të bëjnë të mundur verifikimin e dokumentacionit justifikues të O.E. pjesëmarrës dhe njëkohësisht fitues dhe të analizojë situatën nëse z. A Z në cilësinë e inxhinierit mekanik është tërësisht i angazhuar në përmbushjen e objektivave të kontratës dhe nuk ndikohet nga roli i tij si administrator i subjektit me të cilin operon në treg.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 14.1; Ju informojmë se Komisioni i Vleresimit të Ofertave, Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës ka zbatuar Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Referuar rekomandimit nga KLSH lidhur me këtë pikë nga Kryetari i Komisionit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës është administruar një Memo me nr. 401/1 prot., datë 08.01.2024 (bashkëlidhur planit të veprimit), ku përshkruhet mbi verifikimet dhe zbatimin e kontratës me këtë objekt. Me shkresën nr.19111 prot., datë 05.10.2023 është hartuar raporti përmbledhës mbi korrektësinë e zbatimit të kontratës me këtë objek, nga ku rezulton se z. A Z ka përmbushur të gjitha detyrimet e kontratës pa u ndikuar nga roli i tij si administrator i shoqërisë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe dhe *i zbatuar*.

15. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje letër dhe karton me logo” 2022, në dokumentet standarde të tenderit DST, në pikën 2.1.2 të kapacitetit profesional të O.E. është kërkuar Certifikata ISO 27001;2013, Sistemi Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit. Ky kriter nuk është i lidhur ngushtë dhe nuk është në përpjesëtim me objektin e prokurimit pasi natyra e objektit të procedurës ka të bëjë me blerjen e mallit e cila në asnjë moment nuk lidhet me çënimin e sigurisë së informacionit. Është lënë rekomandim nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) mbi rishikimin e këtij kriteri pasi nuk është i lidhur ngushtë dhe në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit por përsëri nuk është marrë në konsideratë nga NJP. Sa më sipër është në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohen në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përllorarit drejtë fondi limit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 15.1; Ju informojmë se Sektori i Prokurimeve dhe Komisionet për Hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës, kritereve teknike të kualifikimit si dhe fondit limit për prokurimet ka zbatuar dhe do të vijojë të zbatohet në vijimësi rekomandimi i sipërcituar. Në të gjitha prokurimet e zhvilluara në vazhdimësi është zbatuar Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për çdo procedurë prokurimi para dërgimit për publikim të DT është marrë asistencë teknike nga APP lidhur me DT ku përfshihen edhe specifikimet teknike.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe dhe *i zbatuar*.

16. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë me lote , DRSHTRR Berat, Korçë, Laç, Vlorë” u konstatua parregullsi në hartimin e kritereve në dokumentet e tenderit(DST).Më konkretisht vihet re se pothuajse në të gjitha procedurat e zhvilluara në kërkesat në lidhje me kapacitetin ekonomik/financiar kërkohet që xhiro mesatare vjetore të jetë sa dyfishi i vlerës së fondit limit të përlllogaritur. Kriter ky i cili nuk nxit pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Për sa më sipër në mospërputhje me Nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: AK, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të marrë masa që në kërkesat në lidhje me kapacitetet ekonomik-financiar, të përcaktojë qartë kufirin minimal të xhiros vjetore në përputhje me LPP dhe VKM. Pra të përcaktohen sa më qartë kërkesat mbi kapacitetet ekonomik-financiar referuar parimeve të ligjit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 16.1; Ju informojmë se Sektori i Prokurimeve dhe Komisionet për Hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës, kritereve teknike të kualifikimit ka zbatuar dhe do të vijojë të zbatohet në vijimësi rekomandimi i sipërcituar. Në prokurimet e zhvilluara është zbatuar Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. i ndryshuar. Për çdo procedurë prokurimi para dërgimit për publikim të DT është marrë asistencë teknike nga APP lidhur me DT ku përfshihen edhe kriteret mbi kapacitetet ekonomik-financiar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe dhe *i zbatuar*.

17. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë me lote, DRSHTRR Berat, Korçë, Laç, Vlorë”, afatet e lëvrimit të mallrave pothuajse në të gjitha procedurat e audituara në DST përcaktohen nga 1 deri në 45 ditë, duke bërë që numri i OE pjesëmarrës të kufizohet madje në disa raste dhe duke i shkaktuar pamundësi OE ofertues të përgatisin të gjithë sasinë e mallit me një afat kaq të shkurtër kohor të përcaktuar. Sa më sipër është në mospërputhje me Nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1 Rekomandimi: AK, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të marrë masa në përcaktimin e afateve kohore në lidhje me lëvrimitin e mallrave, të shihet e arsyeshme apo të merret në konsideratë në mënyrë të tillë që në përcaktimi i afatit të lëvrimit të mallrave të mos kufizojë numrin e OE pjesëmarrës.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 17.1; Ju informojmë se, Sektori i Prokurimeve dhe Komisionet për Hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës, kritereve teknike të kualifikimit ka zbatuar dhe do të vijojë të zbatohet në vijimësi rekomandimin i sipërcituar. Në të gjitha prokurimet është zbatuar Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Afati i lëvrimit është përcaktuar në DT ne varësi të llojit të procedurës ku edhe afati është pjesë e DT, për të cilat është marrë asistencë teknike nga APP.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe dhe *i zbatuar*.

18. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Botim manuali të përgatitur për kandidatët që do të pajisen me leje drejtimi të kategorive A1, A2, A, B1, BE, viti 2022”, kërkesa e përcaktuar në DST si më poshtë:

OE të vërtetojnë që disponojnë makineri shtypëse 61x43 formati letrës, 5C+llak. Një OE pjesëmarrës duhet të disponojë 1 pajisje shtypi të përmasa 5 Color+llak , për aq kohë sa në DST dhe specifikime teknike nuk kërkohet që mallrat e prokuruar të jenë në 5 ngjyra të ndryshme. Pra në asnjë rast nuk është kërkuar që makina shtypëse të shtyp me 5 ngjyra, njëkohësisht në shtojcën 5 të specifikimeve teknike të DST përcaktohet:

....Pjesa e brendshme e shtypur me 4 ngjyra bazë+llak Etj.

Pra specifikohet që pjesa e brendshme që do shtypet të jetë me 4 ngjyra. Për sa më sipër në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Organet Drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të tregojnë kujdes në hartimin e tyre, të bazohen në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 18.1; Ju informojmë se Sektori i Prokurimeve dhe Komisionet për Hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës, kritereve teknike të kualifikimit ka zbatuar dhe do të vijojë të zbatohet në vijimësi rekomandimi i sipërcituar. Në të gjitha prokurimet e zhvilluara është zbatuar Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për çdo procedurë prokurimi para dërgimit për publikim të DT është marrë asistencë teknike nga APP lidhur me DT ku përfshihen edhe kriteret e veçanta të kualifikimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe dhe *i zbatuar*.

19. Gjetje nga Auditimi: Në procedurën me vlerë të vogël “Blerje holli protokollar” me urdhër prokurimi nr. 8862/3 datë 23.05.2022, përllogaritja e fondit limit e kryer me testim tregu me 3(tre) oferta është në kundërshtim me VKM Nr.285 RRPP datë 19.05.2021, neni 76 ,b si dhe Udhëzimin Nr.5 datë 25.06.2021 pika 7 ku citon që përllogaritja e fondit limit bëhet duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të administruara. Në testimin e tregut të kryer nga KBV ofertat e administruara nga OE “F.. T me NIPT L.....F dhe OE “I E” me NIPT K31406014E nuk e kanë në veprimtarinë e tyre objektin të prokurimit. Sa më sipër është në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar; Udhëzim Nr.5 datë 25.06.2021 i APP.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandimi: A.K., Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, KBV në rastet e përllogaritjes së fondit limit me testim tregu me 3(tre) oferta ekonomike të verifikojë veprimtarinë në QKB të OE nga ku të përputhet veprimtaria e tyre me objektin e prokurimit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 19.1; Ju informojmë se Sektori i Blerjeve të Vogla, Komisioni i Prokurimeve me Vlerë të Vogël, ka zbatuar dhe do të vijojë të zbatojë në vijimësi rekomandimin e sipërcituar. Në të gjitha prokurimet e zhvilluara në vazhdimësi është zbatuar Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Testimi i tregut është bërë detyrimisht pas verifikimit të objektit të veprimtarisë në QKB të OE, ku nga grupi i krijuar më Urdhër të Titullarit për çdo prokurim është verifikuar përputhshmëria e veprimtarisë së tyre me objektin e prokurimit përkatës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe dhe *i zbatuar*.

20. Gjetje nga Auditimi: Në disa procedura të cilat OE ofertues nuk janë prodhues nuk është kërkuar asnjë deklaratë apo vërtetimin në lidhje me origjinën e këtyre mallrave. Më konkretisht në asnjë rast nuk vërtetohet se cili është prodhuesi në mënyrë të tillë që të vërtetohet lidhja ndërmjet prodhuesit apo distributorit të autorizuar prej tij me OE. Sa më sipër është në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar; Udhëzim Nr.5 datë 25.06.2021 i APP.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: AK, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të kërkojë në lidhje me OE ofertues, në rastet e tilla kur ato nuk janë prodhues deklaratave apo vërtetime të ndryshme mbi origjinën e mallrave që të vërtetohet lidhja ndërmjet prodhuesve apo distributorëve të autorizuar prej prodhuesit me OE ofertues në procedurat e prokurimit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 20.1; Ju informojmë se Sektori i Prokurimeve dhe Komisionet për Hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës, kriterëve teknike të kualifikimit, ka zbatuar dhe do të vijojë të zbatohet në vijimësi rekomandimi i sipërcituar. Në të gjitha prokurimet e zhvilluara është zbatuar Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për çdo procedurë prokurimi para dërgimit për publikim të DT është marrë asistencë teknike nga APP lidhur me DT ku përfshihet edhe kriteri mbi paraqitjen e deklaratave apo

Vertetime mbi origjinën e mallrave ku vërtetohet lidhja midis prodhueseve apo distributorëve të autorizuar prej prodhuesit me OE ofertues, referuar kjo llojit të prokurimit .

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe dhe *i zbatuar*.

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se janë ekzekutuar 18 vendime të formës së prerë për personat që janë larguar nga puna. Detyrimi i paguar për këto vendime të formës së prerë për periudhën objekt auditimi është **15,258,500 lekë**, konstatohet se nga këto 18 vendime, 14 prej tyre janë ekzekutuar me zyrë përmbarimore, për të cilat është shpenzuar vlera **872,389 lekë**. Janë edhe 3 vendime të tjera në fazën e Apelit, të cilat nuk kanë përfunduar. Nëse ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë do të ishte kryer me ekzekutim vullnetar do të minimizoheshin kostot në buxhetin e DPSHTRR. Sa më sipër është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të DPSHTRR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrin masa për likuidimin e menjëhershëm të detyrimeve që rrjedhin nga proceset gjyqësore përpara vendimeve të zyrave përmbarimore, me qëllim uljen e kostove të këtyre detyrimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me rekomandimin 1.1 dhe rekomandimin 1.1; Ju informojmë se DPSHTRR ka zbatuar këto 2 rekomandime, duke treguar gatishmërinë që të ekzekutojë dhe me kërkesë individuale, të palës kreditore titujt ekzekutiv dhe vullnetarisht pa kontraktuar shoqëri përmbarimore duke sjellë dokumentacionin e nevojshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor sipas ligjit, në vijim të së cilës ju informojmë se ky rekomandim është zbatuar plotësisht në praktikë, për ish punonjësit, me kërkesën e tyre vullnetare.

Ka raste, kur në vendimet gjyqësore nga gjykata është përcaktuar shprehimisht në dispozitiv ekzekutimin e tij nga shërbimi përmbarimor citojmë: “Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe ngarkohet shërbimi përmbarimor është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor për ekzekutimin e tij”, pra e ngarkon shërbimin përmbarimor si organ përgjegjës për të ndjekur procedurën e ekzekutimit të vendimit në referim të neneve 510, 511.. e në vijim të Kodit të Procedurës Civile, ku përcaktohet se për të pasur efektshmëri të titullit ekzekutiv është e nevojshme pasja e një vendimi nga Gjykata kompetente për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit. Në të kundërt, ekzekutimi i titullit nuk mund të bëhet.

Pasi vendoset lëshimi i urdhërit të ekzekutimit nga Gjykata kompetente, vijohet me fazën e fundit të procedurës civile, pikërisht të ekzekutimit. Organi procedurës në këtë fazë është shërbimi përmbarimor i cili kontraktohet nga kërkuesi/kreditore në bazë të kërkesës së tij.

Gjithashtu, DPSHTRR ka marrë masa për zbatimin e titullit ekzekutiv konform kuadrit ligjor në fuqi duke njoftuar të gjitha drejtoritë rajonale në varësi, që në rast se bëhen pengesë në ekzekutimin e titullit ekzekutiv të sjellë nga shërbimi përmbarimor jashtë afateve, personat përgjegjës që bëhen pengesë në ekzekutimin e titullit ekzekutiv do të paguajnë shumën e detyrimit shtesë të përmbarimit.

Bazuar në nenin 511 “Urdhëri i Ekzekutimit” të Kodit të Procedurës Civile “Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, i cili: a) për rastet e parashikuara nga shkronja “a” dhe “b”, të nenit 510, të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin në dispozitivin e vendimit; b) për vendimet e gjykatave të shteteve të huaja e të gjykatave të arbitrazhit të huaj, që u është dhënë fuqi në zbatimin të dispozitave të këtij Kodi, urdhri i ekzekutimit lëshohet nga gjykata që bën njohjen e vendimit, në dispozitivin e vendimit. Nuk lëshohet urdhër ekzekutimi për vendimin e sigurimit të padisë dhe për gjokat e dhëna nga gjykata, vendimet për marrjen e detyrueshme të provës, vendimin në pjesën që urdhëron shpenzimet gjyqësore, si dhe vendimet civile të gjykatës, të dhëna për ekzekutim të përkohshëm, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga shërbimi përmbarrimor, pas njoftimit të vendimit. Shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit zhvillohet nga gjyqtari pa praninë e palëve. Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit, bazuar mbi dokumentet e depozituara nga kërkuesi. Urdhri i ekzekutimit përmban: a) gjenealitetet e debitorit dhe kreditorit; b) origjinën e detyrimit; c) detyrimin konkret që buron nga titulli ekzekutiv deri në momentin e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit; d) kur titulli ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhri i ekzekutimit, është akt për dhënie kredie bankare ose detyrime monetare, Gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

-Nenin 515 “Vënia në ekzekutim” të Kodit të Procedurës Civile: “Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbarrimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbarruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit. Kreditori, përveç kërkesës për ekzekutim, duhet të paraqesë: a) titullin ekzekutiv (origjinal ose i noterizuar); b) urdhrin e ekzekutimit (origjinal); c) pagesën e tarifës sipas paragrafit të parë të nenit 525 të këtij Kodi; ç) sipas rastit, prokurën e personit, që përfaqëson palën kreditore. Kur nuk plotësohen në rregull dokumentet e mësipërme për vënien në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit, përmbarruesi i le kërkuessit një afat 5-ditor për plotësimin e mangësive...”

Gjatë kohës në pritje të gjykimit të rekursit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, njoftohemi me shkresë “Lajmërim për ekzekutim vullnetar” nga shërbimi përmbarrimor për ekzekutimin e vendimit brenda afatit 5 (pesë) ditor, DPSHTRR para se të ekzekutojë vendimin brenda afatit të përcaktuar nga shërbimi përmbarrimor në zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bën kërkesën për “Pezullim ekzekutimi të vendimit” duke qenë se DPSHTRR është institucion shtetëror me statusin e personit juridik publik me vetëfinancim, ka garancinë financiare për ekzekutimin e vendimit nëpërmjet kësaj kërkesë, citojmë nenin 479 të K.Pr.Civile: “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit (Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017) 1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur: a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit...”, si dhe duke i’u referuar nenit 469 “Pezullimi i ekzekutimit” citojmë: “Kur prishet vendimi i shkallës së parë dhe çështja dërgohet për rigjykim, pezullohet ekzekutimi i vendimit. Gjykata e apelit me kërkesën e palës mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit edhe kur ajo le në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, kur kundër vendimit të saj bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë dhe nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit mund të vijjnë pasoja të rënda ose të pariparueshme, si dhe kur pala që ka bërë rekursin jep garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit” ku i takon Gjykatës së Lartë të shprehet mbi këtë kërkesë për ekzekutimin e vendimit apo pezullimin e tij për shkaqe të përligjura.

Në rastet kur Gjykata e Lartë ka vendosur pezullimin e vendimit siç kemi pasur raste të tilla DPSHTRR ka pezulluar ekzekutimin e vendimit deri në shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë.

Theksojmë se kemi ndjekur me përpikmëri zbatimin dhe ezaurimin e të gjitha dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për ndjekjen e çështjes gjyqësore, ushtrimin e të drejtës ligjore të ankimit, Rekursit e deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda afateve të përcaktuara nga Shërbimi Përmbartimor Shtetëror apo Privat në shkresën lajmërimin për ekzekutim vullnetar.

Për sa më lart, ekzekutimi i një titulli ekzekutiv vullnetarisht pa shërbimin përmbartimor (shtetëror/privat) nga DPSHTRR pa kërkesë të kreditorit nuk është e bazuar në asnjë dispozitë të Kodit të Procedurës Civile që parashikon procedurën e ekzekutimit të titujve ekzekutiv. Pra, është e domosdoshme kërkesa e kreditorit për ekzekutimin vullnetar të vendimit.

Nuk është në diskrecion të DPSHTRR të ndjek procedurën e ekzekutimit pa pasur të gjitha të dhënat e domosdoshme të kreditorit si llogari bankare aktive për xhirimin e detyrimit, si dhe mbi të gjitha të destinuara vullnetin e kreditorit që të ekzekutojë vendimin gjyqësor duke sjellë kërkesë të thjeshtë pranë DPSHTRR me dokumentacionin përkatës apo të kontraktuara shërbimin përmbartimor sipas ligjit dhe dispozitivit të vendimit të gjykatës që e ngarkon këtë të fundit shprehimisht.

DPSHTRR ka treguar gatishmërinë që të ekzekutojë dhe me kërkesë të palës kreditore titujt ekzekutiv dhe vullnetarisht pa kontraktuar shoqëri përmbartimore duke sjellë dokumentacion e nevojshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor sipas ligjit, konkretisht: dokument identifikimi, kopje të vendimit të gjykatave respektive, dokumenta në lidhje me ekzekutimin, kërkesë individuale, të dhëna mbi numrin e llogarisë bankare, etj.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

2. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karta memorie për tahografët digjital, viti 2021”, Çmimi i aplikimit i përcaktuar nga Udhëzimi i përbashkët të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr. 9785/1 datë 01.06.2022 dhe me nr.12 datë 30.05.2022 është 40 euro ose 4,821 lekë më pak se çmimi i kontratës lidhur ndërmjet AK dhe OE “C d.d”. Pra për sa më sipër nga çmimi i aplikimit të përcaktuar nga udhëzimi përbashkët si dhe çmimit të kontratës së lidhur, për sasinë prej 6000 karta memorie tahograf digjital AK ka humbur $6000 \times 4,821 = 28,926,000$ lekë, jo në përputhje me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të DPSHTRR-së, në lidhje me vendosjen dhe përcaktimin e çmimit të përdorimit të kartës së memories së tahografëve, të marrin në konsideratë rrethanat dhe faktorët e tjerë, se cila është kategoria që është e prekur nga vendosja e këtij çmimi dhe se sa implikohet kjo kategori në lidhje me këtë çmim, duke qenë se impakti kryesisht është në biznese dhe jo në individ.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit 2.1; Ju informojmë se, Organet drejtuese të DPSHTRR-së, janë në proces të analizës së kostos për kartat e memories së tahografëve. Gjithashtu oragnet drejtuese janë në fazën e analizimit të rrethanave dhe faktorëve të cilët preken nga ndryshimi i tarifës së kartës së memories së tahografëve.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

C. MASA DISIPLINORE:

C.1. Për punonjësit në marrëdhënie pune

C.1.2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuara në ligje të veçantë.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; germat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, *i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR*, që bazuar në performancën e punonjësve dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësive dhe marrjen e masave disiplinore si vijon:

Masë disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Paralajmërim për largim nga puna” për punonjësit e mëposhtëm:

znj. A Gj, në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt:

- “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore” në mospërputhje me Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

znj. B Gj, në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt:

- “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”
- “Blerje Letër dhe Karton me logo” në mospërputhje me Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

z. A N në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt:

- “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore” në mospërputhje me Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

z. R S në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt:

- “Blerje Letër dhe Karton me logo” në mospërputhje me Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

z. F S në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt:

- “Blerje Letër dhe Karton me logo” në mospërputhje me Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt:
- “Botim Manuali të përgatitur për kandidatët që do të pajisen me leje drejtimi të kategorive A1, A2, A, B1, BE” në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

z. F P, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt:

- “Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë në lote” në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

z. M K, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt:

- “Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë në lote” në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

znj. J J, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt:

- “Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë në lote” në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

z. J V, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt:

- “Botim Manuali të përgatitur për kandidatët që do të pajisen me leje drejtimi të kategorive A1, A2, A, B1, BE” në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

z. E B, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt:

“Botim Manuali të përgatitur për kandidatët që do të pajisen me leje drejtimi të kategorive A1, A2, A, B1, BE” në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Përgjigjja e institucionit:

Mungon

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pa zbatuar*.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit kryer prej grupit të auditimit të KLSH-së rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) 20 Masa Organizative me 23 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit 17 zbatuar dhe 6 pjesërisht zbatuar.
- b) 2 Masa për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficiencës dhe Efektivitetit me 2 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit 2 zbatuar pjesërisht
- c) 1 Masë disiplinore me 1 rekomandim dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit i pa zbatuar.

Për sa më sipër ri kërkojmë që, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar brenda 3 mujorit të pare të vitit 2025, si dhe kërkojmë analizimin dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.6 OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Operatorin e Sistemit të Transmetimit SHA**, mbi “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023*” për auditimin e kryer në vitin 2023, për periudhën objekt auditimi 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr.222/12 prot., datë 27.07.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
 - a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
 - b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
 - c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve;
 - ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe manualit “*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve*”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 222/1 Prot., datë 16.03.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. E.S (Përgjegjësi i Grupit)
2. J.B, anëtar

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr.222/12 datë 27.07.2023, protokolluar në subjektin e audituar me nr.1583/9 datë 31.07.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLuzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Operatori i Sistemit të Transmetimit Sh. A, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr.222/12 Prot., datë 27.07.2023, rezulton se, nga **18** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi, 3-E dhe Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **18** masa të rekomanduara ose 100 %. **Nga të pranuarat (18):** janë zbatuar plotësisht **4**, masa ose 22.2 % e tyre dhe zbatuar pjesërisht **14** masa ose 77.8 % prej tyre.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
1	Organizative	14 masa	3	11	
2	Shpërblim dëmi	2 masa 1,040,000 lekë lekë	1 237,600 lekë	1 802,400 lekë	
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	1 masë	-	1	
4	Masa Disiplinore	1 masë	-	1 masë	
	Gjithsej	18 masa	4 masa	14 masa	

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 22.2 % , niveli i rekomandimeve pjesërisht zbatuar është 77.8 %.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimt) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Operatori Sistemit të Transmetimit sha, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën Nr. 1583/12 Prot. datë 08.08.2023.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna dhe dërguar në KLSH me shkresën me nr.897 prot., datë 08.02.2024, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Operatorin e Sistemit të Transmetimit administruar në KLSH me nr. 1188/6 prot., datë 07.08.2019, janë rekomanduar gjithsej:

- 27 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 8 masa, në proces zbatimi 18 masa dhe të pa zbatuara 1 masë.

- 5 masa shpërblim dëmi, nga të cilat janë zbatuar 4 masa, në proces zbatimi 3 masa në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “j”.

1.1 Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” për përmirësimin e gjendjes së

shoqërisë, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimit që rezultoi i pazbatuar, nxjerrjen e përgjegjësive dhe shkakut përse nuk është zbatuar si dhe përshejtimin e atyre në proces zbatimi.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1583/11 Prot, datë 08.08.2023, të gjithë departamenteve/drejtorive përkatëse në OST ju është përcjellë për zbatim tabela e evadimit të masave të lëna nga KLSH, duke i kërkuar përmbushjen e tyre sipas afatit të përcaktuar.

Komenti i grupit të auditimit.

Rekomandimi 8.1 i pazbatuar, është evidentuar në Raportin Përfundimtar Nr.548/22 datë 16.05.2022 të KLSH, në procedurën me objekt “Punime dalje shtesë e re e N/Stacionit 110 kV, Librazhd, shtesë trakti të ri i linjës 110 kV në N/Stacionin Fibër dhe rikonstruksion i linjës 110 kV me dy qarqe Fibër-Librazhd”. Referuar rekomandimit të sipërcituar, nga ana e autoritetit kontraktor duhet të bëhen analiza kosto-përfitim për kontratat e parashikuara. Projektzbatimi dhe preventivi i punimeve duhen realizuar para hapjes së procedurës së prokurimit, duke qenë se punimet e nënstacioneve dhe të linjave janë të standardizuara në tërësi.

Nga auditimi është konstatuar si më poshtë:

- Administratori i OST SHA me anën e shkresës nr.1325/19 prot., datë 26.05.2022 ka përcjellë për zbatim në departamentet përkatëse, planin e veprimit nr.1325/18 prot., datë 26.05.2022, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

- Me shkresën nr.7112 prot., datë 24.11.2022, OST ka përcjellë për miratim në Entin Rregullator të Energjisë Planin e Investimeve të Shoqërisë për periudhën 2022-2024.

Lidhur me investimet në OST zbatohen procedurat e Rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve”, miratuar me Vendimin Nr.135 datë 0609.2017 të ERE. OST ka përfshirë në këtë plan analizën kosto-përfitim të investimeve që do të kryhen gjatë periudhës kohore 2022-2024 në nënstacionet dhe linjat e OST. Mbi bazën e këtij plani investimesh që miratohet me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE, OST planifikon dhe prokuron kontratat e ardhshme për punimet e nënstacioneve dhe të linjave.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

2. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të pikës 4 të Programit të Auditimit “Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve”, në lidhje me rekrutimin e punonjësve të rinj, nuk janë ndjekur procedurat e percaktuara në Manualin e Burimeve Njerezore. Deri në perzgjedhjen e tyre nuk ka as informacion apo dokument apo gjurme si janë kryer keto procedura; nuk është e qarte dhe transparente sepse nuk ka të dokumentuar hapat që ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj. Gjithashtu nuk u evidentua ndonjë gjurmë që sektorëve/departamenteve përkatëse ju ka lindur nevoja për rekrutimin e punonjësve të rinj. Gjatë auditimit të dosjeve të personelit dhe të dokumentit mbi “Detyrat funksionale dhe Kriteret e punësimit për pozicionet e punës”, perzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj; Për sa më sipër është vepruar jo në mospërputhje me Manualin e Burimeve Njerezore nr. 7862 Prot., datë 27.12.2016, i ndryshuar.

2.1 Rekomandimi: OST sh.a. gjatë hartimit të strukturës organizative të aparatit qendror të OST sh.a dhe njësive të vartësisë, dhe në momentin e plotësimit të strukturës me punonjës të rinj, të marrë në konsideratë nevojat e sektorëve/departamenteve dhe njësisë së vartësisë, kriteret e vendosura dhe të miratuara nga Këshilli Mbikqyrës si dhe në Manualin e Burimeve

Njerëzore si dhe të kryejë procedurat sipas metodave më të mira dhe më të drejta, për zhvillimin e tyre me transparencë të plotë dhe konkurrencë të plotë duke përzgjedhur kandidatin e duhur sipas nevojave të institucionit që të arrijnë efikasitetin e plotë me qasjen me burimet njerëzore të duhura sipas nevojave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Me Urdhër të Brendshëm nr.340, datë 19.10.2023, është ngritur grupi i punës për rishikimin e Manualit të Burimeve Njerëzore për punonjësit e OST, ku janë pasqyruar të gjitha ndryshimet e nevojshme, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në mënyrë që rekrutimet të kryhen në mënyrë transparente me synimin për të përzgjedhur kandidatin e duhur sipas nevojave të shoqërisë.

Me Urdhër të Brendshëm nr.448, datë 29.12.2023, janë miratuar ndryshimet e Manualit të Burimeve Njerëzore. Aktualisht, Drejtoria e Burimeve Njerëzore është në fazën e zbatimit të tij nëpërmjet hapjes së procedurës dhe më specifikisht hapi pasues lidhet me hartimin e Urdhrit mbi përbërjen e Komisionit për Rekrutimet. Gjithashtu, ju informojmë se çdo procedurë rekrutimi që është zhvilluar gjatë kësaj periudhe, është shoqëruar me shkresën shpjeguese dhe arsyen e nevojës për punësim nga sektori përkatës teknik. Rekomandimi është duke u zbatuar në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit.

Me anë të Urdhërit të Brendshëm nr.340, datë 19.10.2023 është ngritur grupi i punës për rishikimin e Manualit të Burimeve Njerëzore për punonjësit e OST. Grupi i punës kishte pasqyruar të gjitha ndryshimet e nevojshme me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në mënyrë që rekrutimet të kryhen në mënyrë transparente me synimin për të përzgjedhur kandidatin e duhur sipas nevojave të shoqërisë.

Keto ndryshime janë miratuar me Urdhër të Brendshëm nr.448, datë 29.12.2023.

Me Urdhër të Brendshëm Nr.93, datë 06.03.2024 është ngritur Komisioni për ndjekjen e procedurave të rekrutimit, bazuar në Dokumentin me nr.6694/1 Prot., datë 29.12.2023 “Manuali i Burimeve Njerëzore të OST SHA”. Rekomandimet e KLSH janë reflektuar në procedurat e ndjekura për punësimin e punonjësve të rinj në OST sikurse vërtetohet në procedurat e ndjekura për 2 nga punonjësit e rinj (S.S dhe M.Xh). Bashkëlidhur dokumentacioni provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

3. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të Pasqyrave Financiare, në vlerësimin e aseteve, vihet re që OST sh.a. nuk i ka regjistruar të gjitha pronat në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Ndërtimet në proces përfaqësojnë ndërtimin e aktiveve të transmetimit, duke përfshirë kryesisht linja transmetimi dhe nënstacione në mospërputhje me SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale.

Njohja e aktiveve afatgjata materiale behet me vlerën e drejte në mënyrë periodike çdo 5 vjet.

3.1 Rekomandimi: OST, të bëjë të mundur ndjekjen dhe finalizimin e të gjitha procedurave në lidhje me regjistrimin e pronave në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në lidhje me këtë rekomandim, ju bëjmë me dije se, pas ndarjes së OST sh.a nga KESH sh.a në vitin 2004, në vitet në vazhdim ka vijuar procesi i kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme në emër të OST sh.a. Disa nga pronat janë kaluar në emër të OST sh.a dhe një pjesë janë në proces. Nga ana e OST SHA janë kryer aplikimet për regjistrimin e pronave në emër të OST sh.a që në vitin 2015. Meqenëse ky është një proces që finalizohet nga ASHK

duke kryer regjistrimin e tyre ose duke kërkuar informacione shtesë, OST ka ndjekur në mnëyrë të vazhdueshme vijimësinë e aplikimeve të kryera nga ana e saj. Në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.21956 Prot., datë 22.11.2022 “Për përfundimin e regjistrimit të pronave”, OST ka përcjellë pranë MFE në Janar 2023, informacionin në lidhje me procesin e kalimit të pronesisë në emër të OST (shkresa nr.319 prot. date 16.01.2023). Me miratimin e VKM Nr.28, datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të perditesimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, OST sh.a ka ngritur një grup pune me qëllim vazhdimin dhe përmbylljen e të gjitha procedurave me ASHK mbi regjistrimin dhe rifreskimin e pronave në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Konkretisht, në zbatim të Urdhrit të Brendshëm nr.79, datë 17.03.2023 “Për ngritjen e grupit të punës me qëllim përditësimin e pronave”, grupi i punës është duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshme për përditësimin e pronave pranë ASHK-ve, referuar VKM nr.28, datë 27.01.2023. Rekomandimi është në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit.

Pas ndarjes së OST SHA nga KESH SHA në zbatim të Urdhërit Nr.586, datë 01.08.2008 të Ministrit METE, në vitet në vazhdim ka vijuar procesi i kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme në emër të OST. Disa nga pronat janë kaluar në emër të OST dhe një pjesë janë në proces. Nga ana e OST janë kryer aplikimet për regjistrimin e pronave në emër të OST që nga viti 2015.

Në zbatim të Urdhrit të Brendshëm nr.79, datë 17.03.2023 “Për ngritjen e grupit të punës me qëllim përditësimin e pronave”, grupi i punës vijon të ndjekë të gjitha hapat e nevojshme për përditësimin e pronave pranë ASHK-ve, referuar VKM nr.28, datë 27.01.2023.

Meqenëse ky është një proces që finalizohet nga ASHK duke kryer regjistrimin e tyre ose duke kërkuar informacione shtesë, OST ka ndjekur në mnëyrë të vazhdueshme vijimësinë e aplikimeve të kryera nga ana e saj.

Në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.21956 Prot., datë 22.11.2022 “Për përfundimin e regjistrimit të pronave”, OST ka përcjellë pranë MFE në Janar 2023, informacionin në lidhje me procesin e kalimit të pronesisë në emër të OST (shkresa nr.319 prot. datë16.01.2023). Gjithashtu, janë bërë kërkesa për regjistrim në ASHK Dibër, ASHK Rurale Tiranë etj. Bashkëlidhur dokumentacioni provues.

Me shkresën nr.3372 Prot., datë 10.06.2024 OST drejtuar MIE, KESH SHA dhe ASHK është sqaruar dhe vërtetuar (Plan vendosja e pronës është hartuar me ekspert topograf privat) se në formularin për inventarizimin e pronave të paluajtshme përmasat e pronës nënstationi elektrik 220/110 kV të Vaut të Dejës në seksionin ¼ është 15300 m² dhe jo 5300 m². Shkrimi në formular lapsus dhe ka penguar regjistrimin e pronës.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

4. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re që në zërin Hua për palët e treta që lidhet me huan e dhënë për Albgaz sh.a me vendimin nr. 22, datë 13 qershor 2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a. Afati i maturimit të kredisë është dy vite. Sipas marrëveshjes mes OST dhe A Sh.a. huamarrësi ka për detyrë kthimin e shumës së plote të huas me norme interesi 0 (zero) tek huadhënësi brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje. Me date 22/10/2019 është firmos Amendimi Nr.1 i marrëveshjes së mësipërme sipas të cilit Huamarrësi ka për detyrim kthimin e shumës së plote të huas tek Huadhënësi me norme interesi zero brenda tre viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes si dhe dy amendimeve të tjera, në mospërputhje me Vendimi nr. 22, datë 13 qershor 2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OST SHA.

4.1 Rekomandimi: OST sh.a., të marrë të gjitha masat mbi kthimin e shumës së plotë të huas nga Albgaz sh.a., duke iu përmbajtur kushteve të kontratës, dhe në rast të moskthimit të shumës nga ana e tyre të marrë masat mbi vendosjen e kamatëvonesave ose penalizimeve sipas kushteve të kontratës

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Me shkresë nr.4398 Prot., datë 18.08.2023, OST i është drejtuar shoqërisë “A” SHA për shlyerjen e huasë sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve. Në përgjigjen e saj, nr.89 Prot., datë 18.08.2023, në pamundësi të shlyerjes së këtij detyrimi, shoqëria Albgaz kishte kërkuar zgjatjen e afatit të marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve.

Në datë 15.01.2024, në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr.20, datë 27.12.2023, është nënshkruar Amendimi nr.4 i marrëveshjes së lidhur ndërmjet OST dhe Albgaz, me anë të të cilit është zgjatur afati i shlyerjes së huasë (shkresa bashkëlidhur). Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit.

Marrëveshja e huasë, me objekt dhënia e huasë pa interes në vlerën prej 20,000,000 lekë, nr.3330 Prot., datë 14.06.2017, ndërmjet A SHA huamarrësi dhe OST SHA huadhënësi, është lidhur në zbatim të Urdhërit Nr.5286 datë 01.06.2017 të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Nga auditimi, në analizën e llogarisë 2660001-Kredi dhënie, 01-Administrata Qëndrore, balanca totale është 20,000,000 lekë, që tregon se nuk ka filluar ende shlyerja e kredisë.

Me shkresën nr.4398 Prot., datë 18.08.2023, OST i është drejtuar shoqërisë “A” për shlyerjen e huasë sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve. Në përgjigjen e saj, me anë të shkresës nr.89 Prot., datë 18.08.2023, në pamundësi të shlyerjes së këtij detyrimi, shoqëria “Albgaz” ka kërkuar zgjatjen e afatit të marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve.

Në datë 15.01.2024, në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr.20, datë 27.12.2023, është nënshkruar Amendimi nr.4 i marrëveshjes së lidhur ndërmjet OST dhe Albgaz, me anë të të cilit përsëri është zgjatur afati i shlyerjes së huasë. Bashkëlidhur do të gjeni praktikën e plotë të marrëveshjes me Albgaz sh.a.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

5. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re një rritje në riskun mbi likuiditetin që përcaktohet si risku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. OST është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Nga ana tjetër, shoqëria përballet me vonesa të konsiderueshme në arkëtimet e shitjeve që i ka bërë OSHEE Sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë.

5.1 Rekomandimi: OST sh.a., të marrë të gjitha masat mbi arkëtimin e shitjeve që i ka bërë OSHEE sh.a. për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike si dhe në rast të vonesave mbi arkëtimin e tyre të marrë masat mbi vendosjen e kamatëvonesave duke iu përmbajtur kushteve të kontratës.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në vijim të zbatimit të këtij rekomandimi ju bëjmë me dije se, OST i është drejtuar OSHEE Group, MFE si dhe MIE me shkresën nr.4335 Prot., datë 15.08.2023 me anë të së cilës kërkohet shlyerja e detyrimeve të papaguara.

Në vijim, të dyja ministritë si MFE ashtu dhe MIE i janë drejtuar OSHEE Group respektivisht me anë të shkresave nr.14974/1 Prot., datë 22.08.2023 dhe nr.4335, datë 15.08.2023, ku kërkohet përmbushja e detyrimeve të paguara.

Deri në këto momente, marrëveshjet për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të lidhura ndërmjet OST – OSHEE, OST – KESH kanë gjetur zbatim, duke respektuar afatet dhe vlerat e përcaktuara në to. Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit.

Detyrimi i prapambetur i OSHEE ndaj OST deri në datën 31.12.2020 ishte në vlerën prej 9,687,768,309 lekë. Në Marrëveshjen Nr.3881 Prot., datë 15.04.2021 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, ndërmjet OSHEE Group dhe OST SHA është përcaktuar që shlyerja do të ishte jo më pak se 360 mil lekë/vit.

Nga auditimi, gjëndja e detyrimit të prapambetur në datën 30.12.2023 është në vlerën 17,210,504,045 lekë.

Në informacionin nr.284/5 Prot., datë 13.06.2024 të Administratorit të OST theksohet se vlera e detyrimeve që OSHEE Group ka kundrejt OST në total është rreth 18.6 miliard lekë.

Sa më sipër, niveli i detyrimit të prapambetur jo vetëm nuk po ulet por po rritet edhe më tej, gjë që tregon parregullsi në pagesa, pavarësisht nga detyrimi i disballancave që krijohet gjatë rrugës.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

6. Gjetje nga Auditimi: Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “*Rinovimi i suportit dhe licensave të platformës elektronike financiare, burimeve njerëzore, archive elektronike dhe sistemit të menaxhimit të dokumenteve*”, gjatë verifikimit të dokumentacionit të ngarkuar në sistem nga ana e O.E. fitues, në lidhje me pikën 2.3.3 në Kriteret e Vecanta “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij*”, O.E. fitues ka paraqitur deklaratë nga Zyra e përfaqësuesit O në Shqipëri, O N, B.V. A R O. Nga hulumtimet e kryera nga grupi i auditimit në faqen zyrtare të kompanisë Oracle, O.E. nuk rezultoi të jetë partner i kompanisë Oracle, ashtu siç deklaroi.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë certifikimet si me poshtë:
- sisteme Oracle ERP;
- sisteme BI;
- infrastructure Cloud;
- sisteme ERP Cloud;
- sisteme për rrjetin e shpërndarjes (Supply Chain);
- Certifikata e lëshuar nga Tatimet dhe AKSHI si prodhues dhe për mirëmbajtjen e softuerike për fiskalizimin me dhe pa para në dore, faturën elektronike si dhe faturën shoqëruese (që ofertohej).

periodha e vlefshmërisë së certifikimeve të mësipërme është deri më 29 Mars 2023, periudhë që nuk e mbulon të plotë shërbimin 1 vjeçar të Rinovimit të suportit dhe licensave në mospërputhje me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

6.1 Rekomandimi: OST, në rastin e vlerësimit të ofertave të kryhet vlerësim i drejtë dhe transparent duke u bazuar në bazën ligjore dhe udhëzimet përkatëse si dhe duke i dhënë gjithmonë përparësi ofertave më të ulëta në rast se përmbushin dokumentacionin e plotë të

kërkuar dhe në rastin kur oferta është e dyshimtë mbi përmbushjen e disa kritereve ose specifikimeve, të kërkohet informacion më tepër në lidhje me të, deri në sqarim e plotë të rastit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me këtë rekomandim ju bëjmë me dije se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, në mënyrë të pavarur. Megjithatë, kur ky Komision ka patur nevojë për sqarime, Drejtoria e Prokurimeve apo Njësia e Prokurimit i është përgjigjur menjëherë kërkesave të Komisionit duke sqaruar edhe parashikimet ligjore të legjislacionit në fuqi për prokurimet publike, duke vënë gjithashtu në dispozicion edhe Udhëzimet dhe Rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik. Vendimet e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mund të janë objekt ankese, në rastin kur ka pretendime për vlerësim të gabuar dhe ato shqyrtohen nga një Komision tjetër i ngritur nga Autoritetit Kontraktor ose nga institucione të jashtme siç janë Komisioni i Prokurimit Publik apo Gjykata.

Në rastet e nevojshme, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund t'i drejtohet Operatorit Ekonomik ofertues me anë të një kërkesë për sqarim, sipas parashikimeve të nenit 92, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, në rastet kur ka qenë e nevojshme, KVO ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shtesë për deklaratimet e bëra nga OE ofertues në procedurën e prokurimit. Konkretisht, në procedurën e prokurimit me objekt “Implementimi dhe zgjerimi i sistemeve të sigurisë së informacionit MFA, ZTNA, SIEM”, me Nr. REF-01309-04-15-2024, anëtarë i KVO i ka kërkuar ofertuesit, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, për të paraqitur dokumentacion mbështetës provues për deklaratimet e bëra nga Operatori Ekonomik.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga auditimi, në procedurën REF-01309-04-15-2024, me objekt “Implementimi dhe zgjerimi i sistemeve të sigurisë së informacionit MFA, ZTNA, SIEM”, nga ana e OE ofertues është paraqitur dokumentacioni i kërkuar, me anë të shkresës Nr.252 Prot, datë 21.05.2024 e cila administrohet në dosjen e procedurës së prokurimit. Bashkëlidhur dokumentacioni provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*

7. Gjetje nga Auditimi: Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi privat i sigurisë fizike”, në vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit ngarkuar në sistem nga O.E. fitues të procedurës u konstatua që në dokumentacionin e sjellë nuk citohet se cilët do jenë punonjësit me të cilët do të realizohet shërbimi, por janë mjaftuar me certifikatat për punonjës shërbimi, ku për të cilët janë sjellë në tërësi të gjitha certifikatat e lëshuara për të gjithë punonjësit e O.E. Lista e punonjësve do të bënte të mundur dhe verifikimin nëse këto punonjës nuk janë angazhuar në kontrata të tjera të lidhura nga O.E. Gjithashtu nuk është kërkuar një listëpagesë e punonjësve e shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe një deklaratë bankare, pasi nga O.E. deklarohet që pagesa për punonjësit është në vlerën 66,359.88 lekë/roje/muaj. Për sa më sipër në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

7.1 Rekomandimi: OST SHA, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të marrë në konsideratë të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të detajuara të nevojshme si dhe gjatë vlerësimit të ofertave të bëjë testet dhe verifikimet përkatëse me çdo institucion tjetër në lidhje me deklaratat e lëshuara nga O.E. pjesëmarrës.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me këtë rekomandim, ju bëjmë me dije se, Njësia e Prokurimit e ngritur rast pas rasti, ku në përbërje të saj ka gjithmonë specialistë të fushës përkatëse objekt prokurimi, harton

kriteret e nevojshme duke u bazuar në kërkesën e paraqitur dhe specifikimet teknike përkatëse. Vlerësimi i ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mund të kërkojë edhe sqarim të deklaratave të paraqitura nga ana e Operatorëve Ekonomikë ofertues, ku në raste të tilla, janë kërkuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, nëse Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të dyshojë në vërtetësinë e dokumenteve apo kur është e nevojshme për sqarimin e ofertës së ofruar.

Komenti i grupit të auditimit.

Me shkresën nr.1583/11 Prot, datë 08.08.2023, të gjithë departamenteve/drejtorive përkatëse në OST ju është përcjellë për zbatim tabela e evadimit të masave të lëna nga KLSH, duke i kërkuar përmbushjen e tyre sipas afatit të përcaktuar.

Nga ana e Drejtorisë së Prokurimeve ende nuk kemi masa konkrete apo komunikime me departamentet e tjera, sipas planit të veprimit bashkëlidhur me njoftimin e sipërcituar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

8. Gjetje nga Auditimi: Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “Suport, licenca dhe mirëmbajtje për pajisjet Hardëare”, në hartimin e kriterëve të vecanta janë përfshirë në kriterin 2.3.4 Përdorimi i termit në këtë rast certifikuar nga prodhuesi kufizojnë konkurrencën dhe nuk janë në përputhje me objektin e kontratës dhe vlerën e kontratës. Procedura e hapur e thjeshtuar nuk duhet të ketë shumë kriterë, në mënyrë që të jetë e mundur përfshirja e biznesit të vogël dhe të mesëm në kundërshtim me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

8.1 Rekomandimi: OST gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të mirëmbajtjes së pajisjeve hardëare, të krijojë kushte me gjithëpërfshirëse, pasi vendosja e kriterëve të cilët kërkojnë certifikime të prodhuesve pengojnë zhvillimin e një gare dhe konkurrence të drejtë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me këtë rekomandim, ju bëjmë me dije se, Njësia e Prokurimit që ngrihet rast pas rasti, angazhohet për të vënë gjithmonë kriteret minimale të nevojshme, në mënyrë që Operatori Ekonomik ofertues të disponojë kapacitet e nevojshme për realizimin e procedurës së prokurimit. Në rastet kur çmohet se është e domosdoshme që të disponohen punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve/shërbimeve që ofertoohen, do të pranohet në vijimësi gjithashtu mundësia, që këto punonjës të kenë certifikimet ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuara/certifikuara për dhënien e tyre.

Komenti i grupit të auditimit.

Me shkresën nr.1583/11 Prot, datë 08.08.2023, të gjithë departamenteve/drejtorive përkatëse në OST ju është përcjellë për zbatim tabela e evadimit të masave të lëna nga KLSH, duke i kërkuar përmbushjen e tyre sipas afatit të përcaktuar.

Nga ana e Drejtorisë së Prokurimeve ende nuk kemi masa konkrete apo komunikime me departamentet e tjera, sipas planit të veprimit bashkëlidhur me njoftimin e sipërcituar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

9. Gjetje nga Auditimi: Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “Suport, licenca dhe mirëmbajtje për pajisjet Hardware”, në vlerësimin e ofertave vihet re që pika 2.3.3 e kriterëve të vecanta “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për pajisjet dhe platformat (Sëitche, NFGW, platforme

NAC, sistemi NMS, Akses Point, Switche Akses). Autorizimi duhet te përmbaje te dhëna te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij”, nuk përmbushet nga O.E. fitues, ku në dokumentet e ngarkuara nga O.E. në sistemin elektronik të APP, gjendej vetëm një autorizim nga Hewlet Packard me anë të emailit, ku dhe kjo e fundit nuk i mbulon të gjitha artikujt në specifikimet teknike në kundërshtim me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

9.1 Rekomandimi: OST sh.a., të tregojë kujdes gjatë vlerësimit të ofertave dhe të marrë në konsideratë të gjithë kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nëse janë ose jo në përputhje me dokumentacionin e sjellë nga O.E. pjesëmarrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me këtë rekomandim, ju bëjmë me dije se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, në mënyrë të pavarur. Megjithatë, kur ky Komision ka patur nevojë për sqarime, DP apo Njësia e Prokurimit i është përgjigjur menjëherë kërkesave të Komisionit duke sqaruar edhe parashikimet ligjore të legjislacionit në fuqi për prokurimet publike, ashtu edhe duke vënë në dispozicion edhe Udhëzimet dhe Rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik. Vendimet e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mund të janë objekt ankese, në rastin kur ka pretendime për vlerësim të gabuar dhe ato shqyrtohen nga një Komision tjetër i ngritur nga Autoritetit Kontraktor ose nga institucione të jashtme siç janë Komisioni i Prokurimit Publik apo Gjykata.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga auditimi, në rastin e procedurës së prokurimit me objekt “Rinovimi dhe Certifikimi ISO 27001”, me Nr. REF-97955-03-11-2024, OE ofertues është kualifikuar dhe është ftuar për të paraqitur dokumentet origjinale apo kopje të noterizuara, në mënyrë që të vijohet me publikimin e njoftimit paraprak të fituesit. KVO, me anë të procesverbalit datë 02.04.2024, ka konstatuar se dokumentacioni i paraqitur nga OE ofertues nuk është në përputhje me atë të paraqitur në SPE dhe për këtë arsye, procedura e prokurimit është anuluar, sipas Njoftimit të Anulimit Nr. 737/10 Prot., datë 02.04.2024.

Gjithashtu, KVO vlerëson në çdo procedurë prokurimi, nëse OE ofertues plotëson kriteret e vendosura, si dhe nëse produkti i ofruar është në përputhje me specifikimet Teknike.

Në rastin e procedurës së prokurimit me objekt “Implementimi dhe zgjerimi i sistemeve të sigurisë së informacionit MFA, ZTNA, SIEM”, me Nr. REF-01309-04-15-2024, KVO ka s’kualifikuar të gjithë ofertat e paraqitura, për shkak se nuk janë përmbushur specifikimet teknike (Termet e Referencës) dhe kriteret e kërkuara në Dokumentet e Tenderit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*

10. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “FV lexues aksesit dhe sisteme të tjera për zonat e sigurisë së lartë në AQ dhe njësi” , në analizimin e kriterëve të vecanta të kualifikimi vihet re kriteri nr. 2.3.5, sipas grupit të auditimit, duke u bazuar dhe tek vlera e kontratës, certifikimet e kërkuara janë të tepërta, pasi kufizojnë konkurrencën dhe nuk janë në përputhje me objektin e kontratës dhe vlerën e kontratës. Procedura e hapur e thjeshtuar nuk duhet të ketë shumë kriterë, në mënyrë që të jetë e mundur përfshirja e biznesit të vogël dhe të mesëm në kundërshtim me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

10.1 Rekomandimi: OST sh.a., gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të mirëmbajtjes, të krijojë kushte me gjithëpërfshirëse, pasi vendosja e kriterëve të cilët kërkojnë certifikimin e vetëm të prodhuesve do të pengojnë zhvillimin e një konkurrence të drejtë.

Përgjigjja e institucionit:

Në lidhje me këtë rekomandim, ju bëjmë me dije se, Njësia e Prokurimit që ngrihet rast pas rasti, angazhohet për të vënë gjithmonë kriteret minimale të nevojshme, në mënyrë që Operatori Ekonomik ofertues të disponojë kapacitet e nevojshme për realizimin e procedurës së prokurimit. Në rastet kur çmohet se është e domosdoshme që të disponohen punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve/shërbimeve që ofertohen, do të pranohet në vijimësi gjithashtu mundësia, që këto punonjës të kenë certifikimet ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.

Komenti i grupit të auditimit:

Me shkresën nr.1583/11 Prot, datë 08.08.2023, të gjithë departamenteve/drejtorive përkatëse në OST ju është përcjellë për zbatim tabela e evadimit të masave të lëna nga KLSH, duke i kërkuar përmbushjen e tyre sipas afatit të përcaktuar.

Nga ana e Drejtorisë së Prokurimeve ende nuk kemi masa konkrete apo komunikime me departamentet e tjera, sipas planit të veprimit bashkëlidhur me njoftimin e sipërcituar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

11. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, disa nga procedurat e prokurimit janë zhvilluar muajin e fundit të vitit, që përbëjnë risk mbi mënyrën e përdorimit të fondeve si dhe disa nga procedurat e tjera të cilat kanë objekt të ngjashëm me njëra tjetrën por që janë zhvilluar të ndara, duke bërë të mundur copëzimin e fondit dhe jo përdorimin e procedurave të prokurimit me vlerë të lartë.

11.1 Rekomandimi: AK të marrë masa për trajnimin e punonjësve që kryejnë procedurat e prokurimit, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve të brendshme për menaxhimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtoria e Prokurimeve ka dërguar punonjës të saj në trajnimet e ofruara nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe/ose Komisioni i Prokurimit Publik. Këto trajnime janë ofruar fizikisht ose online. Gjithashtu, kur ka qenë mundësia, janë dërguar punonjës për trajnime më të specializuara edhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Në Manualin e Burimeve Njerëzore të OST, datë 29.12.2023, është hartuar një procedurë e dedikuar vetëm për zhvillimin e trajnimeve në OST, nëpërmjet të cilës, do të synohet një përmirësim i administrimit të të gjitha praktikave administrative lidhur me zhvillimin e trajnimeve në OST.

Komenti i grupit të auditimit:

Me shkresën nr.1583/11 Prot, datë 08.08.2023, të gjithë departamenteve/drejtorive përkatëse në OST ju është përcjellë për zbatim tabela e evadimit të masave të lëna nga KLSH, duke i kërkuar përmbushjen e tyre sipas afatit të përcaktuar.

Nga ana e Drejtorisë së Prokurimeve ende nuk kemi masa konkrete apo komunikime me Departamentin e Administratës/Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, sipas planit të veprimit bashkëlidhur me njoftimin e sipërcituar, për të bërë të mundur ndryshimet sipas nevojave në planin vjetor të trajnimeve etj.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

12. Gjetje nga Auditimi: Bazuar në tabelën e mësipërme, në seksionin shënime, janë vënë në dukje të ardhurat dhe shpenzimet, mbi të cilat planifikimi i tyre nuk ka qene i saktë, dhe devijanca e tyre në lidhje me realizimin është e lartë.

Shpenzimet janë rritur ndërkohë që të ardhurat janë pakësuar

OST, ka programuar zëra shpenzimesh të cilët nuk i shërbejnë qëllimit dhe natyrës së aktivitetit të punës, mungon lidhja e objektivave dhe qëllimit të tyre me produktin konkret të projektit dhe programit buxhetor, si edhe një analizë e detajuar prioritarizmi duke qenë se mundësitë buxhetore janë të kufizuara, duke cënuar kështu përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe produktivitet të fondeve në dispozicion të institucionit, si më poshtë:

- Shpërblime për ndryshim strukture
- Shpenzime për pagesë largimi nga puna
- Shpenzime për dalje në pension

Shpenzimet për ekspertë kontabël dhe vlerësues, u realizuan në vlerën 44.1 milionë lekë nga 20 milionë lekë të parashikuara, duke kaluar fondit e parashikuar me gati 2 herë të parashikimit.

12.1 Rekomandimi: OST sh.a., në të ardhmen, gjatë hartimit të buxheteve, të analizojë me kujdes situatën e shoqërisë, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negociimin e kushteve më të mira si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive. Të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi si dhe të kryejë një planifikim të saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u bazuar dhe në vitet e mëparshme.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me këtë rekomandim ju bejme me dije se, nga ana e shoqërisë tregohet një vëmendje e vazhdueshme përsa i takon hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik të shoqërisë. Çdo vit krijohet një grup pune “Për hartimin e Programit të Zhvillimit ekonomik të OST”.

Urdhër Nr. 227, datë 21.07.2023 “Për hartimin e programit të zhvillimit ekonomik të OST për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2028”;

Grupi shqyrton kërkesat dhe i analizon ato duke marrë në konsideratë: (i) realizimin treguesve ndër vite; (ii) elementët e tjerë që kanë të bëjnë me vleresimet e tregut të energjisë për treguesit që lidhen me cmimet e enegjisë; (iii) kuadrin ligjor në fuqi. Planifikimi i të ardhurave kryesore të aktivitetit të OST, “Të ardhura nga transmetimi” bëhet duke marrë në konsideratë nivelin e tarifës së transmetimit të miratuar nga Enti rregullator i Energjisë. Rekomandimi zbatohet në vijimesi.

Komenti i grupit të auditimit:

Me shkresën nr.1583/11 Prot, datë 08.08.2023, të gjithë departamenteve/drejtorive përkatëse në OST ju është përcjellë për zbatim tabela e evadimit të masave të lëna nga KLSH, duke i kërkuar përmbushjen e tyre sipas afatit të përcaktuar.

Nga ana e Departamentit të Financës ende nuk kemi masa konkrete apo komunikime me departamentet e tjera, sipas planit të veprimit bashkëlidhur me njoftimin e sipërcituar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit, u konstatua se nuk administrohet Oponenca Teknike e objekteve të ndërtimit “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë” dhe “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6.

13.1. Rekomandim: Titullari i OST sh.a. të marrë masa që të gjitha objektet që prokurohen si “punë publike”, të pajisen me oponencën teknike para fillimit të procedurës së prokurimit, me qëllim që të jenë konform standardeve të projektimit, për të përfituar objekte cilësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me këtë rekomandim, ju bëjmë me dije se oponenca teknike kërkohet në çdo rast pas miratimit të projektit të Kontraktorit, nga ana e Autoritetit Kontraktor. Për kontratat e punëve publike nga ana e OST sha është përdorur forma “me çelësa në dorë”, nga ku nuk mund të bëhet një oponencë teknike para fillimit të procedurës së prokurimit. Autoriteti Kontraktor harton një projekt paraprak ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit, sipas parashikimeve të nenit 39 të VKM Nr.285 datë 19.05.20221 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pas lidhjes së kontratës, Kontraktori përgatit të gjithë projektin e detajuar, i cili, pas miratimit nga ana e Autoritetit Kontraktor, paraqitet pranë organeve kompetente për oponencën teknike, sipas legjislacionit në fuqi.

Komenti i grupit të auditimit.

Me shkresën nr.1583/11 Prot, datë 08.08.2023, të gjithë departamenteve/drejtorive përkatëse në OST ju është përcjellë për zbatim tabela e evadimit të masave të lëna nga KLSH, duke i kërkuar përmbushjen e tyre sipas afatit të përcaktuar.

Nga ana e Drejtorisë së Prokurimeve ende nuk kemi masa konkrete apo komunikime me departamentet e tjera, sipas planit të veprimit bashkëlidhur me njoftimin e sipërcituar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit, u konstatua se kolaudimi i objekteve “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë” dhe “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, është kryer nga stafi teknik i OST sh.a., të cilët nuk janë të pajisur me licencën profesionale për kolaudimin e objekteve, në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 12.

14.1. Rekomandim: Titullari i OST sh.a. të marrë masa që për të gjitha objektet që zbatohen në OST, të ngrihen grupe kolaudimi me specialistë të licencuar profesionalisht, me qëllim kontrollin cilësor të punimeve të përfunduara. Në rast të mungesës së një stafi të licencuar në institucion, kolaudimi të kryhet nga shoqëri/individë me licencat përkatëse të kolaudimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në lidhje me këtë rekomandim ju bëjmë me dije se OST sha disponon një numër të lartë inxhinierësh të fushave të ndryshme, të cilët kanë një eksperiencë të gjatë për sa i përket projekteve që zhvillohen nga ana e saj dhe për këtë arsye, këto punonjës janë pjesë e grupeve të kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të veprave. Rekomandim ndiqet në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit.

Zbatimi i këtij rekomandimi vërtetohet me shkresat:

Listë emërore me emrat e inxhinierëve të OST që disponojnë Licencat përkatëse:

B C – Licencë në mbikqyrje MK.2516/1;

D Xh - Licencë në mbikqyrje MK.1970/4.

OST sha disponon një numër të lartë inxhinierësh të fushave të ndryshme, të cilët kanë një eksperiencë të gjatë përsa i përket projekteve që zhvillohen nga ana e saj dhe për këtë arsye, këto punonjës janë pjesë e grupeve të kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të veprave. Konkretisht Ing. B C, me Nr. Licence MK.2516/1, Ing. D Xh, me Nr. Licence MK.1970/4, etj. Me shkresën nr.1583/11 Prot, datë 08.08.2023, të gjithë departamenteve/drejtorive përkatëse në OST ju është përcjellë për zbatim tabela e evadimit të masave të lëna nga KLSH, duke i kërkuar përbushjen e tyre sipas afatit të përcaktuar.

Nga ana e Drejtorisë së Prokurimeve ende nuk kemi komunikime apo masa konkrete me departamentet e tjera, sipas planit të veprimit bashkëlidhur me njoftimin e sipërcituar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i realizimit të punimeve në procedurën e prokurimit me objekt “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë”, u konstatua se: Ka patur diferenca në volume në zërin e punës “Trajnim i inxhinierëve të SMR për parametrizimin dhe aksesimin e pajisjeve (sipas specifikimeve teknike)”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

1.1 Rekomandimi: Nga OST sh.a. të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **802,400** lekë pa tvsh nga OE “G..” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 968/14 prot datë 11.05.2021 me objekt “Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e Tensionit të Lartë”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Me anën e shkresës nr.1583/14 Prot, datë 04.09.2023 i është kërkuar kontraktorit “G..” SHPK, përbushja vullnetare e detyrimit të lënë nga KLSH (shkresa bashkëlidhur).

Me shkresën nr.1583/14 Prot., datë 11.09.2023, shoqëria “G..” SHPK ka kundërshtuar rekomandimet e KLSH (shkresa bashkëlidhur).

Në vijim, OST i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm me kërkesë-padinë nr.5159 Prot., datë 16.10.2023 me objekt përbushje detyrimi me të paditur shoqërinë “G..” SHPK. Rekomandim është në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit.

Në vijim, OST sh.a. i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm me kërkesë-padinë nr. 5159 prot., datë 16.10.2023 me objekt përbushje detyrimi me të paditur shoqërinë “G..” SHPK. Aktulisht çështja është në proces pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i realizimit të punimeve në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Gërmim dheu me ekskavator 0.25 m3, tokë e zakonshme, kategoria III, për rrugët, t=20cm, me shkarkim në mjet”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve

2.1 Rekomandimi: Nga OST sh.a. të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **237,600** lekë pa tvsh nga BOE “A..” SHPK & “K..” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1246

prot datë 27.04.2021 me objekt “Rikonstruksion i linjës 110 kV, Ulëz Burrel”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.1583/13, date 04.09.2023 “Kërkesë për përmbushje detyrimi sipas Raportit të KLSH”, i është kërkuar shoqërive “A..” SHPK & “K..” SHPK, përmbushja në mënyrë vullnetare e detyrimit brënda një afati 30 ditor.

Në përgjigje të këtij njoftimi, nga ana e kontraktorit “A..” SHPK është bërë përmbushja vullnetare e këtij detyrimi duke depozituar në llogarinë e OST sha vlerën e detyrimit të lënë nga KLSH (bashkëlidhur gjendja e llogarisë bankare). Rekomandimi është zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit.

Me shkresën nr.1583/13, date 04.09.2023 “Kërkesë për përmbushje detyrimi sipas Raportit të KLSH”, i është kërkuar shoqërive “A..” SHPK & “K..” SHPK, përmbushja në mënyrë vullnetare e detyrimit brënda një afati 30 ditor.

Në përgjigje të këtij njoftimi, nga ana e kontraktorit “A..” SHPK është bërë përmbushja vullnetare e këtij detyrimi duke depozituar në llogarinë e OST sha vlerën e detyrimit të lënë nga KLSH. Dokumentet vërtetuese:

-Llogaria e-Dekarata (statement of account) për transfertën 237,600 lekë në BKT- Dega Ismail Qemali Tiranë, nga 14 Shtator 23- 15 Shtator 23.

-Analiza e Llogarisë 759 “Të ardhura të tjera”, Shtator 23, ditari kthim vlere nga A&E në vlerën prej 237,600 lekë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Automjete me qira operationale Leasing”, nga strukturat përgjegjëse të OST në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit, nuk është kryer një analizë kosto-përfitim në lidhje me automjetet e mësipërme, nëse do ishte menduar zhvillimi i procedurës për blerjen e tyre, duke analizuar përfitimin mbi përdorimin e tyre si dhe vlerën e mbetur pas 60 muajve (5 viteve), duke e cilësuar fondin prej 35,450,000 lekë si fond i përdorur pa 3E, në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin.

1.1 Rekomandimi: OST sh.a., në të ardhmen, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të kryejë një analizë kosto përfitim të tyre mbështetur në praktikat më të mira.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Ky rekomandim do të zbatohet në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit.

Aktualisht në OST SHA janë fuqi 3 kontrata qira financiare për mjetet motorrike (leasing operational) si më poshtë:

- Kontrata nr.1 nr.3500/12 prot, datë 16.11.2021, në vlerën 28,950,001 lekë pa TVSH për 5 vjet, ku vlera e faturimit mujor është 579,000 lekë;

-Kontrata nr.2 nr.1015/17 prot, datë 14.11.2022, në vlerën 35,450,000 lekë pa TVSH për 5 vjet, ku vlera e faturimit mujor është 708,999 lekë;

- Kontrata nr.3 nr.402/14 prot, datë 28.04.2023, në vlerën 28,900,000 lekë pa TVSH për 5 vjet, ku vlera e faturimit mujor është 577,999 lekë;

Me shkresën nr.1583/11 Prot, datë 08.08.2023, të gjithë departamenteve/drejtorive përkatëse në OST ju është përcjellë për zbatim tabela e evadimit të masave të lëna nga KLSH, duke i kërkuar përmbushjen e tyre sipas afatit të përcaktuar. Rekomandimi i sipërcituar është lënë për ndjekje Administratorit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

D. MASA DISIPLINORE:

D.1. Për punonjësit në marrëdhënie pune

D.1.2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuara në ligje të veçanta

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; germat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, ***i rekomandojmë Administratorit të Shoqërisë OST, Komisionit Disiplinor***, pranë Institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e punonjësve dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Përgjigjja e institucionit:

Rekomandimi do të zbatohet në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga ana e Administratorit është nxjerrë Urdhëri i Brendshëm nr.3061, datë 28.05.2024 “Për ngritjen e grupit të punës në lidhje me rekomandimin nr. E.1.2 të pikës D “masa disiplinore” sipas Raportit Përfundimtar të KLSH”;

Grupi i punës është duke punuar për përmbushjen e zbatimit të rekomandimit nr. E.1.2 të pikës D “masa disiplinore” të Raportit Përfundimtar të KLSH.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit kryer prej grupit të auditimit të KLSH-së rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. 14 Masa Organizative me 14 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit 3 zbatuar dhe 11 zbatuar pjesërisht;
- b. 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën 1,040,000 lekë me 2 rekomandime dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit; 1 zbatuar dhe 1 zbatuar pjesërisht;
- c. 1 Masë për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficiencës dhe Efektivitetit me 1 rekomandim, i pranuar plotësisht i cili ka statusin e ecurisë zbatuar pjesërisht;
- d. 1 Masë disiplinore, pranuar plotësisht 1 rekomandim dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit 1 zbatuar pjesërisht;

Për sa më sipër ri kërkojmë që, Operatori i Sistemit të Transmetimit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë pjesërisht zbatuar, brenda 3mujorit të parë të vitit 2025 si dhe kërkojmë analizimin dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.7 OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA

PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh. A, mbi “*Zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023*” për auditimin tematik të kryer në vitin 2023, përcjellë me shkresën Nr.826/11 Prot., datë 31.07.2023 duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efizienz dhe ekonomikitet të fondeve;

ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe manualit “*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve*”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 792/1 prot., datë 01.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.R, (*Përgjegjës grupi*)

2. E.K

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr.826/11 prot., datë 31.07.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti OSHEE Sh. A, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH rezulton se, nga 64 masa të rekomanduara (*organizative dhe disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **64** masa të rekomanduara ose 100 %. **Nga të pranuarat** (64): janë zbatuar plotësisht **18** ose 28 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht **30** ose 47 % dhe pa zbatuar **16** masa ose 25 % .

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit		
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
1	Organizative	43 masa	10 masa	24 masa	9 masa
2	Masa për shpërblim dëmi	14 masa 9,831,719 lekë	7 masa 1,984,077 lekë	3 masa 4,338,646 lekë	4 masa 3,508,996 lekë
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	5 masa	1 masa	2 masa	2 masa
4	Disiplinore	1 masë		1 masë	
5	Administrative	1 masë			1 masë
	<i>Gjithsej</i>	64 masa	18 masa	30 masa	16 masa

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 28 % dhe niveli i rekomandimeve pjesërisht zbatuar është 47 % dhe pazbatuar 25%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1- Hartim i programit (Plan veprimt) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA, (OSHEE), ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën Nr. 6071/1 Prot., datë 29.08.2023

III/2- Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna dhe dërguar me shkresën Nr. 6071/3 Prot., datë 29.08.2023, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 01.07.2020 deri më 31.12.2022 konstatohet se, këshilli ka marrë vendime jo në përputhje me legjislacionin shqiptar lidhur me shpërblimin e punonjësve, ndërkohë që shoqëria rezulton me humbje të konsiderueshme dhe me kapital negativ, kështu: Me vendimin nr. 5, datë 22.02.2021 është miratuar dhënia e një page shpërblim për punonjësit e angazhuar në kuadër të planit të gatishmërisë së shoqërisë OSSH sh.a.

- Me vendimin qarkullues nr. 22, datë 29.12.2021 është miratuar dhënia e një shpërblim të veçantë mbi pagë për punonjësit e OSHEE GROUP sh.a, OSSH sh.a, FTL sh.a dhe FSHU sh.a, në masën 20,000 lekë, me propozim të vetë Këshillit Mbikëqyrës, e kjo bazuar në performancën e shoqërisë, në një kohë që shoqëria prej disa vitesh radhazi paraqitet me humbje e me kapital negativ.

Dhënia e këtij shpërblimi, pavarësisht së është miratuar dhe nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6 “Kompetencat e organeve kolegjiale”, Pika 2 ku përcaktohet se: “Për ndërmarrjet shtetërore, veprimtaria e të cilave është me humbje, ose që subvencionohen nga shteti, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përkatës dhe të Ministrit të Financave, miraton, me akte të veçanta, nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të punonjësve të tyre”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE GROUP sh.a, në të ardhmen t’i kushtojë vëmendje të shtuar vendimmarrjeve të veçanta me efekte financiare për shoqërinë, referencës së tyre ligjore dhe bazuar në raporte e analiza të hollësishme mbi situatën financiare të shoqërisë.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Këshilli Mbikëqyrës i ka kushtuar vëmendje të shtuar vendimmarrjeve të veçanta me efekte financiare për shoqërinë.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është pranuar dhe statusi i zbatimit të këtij tij do të verifikohet në auditimet e rradhës.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendime jo në përputhje me legjislacionin shqiptar, vendimmarrje e cila nuk respekton rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve ndërmjet organeve drejtuese të shoqërisë, si dhe ka marrë vendime të cilat nuk gjejnë mbështetje në legjislacionin për shoqëritë tregtare, konkretisht:

a. Me vendimin nr. 27, datë 30.09.2022 është miratuar një ndryshim në strukturën organizative të shoqërisë OSHEE GROUP sh.a, ku në pikë 1, ka zvogëluar numrin e punonjësve në Departamentin e Kontrollit e Rikuperimit të Humbjeve më 83 punonjës dhe në Pikën 2

përcakton: “Në varësi të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “OSHEE GROUP sh.a, krijohet Task Forca e Energjisë”. Ky vendim është në vijim të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 6859, datë 14.09.2022, i cili ka miratuar një ndryshim në Statutin e shoqërisë, nenin 13.2, duke shtuar një pikë më përmbajtjen: “Me qëllim mbarëvajtjen dhe arritjen e objektivave të shoqërisë, të ketë në varësi të drejtpërdrejtë dhe në drejtimin e saj struktura të caktuara të shoqërisë OSHEE GROUP sh.a...”.

b. Me vendimin qarkullues nr. 30, datë 13.10.2022, në Pikën 2 ka miratuar pagat e strukturës së Task Forcës së Energjisë, ... “brenda kufijve të fondit të miratuar të pagave të shoqërisë OSSH sh.a”, kjo në kundërshtim dhe me legjislacionin për përcaktimin e pagave dhe VKM nr. 574, datë 03.08.2016 “Për miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA”. Kjo vendimmarrje mbështetet dhe në Aktin Normativ nr. 14, datë 5.10.2022 “Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin e energjisë elektrike” ku në nenin 3, pika 2 përcaktohet: “Task-Forca e Energjisë” është struktura e posaçme e ngritur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të OSHEE Group, sh.a”. Ndërsa në Rregulloret e kësaj strukture të miratuar nga Aksionari me nr. 8201, datë 27.10.2022, në nenin 1 përcaktohet se është e pavarur nga OSHEE GROUP sh.a dhe raporton direkt te Këshilli Mbikëqyrës; Në nenin 4, pika 7 dhe nenin 10 pika 10.5 përcaktohet se emërimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve të Task Forcës bëhet nga Administratori i OSSH sh.a me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Task Forcës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, nenet 135 deri 153, nenet 154 deri 165 dhe nenet 166 deri 167; ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6 dhe VKM nr. 574, datë 03.08.2016 “Për miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA”.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa, të rishqyrtojë dhe rishikojë vendimet e marra për ngritjen e strukturave paralele të kontrollit të energjisë (të organizuara si njësi Task-Forcë), të cilësuar si të pabazuara dhe jo në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe që nuk respektojnë rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe funksioneve ndërmjet organeve drejtuese të shoqërisë.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Oshee Group ka paraqitur një propozim pranë Këshilli Mbikëqyrës duke kërkuar shfuqizimin e Vendimit nr. 27, datë 30.09.2022. Këshilli Mbikëqyrës ka dalë me Vendimin nr. 23, datë 10.11.2023 mbi shfuqizimin e vendimit nr. 27, datë 30.09.2022 dhe një ndryshim në strukturën organizative të Oshee Group sha. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit të Oshee Group e ka miratuar me Vendimin nr. 9114/1, datë 23.11.2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatua se, për periudhën gjashtëmujori i dytë të vitit 2020 deri më 31.12.2022, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë 39 vendime qarkulluese, ose 34 % e nivelit të vendim-marrjes, për çështje me rëndësi jetike për veprimtarinë e OSHEE GROUP sh.a, si ato miratim të rinovimit të limitit të linjës së kredisë në vitin 2020; për miratim të ndryshimeve të investime në planin e konsoliduar financiar në vitin 2021; për miratimin e kredive të reja, oërdraftet gjatë viteve 2021-2022; ndryshime në strukturat organizative të shoqërive, apo të emërimit të administratorëve, etj., pa u diskutuar, shqyrtuar, analizuar dhe votuar në mbledhje nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës. Një veprimtari e tillë është në

kundërshtim me VKM nr. 570, datë 3.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, pika 9, pasi Këshilli Mbikëqyrës e zhvillon veprimtarinë e tij nëpërmjet mbledhjeve dhe jo me vendime qarkulluese pa u mbledhur.

Për më tepër, referuar Statutit të shoqërisë, në nenin 18 është përcaktuar procesi vendim-marrës i këshillit mbikëqyrës, me vendin e zhvillimit të mbledhjeve, mënyrën e thirrjes me çështjet kryesore të rendit të ditës, si dhe procesverbalet e mbledhjeve.

Gjithashtu, marrja e vendimeve qarkulluese e Këshillit Mbikëqyrës pa u mbledhur, është në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, i cili përcakton: “Organi kolegjial merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes...”, si dhe vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës (neni 14, pika 1).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE GROUP sh.a të shqyrtojë, analizojë me vëmendje, të debattojë dhe të miratojë me votim në mbledhje çështjet që vihen në rendin e ditës dhe të tjera për diskutim, me qëllim ndjekjen në vijimësi të situatës financiare të shoqërisë, si dhe të veprimtarisë së saj.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Këshilli Mbikëqyrës ka shqyrtuar dhe analizuar çdo propozim ku ka dalur me vendimet përkatëse. Këshilli Mbikëqyrës nga muaji Tetor 2023 dhe deri në Korrik 2024 ka kryer 14 mbledhje dhe ka marrë 39 vendime.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hartimin e miratimit të strategjive dhe planeve financiare të shoqërisë, konstatohet se aprovimet dhe miratimi final nga Asambleja e Ortakëve janë bërë përtej afateve të përcaktuara në dispozita nënligjore, pra bëhen me vonesë dhe pasi ka filluar viti ushtrimor, si dhe shoqërohen me ndryshime të mëtejshme përgjatë vitit. Mos hartimi në kohë nga administratorët dhe aprovimet nga Këshillat Mbikëqyrës, si dhe Asambleja e Ortakëve, vështirëson zhvillimin e veprimtarisë tregtare të shoqërisë, mos arritjen e objektivave të vendosura, realizimin e investimeve strategjike, veprime këto në kundërshtim me nenin 13 dhe nenin 20, pika 7, të Statutit të Shoqërisë OSHEE GROUP sh.a, miratuar me Vendimin nr. 7551/1, datë 01.12.2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet nr. 30-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të marrin masa për hartimin në kohë, si dhe aprovimet përkatëse të strategjive dhe planeve financiare të periudhave të ardhshme, pasi të kenë analizuar më parë mos realizimet në periudhën e mëparshme, për të siguruar zhvillimin e veprimtarisë tregtare dhe arritjen e objektivave të vendosura.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ...Në lidhje me afatet e hartimit të planeve financiare prej Departamentit Ekonomik sqarohet se, vonesa në hartimin dhe aprovimin të Planit Financiar 2023 është shkaktuar nga pritja për aprovim të çmimeve të blerjes së energjisë së prodhuar nga HEC-et private si dhe të konfirmimit të vazhdimit të furnizimit të konsumatorëve të energjisë elektrike me skemën e aprovuar në kushtet e VKM

Nr.584 datë 08.10.2021 “Për shpalljen gjendjes emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

Gjithashtu, vonesa në hartimin dhe aprovimin të Planit Financiar 2024 është shkaktuar nga pritja për aprovimin e ndryshimeve në VKM Nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendohen e detyrimit të shërbimit publik” botuar në Fletoren zyrtare 22/2024 të datës 5 Shkurt 2024 të cilat lidhen edhe me largimin e klientëve të lidhur në tension të mesëm drejt furnizuesve të Tregut të Lirë.

Administratori i Oshee Group sh.a. dhe Departamenti Ekonomik i Oshee Group sh.a. kanë përgatitur një Memo mbi Hartimin e Planit Financiar 2025 dhe periudhën 2026-2027, me nr.6146 Prot.datë 18.07.2024 që i drejtohet : Administratorëve të OSSH, FSHU, FTL dhe departamenteve të Oshee Group duke ju lënë detyra për hartimin në kohë të Planit Financiar 2025 brenda afateve ligjore (1.11.2024).

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se nga ana e OSHEE është hartuar MEMO në të cilën përcaktohet programi i punës për hartimin e planit financiar për vitin 2025 dhe periudhën 2026-2027.

Lidhur me rekomandimin e lënë, statusi i tij ngelet për tu verifikuar në auditimet e ardhshme, sa më sipër rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht i zbatuar***.

5. Gjetje nga Auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur për inventarët e datës 31.12.2021 u konstatua se, shoqëria ka gjendje pjesë materiale e artikuj të ndryshëm, të vlerësuar si jashtë përdorimit me vlerë kontabël të mbetur 197,492,859 lekë.

Nga administratori i shoqërisë janë iniciuar procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit pas vlerësimit të komisioneve të ngritura. Më datë 04.06.2018, eksperti i vlerësimit i caktuar nga MIE, ka dorëzuar raportin e vlerësimit, për shkarkimin nga librat kontabël vlerën e inventarit prej 179,436,025 lekë, dhe më datë 18.10.2018, me vendimin nr. 29, Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar raportin, si dhe ka miratuar vlerën e inventarit 108,7843,007 lekë të vlerësuar për tu shitur si skrap, sasinë 495,137 kg në vlerën 30,956,459 lekë, si dhe miratimin e vlerës së inventarit 70,593,018 lekë për tu asgjësuar.

Shoqëria, deri në përfundim të datës së auditimit, nuk ka iniciuar procedurat për hapjen e ankandit publik veprime që ngarkojnë me përgjegjësi administratorin e shoqërisë.

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar asetin për vlerën kontabël të mbetur konform kërkesave të Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 108 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, i ndryshuar. Mos kryerja në kohë e ankandit sjell vështirësi logjistike, duke bllokuar hapësira magazinuese si dhe rrit rriskun për dëmtime dhe zhvlerësime të mëtejshme të vlerës së aktiveve të vendosura për tu shitur.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për vlerësimin e gjendjes aktuale të materialeve skrap, testimin real të tregut, hapjen e procedurës së ankandit publik për shitjen e materialeve dhe duke proceduar më pas në vijimësi sipas situatës.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Urdhri nr. 18, 6071/1 prot., datë 16.08.2023. DSHM /OSSH kane paraqitur relacion / kerkese per miratim ne Keshillin Mbikqyres te Oshee Group per nxjerrjen jashtepedorimit te materialeve ne magazinat e OSSH.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, rezultat financiar i shoqërisë OSSH sh.a., për periudhën 2021 shënoi një humbje prej 2,672 milion lekë. Me gjithë përmirësimet në drejtim të reduktimit të mëtejshëm të humbjeve, të rritjes së nivelit të arkëtimeve në krahasim me atë të planifikuar, si dhe mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme, rezultati financiar ishte negativ kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të energjisë, rrjedhojë e rritjes së çmimit në treg sikurse u parashikua në rishikimin e planit financiar të shoqërisë. Si rrjedhojë e mungesës së furnizimit të plotë të energjisë nga HEC-et private për vitin 2021, OSSH sh.a u furnizua për mbulimin e humbjeve për një sasi prej rreth 215.46 Gëh në tregun e parregulluar. Rritja e çmimit të energjisë në tregun e parregulluar mesatarisht prej rreth 20.75 Lekë/Këh për nga 8.05 Lekë/Këh që ishte parashikuar në fillim të vitit, rriti shpenzimet e blerjes së energjisë për OSSH sh.a, duke ulur performancën financiare dhe vendosur në pozitë të vështirë likuiditetet e shoqërisë. Me VKM nr. 584, datë 8.10.2021 “Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike”, u vendos që OSSH sh.a të ndërpriste investimet e parashikuara për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes, me përjashtim të atyre të domosdoshme për furnizimin me energji të konsumatorëve.

Realizimi i të ardhurave nga energjia është pothuajse i barabartë me planifikimin e të ardhurave, e arrin në vlerën prej 26,875 milion lekë. Ulja e humbjeve në rrjet në nivelin e 20.62 % bëri të mundur që të ulen efektet e kostos së blerjes së energjisë së vitit.

Shpenzimet për blerjen e energjisë dhe transmetim u realizuan në shumën 15.9 miliard lekë, me një rritje prej 1%, për shkak të rritjes së çmimit në tregun e lirë, si dhe të ndryshimit të strukturës së blerjes së energjisë. Të ardhura të tjera rezultuan me një ulje prej 8% , në krahasim me ato të planifikuara pas faturimit të penaliteteve, për mosplotësim të planit të furnizimit me energji elektrike për vitin 2021 sipas kushteve të kontraktimit. Shpenzimet operative për 2021 ishin 14 % më të ulëta se ato të planifikuara, ose 1,653 milion lekë. Të gjitha zërat e shpenzimeve u realizuan sipas planifikimit, me përjashtim të penaliteteve. Humbjet në rrjet në vitin 2021 ishin rreth 20.62 % ose rreth 0.12% më të ulta se ato të planifikuara prej 20.49%. Plani i investimeve për vitin 2021 për rreth 13.4 miliard lekë është realizuar në vlerën 11 miliard lekë, pavarësisht se nga OSSH sh.a prej muajit Tetor me vendim të Qeverisë së Shqipërisë, investimet në rrjet u ndërprehen.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet nr. 30-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të OSSH sh.a dhe të OSHEE GROUP sh.a, duke analizuar me kujdes situatën debitore të shoqërisë, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira me institucionet e kreditit për ristrukturimin e huave, si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive.

Menjëherë e në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

DEK është në negocim të vazhdueshëm me institucionet e kreditit për ristrukturimin e huave.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi konstatohet se, rezultati financiar i shoqërisë FSHU sh.a, për periudhën 2021 shënoi një humbje prej 11,367 milion lekë. Me gjithë përpjekjet dhe përmirësimet e punës operacionale në drejtim të arritjes së arkëtimeve, mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme dhe përmirësimin të cilësisë së shërbimit, performanca negative është rrjedhojë e rritjes së shpenzimeve për blerjen e energjisë si pasojë e rritjes së çmimit të energjisë së blerë në tregun e lirë. Kështu, të ardhurat nga shitja e energjisë ishin rreth 1% më të ulta, ku pjesa më e madhe e uljes vjen nga konsumatorët privatë, ose rreth 1.2 miliard lekë më pak. Të ardhurat nga konsumatorët familjarë janë 2% më të larta, në krahasim me planifikimin e vitit 2021, për shkak të rritjes së sasisë së energjisë së blerë. Të ardhurat nga kamatëvonesat ishin 6.7% më të ulta se ato të planifikuara të vitit 2021, ose rreth 66 milion lekë, për shkak të fillimit të përmirësimit të pasojave të situatës pandemike e Covid-19 dhe ndikimit të saj në ekonominë e vendit.

Shpenzimet në vitin 2021 u rritën me 8%, ose rreth 4.8 miliard lekë, në krahasim me ato të planifikuara, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të energjisë, si rezultat i rritjes së çmimit të blerjes në tregun e lirë gjatë gjysmës së dytë të vitit. Rritje të shpenzimeve kishte edhe në zërin shpenzime operative, ku rritjen më të madhe e kanë shpenzimet për penalitete, gjoha e dëmshpërblime, si dhe në shpenzimet financiare.

Në 6-mujorin e dytë të vitit 2021, kur sasia e energjisë së furnizuar nga KESH sh.a ishte 21% më e ulët se ajo e 6-mujorit të parë të vitit, sasia e energjisë së blerë në tregun e lirë ishte rreth 897 Gëh, e cila për shkak të rritjes së çmimit, u ble me çmim mesatar prej rreth 26.03 Lekë/kah, me një kosto totale prej rreth 23.4 miliard lekë, nga 2.03 miliard lekë që ishin shpenzuar në vitin 2020 për të njëjtën periudhë.

Shpenzimet për tarifën e shpërndarjes dhe të transmetimit, si rezultati i rritjes së energjisë së shitur ishin 10% më të larta se ato të planifikuara, ose respektivisht 1.9 dhe 0.8 miliard lekë më të larta dhe po kështu edhe shpenzimet për energjinë reaktive, të cilat u rritën 11% në krahasim me planifikimin e vitit 2021.

Shpenzimet për disbalancat, pavarësisht se sasia e disbalancuar ishte brenda normave të planifikuara për më pak se 2% të sasisë së energjisë, për shkak të rritjes së çmimit të energjisë u rritën 96%, duke qenë 359 milion lekë më të larta se sa planifikimi i vitit 2021.

Shpenzimet operative u rritën 7%, ose 242 milion lekë në krahasim me ato të planifikuara. Rritja e ndjeshme e shpenzimeve operative lidhet kryesisht me rritjen e shpenzimeve për penalitete, gjoha dhe dëmshpërblime, të cilat janë rritur me 816 milion lekë në krahasim me planifikimin e vitit 2021. Shpenzimet për të punësuarit, postare, konsulenca, auditim dhe të tjera janë më të ulta se ato të parashikuara në planin financiar, ndonëse janë më të larta se ato të realizuara në vitin 2020. Shpenzimet financiare janë rritur me rreth 41 milion lekë, në krahasim me planifikimin e 2021. Rritja e këtyre shpenzimeve është rrjedhojë e kostove të interesave të kredive të reja të marra në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare për kalimin e krizës së likuiditetit në kushtet e rritjes së jashtëzakonshme të çmimit të energjisë në tregun e energjisë.

Marrja e kredive afatshkurtra nga bankat e nivelit të dytë, ka përkeqësuar situatën financiare të shoqërive kontrolluara nga OSHEE Group sh.a dhe të vetë asaj. Rritja e detyrimeve financiare afatshkurtra dhe afatgjata rrit kostot e shoqërive si dhe çënon investimet për rritjen e performancës dhe uljet e humbjeve në rrjet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet nr. 30-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të FSHU sh.a dhe të OSHEE GROUP sh.a, duke analizuar me kujdes situatën debitore të shoqërisë, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira me institucionet e kreditit për ristrukturimin e huave, si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive.

Përgjigjja e institucionit:

DEK është në negociim të vazhdueshëm me institucionet e kreditit për ristrukturimin e huave.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

8. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera për periudhën e audituar, u konstatua se në kontratën e lidhur me operatorin ekonomik “E S sh.p.k.” dhe OSSH sh.a, Drejtoria Rajonale Burrel, me datë 17.06.2021, me vlerë 123,310,827 lekë, si dhe në kontratën e lidhur më datë 19.08.2021, mes Drejtorisë Rajonale të OSSH sh.a dhe FSHU sh.a. Berat, dhe operatorit ekonomik “M S sh.p.k.”, me vlerë kontrate 85,963,221 lekë, kontraktuesit duhet të paraqesin sigurim kontrate në shumën 10 % të vlerës së kontratës në formën e një garancie sigurimi, lëshuar nga një institucion financiar. Kontratat janë formuluar duke iu referuar kontratave të formatuara për furnizime tipike të procedurave të tenderimit, pa reflektuar specifikat e shërbimit të sigurisë fizike.

Operatorët ekonomikë nuk kanë siguruar riskun e mos realizimit të shërbimit të ruajtjes së sigurisë fizike të objekteve e aseteve të shoqërisë. Në një kontratë me një operator tjetër ekonomik që ofron shërbim të njëjtë, kjo pikë është përcaktuar me marrjen e një siguracioni të përgjegjësive profesionale, sipas rregullave dhe praktikave të njohura për të zhdëmtuar Autoritetin Kontraktor për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimit.

-Mos sigurimi i riskut për mos realizimin e shërbimit të ruajtjes së sigurisë fizike të objekteve e aseteve të shoqërisë, mund të sjellë pasoja me dëme të rëndësishme për shoqërinë. Siguracioni për përgjegjësinë profesionale, sipas rregullave dhe praktikave të njohura për të zhdëmtuar Autoritetin Kontraktor për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimit, ul riskun e zvogëlimit të aseteve të shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 60-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa që, në kontratat e ardhshme të shërbimit të sigurisë fizike detyrimet financiare mes palëve në rastet e shkakimit të dëmeve të përcaktohen qartë dhe duke detajuar asetet përkatëse që OE do marrë përsipër për sigurinë fizike. Duke u nisur nga fakti që vlera e aseteve që i lihen për ruajtje është më e lartë se vlera e kontratës së shërbimit, garancia prej 10% e kontratës së shërbimit nuk mbulon dëmin që mund të shkaktohet në rast të moskryerjes së shërbimit. AK duhet të kërkojë garanci nga OE se do dëmshpërblehet në rast të shkakimit të dëmeve nga moskryerja e ruajtjes së sigurisë fizike.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e Oshee Group nuk u paraqit dokumentacion justifikues për realizimin e rekomandimit.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Janë lajmëruar AK në Drejtorinë Rajonale të OSSH për zbatimin e këtij rekomandimi.. i cili është në pamundësi të lëshojë një garanci të tillë nga institucionet përkatëse...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar*

pjesërisht.

9. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve të kryera nga OSHEE GROUP sh.a, u konstatua se në kontratat e lidhura me operatorët ekonomikë “E S sh.p.k.” dhe “M S sh.p.k.”, termat mes palëve nuk janë formuluar sipas parakushteve të paracaktuar në nenin 18 “Kontrata ndërmjet palëve” të ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin privat të sigurisë fizike”, udhëzimit nr. 130, datë 05.03.2018, “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, Kreu V, Menaxhimi i shërbimeve të SHPSF-së, Organizimi dhe drejtimi i SHPSF-së.

Në lidhje me zbatimin e kontratës, nga Autoriteti Kontraktor nuk janë kërkuar deklaratimet e pagesave të sigurimeve shoqërore për punonjësit të përcaktuar për të kryer shërbimin e kontraktuar. Duke u nisur nga fakti që në ofertat ekonomike të OE pjesëmarrës në procedura, pjesa më e madhe e kostos së shërbimit përbëhet nga pagat e punonjësve, pagë kjo e përcaktuar që të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale e përcaktuar me VKM-në përkatëse, si dhe shtesat që do të bëhen në pagën e punonjësve për turnin e II, III, ditët e festave, dhe sigurimet shoqërore, Autoriteti Kontraktor nuk mund të kryejë verifikimet nëse fondet e kaluara ndaj operatorit ekonomik janë përfituar në përputhje me ofertat ekonomike të kryera në procesin e prokurimit.

-Formulimi i kontratës mes palëve pa përfshirë dhe përcaktimet e udhëzimit në lidhje pikën 2, ka si pasojë rritjen e riskut për mos kryerjen e shërbimit me personelin e parashikuar dhe zvogëlimin e mundësive të AK për verifikimet përkatëse.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 130, datë 05.03.2018, “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, Kreu V, pika 2, ka përcaktuar qartë trajtimin financiar të punonjësit të shërbimit sa është dhe se duhet të kryhet me bankë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 60-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa për hartimin e kontratave në përputhje të parakushteve të përcaktuara në udhëzime dhe të ndjekë zbatimin e tyre nga OE fitues, si dhe të bëjë verifikimet përkatëse lidhur me pagesat e punonjësve.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E. K. ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Plotësimi i kushteve të kontratave të lidhura...e ka të vështirë të bëjë verifikimin e pagesave të punonjësve të lidhur me kompaninë ofruese të shërbimit...

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Plotesimi i kushteve të kontratave të lidhura për shërbimin e sigurisë fizike kontrollohen në vazhdimësi dhe me baze mujore sipas faturimeve përkatëse të ofrimit të shërbimit. Keto fatura konfirmohen nga administratoret përkatëse të realizimit të kontratave dhe në mënyrë periodike dërgohen raportet përkatëse në institucionet përgjegjëse. gjithsesi cdo AK e ka të vështirë të bëjë verifikimin e pagesave të punonjësve të lidhur me kompaninë ofruese të shërbimit

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusin e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera për shlyerjen e detyrimeve kontraktore ndaj një pjese furnitorësh, bashkimeve operatorësh ekonomikë, u konstatua se pagesat e shërbimeve dhe mallrave janë faturuar nga një prej operatorëve ekonomikë dhe jo nga të gjithë pjesëmarrësit e bashkimit ekonomik, sipas përqindjes së dakordësuar në dokumentet e tenderit. Këto bashkimeve operatorësh ekonomikë nuk kanë përmbushur detyrimet mbi bazën e të cilave janë shpallur fitues dhe kanë nënshkruar kontratat. Në këto raste, kemi të bëjmë me deklarime të pasakta pranë organeve tatimore, pasi shoqëritë kanë deklaruar një shumë për të cilën nuk ka lidhur kontratë. Gjithashtu, këto fatura tatimore mund të përdoren në procedura prokurimi si kontrata e ngjashme me një vlerë të pasaktë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pikat 1,2,5 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe me Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 32.2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 60-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa në të ardhmen që, me shpalljen fitues të procedurës së tenderimit, BOE të firmosin kontratën për furnizim mallrash ose shërbime, dhe duke ofruar shërbimet në përqindjet e rena dakord dhe duke i shoqëruar me faturat tatimore përkatëse.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Janë lënë udhëzimet përkatëse në AK e OSSH që ky rekomandim të ndiqet e të zbatohet.

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Jane lene udhezimet perkatese ne AK e OSSH qe ky rekomandim te ndiqet e te zbatohet

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusin e zbatimit të rekomandimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

11. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi konstatohet se, nga shoqëria për vitin 2020 janë shpenzuar 42,073,200 lekë dhe për vitin 2021 janë shpenzuar 97,372,800 lekë për audituesit ligjorë për shërbimin e auditivit të pasqyrave financiare, por nga Asambleja e Aksionarit përzgjedhja e audituesit është kryer me miratim, pa u zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

-Nga auditimi i pagesave të bankës për periudhën objekt auditimi u konstatua se shoqëria ka lidhur kontratë për kolaudimin e matësve me shoqëritë 3.. sh.p.k, V.. sh.p.k. dhe HTT sh.p.k. pa zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 4, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto

kuptime: 1. “Autoritet kontraktor” është çdo ent që i nënshtrohet këtij ligji për zbatimin e kontratave të tij publike. 9. “Fondet publike” janë: ç) të ardhurat nga shteti, ndërmarrjet lokale, shoqëritë tregtare dhe entet e tjera, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve ose të kapitalit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 60-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve në zbatim të funksionit ligjor për zgjedhjen e audituesve ligjorë për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë, duhet të kryejë procedurat e prokurimit për këtë proces. Megjithëse tarifa orare është e caktuar me rregullore të brendshme nga IEKA, sasia e orëve të punës për angazhimet audituese mund të ndryshojë në varësi të eksperiencës së tyre, njohjes së mëparshme të subjekteve, kapaciteteve të tyre pa e ulur cilësinë e auditimit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Shkresa nr. 6071/3 prot., datë 29.08.2023 drejtuar këshillit mbikëqyrës (Administratori i oshee group ka përzgjedhur audituesit nga lista e IEKA)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

12. Gjetje nga Auditimi: Gjatë vitit 2022, Komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, ka kryer procedurat me objekt “Blerje ndriçues zyre për godinën qendrore të OSHEE GROUP sh.a” me vlerë 950,000 lekë pa TVSH, me urdhër prokurimi nr. 7469/2, datë 29.07.2022, ku është kërkuar malli ndriçues zyre, copë 300, dhe “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike për mirëmbajtjen e godinës qendrore” me vlerë 750,000 lekë pa TVSH, me urdhër prokurimi nr. 7462/1, datë 28.07.2022. Nga auditimi i këtyre procedurave konstatohet se, Autoriteti Kontraktor për vitin 2022 ka copëzuar fondin limit, në kundërshtim me nenin 34 pika 2 të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 60-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa për trajnimin e punonjësve që kryejnë procedurat e prokurimit, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve të brendshme për menaxhimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e Oshee Group nuk u paraqit dokumentacion justifikues për realizimin e rekomandimit.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E. K. ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit...bashkelidhur gjeni komunikimet e Drejtorive Rajonale dhe Drejtorit të Tensionit të Lartë...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

13. Gjetje nga Auditimi: Konstatohet se, OSHEE GROUP sh.a, ka depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, QKB, brenda afatit vetëm deklaratën e tatim fitimit për periudhën 2020, ndërsa të gjitha deklaratimet e tjera janë bërë me vonesë. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e OSHEE GROUP sh.a., nuk i ka miratuar pasqyrat financiare të periudhës 2020 dhe 2021. Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a), përveç deklaratës së tatim fitimit

të kryer më 31.03.2021, të gjithë dorëzimet e tjera i ka kryer me vonesë. Operatori i Sistemit të Shërbimit sh.a. (OSSH.) përveç deklaratës së tatim fitimit të kryer më 31.03.2021, të gjithë dorëzimet e tjera i ka kryer me vonesë.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 29 “Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit”. Asambleja e Ortakëve ka detyrimin për të aprovuar pasqyrat financiare të shoqërisë në afatin e caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1. Mos depozitimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), si dhe kryerjet jashtë afateve ligjore janë në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Nga titullarët e shoqërive të merren masa që në të ardhmen, pasqyrat financiare të hartohen, depozitohen dhe të aprovohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike lidhur me vendim-marrjet që duhet të marrin palët e interesuara, si asambleja e ortakëve, institute kredidhënie, etj.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Urdhri i brëndshëm me nr. 7958/2 prot., datë 18.08.2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

14. Gjetje nga Auditimi: Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e OSHEE GROUP sh.a., nuk ka miratuar pasqyrat financiare të periudhave 2020 dhe 2021, me arsyetimin e mos aprovimit nga refuzimi i dhënies së opinionit nga audituesit ligjorë, duke vendosur ri auditim nga auditues të tjerë për verifikimin e mos përputhjeve të gjetura në refuzimin e opinionit.

Me datë 28.06.2021, audituesit ligjor në raportin e tyre janë shprehur për “Refuzim opinionit”, bazuar në konstatimet se shoqëria nuk ka finalizuar regjistrin e asetëve si dhe nuk ka marrë titujt e pronësisë për pronat e paluajtshme që ka në përdorim.

Më datë 14.04.2022, drejtimi i shoqërisë OSHEE i ka kërkuar Aksionarit të shoqërisë, emërimin e audituesve ligjor për “Auditimin e pasqyrës së veçantë dhe të konsoliduar të lëvizjes së aktiveve të qëndrueshme të shoqërisë OSHEE Group sh.a.”.

Më datë 13.05.2022, Aksionari i shoqërisë, me shkresën nr. 3235/1 ka vendosur për caktimin e audituesve ligjor L K, E H, I D dhe V Ç për dhënien e opinionit të auditimit për pasqyrat financiare të konsolidurara për vitin e mbyllur më 31.12.2020, pas regjistrimit të rezultateve të inventarizimit të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jomateriale në këto pasqyra, për shoqërinë OSHEE Group sh.a.

Vendim-marrja e Asamblesë së Ortakëve për një ri-auditim të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore 2020, pasi të ishin reflektuar rezultatet e inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, rivlerësimi i tyre dhe sistemimi i diferencave për të mos pasur mbartje në vitin 2021 me refuzim opinionit nuk ka mbështetje në ligjin nr. 10 091, datë 5.03.2009, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Nëse refuzimi i ekspertëve të mëparshëm kishte lidhje me inventarizimin dhe rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale dhe sistemimin e diferencave, nuk kishte arsye për dhënie opinionit përsëri për pjesët e tjera të pasqyrave financiare. Organet drejtuese të shoqërisë të merrnin masa për korrigjimin e situatës dhe diferencat të reflekttoheshin në periudhën pasardhëse.

Veprimet e Asamblesë së Ortakëve kanë sjellë vonesa jo të justifikuar duke kërkuar auditim sërish për pasqyrat financiare të OSHEE Group sh.a.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që, në të ardhmen aprovimi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrit rregullator përkatës dhe që kanë si objektiv dhënien e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, e që janë të dobishme për vendimmarrjen ekonomike të një grupi të gjerë përdoruesish, përveç anës formale të jetë i orientuar në pjesën thelbësore të problematikave dhe zgjidhjen e tyre.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e Oshee Group nuk u paraqit dokumentacion justifikues për realizimin e rekomandimit.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E. K. ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Në lidhje me miratimin e pasqyrave financiare....pasqyrat e vitit 2021 me datë 31.07.2024 jë në proces miratimi...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

15. Gjetje nga auditimi: Shoqëria OSSH sh.a nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjister.

-Nga auditimi i kontabilizimeve të aktiveve të blera u konstatua se emërtimet me të cilat regjistrohej në sistemin SIP, sistemi që përdor financa, emërtimi nuk përfshinte markën, shpjegime më të qarta duke e bërë të vështirë identifikimin në periudhat e mëpasshme për inventarizimet periodike. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30.

Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë dhe Nëpunësi Zbatues duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe për plotësimin e regjistrit të aktiveve që shoqëria zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Bashkalidhur kësaj shkrese do të gjeni komunikimet e Departamentit Ekonomik me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse dhe shoqëritë bija për inventarizimin.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar*

pjesërisht.

16. Gjetje nga Auditimi: OSHEE Group sh.a. nuk ka kryer inventarizimin e plotë të detyrimeve për periudhat 2021 e 2022, duke mos kryer verifikimin e ekzistencës fizike, si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, si të detyrimeve dhe të drejtave e dokumentacionit mbështetës përkatës. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, i ndryshuar, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, “inventari i aktiveve dhe detyrimeve”. Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë dhe Nëpunësi Zbatues, për të ulur riskun e zvogëlimit të aseteve së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre, duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimit të plotë të detyrimeve për periudhat, vitet 2021 dhe 2022, duke kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, të detyrimeve, të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës përkatës, procedura rakordimi dhe dakordësimi për saldot vjetore, shoqëruar me relacionet përkatëse.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni akt rakordime, urdhra dhe raporte të mbajtura nga OSHEE dhe shoqëritë e saj me palët e treta.*

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht.*

17. Gjetje nga Auditimi: Në auditimin e faturimeve të shërbimit të ofrimit të energjisë elektrike, të kryera nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., kamatëvonesat e akumuluar nuk pasqyrohen në faturat që i dërgohen përdoruesve. Shoqëria i evidenton vetëm në momentin e arkëtimit, duke zbatuar dhe parimin e sigurisë dhe duke mos i deklaruar si të ardhura në momentin që maturohen. Ndërsa, kjo është një praktikë e mirë për të mos deklaruar të ardhura që nuk kanë siguri se do të arkëtohen, kur vlerat janë materiale dhe përfituesit e shërbimit janë shoqëri private biznesi ose publike shtetërore që kanë detyrimin ligjor për të zbatuar SNK ose SKK, mos pasja e vlerave të kamatëvonesave në faturë si detyrim për tu paguar sjell vështirësi për paraqitjen e tyre si provizione në pasqyrat financiare. Ky problem është me rëndësi materiale për shumë shoqëri publike shtetërore, të cilat ka detyrime të konsiderueshme ndaj FSHU sh.a., dhe paraqesin në pasqyra detyrimin vetëm për principalin.

Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë, janë miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018, neni 10, “Çmimi i Energjisë Elektrike” pika 10.1. Në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike, çmimi i energjisë elektrike përcaktohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Çmimi, përbërësit e tij, struktura tarifore orare, apo sipas nivelit të konsumit, i bëhen të ditur Klientit në faturën e konsumit të energjisë elektrike. Mos paraqitja e kamatëvonesave për tu paguar dëmton paraqitjen me saktësi dhe siguri të pasqyrave financiare përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandimi: Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., të marrë masa që kamatëvonesat e akumuluar të pasqyrohen në faturat që i dërgohen përdoruesve, duke rritur transparencën në marrëdhëniet me konsumatorët, si dhe duke reflektuar më saktë detyrimet aktuale të përdoruesve.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Urdhri i Brëndshëm i FSHU-së me nr. 5651/2 prot., datë 17.08.2023. Në bashkëpunim ndërmjet Drejt.të Dept të Debisë dhe Drejtorit të Bilancit dhe Faturimi (në cilësinë edhe të Admnsitratorit të kontratës së shërbimit postar hibrid printim+zarfim+shpërndarje e faturave) është mundësuar pasqyrimi i kamatvonesave në faturat që ju dërgohen klientëve, fakt ky i konfirmuar edhe nga Departamenti IT OSHEE Group, të cilët dërgojnë çdo muaj formatin e faturave për printim dhe shpërndarje pranë Postës Shqiptare.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

18. Gjetje nga Auditimi: Shoqëria OSHEE GROUP sh.a nuk ka përfunduar procesin e kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të iniciuara me VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.”. Shoqëria nuk ka zbatuar plotësisht VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.” pikat 1,2,3, për regjistrimin e pasurive në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar me ligjin nr. 9/2016, datë 11.02.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 33/2012, neni 45. VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.” pikat 1,2,3, për regjistrimin e pasurive në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar me ligjin nr. 9/2016, datë 11.02.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 33/2012, neni 45. Mos përfundimi i këtij procesi rrit riskun, që objektet që nuk kanë të përfunduar procesin mund të tjetërsohen nga palë të treta.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Nga drejtimi i shoqërive të merren masa që në të ardhmen, të ndiqet me përgjegjshmëri përfundimi i procesit të kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, në shoqërinë OSHEE sh.a, ose në tre shoqëritë bija sipas raporteve respektive të ndarjes.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

“Shoqëria OSHEE GROUP SH.A., nëpërmjet Akt Marrëveshjes (Kontratë e Kalimit e të Drejtave Reale) me nr.repertori:1441 dhe nr.koleksioni:608, datë 16.12.2020, i ka ceduar dhe transferuar asetet shoqërisë OSSH SH.A, shoqëri e liçensuar për shpërndarjen e energjisë elektrike, me aksioner të vetëm Shoqërinë OSHEE GROUP SH.A. Shoqëria OSHEE GROUP SH.A., nëpërmjet Akt Marrëveshjes (Kontratë e Kalimit e të Drejtave Reale) me nr.repertori:1443 dhe nr.koleksioni:610, datë 16.12.2020 i ka ceduar dhe transferuar asetet shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU SH.A), shoqëri e liçensuar për furnizimin me energji elektrike, me aksioner të vetëm Shoqërinë OSHEE GROUP SH.A.

Me ndryshimet sipërcituara gjithashtu duke qenë se pjesa dërrmuese e pasurive të paluajtshme inventarizuar me VKM 1108/2008 kanë mospërputhje të sipërfaqeve fakt / titull pronësie vkm 1108/2008, mospërputhje e cila e bën të pamundur regjistrimin e pasurisë, sikurse janë shtuar

edhe pasuri të reja në rrjetin shpërndarës(kabina elektrike), gjatë kësaj periudhe kemi punuar për krijimin e një liste të re të përditësuar të inventarit të pasurive me qëllim dërgimin e kësaj liste në Këshillin e Ministrave për të dy shoqëritë që i janë transferuar asetet, konkretisht OSSH SH.A. dhe FSHU SH.A. Inisiativën tonë e përforcon edhe VKM nr.28, datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunim ndërmjet institucioneve”, të procesit të inventarizimit, plotësimit dhe përditësimit të listës së pronave shtetërore, e cila kërkon nisjen e procesit të inventarizimit, plotësimit dhe përditësimit të listës së pronave shtetërore, deri në regjistrimin e tyre në regjistrat publik të administruar nga ASHK. Sa më sipër nga ana jonë, krahas procesit të krijimit të një liste të re inventari, kemi vijuar edhe me procesin e regjistrimit të pasurive në emër të Shoqërive bija sipas akteve sipërcituara, për pasuritë të cilat përpunohen sipërfaqet faktike me ato në titullin e pronësisë VKM 1108/2008”.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

19. Gjetje nga Auditimi: Në raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë dhe dokumenteve shpjegues, mungonte deklaratat e miradministrimit të shoqërisë, praktikat e ndjekura prej saj si dhe profili i administratorëve dhe anëtarëve të këshillave, ku të shpjegohen elementët dhe faktet që i kualifikojnë për kryerjen e detyrave të caktuara nga shoqëria.

Këto veprime zvogëlojnë transparencën e menaxhimit të shoqërisë si dhe janë në kundërshtim me nenin 134, të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: Administratorët e shoqërive të marrin masa për plotësimin e deklaratave të miradministrimit të shoqërisë, praktikat e ndjekura prej saj, si dhe profilet e administratorëve dhe anëtarëve të këshillave, ku të shpjegohen elementët dhe faktet që i kualifikojnë për kryerjen e detyrave të caktuara nga shoqëria, për të rritur transparencën e menaxhimit të shoqërisë.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Departamenti Ligjor ka përgatitur formatin e deklaratave të mirëbesimit...së bashku me CV e pjestarëve të Këshillave të Administrimit dhe Administratorve...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

20. Gjetje nga Auditimi: Në shënimet shpjeguese, nga drejtimi i shoqërisë nuk janë paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme së AAM-ve, pra për normat e amortizimit të aplikuara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore në kundërshtim me pikat 75 të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivitet Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).

-Në lidhje me përlllogaritjen e shpenzimeve të amortizimit, shoqëria përdor norma menaxheriale si dhe normat fiskale, duke paraqitur diferencën në shpenzimet e pazbritshme, të rezultatit të periudhës ushtrimore. Normat menaxheriale dhe ato fiskale të përdorura kanë

mbetur të pandryshuara nga periudha e ish CEZ. Jetëgjatësia e aktiveve është rishikuar nga vlerësimi i kryer nga grupi i ekspertëve vlerësues dhe kontabël, që me urdhrin nr. 1460, datë 20.02.2015, i ndryshuar të ministrit të MZHETTS si dhe bazuar në kontratën nr. 23318 prot., datë 31.12.2015 “Për rivlerësimin e aktiveve afatgjatë materialë të shoqërisë Oshee SHA”.

-Shoqëria nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16, dhe pikës 75 të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivitet Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Duke mos përdorur norma menaxheriale të mirëargumentuara nga specialistët përkatës dhe duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, shoqëria rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa për vlerësimin e jetëgjatësisë së aktiveve, duke përdorur fleksibilitet dhe relacione të mirë argumentuara nga specialistët përkatës, për klasa specifike të aktiveve dhe jo të përgjithshme, për planifikimin në kohë të zëvendësimit të aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Me shkresën nr. 5426 prot., datë 10.07.2023 me lënd “Përcaktimin e jetës së dobishme të aktiveve afatgjatë-aseteve” është kryer përcaktimi i jetëgjatësisë së aseteve.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*

21. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i kryer në librat e blerjes për deklaratimet e faturave të blerjes, u konstatua se kishte fatura që i përkisnin periudhave ushtrimore të mëparshme ose të lëshuara nga subjektet disa muaj më parë dhe që departamentit të financës, u ishin vënë në dispozicion në muajin e deklaruar. Këto veprime sjellin efekte në kontabilizimin e aktiveve dhe përcaktimin e datës së hyrjes në përdorim. Në Standardin Ndërkombëtar i Kontabilitetit 16 “Aktivitet Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)”, neni 55, përcaktohet se amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, pra pasi aktivi është marrë në dorëzim dhe është bërë pjesë e sistemeve përkatëse. Ky veprim sjell shtrembërime në llogaritjen e saktë të amortizimit të aktiveve të shoqërisë duke ndikuar në rezultatin e shoqërisë. Vonesat në mos likuidimin e faturave, krijojnë mundësinë e krijimit të penaliteteve nga Operatori Ekonomik, i cili ka kryer objektin e investimit, dhe në bazë të neneve të kontratës dhe ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 4, OE i lind e drejta për të kërkuar kamatëvonesa. Veprimet e mësipërme sjellin efekte dhe në raportin e TVSH-së kreditore dhe debitore, duke mos pasqyruar detyrimet e sakta në kohë të shoqërisë, për pagesat e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë të merren masa për kryerjen me përgjegjshmëri dhe brenda afateve përkatëse të procesit të nënshkrimit të faturave tatimore nga personat e autorizuar, si një dokument zyrtar i shoqërisë i pranimit të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr. 4243 prot., datë 19.06.2024 është miratuar udhëzimi “Mbi procesin e lëshimit/konfirmimit/refuzimit të faturave të fiskalizuara” dhe me shkresën nr. 4244 prot., datë 19.06.2024 është nxjerrë autorizimi për përcaktimin e punonjësve përgjegjës për procesin e lëshimit/konfirmimit/refuzimit të faturave të fiskalizuara.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

22. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara u konstatua se, nuk është kryer zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme të shoqërisë sipas metodologjisë të zhvlerësimit të kërkesave tregtare për arkëtim. Për periudhat e mëparshme shoqëria ka përdorur metodologjinë e përcaktuar në raportin e audituesit ligjor “B.Shpk”, e miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 39, datë 20.07.2017, ku në raportin e paraqitur nga audituesi ligjor janë kryer supozime hipotetike nga pika 5.5.17 C dhe 5.5.19 për maksimumin e periudhës kontraktuale pa vlerësuar të dhënat aktuale që disponon shoqëria. Raporti paraqet metodologjinë e zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme sipas standardit të raportimit SNRF 9.

Shoqëria OSHEE nuk duhet të marrë parasysh veç metodologjinë e standardit, por edhe ligjet kombëtare bashkë me ligjet e faljes së detyrimeve, të cilat janë të parat që duhen reflektuar në pasqyrat financiare dhe më pas në programin ekonomik.

Gjithashtu Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 15 “Të ardhurat nga Kontratat me Klientët”, “Kontratat me klientët”, Paragrafi 113. Ky informacion nuk ka shpjegimet përkatëse të cilat e bëjnë të përshtatshëm për tu përdorur nga palët e treta, si dhe drejtimi i shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa për kryer zhvlerësimit i llogarive të arkëtueshme të shoqërisë sipas metodologjisë të zhvlerësimit të kërkesave tregtare për arkëtim, duke u nisur nga të dhënat aktuale që disponon shoqëria për të pasur një situatë sa më të besueshme dhe reale.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Nga ana e OSHEE në planin financiar të vitit 2024 është parashikuar vlera për prokurimin e shërbimit për përgatitjen e një metodologjie të re sipas standardeve IFSN9.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

23. Gjetje nga Auditimi: Gjatë procesit të inventarizimit fizik të vlerave materiale në magazinat e OSSH-së, nga komisionet përkatëse, për periudhën 2021, në relacionin përfundimtar në zbatim të Urdhrit nr. 13037 prot., datë 06.12.2021, u evidentuan artikuj me qarkullim të ngadalshëm në këto magazina, me vlerë totale në **257,303,138 lekë**, artikuj të bërë hyrje në periudha të mëparshme dhe në ato të fundit.

Në relacionin teknik drejtuar Drejtorisë Ekonomike, për nevojat e shoqërisë për bazë materiale për mirëmbajtje, nga Divizionit të Shpërndarjes, janë hartuar dhe përllogaritur në Planin e

Mirëmbajtjes, sasitë vjetore të parashikuara. Nga kjo drejtori nuk janë kryer me saktësi llogaritjet për sasitë e artikujve të kërkuar për buxhetin e viteve 2020, 2021, duke krijuar materiale stok, që përveç se ka impenjuar fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Për llogaritja jo e saktë e sasive të artikujve të kërkuar për tu blerë, sjell riskun e krijimit të materialit stok, që përveç se impenjon fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1 Rekomandimi: Nga administratori i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, strukturat e ngarkuara për planifikimin e bazës materiale për mirëmbajtje, të kryejnë kërkesat e tyre të bazuara në raporte të mirë argumentuara, të specifikuara dhe të detajuara, për shmangien e krijimit të materialeve stok dhe një menaxhim me efektivitet dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Urdhri nr. 18, 6071/1 prot., datë 16.08.2023. DSHM /OSSH kane paraqitur relacion / kerkese per miratim ne Keshillin Mbikqyres te Oshee Group per nxjerrjen jashtepedorimit te materialeve ne magazinat e OSSH.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

24. Gjetje nga Auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur për inventarët e datës 31.12.2021 u konstatua se, shoqëria ka gjendje pjesë materiale e artikuj të ndryshëm, të vlerësuar si jashtë përdorimit me vlerë kontabël të mbetur 197,492,859 lekë.

Nga administratori i shoqërisë janë iniciuar procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit pas vlerësimit të komisioneve të ngritura. Më datë 04.06.2018, eksperti i vlerësimit i caktuar nga MIE, ka dorëzuar raportin e vlerësimit, për shkarkimin nga librat kontabël vlerën e inventarit prej 179,436,025 lekë, dhe më datë 18.10.2018, me vendimin nr. 29, Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar raportin, si dhe ka miratuar vlerën e inventarit 108,7843,007 lekë të vlerësuar për tu shitur si skrap, sasinë 495,137 kg në vlerën 30,956,459 lekë, si dhe miratimin e vlerës së inventarit 70,593,018 lekë për tu asgjësuar.

Shoqëria, deri në përfundim të datës së auditimit, nuk ka iniciuar procedurat për hapjen e ankandit publik veprime që ngarkojnë me përgjegjësi administratorin e shoqërisë.

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar asetin për vlerën kontabël të mbetur konform kërkesave të Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 108 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, i ndryshuar. Mos kryerja në kohë e ankandit sjell vështirësi logjistike, duke bllokuar hapësira magazinuese si dhe rrit riskun për dëmtime dhe zhvlerësime të mëtejshme të vlerës së aktiveve të vendosura për tu shitur.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për vlerësimin e gjendjes aktuale të materialeve skrap, testimin real të tregut, hapjen e procedurës së ankandit publik për shitjen e materialeve dhe duke proceduar më pas në vijimësi sipas situatës.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Urdhri nr. 18, 6071/1 prot., datë 16.08.2023. DSHM /OSSH kane paraqitur relacion / kerkese per miratim ne Keshillin Mbikqyres te Oshee Group per nxjerrjen jashtepedorimit te materialeve ne magazinat e OSSH.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

25. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi konstatohet se, situata debitore e OSHEE Group në fund të periudhës 2022 është përkeqësuar në krahasim me vitin 2020, duke u rritur me 13,997,171 mijë lekë dhe që arrin në një total prej 139,653,687 mijë lekë. Në strukturën e detyrimeve që ka shoqëria, një pjesë e madhe përbëhet nga detyrimet ndaj Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. për blerje energjie, hua dhe interesa dhe për periudhën 2021-2022, janë rritur në vlerën 4,387,945 mijë lekë, dhe detyrimi total është në vlerën 65,743,270 mijë lekë. Mes shoqërive është rënë dakord për balancën e detyrimeve që OSHEE ka ndaj KESH më datë 31.12.2020, vlera 48,910,915 mijë lekë. Kjo vlerë do të paguhet me këste, duke filluar në vitin 2021 deri në vitin 2046. Detyrimet e OSHEE ndaj OST për transmetim energjie, hua dhe interesa për periudhën 2021-2022, ku OSHEE i detyrohet OST detyrime në vlerën 15.268,646 mijë lekë deri në 31.12.2022, detyrimet e OSHEE ndaj OST deri në vitin 2022 janë rritur me vlerën 3,557,129 mijë lekë. OSHEE ka lidhur një marrëveshje me OST datë 15.04.2021 për pagesën e detyrimeve të prapambetura. Shoqëria ka rritje të detyrimit për energji elektrike ndaj HEC-eve në vlerën 2,746,462 mijë lekë si dhe ka ulur me 8,961,484 mijë lekë detyrimin për energji elektrike nga importi.

Gjatë periudhës 2022 janë rritur huatë afatgjata me 6,026,538 mijë lekë, me pjesën më të madhe në 5,497,318 mijë lekë nga EBRD. Huatë ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) përbëhen nga: - Hua afatgjatë të financuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, miratuar me ligjin nr. 170/2014, datë 11.12.2014. Për zbatimin e projektit, Shoqëria dhe MFE kanë nënshkruar marrëveshjen e nënhuasë më 31.12.2014, të ndryshuar më 19.01.2018, me vlerë 69,679 mijë Euro. - Huatë buxhetore nga MFE, detyrimi i përket huasë afatgjatë në vlerën 1.5 miliard lekë. Kjo hua është marrë në vitin 2017 me interes 0.25% për tu ripaguar brenda vitit 2019 dhe huasë afat shkurtër në vlerën 1 miliard lekë. Kjo hua është marrë në vitin 2017 me interes 0.25 % për tu ripaguar brenda vitit 2018, por që mbetet në detyrimet e shoqërisë.

Në periudhën e fundvitit 2021 dhe në 2022, shoqëria ka rritur borxhin afatshkurtër në vlerën 17,060,882 mijë lekë, duke pasur një rritje në 9,579,154 mijë lek në hua afatshkurtra (Oëerdrafte) nga bankat e nivelit të dytë.

Detyrimet ndaj Tatimeve janë ulur në vlerën 1,151,068 mijë lekë dhe vlera e fund vitit 2022 5,279,056 mijë lekë përbëhet nga detyrimet për tatimin mbi fitimin kur 1,146,452 mijë lekë është principal, 2,805,637 mijë lekë gjoba dhe 1,269,529 mijë lekë janë interesa.

Vështirësitë e shkaktuara në sistemin energjetik për arsye klimaterike, mungesa e reshjeve gjatë viteve 2017 dhe 2019 si dhe rritja e pa parashikuar e çmimeve në import në 6-mujorin e dytë të 2021, dhe në vitin 2022, detyroi OSHEE të blinte energji elektrike në tregun e jashtëm me çmime jo të favorshme, duke kërkuar një pjesë e rëndësishme e arkëtimeve të shoqërisë.

OSHEE ka hasur vështirësi me likuiditetin gjë që shkaktoi rritjen e detyrimeve për blerjen e materialeve për investimet me kontrata të lidhura në proces. Rritja e detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata shton barrën financiare, duke kufizuar aftësitë e shoqërisë për investime të mëtejshme. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pika 2, neni 12.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të shoqërisë duhet të marrin masa në përmirësimin e situatës debitore të shoqërisë duke rritur të ardhurat kryesore, mbledhjen e llogarive të pagueshme nga klientët, uljen e kostove, negocimin e kushteve më të mira me institucionet e kreditit, si dhe shtimin e kapitalit të shoqërisë.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Duke krahasuar të dhenat e debise të 6 mujorit të parë të 2023 me 6 mujorin e parë të 2024, detyrimet në principal janë reduktuar me 0.8 %.

Faktor për reduktimin e detyrimeve janë masat organizative që janë ndërmarrë nga FSHU Sh.a në bashkëpunim me OSSH Sh.a, pjesë të OSHEE Group sha, me strukturat e terrenit për “ndjekjen e debitorëve” duke rritur numrin e nderprejeve të energjisë elektrike si mekanizem për rritjen e arketimeve. Në 6-mujorin e parë të 2023 janë realizuar 16,700 nderpreje ndërsa në 6 mujorin e parë të 2024 janë realizuar 40,647 nderpreje.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 janë ofruar dhe implementuar skema lehtësuese në sistemin për pagesën e detyrimeve të prapambetura për pagesë të detyrimeve deri në 31.12.2022 duke sjelle kështu likuidimin e menjehershëm të detyrimeve për të vitet 2023-2024 si kusht i përfitimit të skemave.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 11 (Njëmbëdhjetë) procedurave të prokurimit “Punë dhe Mallra”, në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a me objekt: 1- "Rikonstrukcion rrjeti TU me ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabinë e re shtyllore"; 2- "Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, fideri F6, kabinave përkatëse dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti III ", 3- “Blerja e PDA dhe tablet, si dhe monitorimi i punonjësve”, 4- “Fiderat e rinj 20 KV të Nënstacionit Vorë”, 5- “Bazë materiale për nyjet kritike”, 6- “Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti II”, 7- “Ndërtim i disa kabinave të reja si dhe zhvillimi i rrjetit TU me kabull me vetëpërmbajtje ABC në kabinat e fiderave 3,4 dhe 6 të N/St Gramsh”, 8- “Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti III”, 9- “Rikonstrukcion i linjës 35kV Korçë - Bilisht”, 10- “Rikonstrukcion dhe ndërtim kabinash muraturë në Korçë”, 11- “Rikonstrukcione të rrjetit TM, TU në zonat e përgjegjësive në agjencinë Bilisht. Rikonstrukcion kabinash tip murature në Agj. Bilisht. Spostim i fiderit Nr 5, N/St Bilisht tek Fideri Nr 6 N/St Bilisht. Rikonstrukcion rrjeti TM 10kV fideri 8 ndërtim kabine BOX”, janë konstatuar se në mënyrë të gabuar nga ana e njësive të prokurimit, jo të gjithë kriteret e pjesëmarrjes janë argumentuar teknikisht në një procesverbal në referim të grafikut, volumeve, natyrës së punës apo zërave të preventivit të cilat do të justifikonin dhe ligjëronin vendosjen e secilit kriter. Janë konstatuar mangësi në kategori licencash, mangësi në stafin drejtues, mangësi përcaktimin e specialistëve, mangësi në makineri e pajisje, mangësi përcaktimet e kushteve të bashkimit të operatorëve, mangësi në certifikatat dhe standarde, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 , e ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61. Janë konstatuar shkelje të nenin 46,

të LPP. Kriteret kualifikuese nuk kanë nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe nuk është stimuluar pjesëmarrjen e tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1 Rekomandimi: OSHEE, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjësve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më efeciente.

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit...ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet...kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

26.2 Rekomandimi: AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës për punë, mallra, shërbime. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar teknikisht dhe ligjërish, duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit...ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet...kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik...

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AK e OSHEE GROUP sha ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet e hapura nga APP kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik . Sa më sipër do të kërkonim rishikimin e kësaj gjetje të grupit të auditimit, nga i pazbatuar në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 2 (dy) procedurave të prokurimit “Punë dhe Mallra”,

në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave si më poshtë:

Në procedurën e prokurimit me objekt “Elemente të qarqeve primare për mirëmbajtje të N/stacioneve elektrike të shpërndarjes”, dhe në procedurën e prokurimit “Elemente për mirëmbajtje të qarqeve sekondare për N/stacione”, nga verifikimi në SPE për dokumentacionin e operatorëve ekonomik dhe vlerësimin të ofertave konstatohet se operatori fitues “El-Poëer”, ka disa mangësi në plotësimin e Dokumenteve të tenderit. Kontratat Individuale të Punës, me Ing. Mekanik dhe Ing. Elektronik, nuk janë në përputhje me Kodin e Punës i RSH, neni 21, pika 3. Disa nga Test raportet e lëshuar nga prodhuesit, janë përkthyer nga punonjësja e operatorit fitues e cila nuk është në listën e përkthyesve të njohur nga Ministria e Drejtësisë dhe vërtetimi i përkthimit është i pavlefshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1 Rekomandimi: AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimin të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s’kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit...ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet...kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik...

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AK e OSHEE GROUP sha ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet e hapura nga APP kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik. Sa më sipër do të kërkonim rishikimin e kësaj gjetje të grupit të auditimit, nga i pazbatuar në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusin e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

28. Gjetje nga auditimi: Sipas procedurës së prokurimit “Blerja e PDA dhe tableta, si dhe monitorimi i punonjësve”, për përcaktimin e çmimit është aplikuar studimi i tregut nëpërmjet ofertave të 5 OE dhe konkretisht: “B”, P, me vlerë 161,000,000 lekë, “A T” SHPK, me vlerë 160,000,000 lekë. “I” SHPK, me vlerë 154,000,000 lekë, “P I” SHPK, me vlerë 156,000,000 lekë, “B..” SHPK, me vlerë 186,000,000 lekë. Fondi limit është përcaktuar me vlerë 157,200,000 lekë. Nga auditimi rezulton se OE “I” SHPK dhe OE “P I” SHPK, nuk kanë të

regjistruar në QKB aktivitet programimi. OE “B..” SHPK, nuk ka të regjistruar asnjë objekt në lidhje me prokurimin, si për ofrimin e pajisjeve elektronike, ashtu dhe programimin. Sa më sipër arrihet në konkluzionin se përlllogaritja e fondit limit duke pranuar oferta nga OE që nuk ushtrojnë aktivitet të fushës, plotësisht apo pjesërisht, nuk është e argumentuar. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i shfuqizuar), neni 59.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1.Rekomandimi: OSHEE sh.a të marrë masa të vazhdueshme për përcaktimin e vlerës paraprake të kontratave, si duke bërë studimin real të tregut, por duke përdorur edhe metoda të tjera, në mënyrë që ta blejë punën, mallrat apo shërbimet me sa më ekonomikitet.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit...ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet...kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik...

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AK e OSHEE GROUP sha ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet e hapura nga APP kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik. Sa më sipër do të kërkonim rishikimin e kësaj gjetje të grupit të auditimit, nga i pazbatuar në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

29. Gjetje nga auditimi: Në shtyllat e vendosura sipas kontratës “Rikonstruksion rrjeti TU me kabell ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabine e re shtyllore”, por dhe kontrata të tjera mungon:

- Etiketa e identifikimit të prodhuesit, në të cilën përcaktohen: Emri i prodhuesit, data, muaji dhe viti i prodhimit, numri i strukturës, gjatësia e shtyllës, kapaciteti (momenti) ne sipërfaqen e tokës, ose pika e fiksimit, logo e blerësit/OSHEE etj.

- Etiketa e identifikimit të shtyllës, në të cilën përcaktohen: Emri i pikës së transformimit, emri i linjës dalëse TU, lloji i shtyllës, ndërmjetëse/ankerore ose ankerore fundore, numri i shtyllës. Etiketa duhet të jetë më sfond ngjyrë gri, korniza ngjyrë e gjelbër me trashësi 10 mm, me dimensione 210 x140 mm.

- Etiketa paralajmëruese e sigurimit teknik.

Veprim në kundërshtim me specifikimet teknike “Shtylla beton arme të centrifuguara”, pika 8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1.Rekomandimi: OSSH sh.a, të marrë masa që për projektet e realizuara, në proces apo në vazhdimësi, të parashikojë dhe kërkojë vendosjen e etiketave të identifikimit të prodhuesit,

identifikimit të shtyllës dhe etiketës paralajmëruese të sigurimit teknike, në të gjitha shtyllat si betonarme, ashtu metalike apo material tjetër.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Nga ana e Oshee Group është kryer vendosja e etiketave të identifikimit të prodhuesit, identifikimit të shtyllës dhe etiketës paralajmëruese të sigurimit teknike.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

30. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i materialeve të furnizuara sipas kontratës “Blerje bokse individuale dhe aksesore për sistemin e matjes”, rezulton se sipas zërit 1 “Bokse individual të integruar për matës statik 1 fazor me automat 1 P 230 V 25 A, pa matës”, bokset janë dorëzuar pa asnjë shenjë dalluese të prodhuesit, të ndonjë specifikimi të llojit apo specifikim tjetër. Po ashtu, bazamenti i boxeve ishte transparent, nga ku vërtetohet që bazamenti nuk është i përforcuar me fibra xhami, pasi është i njëjti material me kapakun. Në ambalazhin e boxeve është paraqitur se boxet plotësojnë standardin IP 41-54, ndërkohë që standardi i kërkuar është jo më i vogël se 54. Mbulesa e përparme është përcaktuar me copë litari me shkumë poliuretani, ndërkohë që në specifikime teknike përcaktohet që kapaku do të jetë transparent, i pathyeshëm, rezistente ndaj temperaturës së lartë dhe rrezeve ultraviolette (UV), si dhe i bërë nga polikarbonat rezistent”. Vendosja e diapazonit nga 41 deri 54, nuk garanton në çdo rast specifikimin e kërkuar.

Sa i takon bokseve për matës 3 fazorë, boksi ka të stampuar vetëm markën “YAVUZ” dhe në ambalazh nuk ka të përcaktuar asnjë specifikim teknik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, (i ndryshuar) pikat 45, 46, 47, si dhe specifikimet teknike, Pika 7.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.1.Rekomandimi: OSHEE sh.a, të marrë masa që për kontrata në vazhdimësi të verifikojë me korrektësi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të materialeve të furnizuara me ato të parashikuara në procedurat e prokurimit, me qëllim garantimin e cilësisë së materialeve dhe jetëgjatësinë e tyre.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit...ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet...kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik...

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AK e OSHEE GROUP sha ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet e hapura nga APP kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik. Sa më sipër do të kërkonim rishikimin e kësaj gjetje të grupit të auditimit, nga i pazbatuar në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve

dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

31. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit: “F.V dhe Instalim të sistemit të Matjes Inteligjente në Kabinat Elektrike të OSSH sh.a, software-t dhe integrimet e tyre në platformën MDMS (Mater data mangement system)” nuk janë kërkuar kapacitete teknike për realizimin dhe përgatitjen e infrastrukturës për LV Smart Grid (Rrjetin inteligjent në TU) dhe të gjitha modulet për operacionet e saj. Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 01.09.2022 për F.V dhe Instalimin e sistemit të Matjes Inteligjente, në DST dhe relacion teknik pika 2.3.4, nuk është kërkuar Inxh. Elektronikë, Inxh. Mekatronik apo Inxh. Informatike, që autoriteti kontraktor të sigurohet për realizimin e sofwarëve apo Upgradimin i sistemit HES. Në dokumentet e hedhura në tender nuk kërkohet asnjë kontratë me specialist të fushës së programimeve apo kompani për bashkëpunim për mirëmbajtje programesh në lidhje me specifikimet e projektit, sipas nenit 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Pika 2, Pika 4. dhe nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik, ku operatori fitues disponon vetëm 26 punonjës kryesisht elektrikistë, 4 Inxh elektrik, 1 Inxh elektroenergjitik dhe 1 Inxhinier Ndërtimi. Referuar zërave të ofertës fituese Upgrade i sistemit HES në vlerën 45,000,000 lekë, Training Packege në vlerën 8,500,000 lekë, Test dhe Inspektimi në vlerën 3,350,000 lekë, Komisionim dhe operimi në vlerën 3,350,000 lekë, në total prej 60,200,000 lekë pa TVSH, nga AK OSHEE sh.a, realizimi i tyre paraqitet me risk bazuar në kapacitetit teknik të OE fitues.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, OSHEE Group sh.a, në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret kualifikuese të jenë në përputhje e të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasën e kontratës, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit...ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet...kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik...

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AK e OSHEE GROUP sha ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet e hapura nga APP kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik. Sa më sipër do të kërkonim rishikimin e kësaj gjetje të grupit të auditimit, nga i pazbatuar në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

32. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht” është konstatuar pasaktësi në përlllogaritjen e fondit limit dhe mangësi në përzgjedhjen e llojit të kontratës. Përlllogaritja e fondit limit është bërë e përgjithshme për punimet që do të realizohen, por në dokumentet e tenderit preventivi është konceptuar me çelësa në dorë. Të gjitha projektet dhe detajet do të jenë subjekt i aprovimit nga Investitorit. Investitori ka të drejtën ti kërkojë kontraktorit, pa kosto shtesë, për çdo ndryshim në projekt dhe detaje, të nevojshme për ta realizuar objektin konform kushteve të kontratës. Ofertuesi duhet të ofroje sasi të në përputhje me formularin e çmimeve. Këto sasi janë vlerësuar për qëllime tenderimi, të bazuara në projekt idenë paraprake. Verifikimi i sasive nga Drejtoria e Tensionit të Lartë do të bëhet gjatë fazës së projektimit të detajuar dhe janë subjekt i miratimit nga Investitorit. Kontraktori duhet të vendose sasi të nevojshme bazuar në projektin e tij final të miratuar. Referuar sa më sipër, konstatohet se nga AK është hartuar një projekt ide, duke mos përcaktuar saktë fondin limit të kontratës prej 249,996,339 lekë pa TVSH. Parashikimi i projektimit për realizim nga kontraktori, si dhe përcaktimi kontratë me çelësa në dorë ndërkohë që projektimi duhet të prokurohet nga autoriteti kontraktor, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 26, pika 1.b. Në preventivin e punimeve është përfshirë pagesë për realizimin e projektit të zbatimit. Nga ana e Kontraktorit është parashikuar për projektimin vlera 9,650,000 lekë pa TVSH.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.1.Rekomandimi: Nga AK, të merren masa që në të ardhmen të bëhen analiza kosto përfitim për kontratat e parashikuara. Projekt zbatim dhe preventivi i punimeve duhen realizuar para hapjes së procedurës së prokurimit, duke stimuluar konkurrencën e operatorëve ekonomikë.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit...ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet...kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik...

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AK e OSHEE GROUP sha ndjekin në mënyrë të vazhdueshme të gjitha trajnimet e hapura nga APP kjo në zbatim të detyrimeve ligjore e të ligjit për prokurimin publik. Sa më sipër do të kërkonim rishikimin e kësaj gjetje të grupit të auditimit, nga i pazbatuar në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17

prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

33. Gjetje nga auditimi: Nga zbatimi i kontratës “Blerje bokse individuale dhe aksesore për sistemin e matjes”, rezulton se megjithëse ka kaluar një periudhë e konsiderueshme afro 3 vite nga realizimi i furnizimit, një pjesë e konsiderueshme e materialeve nuk janë vënë në përdorim. Nëse u referohemi zërave të veçantë, boxet për matësit 3 fazorë janë vënë shumë pak në përdorim, nga 13550 copë të blerë, janë vendosur 5120 copë, ose 37 % e sasisë. Theksojmë faktin se, boxet e blera nuk janë vënë në përdorim vetëm në rajonin e Fierit, por edhe në rajone të tjera, të cilat kanë patur nevojë, nëpërmjet transferimit. Rezulton se nuk janë bërë parashikime të sakta në lidhje me nevojën për materiale, duke krijuar stok të pa nevojshëm (mallra me qarkullim të ngadaltë), sidomos sa i takon bokseve për matës 3 fazorë. Është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, (i ndryshuar), pika 18.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1. Rekomandimi: OSHEE, të planifikojë në mënyrë sa më të saktë nevojat për blerjen e materialeve, në mënyrë që të shmanget blerja përtej nevojave, duke krijuar stok dhe qarkullim të ngadaltë të tyre.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E. K. ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Në bashkëpunim me strukturat e OSSH po ndiqen të gjitha hapat e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi.

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Në bashkëpunim me strukturat e OSSH po ndiqen të gjitha hapat e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi. Sa më sipër do të kërkonim rishikimin e kësaj gjetje të grupit të auditimit, nga i pazbatuar në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

34. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit konstatohet se, sipas programit ekonomik në OSHEE GROUP sh.a për vitin **2020**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7,138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2020 është realizuar 6,420 punonjës. Fondi i pagave është 3,258,029,500 lekë, pra 359,374,326 lekë më pak se programi.

Sipas programit ekonomik në OSHEE GROUP për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7,138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezultoi se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2021 është realizuar 6,564 punonjës. Fondi i pagave është 6,536,253,000 lekë, pra 420,424,852 lekë më pak se programi.

Sipas programit ekonomik në OSHEE GROUP për vitin **2022**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezultoi se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2022 është realizuar 6,156 punonjës. Fondi i pagave është 6,359,574,212 lekë, pra 921,310,438 lekë më pak se programi. Mosplotësimi i vendeve të planifikuara të punës çënon performancën e shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

34.1. Rekomandim: Nga Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të merren masa për plotësimin e nevojave për punonjës të shoqërisë, referuar parashikimeve të programit ekonomik.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

DBNJ ka kryer testimet dhe fushata rekrutimi për plotësimin e vendeve vakante me punonjës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *është zbatuar*.

35. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi konstatohet se në Drejtorinë e Përgjithshme të OSHEE SHA: Nuk është hartuar Rregullorja e Brendshme; Është hartuar “Procedura e lëvizjeve të stafit”, “Kodi i sjelljes”, dhe “Udhëzimet operative në sektorin e planifikimeve, trajnimeve dhe vlerësimet e performancës”; Nuk është bërë për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve; Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë, nga Burimet Njerëzore, pranë OSHEE sh.a nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura.

-Po ashtu procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhje nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.

-Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 86 masa disiplinore, në Drejtorinë e Përgjithshme të OSHEE sh.a, nga këto 14 “Vërejtje me shkrim”, 3 masa “Vërejtje me shkrim, paralajmërim për largim nga puna” dhe 69 masa “Pushim nga puna”. Janë audituar 35 nga këto procedura, pra 40%. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedurë transparente, si dhe nuk ka komision apelimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

35.1 Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të shoqërisë OSHEE SHA.

Nga Administratori dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me masat disiplinore në shoqërinë OSHEE sh.a.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Bashkëlidhur do të gjeni edhe Vendimin e Asamblesë nr. 5671/3, datë 31.07.2024...si dhe Rregulloren e Përgjithshme të OSHEE sh.a...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

36. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, niveli i pagave është përcaktuar me VKM nr. 574, datë 03.08.2016 “Miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA”.

Niveli i klasave në këtë vendim është bërë në 4 grupe, nga 1 më i ulëti te 4 më i larti, por në këtë klasifikim nuk janë përcaktuar kriteret që i diferencojnë qartë këto klasa. Nga informacioni i marrë nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore, nuk ka kritere të përcaktuara qartë dhe praktika e krijuar ka qenë klasifikimi nga 1, si shkalla më e ulët në 4, si shkalla më e lartë, duke ju lenë në dorë drejtuesve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (duke ruajtur fondin e pagave), sipas aftësive dhe përgjegjësive, detyrave dhe shkallës së vështirësisë në kryerjen e tyre, si dhe volumit të punës që punonjësit kanë. Nga sa më sipër rezulton se, nivelet e pagave për vitet 2020, 2021 dhe 2022, duhet të ishin miratuar nga organet kolegjiale drejtuese (Këshilli Mbikëqyrës) të shoqërisë tregtare, me kapital mbi 50 % shtetëror, brenda kufirit minimal e maksimal të pagës të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive financiare të OSHEE sh.a, në bazë të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja (a), ku citohet se organe kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50% shtetëror, miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

36.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrin masat e duhura, lidhur me miratimin e pagave dhe përcaktimin e kritereve për klasifikimin e tyre sipas secilit nivel.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

OSHEE Group ka paraqitur pranë Këshillit Mbikëqyrës propozimin në lidhje me kategorizimin e pagave sipas niveleve. Këshilli Mbikëqyrës ka dalë me Vendimin nr. 25, datë 10.11.2023 mbi miratimin e kategorizimit të pozicioneve të punës, strukturës dhe nivelit të pagave për punonjësit e shoqërisë Oshee Group sha dhe shoqërive bija. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit të Oshee Group e ka miratuar me vendimin nr. 9114/3, datë 23.11.2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti *i zbatuar*.

37. Gjetje nga auditimi: OSHEE GROUP sha, merr ambiente me qira për të siguruar kushte për akomodimin e punonjësve, kryesisht të qendrave të kujdesit ndaj klientit, punonjësit e administratës qendrore dhe lokale të drejtorive rajonale dhe njësive përkatëse, por edhe ambiente për të magazinuar materialet e mirëmbajtjes dhe të investimeve. Shoqëria për pagesat e qirave, shpenzon mesatarisht në muaj **28,358,125.3 lekë** në dhe në vit arrin vlerën prej **340,237,624 lekë**, shumë kjo e konsiderueshme.

-Nga auditimi i kontratave të qirasë konstatohet se në kontratat e qiramarrjes, parashikohet në nenin 5.3 mbajtja e penalitetit, konkretisht: “nëse ndonjë nga pagesat e qerasë mujore ose ndonjë pagesë tjetër sipas kësaj kontrate mbetet e papaguar pas 15 ditësh nga afati i pagesës së saj, ndaj qiramarrësit do të aplikohet një penalitet në masën 0.05% të shumës së prapambetur. Penaliteti do të fillojë aplikohet pas ditës të 15-të nga momenti i përfundimit të afatit të

pagesës.”. Në kontratën e qiradhënies nuk parashikohet një nen i tillë, dhe për pasojë shoqëria OSHEE sh.a nuk mund të mbajë penaltete lidhur me vonesat në pagesë të cilat shkojnë në vlerën **338,959 lekë**.

-Në kontratat e qiradhënies neni 1, pika 1 parashikohet se “...qiramarrësi nuk ka kryer pagesën brenda një muaji nga data e pagesës së përcaktuar...”, por kjo pikë nuk është zbatuar asnjëherë nga ana e OSHEE sh.a.

-Nga auditimi i procedurave të marrjes së ambienteve me qira, rezulton se OSHEE sh.a nuk ka ndjekur ndonjë procedurë të hapur apo publikime në buletine, në gazetatat kombëtare apo mediat e shkruara, për marrjen e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmime konkurruese, por është nisur dhe ka vazhduar procedurat me propozimet e ardhura nga njësitë respektive sipas rretheve, më tej ka ndjekur një procedurë negociimi çmimi, sipërfaqeje, kushtet e duhura, etj. , nisur dhe nga fakti se shërbimin e arkëtimit për shoqërinë, prej disa vitesh e ofrojnë edhe bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e licencuara për operacione financiare, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqet nr. 229-230 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

37.1.Rekomandimi: Administratori i OSHEE SHA Group sh.a në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse, të analizojnë situatën mbi mundësinë e reduktimit të kostove lidhur me ambientet e marra me qira, duke u nisur nga fakti se shërbimin e arkëtimit për shoqërinë, prej disa vitesh e ofrojnë edhe bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e licencuara për operacione financiare, etj.

- Departamenti Ligjor në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për shtimin e penalteteve në kontratat e qiradhënies dhe sanksionimin e subjekteve debitore nga kontratat e shmangien e krijimit të detyrimeve.

-Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për publikimin e procedurave të marrjes me qira në buletin e APP, në gazetatat kombëtare apo mediat e shkruara, për marrjen e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmime konkurruese.

Menjëherë.

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Departamenti Ligjor në bashkëpunim me DSHM dhe DPP po punojnë për krijimin e për hartimin e procedurave të marrjes me qera...bashkëlidhur do të gjeni një draft të kësaj procedure...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

38. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi shoqëria OSHEE GROUP sh.a dhe shoqëritë e kontrolluara prej saj, kanë funksionuar pa rregullore të brendshme, si dhe nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, referuar përgjigjeve të pyetësorit e MFK, drejtuar Drejtorisë së Zhvillimit të Biznesit, me argumentin se: “... në kuadër të procesit të ndarjes së shoqërisë, rregulloret e shoqërive janë në proces hartimi, duke marrë në konsideratë zhvillimet praktike të proceseve në ndjekje”. Pra, OSHEE GROUP sh.a dhe tre shoqëritë e reja të krijuara kanë funksionuar për gjithë periudhën e auditimit pa rregullore të brendshme, e për rrjedhojë nuk janë unifikuar pozicionet sipas funksioneve që mbulojnë dhe kompetencave.

Lidhur me krijimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) të njësisë publike me pozicione dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë, sipas kuadrit ligjor, në rregulloren përkatëse, konstatohet se, ky grup nuk funksionon, kjo me argumentin e procesit të ndarjes së shoqërisë dhe se ky

grup po ridimensionohet në kuadër të kërkesave të reformimit të sektorit të energjisë, edhe pse këto shoqëri kanë dy vite që funksionojnë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 4, pika 19 "Gjurma e auditimit" dhe me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 "Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqet nr. 230-232 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

38.1 Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë OSHEE GROUP sh.a, të merren masa që të përditësohet kuadri rregullator (rregulloret e funksionimit) për proceset kryesore të punës Drejtorive/Njërive në vartësi të shoqërisë dhe në qendër referuar ndryshimeve strukturore që ka pësuar shoqëria nga ndarja e saj në shoqëri (mëma dhe bija), sipas detyrave funksionale. Nga strukturat drejtuese dhe Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit, të merren masa për ngritjen e Grupit të Menaxhimit, si një organ përgjegjës për hartimin e politikave dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Urdhri mbi krijimin e komitetit të riskut brenda strukturave organizative të OSHEE datë 15.03.2022...ky grup duhet të veprojë si Komitet ku diskutohen dhe merren masa mbi çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në kuadrin e menaxhimit të riskut...në vijim të ndryshimit të legjislacionit për MFK, OSHEE është në proces të ngritjes së grupit të menaxhimit të riskut...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në OSHEE GROUP sh.a për periudhën 1.07.2020-31.12.2021 është konstatuar se, nuk është realizuar plani i auditimeve sipas periudhës së përcaktuar në planin strategjik 2020-2022, planin strategjik 2021-2023 dhe planet vjetore të auditimit, pasi disa nga auditimet e planifikuara nga DAB për çdo vit të mbetura pa u audituar janë mbartur në vitin pasardhës, ose nuk janë realizuar (DEK, Drejtoria Ligjore, njësia PIU, etj.),. Mosrealizimi i plotë i planit të auditimit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm sipas planeve të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, ndikon në mungesën e pasqyrimin objektiv, transparent i të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë për arritjen e objektivave dhe në përmirësimin e aktivitetit të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, si shoqëri mëmë, por dhe të shoqërive të kontrolluara prej saj.

Nga auditimi mbi kryerjen e angazhimeve të auditimit, referuar dokumentacionit të dosjeve të auditimit, u konstatua se në 6 angazhime të përzgjedhura për periudhën objekt auditimi janë tejkualuar afatet e hartimit të Projekt Raportit dhe të Raportit Final, duke tejkualuar afatin 10 ditore për hartimin e tyre, konkretisht: Angazhim auditimi në FSHU sh.a, Departamenti i Shitjeve; angazhim auditimi në OSHEE GROUP sh.a, Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse; angazhim auditimi në DEK; angazhim auditimi në DTL, angazhim auditimi në FTL sh.a dhe angazhim auditimi në OSSH sh.a, Departamenti i Leximit, Menaxhimit të Matjes dhe Bilancit Energjetik.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016, ndryshuar me

urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, Kapitulli IV dhe VII, si dhe me Kartën e Auditimit të Brendshëm dhe Rregulloren e brendshme e funksionimit të DAB në OSHEE sh.a.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10 faqe 232-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

39.1Rekomandimi: Nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të planit të auditimit pas miratimit në organet drejtuese të shoqërisë, sipas afateve të përcaktuara me qëllim pasqyrimin objektiv, transparent të të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë OSHEE GROUP sh.a, si dhe të tre shoqërive të kontrolluara prej saj.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në OSHEE ka marrë të gjitha masat për zbatimin dhe realizimin e planit vjetor...me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

40. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore për blerjen e energjisë elektrike është konstatuar se, nga 10 subjektet e Prodhimit me Përparësi të Energjisë (PPE) të cilët prodhojnë energji elektrike të rinovueshme nga centralet fotovoltaike, bazuar në kapacitetin 2M \dot{W} , miratuar në kushtet kontraktore me Autoritetin Kontraktor (dokumentacionit financiar nga shoqëria OSHEE GROUP sh.a (FTL sh.a) dhe sipas treguesve të programit PVGIS, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet këto centrale e prodhimit të operatorit ekonomik, rezulton se këta subjekte kanë prodhuar me tepër energji se sa është kapaciteti i tyre prej 2M \dot{W} , gjithsej në sasinë 23,568,327 kWh, me vlerë **2,356,730 Euro**, përkatësisht nga: Subjekti “S” shpk në shumën 264,486 Euro; RTS shpk për 247,776 Euro, “A..” shpk për 308,653 Euro; “A.. S” shpk për 213,639 Euro; “S..” shpk për 200,818Euro; “S2S” shpk për 222,965 Euro; “S S” shpk për 245,284Euro; “S w” shpk 175,985 Euro; “L” 202,136 Euro dhe “A.. S..” shpk 274,988 Euro. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar dhe me kushtet kontraktore përcaktuar me kontratat për ndërtimin e Centraleve Fotovoltaike lidhur ndërmjet MIE dhe subjekteve PPE.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 193-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

40.1Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), si institucioni përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kontratave për “Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Centraleve Fotovoltaike”, të ushtrojnë në mënyrë të menjëhershme kontrollin fizik dhe teknik të secilit stacion fotovoltaike, nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike, në drejtim të fuqisë së instaluar dhe sasisë së prodhuar e shitur.

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Shoqëria OSHEE me urdhrin e brendshëm nr. 18, datë 16.08.2023...ka krijuar

grupin e punës për ndjekjen e rekomandimeve të KLSH...për të cilat është informuar edhe KLSH në shkresën e AKBN nr. 3574/1 prot., datë 04.08.2023...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

40.2Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), pas kontrollit të secilit subjekt prodhues, dhe në rast të përcaktimit të shkaqeve të prodhimit më tepër, nga secili subjekt i licencuar, pasojë e ndërtimit dhe instalimit të një fuqie prodhuese më të madhe se ajo e lejuar/miraturar e licencuar (2M \dot{W}), të marrë masa të menjëhershme ndaj tyre, duke i propozuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përjashtimin e subjekteve nga lista e Prodhuësve me Përparësi të Energjisë, si dhe aplikimin e sanksioneve ligjore përkatëse, subjekte për të cilët OSHEE GROUP sh.a me shkresën nr. 8410/3, datë 30.05.2023, pas kontrolleve të ushtruara dhe verifikimit në terren të sistemeve të matjes të këtyre centraleve prodhuese, ka saktësuar se nuk ka parregullsi në matjen dhe regjistrimin e energjisë së livruar nga këto centrale fotovoltaike.

Përgjigjja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Shoqëria OSHEE me urdhrin e brendshëm nr. 18, datë 16.08.2023...ka krijuar grupin e punës për ndjekjen e rekomandimeve të KLSH...për të cilat është informuar edhe KLSH në shkresën e AKBN nr. 3574/1 prot., datë 04.08.2023...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *është zbatuar*.

40.3 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), të njoftojë Kontrollin e Lartë të Shtetit për rezultatet e kontrollit dhe monitorimit të zbatimit të kushteve kontraktore nga subjektet që kanë ndërtuar centrale fotovoltaike dhe masat e marra për zgjidhjen e problematikës.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: AKBN me shkresën nr. 3574/3, datë 19.12.2023...ka informuar OSHEE se me shkresën nr. 3574/2 prot.,datë 19.12.2023 ka përcjellë në KLSH...bashkëlidhur shkresa e AKBN...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *është zbatuar*.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, germat b) dhe c) “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së” dhe mbështetur

në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqësorisë, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësorisht, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **9,831,919 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës “Zgjatim i fiderit A 1, N/stacioni Burdullias dhe rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll ABC”, u konstatua se në situacionin nr. 2, janë përfshirë punime kanali edhe për urën 60 m, ndërkohë që në këtë urë, kabullat kalojnë të inkastruar në anë të urës të futur në tuba plastikë dhe çeliku. Nga përlllogaritjet e volumit të prerjes së asfaltit me disk, prishje shtresë çakulli, shtresë rëre dhe transport, rezultojnë diferenca me vlerë 166,691 lekë, përfituar më tepër nga Kontraktori “E P” SHPK. Ndër zërat e punimeve të përfshirë në fondin rezervë është edhe “F.V hekur betoni periodik Ø 6 mm deri Ø 10 mm (zgarë 10 x 10 cm), në sasinë 0.64 ton. Sasia e betonit respektive është 0.2 m³, që i përgjigjet zgarës në sasinë 0.04 ton. Vlera 67,215 lekë (0.6 ton x 112,025 lekë/ton), është përfituar më tepër nga Kontraktori “E P” SHPK. Nga verifikimi i punimeve në objekt, u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve prej betoni të shtyllave 9/15 kV dhe 9/6 kV. Themelet nuk janë ndërtuar në të gjithë thellësinë me beton por vetëm në sipërfaqe me një trashësi 30 cm, kjo e dallueshme lehtësisht pothuajse në të gjitha shtyllat e verifikuara. Si pasojë e mos zbatimit të kushteve teknike sa më sipër, në 3 shtylla devijimi nga vertikalishteti është i dukshëm. Nga përlllogaritjet e përafërta rezulton se për shtyllat 9/15 kV dhe 9/15 kV është hedhur sasia 0.3 m³ beton (100 cm x 100 cm x 30 cm). Nga verifikimi i librezës së masave dhe situacionit përfundimtar, për këto dy kabina janë certifikuar të vendosura 52 shtylla, me sasi totale betoni 83.3 m³. Sasia e vendosur rezulton 15.6 m³ (52 shtylla x 0.3 m³), nga ku rezulton diferenca 67.7 m³. Vlera 571,360 lekë (67.7 m³ x 8439.6 lekë/m³), është përfituar më tepër nga Kontraktori “E. P.” SHPK. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqësorisë, arkëtimin e vlerës **805,266 lekë**, nga Kontraktori “EP” SHPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Masa shpërblim demit ne zbatim te rekomandimit nr. 1.1 me Nr. 7958/3 Prot., date 30.08.2023. Fatura Nr. 1063/2023 dt 21.09.2023, Refuzuar Fatura në Sistem nga O.E. (Kontraktori) Dokumentacioni i plotë Administrativ është Dërguar në Drejtorinë Ligjore për vijimin e kerkimit të arketimit të vlerës në rrugë gjyqësore.

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Refuzuar Fatura ne Sistem nga O.E. (Kontraktori). Vlera e dëmit do të mbahet nga shuma e Garancisë së Punimeve për këtë kontratë, pas përfundimit të afatit të garancisë. Është njoftuar KLSH për këtë procedurë, përmes shkresës së OSHEE GROUP SHA me nr 185/2 Prot. datë 22.01.2024.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike (numër subjekte (OE) pa fatura bashkangjitur në rolin e dokumentacionit justifikues vërtetues) të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues. Sa më sipër statusi vijon të mbetet pjesërisht i zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i punimeve sipas Kontratës “Ndërtim i rrjetit TU me ABC për 23 kabina Cërrik-Gostime”, kryesisht për kabinat në zonën e Shtërmën (Kabina 1, 2,6,8) dhe Gostimë (1,2,3), u konstatua se nuk janë respektuar specifikimet teknike sa i takon bazamentit të shtyllave prej betoni, si për shtyllat 9/6 kN, ashtu dhe për shtyllat 9/16 kN. Në disa raste të verifikuara shtresa e betonit ndërtohet sipas dimensioneve vetëm në sipërfaqe për trashësi afërsisht 30 cm, por në thellësi nuk respektohen dimensionet e përcaktuara në librezën e masave. Për shtylla 9/6 kN, konsiderohet i realizuar seksioni 0.6 x 0.6 m (për thellësinë 1.3 m). Në këto kushte sasia e betonit që konsiderohet e realizuar është në masën 0.7 m³. Për shtylla 9/15 kN, është konsideruar i realizuar seksioni 0.8 x 0.8 (për thellësinë 1.7 m). Për shtyllat 9/15, rezulton se në shumicën e shtyllave, dimensionet e kokës së betonit të realizuar është mesatarisht 1 x 1 m. Në këto kushte sasia e betonit që konsiderohet e realizuar është në masën 1.72 m³. Nga përllogaritjet rezulton se për këtë kontratë, është certifikuar më shumë sasia 136.2 m³ beton me vlerë 1,021,425 lekë. Mangësi në përllogaritjen e volumit të punimeve. Nga verifikimi i punimeve sipas Kontratës “Ndërtim i rrjetit TU me ABC për 23 kabina Cërrik-Gostime”, kryesisht për kabinat në zonën e Shtërmën (Kabina 1, 2,6,8) dhe Gostimë (1,2,3), u konstatua se nuk janë respektuar specifikimet teknike sa i takon bazamentit të shtyllave prej betoni, si për shtyllat 9/6 kN, ashtu dhe për shtyllat 9/16 kN. Në disa raste të verifikuara shtresa e betonit ndërtohet sipas dimensioneve vetëm në sipërfaqe për trashësi afërsisht 30 cm, por në thellësi nuk respektohen dimensionet e përcaktuara në librezën e masave. Për shtylla 9/6 kN, konsiderohet i realizuar seksioni 0.6 x 0.6 m (për thellësinë 1.3 m). Në këto kushte sasia e betonit që konsiderohet e realizuar është në masën 0.7 m³. Për shtylla 9/15 kN, është konsideruar i realizuar seksioni 0.8 x 0.8 (për thellësinë 1.7 m). Për shtyllat 9/15, rezulton se në shumicën e shtyllave, dimensionet e kokës së betonit të realizuar është mesatarisht 1 x 1 m. Në këto kushte sasia e betonit që konsiderohet e realizuar është në masën 1.72 m³. Nga përllogaritjet rezulton se për këtë kontratë, është certifikuar më shumë sasia 136.2 m³ beton me vlerë 1,021,425 lekë. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës **1,021,425 lekë**, nga Kontraktori “E.” Shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Masa shperblim demi ne zbatim te rekomandimit nr. 2.1 me Nr. 7958/4 Prot., date 30.08.2023. Fatura Nr. 1065/2023 dt 21.09.2023, OE nuk e ka refuzuar faturen dhe nuk ka bere kontestimin e njoftimit të OSSH për arkëtimin e dëmit. Në datë 10.10.2023 fatura merr formën titull

ekzekutiv. Ne perfundim te afatit 30 ditor nga data e leshimit të fatures pritet të arketohet pagesa në menyre vullnetare ose do të mbahet kundervlefata nga Garancia e Punimeve.

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Arkëtuar vlera e dëmit. Duhet konsideruar rekomandim i zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike (numër subjekte (OE) pa fatura bashkangjitur në rolin e dokumentacionit justifikues vërtetues) të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues. Sa më sipër statusi vijon të mbetet pjesërisht i zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratës “Zgjatim i fiderit 12 me kabina dhe rrjet të ri TU, nënstacioni 110/20 Sallmone, Lot I” u konstatuan mangësitë si më poshtë:

-Në situacionin nr. 7, II “Rrjeti ajror 20 kV me shtylla betoni”, sipas zërit B 5 “Punime montimi” – Shtresë betoni C 16/20 (bazamenti i shtyllës) është certifikuar sasia 18.74 m³ me çmim 8,308 lekë/m³. Po për bazamentet e shtyllave është certifikuar sipas zërit B 6 “Punime civile” – Shtresë betoni C 16/20 (bazamenti i shtyllës) sasia 12.74 m³, me çmim 8,392 lekë/m³, pa detajim dhe përcaktim përmasash. Sasia 12.74 m³, me vlerë 106,914 lekë (12.74 m³ x 8,392 lekë/m³, është certifikuar padrejtësisht për punime të pa realizuara. Në situacionin 7, I “Rrjeti ajror 20 kV me shtylla betoni”, sipas zërit B 5 “Punime montimi” – Shtresë betoni C 16/20 (bazamenti i shtyllës) është certifikuar sasia 139 m³ me çmim 8,309 lekë/m³. Sipas këtij zëri, në librezën e masave është përlllogaritur sasia 232 m³. Në situacionin 7,I, zëri B 6 “Punime civile” – Shtresë betoni C 16/20 (bazamenti i shtyllës) është certifikuar sasia 93.7 m³ me Çmim 8,474 lekë/m³. Për të njëjtin zë punimesh janë certifikuar sasi në dy raste. Sasia 93.7 m³ me vlerë 794,013 lekë (93.7 m³ x 8,474 lekë/m³), është certifikuar padrejtësisht. Po ashtu sasia 93 m³ (232 m³ – 139 m³), duhet të përfshihej në situacion me diferencë në vlerë 13,345 lekë [93 m³ (8,474 – 8,309)]. Sa më sipër, nga ana e Kontraktorit BOE “E P SHPK dhe A I G C SHPK”, është përfutur më tepër vlera 916,272 lekë (106,914 lekë + 794,013 lekë + 13,345 lekë). Sipas situacionit nr. 7 dhe përfundimtar, janë certifikuar volumet e shtresave asfaltike volumi i të cilave nuk përputhet me atë të realizuar në fakt. Këto shtresa janë paraqitur në librezën e masave nga piketa 3 deri piketë 4, në distancë 802 m dhe gjerësi 0.8 m. Në fakt gjatësia e realizuar është 410 m, me gjerësi mesatare 0.7 m, kjo për faktin se një pjesë e linjës është shtruar në bankinë dhe jo në trupin e rrugës. Për pjesën e realizuar në trupin e rrugës, prerja e asfaltit është bërë vetëm në një anë. Është certifikuar më shumë “Prerje asfalt me disk” me vlerë 295,240 lekë, “Shtresë stabilizant” me vlerë 105,356 lekë, “Shtresë binderi” me vlerë 427,502 lekë dhe “Shtresë asfaltobetoni me vlerë 256,951 lekë. Nga verifikimi i punimeve për realizimin e linjave të tensionit të mesëm ajror dhe tensionit të ulët, rezultuan mangësi në lidhje me realizimin e bazamentit të shtyllave. Sa i takon linjës së tensionit të mesëm u konstatua së në 30 shtylla betoni i bazamentit nuk është vendosur sipas specifikimeve, me një diferencë prej afërsisht 1 m³ beton për shtyllë, në total 30 m³ beton të certifikuar më tepër. Po ashtu në linjat e tensionit të ulët u konstatuan mangësi në realizimin e bazamentit të shtyllave për 35 shtylla, me një diferencë afërsisht 0.9 m³ beton për shtyllë, në total 31.5 m³ beton të certifikuar më

tepër. Vlera 510,634 lekë [(30 m³ + 31.5 m³) x 8,303 lekë/m³] është përfituar më tepër nga BOE “E P SHPK dhe A I G C SHPK”. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **2,511,955 lekë**, nga Kontraktori “BOE “E P SHPK dhe A I G C SHPK”, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Masa shperblim demi ne zbatim te rekomandimit nr. 3.1 me Nr. 7958/5 Prot., date 30.08.2023. Prere Fatura pa TVSH Nr. 1067/2023 dt 21.09.2023 dhe është refuzuar fatura në sistem nga O.E. (Kontraktori) Dokumentacioni i plote Administrativ është dërguar në Drejtorine Ligjore për vijimin e kërkimit të arkëtimin të vlerës në rrugë gjyqësore.

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Refuzuar Fatura ne Sistem nga O.E. Vlera e dëmit do të mbahet nga shuma e Garancisë së Punimeve për këtë kontratë, pas përfundimit të afatit të garancisë. Është njoftuar KLSH për këtë procedurë, përmes shkresës së OSHEE GROUP SHA me nr 185/2 Prot. datë 22.01.2024.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues. Sa më sipër statusi vijon të mbetet pjesërisht i zbatuar. Plotësia e zbatimit të rekomandimit ngelet të verifikohet në auditimin e rradhës.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

4. Gjetje nga auditimi: Librezat e masave sipas kontratës “Rikonstruksion i rrjetit TM dhe TU në lagjet 4, 5 dhe 6, Bashkia Kukës”, janë hartuar vetëm me volumet dhe jo me detaje, apo përmasa. Në këto kushte nuk mund të përcaktohen saktë volumet e realizuara. Krahas këtij investimi po në këtë lagje është realizuar investim edhe nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për rikonstruksion si të infrastrukturës ashtu dhe fasadave të pallateve. Theksojmë se kontratat sipas dy investimeve janë realizuar nga i njëjti kontraktor. Nuk ka një ndarje të qartë të investimeve të realizuara nëpërmjet dy kontratave sa i takon kryesisht punimeve për shtresa rrugore apo trotuare. Nëse për trotuaret nevojitet një rakordim me punimet e realizuara nëpërmjet kontratës me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në lidhje me sasinë e binderit, ato nuk rezultojnë të kryera, pasi nuk ka qenë i nevojshëm prishja dhe rindërtimi i tyre, në kuadrin e rikonstruksionit të plotë të infrastrukturës, sipas të cilit janë realizuar shtresa të reja rrugore. Vlera e punimeve certifikuar për shtresa binderi është 149,350 lekë (103 m² x 1,450 lekë/m²), përfituar më tepër nga Kontraktori “M” SHPK. Është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **149,350 lekë**, nga Kontraktori “M” SHPK, për punime të certifikuara por të pa realizuara.

Përgjigja e institucionit:

Masa shpërblim dëmi në zbatim të rekomandimit nr. 4.1 me nr. 7958/6 Prot., date 30.08.2023 prerë fatura pa TVSH nr. 1069/2023 datë 21.09.2023. OE nuk e ka refuzuar faturën dhe nuk ka bërë kontestimin e njoftimit të OSSH për arkëtimin e dëmit. Rezultom se është paguar dhe arkëtuar vlera e detyrimit, e konfirmuar me statement banker në datë 04.10.2023 pranë C. B.Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Arkëtuar vlera e dëmit. Duhet konsideruar rekomandim i zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

4.2. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë bashkëpunim me Fondin Shqiptar i Zhvillimit, në lidhje me investimin e realizuar nga ana e tyre, duke bërë rakordimet përkatëse të volumeve të realizuara nga dy kontratat dhe zbritjen e vlerës, për punime të cilat mund të jenë raportuar të realizuara në të dy kontratat.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Masa shpërblim dëmi në zbatim të rekomandimit nr. 4.1 me nr. 7958/6 Prot., date 30.08.2023 prerë fatura pa TVSH nr. 1069/2023 datë 21.09.2023. OE nuk e ka refuzuar faturën dhe nuk ka bërë kontestimin e njoftimit të OSSH për arkëtimin e dëmit. Rezultom se është paguar dhe arkëtuar vlera e detyrimit, e konfirmuar me statement banker në datë 04.10.2023 pranë CB. Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Arkëtuar vlera e dëmit. Duhet konsideruar rekomandim i zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

5. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i punimeve sipas kontratës Ndërtim i rrjetit TM 20 kV, Fideri F 6, kabinave përkatëse dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/Stacioni i Lalëzit”, sa i takon linjave të tensionit të ulët u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Në këto themele kryesisht ndërtohet shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi 20 deri 30 cm, por jo në brendi. Në disa shtylla është konstatuar se janë vendosur tombino betoni, të cilat nuk janë urdhëruar, apo miratuar për vendosje. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, shtyllat kanë pësuar devijim dhe rrezikojnë rënien e tyre, duke shkaktuar dëme jo vetëm për shtyllën përkatëse, por dhe të tjerat, si pasojë e forcës së tërheqjes së kablllove të vendosur në to. Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë vendosur në pronë private, në trotuar, apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në verifikimin në terren, për disa shtylla 9/15 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.72 m², ndërkohë që është certifikuar sasia 2.59 m³, me një diferencë 1.12 m³ për shtyllë të verifikuar. Për disa shtylla 9/6 kN, sasia e realizuar afërsisht për shtyllë është 0.56 m³, ndërsa sasia e certifikuar është 1 m³ për shtyllë, me një diferencë 0.44 m³ për shtyllë të verifikuar. Sa më sipër

është certifikuar më tepër sasia e betonit në masën 24.6 m³ (10 + 14.6), me vlerë 196,800 lekë (24.6 m³ x 8,000 lekë/m³), është përfituar më tepër nga Kontraktori BOE “K K & E” SHPK. Është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **196,800 lekë**, nga Kontraktori BOE “K K & E” SHPK, për punime të certifikuara por të pa realizuara.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Masa shpërblim dëmi në zbatim të rekomandimit nr. 5.1 me nr. 7958/7 Prot., date 30.08.2023 prere fatura pa TVSH nr. 1071/2023 datë 21.09.2023. OE nuk e ka refuzuar faturen dhe nuk ka bërë kontestimin e njoftimit të OSSH për arketimin e dëmit. Në datë 10.10.2023 fatura merr formen titull ekzekutiv. Në përfundim të afatit 30 ditor nga data e lëshimit të fatures pritet të arkëtohet pagesa në mënyre vullnetare ose do të mbahet kundervlehtë nga Garancia e Punimeve. Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Arkëtuar vlera e dëmit. Duhet konsideruar rekomandim i zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues. Sa më sipër statusi vijon të mbetet pjesërisht i zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

6. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i punimeve sipas kontratës “Rikonstruksion i rrjetit TU dhe kabinave Tresh 7, Zejmen 7, Spiten 2, Ded Alija, Pllanë 2, Gajush 3, Gjush 1, Markatomaj 9, Markatomaj 3, Markatomaj 2, Fideri 10 Zejmen, N/Stacioni Lezhë”, u konstatuan mangësi në lidhje me sasinë e betonit C 16/20 të vendosur në fakt, krahasuar me atë të përshkruar në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar. Verifikimi i punimeve u përqendrua në kabinat “Markatomaj 2”, “Markatomaj 4”, “Zejmen 7” dhe “Tresh 7”. Nga bazamentet e verifikuara rezultojnë se janë realizuar me përmasa mesatare 0.9 m x 0.9 m, duke konsideruar thellësinë 1.7 m të njëjtë me atë të certifikuar, ose në sasinë 1.38 m³. Nga përlllogaritjet rezultojnë se është certifikuar më tepër sasia 62.6 m³ beton, me vlerë 532,600 lekë. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **532,600 lekë**, nga Kontraktori BOE “P SHPK & N 2.. SHPK”, për punime të certifikuara por të pa realizuara.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Masa shpërblim dëmi në zbatim të rekomandimit nr. 6.1 me nr. 7958/8 Prot., date 30.08.2023 prere fatura pa TVSH nr. 1085/2023 datë 21.09.2023. OE nuk e ka refuzuar faturen dhe nuk ka

bërë kontestimin e njoftimit të OSSH për arketimin e dëmit. Rezulton se është paguar dhe arkëtuar vlera e detyrimit, e konfirmuar me statement banker në datë 29.09.2023 pranë Raiffeisen Bank. Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Arkëtuar vlera e dëmit. Duhet konsideruar rekomandim i zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

7. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “Ndërtim i kabinave të reja dhe rikonstruksion i rrjetit TU me kabull ABC në Njësinë Lushnje”, njësia rajonale Berat viti 2020, konstatohet se objekti është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 1476/16prot., datë 30.04.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor OSSH, Berat dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "A-S" shpk, & “E N” shpk. Përfaqësuesi i BOE është operatori “A-s” shpk, sipas prokurës së posaçme nr. 555 datë 03.02.2021. Vlera e kontratës është 209,318,891 lekë me TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Zëri nr. 4, me Nr. Anali. 3.25/a “Gërmim me krahë seksion detyruar me gjerësi $b < 1$ m, $H = 1.5$ m, tokë e fortë”. Në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 1,731 m³ të zërit “Gërmim me krahë seksion detyruar me gjerësi $b < 1$ m, $H = 1.5$ m, tokë e fortë”. Librezat e masave rezulton në sasinë prej 1,731 m³, ku është llogaritur thellësia e gërmimit $H = 1.2$ m. Nga verifikimi i Librezave të masave janë konstatuar disa piketa të janë mbivendosur 2 herë dhe të likuiduara edhe në zërin nr. 3, me Nr. Anali. 3.89/a “Gërmim dheu me eskavator me goma 0.25 m³ në kanale me gjerësi deri 2m, prani uji katg. IIP”, me po të njëjtën lartësi $H = 1.2$ m. Sipërmarrësi ka përfituar volum më të tepër punimesh prej 339.84 m³, në zërin nr. 4 me nr. anal. 3.25/a “Gërmim me krahë seksion detyruar me gjerësi $b < 1$ m, $H = 1.5$ m, tokë e fortë”, me çmimin përkatës të ofertuar prej 2,409 lek / m³, rezulton vlera prej 818,674 lekë pa TVSH. Zëri nr. 5, me Nr. Anali. 2.19/a “Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, katg IV”. Referuar Llogaritjeve mbi volumin total të gërmimit, sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave ka rezultuar Volumi total prej 5,805.72 m³ (1. Gërmim me eskavator 4,074.6 m³ + 2. Gërmim me krahë 1,731.12 m³). Ky volum i dalë nga gërmimet është ndarë sipas përlllogaritjeve në 2 zëra. a. “Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, katg IV”, me volum prej 2,493 m³ dhe b. “Transport dheu me auto deri 5km” me volum prej 3,312 m³. Pra (2,493 m³ + 3,312 m³ = 5,805 m³). Volumi i transportit ka dalë si rezultat i diferencës së nxjerrë nga llogaritjet e hedhjes dhe rrafshimit të dheut. Nga sa më sipër konstatuar volumi i gërmimit rezultoi me llogaritje jo të saktë me diferencë 339.84 m³ dhe rrjedhimisht kjo sasi duhet ti zbritet edhe zërit “Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, katg IV”, me çmimin përkatës të ofertuar prej 241 lek / m³, rezulton vlera prej 81,901 lekë pa TVSH. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **900,575 lekë pa tvsh** (818,674 + 81,901), e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arketimin e vlerës masa për arketimin e vlerës prej **900,575 lekë** nga kontraktori BOE "A-S" shpk, & “E N” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Rezulton se detyrimi është refuzuar nga O.E me shkresën nr. 7958/16 prot., datë 13.09.2023. Dokumentacioni i komunikimit është administruar në OSHEE Group sh.a me qellim vijimin e

veprimeve për rikuperimin e vlerës sipas rekomandimit. Grupi i punës së OSSH sh.a ka konfirmuar rregjistrimin e faturës nr. 1073/2023 datë 21.09.2023 në sistemin financiar të OSSH sh.a.

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... *Refuzuar fatura me shkresën nr. 7958/16 prot., dt 13.09.2023. (Kontraktori). Vlera e dëmit do të mbahet nga shuma e Garancisë së Punimeve për këtë kontratë, pas përfundimit të afatit të garancisë. Është njoftuar KLSH për këtë procedurë, përmes shkresës së OSHEE GROUP SHA me nr 185/2 Prot. datë 22.01.2024. Duhet konsideruar në proces zbatimi.*

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

8. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “*Rikonstrukcion i N/Stacionit Vorës 35/20/6 KV*”, njësia rajonale DTL viti 2021, konstatohet se objekti është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 335/17 prot. datë 18.06.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Tensionit të Lartë DTL dhe Operatorit Ekonomik “4..A..M” shpk. Vlera e kontratës është 207,215,336 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (A-B) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Zëri nr. 2.5, në pajisjet 35 kv “*F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm²)*”, në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 426 ml të zërit “*F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm²)*”. Librezat e masave rezultojnë në sasinë prej 426 ml, ku është llogaritur Ura Tr 35/20/6kv nr. 1, Ura Tr 35/20/6kv nr. 2, linja e ajrore N/st Shijak – N/st vore dhe cela 35kv e seksionimit. Në librezën e masave nuk janë bashkëlidhur distancat e kabllave të projektit të zbatuar. Nga verifikimi i projektit të Azhurnuar, verifikimeve në terren dhe observacioneve përkatëse, janë konstatuar disa pasaktësi në sasi ku në total rezultojnë sasia prej 411 ml. Referuar projektit të azhurnuar kablli me linjën kabllore 35 kv është kabëll 3 (1 x 95 mm), sipërmarrësi ka përfituar volum më tepër punimesh prej 15 ml (426 ml – 411 ml), në zërin nr. 2.5 në pajisjet 35 kv “*F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm²)*”, me çmimin përkatës të ofertuar prej 20,000 lek/m³, rezultojnë se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **300,000 lekë** pa tvsh, e përfituar më tepër sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **300,000 lekë** nga kontraktori OE “4..A..M” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

OSSH sh.a ka dërguar për kontraktorin shkresën nr. 7958/10 prot., datë 30.08.2023 “*Njoftim mase shpërblim dëmi*”. Në vijim OSSH sh.a ka lëshuar faturën nr. 1075/2023 datë 21.09.2023, rezultojnë se është paguar dhe arkëtuar vlera e detyrimit e konfirmuar me statement bankar në datë 28.09.2023 pranë C B.

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Arkëtuar vlera e dëmit. Duhet konsideruar rekomandim i zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

9. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “Ndërtimi i rrjetit TM 20 kV, fideri F6, kabinave dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Lot II”, njësia rajonale Durrës viti 2021, konstatohet se objekti është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 3161/18 prot. datë 05.01.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale OSSH Durrës, dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “I” shpk & “4..A..M SHPK. Vlera e kontratës është 159,477,902 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Linja e tensionit të ulët u konstatua mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Themelet kryesisht janë ndërtuar me shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi 20 deri 30 cm, por jo në brendësi të gropës së shtyllës. Në disa raste, janë konstatuar se mbushja e betoneve me tulla dhe jo me beton dhe në disa raste janë konstatuar thyerje të betoneve. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, shtyllat kanë pësuar devijime dhe rrezikojnë rënien e tyre, duke shkaktuar jo vetëm dëme për shtyllën përkatëse, por edhe shtyllave të tjerat si pasojë e forcës tërheqëse së kabllave të vendosur në to. Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë vendosur në pronë private, në trotuar, apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në përlllogaritjet, për shtyllat 9/6 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.55 m³, ndërkohë që është certifikuar sasia 0.65 m³, me një diferencë 0.1 m³ për shtyllë të verifikuar. Për shtyllat 9/15 kN, sasia e realizuar gjithashtu për shtyllë është afërsisht 1.2 m³, ndërsa sasia e certifikuar është 1.27 m³ për shtyllë, me një diferencë 0.07 m³ për shtyllë të verifikuar. Sasia e betonit e certifikuar më tepër është në masën 27.16 m³ (25.2 + 1.96). Vlera 231,539 lekë (27.16 m³ x 8,525 lekë/m³) e zërit “Shtresë betoni c16/20”, e përfituar padrejtësisht Kontraktori BOE “I & 4 A-M” shpk. Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **231,539 lekë** pa tvsh, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **231,539 lekë** nga kontraktori BOE “I & 4.. A..M” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

OSSH sh.a ka dërguar për kontraktorin shkresën nr. 7958/11 prot., datë 30.08.2023 “Njoftim mase shpërbllim dëmi”. Në vijim OSSH sh.a ka lëshuar faturën nr. 1087/2023 datë 21.09.2023, rezulton se është paguar dhe arkëtuar vlera e detyrimit e konfirmuar me statement bankar në datë 28.09.2023 pranë Credins Bank. Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Arkëtuar vlera e dëmit. Duhet konsideruar rekomandim i zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

10. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt “*Rikonstruksioni i N/Stacionit Salmone 110/20 kV*”, Drejtoria e Tensionit të Lartë viti 2021, konstatohet se objekti i kontratës është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 347/20 prot., datë 01.07.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë së Tensionit të Lartë dhe operatorit ekonomik “L O” shpk. Vlera e kontratës është 158,333,665 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Kabllot e kontrollit, sinjalizimit, mbrojtjes, nga auditimi i librezave të masave të fondit rezervë, nuk rezultojn të jetë e argumentuar apo justifikuar sasia e cila ka rezultuar më tepër, pasi nuk disponohen AS-built mbi lidhjet dhe gjatësitë e kabllave. Në librezat e masave të fondit rezervë nuk disponohen përlllogaritje të përmasave por vetëm sasi fikse të cilat kanë mbuluar fondin rezervë. Për këtë investim rezultojn se nuk argumentohet apo justifikohet **vlera prej 355,700 lekë** pa TVSH e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për mos llogaritje dhe argumentime nga fakti i punës së realizuar.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **355,700 lekë** nga kontraktori OE “L O” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

OSSH sh.a ka dërguar për kontraktorin shkresën nr. 7958/12 prot., datë 30.08.2023 “*Njoftim mase shpërblim dëmi*”. Në vijim OSSH sh.a ka lëshuar faturën nr. 1077/2023 datë 21.09.2023, OE nuk e ka refuzuar faturen dhe nuk ka bërë kontestimin e njoftimit të OSSH për arkëtimin e dëmit. Në përfundim të afatit 30 ditor nga data e lëshimit të fatures pritet të arkëtohet pagesa në mënyrë vullnetare ose do të mbahet kundërvlefë nga Garancia e punimeve.

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... OE nuk e ka refuzuar faturën dhe nuk ka bërë kontestimin e Njoftimit të OSSH për arkëtimin e dëmit. Vlera e dëmit do të mbahet nga shuma e Garancisë së Punimeve për këtë kontratë, pas përfundimit të afatit të garancisë. Është njoftuar KLSH për këtë procedurë, përmes shkresës së OSHEE GROUP SHA me nr 185/2 Prot. datë 22.01.2024. Duhet konsideruar në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultojn se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusin e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojn të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

11. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “*Ndërtimi i Fiderit 20 kV për përdorimin dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në zonën e Bypassit (Rotondo) Fier si dhe furnizim me energji elektrike të përdoruesve të kësaj zone*”, njësia rajonale Fier viti 2021, konstatohet se objekti i kontratës është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 225/24 prot., datë 30.06.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale OSSH Fier dhe operatorit ekonomik “A..A..P” shpk.

Vlera e kontratës është 78,061,609 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (A-B) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Furnizim me Fider të ri të dedikuar nga Nënstacioni ekzistues 110/20 kV. Zëri nr. 1, "Prerje Asfalti me disk", në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 11,223 ml të zërit "Prerje Asfalti me disk". Librezat e masave rezultojnë në sasinë prej 12,681.8 ml, ku janë llogaritur seksionet e prerjeve sipas piketave të projektit të azhurnuar. Nga auditimi i librezave të masave konstatohet pasaktësi dhe përlllogaritje e gabuar në prerjen e asfaltit, pasi në gjatësinë e rrugës së prerë me asfalt janë llogaritur 4 (katër) anë prerje, kur në fakt janë realizuar prerje në 3 (tre) anë të kanalit. Sipërmarrësi "A..A..P" shpk, ka përfituar sasi më tepër të zërit "Prerje Asfalti me disk", në sasinë 4,882 ml (11,223 ml situacionuar – 9,511 ml fakti = 1,712 ml), me çmimin përkatës të ofertuar prej 200 lekë/ml, rezultojnë vlera prej 342,400 lekë pa TVSH. Rrjeti TM nga kabina Celigrad dhe parafabrikat 7 deri në Spital. Zëri nr. 1, "Prerje Asfalti me disk", në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 4,280 ml të zërit "Prerje Asfalti me disk". Librezat e masave rezultojnë në sasinë prej 7,702 ml, ku janë llogaritur seksionet e prerjeve sipas piketave të projektit të azhurnuar. Nga auditimi i librezave të masave konstatohet pasaktësi dhe përlllogaritje e gabuar në prerjen e asfaltit, pasi në gjatësinë e rrugës së prerë me asfalt janë llogaritur 4 (katër) anë prerje, kur në fakt janë realizuar prerje në 2 (dy) anë të kanalit. Sipërmarrësi "A..A..P" shpk, ka përfituar sasi më tepër të zërit "Prerje Asfalti me disk", në sasinë 429 ml (4,280 ml situacionuar – 3,851 ml fakti), me çmimin përkatës të ofertuar prej 200 lekë/ml, rezultojnë vlera prej 85,800 lekë pa TVSH. Për këtë investim rezultojnë se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **428,200 lekë** (342,400 + 85,800) lekë pa tvsh, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **428,200 lekë** nga kontraktori OE "A..A..P" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

OSSH sh.a ka dërguar për kontraktorin shkresën nr. 7958/13 prot., datë 30.08.2023 "Njoftim mase shpërbllim dëmi". Në vijim OSSH sh.a ka lëshuar faturën nr. 1079/2023 datë 21.09.2023, rezultojnë se është paguar dhe arkëtuar vlera e detyrimit e konfirmuar me statement bankar në datë 27.09.2023 pranë C B. Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Arkëtuar vlera e dëmit. Duhet konsideruar rekomandim i zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

12. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "Rikonstruksioni i kabinave Vajkan 1 dhe Vërri 2 dhe sistemim i rrjetit TU të tyre dhe sistemimi i rrjetit TU për Kallm i Vogël 1, 2, 3, 4 dhe Kallm i Madh, Nënstacioni 35/6 Jagodinë", njësia rajonale Fier viti 2021, konstatohet se objekti i kontratës është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 716/21 prot., datë 05.01.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale OSSH Fier dhe operatorit ekonomik "G..P..G" shpk. Vlera e kontratës është 24,689,395 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Rrjeti TU me përcjellës ABC, u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Themelet kryesisht janë ndërtuar me shtresë

betoni në sipërfaqe me trashësi 20 deri 30 cm, por jo në brendësi të gropës së shtyllës. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, *shtyllat kanë pësuar devijime*. Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë, në trotuare apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në verifikimin në terren, për shtyllat 9/6 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.28 m³ (0.9m gjerësi x 0.9m gjatësi x 0.35 m thellësi), ndërkohë që është certifikuar sasia 0.78 m³ (0.7m gjerësi x 0.7m gjatësi x 1.6m thellësi), me një diferencë 0.5 m³ për shtyllë të verifikuar. Për shtyllat 9/15 kN, sasia e realizuar gjithashtu për shtyllë është afërsisht 0.38 m³ (1.05m gjerësi x 0.9m gjatësi x 0.35 m thellësi), ndërsa sasia e certifikuar është 1.45 m³ për shtyllë (0.9m gjerësi x 1.05m gjatësi x 1.8m thellësi), me një diferencë 1.07 m³ për shtyllë të verifikuar. Sasia e certifikuar më tepër e betonit në masën 41.77 m³ (30 + 11.77). Vlera **342,388 lekë** (41.77 m³ x 8,197 lekë/m³) e zërit “*Shtresë betoni c16/20*”, është përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **342,388 lekë** nga kontraktori OE “G..P..G” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

OSSH sh.a ka dërguar për kontraktorin shkresën nr. 7958/14 prot., datë 30.08.2023 “*Njoftim mase shpërblim dëmi*”. Në vijim OSSH sh.a ka lëshuar faturën nr. 1081/2023 datë 21.09.2023, rezulton se është paguar dhe arkëtuar vlera e detyrimit e konfirmuar me statement bankar në datë 23.10.2023 pranë C B. Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Arkëtuar vlera e dëmit. Duhet konsideruar rekomandim i zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

13. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: “*Rikonstruktion rrjeti TU me kabëll ABC Rajoni Korçë*”, njësia rajonale Korçë viti 2020, konstatohet se objekti i kontratës është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 445/12 prot. datë 01.12.2020, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale OSSH Korçë, dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “M” shpk & “A” shpk & “E” shpk. Referuar Akt Marrëveshjes datë 16.10.2020, mbi bashkimin e përkohshëm të shoqërive, është përcaktuar se shoqëria “M” LTD, si udhëheqëse dhe autorizuese për kryerjen e të gjitha veprimeve në emër të BOE. Vlera e kontratës është 119,739,951 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (A-B) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Përsa i takon linjave të tensionit të ulët u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Themelet kryesisht janë ndërtuar me shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi deri 20 cm por jo në brendësi të gropës së shtyllës dhe *në shumë raste nuk ishte hedhur beton*. Në disa raste, janë konstatuar se mbushja e betoneve me tulla dhe jo me beton dhe në disa raste janë konstatuar thyerje të betoneve. Punimet e betonit në shtylla, janë realizuar jashtë kushtit teknik dhe nuk mund të pranohej si zë punimi i realizuar. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, *shtyllat kanë pësuar devijime dhe rrezikojnë rënien e tyre*, duke shkaktuar jo vetëm dëme për shtyllën përkatëse, por edhe shtyllave të tjerat si pasojë e forcës tërheqëse së kabllove të vendosur në to. Nga ana e grupit

të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë vendosur në pronë private, në trotuar, apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në verifikimin në terren, për shtyllat 9/6 kN dhe 9/15 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.1 m³ për shtyllë të verifikuar (*ku në shumë raste nuk ekziston betoni*). Ndërkohë që është certifikuar sasia më tepër në librezën e masave ndërsa në situacionin përfundimtar është ruajtur e njëjta sasi me preventivin fillestar. Një pjesë e shtyllave thjesht janë hedhur 2-3 lopata beton të cilat nuk konsiderohen si të realizuara. Bazuar në verifikimin në terren, për shtyllat 9/6 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.1 m³, ndërkohë që është certifikuar sasia 0.78 m³, me një diferencë 0.68 m³ (0.78 – 0.1) për shtyllë të verifikuar. Për shtyllat 9/15 kN, sasia e realizuar gjithashtu për shtyllë është afërsisht 0.1 m³, ndërsa sasia e certifikuar është 0.87 m³ për shtyllë, me një diferencë 0.77 m³ (0.87 – 0.1) për shtyllë të verifikuar. Sa më sipër është certifikuar më tepër sasia e betonit në masën 248.63 m³ (169.32 + 79.31). Vlera 2,055,921 lekë (248.63 m³ x 8,269 lekë/m³) e zërit “*Shtresë betoni c16/20*”, është përfituar padrejtësisht Kontraktori BOE “M” shpk & “A” shpk & “E” shpk. Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **2,055,921 lekë** pa tvsh e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **2,055,921 lekë** nga kontraktori BOE “M” shpk & “A” shpk & “E” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

OSSH sh.a ka dërguar për kontraktorin shkresën nr. 7958/15 prot., datë 30.08.2023 “*Njoftim mase shpërblim dëmi*”. Në vijim OSSH sh.a ka lëshuar faturën nr.1083/2023 datë 21.09.2023, OE nuk e ka refuzuar faturen dhe nuk ka bërë kontestimin e njoftimit të OSSH për arkëtimin e dëmit. Në përfundim të afatit 30 ditor nga data e lëshimit të fatures pritet të arkëtohet pagesa në mënyrë vullnetare ose do të mbahet kundërvlefë nga Garancia e punimeve.

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Arkëtuar vlera e dëmit. Duhet konsideruar rekomandim i zbatuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusin e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues. Sa më sipër statusi vijon të mbetet pjesërisht i zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore për blerjen e energjisë elektrike është konstatuar se, nga 10 subjektet e Prodhimit me Përparësi të Energjisë (PPE) të cilët prodhojnë energji elektrike të rinovueshme nga centralet fotovoltaike, bazuar në kapacitetin 2M^W, miratuar në kushtet kontraktore me Autoritetin Kontraktor

(dokumentacionit financiar nga shoqëria OSHEE GROUP sh.a (FTL sh.a) dhe sipas treguesve të programit PVGIS, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihen këto centrale e prodhimit të operatorëve ekonomike, rezulton se këta subjekte kanë prodhuar me tepër energji se sa është kapaciteti i tyre prej 2MŴ, përcaktuar në kushtet kontraktore, gjithsej në sasinë 23,568,327kŵh, me efekte financiare për shoqërinë në shumën **2,356,730 Euro**, përkatësisht nga: Subjekti “S” shpk në shumën 264,486 Euro; R..T..S shpk për 247,776 Euro, “A...” shpk për 308,653 Euro; “A.. Su” shpk për 213,639 Euro; “S1S” shpk për 200,818Euro; “S2S” shpk për 222,965 Euro; “S S” shpk për 245,284Euro; “S ŵ” shpk 175,985 Euro; “L” 202,136 Euro dhe “A S” shpk 274,988 Euro. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar dhe me kushtet kontraktore përcaktuar me kontratat për ndërtimin e Centraleve Fotovoltaike lidhur ndërmjet MIE dhe subjekteve PPE.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqet nr. 193—229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) në bashkëpunim me OSHEE GROUP sh.a/FTL sh.a, si institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e kontratave për “Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Centraleve Fotovoltaike”, të ndjekin me korrektësi zbatimin e kushteve kontraktore në drejtim të prodhimit të energjisë elektrike jo vetëm nga këto centrale fotovoltaike që aktualisht janë në prodhim, por dhe të tjerë të tillë që do të hyjnë në shfrytëzim në të ardhmen.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Rekomandimet e KLSH i janë përcjellë MIE dhe AKBN...monitorimi i zbatimit të kontratave për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centraleve prodhuese...për blerjen e energjisë nga burimeve të rinovueshme ndjek në vijimësi zbatimin e kushteve kontraktore nga këta prodhues...

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën e audituar rezultoi se, punonjësit e OSHEE Group sh.a trajtohen me dietë një vakt në ditë, por duke u shpërblyer me 500 lekë në ditë, kur në fakt duhet të shpërblehen me 300 lekë në ditë, referuar përcaktimeve të VKM nr. 68, datë 07.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë”, pika 2, germa a), *kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt dhe deri në 500 lekë kur trajtohet me më shumë se një vakt për ditë pune*. Konstatohet se, nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimore në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, fenomen i konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse, por përsëri rezultojnë të pazbatuara. Nga përlllogaritjet e bëra sipas listëpagesave të periudhës korrik 2020 – dhjetor 2022 rezulton se, janë përfituar gjithsej nga punonjësit shuma 1,878,988,532 lekë, nga vlera 1,127,393,119 lekë që duhej të ishte, pra është paguar më tepër shuma prej **751,595,412.8 lekë**, e cila

konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 68, datë 07.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të analizojnë situatën dhe të marrin masat e duhura për personat përgjegjës për mos azhurnimin e legjislacionit, si dhe të ndiqen procedurat administrative ndaj tyre konform kërkesave të Kodit të Punës. Administratori i Shoqërisë, Departamenti Ligjor të marrin masat e duhura dhe të kryejnë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, duke nxjerrë aktet përkatëse për mos vazhdimin e dietës ushqimore më tepër nga sa përcaktimet ligjore.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Në lidhje me zbatimin e Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 07.02.2018 nga OSHEE...pra një rregullim ligjor ky i kryer në përputhje me parashikimet e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës...punëmarrësi nuk mund të heqë dorë nga të drejtat, që rrjedhin nga dispozitat urdhëruese të këtij Kodi ose të kontratave kolektive të punës...për më tepër që në kontratën kolektive të nënshkruar në vitin 2019 palët sërish kanë rënë dakort që masa e pagës në natyrë do të jetë 500 lekë për ditë pune...*

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Është cituar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 7.2.2018 dhe OSHEE GROUP SH.A, pika 2 “Vlera, mënyrat dhe kriteret e dhënies së pagës në natyrë”. Referuar parashikimeve të mësipërme, pagesa e përfituar në natyrë nga punonjësit e OSHEE GROUP SH.A,Sh.a për një periudhë kohore mbi 10 vjet ka qënë në masën 500 lek në ditë, aplikimi i masës 300 lek në ditë për pagesën në natyrë ndaj punonjësve të OSHEE GROUP SH.A, do të cënonte përparësinë që ka kontrata kolektive e punës ndaj akteve të tjera, në rregullimin e marrëdhënieve punëdhënës-punëmarrës, por njëkohësisht do të sillte humbjen e një të drejtë të fituar prej vitesh nga ana e punëmarrësve në kundërshtim dhe në shkelje kjo me parashikimet e nenit 11 të Kodit të Punës. Gjithashtu, në vitin 2019, punëdhënësi dhe përfaqësuesit e punëmarrësve, në referim të shkronjës (b) e Pikës 2, të VKM nr. 68/2018 dhe duke vlerësuar indeksimin e çmimeve të konsumit sërish kanë rënë dakort që masa e pagës në natyrë do të jetë 500 lekë për ditë pune, duke e përfshirë këtë trajtim në kontratën kolektive.

Pra, konstatimi i KLSH se punonjësit e OSHEE GROUP SH.A, kanë përfituar pagesën në natyrë në masën 500 lekë është në kundërshtim me VKM nr.68/2018 dhe për rrjedhojë ka sjellë efekt negative në buxhetin e Shoqërisë është një konstatim i gabuar dhe në kundërshtim me parashikimet ligjore të Kodit të Punës dhe të vetë VKM-së nr. 68/2018.

Për arsye të cilat nuk varen nga shoqëria OSHEE GROUP SH.A, si pasojë e një mosmarrëveshjeje gjyqësore midis Konfederatës dhe Federatës, si dhe pas inspektimit të Inspektoriatit të Punës, nga ku nuk rezultoi ndonjë shkelje apo penalitet për shoqërinë, aktualisht jemi në proces negocijimi për lidhjen e kontratës kolektive... Sa më sipër do të kërkonim rishikimin e kësaj gjetje të grupit të auditimit, nga i pazbatuar në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17

prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **18,796,671 lekë**, si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për periudhën objekt auditimi, janë humbur dhe janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë, në vlerën **63,843,433 lekë**, si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Në total, për periudhën objekt auditimi është paguar si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **82,640,104 lekë**, e cila konsiderohet *efekt financiar negativ* për buxhetin e shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Nga Administratori, Departamenti Ligjor dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të shoqërisë, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Na lejoni të sqarojmë se Departamenti Ligjor ka pjesë funksionale të detyrave të tij...vlerësimi nëse jemi në kushtet e zgjidhjes së drejtë apo të padrejtë të marrëdhënieve të punës...vendim i cili sipas procedurës i nënshtrohet rishikimit nga gjykata e shkallës më të lartë...janë ndjekur në të gjitha shkallët e gjykimit sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile...*

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se: Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 2123/1 prot, datë 14.04.2022 “Mbi dhënien e një page shpërblim për punonjësit e angazhuar në kuadër të Planit të Gatishmërisë së shoqërisë OSSH sh.a”, janë shpërblyer 1211 punonjës me vlerën **60,925,595 lekë**.

-Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 9423 prot., datë 30.12.2021 “Mbi dhënien e një shpërblimi të veçantë mbi pagë për punonjësit e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a, FTL sh.a, OSSH sh.a dhe FSHU sh.a”, janë dhënë shpërblime në vlerën **128,240,000 lekë**.

Duke qenë se shoqëria rezulton me rezultat financiar negativ (pra me humbje), dhe shpërblimi për një kategori punonjësish është dhënë 2 herë brenda një viti, vlera **189,165,595 lekë konsiderohet efekt financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

Sa më sipër veprimet bien në kundërshtim me nenin 34 të Kontratës Kolektive “Për një

kategori të caktuar punonjësish, në përputhje me interesat e shoqërisë dhe me performancën e saj ekonomike, Administratori mund të japë një shpërblim ekstra në vit me motivacion realizimin e objektivave të ngarkuara”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 25-30 dhe pika 2.3 faqet nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Asambleja e Aksionarit dhe Administratori i Shoqërisë, të analizojnë situatën dhe të marrin masa lidhur me dhënien e shpërblimeve konform rezultateve financiare të shoqërisë.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Asambleja e Aksionerit dhe Administratori i shoqërisë nuk kanë dhënë shpërblime përgjatë viteve 2022,2023 dhe 2024.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***është zbatuar***.

5. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit: “*Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht*” është konstatuar pasaktësi në përlllogaritjen e fondit limit dhe mangësi në përzgjedhjen e llojit të kontratës. Përlllogaritja e fondit limit është bërë e përgjithshme për punimet që do të realizohen, por në dokumentet e tenderit preventivi është konceptuar me çelësa në dorë. Të gjitha projektet dhe detajet do të jenë subjekt i aprovimit nga Investitorit. Investitori ka të drejtën ti kërkojë kontraktorit, pa kosto shtesë, për çdo ndryshim në projekt dhe detaje, të nevojshme për ta realizuar objektin konform kushteve të kontratës. Ofertuesi duhet të ofrojë sasi të në përputhje me formularin e çmimeve. Këto sasi janë vlerësuar për qëllime tenderimi, të bazuara në projekt idenë paraprake. Verifikimi i sasive nga Drejtoria e Tensionit të Lartë do të bëhet gjatë fazës së projektimit të detajuar dhe janë subjekt i miratimit nga Investitori. Kontraktori duhet të vendosë sasi të nevojshme bazuar në projektin e tij final të miratuar. Referuar sa më sipër, konstatohet se nga AK është hartuar një projekt ide, duke mos përcaktuar saktë fondin limit të kontratës. Parashikimi i projektimit për realizim nga kontraktori, si dhe përcaktimi kontratë me çelësa në dorë ndërkohë që projektimi duhet të prokurohet nga autoriteti kontraktor, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, neni 26, pika 1.b. Në preventivin e punimeve është përfshirë pagesë për realizimin e projektit të zbatimit. Nga ana e Kontraktorit është parashikuar për projektimin vlera **9,650,000 lekë**, e cila nuk disponon analizë bazuar VKM 354 datë 11.05.2016 “*Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”. Projektit të detajuar inxhinierik në vlerën 9,650,000 lekë pa TVSH vlerësohet si efekt negativ ekonomik dhe jo në përputhje me parimet e efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit, pasi nga OSSH sha, për projektin mund të shfrytëzoheshin kapacitetet inxhinierike e profesionale të specialistëve të “*Sektorit të Projekteve*”, të cilët kanë detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara konform rregullores së brendshme të institucionit, ku deri më periudhën aktuale projektet hartoheshin pikërisht nga specialistët e zyrës së projektimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: OSHEE sh.a, të marrë masa që në të ardhmen projektet inxhinierike në sektorin e energjisë, të hartohen nga specialistët, me profesione në fushat inxhinierike që disponon Sektori i Projektimit të shoqërisë, duke ulur në këtë mënyrë shpenzimet e tepërta në kontratat publike.

Përgjigja e institucionit:

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ...Sa i përket projekteve në sektorin e energjisë, OSSH sha mund të kryejë projekte kur disponon të punësuar projektuesit e nevojshëm me kualifikimin e domosdoshëm dhe licensat përkatëse në mardhënie me natyrën e projektit që kërkohet të hartohet. Në rastet kur inxhinierët që disponojmë në stafin e projektimit nuk kanë as kualifikimin dhe as licesën e domosdoshme për zhvillimin e projekteve specifike, në OSSH sha hartohet detyra e projektimit përfshirë buxhetin e parashikuar, ndërsa zhvillimi i projektit të zbatimit parashikohet si zë i veçantë në buxhetin e investimit. Kjo ndodh në projekte ku duhet të ketë, Inxhinier Gjeodet të licensuar (studimet Gjeodezike Topografike, për Nënstacione dhe Linja), Inxhinier Informatike të licensuar (për të projektuar Arkitekturën e Sistemeve Softëare dhe programimin e tyre për komandimin në distancë të paisjeve të NS, Gjuha e mbrojtjes Rele, etj), Inxhinier Elektronike të licensuar (Arkitektura e sistemeve të paneleve të sinjaleve të komandimit dhe shtrirjen fizike të linjave të tyre, si dhe llogaritjen e kapacitetit të sistemeve elektronike të NS, paramentrat e mbrojtjes rele dhe lidhja e tyre me sistemet që duhet të mbrohen). Sa më sipër duhet theksuar se avancimet e teknologjive të reja dhe situata e amortizimit të mbi 168 Nënstacioneve tona ekzistuesë që datojnë që prej 1968, e që kanë nevoja emergjente për ndërhyrje i tejkalojnë mundësitë tona me stafin projektues që disponojmë për të përfunduar projektet e zbatimit paralelisht për një kohë tremujore përpara periudhave të miratimit të planeve. Gjithashtu Projektuesit tanë nuk kanë kapacitetet për projektet në PLSS CADD, apo Licensa të sistemeve SCADA, etj. Së Dyti: duhet të marrim në konsideratë që kjo eksperiencë ka gjetur bazë në modelet e kontratave me financim të huaj, ku jepet projekti për zbatim në kontratë të mbyllur me çelës në dorë, përfshirë trajnimet e stafëve. Praktikë kjo optimale për të minimizuar problematikën e projekteve të zbatimit gjatë fazës së implementimit, sikundër difektet në projektim janë risk që e absorbon kontraktori, duke mos e ekspozuar Investitorin ndaj riskut për modifikime projektesh, që bëhen shkak për pezullime, kosto shtesë dhe vonojne afatin e zbatimit të kontratave duke mos e realizuar objektivin e vënies së vepres në punë sipas parashikimeve të planeve të investimeve. Sjellim si rast të ngjashëm në praktikën europiane dhe botërore Kontratat FIDIC Green Book (version i shkurtuar i Yelloë Book), që lidhen ekskluzivisht me veprat energjitike (Nënstracione dhe Linja), ku përfshin Projektimin e plotë, Studimet, Testimet, Komisionimet, Trajnimet e stafit, etj. Kostot e materialeve dhe zbatimit të punës. Kontrata të tilla janë tepër efikase për shkak se arrijnë të realizojnë brënda afateve të parashikuara dhe brënda buxhetit objektet e investimit. Ndoshta ky model ku Kontraktori kryen projektimin dhe zbatimin nën mbikqyrjen e Klientit, u shpik për shkak se bota problematikat që hasen sot në OSSH i ka kaluar disa dekada mëparë duke e përkthyer eksperiencën në modele të tilla kontraktimi.

Së Treti: legjislacioni shqiptar në fuqi, nuk ka në asnjë rast karakter ndalues për dhënien e shërbimit të projektimit me të tretë, në të njëjtën kohë kur kompania disponon staf projektimi. Kapacitetet e projektuesve që disponon OSSH sha për Linja TL dhe NS, në raport me volumin constant të punës që kërkojnë projektet e këtyrë infrastrukturave, janë minimale. Për këtë arsye stafi i paktët që disponojmë është vënë në funksion të hartimit të Detyrave të Projektimit, pasi po të vendosej në zhvillimin e projekteve të zbatimit do ishte e pamundur të realizoheshin më shumë se 3 projekte në vit, gjë që do të çonte në kolaps Kompaninë. Për më tepër kostot e studimeve topografike, gjeologjike, gjeodezike, mjedisore, sizmike, urbanistike, etj. Do prokuroheshin me të tretë gjë që do rriste shumëfish herë më shumë kostot e projektimit të Linjave dhe Nënstacioneve tona. Parë në këtë këndvështrim krahas argumentimit më sipër, arsyetojmë se zgjidhja e dhënë ka maksimizuar uljen e kostove të OSSH sha për investimet, duke e transferuar riskun e situatave të paparashikuara tek Kontraktori.

Sa më sipër do të kërkonim rishikimin e kësaj gjetje të grupit të auditimit, nga i pazbatuar në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

D. MASA DISIPLINORE.

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Kontratën Kolektive të Punës nr. 8336prot., datë 16.12.2019 dhe kontratën individuale të punës, i rekomandohet Administratorit të OSHEE GROUP sh.a, vlerësimin e problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe dhënia e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si më poshtë:

1. D M

2. E M

3. ZH B, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, për arsye se:

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “*Fiderat e rinj 20 KV te Nënstacionit Vorë*”, në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.

Përgjigjja e institucionit:

Për znj. B është dhënë vërejtje me shkrim me urdhrin e brendshëm nr. 9247/21 prot., datë 07.09.2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

4. R S

5. A P

6. T Gj, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, për arsye se:

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “*Bazë materiale për nyjet kritike*”, në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “*Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht*”, në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim, pasaktësi në përlllogaritjen e fondit limit dhe mangësi në përzgjedhjen e llojit të kontratës.

Përgjigjja e institucionit:

Me shkresat nr. 9247/18 prot., datë 07.09.2023, nr. 9247/19 prot., datë 07.09.2023 dhe shkresa me nr. 9247/20 prot., datë 07.09.2023 janë dhënë masat “vrejtje me shkrim” për secilin punonjës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

7. J B

8. E B

9. A M, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, për arsye se:

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Ndërtim i disa kabinave te reja si dhe zhvillimi i rrjetit TU me kabëll me vetëpërbajtje ABC ne kabinat e fiderave 3,4 dhe 6 te N/St Gramsh”, në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresat nr. 9247/17 prot., datë 07.09.2023, nr. 9247/16 prot., datë 07.09.2023 dhe shkresa me nr. 9247/15 prot., datë 07.09.2023 janë dhënë masat “vrejtje me shkrim” dhe “paralajmerim largim” për secilin punonjës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

10. A N

11. A Gj

12. A Rr, në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për arsye se:

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Kabëll dhe aksesore për rrjetin shpërndarës”, gjatë vlerësimit të ofertave nuk kanë mbajtur në konsideratë një ofertë të vlefshme me devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet, duke mos rritur efijencën dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresat nr. 9247/14 prot., datë 07.09.2023, dhe shkresa me nr. 9247/13 prot., datë 07.09.2023 janë dhënë masat “vrejtje me shkrim” dhe “paralajmerim largim” për secilin punonjës. Për z. A Gj nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

13. D Xh

14. Z K

15. Dh Gj, në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për arsye se:

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Elemente të qarqeve primare për mirëmbajtje të Nënstacioneve elektrike të shpërndarjes”, gjatë vlerësimit të ofertave nuk kanë vlerësuar drejtë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Elemente për mirëmbajtje të qarqeve sekondare për N/stacioneve”, gjatë vlerësimit të ofertave nuk kanë vlerësuar drejtë operatorët ekonomik

pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresat nr. 9247/12 prot., datë 07.09.2023, nr. 9247/11 prot., datë 07.09.2023 dhe shkresa me nr. 9247/22 prot., datë 07.09.2023 janë dhënë masat “vrejtje me shkrim” për secilin punonjës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

16. E Dh

17. R K

18. A D, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, për arsye se:

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “*Rikonstruksion dhe ndërtim kabinash murature në Korçë*”, në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “*Rikonstruksione te rrjetit TM, TU ne zonat e përgjegjësishë në agjencinë Bilisht. Rikonstruksion kabinash tip murature në agj. Bilisht. Spostim i fiderit Nr. 5, N/St Bilisht tek Fideri Nr. 6 N/St Bilisht. Rikonstruksion rrjeti TM 10kV fideri nr. 8 ndërtim kabine BOX*”, në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresat nr. 9247/10 prot., datë 07.09.2023, nr. 9247/09 prot., datë 07.09.2023 dhe shkresa me nr. 9247/08 prot., datë 07.09.2023 janë dhënë masat “vrejtje me shkrim” për secilin punonjës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

19. z. A G

20. znj. G Gj

21. z. F G, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, për arsye se:

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “*Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, fideri F6, kabinave përkatëse dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti III*”, kanë hartuar kriteret të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “*Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti II*”, në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “*Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti III*”, në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.

Përgjigja e institucionit:

Me shkresat nr. 9247/6 prot., datë 07.09.2023, dhe shkresa me nr. 9247/7 prot., datë 07.09.2023 janë dhënë masat “vrejtje me shkrim” për znj. G Gj dhe për z. A G, ndërsa për z. F G nuk është dhënë masë disiplinore.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

22. znj. M G

23. z. Xh H

24. z. E T, në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve, për arsye se: Nga verifikimi i zbatimit të kontratës së furnizimit “*Blerje bokse individuale dhe aksesore për sistemin e matjes*”, është konstatuar se janë marrë në dorëzim materiale për të cilat nuk mund të garantohet se plotësojnë kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe specifikimet teknike.

Përgjigjja e institucionit:

Me shkresat nr. 9247/5 prot., datë 07.09.2023, nr. 9247/4 prot., datë 07.09.2023 dhe shkresa me nr. 9247/3 prot., datë 07.09.2023 janë dhënë masat “*vrejtje me shkrim*” për secilin punonjës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

25. znj. V K

26. z. A Gj

27. z. D M, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, për arsye se:

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “*Rikonstrukcion rrjeti TU me ABC njesia Elbasan 1 dhe një kabinë e re shtyllore*”, kanë hartuar kriteret të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Përgjigjja e institucionit:

Për punonjësit e sipërcituar nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ... Në lidhje me procedurën e prokurimit: “E hapur-Pune” me objekt prokurimi “Rikonstrukcion rrjeti TU me ABC njesia Elbasan 1 dhe nje kabine e re Shtyllore”, me fond limit 179,626,163 leke pa tvsh, në të cilën konstatohet gjetja se Njesia e Prokurimit ka kerkuar ne dokumenta tenderi licensim sipas kategorise: N.S-14 e cila nuk i perket punimeve qe realizohen sipas kontrates. Ka kerkuar gjithashtu edhe makineri pajisje si rul vibrues, kompresor, autobitumatrice, asfaltoshtruese qe bazuar ne preventivin e punimeve nuk ka asnje ze i cili i perket perdorimit te ketyre makinerive. Nepermjet ketij observacioni sqarojme se me shkresen nr. 3059 prot date 26.03.2021 jane percjelle prane prokurimit se bashku me kerkesen per prokurim edhe kapacitetet teknike te hatuara nga grupi i punes i perbere nga specialist te fushes si preventivues e projektues te ketij projekti.

Sipas kesaj shkrese te cilen do ta gjeni bashkengjitur observacionit rezulton se specialistet e fushes kane percaktuar edhe domosdoshmerine e licensimit sipas kategorise: N.S-14, por edhe makineri pajisjet si rul vibrues, kompresor, autobitumatrice, asfaltoshtruese.

Ne keto kushte sqarojme se Njesise se Prokurimit ka zbatuar dhe ka vendosur ne kapacitete teknike ato kerkesa te cilat jane hartuar dhe percjelle per zbatim me kerkesen nr.3059 prot., date 26.03.2021.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE nuk janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit. Prej institucionit rezultojnë të sjella pretendime teorike të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacion shkresor provues.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

28. z. Z Dh, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për arsye se:

Gjatë auditimit të kontratës “Zgjatim i fiderit A 1, N/stacioni Burdullias dhe rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll ABC”, janë konstatuar mangësi të cilat kanë të bëjnë me certifikim të punimeve më tepër nga ato të realizuara me vlerë 2,511,955 lekë.

29. z. V G, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për arsye se:

Gjatë auditimit të kontratës “Ndërtim i rrjetit TU me ABC për 23 kabina Cërrrik-Gostime”, janë konstatuar mangësi të cilat kanë të bëjnë me certifikim të punimeve më tepër nga ato të realizuara me vlerë 1,021,425 lekë.

30. z. K K, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për arsye se:

Gjatë auditimit të kontratës “Rikonstruksion rrjeti TU me kabëll ABC Rajoni Korçë”, janë konstatuar mangësi të cilat kanë të bëjnë me certifikim të punimeve më tepër nga ato të realizuara me vlerë 2,055,921 lekë.

-Për mbikëqyrësit e punimeve z. A GJ, z. A A, znj. F D, znj. A Q, z. A M, z. G K dhe z. A H, mendojmë të mos rekomandojmë masë disiplinore, për arsye se shkeljet e konstatuara janë të një niveli jo të konsiderueshëm dhe jo të përhapura.

Përgjigjja e institucionit:

Me shkresat nr. 9247/2 prot., datë 07.09.2023, nr. 9247/1 prot., datë 07.09.2023 dhe shkresa me nr. 9247 prot., datë 07.09.2023 janë dhënë masat “vrejtje me shkrim” për secilin punonjës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

E. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, në Ligjin nr. 7, datë 02.02.2017 ‘Për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme’, në VKM nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar, neni 29, si dhe në Kontratat Tip të lidhura ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe subjekteve Prodhues me Përparësi të Energjisë (PPE), neni 11 “Zgjidhja e kontratës”, ***i rekomandojmë*** Ministrinë të Infrastrukturës dhe Energjisë, që pas kontrollit nga AKBN dhe saktësisht të shkaqeve të prodhimit më tepër se fuqia e licencuar, të veprojnë për zgjidhjen e menjëhershme të kontratave “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik” me Prodhuesit me Përparësi të Energjisë, të cilët kanë përfituar më tepër, si pasojë e ndërtimit dhe instalimit të një fuqie prodhuese më të madhe se ajo e lejuar/miratur e licencuar.

-Nga Administratori i OSHEE GROUP sh.a në bashkëpunim me Administratorin e FTL sh.a, në rast se MIE nxjerrë akte administrative për zgjidhjen e kontratave me subjektet PPE, “Për shit-blerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike”, për subjektet: “S” shpk, R.. shpk, “A..” shpk, “A.. S” shpk, “S1S” shpk,

“S2S” shpk, “S S” shpk, “S w” shpk, “L” dhe “A..S”, të vijojnë procedurat për ndërprerjen e kontratave të blerjes së energjisë.

- MIE në bashkëpunime me ERE, OSHEE GROUP sh.a dhe FTL sh.a., të fillojë procedurat ligjore për përditësimin dhe ndryshimin e kushteve të sanksionuara në kontratën që OSHEE dhe FTL sh.a. nënshkruajnë me secilin Prodhues me Përparësi të Energjisë (PPE), si dhe MIE të përditësoj kushtet e kontratës për “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik” me Prodhuesit me Përparësi të Energjisë.

Përgjigjja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 5081/3 prot, datë 12.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/3 prot, datë 14.08.2024 z. E K ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Sikurse është parashtruar edhe më lart AKBN ka konkluduar se fuqia prodhuese e impianteve fotovoltaike është në përputhje me kushtet e licencës...ERE në cilësinë e institucionit përgjegjës për miratimin e kontratave tip, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Pretendim i subjektit i sjellë përmes observacioneve me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 protokolluar në KLSH me nr.792/17 prot., datë 18.10.2024 ...

Sikurse kemi parashtruar edhe mbi akt verifikimin Nr. 1, datë 02.08.2024 (Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka konkluduar se fuqia prodhuese (AC) e impianteve fotovoltaike është në përputhje me kushtet të licencës. Gjithashtu Ministria e Infrastrukturës e Energjisë nuk ka nxjerrë akte administrative në lidhje me këtë rekomandim.

Në vijim, “OSHEE Group” SH.A./ “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., referuar edhe zhvillimeve të tregut të energjisë elektrike, në bashkëpunim me konsulentët e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, projekt i financuar nga Agjencia Franceze e Zhvillimit (AFD) finalizoi procesin mbi përditësimin/ ndryshimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike me prodhuesit e energjisë elektrike, ndryshime të cilat me shkresën Nr. 3335 Prot., datë 06.09.2024 u paraqiten për miratim pranë Entit Rregullator të Energjisë, në cilësinë e institucionit përgjegjës për miratimin e kontratave tip, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Në vijim informojmë se shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., edhe nëpërmjet shkresës Nr. 1946 prot., datë 21.07.2022 me lëndë “Mbi rishikimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet “FTL” SH.A. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë”, ka kërkuar pranë Entit Rregullator të Energjisë rishikimin e kësaj kontrate.

Bashkëlidhur gjeni:

- shkresën e Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A. drejtuar Entit Rregullator të Energjisë Nr. 1946 prot., datë 21.07.2022.

- shkresën e Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A. drejtuar Entit Rregullator të Energjisë Nr. 3335 Prot., datë 06.09.2024.

Sa më sipër do të kërkonim rishikimin e kësaj gjetje të grupit të auditimit, nga i pazbatuar në proces zbatimi, në varësi të Institucioneve Vendimmarrëse/ERE-s.

Në përfundim të këtij materiali kërkojmë të rishikoni dhe ndryshoni Tabelen përmbledhëse, faqe 5 dhe faqe 61 në lidhje më numrin e masave dhe zbatueshmërinë e tyre duke qënë se ka disa lapsuse.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit të ri justifikues, vendosur në dispozicion përmes observacioneve dërguar me shkresën nr.5081/5 prot., datë 11.10.2024 dhe protokolluar në KLSH me nr.792/17

prot., datë 18.10.2024, rezultoj se, nga ana e OSHEE janë paraqitur prova/evidenca të reja justifikuese të cilat do të ndryshonin statusinë e zbatimit të rekomandimit nga pazbatuar në pjesërisht të zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit kryer prej grupit të auditimit të KLSH-së rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 43 Masa Organizative nga ku 42 rekomandime, janë pranuar plotësisht 42 të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 8 zbatuar dhe 9 pjesërisht zbatuar dhe 25 pazbatuar;
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 14 Masa Shpërblim Dëmi nga ku 14 rekomandime, janë pranuar plotësisht 14 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit 7 zbatuar, 3 pjesërisht zbatuar dhe 4 pazbatuar
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 5 Masa për Menaxhimin me Eficencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike, nga ku 5 rekomandim, pranuar plotësisht 5 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit 5 pa zbatuar;
- d) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë Disiplinore nga ku 1 rekomandim, është pranuar plotësisht 1 dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit 1 pjesërisht zbatuar ;
- e) Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 Masë Administrative nga ku 1 rekomandim, është pranuar plotësisht 1 dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit 1 pjesërisht zbatuar.

Kërkojmë që, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar si dhe pjesërisht zbatuar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.

Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuarra prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pazbatuara.

3.8 HEKURUDHA SHQIPTARE Sh. A

PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Hekurudhën Shqiptare SHA** mbi “*Zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023*” për auditimin e kryer në vitin 2023, për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr. 126/10 prot., datë 28.07.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdrave) për zbatimin e masave organizative;

b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomikitet të fondeve;

ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 792/1 prot., datë 01.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.R, (Përgjegjës grupi)
2. E.K

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr. 126/10 prot., datë 28.07.2023 së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Hekurudha Shqiptare Sh.A, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr. 126/10 Prot., datë 28.07.2023, rezulton se, nga **33** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi, 3-E dhe Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **33** masa të rekomanduara ose 100 %. **Nga të pranuarat (33):** janë zbatuar plotësisht **9**, ose 27 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht **20** masë ose 58 % dhe pazbatuar **5** masa ose 15%.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit		
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
1	Organizative	19 masa	7 masa	10 masa	2 masa
2	Shpërblim dëmi	7 masa 10,785,552 lekë	-	7 masa 10,785,552 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	6 masa 44,367,188 lekë	2 masa	2 masa 30,787,598 lekë	2 masa 13,579,590 lekë
4	Masa Disiplinore	1 masë	-	-	1
	<i>Gjithsej</i>	33 masa 55,152,740 lekë	9 masa	19 masa 41,573,150 lekë	5 masa 13,579,590 lekë

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është, zbatuar plotësisht në masën 27 %, zbatuar pjesërisht në masën 58% dhe pa zbatuar në masën 15%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1- Hartim i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Hekurudha Shqiptare Sh.A ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën Nr. 109/58 prot., datë 04.08.2023.

III/2- Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, jo në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: Në shkresën nr. 415/7 prot., datë 13.11.2019, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, “Hekurudha Shqiptare” SHA, i janë lënë për zbatim 36 masa organizative, 5 masa për shpërblim dëmi, 1 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike, për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike si dhe 2 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar gjithsej:

A. 36 masa organizative: janë pranuar 35 prej tyre, ose 97.3%, nga të cilat, 14 masa janë zbatuar plotësisht (40%), 3 masa janë në proces zbatimi (8.6%), 14 masa nuk janë zbatuar (40%), 4 masa zbatuar pjesërisht (11.4%).

B. 5 masa për shpërblim dëmi: nga të cilat, 2 masa janë zbatuar plotësisht (40%), 3 masa nuk janë zbatuar (60%).

C. 1 masë për eliminimin e efekteve të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, e cila nuk është zbatuar.

D. 2 masa disiplinore rekomanduar gjithsej, të cilat janë zbatuar.

Mozbatimi i masave të rekomanduara nga KLSH në auditimin e mëparshëm është jo në përputhje me ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", duke sjellë mos eficiencë në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për “Hekurudha Shqiptare” SHA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 17 - 39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju ri kërkohet** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht, të pa zbatuara.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Për sa është rekomanduar, sqarojmë se “Hekurudha Shqiptare” sha, ndërmjet shkresës Nr. 401/1 Prot, datë 24.06.2024, ka rikërkuar nga të gjitha Njësitë e Biznesit dhe Shërbimeve, marrjen e masave që nuk janë zbatuar akoma, apo që janë në proces realizimi. Këto të fundit duhet ti njihen Administratorit të Shoqërisë të shoqëruara me dokumentacionin shoqëruar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

2- Gjetje nga auditimi: Në “Hekurudha Shqiptare” SHA, konstatohet një planifikim dhe realizim jo i duhur i programit ekonomik, fakt që flet për planifikim jo të saktë dhe mos rishikim të programit fillestar. Performanca e treguesve ekonomik-financiar që lidhen me realizimin e buxhetit faktik të shoqërisë, nuk është e kënaqshme dhe ka vend të përmirësohet, pasi për çdo lekë të shpenzuar, sipas viteve objekt auditimi është përfituar një e ardhur: 2019 prej 0.89 lekë, 2020 prej 0.79 leke, 2021 prej 0.94 lekë dhe për vitin 2022 një e ardhur prej 0,99 lekë. Raporti i detyrimeve afat shkurtër/kapitalit për vitin 2019, paraqitet 1.5 % , për vitin 2020 paraqitet 1.22%, për vitin 2021 paraqitet 1.31% dhe për 2022 në 1.45%. “Hekurudha Shqiptare” SHA, ka riskun e gjendjes së pamjaftueshme të likuiditeteve. Në qoftë se shoqëria do të llogariste penalitetin e hekurudhave të huaja si dhe nuk do të çelej subvencion nga buxheti i shtetit, do të çonte në rezultat negativ akoma më të lartë për vitet ushtrimore. Duke zbritur nga pasqyrat financiare subvencionin si e ardhur, raporti të ardhura/shpenzime do të ndryshojë duke thelluar në mënyrë të ndjeshme rezultatin financiar (humbje). Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjet nr. 115/ 2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar; nr.137/ 16.11.20, “Për buxhetin e vitit 2021”, ndryshuar; nr.88/ 18.12.19, “Për buxhetin e vitit 2020”, ndryshuar; nr. 99/ 2018, “Për buxhetin e vitit 2019” si dhe UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 43 – 66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Nga ana e organeve drejtuese të bëhet një analizë e detajuar e investimeve kapitale dhe shpenzimeve, etj., të planifikuara për t`u realizuar gjatë vitit dhe të merren veprimet e nevojshme që këto projekte të realizohen sipas programit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me shkresën nr. 322 prot., datë 25.04.2024, ku ky grup është përgjegjës për të raportuar planifikimin, programet me prioritet, objektivat, detyrat e Hekurudhes Shqiptare.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se nga ana e MFE, me shkresat përkatëse, është miratuar detajimi i planit për shpenzimet korrente, ndërkohë që emërtimi i produktit është “rrjet hekurudhor i subvencionuar”. Në opinionin e grupit të auditimit emërtimi “Rrjet hekurudhor i subvencionuar” është në kundërshtim me pikën 26, 58 dhe 63, të nenit 5, të ligjit nr.142/2016

“Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se rrjeti nuk është veprimtari por objekt. Nga auditimi i dokumentacionit, për përdorimin/ realizimin e subvencionit sipas shkresave dërguar MIE-s dhe Degës së Thesarit Durrës, subvencioni ka numër artikulli 603000 “Subvencione për transportin hekurudhor” (sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik) dhe jo artikullin përkatës për të cilin është kryer shpenzimi faktik. Nga sa rezulton, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), Dega e Thesarit Durrës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar), me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë të paqartë për alokimin dhe përdorimin e subvencionit nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, duke i krijuar kësaj shoqërie mundësinë që ta përdor këtë subvencion për paga dhe sigurime shoqërore, duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të akorduar po nga MFE. MIE dhe MFE, e kanë përdorur subvencionin si të vetmin instrument për të mos shpallur procedurat e falimentimit të Shoqërisë HSH sha.

Pas miratimit të programit ekonomik nga MFE, nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, janë përgatitur kontrata për marrëveshjen financiare shtetërore e cila i është dërguar MIE-s. Këto marrëveshje janë firmosur në mënyrë të njëanshme vetëm nga “Hekurudha Shqiptare” SHA dhe në asnjë rast nuk janë firmosur nga MIE.

Ecuria e treguesve ekonomik-financiare për vitet e fundit 2019, 2020, 2021 dhe 2022, pasqyron një krizë likuiditeti “Hekurudha Shqiptare” SHA, si dhe ka detyrime të prapambetura ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë, për principial dhe interesa, fatura për blerje etj., në vlerën 3,870,023 mijë lekë (totali i detyrimeve afatshkurtra 1.096.943 mijë lekë + totali i detyrimeve afatgjata 2.773.080 mijë lekë). Në opinionin e grupit të auditimit “Hekurudha Shqiptare” SHA, është në gjendje falimentimi.

Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjet nr.115/ 2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, ndryshuar; nr.137/ 16.11.20, “Për buxhetin e vitit 2021”, ndryshuar; nr.88/ 18.12.19, “Për buxhetin e vitit 2020”, ndryshuar; nr.99/ 2018, “Për buxhetin e vitit 2019” si dhe UMFE nr.9, datë 20.03.18, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli Mbikqyrës, ti kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e pronarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime urgjente ligjore, për korrigjimin e menjëhershëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për subvencionin, që të përputhen kërkesat e ligjeve me kushtet dhe specifikat në të cilat ndodhet kjo shoqëri

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në lidhje me rekomandimin e lënë, ju bëjmë me dije se me shkresën nr. 109/ 70 Prot., datë 10.10.2023, i jemi drejtuar MFE në lidhje me korrigjimin e emërtesës së subvencionit. MFE ka përcjell shkresën nr. 18652/ 1, datë 20.10.2023 drejtuar MIE, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe për dijeni në Hekurudha Shqiptare, në të cilën ka kërkuar ndryshimin e emërtesës. Në lidhje me këtë të fundit nuk ka asnjë shkresë nga MIE dhe DPTH.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

4- Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2022, huatë afatgjata dhe detyrimet e tjera afatgjata, paraqiten në vlerën 1,438,887 mijë lekë, kjo bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit nr. 37, në fuqi. Objektivi i SNK 37 është të sigurojë se janë zbatuar kriteret e duhura të njohjes dhe bazat e matjes për provizionet, pasivet dhe

aktivet e kushtëzuara. Në këtë vlerë, Shoqëria nuk ka përfshirë vlerat për interesa dhe kamatëvonesa të arritura sipas marrëveshjeve të huave. Shoqëria ka njohur në vitin 2000 provizionet afatgjata në vlerën 237,250 mijë lekë, që lidhen drejtpërdrejt me detyrimet e mundshme të huave dhe detyrimeve. Me shkresën nr. 48 prot., datë 19.01.2023, HSH sha, i është drejtuar MFE^{së}, për të krijuar kushtet e nevojshme për likuidimin e borxheve të huaja. Duke marrë në konsideratë shumën e penaliteteve të pa llogaritura, pretendimet e hekurudhave të huaja dhe kostot potenciale për zgjidhjen e marrëveshjeve, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë mbi shumën e nevojshme të provizioneve shtesë që duhet të krijohen dhe efektet që kjo do të kishte në pasqyrat financiare. Shoqëria nuk ka pasur një politikë koherente të njohjes së provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta. Mungesa e një rregulloreje për provizione si dhe mungesa e një analize për vjetërsinë dhe vlerësimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta, mund të ketë ndikim në rritjen e rrezikut për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dhe marrjen e vendimeve të gabuara lidhur me to. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b e d, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme për hartimin e një rregullore për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija, të bazuar në politika të qarta dhe në harmoni me Standardet e kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës nuk është marrë asnjë masë për hartimin e një rregullore për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

5- Gjetje nga auditimi: Gjendja debitore dhe kreditore për “Hekurudha Shqiptare” SHA është shumë e rënduar, pavarësisht se nga organet drejtuese të saj është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre. Gjendja debitore për vitin 2022 është në vlerën 594,825,000 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, e mbajnë aktivet korrente në vlerën 369,000,000 lekë ose 67 %. Pjesë tjetër e cila është e rëndësishme, është TVSH me saldo debitore, në vlerën 36,129,000 lekë. Ndërsa në llogarinë 4671, e cila është në vlerën 68,464,784 lekë, janë detyrime të cilat nuk mblidhen prej vitesh dhe janë të ndjekura nga sektori juridik. Në llogarinë 411, të arkëtueshme, e cila ka vlerën 15,966,000 lekë, janë të viteve të fundit dhe mendohet se do jenë të arkëtueshme nga Njësia Biznes Mallit dhe Njësia e Menaxhimit të Infrastrukturës. Sa trajtuar janë në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, situatë e cila sjell ndikim në rezultatin financiar të Shoqërisë në fund të vitit ushtrimor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b e d, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1 Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” SHA, (Administratori, Këshilli Mbikëqyrës, Asambleja e Përgjithshme), të marrin masa për analizimin, shqyrtimin dhe reduktimin e humbjeve të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Organet Drejtuese të Shoqërisë nuk ka marrë masa për analizimin, shqyrtimin dhe reduktimin e humbjeve të shoqërisë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

6- Gjetje nga auditimi: “Hekurudha Shqiptare” SHA, pasqyrimin në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, bëhet vetëm për vlerën e detyrimit (borxhit). Deri më 31.12.2022, detyrimi ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 1,976,747 euro ose 225,803,918 lekë, nga të cilat 518,483 euro (59,221,332 lekë) penalitete, kryesisht detyrimet janë ndaj Hekurudhës Serbe dhe Hungareze. Mos likuidimet në kohë janë jo në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, si dhe ndikojnë në mos pasqyrim të saktë të rezultatit financiar të shoqërisë. Këto detyrime i përkasin periudhës 2009-2022, të cilat përfshijnë orë/qëndrimet e vagonëve të huaj në territorin shqiptar. Gjatë kësaj periudhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, e ka patur të pamundur likuidimin e tyre për shkak të gjendjes së rëndë financiare. Hekurudha Serbe (Serbia Carko) i ka kërkuar gjatë gjithë periudhës detyrimet e tyre madje kane kërkuar dhe interesa. Shoqëria ka vënë në dijeni dhe Ministrinë e Financave për detyrimin që ka “Hekurudha Shqiptare” SHA ndaj hekurudhave të huaja. Detyrime të tjera në këtë llogari paraqitet dhe detyrimi ndaj hekurudhave të huaja (të vjetra “deri në vitin 1990-1992”) në vlerën 781.465.000 lekë. Theksojmë se “Hekurudha Shqiptare” SHA nuk disponon dokumente ligjor, për ndarjen e detyrimeve të ish Hekurudhës Jugosllave, sipas shteteve që aktualisht janë, pra në pasqyrat financiare disponohet detyrimi i trashëguar që nga periudha 1990-1992 si Hekurudhë Jugosllave. Nga ana e “Hekurudha Shqiptare” SHA nuk janë llogaritur interesa ndër vite për këto detyrime afatgjata.

Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b e d, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Nga Administratori i Përgjithshëm, Njësia Ekonomike dhe Sektori i Marketingut, të merren masa për të bërë evidentimin dhe regjistrimin e penaliteteve të shkaktuara nga mos likuidimi i kamatë vonesave për orë qëndrimet e vagonëve të hekurudhave të huaja, duke bërë në këtë mënyrë raportim të saktë dhe të besueshëm të detyrimeve financiare, si dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për sa është rekomanduar ju parashtrjmë se nga NJBM janë llogaritur kamatëvonesat për Hekurudhën Serbe dhe Hungareze të cilat kanë peshën më të mëdhe të borxheve për orë qëndrimet. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë është urdhëruar likuidimi i Hekurudhave Polake, Gjermane si dhe është lidhur akt-marrëveshja nr. 11/51 Prot, datë 14.12.2023 për likuidimin me këste të hekurudhave të Malit të Zi, e cila është përlllogaritur të shlyhet në fund të vitit 2024.

Nga Njësia Ekonomike dhe Administratori i Shoqërisë janë dërguar aktet shkresore respektive me nr. 48 Prot, datë 19.01.2023; nr. 237/ 3 Prot, datë 17.05.2023 dhe nr. 237/ 5 Prot, datë 11.12.2023 Ministrisë Financave dhe Ekonomisë dhe për dijeni Ministrisë së linjës, mbi sistemimin e borxheve. Këto shkresa dhe sot mbeten pa përgjigje.

Njësia e Biznesit Mallit me Nr.04/7 Prot, datë 26.06.2024 ka njoftuar se NJBM ka përfshirë në pasqyrat financiare detyrimet ndaj hekurudhave të huaja që kanë lindur gjatë periudhës 2009-2024. Sektori Ekonomik i NJMB-së ka kryer rakordimin me të gjitha hekurudha e huaja për detyrimet e orë-qëndrimeve të vagonëve të huaj në territorin e Hsh-së (principalin, si edhe për penalitetet (interesat) lindura nga mosshlyerja e detyrimeve. Hekurudha e huaja që kanë aplikuar kamatvonesa janë; Hekurudha Serbia Cargo, HZ CARGO, PKP CARGO, Hekurudhën e Malit të Zi.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

7- Gjetje nga auditimi: “Hekurudha Shqiptare” SHA, në sistemin kontabël që përdor për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarive të njëjësive ekonomike nuk përdor bartësit informatikë, duke shfaqur rritje të riskut të gabimeve si dhe të vështirësive për monitorim të sistemit, mungesën e të dhënave financiare në kohë reale për t’u reflektuar në vendim-marrjen e organeve drejtuese të shoqërisë. Ky fakt ndikon në mos kontroll për sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave për të gjitha veprimet dhe ngjarjet ekonomike, mundësi për ndryshim të tyre nga përdoruesit dhe rezulton mos vlerësim sa dhe si duhet i programeve informatike bashkëkohore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b e d, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë të merren masa që në sistemin e saj kontabël, evidence mbështetëse, dokumentet bazë, dokumentet plotësues dhe regjistrat kontabël, të implementojë bartësit informatikë, që janë autorizuar nga organet përkatëse, të shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa-manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Shoqëria ka lidhur Kontratën nr. 539 Prot, datë 06.07.2023 me subjektin “*Infosoft Software Developer*” shpk, për instalimin dhe implemetimin e sistemit financiar elektronik. Aktualisht në Sektorin e Financës HSH Njësia Qëndrore, po punohet në programin elektronik, ndërsa në njësitë përkatëse jemi në proces implementimi, për shkak se ka shumë të dhëna financiare që kërkojnë kohën e nevojshem për t’u përpunuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

8- Gjetje nga auditimi: Në “Hekurudha Shqiptare” SHA, mbajtja e llogarive të aktiveve jashtë kontabilitetit është në shumën 2,441,739,656 lekë, në të cilat paraqiten vlera e aktiveve afatgjata materiale që priten t’i transferohen bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës, procedurë e cila ka mbetur përgjysmë. Si rrjedhojë, grupi i auditimit nuk është në gjendje të vlerësojë efektin që do të kishin patur në pasqyrën e performancës, si edhe në pozicionin financiar, nëse kjo procedurë e nisur nuk do të realizohet, bazuar në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, i ndryshuar dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në fuqi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b e d, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi: Shoqëria të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të vlerës 2,441,739,656 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me aktivet afatgjata materiale, të cilat janë në proces transferimi ndaj bashkive Tiranë, Mirditë, Klos, Laç, Elbasan dhe Durrës, në zbatim të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Kjo vlerë ndodhet jashtë bilancit në debi dhe kredi, e për rrjedhojë nuk ka efekt për vitin ushtrimor, sepse efektet financiare janë mbyllur sipas periudhave kur janë hequr nga

kontabiliteti me Vendime të MFE. Hekurudha Shqiptare është në pritje për dorezimin pranë pushtetit lokal të këtyre aseteve.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

9- Gjetje nga auditimi: Të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, me përjashtim të 4 prej tyre, nuk janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, (Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme), veprime në kundërshtim me ligjin nr.111/2018, “Për Kadastrën” dhe ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, fakt i cili ndikon në keq menaxhim të aktiveve të Shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/b e d, faqe 72 -91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Nga Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” SHA, të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorinë Vendore, Durrës, të gjitha objektet që janë regjistruar në zërin “troje” në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Hekurudha Shqiptare ka lidhur kontratën e shërbimit me Universitetin Politeknik të Tiranës me objekt “Realizimin e rievimeve topografike kadastrale për pronat e DPH”, pasi të mbyllet si proces Hekurudha Shqiptare do ti drejtohet Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për regjistrimin e tyre.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, sipas kontratës së lidhur midis kontraktorit “E B” SHPK & “V E” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 984/2 prot., datë 18.11.2019, objekt “Punime për mbrojtjen e linjës”, grupi i auditimit, nuk mundi të verifikonte disa zëra punimesh, konkretisht, në km 75 +050, L=35 ml, perigoni Lushnje-Fier, pasi hasi në vështirësi për të evidentuar me saktësi segmentet e deklaruara (km) nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, si segmente që duheshin riparuar. Mungonin gurët kilometrikë e si rezultat nuk ishte e mundur të evidentohesh saktësisht nëse punimet ishin kryer në segmentet/kilometrat e deklaruara nga “Hekurudha Shqiptare” SHA. U konstatuan mangësi të theksuara të sinjalistikës hekurudhore si ajo që nevojitet për makinistët e trenave por edhe sinjalistika e domosdoshme për këmbësorët ose automjetet që kalojnë kryqëzimet hekurudhore. Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA nuk është marrë asnjë masë për saktësimin e gjatësive kilometrike të linjave hekurudhore shqiptare, duke vështirësuar kryerjen e verifikimeve në terren, lidhur me investimet e deklaruara për kilometrat respektiv. Veprimet sa më sipër janë jo në përputhje me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7 dhe Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të “Hekurudha Shqiptare” SHA, nenet 112, 114, 149 dhe neni 152.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 164 -203 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të merren masa për vendosjen e sinjalistikës hekurudhore me qëllim garantimin e sigurisë në trafikun hekurudhor dhe vendosjen e gurëve kilometrikë të paktën për çdo 100 km gjatësi të linjës hekurudhore, me qëllim lehtësimin e kryerjes së verifikimeve në të ardhmen të zërave të punimeve për rikonstruktionet e segmenteve të ndryshëm të linjës hekurudhore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e Hekurudhes Shqiptare janë marrë masa për vendosjen e sinjalistikës hekurudhore me qëllim garantimin e sigurisë në trafikun hekurudhor dhe vendosjen e gurëve kilometrikë të paktën për çdo 100 m gjatësi të linjës hekurudhore.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

11. Gjetje nga auditimi: Midis kontraktorit “M LTD” SHPK & “V K” SHPK & “E K” SHPK & “N G” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, është lidhur kontrata nr.110/4 Prot., datë 03.11.2022 dhe objekt “Riparim vepra arti (mbrojtja e urës hekurudhore të Rrogozhinës)”, me afat 45 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit dhe vlerë kontrate 37,799,726.4 lekë me TVSH. Nga auditimi në terren për verifikimin e zbatimit të punimeve, rezultoi se për zërin “F.V. Mbushje me gurë kave të mëdhenj $D>70$ cm për mbrojtje të këmbëve të urës dhe stabilizim dhe uljen e gërryerjes së mëtejshme, $t=2\text{ton/m}^3$ ”, ishte pamundur për grupin e auditimit që të verifikohet realizimi i këtij zëri, për sasinë e deklaruar e gurëve të hedhur në shtratin e lumit prej $9,254 \text{ m}^3$, sa deklaruar në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar, për arsye të prezencës së ujit në lumin Shkumbin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 164 -203 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: “Hekurudha Shqiptare” SHA, në bashkëpunim me institucionet shtetërore përkatëse për menaxhimin dhe mbrojtjen e lumenjve, të verifikojnë nëse kontraktori “M LTD” SHPK & “V K” SHPK & “E K” SHPK & “N G” SHPK, kanë realizuar zërin e punimeve të mësipërme. Në rast se nuk kryhet ky verifikim **vlera 8,853,016 lekë, do të konsiderohet dëm ekonomik.**

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Për sa është rekomanduar, sqarojmë se “Hekurudha Shqiptare” sha, ndërmjet shkresës me nr. 477 Prot, datë 09.06.2023, ka kërkuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore specialistë të fushës me pajisjet përkatëse për skanimin e lumenjve. Pas kësaj Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, ka kthyer përgjigjen e saj me aktin shkresor nr. 859/ 1 Prot, datë 06.07.2023, ku dhe parashtron se nuk ka mjete, pajisje për matjen apo skanimin topografik të lumenjve.

Me shkresën 109/69 Prot., datë 04.10.2023 është dërguar akt inspektimi me objekt “*riparim vepra arti projektim zbatim*” pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, inspektim i kryer nga supervizori i licensuar F S i cili ka kryer inspektimin me shkresën nr. Extra Prot., datë 18.09.2023, e cila ka dalur në konkluzionin se: Objekti është kontrolluar, verifikuar nga mbikqyrësi i punimeve, kolaudatori dhe investitori. Nga të gjitha kontrollet e bëra ka rezultuar që objekti është në gjëndje shumë të mirë, pa difekte dhe me të gjitha sasinë e realizuara sipas situacionit përfundimtar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

12- Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit publik të kryera nga AK, për periudhën objekt auditimi, pothuajse në të gjitha procedurat e audituara, nga ana e APP është dhënë asistencë teknike për kërkesat e veçanta për kualifikim. Pavarësisht se rekomandimet e dhëna

nga APP janë zbatuar sipas shtojcave të modifikimit të DST^{ve}, kjo ka sjellë shtyrjen e afatit të procedurës së prokurimit.

Në përbërjen e njësisë së prokurimit nuk ka specialistë të fushës, por ato janë me profesion jurist dhe vetëm në tre raste është inxhinier elektrik, por që nuk është i fushës konkrete, kërkesë kjo e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 57, “Njësia e prokurimit”, pika 1 dhe 2, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 74, pika 4, neni 78.

Nisur nga fakti se projektet, preventivat dhe specifikimet teknike hartohen nga Njësia e Infrastrukturës, bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim mbikëqyrje dhe kolaudim”, neni 3, “Shërbimet dhe tipologjitë”, pika 5, ku janë përcaktuar tipologjitë e shërbimit, kriteret e veçanta teknike duhet të ishin hartuar nga njësia e cila paraqet projektet, preventivat dhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 102-164, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: AK, “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masa që hartimi i kriterëve teknike për kualifikim të kryhet nga specialisti i fushës së njësisë së prokurimit ose nga struktura të posaçme, Njësia e Infrastrukturës.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Nga Hekurudha Shqiptare Sh.A janë marë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimeve në vazhdimësi hartimi i kriterëve teknike për kualifikim është bërë nga specialistë të fushës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

13- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se projektet nuk shoqërohet nga licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Grupi i projektimit duhet jetë i përbërë minimumi nga: inxhinieri gjeodet për plan rievimin dhe azhurnimin topografik, projektuesi arkitekt, projektuesi konstruktor, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi i instalimeve hidrosanitare, projektuesi i instalimeve ngrohje ftohje ventilim, projektuesi i instalimeve elektrike, projektuesi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri, inxhinieri sizmolog, inxhinieri gjeolog, eksperti mjedisor, veprim jo në përputhje me VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 102-164, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1 Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” SHA, të merren masa për të operuar vetëm me projekte të zbatimit të hartuara nga projektues, të pajisur me licencat përkatëse.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Për këtë pikë ju bëjmë me dije se nga Administratori i Shoqërisë dhe NJ.SH.B.M janë marë të gjitha masat që për kontratat e punëve publike të ndërtimit në vazhdimësi do të operohet me projekte të hartuara nga subjekte të licensuara.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

14- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për përlllogaritjen e fondit limit nga komisionet përkatëse rezultoi se: Nuk ka të dhëna mbi çmimet bazë të kontratave të mëparshme të vetë AK. Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, nuk liston asnjë çmim të kontratave të mëparshme për të lënë gjurmë auditimi, por kërkojmë nga njësia e prokurimit dhe strukturat juridike pranë saj të bëjnë verifikimin ligjor të procedurës së ndjekur për hartimin e fondit limit dhe nëse del ndonjë problem të referohet për ndryshimet e nevojshme, veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, neni 74/4, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, neni 76, “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pika 3. Nga ana e këtij komisioni përcaktohet se: “Vlerat e mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve do të mbulohen nga ulja në procedurën e prokurimit”, veprim jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 1, “Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 113 -221, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: AK, “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masa të argumentojë përlllogaritjen e fondit limit sipas detyrës së caktuar nga titullari. Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit të mos tejkalojë kompetencat e caktuara, duke përcaktuar fondet për mbikëqyrje e kolaudit nga përlllogaritja e fondit limit të procedurës së urdhëruar.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Nisur nga fakti që në buxhetin vjetor të planifikuar për Hekurudhën Shqiptare sipas PBA-ve përkatëse vlera e mbikëqyrjes dhe kolaudit për procedurat e punimeve të ndërtimit nuk ka qënë e ndarë me emertim të vecantë. Sipas Ligjit 8402 me ndryshimet përkatëse këto procedura duhet të mbikëqyren dhe kolaudoen dhe për këtë arsye jemi detyruar që vlerën e tyre ta zbrezim nga fondi total i planifikuar për investimin. Për procedurat në vazhdimësi do të marim masa që vlerat e mbikëqyrjes dhe kolaudit të planifikohen me emërtim të vecantë në buxhetin afatmesëm.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

15- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit kryesisht për blerje traversa druri apo rikonstruksione të linjave rezultoi se në specifikimet teknike, komision nuk ka përcaktuar llojin e standardit të KE në fuqi si dhe është kërkuar certifikatë cilësie e prodhuesit, pa përcaktuar numrin e saj, certifikatë garancie të prodhuesit pa përcaktuar afatin e garancisë së traversave, veprim jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 27, Kontratat e mallrave, pika 1. Ndërsa në arsyetimin për nevojën e prokurimit për blerje traversa druri hekurudhore (kjo e vlefshme edhe për rikonstruksionin e linjave), jepet arsyetimi i

gjendjes se rënduar hekurudhore, por në lidhje me rezultatet e kontrollit teknik periodik të kryer në linjën hekurudhore nuk jepet asnjë e dhënë mbi rezultatet se sa janë kërkuar dhe për kë linja janë kërkuar këto traversa. Sa më sipër është jo në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, ndryshuar, neni 60 “Urdhri i prokurimit”, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 102-164, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: AK, “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masa të arsyetojës në mënyrë të drejtë domosdoshmërinë e kryerjes së procedurës së prokurimit dhe hartimi i specifikimeve teknike të jetë në përputhje me objektin e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Gjatë hartimit të specifikimeve teknike nga komisionet përkatëse është patur parasysh procesi i punimeve të ndërtimit që do të realizohet në linjat hekurudhore si punë specifike për hekurudha. Domosdoshmëria e investimit ka dalë për shkak të gjendjes tejet të amortizuara të linjës hekurudhore dhe reduktimit të shpejtësisë së lëvizjes mjeteve hekurudhore. Gjithashtu investime janë realizuar në ato segmente të linjës hekurudhore ku shpejtësia e lëvizjes ka qënë me 5 deri 10 km/orë, me qëllim përmirësimin e lëvizjes. Megjithatë nga Hekurudha Shqiptare SHA do të merren masa të mtejshme për përmirësimin e punës nga ana e komisioneve përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

16- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit publik në të gjitha rastet rezultoi se preventivat nuk shoqërohen me analizë teknike të çmimeve për ato raste kur këto çmime nuk janë pjesë e manualeve teknike të çmimeve, veprim jo në përputhje me VKM nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat: 9, 10, 11 dhe me Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe nr. 1, datë 16.6.2011.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 102-164, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: AK, “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masa që të hartojë preventiva, ku çmimet e reja që nuk përfshihen në manualin teknik të çmimeve të bëhen me analizë, duke u bërë pjesë e dosjes së procedurës së prokurimit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Nga komisioni i hartimit të preventivit të procedurës apo nga projektuesi i veprës për zëerat që nuk përfshihen në manualin teknik do të hartojmë analizat përkatëse të cilat do të jenë pjesë e dosjes së procedurës.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

17-Gjetje nga auditimi: Sistemi i kontrollit të brendshëm i HSH^{së} vlerësohet jo efektiv dhe me mangësi në lidhje me funksionimin e të pese komponentëve që veprojnë së bashku në një mënyrë të integruar, duke ndikuar drejtpërdrejt në mosfunksionimin e plotë të sistemit të kontrollit të brendshëm të kësaj njësie. Nga auditimi rezultoi se “Hekurudha Shqiptare” SHA ka përcaktuar koordinator të menaxhimit të riskut një specialist IT, ndërkohë që koordinator i menaxhimit të riskut duhet të jetë Nëpunësi Autorizues. Grupi Menaxhimit Strategjik nuk kishte të dokumentuar mbledhjet e zhvilluara, të cilat duhet të jenë minimalisht 4 herë në vit, e përcaktuar në UMF nr.16 datë 20.07.2016, pika 2.2.4, “Roli i Grupit të Menaxhimit Strategjik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 203 - 210, të Raporti Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandimi: Nga ana e “Hekurudha Shqiptare” SHA, të merren masa që Grupi Menaxhimit Strategjik të mblidhet minimalisht 4 herë në vit, duke dokumentuar diskutimet dhe vendimet e marra.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Me Urdhërin Nr. 44, datë 25.04.2024 është ngritur GMSMR, i cili duhet të mblidhet cdo dy javë në muaj.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

17.2 Rekomandimi: Nga ana e “Hekurudha Shqiptare” SHA, të merren masa që koordinatori i menaxhimit të riskut të jetë nëpunësi autorizues.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Për sa është rekomanduar, me shkresën nr. 322 Prot., datë 25.04.2024 dhe referuar Urdhërit nr. 44, datë 25.04.2024, ju bëjmë me dije se kryetari i grupit të menaxhimit të riskut është Administratori i Shoqërisë ose nëpunësi autorizues.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

18-Gjetje nga auditimi: “Hekurudha Shqiptare” SHA, për periudhën objekt auditimi nuk ka të hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit, e cila detajon procedurat kryesore dhe siguron që të gjitha operacionet e njësisë publike të dokumentohen në formën që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoritetit mbikëqyrës të kuptojnë mjedisin e kontrollit, veprim jo në përputhje me ligji nr.10296, datë 08.07.2010, ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, Kapitulli II, “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 203 – 210, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Nga ana e “Hekurudha Shqiptare” SHA, Administratori i shoqërisë, të miratojë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoritetit mbikëqyrës të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Hekurudha Shqiptare sh.a në zbatim të SNRF, standarteve ndërkombetare të raportimit financiar, ka krijuar gjurmët e auditit, të cilët kanë përfshire sektorin e prokurimit dhe sektorin e investimeve, në përbërje të NJSHBM, dhe sektorin e finances dhe të zbatimit të projekteve, për ndjekjen e veprimeve sipas kolonave përkates, anagrames së miratuar ne manualin e

menaxhimit të aseteve, të miratuar në janar 2024. Po ashtu, në bashkëpunim me njesinë e shërbimeve të brëndshme mbështese dhe atë ekonomike e të menaxhimit të riskut, njesite e biznesit hekurudhor për menaxhimin e projekteve dhe të infrastruktures kanë krijuar gjurmet e tyre, të cilat janë përfshirë në vlerësimin e SAB, sipas planit të veprimit, të programuar përkatësisht.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës së lidhur me objekt “Punime për mbrojtjen e linjës”, midis BOE “E B” SHPK & “V E” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 984/2 prot., datë 18.11.2019, me afat 90 ditë kalendarike nga dita e dhënies së lejes së sheshit të ndërtimit, me vlerë 21,338,017 lekë me TVSH, rezultoi se kontraktori “E B” SHPK & “V E” SHPK, ka aplikuar për leje për lëvizje në portalin e-Albania, në datën 31 mars 2020, pas daljes së Urdhrit nr.1434 prot., datë 12.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për kufizimin e lëvizjeve të mjeteve të transportit, aplikim pas mbarimit të afatit të kontratës shtesë, 23.03.2020. Punimet kanë vazhduar pa një kontratë e si të tilla, zërat e punimeve të kryera jashtë afateve ligjore, janë zëra punimesh të kryera me vonesë nga kontraktori. Sipas ditarit të objektit zërat e punimeve të kryera jashtë afateve ligjore, janë nga data 07.04.2020 - 17.04.2020 dhe përfshijnë punimet e kryera në segmentin Lushnje – Fier km 75 + 0.50. Vlera e zërave të punimeve, të kryera jashtë afatit të përfundimit të kontratës (12 ditë vonesë), është 1,300,320 lekë. Në këto kushte, Njësia e Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore Durrës, e ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës sipas nenit 2, “Komunikimi dhe përfaqësimi”, pika 2.5 e saj, duhej të njoftonte HSH SHA, për vonesa në kryerje të punimeve, duke u aplikuar në vazhdim, neni 7, “Dëmshpërblimet për vonesat”, i kontratës më nr. 984/2 Prot., datë 18.11.2020, pika 7.1, për 12 ditë vonesë kryerje punimesh me vlerë 1,300,320 lekë, është: $4/1000 * 12 * 1,300,320 = 62,415$ lekë.

-Nga auditimi në terren lidhur me punimet e kryera, u konstatua se jo në përputhje me kontratën e lidhur, nuk është ekzekutuar zëri nr.5, An-9, “Mbushje me zhavorr mbrapa murit”, me vlerë 285,994.8 lekë me TVSH, për segmentin hekurudhor Rrogozhinë-Lushnje, km 74+850 deri km 75+000 dhe km 75+700 deri 75+765, me vlerë të punimeve të pa kryera në shumën **285,995 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 161 -167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 62,415 lekë**, nga kontraktori “E B” SHPK & “V E” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 984/2 prot., datë 18.11.2019.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Rekomandimi i KLSH-s mbi gjetjen e mësipërme është plotësuar pjesërisht. Hekurudha Shqiptare ka kërkuar, ndërmjet shkresës me Nr. 109/ 63 Prot, datë 19.09.2023, në rrugë administrative shpërbllimin e dëmit në vlerën e 62,415 lekë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

1.2 Rekomandimi:

Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **285,995 lekë**, nga kontraktori “E B” SHPK & “V E” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar dhe likuiduar por të pa kryer nga kontraktori sipas kontratës nr. 984/2 Prot., datë 18.11.2019.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Rekomandimi i KLSH-s mbi gjetjen e mësipërme është plotësuar pjesërisht. Hekurudha Shqiptare ka kërkuar, ndërmjet shkresës me Nr. 109/ 63 Prot, datë 19.09.2023, në rrugë administrative shpërbllimin e dëmit në vlerën e 285,994.8 lekë. Krahas sa më sipër ju kërkua Shoqërisë E. B&B” Shpk dhe dokumentacion justifikues, dokument ky i njohur nga ana jonë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *zbatuar pjesërisht*.

2-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës së lidhur me objekt “Rikonstruksioni i Linjës Budull - Gjorëm”, midis kontraktorit “E.” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 52/5 prot., datë 02.07.2021, me afat 3 muaj kalendarikë duke filluar nga data e lidhjes së kontratës (deri në datën 29.09.2021), me vlerë 9,724,178 lekë me TVSH, rezultoi se: me shkresën nr. 1001/2 Prot., datë 19.07.2021 protokolluar pranë “Hekurudha Shqiptare” SHA, është lidhur Akt-Marrëveshje për kryerjen e punimeve ndërtimore pa ndërprerje të trafikut hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve, me qëllimin e ruajtjes së sigurisë së qarkullimit të trenave gjatë kryerjes së punimeve në linjën hekurudhore. Kontrata bazë, (lidhur datë 02.07.2021) ka afatin 3 muaj nga data e nënshkrimit të saj, ndërkohë që Akt-Marrëveshja është lidhur vetëm, për përcaktimin e kohës ditore të punës me qëllim mos ndërprerjen e trafikut hekurudhor. Nga auditimi rezultoi se është ndryshuar afati i ekzekutimit nga 90 ditë kalendarike i përcaktuar në kontratën bazë, në 135 ditë kalendarike. Në vazhdim, është nënshkruar me shkresën nr. 52/21 Prot., datë 04.10.2021, një amendament kontrate, e cila zgjat afatin e kontratës bazë (sipas nenit 4, pika 1 të saj) deri në datën 15.11.2021. Nëse i referohemi nenit 4 të kontratës bazë, rezulton se kontrata bazë fillon në datën e nënshkrimit të saj pra në datën 02.07.2021 dhe përfundon pas 90 ditësh kalendarike ose në datën 29.09.2021. Si rezultat:

1. Kontrata shtesë është nënshkruar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në kontratën bazë e cila e ka humbur fuqinë e saj ligjore në datën 29.09.2021. Kontrata shtesë i referohet një neni të shfuqizuar e si e tillë, është e pavlefshme juridikisht.

2. Argumentimi i cilësuar në kërkesën e mbikëqyrësit të punimeve, drejtuar “Hekurudha Shqiptare” SHA lidhur me mos disponueshmërinë e stafit të një operatori tjetër ekonomik me të cilin bashkëpunon “Eu” SHPK, fitues i procedurës së prokurimit dhe nënshkruar i kontratës, nuk qëndron pasi në procedurën e prokurimit, OE “E.” SHPK, nuk ka dorëzuar gjatë fazës së konkurrimit, nuk ka deklaruar nënkontraktim. Njoftimi për përfundimin e punimeve, është me datë 08.11.2021 dhe punimet kanë përfunduar me vonesë, nga data 29.09.2021, ka tejkaluar afatet e përcaktuara në kontratë me 40 ditë vonesë. Referuar ditarit të objektit në dosjen teknike, me numrin rendor 38 sipas inventarit të dosjes i cili ka 117 fletë, konstatohet se nga data 30.09.2021 deri në datën 08.11.2021, janë ekzekutuar zërat e punimeve në vlerën 720,000 lekë. Në këto kushte, duhej të aplikohesh neni 7, “Dëmshpërbllimet për vonesat”, i kontratës, pika 7.1. Vlera e penalitetit për 40 ditë vonesë që duhet mbajtur nga kontraktori “E.” SHPK për kryerje punimesh me vlerë 720,000 lekë, është: $4/1000 * 40 * 720,000 = 115,200 \text{ lekë}$.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 167 -174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 115,200 lekë**, nga kontraktori “E.” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 52/5 prot., datë 02.07.2021.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Rekomandimi i KLSH-s mbi gjetjen e mësipërme është plotësuar pjesërisht. Hekurudha Shqiptare ka kërkuar, ndërmjet shkresës me Nr. 109/ 64 Prot, datë 19.09.2023, në rrugë administrative shpërblimin e dëmit në vlerën 115,200 lekë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *zbatuar pjesërisht*.

3-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren për punimet e kryera, sipas kontratës midis “Eu” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, nr. 52/5 Prot., datë 02.07.2021 dhe objekt “Rikonstrukcioni i Linjës Budull-Gjorëm”, u konstatuan diferenca në zëra punimesh të pa ekzekutuara, por të situacionuara dhe faturuara. Punimet kanë filluar në Km 38+050 deri tek ura mbi kanalin vaditës. Për një gjatësi prej 70 m, ose mbi të gjithë gjatësinë e urës, nuk është kryer asnjë punim. Pjesa e shinave mbi urë është tejet e amortizuar dhe e pa kalueshme pasi ka dëmtime të shumta dhe çarje të urës. Janë vendosur 672 copë traversa betoni. Traversat e betonit janë me dimensione (26*16*240) cm dhe e shprehur në vëllim, një traverse është afro 0.11 m³. Për 672 traversa, vëllimi total i traversave të montuara është: 672 copë * 0.11 m³ = 73 m³ dhe jo 672 m³ sa është deklaruar në situacionin përfundimtar dhe librezën e masave. Në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 3575 orë pune për vendosjen e 672 m³ traversa betoni. Në fakt janë vendosur 73 m³ traversa betoni dhe respektivisht për këtë vëllim, nevojiten (73*3575)/672=388 orë pune. Vlera totale e punimeve të pa kryera është **6,362,304 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 167 -174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 6,362,304 lekë**, nga kontraktori “E.” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer nga kontraktori, sipas kontratës nr. 52/5 prot., datë 02.07.2021.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Rekomandimi i KLSH-s mbi gjetjen e mësipërme është plotësuar pjesërisht. Hekurudha Shqiptare ka kërkuar, ndërmjet shkresës me Nr. 109/ 64 Prot, datë 19.09.2023, në rrugë administrative shpërblimin e dëmit në vlerën 6,362,304 lekë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *zbatuar pjesërisht*.

4-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të lidhur me objekt “Rikonstrukcioni i linjës hekurudhore Shkozet-Kavajë”, midis “E.” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021, me afat 3 muaj kalendarik nga dita e nënshkrimit të kontratës midis palëve, me vlerë 8,879,149.92 lekë me TVSH, rezultoi se: nuk u konstatua asnjë dokument apo argument lidhur me vonesën për rifillimin e punimeve nga data që ARRSH ka dhënë lejen për të kryer punimet pra nga data 06.12.2021 sipas shkresës me nr. 9672/2 Prot., datë 06.12.2021 deri në datën që kontraktori ka njoftuar “Hekurudha

Shqiptare” SHA për rifillimin e punimeve pra në datën 15.12.2021. Kjo vonesë prej 9 ditësh, nuk është e justifikuar as nga kontraktori dhe as nga “Hekurudha Shqiptare” SHA. Referuar edhe ditarit të punimeve, punimet janë pezulluar në datën 28.10.2021 dhe kanë rifilluar në datën 15.12.2021. Kjo vonesë prej 9 ditësh është rikuperuar nga OE pasi ka përfunduar punimet 5 ditë përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në amendamentin e dytë. Referuar nenit 7 të kontratës bazë me nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021, “Dëmshpërblimet për vonesat”, HSH SHA duhej të kalkulonte penalitetin për 4 ditë vonesë të vlerës së punimeve të kryera për 494,854.2 lekë, që korrespondon me vlerën e punimeve të kryera jashtë afateve të përcaktuara në kontratë, penaliteti i cili është: $4/1000 * 4 * 494,854.2 = 7917.7$ lekë. Meqenëse kjo vlerë është më pak se 25% e vlerës së kontratës të mbetur pa u zbatuar, atëherë aplikohet formula: $25% * 494,854.2$ lekë = 123,713.55 lekë në dëm të “Hekurudha Shqiptare” SHA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 176 -181 të Raportit të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 123,714 lekë**, nga kontraktori “Eu” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 73/7 Prot., datë 30.06.2021.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Rekomandimi i KLSH-s mbi gjetjen e mësipërme është plotësuar pjesërisht. Hekurudha Shqiptare ka kërkuar, ndërmjet shkresës me Nr. 109/ 64 Prot, datë 19.09.2023, në rrugë administrative shpërblimin e dëmit në vlerën 123,714 lekë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *zbatuar pjesërisht*.

5-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të lidhur me objekt “Riparime vepra arti”, midis “R G” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021, me afat 45 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës midis palëve dhe me vlerë 9,231,016 lekë me TVSH, rezultoi se: punimet (duke marrë në konsideratë vonesat për shkak të përmbytjeve të lumit Kir) duhej të përfundonin në datën 29.05.2022 dhe jo në 04.07.2022. Referuar edhe ditarit të punimeve, punimet janë pezulluar në datën 20.12.2021 dhe kanë rifilluar në datën 23.05.2022. Punimet kanë përfunduar me 35 ditë vonesë. Referuar nenit 7, të kontratës bazë, me nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021, “Dëmshpërblimet për vonesat”, “Hekurudha Shqiptare” SHA duhej të kalkulonte penalitetin për 35 ditë vonesë, kryerje punimesh, e cila është: $4/1000 * 35 * 9,231,016 = 1,292,342$ lekë. Meqenëse kjo vlerë është më pak se 25% e vlerës totale, atëherë aplikohet formula $25% * 9,231,016 = 2,307,754$ lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 181 -184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Nga Hekurudha Shqiptare SHA, Durrës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 2,307,754 lekë**, nga kontraktori “R G” SHPK, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratën nr. 74/5 Prot., datë 11.11.2021.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit: Rekomandimi i KLSH-s mbi gjetjen e mësipërme është plotësuar pjesërisht. Hekurudha Shqiptare ka kërkuar, ndërmjet shkresës me Nr. 109/ 64 Prot, datë 19.09.2023, në rrugë administrative shpërblimin e dëmit në vlerën 2,307,754 lekë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *zbatuar pjesërisht*.

6-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës të lidhur me objekt “Riparim vepra arti (mbrojtja e urës hekurudhore të Rrogozhinës)” midis kontraktorit “M LTD” SHPK & “V K” SHPK & “E K” SHPK & “N G” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr.110/4 Prot., datë 03.11.2022, me afat 45 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit nga AK të kontratës dhe vlerë 37,799,726.4 lekë me TVSH, nga auditimi në terren për verifikimin e zbatimit të punimeve grupi i auditimit konstatoi, se kishte diferenca në zëra punimesh. “Prerje bimë të vogla Ø 10 cm”. Në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 2,450 m² sipërfaqe e pastruar. Nga verifikimi në terren, u konstatua se ky zë punimesh nuk është. Për zërin “Shkulje/Këputje pilash ekzistuese druri të vjetra”, në situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 125 copë pilash të shkulura. Nga verifikimi në terren, u konstatua se ky zë punimesh nuk është ekzekutuar. Për zërin “Rrafshim i skarpatës për ndërtim argjinate”, në librezën e masave e situacionin përfundimtar, janë pasqyruar 1,405 m² sipërfaqe e rrafshuar. Nga verifikimi në terren, u konstatua se ky zë punimesh nuk është ekzekutuar. Sa më sipër, vlera në total e punimeve të pakryera është **1,528,170 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 194 -200 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Nga “Hekurudha Shqiptare” SHA, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 1,528,170 lekë**, nga kontraktori “M LTD” SHPK & “V K” SHPK & “E K” SHPK & “N G” SHPK, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer nga kontraktori, bazuar në kontratën nr.110/4 Prot., datë 03.11.2022.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Rekomandimi i KLSH mbi gjetjen e mësipërme është plotësuar pjesërisht. Hekurudha Shqiptare ka kërkuar, ndërmjet shkresës me Nr. 109/ 64 Prot, datë 19.09.2023, në rrugë administrative shpërblimin e dëmit në vlerën 1,528,170 lekë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *zbatuar pjesërisht*.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës së lidhur midis OE “Z” SHPK dhe “Hekurudha Shqiptare” SHA, me nr.501/2 Prot., datë 24.06.2019, me objekt “Rinovim agregatesh për lokomotiva”, me vlerë 11,208,000 lekë me TVSH, me afat 60 ditë kalendarike, me datë përfundimi 22.08.2019, rezultoi se: në dosjen e zbatimit të kontratës nuk u gjet fletë-dalje dhe as akt-dorëzimi të agregateve nga NJSHML tek kontraktori “Z” SHPK. Në dosje gjendet një fletë-hyrje me nr.02 dhe datë 11.10.2019. Tek kjo fletë-hyrje, nuk janë Takografët por vetëm agregatet ashtu siç përshkruhen në deklaratat doganore. Referuar kontratës së lidhur, neni 3, pika 3.1, në fillim, përpara se agregatet e rinovuar, ti dorëzoheshin “Hekurudha Shqiptare” SHA, NJSHML duhej të dokumentonte veprimin e dorëzimit të agregateve tek OE. Në dosjen teknike të dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk u gjet relacioni teknik i mbajtur nga nëpunësit përkatës të “Hekurudha Shqiptare” SHA sipas detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara në Rregullore. NJSHML nuk ka ndjekur procedurat ligjore për menaxhimin me korrektësi të aktiveve duke mos dokumentuar me saktësi lëvizjen e tyre, pasi nuk ka mbajtur procesverbal lidhur me arsyet e klasifikimit të agregateve si agregate me probleme ose agregate

me defekte. Nuk u konstatua asnjë fletë-dalje nga magazina e NJSHML-së (edhe pse në fakt agregatët janë dërguar për riparim) për çdo aktiv (agregat) ku të nënshkruhej edhe nga kontraktuesi dhe të vërtetohej se aktivet janë bërë dalje nga “Hekurudha Shqiptare” SHA dhe janë transportuar me mjetin përkatës nga kontraktori. Procedura e prokurimit ka mangësi lidhur me nevojat për riparimin e lokomotivave që kanë pasur defekt. NJSHML, nuk ka kryer procedurat e duhura ligjore për marrjen në dorëzim të shërbimeve duke vepruar në kundërshtim me kontratën, nenin 7 “Inspektimet dhe Testimet”, pika 7.2 e këtij neni, ku cilësohet se: “Autoriteti Kontraktor (NJSHML në rastin konkret si përfaqësues i AK konform pikës 7.1 të po këtij neni) do të kryejë për agregatet e rinovuar, provat në lokomotiva”. Sa më sipër, vlera e investuar prej **11,208,000 lekë**, përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 181 -221 të Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive të Strukturave Drejtuese, lidhur me kryerjen e procedurave të prokurimit pa argumentuar më parë nevojat reale të shoqërisë duke sjellë pasoja negative financiare për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit: Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës nuk janë marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive të Strukturave Drejtuese, lidhur me kryerjen e procedurave të prokurimit pa argumentuar më parë nevojat reale të shoqërisë duke sjellë pasoja negative financiare për buxhetin e shtetit.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

1.2 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të shoqërisë, të marrin masa që në të ardhmen, përpara zhvillimit të një procedure prokurimi, të argumentohet dhe dokumentohet nevoja reale që ka institucioni dhe në vijim të kryhet prokurimi për mallra, shërbime apo punime, konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

2- Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, si rezultat i largimeve nga puna pa shkaqe të arsyeshme, “Hekurudha Shqiptare” SHA, është penalizuar me vlerën prej 2,371,590 lekë. Pavarësisht ndjekjes në të gjitha shkallët e gjykimit dhe kontestimeve nga HSH SHA të vendimeve të gjykatave, për dëmshpërblimet si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës konstatohet se vendimet në shumicën e rasteve janë në favor të punonjësve të larguar. Në vitin 2022, janë marrë 4 vendime të formës së prerë me vlerë totale dëmshpërblimi për punonjësit e larguar padrejtësisht në **2,371,590 lekë**, vlerë e cila përbën efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit dhe në të ardhmen shkakton rëndim të situatës financiare duke cenuar zhvillimin normal të aktivitetit ekonomik-financiar të “Hekurudha Shqiptare” SHA, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 101 -113, të Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive lidhur me largimet e padrejta nga puna të punonjësve nga Strukturat Drejtuese.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës nuk janë marrë masat për nxjerrjen e përgjegjësive lidhur me largimet e padrejta nga puna të punonjësve.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

2.2 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të shoqërisë dhe Dega e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për rekrutimin e punonjësve bazuar në kërkesat e vendit të punës, me qëllim shmangien e efekteve negative financiare që shkaktohen nga dëmshpërblimi si pasojë e vendimeve gjyqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Hekurudha Shqiptare, me anë të Urdhërit Nr. 40, datë 22.05.2023, ka ezauruar tërësisht rekomandimin e lënë nga KLSH.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

3.1 Rekomandimi: Nisur nga gjendja e rëndë financiare dhe situata përpara ndarjes së shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” SHA, “Hekurudha Shqiptare” SHA në bashkëpunim me MFE në cilësinë e aksionarit të vetëm dhe që ka shlyer detyrimet e kësaj kredie që nga viti 2008, të marrin masat e duhura për sistemimin e detyrimit nga pasqyrat financiare të HSH sha ne likuiduesin e kësaj kredie.

Përgjigjja e institucionit:

Konfirmohet ndërmjet shkresave rakorduese. Kjo llogari detyrimi është e veçantë në llogaritë kontabël dhe mban numrin 4672/ 1 në pasqyrat financiare të Hekurudha Shqiptare.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

4- Gjetje nga auditimi: “Hekurudha Shqiptare” SHA, për vitet periudhën objekt auditimi, ka paguar gjoba në lidhje me kryerjen me vonesë të pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pagesa përmbarues privat detyrime të cilat kanë lindur si rrjedhojë e mos likuidimit në afatet e përcaktuara në kontratat e lidhura me sipërmarrësit, pagesa tatimi në burim etj. Për periudhën e auditimit, shuma e paguar nga ana e Shoqërisë është **30,787,598 lekë** shumë e cila është efekt financiar negativ për buxhetin e shoqërisë. Shoqëria nëpërmjet subvencioneve të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë (MFE), ka likuiduar detyrimet fiskale të ndryshme, likuidime të tjera të kërkuara nga zyrat përmbarimore, si shkak mos likuidim në kohë të kontratave të ndryshme. Sa trajtuar është jo në përputhje me “Kodi i procedurës civile” , i ndryshuar; Ligji i Prokurimit Publik nr. 162, datë 23.12.2020, RRPP nr.285 datë 19.05.2021, i ndryshuar “Zbatimi i detyrimeve të Kontratave”; ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji nr.10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4/a, faqe 68 – 75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: “Hekurudha Shqiptare” SHA, të marrë masat e nevojshme që në ta ardhmen të eliminojë efektet financiare negative. Shoqëria duhet të marrë në konsideratë që mos shlyerja në kohë e detyrimeve të ndryshme ndaj punonjësve si (derdhja e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat personale etj.) si dhe zgjidhja e kontratave me të tretët në gjykatë do të rëndonte akoma më shumë financat e shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Njësia Ekonomike ka likuaduar të gjitha detyrimet fiskale ndaj institucioneve tatimore dhe aktualisht detyrimi është zero lekë. Për sa i përket efekteve për zgjidhjen e kontratave, nuk varet nga Njësia Ekonomike, pasi roli i kësaj të fundit është zbatues dhe jo vendimarrës për efektete që prodhon një marrëdhënie kontraktore.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

D. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, kontratat individuale të punës, kërkojmë nga Administratori i “Hekurudha Shqiptare” SHA, referuar gjetjeve të auditimit, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe në varësi të tyre të japë masat disiplinore për ata punonjës që atakohen në këtë Raport Auditimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në mungesë të dokumentacionit justifikues mbështetës për të verifikuar me siguri të arsyeshme statusin e zbatimit të rekomandimit, konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit kryer prej grupit të auditimit të KLSH-së rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a) 18 Masa organizative nga ku 19 rekomandime, janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 7 zbatuar, 10 pjesërisht zbatuar dhe 2 pa zbatuar ;
- b) 7 Masa shpërblim dëmi në vlerën 10,785,552 lekë nga ku 7 rekomandime dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit 7 pjesërisht zbatuar.
- c) 4 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike nga ku 6 rekomandime, janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 2 zbatuar, 2 pjesërisht zbatuar dhe 2 pa zbatuar;
- d) 1 Masë Disiplinore nga ku 1 rekomandim, është pranuar plotësisht dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit 1 pazbatuar ;

Për sa më sipër ri kërkojmë që, Hekurudha Shqiptare Sh. A të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar, brenda 3 mujorit të parë të vitit 2025 si dhe kërkojmë analizimin dhe

marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.9 POSTA SHQIPTARE SHA

PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Posta Shqiptare Sh.A** mbi “*Zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023*” për auditimin e kryer në vitin 2023, për periudhën objekt auditimi 01.06.2019 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr. 406/13 prot., datë 29.12.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
 - a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
 - b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
 - c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve;
 - ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe manualit “*Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve*”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 792/1 prot., datë 01.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A. K, (*Përgjegjës grupi*)
2. J.M

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr. 406/13 Prot., datë 29.12.2023 së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Posta Shqiptare Sh.A në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr. 406/13 Prot., datë 29.12.2023, rezulton se, nga **52** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi, 3-E dhe Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **51** masa të rekomanduara ose 98 %. **Nga të pranuarat (51):** janë zbatuar plotësisht **29**, ose 57 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht **17** masa ose 34 % dhe pa zbatuar **5** masa ose 9 % e tyre.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit		
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
1	Organizative	29 masa	18 masa	9 masa	2 masa
2	Shpërblim dëmi	6 masa 2,145,410 lekë	2 masa 458,663 lekë	4 masa 1.686,747 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	15 masa 216,820,630 Lekë / 9,579 Euro	9 masa 39,160,330 lekë / 9,579 Euro	3 masa 146,009,900 lekë	3 masa 31,650,400 lekë
4	Masa Disiplinore	1 masë	-	1 masë	-
	<i>Gjithsej</i>	<i>51 masa 216,820,630 lekë / 9,579 Euro</i>	<i>29 masa 39,618,993 lekë / 9,579 Euro</i>	<i>17 masa 147,170,431 +526,216 147,696,647lekë</i>	<i>5 masa 31,650,400 lekë</i>

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve që mbajnë statusin zbatuar plotësisht është 29 %, niveli i rekomandimeve zbatuar pjesërisht është në masën 34 % dhe pazbatuar në masën 9%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1- Hartim i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Posta Shqiptare SHA, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën Nr. 909/65 Prot., datë 11.08.2023.

III/2- Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e Posta Shqiptare SHA nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për

rekomandimet e realizuara plotësisht dhe pjesërisht, si dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me Auditin e Brendshëm rezulton se për periudhën objekt auditimi, konkretisht në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nuk janë realizuar plotësisht auditimet e parashikuara në planet vjetore të miratuara nga ana e Titullarëve. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 6, pika a.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 30 – 33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm, të marrë masa për të përmbushur planet e auditimeve në subjektet e parashikuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtori i Auditit të Brendshëm ka hartuar relacionin me Nr. 137/B Prot., datë 14.06.2024 dhe është përmbushur plani i plotë i auditimeve për vitin 2023.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin rezulton se Posta Shqiptare SHA nuk ka të miratuar planin për zhvillimin e strategjisë të cilën Titullari i njësisë publike miraton dhe monitoron. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 mbi “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit” dhe neni 21 “Menaxhimi i riskut”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 30 – 33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Administratorit të Shoqërisë të merren masa për të ngritur një plan për zhvillimin e strategjisë, duke zbatuar kërkesat e parashikuara nga ligji si dhe duke kryer procedurat hap pas hapi konform kuadrit përkatës ligjor e rregullator.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Administratori i Posta Shqiptare SHA me anë Urdhrit të brendshëm Nr.51 Datë 24.06.2024 ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për hartimin e një plani strategjik dhe biznesi të zhvillimit të Postës Shqiptare për vitet 2024-2029.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin rezulton se Posta Shqiptare SHA nuk ka zhvilluar dhe rifreskuar në portalin e saj informacionin e rrjetit postar për vendndodhjen e zyrave postare. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Neni 3 “E drejta e informimit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 30– 33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoritë përkatëse të marrin masa për azhurnimin e faqes web në lidhje me vendndodhjet e pikave postare të vendosura në zona të ndryshme.

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të këtij rekomandimi me shkresën nr. 172/B datë 29.07.2024, Drejtoria e Marketingut në kordinim me Drejtorinë e Shërbimit Postar dhe Drejtorinë e IT, kanë marrë masat e nevojshme për verifikimin e adresave dhe kordinatave gjeografike me qëllim përditësimin e tyre në faqen Web të Postës Shqiptare.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

4. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me Programet ekonomiko-financiare rezulton se:

- a. *Shoqëria Posta Shqiptare nuk ka hartuar plane afat mesme apo afat gjatë të zhvillimit strategjik të saj;*
- b. *Shoqëria Posta Shqiptare nuk ka hartuar dhe miratuar plan biznesin afatmesëm të shoqërisë.*
- c. *Si rezultat i mungesës së dokumenteve dhe planeve strategjike shoqëria Posta Shqiptare nuk ka përcaktuar objektiva të qarta të zhvillimit, të cilat do të shërbenin si objektiva të matshme për vlerësimin e performancës së drejtimit të shoqërisë dhe në përmirësimin e performancës së shoqërisë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” të Ministrisë të Financës dhe Ekonomisë si dhe Statutin e Postës Shqiptare, të ndryshuar.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 34 – 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të fillojë hartimin dhe miratimin e planit të biznesit dhe dokumentet e tjerë strategjik të zhvillimit ekonomik afat mesëm dhe afat gjatë të shoqërisë.

Përgjigja e institucionit:

Administratori i Posta Shqiptare SHA me anë Urdhrit të brendshëm Nr.51 datë 24.06.2024 ka ngritur grupin e punës për hartimin e një plani strategjik dhe biznesi të zhvillimit të Postës Shqiptare për vitet 2024-2029.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

5. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi mbi Hartimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar si dhe miratimi tyre në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet e prore, rezulton se niveli i realizimit të investimeve të vitit 2019 është i ulët dhe zë 36% kundrejt programit, megjithëse investimet janë dyfishuar në vitin 2019 kundrejt vitit 2018, shkalla e realizimit të tyre ngelet e ulët pasi dhe në vitin 2018 shoqëria ka realizuar 45% të vlerës së investimit të programuara. Nga auditimi rezulton se, përtej parashikimeve optimiste të menaxhimit të lartë të shoqërisë, për të patur një fitim neto 6.6 milion lekë, si rezultat i rritjes së shpenzimeve, rënies të disa kategorive të të ardhurave dhe mungesa e një menaxhimi efektiv dhe planifikimi të mirë nga ana e drejtuesve të shoqërisë Posta Shqiptare, kanë sjellë që shoqëria në fund të vitit 2019 të rezultojë me humbje në vlerën 188,035,447.6 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 34 – 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësi për realizimin e ulët të të ardhurave ndër vite dhe të bëjë kujdes në vijimësi në lidhje me miratimin e shpenzimeve, për të mundësuar një mbulim të shpenzimeve nga të ardhurat, që shoqëria në fund të vitit ushtrimor të rezultojë me fitim.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Këshilli Mbikëqyrës, me Vendimin Nr.10., datë 31.05.2024., ka vendosur që nga ana e Administratorit të Shoqërisë dhe strukturave përgjegjëse të kryhet një analizë ekonomike juridike për të gjitha procedurat e konstatuara nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit të cilat kanë sjellë pasoja dhe efekte negative për Shoqërinë.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht i zbatuar***.

6. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratat e qirave rezultojnë se:

- Për praktikën e qiramarrjes mes Posta Shqiptare Filiali Tiranë dhe znj. E A, mungonte certifikata e pronësisë për kontratën e lidhur me UKT dhe as me OSHEE, në kundërshtim me kriteret e vendosura sipas Urdhrit të brendshëm nr. 39/1 datë 23.09.2019.

- Për praktikën e qiramarrjes mes Posta Shqiptare Filiali Sarandë dhe znj. S M dhe z. M M, mungon kontrata e lidhur me UK Sarandë dhe OSHEE, në kundërshtim me kriteret e vendosura sipas Urdhrit të brendshëm nr. 185 prot datë 14.02.2019.

- Për praktikën e qiramarrjes mes Posta Shqiptare Filiali Durrës dhe z. V M, mungon certifikata e pronësisë për ambientin e marrë me qira nga Posta Shqiptare SHA, në kundërshtim me kriteret e vendosura sipas Urdhrit të brendshëm nr. 7 datë 17.05.2021. Gjithashtu është konstatuar se Drejtoresha për Postën Shqiptare Filiali Durrës znj. E B ka pranuar kërkesën e z. V M për rritjen e pagesës së qirasë nga 20,000 lekë në 29,500 lekë pa kryer përsëri procedurën ligjore për marrjen e ambientit me qira, veprime këto në kundërshtim me nenin 821 i Kodit Civil i cili përcakton saktë se *Përsëritja e kontratës së qirasë rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshme* si dhe me vet Urdhrit të Titullari nr. 7 prot., datë 17.05.2021;

- Disa zyra postare të marra me qira në Tiranë kanë distanca të afërta me njëra tjetrën. duke sjellë tejkalim të nevojave të qytetarëve në këto zona për të përdorur shërbimet e postës. Këto zyra postare që janë marrë me qira nga Posta Shqiptare rezultojnë të kenë një bilanc negativ në kundërshtim me nenin 8, pika 1 dhe neni 12 pika 3, germa a e ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

- Në të gjitha kontratat e qirave rezultojnë se sipërfaqja e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të zyrave postare, nuk është përlllogaritur duke pasur në konsideratë numrin e punonjësve të zyrave, në kundërshtim me neni 8, pika 1 dhe neni 12 pika 3, germa a e ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* si dhe germa a, pika 2 për mjedisin, Shtojca e VKM nr. 521, datë 06.08.2014 *“Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës”*. Gjithashtu rezultojnë se nuk janë kërkuar kriteret e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës në kundërshtim me VKM nr. 564, datë 3.7.2013 *“Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe*

shëndetit në vendin e punës” si dhe me nenin 37 të ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

- Nga Posta Shqiptare nuk janë ngritur grupe pune për marrjen në dorëzim të ambienteve të mara me qira sipas kontratat në përputhje me kërkesat e Postës Shqiptare ndaj objekteve. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe me VKM nr. 564, datë 3.7.2013 “Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”.

- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratat e qirave rezulton se Posta Shqiptare nuk ka përdorur ligjin e posaçëm për dhënien me qira të objekteve. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 34 – 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për kualifikimin e ofertuesve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim gëzimin e qetë të periudhës së qirasë dhe përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A, në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për të gjitha kërkesat e reja për marrje ambjenti me qera, ka udhëzuar Filialet që të procedojnë në zbatim të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, bashkëlidhur kthim përgjigje Filialit Tiranë Nr.1413/1.prot., datë 19.07.2024. Për periudhën Janar – Qershor 2024, nga ana e institucionit ende nuk kemi kontrata të reja për ambiente me qera.

Rast pas rasti kontratat e reja do të shoqërohen me Urdhër nga ana e Posta Shqiptare për grupin e marrjes në dorëzim të objekteve si dhe zbatimin e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës në zbatim të VKM nr. 564, datë 3.7.2013 “Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës” si dhe me nenin 37 të ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Posta Shqiptare në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përdorur ligjin e posaçëm për dhënien me qira të objekteve, në zbatim të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, bashkëlidhur relacioni Nr.1228/1.prot., datë 28.05.2024, me lëndë “Relacion mbi autorizimin e dhënies me qira te ambientit bar-mence, me sipërfaqe 66.1 m2, në katin e parë të godinës së drejtorisë së përgjithshme.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

6.2 Rekomandimi: Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për plotësimin e dosjes së ofertuesve E A, znj. S M dhe z. M M dhe z. V M me dokumentacionin e nevojshëm sipas parashikimeve të kuadrit ligjor e rregullator. Në rast të mosplotësimin, nga ana e Posta Shqiptare SHA të bëhet ndërprerja e kontratës së qirasë.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Filiali i Postës Shqiptare sh.a., Tiranë me anë të shkresës Nr.332/2 prot., datë 18.04.2024 ka bërë njoftimin për ndërprejen e kontratës së qirasë me znj. E A.

Me shkresën Nr.909/141 datë 28.06.2024 është kërkuar nga Posta Shqiptare plotësimi i saktë i dokumentacionit për ofertuesin z. V M. Për ofertuesit znj. S M dhe z. M M është ndërprerë kontrata e qirasë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

6.3 Rekomandimi: Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për të përdorur ligjin e posaçëm për dhënien me qira të objekteve të pasurisë shtetërore.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përdorur ligjin e posaçëm për dhënien me qira të objekteve, në zbatim të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, bashkëlidhur relacioni Nr.1228/1.prot., date 28.05.2024, me lëndë “Relacion mbi autorizimin e dhënies me qira te ambientit bar-mencë, me sipërfaqe 66.1 m2, në katin e parë të godinës së drejtorisë së përgjithshme, bashkëlidhur Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës Nr.9., datë 31.05.2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

7. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara, konkretisht referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE fitues rezulton:

- Në 1 rast, në procedurat me objekt *Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër* BOE nuk plotëson kriterin në lidhje me disponimit e stafit mesatar për periudhën janar – nëntor 2019 sipër përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit me nr. 92 rep., 23 kol., datë 17.01.2020. Përveç sa më sipër rezulton se nga ana e BOE nuk janë dorëzuar analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar.

- Në procedurën e prokurimit me objekt *“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”* viti 2019 rezulton se nga mjetet e ofertuara nga ana e OE M M, ai i modelit Furgonçinë është i markës FIAT modeli Fiat Doblo dhe të dhënat e këtij mjeti, çmimi njësi i të cilit ka shërbyer si referencë për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit nuk janë sipas kërkesave të bëra nga Grupi i Punës sipas aktit nr. 381/1 prot., datë 20.02.2019. Në mënyrë të ngjashme rezulton se edhe për mjetet e ofruara nga ana e dy OE të tjerë A M dhe A S, çmimet njësi të të cilëve kanë shërbyer si referencë për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit nuk janë sipas kërkesave të bëra nga Grupi i Punës sipas aktit nr. 381/1 prot., datë 20.02.2019.

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, neni 53, “Shqyrtimi i Ofertave”, pika 3 dhe 5 germa c, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 59, pika 2, neni 66 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 2, VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Vendim nr. 664, datë 26.9.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave ‘Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit’”, pika 10 dhe pika 11 si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë aksionare Posta Shqiptare të merren masa për të kualifikuar operatorët të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura në DST. Gjithashtu në përlogaritjen e fondit limit të kihen parasysh ofertat e marra për mallra/shërbime/punime sipas atyre të kërkuara nga AK me qëllim sigurimin e mirë përdorimit të fondeve dhe transparencës në drejtim të planifikimit të vlerës së investimeve.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka proceduar duke bërë kualifikimin e ofertave të rregullta të cilat përmbushin kërkesat sipas dokumenteve standarte të tenderit në procedurat e zhvilluara në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, gjithashtu duke përmbushur edhe detyrimet ligjore në zbatim të Vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik. Konkretisht në procedurën me REF-84242-1018-2023, me objekt “Blerje letër fotokopje A4, letër fotokopje A3, në procedurë kanë marrë pjesë 3 Operator ekonomik, nga shqyrtimi i dokumentacionit është bërë kualifikimi i ofertave të vlefshme dhe nga ana e Operatorëve ekonomik pjesëmarrës në garë nuk ka patur ankesa sipas parashikimeve ligjore. Gjithashtu gjatë fazës që procedurat janë të publikuara në SPE, i kushtohet vëmendje kërkesave për sqarim (nëse ka), dhe rast pas rasti nga ana e AK reflektohen në DST me shtojcat përkatëse brenda afateve ligjore.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

8. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara, konkretisht referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE fitues rezulton, në 1 rast, në procedurat me objekt *Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë* BOE nuk plotëson kriterin në lidhje me disponimit e stafit mesatar për periudhën janar – nëntor 2019 sipër përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit me nr. 92 rep., 23 kol., datë 17.01.2020. Konkretisht sipas kësaj marrëveshjeje punimet janë ndarë në raportin 69.38 % OE A dhe 30.62 % OE B. Nisur nga fakti që numri total i punonjësve të kërkuar është 90, atëherë nga ana e këtyre dy OE duhet të ishin sjellë respektivisht dëshmi për disponimin e respektivisht 63 dhe 27 të punësuar. Në fakt nga ana e OE A janë paraqitur listë pagesat mujore janar 2019 – nëntor 2019 me një numër mesatar prej 61 të punësuarish. Gjithashtu, nga ana e OE B, edhe pse janë marrë përsipër 30.62 %, nuk janë sjellë dëshmi për disponimin e një inxhinieri elektrik si dhe një arkitekti si pjesë e licencës së shoqërisë. Përveç sa më sipër rezulton se nga ana e BOE nuk janë dorëzuar analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, neni 53, “Shqyrtimi i Ofertave”, pika 3 dhe 5 germa c, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 66 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 2, VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Vendim nr. 664, datë 26.9.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave ‘Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit’”, pika 10 dhe pika 11 si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë aksionare Posta Shqiptare të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka proceduar duke bërë kualifikimin e ofertave të rregullta të cilat përmbushin kërkesat sipas dokumenteve standarte të tenderit në procedurat e zhvilluara në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, gjithashtu duke përmbushur edhe detyrimet ligjore në zbatim të Vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik. Konkretisht në procedurën me REF-84242-1018-2023, me objekt “Blerje letër fotokopje A4, letër fotokopje A3, në procedurë kanë marrë pjesë 3 Operator ekonomik, nga shqyrtimi i dokumentacionit është bërë kualifikimi i ofertave të vlefshme dhe nga ana e Operatoreve ekonomik pjesmarrës në garë nuk ka pasur ankesa sipas parashikimeve ligjore. Gjithashtu gjatë fazës që procedurat janë të publikuara në SPE, i kushtohet vëmendje kërkesave për sqarim (nëse ka), dhe rast pas rati nga ana e AK reflektohen në DST me shtojcat përkatëse brenda afateve ligjore.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

9. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite” viti 2019 rezulton se nga mjetet e ofertuara nga ana e OE M M, ai i modelit Furgonçinë është i markës FIAT modeli Fiat Doblo dhe të dhënat e këtij mjeti, çmimi njësi i të cilit ka shërbyer si referencë për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit nuk janë sipas kërkesave të bëra nga Grupi i Punës sipas aktit nr. 381/1 prot., datë 20.02.2019. Konkretisht është kërkuar që konsumi i kombinuar është kërkuar të jetë 4.5 l/100 km në një kohë që mjeti Fiat Doblo ka një konsum prej 5.5 l/100 km, mjeti nuk dëshmon për disponimin e opsionit Hill Assist, komanda në timon, sistem start – stop, fuqia motorike është nën nivelin e kërkuar, etj. Në mënyrë të ngjashme rezulton se edhe për mjetet e ofruara nga ana e dy OE të tjerë A M dhe A S, çmimet njësi të të cilëve kanë shërbyer si referencë për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit nuk janë sipas kërkesave të bëra nga Grupi i Punës sipas aktit nr. 381/1 prot., datë 20.02.2019. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa b dhe dh, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 59, pika 2 si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Nga ana e grupeve të ngritura për përlllogaritjen e fondit limit të ezaurohen të gjitha hapat e duhur e të nevojshëm me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike përmes marrjes së ofertave për mallra/shërbime/punime sipas atyre të kërkuara nga AK me qëllim sigurimin e mirë përdorimit të fondeve dhe transparencës në drejtim të planifikimit të vlerës së investimeve.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas Urdhrave të nxjerrë për studimin e tregut për përcaktimin e vlerës për fondin limit, ezaurohen të gjitha format e parashikuara në V.K.M, duke ju drejtuar INSTAT, kërkesave për ofertë në tregun e lirë operatorëve ekonomik, kontratat e mëparshme si dhe informacion nga Drejtoria e Doganave. Konkretisht nga studimi i tregut ka rezultuar në uljen e fondit krahasuar me parashikimin, me objekte “Blerje Kasaforta” dhe “Blerje Karburant për Automjete”.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

10. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite” viti 2019 rezulton se specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur sipas shkresës nr. 381 prot., datë 08.02.2019 me përbërje të grupit z. G P, z. B Sh dhe znj. E S janë të paargumentuara teknikisht dhe ligjërish. Në lidhje me këto specifikime, përveç sa më sipër, nuk argumentohet domosdoshmëria e përdorimit të sistemit GPS i cili, sipas citimit të Grupit të Punës është parashikuar të përdoret vetëm për Motoçikletat dhe Furgonçinat dhe jo për Autoveturën. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, neni 20 “Mosdiskriminimi”, neni 23 “Specifikimet teknike”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 28 “Kontratat e Shërbimeve”, si dhe me Rregullore e Brendshme e Punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve të argumentuara teknikisht dhe ligjërish si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për cdo kriter të vendosur ose specifikime teknike, nga anëtarët e grupeve të punës mbahet procesverbali me argumentimin ligjor dhe teknik, konkretisht bashkëlidhur dokumentacioni për 2 procedura të zhvilluara nga Posta Shqiptare në cilësinë e AK. Konkretisht procedura “Blerje pajisje sigurie” e vitit 2024 dhe “Rikonstruksion i zyrës postare Tirana 5, Zyra Postare Qendër Durrës” procedurave të cilave i është mbajtur procesverbali me argumentimin ligjor dhe teknik.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

11. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e zbatimit të kontratave me objekte si më poshtë rezulton se:

1. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastër, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti I: Rikonstruksion i Zyrave Postare të Filialeve Gjirokastër, Sarandë: Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R me përfaqësuese ligjore znj. R N; Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria R me përfaqësuese ligjore znj. R N; Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. I S. Në fakt, referuar dokumentacionit të kontratës së dhurimit të kuotave me

nr. 1828 rep. 754 kol., datë 25.09.2020 ndodhur në QKB, rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara person me lidhje me hartuesin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht shoqërinë R.

Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.

2. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastrë, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti II: Rikonstruksion i Filialit Qendra Tranzite:

Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R me përfaqësuese ligjore znj. R N; Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria R me përfaqësuese ligjore znj. R N; Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. I S. Në fakt, referuar dokumentacionit të kontratës së dhurimit të kuotave me nr. 1828 rep. 754 kol., datë 25.09.2020 ndodhur në QKB, rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara person me lidhje me hartuesin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht shoqërinë R. Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.

3. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan:

Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R me përfaqësuese ligjore znj. R N; Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria A me përfaqësues ligjor znj. A N; Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. A N. Në fakt, sipas dokumentacionit të sipërcituar, rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara person me lidhje me hartuesin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht shoqërinë R. Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.

4. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë:

Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R me përfaqësuese ligjore znj. R N. Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria D me përfaqësues ligjor z.V T ; Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. R N.

Sipas dokumentacionit të sipërcituar rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara të njëjtin person i cili njëkohësisht ka qenë edhe përfaqësues ligjor i shoqërisë hartuese të projektit R, konkretisht znj. R N. Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 12 sipas të cilit kolaudatori nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin dhe mbikëqyrjen dhe e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare SHA të merren masat e nevojshme për identifikimin dhe shmangien e rasteve të konfliktit të interesit me qëllim sigurimin e shërbimeve efektive nga ana e Kontraktorëve.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për çdo procedurë

nga ana e anëtarëve të grupeve të ngritura me Urdhër Titullari AK, plotëson formularë deklarimi tip të miratuar nga Agjensia e Prokurimit Publik për të cilat anëtarët deklarojnë me vullnet të plotë që nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit, i njëjti standart do të ndiqet edhe për rastet e konstatuara në rekomandim për operatorët pjesmarrës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

12. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video Wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë*”, viti 2020 gjatë implementimin dhe zbatimit të kontratës nga grupi i auditimit u konstatua që një pjesë e konsiderueshme e automjeteve nuk ishin të pajisura me sistemin GPS si dhe automjetet që ishin të pajisura me sistemin GPS, nuk u arrit të merreshin të dhëna për vitet periudhë nën auditim 2019-2022, pasi në sistemin qendror nuk u gjenden rekorde për gjurmimin e automjeteve. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, neni 107 “*Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës*”.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, nga ana e Posta Shqiptare Sh.A., për çdo kriter të vendosur ose specifikime teknike, nga anëtarët e grupeve të punës mbahet procesverbali me argumentimin ligjor dhe teknik, konkretisht bashkëlidhur dokumentacioni për 2 procedura të zhvilluara nga Posta Shqiptare në cilësinë e AK. Konkretisht procedura “*Blerje pajisje sigurie*” e vitit 2024 dhe “*Rikonstruksion i zyrës postare Tirana 5, Zyra Postare Qendër Durrës*”, procedurave të cilave i është mbajtur procesverbali me argumentimin ligjor dhe teknik.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi mbi disa kampionë të përzgjedhur për të marrë siguri të arsyeshme mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, u konstatua se, në kampionet e përzgjedhur është operuar rast pas rasti që kriteret të jenë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

13. Gjetje nga Auditimi: Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje palmar profesional, barkod reader me Wireless, lexues barkodesh*”, rezulton se në hartimin e kriterëve të veçanta është përfshirë në pikën nr. 2.5 kërkesa sipas të cilës produktet e ofruara duhet të jenë Brand i njohur Ndërkombëtar, veprim ky diskriminues pasi kriteri i plotësimit të kërkesave të cilësisë dhe origjinalitetit të mallrave nuk qëndron, kjo sepse janë certifikatat ato që i japin këto attribute dhe jo emri. Gjatë analizimit të kësaj procedure, rezulton se komisioni i vlerësimi të ofertave ka s’kualifikuar ofertën me vlerë më të ulët mbështetur në këtë kriter, atë të OE S T me vlerë 29,800,000 lekë pa TVSH dhe duke kualifikuar OE S me ofertë

ekonomike 32,821,000 lekë pa TVSH, me diferencë **3,021,000 lekë**. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 23 “Specifikimet Teknike” si dhe neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Organet Drejtuese të Posta Shqiptare SHA, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të mirëmbajtjes së pajisjeve hardwëre, të krijojnë kushte me gjithëpërfshirëse, pasi vendosja e kriterëve të cilët kërkojnë certifikime të prodhuesve pengojnë zhvillimin e një gare dhe konkurrence të drejtë.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare nuk ka kryer procedurë tjetër prokurimi për mirëmbajtjen e pajisjeve hardwëre.

Komenti i grupit të auditimit.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) ky rekomandim ngelet të vlerësohet në vijimësi përmes auditimeve të ardhshme .

13.2 Rekomandimi: Organet Drejtuese të Posta Shqiptare SHA, të tregojë kujdes gjatë vlerësimit të ofertave dhe të marrë në konsideratë të gjithë kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nëse janë ose jo në përputhje me dokumentacionin e sjellë nga O.E. pjesëmarrës.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare ka kryer procedura prokurimi ku janë në përputhje me dokumentacionin e O.E të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike. Konkretisht procedurat “Blerje Kasaforta” dhe “Blerje Karburanti për automjete”.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga verifikimi mbi disa kampionë të përzgjedhur për të marrë siguri të arsyeshme mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, u konstatua se, në kampionet e përzgjedhur është operuar rast pas rasti që gjithë kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara të vlerësohen nëse janë ose jo në përputhje me dokumentacionin e sjellë nga O.E pjesëmarrës.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

14. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “Blerje Eterna BI + Data Warehouse + Reporting Services, log management, manaxhim te dokumenteve, statistikë si dhe Mirëmbajtje Eterna BI për 4 vite pas implementimit”, më datë 22.07.2019, objektivi ka qenë ndërtimi i një magazine të dhënash (Data Warehouse), inteligjencë biznesi (Business Intelligence) dhe administrim logesh (Log Managament) që do të shërbejnë si një burim kryesor raportimi dhe analize për punonjësit e Postës Shqiptare SHA si dhe mirëmbajtja e tyre për 4 vite, ku njëkohësisht është zhvilluar dhe procedura me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për tre vite”, më datë 05.05.2020 ku kanë objekt të ngjashëm dhe flitet për të njëjtat zëra mirëmbajtje si më poshtë: ‘Application server’, ‘Database Server’ dhe ‘Data Warehouse Server. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare, të kryejnë një analizë të hollësishme të sistemeve të implementuar, duke kryer një kategorizim të serverëve dhe të

mirëmbajtjes së tyre, pasi në procedurat e prokurimit të zhvilluara për mirëmbajtjet, objekti dhe specifikimet janë të njëjta.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria e IT ka paraqitur relacion mbi këtë rekomandim ku shpjegon se kush është qëllimi i teknologjisë.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje pjesë këmbimi për automjetet e tipit Nissan NV300*” rezulton se:

Grupi i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike nuk ka përcaktuar asnjë tregues teknik për mallrat e kërkuar, por thjesht ka pasqyruar listën e materialeve të kërkuar nga Drejtori i filialit qendra Tranzite z.A Gj bashkëlidhur relacionit me nr. 190 prot., datë 17.03.2022.

Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike nuk ka parashikuar që:

a. Operatori Ekonomik të paraqiste katalogun origjinal të prodhuesit ose kopje te noterizuar të përkthyer në gjuhën shqipe me të dhënat teknike ku të jenë specifikuar të gjitha specifikimet e pjesëve të këmbimit.

b. Në ditën e hapjes së ofertave Operatori Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesë para komisionit mostra për te gjithë artikujt Pjesë Këmbimi.

c. Kërkesat e paraqitura tek shtojca nr. 5 nuk janë materializuar në kritere të veçanta si kërkesa të detyrueshme për OE pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi.

d. Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike për të garantuar cilësinë e mallrave të kërkuara duhej të përfshinte kërkesën që gjatë dorëzimit të mallit, ato të shoqëroheshin me certifikata të sigurimit të cilësisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të hartimit të specifikimeve teknike, pasi në disa raste hartimi i tyre konstatohet jo korrekt.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nga ana e Posta Shqiptare Sh.A., për çdo kriter të vendosur ose specifikime teknike, nga anëtarët e grupeve të punës mbahet procesverbali me argumentimin ligjor dhe teknik, konkretisht bashkëlidhur dokumentacioni për 2 procedura të zhvilluara nga Posta Shqiptare në cilësinë e AK.

Procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AK Posta Shqiptare Sh.A., sistematikisht janë nën mbikqyrjen e asistencës së Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), që i jep autoriteteve/enteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), bashkëlidhur material plotësues për procedura në të cilat janë bërë ndryshime sipas konstatimeve të Koordinatorit të APP.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)” është konstatuar se, kontraktuesi nuk ka respektuar afatet kohore gjatë dorëzimit të letrës A3 80gr/m², pasi Kontraktuesi ka dorëzuar pranë magazinës së AK Posta Shqiptare mallin pjesë të Kontratës nr. 1637/82 date 22.02.2023, letër Fotokopje A3 80 gr/m² më datë 18.08.2023, pra me 118 dite me vonesë të këtij artikulli duke mos respektuar nenin 10 pika 10.2 të Kontratës Loti I “Blerje letër fotokopje A4, letër fotokopje A3”. Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka mbajtur proces verbal në lidhje me dorëzimin me vonese të këtij artikulli, duke mos informuar AK për mos përmbushjen e afateve nga kontraktuesi siç janë të përcaktuara në kontratën e sipërcituar për mallin “Leter A3 80 gr/m²” ku është përcaktuar se: *Malli objekt kontrate do të lëvrohet me dërgesa të pjesshme sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, për gjatë periudhës 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Sasia prej 25% e mallit objekt kontrate, duhet të lëvrohet jo më vonë se 2 (dy) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës.* Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Grupi i auditimit të KLSH, konstatohet se OE I nuk e ka respektuar këtë detyrim për mallin letër A3 pjesë e objektit të kontratës nr. 1637/82 datë 22.02.2023. Vlera e penaltetit sipas nenit 21 duhet të llogaritet mbi 25 % të vlerës totale të këtij artikulli duke e penalizuar me 4/1000 për ditë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren për masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin e kontratave me qëllim identifikimin e rasteve në të cilat kontraktorët nuk respektojnë afatet e parashikuara.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në cilësinë e AK, Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me Urdhër të titullarit të AK, kryen ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e kontratave ose grupet e marrjes në dorëzim sipas objektit të kontratave, të cilët kanë detyrimin ligjor për zbatimin e tyre. Rast pas rasti, në zbatim të Urdhrave të ngarkuar dhe kontratave, grupet e punës përgatisin materialin shoqëruar për ekzekutimin e tyre, ku, në ato raste në të cilat ka pasur vonesa, është aplikuar penalteti për vonesën e shaktuar sipas akteve në fuqi.

Bashkëlidhur informacioni për penaltetet e aplikuar për vonesën në zbatim kontrate nga Drejtoria Ekonomike (Printscreen A N, Dr Ekonomike) më datë 18 korrik 2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

17. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe nga verifikimi në terren i mallit i kontratës me objekt “Blerje e vendosje sisteme të integruara të sigurisë (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi CH4, CH8, CH16), sisteme inteligjente (SMART) të sigurisë CH4, CH8, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit” u konstatuan problematika. Konkretisht rezultoi se disa prej kamerave të instaluar në filialet e postës nuk ishin funksionale. Sa më sipër është në kundërshtim me Vendimin nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, pika 2.b).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Posta Shqiptare SHA, të marrë masat të hartojë dhe të parashikojë mirëmbajtjen e mallrave objekt kontrate sipas Vendimit në fuqi.

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, ka marre masa për parashikimin e saktë të mirëmbajtjes së mallrave objekt kontrate dhe parashikimit në Programin Ekonomik për vitin ushtrimor 2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

18. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “*Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë*” rezultojnë specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke mos përshkruar minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar,

Kërkesat e bëra nuk janë bërë plotësisht në terma funksionalë pasi nuk janë ta argumentuara teknikisht dhe ligjërish. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 20, “*Mosdiskriminimi*”, neni 23, “*Specifikimet teknike*”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 27, “*Kontratat e mallrave*” pika 1 dhe pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1 Rekomandimi: Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të specifikimeve teknike në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nga ana e Posta Shqiptare Sh.A., për çdo kriter të vendosur ose specifikime teknike, nga anëtarët e grupeve të punës mbahet procesverbali me argumentimin ligjor dhe teknik, konkretisht bashkëlidhur dokumentacioni për 2 procedura të zhvilluara nga Posta Shqiptare në cilësinë e AK.

Procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AK Posta Shqiptare Sh.A., sistematikisht janë nën mbikqyrjen e asistencës së Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), që i jep autoriteteve/enteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), bashkëlidhur material plotësues për procedura në të cilat janë bërë ndryshime sipas konstatimeve të Koordinatorit të APP.

Konkretisht është vënë në dispozicion procedura “Blerje Kasaforta” viti 2024 e cila nuk ka pasur ankesa nga operatorë të tjerë dhe Koordinatorin e APP i cili monitoron procedurat e prokurimit. Vendosja e kasafortave është kryer sipas planit të nevojës dhe shpërndarjes.

Lidhur me parashikimin për blerje kasaforta të mëdha, mesme, vogla:

1. Kasafortat e Mëdha janë të domosdoshme për ruajtjen e vlerave monetare në Dhomat e Sigurisë në Filiale dhe Degë të Posta Shqiptare sh.a për ruajtjen e vlerave monetare gjatë punës edhe në fjetje, si dhe duke zbatuar me korrektësi Vendimin nr.2, viti 2016 të Këshillit Mbikqyrës mbi limitet e vlerave monetare gjatë punës dhe në fjetje. Limitet në Dhomat e Sigurisë janë të konsiderueshme dhe kërkohet sipas rregullores së sigurisë për menaxhimin e vlerave monetare që kasafortat të jenë të mëdha me kod elektronik dhe me çelës, kundra

zjarrit, vjedhjeve, përmbytjeve dhe pesha e tyre të jetë jo më pak se 800 kg dhe përdoren vetëm për dhomat e sigurisë në Filiale dhe Degë.

2. Kasafortat e Mesme përdoren në zyra pensionesh dhe shërbimesh për ruajtjen e vlerave të konsiderueshme gjatë punës dhe në fjetje. Kasafortat e mesme janë të domosdoshme për të mbajtur vlerat monetare që furnizohen nga operatori me eskortë dhe mjet të blinduar për shpërndarjen e pensioneve gjatë ditës. Janë të domosdoshme në zyrat e qytetit për sigurimin e vlerave monetare që arkëtohen gjatë turnit të dytë në bazë të Vendimit nr.2, viti 2016 të Këshillit Mbikqyrës. Këto kasaforta duhet të kenë këto elemente sigurie kod elektronik, bravë me çelës mekanik, kundra zjarrit, kundra vjedhjes, kundra përmbytjes dhe jo më pak se 500 kg. Arsyeja e kërkesës për pajisje të zyrave të qytetit me kasaforta të mesme është e domosdoshme për shkak se turni i dytë i punonjësve nga ora 16:00-20:00 nuk ka kthime me eskortë të blinduar, prandaj këto vlera duhen të rruhen në kasaforta të mesme zyre.

3. Kasafortat e vogla janë të domosdoshme gjatë orarit të punës për arkëtimin dhe pagesat që kryhen në sportel, kanë limite për vlerat monetare më të ulëta në bazë të Vendimit nr.2, viti 2016 të Këshillit Mbikqyrës. Në këto kasaforta të vogla sporteli nuk lejohet fjetja e vlerave monetare, janë vetëm për përdorim gjatë punës.

Vlerat që vijnë me eskortë nga Filiali në zyrë postare i dorëzohen kryetares së zyrës e cila i vendos në kasafortën e mesme të zyrës ku nga aty ia shpërndan sportele sipas limiteve të cilat punonjëset i mbajnë në kasaforta të vogla sporteli.

Planifikimi për blerje kasaforta të vogla, të mesme dhe të mëdha kryhet në bazë të kërkesave të Filialeve të Posta Shqiptare sh.a.

Nga kontrollet e ushtruara nga Drejtoria e Sigurisë kemi konstatuar se disa kasaforta të vogla, të mesme dhe të mëdha janë të amortizuara dhe nuk janë në funksion të plotë të cilat shpesh herë na kanë bllokuar procesin e punës për arsye se janë në moshë të vjetër dhe nuk riparohen sepse nuk gjenden pjesë ndërrimi për ato.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

19. Gjetje nga auditimi: Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe pas verifikimit në terren të mallit objekt kontrate për praktikën me objekt “*Blerje kuti postare restante dhe kuti postare për klientë*”, pas një inspektimi në terren duke zgjedhur disa nga pikat ku janë montuar kutit postare sipas proces-verbalit bashkangjitur dosjes së prokurimit, rezultoi se shumë kuti postare në hyrjet e pallateve nuk ishin funksionale pasi nuk përmbanin as emrin dhe as nr. e apartamentit të banorëve. Pas një komunikimi dhe me administratorët e pallateve ata e mohuan që të kishin një kopje të çelësave për aksesimin e kutive postare. Kjo gjë është e ilustruar dhe nga fotot me nr. 3, 4, 5 dhe 6 në Aneksin nr. 2.3.4. Kutitë restante nuk janë montuar por janë në gjendje në magazinën qendrore të postës. Sa më sipër është në kundërshtim me kontratën nr. 225/19 prot., datë 21.05.2021.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1 Rekomandimi: Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të Posta Shqiptare SHA, të marrë masat të analizojë situatën, të nxjerrë shkaqet dhe përgjegjësitë me qëllim vënien në funksion të kontratës nr. 225/19 prot., datë 21.05.2021.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Relacioni i përgatitur nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Postar si dhe dështimi i procedurës së prokurimit për rikonstruksionin në zyra postare nr.5., mbi 2 herë, objekt në të cilën do të instalohen kutitë postare restante. Konkretisht ka dështuar kjo procedurë në vitin 2021 dhe në

vitin 2023 ka dështuar 2 herë. Kjo procedurë është rihedhur në SPE dhe data e hapjes së ofertave është 24.07.2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

20. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se Rregullorja e Brendshme, “*Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SHA*” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare nuk është përshtatur (amenduar) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Posta Shqiptare. Konkretisht:

- në rregulloren e brendshme të Posta Shqiptare SHA detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara përgjithësisht në nivel makro;
- në disa raste konstatohet se mungojnë përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësive për disa funksione që janë në strukturën organizative por nuk gjenden të reflektuara në rregulloren e brendshme të funksionit të administratës qendrore. Sa më sipër është në kundërshtim me nenet 7, 11, 14, të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare, dhe nenin 20 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar si dhe “*Detyrat dhe kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm*” përcaktuar në rregulloren e brendshme. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 120 – 123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Posta Shqiptare SHA, të hartojnë, amendojnë dhe miratojnë, rregulloren e brendshme, “*Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SHA*” duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura ndër vite në shoqëri. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Administratori Shoqërisë “Posta Shqiptare” SH.A., me anë të Urdhrit të brendshëm Nr.48, datë 10.06.2024 me Nr.Prot.,1218, ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për hartimin Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme “Posta Shqiptare” sh.a.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

21. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurave në lidhje me rekrutimin e punonjësve të rinj rezultoi se:

- Në asnjë rast nuk u evidentua ndonjë gjurmë që sektorëve/departamenteve përkatëse ju ka lindur nevoja për rekrutimin e punonjësve të rinj.
- Nuk janë dokumentuar procedura të mirëfillta rekrutimi të tyre dhe deri në përzgjedhjen e tyre nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura,
- Përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj.

Sa më sipër është në kundërshtim me Rregullorja e Brendshme, “*Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SHA*” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare dhe Vendimet “*Për miratimin e strukturës organizative të aparatit qendror të Posta Shqiptare SHA*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 120 – 123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Posta Shqiptare SHA, gjatë hartimit të strukturës organizative të aparatit qendror Posta Shqiptare SHA dhe njësive të vartësisë, të marrë në konsideratë nevojat e sektorëve/departamenteve dhe njësive të vartësisë duke rekrutuar punonjës të rinj me procedurat sipas metodave më të mira dhe me të drejta.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Administratori Shoqërisë “Posta Shqiptare” SH.A., me anë të Urdhrit të brendshëm Nr.37 datë 22.04.2024 me Nr.Prot.,824, ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për “Ngritjen e Komisionit për përzgjedhjen e punonjësve, të cilët do të emërohen në Filialiet e Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

22. Gjetje nga Auditimi: Drejtoria e Përgjithshme Posta Shqiptare SHA në momentin e hartimit të regjistrave të parashikimit, nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, sipas natyrës, sasisë dhe llojit të kontratës, të cilat kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Në 10 raste, gjatë hartimit të regjistrave të parashikimeve të prokurimeve në vlerë të vogël, është evidentuar shmangie nga procedurat përkatëse të prokurimit, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo të kontratave si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme

-Procedura e prokurimit me objekt “*Blerje materiale anti-covid 2019*” me numrin e referencës REF-87799-02-22-2021 dhe fond limit në vlerën prej 788,000 lekë pa TVSH, nga ku fitues është shpallur M V me vlerën prej 778,900 lekë pa TVSH.

-Procedura e prokurimit me objekt “*Blerje produkte higjieno-sanitare*” me numrin e referencës REF-87793-02-22-2021 dhe fond limit në vlerën prej 792,666 lekë pa TVSH, nga ku fitues është shpallur M V me vlerën prej 779,900 lekë pa TVSH.

Procedurat e prokurimit të sipërcituara rezultojnë në të njëjtën llogari shpenzimesh dhe me të njëjtin funksion kryesor parandalimin e përhapjes të infeksioneve nga bakteret dhe viruset.

Sa më sipër, vlera totale e tyre është 1,558,800 lekë, nga ku kanë tejkaluar pragun procedurës së prokurimit në vlerën prej 758,800 lekë.

-Procedura e prokurimit me objekt “*Sigurimi i fondit të përdoruesve për shërbimin e pagesave*”, me fondin limit 543,000 pa TVSH, e realizuar në datën 13.10.2022 dhe operatori fitues A SHA me vlerën prej 520,000 lekë pa TVSH.

-Blerje nën vlerën 100,000 lekë “*Siguracioni TPL për mjetet motorike*”, me fondin limit 100,000 pa TVSH, e realizuar me vlerën prej 19,700 lekë pa TVSH me shoqërinë I SHA.

-Procedura e prokurimit me objekt “*Sigurim kontrate për magazinë doganore*”, fondi limit 1,000,000 pa TVSH, e realizuar në datën 23.02.2022 dhe operatori fitues A SHA me vlerën prej 970,000 lekë pa TVSH. Sa më sipër, përbëjnë grupe mallrash të ngjashëm në të njëjtën llogari shpenzimesh dhe si produkte sigurimi me të njëjtin funksion dhe qëllim kryesor blerjen e përgjegjësive tek shoqëritë e sigurimeve. Procedurat e sipërcituara së bashku, rezultojnë në vlerën totale prej 1,539,700 lekë, nga ku tejkalohet pragu në vlerën 539,700 lekë.

Filiali Tiranë

-Procedura e prokurimit me objekt “*Siguracioni i aktiveve të qëndrueshme (ndërtesës)*”, fondi limit 800,000 pa TVSH, e realizuar në datën 09.04.2021 dhe operatori fitues A SHA me vlerën prej 796,400 lekë pa TVSH.

-Procedura e prokurimit me objekt “*Siguracioni TPL për mjetet motorike*”, fondi limit 300,000 pa TVSH, e realizuar në datën 26.04.2021 dhe operatori fitues A SHA me vlerën prej 298,500 lekë pa TVSH.

-Procedura nën vlerën 100,000 lekë me objekt “*Siguracioni TPL për mjetet motorike*”, fondi limit 100,000 pa TVSH, e realizuar në datën 09.07.2021 dhe operatori fitues A SHA me vlerën prej 99,996 lekë pa TVSH.

Sa më sipër, të tre procedurat përbëjnë grupe mallrash të ngjashëm në të njëjtën llogari shpenzimesh si dhe produkte sigurimi me të njëjtin funksion dhe qëllim kryesor, pra blerjen e përgjegjësi tek shoqëritë e sigurimeve. Vlera totale e tyre është 1,194,896 lekë, pra tejkalojnë pragun e procedurës së prokurimit në vlerën me 394,896 lekë.

-Procedura e prokurimit me objekt “*Siguracioni i aktiveve të qëndrueshme (ndërtesës)*” me numrin e referencës REF-21657--03-10-2022 me fond limit në vlerën 800,000 lekë pa TVSH, dhe fitues A SHA me vlerën prej 796,950 lekë pa TVSH.

-Procedura e prokurimit me objekt “*Siguracioni TPL për mjetet motorike*” me numrin e referencës REF-26141-04-22-2022 me fond limit në vlerën prej 400,000 lekë pa TVSH dhe fitues A SHA me vlerën prej 398,000 lekë pa TVSH.

Dy procedurat e mësipërme së bashku rezultojnë në vlerën totale prej 1,194,950 lekë, nga ku tejkalojnë pragun e procedurës së prokurimit në vlerën prej **194,950 lekë**. Sa më sipër trajtuam, bie në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit nr. 03, datë 08.01.2018 të APP, me pikën 3 të Udhëzimit nr. 05, datë 25.06.2021 të APP, gjithashtu në kundërshtim me nenin 56, pika 2 dhe 11, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”. Parregullsitë, sa më sipër, kanë sjellë për pasojë shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo kontratave.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masat e nevojshme, që në hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve në vlerë të vogël, të krijohet linja të qarta bashkëpunimi, raportimi dhe përgjegjësi dhe vendimmarrje të përcaktuara për parandalimin e copëzimit të fondeve publike, kjo njëkohësisht me qëllim edhe shmangien e kufizimit të procedurave konkurruese të prokurimit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*” i ndryshuar, nga ana e Posta Shqiptare Sh.A., në përgatitjen e Regjistrit të Parashikimeve të Blerjeve të Vogla, janë marrë masa për parandalimin e copëzimit të fondeve. (*Bashkëlidhur Regjistri Parashikimeve të Blerjeve të Vogla për vitin ushtrimor 2024 sipas programit ekonomik të miratuar dhe rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

23. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me blerjet e vogla konstatohet se operatori ekonomik fitues rezulton me ofertë me vlerë më të ulët nga oferta e paraqitur gjatë verifikimit në treg për vlerësimin e fondit limit, kjo kur ofertat janë dhënë për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, si më poshtë:

-Procedura e prokurimit me objekt “*Blerje produkte higjierno-sanitare*” me numrin e referencës REF-87793-02-22-2021, është kryer me Urdhrin e Prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme me nr. 03 datë 19.02.2021. Fondi limit i kësaj procedure është përcaktuar nga tregu në vlerën prej 792,666 lekë pa TVSH. Në procesverbalin datë 18.02.2021 të komisionit të prokurimeve të vogla për llogaritjen e fondit limit është administruar oferta e OE M V në vlerën prej 785,000 lekë, si një nga ofertat e marra gjatë studimit të tregut. Në të njëjtën kohë, oferta e operatorit

ekonomik M V në sistemin elektronik të prokurimit është konstatuar e ndryshuar dhe në një vlerë më të ulët prej 779,900 lekë, e cila është shpallur operator fitues. Në rastin e konsultimit verbal, grupi i ngritur për këtë qëllim, duhet të hartojë një procesverbal me të dhëna, që mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës (praktikisht ofertat nga fituesi janë dhënë në të njëjtën kohë). Pranimi nga ana e komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël, të ofertës të operatorit fitues M V në SPE, ka sjellë deformimin e procesit të krahasimit të kësaj oferte me fondin limit për arsye se ka ndryshuar baza krahasuese (ekzistenca e dy ofertave të ndryshme në të njëjtën kohë dhe për të njëjtin objekt prokurimi). Sa më sipër, operatori ekonomik fitues është paraqitur me 2 oferta të ndryshme për të njëjtën objekt prokurimi. Pranimi i 2 ofertave të sipërcituara për OE fitues, për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, ka shkaktuar deformimin e vlerësimit dhe të konkurrencës në procesin e prokurimit. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 63 pika 3, i ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 13 pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA, të merren masat e nevojshme për shmangien e deformimit gjatë procedurës së vlerësimit, duke siguruar që procesi i prokurimit në vlerë të vogël të përfshihet në një manual përdorimi, me qëllim identifikimin e përgjegjësive individuale, dokumentacionin përkatës të miratuar për hapat e procesit dhe vendimmarrjen individuale, që duhet të ushtrohen gjatë zbatimit të kësaj procedure të thjeshtuar.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nga ana e Posta Shqiptare Sh.A., si dhe në zbatim të manualit të APP: <https://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/udh%C3%ABzime/>. Janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

24. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me blerjet e vogla konstatohet se me urdhrin nr. 81, 2112 prot., datës 15.10.2020 ish administratori z. L D ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “Blerje dhe riparim pajisjesh për mobilim dhe arredimin e zyrave”. Pavarësisht procedurës së kryer, janë konstatuar problematikat e mëposhtme. Për realizimin e kësaj procedure prokurimi mungon kërkesa nga ana e drejtorisë përkatëse, nga ku të lindte nevoja për kryerjen e kësaj procedure. Së dyti, në rastin e s’kualifikimit të OE N H i renditur i gjashti në klasifikimin përfundimtar nuk është mbajtur protokoll zyrtar që të shpjegojë arsyet e s’kualifikimit, por e vetmja gjurmë gjendet në sistemin elektronik të APP. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56, pika 6.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1 Rekomandimi: Nga administratori dhe zyra e financës të shoqërisë Posta Shqiptare SHA, të merren masa për korrigjimin e praktikave të prokurimeve me vlerë të vogël dhe zbatimi i tyre në përpikmëri sipas ligjit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, n si dhe në zbatim të manualit të APP:[https:// www.app.gov.al/](https://www.app.gov.al/) ka kryer korrigjimin e praktikave. (Bashkëlidhur dokumentacioni, kërkesa nga Drejtoritë përkatëse për fillim procedure për procedurat me blerje të vogël në zbatim të Programit Ekonomik për vitin ushtrimor 2024).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

25. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re një rritje në riskun mbi likuiditetit që përcaktohet si risku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare si dhe arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Posta Shqiptare është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer llogaritë e pagueshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 134 – 136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1 Rekomandimi: Posta Shqiptare SHA të marrë të gjitha masat mbi arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, në rast të vonesave mbi arkëtimin e tyre të marrë masat mbi vendosjen e kamatëvonesave duke iu përmbajtur kushteve të kontratave si dhe në mos realizimin e arkëtimit të tyre ti kalojë në borxh të keq. Gjithashtu Posta Shqiptare SHA të bëjë të mundur shlyerjen e llogarive të pagueshme duke shmangur penalitetet e mundshme në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Drejtoria ekonomike me shkresën Nr.136/13, prot.,datë 14.06.2024 ka dhënë sqarimet përkatëse por nuk ka ndërmarrë asnjë masë .

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

26. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm rezulton se me shkresën nr. 3003 prot., datë 14.11.2019 është lëshuar nga Administratori i Posta Shqiptare SHA z. L D , Urdhri nr. 332 i datës 14.11.2019 “*Mbi raportin përfundimtar dhe rekomandimeve për auditimin e Posta Shqiptare SHA nga Kontrolli i Lartë i Shtetit*”. Me shkresën nr. 3003/1 prot., datë 14.11.2019 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është vënë në dijeni Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditor për kthim përgjigje ndaj KLSH, konstatohet se nga ana e Posta Shqiptare SHA është respektuar afati me dërgimin e shkresës nr. 1519/67 datë 26.09.2019 në zbatim të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, germa j. Nga auditimi i zbatimit të afatit 6 mujor për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, konstatohet se Posta Shqiptare SHA nuk e ka përmbushur këtë detyrim. Me nisjen e shkresës nr. 520 prot., e datës 05.06.2020 KLSH njofton drejtuar Posta Shqiptare SHA për fillimin e auditimit tematik për zbatimin e rekomandimeve. Me shkresën nr. 520/1 prot., e datës 05.06.2020 KLSH nis programin e auditimit tematik për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Me shkresën nr. 520/9 prot., e datës 27.07.2020 KLSH nis projekt raportin e auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve në subjektin Posta Shqiptare SHA. Me shkresën nr. 520/42 prot., e datës 04.12.2020 KLSH nis drejt Posta Shqiptare SHA rekomandime dhe pjesë nga raporti përfundimtar. Me shkresën nr. 2689 prot., e datës

28.12.2020 është lëshuar Urdhri i Brendshëm nr. 105 nga Administratori i Posta Shqiptare SHA për marrjen e masave mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Posta Shqiptare sha nuk i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 32 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 11 masa, janë në proces realizimi 12 masa dhe 9 masa nuk janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 7 masa për shpërblim dëmi, në vlerën 7,105,904 lekë, nga të cilat 0 masa janë zbatuar, janë në proces zbatimi 6 masa dhe 1 masë nuk është zbatuar,

-Janë rekomanduar 6 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, nga të cilat 2 masa nuk janë pranuar, 1 masë është zbatuar, është në proces realizimi 1 masë dhe 2 masa nuk janë zbatuar. Sa më sipër është në kundërshtim me ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, nenet 15 germa “j” 30, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1 Rekomandimi: Posta Shqiptare SHA, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për rekomandimet e lëna në Auditimin e vitit 2019, janë në proces zbatimi.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt “Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastër, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti II: Rikonstruksion i Filialit Qendra Tranzite”, viti 2018 rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve BOE H K & 2 tepër në vlerë si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shumën totale prej **458,663 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila jepet e detajuar sipas Aneksit nr. 2.3.0.1. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, neni 12, VKM me nr. 629 datë 15.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I, germa A, paragrafi i fundit si dhe Kreu II, Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1 dhe Pika 8.3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 14/1 prot., datë 29.10.2018 si dhe me kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 5/2 prot., datë 30.09.2019.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej **458,663 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit të punimeve BOE H K & 2me të cilët është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 2902/16

prot., datë 05.12.2018 me objekt “Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastrë, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti II: Rikonstruksion i Filialit Qendra Tranzite”, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Posta Shqiptare ka kërkuar nëpërmjet Drejtorisë Juridike arkëtimin e vlerës totale prej **458,663 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit të punimeve BOE H K & 2 , nëpërmjet shkresës Nr.909/69, prot.,datë 29.04.2024, njoftim për arkëtim shume. Operatori është përgjegjitur me shkresën Nr.909/72 prot., datë 23.05.2024 duke bërë likuidimin përkatës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt “Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë”, viti 2020, nga krahasimi i volumeve të situacionuara e likuiduara si dhe atyre të kryera në fakt rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve BOE A & B në shumën totale prej **58,414 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila jepet e detajuar sipas Aneksit nr. 2.3.0.2. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7/1, neni 12, VKM me nr. 629 datë 15.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1 dhe Pika 8.3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 135 prot., datë 30.03.2020 si dhe me kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej **58,414 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit të punimeve BOE A & B me të cilët është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3163/47 prot., datë 30.03.2020 me objekt “Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë”, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Posta Shqiptare ka kërkuar nëpërmjet Drejtorisë Juridike arkëtimin e vlerës totale prej 58,414 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit të punimeve BOE A & B duke ngritur kërkesëpadinë me Nr.1423 Prot., datë 09.07.2024 , në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Paraprakisht është bërë njoftimi për arkëtim shume ndaj operatorit me shkresën Nr.909/70 prot.,datë 29.04.2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht i zbatuar***.

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan”*, viti 2020 nga krahasimi i zërave të situacionuar e të pasqyruara në librezën e masave si dhe verifikimit në terren të kryer në prezencë të përfaqësuesve të Postës Shqiptare SHA rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve OE L K si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej **202,501 lekë pa TVSH**, e argumentuar kjo sipas Aneksit nr. 2.3.0.3. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, neni 7/1, neni 12, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, Pika 8.1 dhe Pika 8.3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 104 prot., datë 30.03.2020 si dhe me kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej **202,501 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit të punimeve OE L K me të cilin është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3163/56 prot., datë 15.05.2020 me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan”*, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Posta Shqiptare ka kërkuar nëpërmjet Drejtorisë Juridike arkëtimin e vlerës totale prej **202,501 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit të punimeve L K duke ngritur kërkesë padi me Nr.Prot., 1422 datë 09.07.2024 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Paraprakisht është bërë njoftimi për arkëtim shume ndaj operatorit me shkresën Nr.909/67 prot., datë 29.04.2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht i zbatuar***.

4. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt *“Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës”*, viti 2020 nga krahasimi i zërave të situacionuar e të pasqyruara në librezën e masave rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve OE K C si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej **265,301 lekë pa TVSH**, e argumentuar kjo sipas Aneksit nr. 2.3.0.4. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, neni 7/1, neni 12, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, Pika 8.1 dhe Pika 8.3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 224/1 prot., datë 15.06.2020 si dhe me kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej **265,301 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit të punimeve OE K C me të cilin është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3163/56 prot., datë 15.05.2020 me objekt “*Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës*”, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Posta Shqiptare ka kërkuar nëpërmjet Drejtorisë Juridike arkëtimin e vlerës totale prej **265,301 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit të punimeve L K duke ngritur kërkesë padi me Nr.1421 Prot., datë 09.07.2024 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Paraprakisht është bërë njoftimi për arkëtim shume ndaj operatorit me shkresën Nr.909/68 prot., datë 29.04.2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje kancelari dhe zarfa*” rezulton se KVO ka s’kualifikuar me të padrejtë OE Gj K e cila rezulton si ofertë anomalisht e ulët. Në referim të shkresës së datës 01.02.2023 të paraqitur në Faksimilen nr. 1, aneksi 2.3.1., OE Gj K sqaron se oferta e paraqitur prej tij është e përballeshme pasi ka një xhiro të lartë vjetore dhe se për të artikuj të njëjtë me ato të AK Posta Shqiptare ka realizuar kontrata të suksesshme me 15 subjektet publike të rëndësishme. Bashkëlidhur, shkresës në lidhje me zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, OE Gj K ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015, si dhe vërtetim nga AK të sipërcituar mbi realizimin me sukses të kontratave me objekt të njëjtë me prokurimin e zhvilluar nga AK Posta Shqiptare. Kontrata këto të ngarkuara në SPE. Për sa më lart, OE Gj K plotëson kërkesat e pikës 2 germa a, b, c, ç, d, të nenit 93 në të 5 komponentët e kërkuar. Nga auditimi i procedurave të mëparshme të Postës Shqiptare, rezulton se në procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje tonera, bojëra printeri*” të vitit 2022, KVO ka konstatuar se OE M & D dhe IN kanë rezultuar oferta anomalisht të ulëta. Pas kërkesës së KVO të asaj procedure, drejtuar dy OE mbi dhënien e sqarimeve për mbështetjen e ofertës anomalisht të ulët, rezulton se këta OE kanë paraqitur pothuajse të njëjtat argumente me ato të paraqitura nga OE Gj duke i pranuar dhe kualifikuar dhe në përfundim është shpallur fitues OE M & D, pavarësisht se rezultonte Ofertë anomalisht e ulët. Ndërkohë për rastin e OE IT Gj, Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i kane konsideruar jo bindëse argumentet e këtij OE duke e s’kualifikuar në kundërshtim me *nenin 82 pika 4 e VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*. KVO e ka s’kualifikuar OE Gj në mënyrë të pa drejtë, dhe pas shpjegimeve të dhëna nga OE Gj, duke vërtetuar me dokumentacion qe kishte kapacitete financiare për ta realizuar kontratën me një marzh të vogël fitimi, dhe për më tepër që nga auditimi i kësaj procedure rezultoi që vlera e FL e përllëgaritur nga AK posta Shqiptare ishte jo reale dhe e rritur artificialisht me 201 %. Shuma 11,990,389 lekë e cila përfaqëson diferencën midis Ofertës së shpallur fituese padrejtësisht në vendin e parë në shumën 39,187,981 lekë të OE IN dhe ofertës së paraqitur nga OE Gj në shumën 27,197,592.50 lekë e s’kualifikuar si ofertë anomalisht e ulët, do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Postës Shqiptare.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të ndiqen procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës **11,990,389 lekë** të ndarë në

mënyrë proporcionale për secilin anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit “Blerje kancelari dhe zarfa”.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nga ana e Posta Shqiptare Sh.A., lutemi gjeni bashkëlidhur Relacionin shpjegues në lidhje me masën e lënë, konkretisht relacioni Nr.909/73.Prot., datë 30.05.2024., me lëndë “Relacion mbi rekomandimin nr.20.1., faqe 88-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet” nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i papranuar*.

6. Gjetje nga Auditimi: Parku i filialit Tiranë është i përbërë nga 14 automjete naftë (gazoil) në gjendje pune, nga ku 7 prej tyre, të tipit Ford Courier janë pjesë të kontratës me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 “Qiraja financiare (Leasing)”, ndërmjet M M SHPK dhe Posta Shqiptare SHA. Me anë të kontratës të shërbimit të sigurisë nr. 1322/24 prot., datë 19.10.2020 është përfshirë shërbimi i sistemeve të gjurmimit GPS/GPRS, ku është parashikuar të kryhet monitorimi i mjeteve me targa AA288NY, AA289NY dhe AA798BX të këtij parku (qendra e monitorimit ndodhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare SHA, me shërbim 24 h/7). Për sa më sipër, rezulton se për periudhën 2021-2022 ky shërbim nuk ka funksionuar. Shërbimi gjurmimit GPS/GPRS nuk përfshin mjetet nga kontrata e qerasë financiare (leasing), monitorimi i të cilave kontraktohet nga shoqëria qiradhënëse M M SHPK. Procesi i administrimit të konsumit të karburantit (gazoil) është raportuar sipas formatit “*Treguesit teknik të mjeteve*”, i cili nuk përmban çmimin për njësi, orën, datën dhe vendin e furnizimit, megjithëse programi “IN” i furnitorit K SHPK është në gjendje të gjenerojë një situacion të saktë shpenzimi, për çdo automjet, me datën, vendin, dhe orën e furnizimit, çmimin/njësi, sasinë përkatëse të lëndës djegëse, si edhe numrin e kuponit të tërhequr. Nga ana tjetër, në procesin e administrimit të karburantit mungojnë fletudhëtimet e lëvizjes së automjeteve apo autorizimet përkatëse dhe nga muaji Mars 2022 nuk janë dhënë kilometrat e përshkruara në formatin “*Treguesit teknik të mjeteve*”. Nga auditimi rezulton se në formatin e sipërcituar është vendosur norma e konsumit të karburantit (gazoil) 10 litra (mesatarisht)/100 km, pa studim dhe procedurë të miratuar, për 7 mjetet nga kontrata leasing me targa AA 051YV, AA487YY, AA057YY, AA491YY, AA058YV, AA798YU, AA794YU. Por, në procesverbalin e datës 01.10.2019 për marrjen në dorëzim “*Mbi pranimin e 21 furgonçinave Ford Courier sipas kontratës “leasing” nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019*”, është konfirmuar se mjetet e reja të sipërcituara kanë një konsum të kombinuar 4.5 litra/100 km. Vendosja e normës së harxhimit të karburantit (gazoil)10 litra/100 km, duke u nisur nga kilometrat të plotësuar në formatin “*Treguesit teknik të mjeteve*”, tregon se administrimi i karburantit nuk është në pajtueshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator, për aq kohë sa kilometrat nuk janë të konfirmuara, kur lëvizjet e automjeteve nuk janë autorizuar, dhe kur nuk ka një studim të miratuar, që argumenton ndryshimin dhe rritjen e normës së dhënë të kombinuar për harxhimin e karburantit. Sa më sipër bie në kundërshtim me pikën 1.11.4 “*Rregullat mbi përdorimin e automjeteve*”, si edhe me pikat 3 dhe 7, neni 28 në Rregulloren e Brendshme të Filialit Tiranë, miratuar me ndryshimet e saj me Urdhrin nr. 556, datë 13.12.2018 të Administratorit të shoqërisë. Veprimet dhe mosveprimet e njësisë shpenzuese Filiali Tiranë, kanë sjellë rritjen e paargumentuar të normës së konsumit të karburantit (gazoil), dhe kanë shkaktuar si pasojë

konsumin prej 7,793 litra naftë më tepër {[konsumi në litra/muaj – konsumi i llogaritur (km të përshkruara * 4.5 litra/100 km)] /1 muaj}. Nga të dhënat e siguruar, rezulton se është kryer pagesa në vlerën prej 1,160,531 lekë më shumë, nga përdorimi i automjeteve “leasing” për periudhën Maj 2021 - Shkurt 2022 {Vlera në lekë e paguar/muaj – vlera e llogaritur [(km *4.5 litra/100 km) /1muaj * çmimi mujor]}. Parregullsitë, sa më sipër, kanë sjellë si pasojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare SHA një dëm ekonomik në vlerën prej **1,160,531 lekë**. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 1.11.4 e “Rregulla të përgjithshme mbi përdorimin e automjeteve” në Rregulloren e Brendshme të Filialit Tiranë, Pikat 3 dhe 7, neni 28 në Rregulloren e Brendshme të Filialit Tiranë, miratuar me ndryshimet e saj si dhe me Urdhrin nr. 556, datë 13.12.2018 të Administratorit të shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej **1,160,531 lekë pa TVSH** ndaj ofruesit të shërbimit OE M M me të cilin është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 “Qiraja financiare (Leasing)”, për shërbime të ofruara jo në përputhje me termat e kontratës, veprime këto pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të institucionit si më sipër.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe akteve ligjore në fuqi, është administruar shkresa me nr.863.prot., datë 26.04.2024., me lëndë “Njoftim për arkëtim shume”, drejtuar subjektit “M M”. (Bashkëlidhur dokumentacioni).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

6.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren të gjitha masat e nevojshme për llogaritjen e vlerës së plotë të dëmit ekonomik të shkaktuar nga ana e OE M M për shkak të dorëzimit të mjeteve jo në përdhje me kushtet e kontratës. Kjo përlllogaritje të kryhet në bazë të kostos shtesë që i është shkaktuar buxhetit të AK Posta Shqiptare për sasinë e konsumuar të karburantit me norma mbi ato të paraqitura në katalogët përkatës të mjeteve të ofruara. Në përfundim të kësaj, vlera e përlllogaritur si dëm ekonomik, të kërkohet në rrugë ligjore për tu arkëtuar përmes ndjekjes së të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe të gjitha shkallëve të gjykimit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe akteve ligjore në fuqi, është administruar shkresa me nr.863.prot., datë 26.04.2024., me lëndë “Njoftim për arkëtim shume”, drejtuar subjektit “M M”. (Bashkëlidhur dokumentacioni).

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “*Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite*”, u analizua Relacioni i hartuar nga ana e Grupit të Punës i ngritur me Urdhër nr. 53, datë 12.03.2019, me nr. 740 prot., datë 12.03.2019 për analizën e kostos dhe efikasitetin procedural për procedurën e prokurimit si më sipër, kjo me qëllim identifikimin e avantazheve dhe disavantazheve të përdorimit të Leasing operacional dhe imazhin e institucionit. Nga kjo analizë rezulton si më poshtë shpjegohet:

Sipas këtij relacioni, pika 2 është cituar ndër të tjera se vlera e automjetit pëson një rënie të konsiderueshme gjatë viteve të përdorimit, vlerë kjo e parikuperueshme në fund të jetës së automjetit. Në fakt, nga një analizë e dokumenteve të vëna në dispozicion rezulton se nga grupi përkatës nuk është marrë në konsideratë shuma e mbetur e investimit e cila në fund të 4 viteve rezulton të jetë në total në masën 24,332,448 lekë, e përlllogaritur kjo për mjete si më poshtë: Motoçikleta – 3,756,840 lekë; Autovetura – 3,686,400 lekë; Furgonçina – 16,889,208 lekë; Pra, në total rezulton se AK në përfundim të afatit të kontratës së qirasë do të kishte në dispozicion të tij asete me vlerë kontabël 24,332,448 lekë. Përveç kësaj, rezulton se pa u mbështetur në një historik konkret, Grupi i Punës ka përlllogaritur për variantin e blerjes, shpenzime për kryerjen e shërbimeve periodike. Konkretisht rezulton se në përlllogaritje janë përfshirë pajisje kamera dhe sistemi GIS, të dyja këto në shumën prej 67,000 lekë/makine për 4 vite, ose shuma prej 1,407,000 lekë pa TVSH. Njëkohësisht nga ana e këtij Grupi Pune është përlllogaritur shuma prej 114,720 lekë pa TVSH/vit x mjet, ose në total për 21 furgonçina shuma prej 9,636,480 lekë pa TVSH, parashikim ky jo plotësisht i argumentuar, kjo pasi vetë blerja e sistemit së bashku me kamerat është parashikuar në shumën prej 67,000 lekë/mjet. Nga verifikimi i kilometrave të përshkruara nga mjetet e marra me qira nga fillimi i kontratës e deri aktualisht rezulton se autoveturat, furgonçinat dhe motoçikletat në pjesën më të madhe të tyre kanë përshkruar më pak kilometra nga sa janë parashikuar³. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 1 “*Objekti dhe qëllimi*”, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për një vlerësim të saktë të leverdishmërisë së investimeve të kryera për punë/mallra shërbime me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve siç është i rastit të kontratës me objekt “*Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite*” me vlerë **96,009,900 lekë pa TVSH**.

Përgjigjja e institucionit:

Administratori Shoqërisë “Posta Shqiptare” SH.A., me anë të Urdhrit të brendshëm Nr.42 datë 22.05.2024 ka ngritur grupin e punës “Për analizën e Kostos dhe efikasitetin procedural për procedurën e prokurimit me objekt” Leasing për automjete dhe motorcikleta”. Me relacionin Nr.1074/1 prot., datë 01.07.2024 grupi i punës paraqiti relacionin për “Analizën e Kostos dhe Efikasitetin për procedurën e prokurimit me objekt “Leasing për automjete dhe motorcikleta”. Grupi i punës ka analizuar se kjo procedurë është më efikase duke përdorur Leasing Operacional.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

³ Aneksi 2.3.7

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt “*Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë*”, viti 2020 rezultoi se në përgjithësi punimet janë kryer me një cilësi të dobët duke bërë që investimi të paraqesë shenja shumë të hershme amortizimi, kjo më shumë në rifiniturat për shkak kryesisht të mos marrjes së masave kundër shkaktarëve të lagështisë. Dyert nuk janë vendosur të cilësisë së parë dhe druri duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të punimeve të mos respektohen kërkesat e projektit për një shumë totale prej 740,432 lekë pa TVSH për 84.14 m² dyer të realizuara. Gjithashtu, për sa i takon dritareve dhe dyerve rezultoi se nuk janë realizuar me material plastik por me alumin të thjeshtë duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të punimeve të mos respektohen kërkesat e projektit dhe preventivit për një shumë totale prej 1,248,296 lekë pa TVSH për dritaret dhe dyert e realizuara. Për rrjedhojë rezultoi se janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet fondet në shumën prej 1,988,728 lekë pa TVSH. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 7/1, neni 12, VKM me nr. 629 datë 15.05.2015 “*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*”, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu II, Pika 8.1 dhe Pika 8.3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 135 prot., datë 30.03.2020 si dhe me kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të kontratave të punimeve për të siguruar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale e duke shmangur kështu përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve siç është ai në rastin e kontratës me objekt “*Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë*” me BOE A & B ku rezultoi se nuk janë respektuar specifikimet teknike për dy zëra punimesh në shumën prej **1,988,414 lekë pa TVSH**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*” i ndryshuar, nga ana e Posta Shqiptare Sh.A., për procedurat në vijimësi të ngjashme me objektin e rekomandimit, janë marrë masa për ngritjen e grupeve të punës sipas specifikës të anëtareve sipas pozicionit të punës dhe arsimit përkatës, si dhe duke kryer detyrat e ngarkuara dhe duke lënë detyra për tu përmbushur sipas detyrimeve kontraktuale nga ana e operatorit ekonomik, vërtetuar kjo me Urdhrin Nr.54., datë 24.06.2024., Nr.1314 prot., datë 24.06.2024., detyrat e lëna nga grupi i punës për riparimin e punimeve në zbatim të kontratës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

3. Gjetje nga Auditimi: Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “*Mirëmbajtja e Data Center*”, nuk është marrë në konsideratë menaxhimi i duhur i burimeve të shoqërisë,

ku grupi i auditimit gjykon që pjesët hardw­are dhe sistemet e m­esip­ërme mund t­ë menaxhohen dhe mir­ëmbahen nga vet­ë specialist­t­et e institucionit si dhe gjat­ë zhvillimit t­ë procedur­ës s­ë prokurimit, n­ë p­ërlllogaritjen e fondit limit nuk jan­ë marr­ë n­ë konsiderat­ë çmimet e pajisjeve që do t­ë mbulohen me mir­ëmbajtje, duke kaluar çmimin e tyre t­ë blerjes. P­ër sa m­ë sip­ër nga ana e shoq­ëris­ë konstatohet se jan­ë p­ërdorur n­ë kund­ërshtim me parimet e efektivitetit, ef­iç­enc­ës dhe ekonomikitetit vlera prej **11,898,000 lek­ë**. Sa m­ë sip­ër ­është n­ë kund­ërshtim me VKM nr. 285, dat­ë 19.5.2021 “P­ër Miratimin E Rregullave T­ë Prokurimit Publik”, neni 13 “Neni 13 “Studimi paraprak i tregut”.

(M­ë holl­ësisht trajtuar n­ë pik­ën 3 faqet nr. 51 – 118 t­ë Raportit P­ërfundimtar t­ë Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Organet drejtuese t­ë shoq­ëris­ë Posta Shqiptare, gjat­ë alokimit t­ë burimeve t­ë shoq­ëris­ë, t­ë marrin n­ë konsiderat­ë p­ërdorimin e 3E, duke p­ërdorur burimet e shoq­ëris­ë p­ër kryerjen e detyrave dhe arritjen e objektivave t­ë shoq­ëris­ë.

N­ë vijim­ësi

P­ërgjigjja e institucionit:

Nuk ­është marr­ë asnj­ë mas­ë p­ër zbatimin e k­ëtj rekomandimi.

Komenti i grupit t­ë auditimit.

P­ër sa m­ë sip­ër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

4. Gjetje nga Auditimi: Gjat­ë zhvillimit t­ë procedur­ës me objekt “Mir­ëmbajtja e Moduleve t­ë Etern­ës (Finance-kontabilitet, Burimet njer­ëzore, Magazina, Help Desk) p­ër 4 vite”, dat­ë 31.05.2019, nga auditimi rezulton se zhvillimi i mir­ëmbajtjes p­ër modulet n­ë fjal­ë nuk ­është i nevojsh­ëm dhe mund t­ë mbulohet nga specialist­t­et e IT s­ë institucionit, duke marr­ë n­ë konsiderat­ë dhe modulet ose aplikacionet e tjera që zhvillohen pran­ë institucioneve t­ë tjera t­ë cil­ët mir­ëmbahen nga vet­ë specialist­t­et e institucioneve pas zhvillimit t­ë trajnimeve. P­ër sa m­ë sip­ër nga ana e shoq­ëris­ë konstatohet se jan­ë p­ërdorur n­ë kund­ërshtim me parimet e efektivitetit, ef­iç­enc­ës dhe ekonomikitetit vlera prej **9,450,000 lek­ë**. Sa m­ë sip­ër ­është n­ë kund­ërshtim me Ligji nr. 10 296, dat­ë 8.7.2010 “P­ër Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin”. (M­ë holl­ësisht trajtuar n­ë pik­ën 3 faqet nr. 51 – 118 t­ë Raportit P­ërfundimtar t­ë Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Organet drejtuese t­ë shoq­ëris­ë Posta Shqiptare, gjat­ë alokimit t­ë burimeve t­ë shoq­ëris­ë, t­ë marrin n­ë konsiderat­ë p­ërdorimin me efektivitet, ef­iç­enc­ë dhe ekonomikitet t­ë fondeve, duke p­ërdorur burimet e shoq­ëris­ë p­ër kryerjen e detyrave dhe arritjen e objektivave t­ë shoq­ëris­ë.

N­ë vijim­ësi

P­ërgjigjja e institucionit:

Nuk ­është marr­ë asnj­ë mas­ë p­ër zbatimin e k­ëtj rekomandimi.

Komenti i grupit t­ë auditimit.

P­ër sa m­ë sip­ër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

5. Gjetje nga Auditimi: Gjat­ë zhvillimit t­ë procedur­ës me objekt “Blerje Biznes Hub”, m­ë dat­ë 14.05.2021, n­ë p­ërb­ërje t­ë objektit dhe specifikimeve t­ë cil­ësuar­ë n­ë dokumentet standard­ë t­ë procedur­ës s­ë prokurimit, cil­ësohen modifikime t­ë moduleve ekzistuese t­ë Etern­ës, p­ër t­ë cil­ët ­është zhvilluar procedur­ë p­ër mir­ëmbajtjen dhe modifikimin e moduleve ekzistuese. P­ër sa m­ë sip­ër nga ana e shoq­ëris­ë konstatohet se jan­ë p­ërdorur n­ë kund­ërshtim me parimet e efektivitetit, ef­iç­enc­ës dhe ekonomikitetit vlera prej **25,000,000 lek­ë**. Sa m­ë sip­ër ­është n­ë kund­ërshtim me Ligji nr. 10 296, dat­ë 8.7.2010 “P­ër Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin”. (M­ë holl­ësisht trajtuar n­ë pik­ën 3 faqet nr. 51 – 118 t­ë Raportit P­ërfundimtar t­ë Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë, të kryejnë një analizë të hollësishme lidhur me shtimin dhe modifikimin e moduleve, të cilat janë objekt i procedurave të mëparshme të prokurimeve dhe detyrë e O.E. fitues i procedurave të mëparshme të Eternës, si dhe të kryejnë një analizë kosto përfitim në lidhje me shtimin e moduleve të tilla, pasi mirëmbajtja e tyre rrit kostot e shoqërisë.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtoria e IT ka paraqitur relacion mbi këtë rekomandim ku shpjegon se kush është qëllimi dhe funksionimi i teknologjisë, por nuk ka një analize kosto përfitim.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

6. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “*Blerje bojëra teknologjike dhe lëndë pastrimi teknologjike për Hibrid Mail*”, më datë 30.09.2022, për një vlerë prej 12,580,000 lekë pa TVSH, nga i njëjti operator ekonomik, vlerë e cila nuk e mbulon fitimin e përdorimit të sistemit gjatë kësaj periudhe, pasi sistemi “Hibrid Mail” pothuajse nuk ka funksionuar. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit vlera prej **12,580,000 lekë**. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë, gjatë menaxhimit të burimeve të shoqërisë si dhe zhvillimit të sistemeve të reja të kryejnë një analizë kosto përfitim të detajuar duke shmangur përdorimin e fondeve pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

“Posta Shqiptare” sh.a. është një shoqëri tregtare me kapital 100% shtetëror. Fusha e objektit të veprimtarisë përfshin shërbimet postare dhe shërbimet financiare jo bankare. Krahas disa fushave ku Posta Shqiptare vepron sipas legjisllacionin në fuqi dhe autorizimeve përkatëse, në vijim të parashikimeve të Ligjit Nr. 46/2015, “*Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë*”, ku ndër të tjera është parashikuar si objekt i veprimtarisë edhe ofrimi i shërbimit të “Hybrid Mail”, shërbim i cili ofrohet nga të gjithë operatorët postar në rajon.

Në këtë kuadër edhe Shoqëria Posta Shqiptare Sh.a, ka implementuar me sukses projektin “Hybrid Mail”, i cili funksionon si Filial i Postës Shqiptare, ky Filial në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Posta Shqiptare Sh.A, për periudhën Nëntor 2022 – Gusht 2023, ka arritur të realizojë me sukses lidhjen e kontratave të shërbimit me :

- *Ujësjes Kanalizime Korçë*
- *Ujësjes Kanalizime Fier*
- *Ujësjes Kanalizime Sarandë*
- *Ujësjes Kanalizime Elbasan*
- *Ujësjes Kanalizime Tiranë*

Gjithashtu, është nënshkruar edhe kontrata mes palëve “Posta Shqiptare” Sh.a dhe “Furnizuesi Shërbimit Universal” (FSHU), me objekt printim, zarfim dhe shpërndarje.

Në total Filiali Hybrid Mail ka arritur kapacitetin e prodhimit rreth 3.000.000 fatura në muaj, e përkthyer në vlerë kontrate, parashikohet që të ardhurat për vitin ushtrimor 2024 për këtë Filial të jenë në masën 70.000.000 (shtatëdhjetë milion) lekë, duke e kthyer në një projekt të suksesshëm të Shoqërisë posta Shqiptare Sh.A. (Bashkelidhur kontratat e Filialit Hibrid Mail)

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kancelari dhe zarfa”, rezulton se fondi limit nuk është përlogaritur sipas kërkesave të LPP dhe akteve nënligjore në fuqi. Nga auditimi rezulton se:

- Autoriteti Kontraktor Posta Shqiptare ka zhvilluar tender për blerjen kancelari dhe zarfa me objekt dhe specifikime teknike të njëjta në vitin 2021 me procedurën e vitit 2022.

- Në kontratën e vitit 2021 me nr. 939/33 prot., datë 17.11.2021 “Blerje kancelari dhe zarfa”, 29 artikuj të saj, kanë specifikime teknike të njëjta me artikujt e procedurës së prokurimit të zhvilluar në vitin 2022.

- Grupi i punës për përlogaritjen e fondit limit, nuk ka përfshirë çmimet për njësi të këtyre 29 artikujve të kontratës së vitit 2021 në prokurimin e vitit 2022.

- Fondit limit i përlogaritur nga AK është miratuar në shumën 40,577,848 lekë pa TVSH, kundrejt atij të përlogaritur nga grupi i auditimit të KLSH në shumën 20,173,165 lekë pa TVSH, pra AK Posta Shqiptare ka rritur artificialisht FL me 201 %, ose vlerën prej **20,404,683 lekë pa TVSH**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohen në procedurat e prokurimit publik, dhe të marrë masa për anëtarët e njësisë së përlogaritjes së fondit limit të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur artificialisht Fondin Limit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nga ana e Posta Shqiptare Sh.A., janë marrë masa për pjesmarrjen në programe trajnimi, vërtetuar kjo me shkresën e ardhur Nr. 393 prot., datë 19.02.2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe është ***zbatuar***.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)”, rezulton se fondi limit nuk është përlogaritur sipas kërkesave të LPP dhe akteve nënligjore në fuqi.

Nga Auditimi rezulton se:

- Autoriteti Kontraktor Posta Shqiptare ka zhvilluar tender me të njëjtin objekt prokurimi edhe në vitin 2021, duke lidhur kontratën nr. 2575/40 prot., datë 17.06.2021 me objekt “Blerje letër fotokopje A4”, dhe kontratën nr. 2575/41 prot., “Blerje letër traktor (3 kopje) A5, A4” datë 17.06.202.

- Grupi i punës për përlogaritjen e fondit limit nuk ka përfshirë çmimet për njësi të artikujve letër fotokopje A4 dhe atyre të letrës traktor (3 kopje) A5, A4 të kontratës të lidhur në vitin 2021, të cilat kanë patur specifikime teknike të njëjta me specifikimet e kërkuara nga AK në procedurën e prokurimit të vitit 2022.

- Në zbatim të LPP dhe akteve nënligjore në fuqi, grupi i auditimit të KLSH bëri përlllogaritjen e fondit limit duke përfshirë dhe çmimet për njësi të artikujve letër fotokopje A4 dhe letër traktor (3 kopje) A5 dhe A4.

Si rezultat FL i përlllogaritur nga grupi i auditimit të KLSH është në shumën 42,064,659 lekë pa TVSH. Ndërkohë që AK Posta Shqiptare Fondin limit e ka përlllogaritur dhe miratuar në shumën 62,891,062 lekë, pa TVSH pra me një diferencë prej **20,826,403 lekë pa TVSH**.

Për sa më lart, AK ka rritur artificialisht me 150% Fondin Limit për procedurën me objekt “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)”

Grupi i auditimit të KLSH, në përlllogaritja e Fondin Limit të kësaj procedure ka përfshirë përveç çmimeve të studimit të tregut edhe çmimet e artikujve të Kontratës nr. 2575/40 prot., Kontratës Nr. 2575/41 prot., datë 17.06.2021 me objekt “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)” të paraqitur në tabelën nr. 2., aneksi 2.3.2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohen në procedurat e prokurimit publik, dhe të marrë masa për anëtarët e njësisë së përlllogaritjes së fondit limit të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur artificialisht Fondin Limit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nga ana e Posta Shqiptare Sh.A., janë marrë masa për pjesmarrjen në programe trajnimi, vërtetuar kjo me shkresën e ardhur Nr. 393 prot., datë 19.02.2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar**.

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi procedurës së prokurimit me objekt “Blerje tonera, bojëra printer”, rezulton se fondi limit nuk është përlllogaritur sipas kërkesave të LPP dhe akteve nënligjore në fuqi. Nga Auditimi rezulton se AK ka lidhur kontratën nr. 635/46 prot., datë 15.02.2021 me objekt “Blerje tonera dhe bojëra printeri”, nga ku 10 artikuj nga 14 artikuj të kërkuar në procedurën e prokurimit mbi bazën e Urdhri i Prokurimit nr. 17 prot., datë 26.10.2022 kanë specifikime teknike dhe Part/Number të njëjtë. Grupi i KLSH mbi bazën e çmimeve të ofertave të OE dhe çmimeve koresponduese të artikujve të kontratës së mëparshme bëri përlllogaritjen e Fondit limit. Fondi Limit i përlllogaritur nga grupi i KLSH rezultoi në shumën 11,376,988 lekë. Për sa më lart, AK ka përlllogaritur Fondin Limit në shumën 14,717,900 lekë duke e rritur artificialisht me 29 % më shumë se vlera e Fondit Limit, e përlllogaritur nga grupi i auditimit të KLSH. Pra **3,340,912 lekë pa TVSH** më tepër.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohen në procedurat e prokurimit publik, dhe të marrë masa për anëtarët e njësisë së përlllogaritjes së fondit limit të cilët kanë vepruar në

mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur artificialisht Fondin Limit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nga ana e Posta Shqiptare Sh.A., janë marrë masa për pjesmarrjen në programe trajnimi, vërtetuar kjo me shkresën e ardhur Nr. 393 prot., datë 19.02.2024.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është **zbatuar**.

10. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kontraktuesi nuk ka zbatuar kushtet e kontratës për afatin e dorëzimit të letrës traktor A5 me 3 kopje në masën 25 % të sasisë, të cilën duhej ta dorëzonte pranë AK Posta Shqiptare brenda datës 23.05.2023, kjo pasi është dorëzuar gjithë sasia e mallit letër A5 traktor me 3 kopje më datë 15.08.2023, pra 84 ditë me vonesë nga afati i përcaktuar në kontratën nr. 1637/92 prot., datë 23.03.2023. Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka mbajtur proces verbal për dorëzimin me vonesë të letrës traktor A5 si pjesë e mallit të kontratës dhe nga ana e Drejtorisë Ekonomike të Postës Shqiptare nuk është llogaritur penalitetet për këtë mall, duke e paguar tërësisht faturën tatimore nr. 156/2023 datë 15.08.2023 të kontraktuesit A CO. Bazuar në kushtet e kontratës, Letra A5 “Traktor” (3 kopje) si pjesë e mallit objekt kontrate duhet që sasia prej 25 % të dorëzohej brenda datës 23.05.2023. Në referim të nenit 21 të kontratës “Penalitet”, parashikohet se: “*Penalitetet për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarife ditore 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i kontratës, por jo me pak se 25 % e vlerës së kontratës.* Për sa më lart, Kontraktuesi A CO ka dorëzuar mallin letër A5 traktor (3 kopje) me 84 dite vonesë nga përcaktimi në DTS dhe kontratën e lidhur midis palëve. Meqenëse ky zë i Kontratës për artikullin me emërtimin letër A5 traktor (3 kopje) është lëvruar në sasinë totale më datë 15.08.2023., për të llogaritur penalitetin është marrë vlera minimale e këtij zëri në shumën 25% të saj. Vlera e letrës A5 Traktor (3 kopje) është në shumën 7,841,160 lekë. Vlera e përllogaritur e penalitetit është në shumën $(1,960,290 * 0.004) * 84 = 658,657$ lekë, vlerë kjo e cila përbën përdorim pa efektivitet eficient dhe ekonomikitet të fondeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren për masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin e kontratave me qëllim identifikimin e rasteve në të cilat kontraktorët nuk respektojnë afatet e parashikuara.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në cilësinë e AK, Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me Urdhër të titullarit të AK, kryen ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e kontratave ose grupet e marrjes në dorëzim sipas objektit të kontratave, të cilët kanë detyrimin ligjor për zbatimin e tyre. Rast pas rasti, në zbatim të Urdhrave të ngarkuar dhe kontratave, grupet e punës përgatisin materialin shoqërues për ekzekutimin e tyre, ku, në ato raste në të cilat ka pasur vonesa, është aplikuar penaliteti për vonesën e shaktuar sipas akteve në fuqi.

Bashkëlidhur informacioni për penalitetet e aplikuar për vonesën në zbatim kontrate nga Drejtoria Ekonomike (Printscreen A N, Dr Ekonomike).

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nga ana e Posta Shqiptare Sh.A., për procedurat në vijimësi të ngjashme me objektin e rekomandimit, janë marre masa për ngritjen e grupeve të punës sipas specifikës të anëtarëve sipas pozicionit të punës dhe arsimit përkatës, si dhe duke kryer detyrat e ngarkuara dhe duke lënë detyra për tu përmbushur sipas detyrimeve kontraktuale nga ana e operatorit ekonomik, vërtetuar kjo me Urdhrin Nr.54., date 24.06.2024., Nr. 1314 prot., datë 24.06.2024., detyrat e lëna nga grupi i punës për riparimin e punimeve në zbatim të kontratës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

11. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje tonera, bojëra printer” rezulton se kontraktuesi nuk ka respektuar afatet kohore gjatë dorëzimit të bojërave dhe tonerave për printer. Konkretisht, në zbatim të kushteve të kontratës kontraktuesi duhej të dorëzonte pranë magazinës së Postës Shqiptare brenda datës 02.06.2023 të paktën 25 % të çdo artikuj sipas përcaktimeve të DST. Më datë 07.07.2023, nga ana e audituesve të KLSH u krye një verifikim fizik pranë magazinës së Postës Shqiptare dhe kanë mbajtur Akt verifikimi nr. 1 me punonjësen përgjegjëse të materialeve, nga ku u konstatua se nga ana e Kontraktuesit nuk ka filluar lëvrimiti i mallit për sasinë 25 % për çdo artikull brenda 45 ditëve. Akt verifikimi nr. 1 është protokolluar në Posta Shqiptare me nr. 909/2 prot., datë 12.07.2023. Nga Komisioni i marrjes në dorëzim nuk është mbajtur proces verbal në lidhje me mosrespektimin e kushteve të kontratës dhe nuk është informuar Administratori për mos respektimin e kushteve të kontratës nga ana e Kontraktuesit në lidhje me afatet e lëvrimit të mallit. Për mos zbatim të kushteve të kontratës deri në datën e mbajtjes së akt verifikimit, nga KLSH rezulton se kontraktuesi nuk e ka dorëzuar mallin për 36 ditë kalendarike. Penaliteti për vonesë të lëvrimit nga kontraktuesi është $(0.25 * 5,212,900) * 0.004 * 36 = 187,664$ lekë, vlerë kjo e cila përbën përdorim pa efektivitet eficient dhe ekonomikitet të fondeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren për masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin e kontratave me qëllim identifikimin e rasteve në të cilat kontraktorët nuk respektojnë afatet e parashikuara.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në cilësinë e AK, Posta Shqiptare Sh.A., në zbatim të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me Urdhër të titullarit të AK, kryen ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e kontratave ose grupet e marrjes në dorëzim sipas objektit të kontratave, të cilët kanë detyrimin ligjor për zbatimin e tyre. Rast pas rasti, në zbatim të Urdhrave të ngarkuar dhe kontratave, grupet e punës përgatisin materialin shoqëruar për ekzekutimin e tyre, ku, në ato raste në të cilat ka pasur vonesa, është aplikuar penaliteti për vonesën e shaktuar sipas akteve në fuqi.

Bashkëlidhur informacioni për penalitetet e aplikuara për vonesën në zbatim kontrate nga Drejtoria Ekonomike (Printscreen A N , Dr Ekonomike).

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nga ana e Posta Shqiptare Sh.A., për procedurat në vijimësi të ngjashme me objektin e rekomandimit, janë marre masa për

ngritjen e grupeve të punës sipas specifikës të anëtarëve sipas pozicionit të punës dhe arsimit përkatës, si dhe duke kryer detyrat e ngarkuara dhe duke lënë detyra për tu përmbushur sipas detyrimeve kontraktuale nga ana e operatorit ekonomik, vërtetuar kjo me Urdhrin Nr.54., date 24.06.2024., Nr.1314 prot., datë 24.06.2024., detyrat e lëna nga grupi i punës për riparimin e punimeve në zbatim të kontratës.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

12. Gjetje nga auditimi. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “*Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë*” rezulton se specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke mos përshtuar minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së për të vlerësuar mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara e për rrjedhojë janë hartuar të tilla që nuk kanë krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve si rrjedhojë e arsyeve të sipërpërmendura. Referuar LPP është saktësuar fakti se specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik dhe ato duhet ti referohen standardeve kombëtare, ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato duhet t’u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare. Kërkesat e bëra nuk janë bërë plotësisht në terma funksionalë pasi nuk janë ta argumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Grupi i auditimit ka kryer një analizë të kritereve të vendosura në raport me ato të përmbushura në ana e OE fitues të cilat, në gjykim të grupit krijohet një dyshim i arsyeshëm e i mbështetur në argumente konkrete mbi paracaktimin e OE fitues përmes vendosjes së specifikimeve teknike fikse të paargumentuara dhe që nuk lidhen me ndonjë domosdoshmëri konkrete me nevojat e AK. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 20, “*Mosdiskriminimi*”, neni 23, “*Specifikimet teknike*”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 27, “*Kontratat e mallrave*” pika 1 dhe pika 3.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive për mosvënien në përdorim të këtij investimi me vlerë **47,500,000 lekë pa TVSH** si dhe për shfrytëzimin e këtij aseti për qëllimin për të cilin është blerë.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Me Urdhrin Nr.30 datë 18.02.2022 është urdhëruar vënia në funksion e kutive postare elektronike. Janë hartuar dhe relacione për tarifrat për përdorimin e këtyre kutive.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

13. Gjetje nga Auditimi: Nga analiza e llogarisë 638 “Penalitete dhe dëmshpërblime”, për vitin 2021, shpenzimet për dëmshpërblime, kryesisht për largimet nga puna, që shoqëria ka

kryer për shkak të vendimeve të formës së prerë të gjykatave, janë vlerësuar në vlerën gjithsej prej 10,302,400 lekë si më poshtë:

- Me Vendimin nr. 36, datë 11.02.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin z. A K, si dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi i paditësit është kryer me numër dokumenti 442, datë 11.03.2021 në vlerën prej 1,568,134 lekë.

- Me Urdhrin e Sekuestros nr. 14483, datë 25.06.2021 është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin z. A K dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi është kryer me numër dokumenti 1122, datë 29.06.2021 në vlerën prej 854,700 lekë.

- Me Vendimin nr. 163, datë 08.06.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin z. R M, si edhe dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi është kryer me numër dokumenti 4278, datë 05.10.2021 në vlerën prej 1,663,801.60 lekë.

- Me Vendimin nr. 23, datë 01.02.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin Sindikatën e Pavarur të Industrisë, Energjetikës të Shqipërisë, si edhe dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi i paditësit është kryer me numër dokumenti 769, datë 17.06.2021 në vlerën prej 6,215,765 lekë. Nga vendimet e gjykatave, sa më sipër, ndërprerjet e marrëdhënieve të punës të ish-punonjësve kanë rezultuar në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi Punës i Republikës të Shqipërisë, i ndryshuar, për shkak të ndryshimeve të njëanshme të kushteve të përgjithshme të kontratës individuale të punës, nga ana shoqërisë Posta Shqiptare SHA. Për sa më sipër, në kundërshtim me pikën 4, neni 5 të Vendimit nr. 11, datë 15.01.2018 të Asamblesë të Aksionarit “Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e shoqërisë Posta Shqiptare SHA”, Administratori i Shoqërisë nuk ka propozuar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës mbi largimin e drejtuesve me nivel kombëtar përgjegjësie, siç është rasti i largimit të Drejtorit të Shërbimeve Bankare dhe Financiare në Drejtorinë e Përgjithshme, me Urdhrin nr. 28, datë 31.01.2018. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës në Vendimin nr. 13, datë 29.05.2020 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH” ka analizuar rastet e largimeve nga puna dhe ka ngarkuar administratorin dhe drejtoritë përkatëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi. Sa më sipër, shoqëria nuk ka hartuar një plan veprimi për reagimin dhe raportimin sipas vendimit të sipërcituar, si edhe nuk ka nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për shpenzimet e kryera, të cilat rezultojnë si shpenzime me efekt financiar negativ. Sa më sipër, bie në kundërshtim me pikën 14.6, neni 14 i statutit të shoqërisë Posta Shqiptare SHA. Parregullsitë sa më sipër, kanë shkaktuar shpenzime me **efekt negativ financiar** gjithsej në vlerën prej **10,302,400 lekë**, në formën shpenzimeve të përsëritura për të njëjtin vend pune, në dëm të shoqërisë Posta Shqiptare SHA. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 14.6, neni 14 të statutit të Postës Shqiptare SHA si dhe me pikën 4 neni 5, të Vendimit nr. 11, datë 15.01.2018 të Asamblesë të Aksionarit “Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e shoqërisë Posta Shqiptare SHA”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë Posta Shqiptare SHA të analizohen shpenzimet e dëmshpërblimeve për shkak të ndërprerjeve të njëanshme të marrëdhënieve të punës dhe të përcaktohen personat shkaktarë përgjegjës. Administratori i shoqërisë të marrë masat e nevojshme për mundësinë e kompensimit të këtyre fondeve në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara ligjore.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit.

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues provues të statusit të zbatimit të rekomandimit, ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

14. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me blerjet e vogla konstatohet se referuar urdhrin nr. 194 datë 17.07.2019 për udhëtimet e disa punonjësve të Posta Shqiptare SHA jashtë shtetit, nga zyra e financës klasifikimi i shpenzimeve të paradhënies është kryer njëjloj për çdo pozicion pune. Ky urdhër nuk është argumentuar sipas VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” referuar dokumentacionit të sjellë me observacionin nr. 909/59 prot., datë 06.10.2023, sepse klasifikimi i kryer për çdo person udhëtues është i njëjti për çdo pozicion pune, duke nisur nga pozicioni i administratorit, drejtori drejtorisë, kryetar dege dhe këshilltar. Si rrjedhojë në VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, nuk përcaktohet që paradhënia për klasifikimet e pozicioneve të mësipërme të jetë e njëjtë. Për këtë arsye nuk justifikohen shpenzimet e udhëtimit referuar urdhrave të paradhënies. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe Udhëzimi nr. 22 datë 10.07.2013 i Ministrisë së Financave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Nga administratori i Posta Shqiptare SHA dhe zyra e financës të analizohet vlera e efektit financiar negativ prej **6,434 euro** dhe të merren masa për korrigjimin e praktikave të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë shtetit, pa dokumentacion justifikues.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Drejtoria ekonomike me shkresën Nr.134/13, prot.,datë 14.06.2024 ka dhënë sqarimet përkatëse për analizimin e vlerës me efekt negativ financiar.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti *i zbatuar*.

15. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me blerjet e vogla konstatohet se referuar urdhrin nr. 199 datë 07.08.2019 për udhëtimet e disa punonjësve të Posta Shqiptare SHA jashtë shtetit, nga zyra e financës klasifikimi i shpenzimeve të paradhënies është kryer njëjloj për çdo pozicion pune. Ky urdhër nuk është argumentuar sipas VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” referuar dokumentacionit të sjellë me observacionin nr. 909/59 prot., datë 06.10.2023, sepse klasifikimi i kryer për çdo person udhëtues është i njëjti për çdo pozicion pune, duke nisur nga pozicioni i administratorit, drejtori drejtorisë, kryetar dege dhe këshilltar. Si rrjedhojë në VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, nuk përcaktohet që paradhënia për klasifikimet e pozicioneve të mësipërme të jetë e njëjtë. Për këtë arsye nuk justifikohen shpenzimet e udhëtimit referuar urdhrave të paradhënies. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe Udhëzimi nr. 22 datë 10.07.2013 i Ministrisë së Financave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Nga administratori dhe zyra e financës të shoqërisë Posta Shqiptare SHA të analizohet vlera e efektit financiar negativ prej **3,145 euro** dhe të merren masa për korrigjimin e praktikave të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë shtetit, pa dokumentacion justifikues.

Përgjigjja e institucionit:

Drejtoria ekonomike me shkresën Nr.135/13, prot.,datë 14.06.2024 ka dhënë sqarimet përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

D. MASA DISIPLINORE:

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 - Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Statutit të Shoqërisë si dhe Kontratës kolektive për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare SHA, kërkojmë nga Këshilli Mbikëqyrës si dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i institucionit të Posta Shqiptare SHA fillimin e procedurave për dhënie masash disiplinore për punonjësit të cilët janë konstatuar me shkelje nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit si më poshtë:

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për

z. **A D** në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA:

- Për mangësitë e konstatuara në praktikën me objekt “*Blerje e vendosje sisteme të integruara të sigurisë (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi CH4, CH8, CH16), sisteme inteligjente (SMART) të sigurisë CH4, CH8, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit*”;
- Për mos marrjen e masave të nevojshme për vënien në përdorim të investimit të kryer sipas kontratës me objekt “*Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë*”, për të cilën AK ka lidhur kontratën përkatëse me vlerë **47,500,000 lekë pa TVSH**. Konkretisht për pajisjet objekt kontrate rezultoi se asnjë nga pajisjet nuk është funksionale me argumentimin e dhënë nga grupi i ndjekjes kontratës se i ka mbaruar afati sistemit Cloud, sistem ky i domosdoshëm për funksionim e pajisjeve MAK;
- Për mos marrjen e masave të nevojshme për vënien e plotë në përdorim të investimit të kryer sipas kontratës me objekt “*Blerje kuti postare restante dhe kuti postare për klientë*”, për të cilën AK ka lidhur kontratën përkatëse me vlerë **7,572,000 lekë pa TVSH**. Konkretisht për pajisjet objekt kontrate, pas një inspektimi në terren rezultoi se disa nga pikat ku janë montuar kutitë postare sipas proces-verbalit bashkangjitur dosjes së prokurimit, shumë prej tyre në hyrjet e pallateve nuk ishin funksionale pasi nuk përmbanin as emrin dhe as nr. e apartamentit të banorëve dhe njëkohësisht Administratorët e pallateve nuk dispononin kopje të çelësave për aksesimin e kutive postare;
- Për miratimin e fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje kancelari dhe zarfa*” në kundërshtim me kuadrin ligjor e rregullator të prokurimit publik e me pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **20,404,683 lekë pa TVSH**;
- Për mangësitë e konstatuara në drejtim të programeve ekonomiko – financiare për periudhën takuese të drejtimit të institucioni;
- Për mangësitë e konstatuara nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Mirëmbajtja e Data Center*”, viti 2022 nga ku rezultoi se nga ana e AK Posta Shqiptare SHA gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit për mirëmbajtjen e Data Center nuk është marrë në konsideratë menaxhimi i duhur i burimeve të shoqërisë, pasi pjesët hardware dhe sistemet e objekt kontrate mund të ishin menaxhuar dhe mirëmbajtur nga vetë specialistët e institucionit. Gjithashtu, po në këtë praktikë rezultoi se gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, në përlllogaritjen e fondit limit nuk janë marrë në konsideratë çmimet e pajisjeve që do të

mbulohen me mirëmbajtje, duke bërë që kostoja e mirëmbajtje të kalojë edhe çmimin përkatës të blerjes;

- Mos kryerjen e një analize të detajuar kosto – përfitim gjatë ushtrimit të funksionit të Drejorit të Përgjithshëm për Posta Shqiptare SHA, përpara zhvillimit të procedurave të prokurimit për periudhën 2019 – 2022, të fituara nga një OE i vetëm H S, me vlerë totale të kontratave të lidhura në shumën prej 178,150,000 lekë pa TVSH;

- Për mangësitë e konstatuara nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje Hibrid Mail*”, për të cilën rezultoi se jo vetëm që nuk është kryer një analizë kosto përfitim për një menaxhim sa më efektiv të shpenzimeve në mospërputhje me praktikat më të mira, por përkundrazi rezultoi se nga momenti që është vënë në përdorim deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit, kontratat e lidhura nga AK Posta Shqiptare SHA me subjektet e tjera, janë minimale në vlerë dhe nuk sjellin përfitime për përdorimin e një sistemi të tillë. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2022 është realizuar dhe një procedurë prokurimi për mirëmbajtjen e sistemit në fjalë me bojëra teknologjike, për një vlerë prej **12,580,000 lekë pa TVSH**, nga i njëjti operator ekonomik S C, vlerë e cila nuk e mbulon fitimin e përdorimit të sistemit gjatë kësaj periudhe. Njëkohësisht, nga auditimi rezultoi se e njëjta procedurë prokurimi është zhvilluar dhe gjatë vitit 2023 për një vlerë prej **11,599,165 lekë pa TVSH**;

- Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit të dispozitave ligjore që rregullon strukturën organizative dhe dhënien e pagave dhe shpërblimeve të institucionit. Konkretisht në këtë drejtim rezultoi se:

a. *Nuk ka gjurmë në asnjë rast në burimet njerëzore, për nevojat e sektorëve apo drejtorive*

b. *Në shoqërinë Posta Shqiptare SHA nuk ekziston një procedurë rekrutimi të punonjësve;*

c. *Deri në përzgjedhjen e tyre nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura;*

d. *nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar hapat që ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.*

e. *Përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj.;*

f. *Për disa pozicione pune nuk është përcaktuar kriteri i arsimit si domosdoshmëri për përmbushjen e funksionit të detyrave të pozicionit të punës.*

- Për mangësitë e konstatuara në drejtim të menaxhimit financiar dhe kontrollit;

- Për mangësitë e konstatuara në drejtim të detyrimeve të institucionit për sa i takon pagesave të kryera si rrjedhojë e largimeve të padrejta nga puna;

- Mos marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm;

- Etj.

“*Vërejtje*” deri në “*Largim nga puna*” sipas nivelit të përgjegjësisë dhe shkeljeve për punonjësit e poshtë shënuar:

1. A S

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të hartimit të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje tonera dhe bojëra printeri*” me pasojë përdorim pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **3,340,912 lekë pa TVSH**;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit të kontratës me objekt “*Blerje kuti postare restante dhe kuti postare për klientë*”;

2. A V

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë;

3. A K

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të hartimit të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje tonera dhe bojëra printeri”* me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **3,340,912 lekë pa TVSH**

4. A V

Për mangësitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Tiranë, Durrës, Qendra Tranzite, Ndryshime ndarjesh për shkak të ndryshimit të strukturës dhe Ndryshimi i ndriçimit nga floureshent në led (322 copë) në Godinën e Drejtorisë së Përgjithshme”* si dhe në procedurën me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”*;

5. A C

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë, konkretisht për mosrespektim të Urdhrit të brendshëm nr. 39/1 datë 23.09.2019 me nr. 1264/3 prot., datë 23.09.2019;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të konsumit të karburantit nga OE M M SHPK me të cilin është lidhura kontrata me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 *“Qiraja financiare (Leasing)”*;

6. A M

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë;

7. A B

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës së anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje pjese këmbimi për automjetet e tipit Nissan NV300”*;

8. B B

Për mangësitë e konstatuara në ushtrimin e funksionit të anëtarit të Njësisë së Hartimit të Specifikimeve Teknike në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje Kutit Postare me çelës për paketa për klientë”*, viti 2021;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të hartimit të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)”* me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **20,826,403 lekë pa TVSH**;

Për mangësitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Tiranë, Durrës, Qendra Tranzite, Ndryshime ndarjesh për shkak të ndryshimit të strukturës dhe Ndryshimi i ndriçimit nga floureshent në led (322 copë) në Godinën e Drejtorisë së Përgjithshme”* dhe në atë me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”*

Për mangësitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës”*

9. B A

Për mangësitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje kancelari dhe zarfa”* me pasojë dëmin ekonomik në shumën prej **11,990,389 lekë**;

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrave si Drejtor i Burimeve Njerëzore;

10. B H

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 17/35., datë 20.04.2023 të Titullarit për ndjekjen e kontratës me objekt *“Blerje tonera, bojëra printer”* me pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **187,664 lekë**;

11. B L

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës së anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje pjese këmbimi për automjetet e tipit Nissan NV300”*

12. D G

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës së anëtarit të komisionit të prokurimit në vlerë të vogël;

13. D M

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të hartimit të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)”* me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **20,826,403 lekë pa TVSH**;

14. E L

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 17/35, datë 20.04.2023 të Titullarit për ndjekjen e kontratës me objekt *“Blerje tonera, bojëra printer”* me pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **187,664 lekë**;

15. E S

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës për përcaktimin e specifikimeve teknike sipas shkresës nr. 381 prot., datë 08.02.2019 në procedurën e prokurimit me objekt *“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”*;

16. E A

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 5/93, datë 23.03.2023 të Titullarit për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt *“Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), letër A4 “Traktor” (3 kopje)”* me pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **658,657 lekë**;

17. E Q

Për mangësitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje kancelari dhe zarfa”* me pasojë dëmin ekonomik në shumën prej **11,990,389 lekë**;

18. E M

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të ushtrimit të detyrës si anëtare e Grupit të Punës për analizën e kostos dhe efikasitetin procedural për procedurën e prokurimit me objekt *“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”*;

19. E Ç

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtare e komisionit të prokurimit në vlerë të vogël;

20. E B

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë;

21. F Gj

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës për përcaktimin e specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë”*;

22. F H

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të konsumit të karburantit nga OE M M me të cilin është lidhura kontrata me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 *“Qiraja financiare (Leasing)”*;

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës së anëtarit të komisionit të prokurimit në vlerë të vogël.

23. G K

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 5/93, datë 23.03.2023 të Titullarit për ndjekjen e kontratës me objekt *“Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), letër A4 “ Traktor” (3 kopje)”*;

24. G J

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtar i komisionit të prokurimit në vlerë të vogël;

25. H K

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtar i komisionit të ofertave në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje palmar profesional, barkod reader me Wireless, lexues barkodesh”*;

26. H M

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të ushtrimit të detyrës si anëtar i Grupit të Punës për analizën e kostos dhe efikasitetin procedural për procedurën e prokurimit me objekt *“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”*;

27. H B

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtar i grupit të hartimit të specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje pjese këmbimi për automjetet e tipit Nissan NV300”*;

28. I K

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 5/93, datë 23.03.2023 të Titullarit për ndjekjen e kontratës me objekt *“Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), letër A4 “ Traktor” (3 kopje)”* me pasojë përdorimin pa efektivitet, efizienzë dhe ekonomicitet të fondeve në shumën prej **658,657 lekë**;

29. J K

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë;

30. L M

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të pasqyrave financiare;

31. L M

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë;

32. M Z

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtare e Komisionit të Vlerësimit Ofertave në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruktion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”*;

33. M H

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtare e komisionit të prokurimit në vlerë të vogël;

34. N LI

Pas mangësive të konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtar i Njësisë së Prokurimit;

35. O M

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 5/93, datë 23.03.2023 të Titullarit për ndjekjen e kontratës me objekt *“Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), letër A4 “ Traktor” (3 kopje)”*;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të hartimit të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)”* me pasojë përdorim pa efektivitet, efizienzë dhe ekonomicitet të fondeve në shumën prej **20,826,403 lekë pa TVSH**;

36. Q H

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të hartimit të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt *“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”*;

37. R LI

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës së anëtarit të komisionit të ofertave në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”*;

38. S Z

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit të kontratës me objekt *“Blerje kuti postare restante dhe kuti postare për klientë”*;

Për mangësitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës”*;

39. Sh K

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë, në cilësinë e Drejtorit të Filialit Tiranë;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të konsumit të karburantit nga OE M M me të cilin është lidhura kontrata me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 *“Qiraja financiare (Leasing)”*;

40. Sh I

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë;

41. T H

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 5/83, datë 22.02.2023 të Titullarit për ndjekjen e kontratës me objekt *“Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), letër A4 “ Traktor” (3 kopje)”*;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të ndjekjes së kontratës me objekt *“Blerje e vendosje sisteme të integruara të sigurisë (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi CH4, CH8, CH16), sisteme inteligjente (SMART) të sigurisë CH4, CH8, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit”*;

42. V D

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë, konkretisht për mosrespektim të Urdhrit të brendshëm nr. 7 datë 17.05.2021.

43. Xh H

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të ndjekjes së kontratës me objekt *“Blerje e vendosje sisteme të integruara të sigurisë (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi CH4, CH8, CH16), sisteme inteligjente (SMART) të sigurisë CH4, CH8, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit”*;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të ndjekjes së kontratës me objekt *“Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video Wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë”*.

Përgjigjja e institucionit:

Posta Shqiptare sipas Urdhërit Nr.187, datë 14.06.2024 ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje” për z.B A.

Posta Shqiptare sipas Urdhërit Nr.182, datë 13.06.2024 ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje” për z.H B.

Posta Shqiptare sipas Urdhërit Nr.182/1, datë 13.06.2024 ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje” për z.S Z.

Posta Shqiptare sipas Urdhërit Nr.182/2, datë 13.06.2024 ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje” për znj.E Q.

Posta Shqiptare sipas Urdhërit Nr.182/3, datë 13.06.2024 ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje” për znj.M H.

Posta Shqiptare sipas Urdhërit Nr.182/4, datë 13.06.2024 ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje” për znj.E M.

Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për z.N Ll.	Urdhërit Nr.182/5, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për z.T H.	Urdhërit Nr.182/6, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për z.Xh H.	Urdhërit Nr.182/7, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për znj.R Ll.	Urdhërit Nr.182/8, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për z.I K.	Urdhërit Nr.182/9, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për z.A K.	Urdhërit Nr.182/10, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për znj.B L.	Urdhërit Nr.182/11, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për z.A S.	Urdhërit Nr.182/12, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për znj.B B.	Urdhërit Nr.182/13, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për z.E L.	Urdhërit Nr.182/14, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për znj.A V.	Urdhërit Nr.182/15, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për znj.Sh I.	Urdhërit Nr.182/16, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për znj.A M.	Urdhërit Nr.182/17, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për z.A Ç.	Urdhërit Nr.182/18, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për z.A B.	Urdhërit Nr.182/19, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për znj.E Çi.	Urdhërit Nr.182/20, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për znj.G K.	Urdhërit Nr.182/21, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për z.Fa H.	Urdhërit Nr.182/22, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për z.G J.	Urdhërit Nr.182/23, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për znj.Q H.	Urdhërit Nr.182/24, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për z.H M.	Urdhërit Nr.182/25, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për znj.O M.	Urdhërit Nr.182/26, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për znj.L M.	Urdhërit Nr.182/27, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore
Posta Shqiptare sipas “Vërejtje” për znj.J K.	Urdhërit Nr.182/28, datë 13.06.2024	ka dhënë masën disiplinore

Posta Shqiptare sipas Urdhërit Nr.182/29, datë 13.06.2024 ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje” për znj.V D.

Posta Shqiptare sipas Urdhërit Nr.182/30, datë 13.06.2024 ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje” për znj.F Gj.

Posta Shqiptare sipas Urdhërit Nr.182/31, datë 13.06.2024 ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për znj.B H.

Posta Shqiptare sipas Urdhërit Nr.182/32, datë 13.06.2024 ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje” për znj.R Ll.

Komenti i grupit të auditimit.

Posta Shqiptare ka zbatuar rekomandimin për masa disiplinore për 39 nga 43 punonjës.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit kryer prej grupit të auditimit të KLSH-së rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a) 26 Masa organizative nga ku 29 rekomandime, janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 18 Zbatuar, 9 pjesërisht zbatuar dhe 2 pa zbatuar.

b) 6 Masa shpërblim dëmi nga ku 7 rekomandime 6 janë pranuar plotësisht dhe 1 rekomandim nuk është pranuar, të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 2 Zbatuar dhe 4 zbatuar pjesërisht.

c) 15 Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike nga ku 2 rekomandime, janë pranuar plotësisht dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 9 Zbatuar, 3 zbatuar pjesërisht dhe 3 pa zbatuar .

d) 1 Masë Disiplinore nga ku 1 rekomandim, i cili ka statusin e ecurisë së zbatimit pjesërisht i zbatuar.

Për sa më sipër ri kërkojmë që, Posta Shqiptare SHA të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar dhe pjesërisht zbatuar, brenda 3 mujorit të parë të vitit 2025 si dhe kërkojmë analizimin dhe marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar dhe që efektivisht rezultojnë të pa zbatuara.

3.10 ALBPETROL SHA

PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Shoqërinë Albpetrol Sh. A** mbi “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2023*” për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr. 1202/25 Prot., datë 01.08.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomikitet të fondeve;

ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr. 792/1 prot., datë 01.07.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. E.K, anëtar
2. A.R, anëtar

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 1202/25 Prot., datë 01.08.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Albpetrol Sh. A në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr. 1202/25 Prot., datë 01.08.2023, rezulton se, nga **142** masa të rekomanduara (përmirësim ligjor, organizative, shpërblim dëmi, 3-E disiplinore dhe administrative), janë pranuar nga subjekti **137** masa të rekomanduara ose 96 %. **Nga të pranuarat (137):** janë zbatuar plotësisht **24**, ose 20 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht **42** masa ose 31 % dhe nuk janë zbatuar **71** masa ose 52 %.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Gjithsej	Pranuar	Pa pranuar	Statusi i zbatimit		
					Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
1	Organizative	44 masa	41 masa	3 masa	11 masa	29 masa	1 masa
1/1	Organizative nga auditimi i kaluar	33 masa	33 masa	-	10 masa	8 masa	15 masa
	Total Organizative	77 masa	74 masa	3 masa	21 masa	37 masa	16 masa
2	Shpërblim dëmi	21 masa	20 masa 4,567,928,206 lekë	1 masë	2 masa 728,935 lekë	2 masa 3,162,155,230 lekë	16 masa 1,405,044,041 lekë
2/1	Shpërblim dëmi nga auditimi i kaluar	8 masa	8 masa	-	-	-	8 masa 345,748,708 lekë
	Total Shpërblim dëmi	29 masa	28 masa	1 masë	2 masa	2 masa	24 masa
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të	16 masa	16 masa	-	-	2 masa 104,452,178	14 masa 15,907,079 lekë

	fondeve publike		16,225,555 lekë 60,620,807 \$			lekë 39,247,000 \$	21,373,807 \$
3/1	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike nga auditimi i kaluar	18 masa	17 masa	1 masë	-	-	17 masa 1,392,079,949 lekë 77,284,314 \$
	Total Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	34 masa	33 masa	1 masë	-	2 masa	31 masa
4	Masa Disiplinore	1 masë	1 masë		-	1 masë	
5	Masa Administrative	1 masë	1 masë		1 masë	-	-
	Gjithsej	142 masa	137 masa 1,444,216,451 lekë 60,620,807 \$	5 masa	24 masa 728,935 lekë	42 masa 26,625,161 lekë 60,620,807 \$	71 masa 215,362,826 lekë

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 20 % dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht është 31% dhe rekomandimet e pazbatuar 52%.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Albpetrol Sh. A, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën Nr. 815 prot., datë 17.08.2023,

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga ana e Albpetrol Sh. A nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, si dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kaluar të lëna me Vendimin nr.76 datë 18.05.2022 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, statusi i zbatimit të së cilave është si më poshtë vijonë

1. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, drejtuar KLSH, Administratori i Albpetrol sh.a ka dërguar informacion (Planin e Masave) mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së, brenda **afatit 20 ditor**.

Albpetrol sh.a nuk i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 50 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 8 masa, janë në proces realizimi 8 masa dhe 31 masa nuk janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 10 masa për shpërbllim dëmi, në vlerën 346,696,708 lekë, nga të cilat 2 masa janë zbatuar dhe 7 masa nuk janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 22 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, nga të cilat janë në proces realizimi 1 masa, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 14 masa nuk janë zbatuar.

-Është rekomanduar 1 masë Administrative, e cila nuk është zbatuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.11 faqe 300-350, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marri masat për zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pa zbatuara, dhe të zbatuara pjesërisht. Ndërsa për të gjitha rekomandimet e tjera, që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2023, si më poshtë:

- *Rekomandimet për masa organizative, respektivisht:*

1.1. Rekomandim: *Nga organet drejtuese të Albpetrol Sh. A të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë.*

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Është nënshkruar Kontrata Kolektive e Punës nr. 1026 prot., datë 10.02.2023, ku parashikohen procedurat e lëvizjeve të punonjësve. Rregullorja për Programin “Punësimi i Profesionistëve të Rinj në shoqërinë “Albpetrol” Sh. A është miratuar me vendimin nr. 8, datë 2.05.2024 të Këshillit Mbikëqyrës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

1.2. Rekomandim: *Në Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë hartimi i detyrave dhe përgjegjësisve të shtrihet për të gjithë punonjësit dhe jo vetëm në nivel drejtorie, në mënyrë që secili punonjës të ketë të qartë detyrën funksionale dhe përgjegjësit sipas pozicionit të punës.*

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit: Me urdhrin nr. 280, datë 11.09.2023, “Për rishikimin e rregullores së brendshme të shoqërisë”, është hartuar rregullore e përditësuar e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë, (me detyra të specifikuar për çdo pozicion pune) pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës i strukturës organizative me vendimin nr. 10, datë 4.10.2023, i ndryshuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar pjesërisht***.

2.1. Rekomandim: Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik, të hartohet strategjia e riskut, regjistri i riskut, gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës dhe lista e proceseve.

Të përcaktohen procedurat anti-korrupsion, rregulla të shkruara për sinjalizimin e parregullsisve, si dhe të hartohen programe trajnimit për punonjësit.

Në fund të çdo viti të plotësohet pyetësori i vetëvlerësimit, si dhe deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ku të përcaktohen pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi, nevojat për përmirësim, si dhe kjo deklaratë të raportohet në MFE.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Është hartuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut (Urdhri 25, datë 30.01.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A; urdhri nr. 125, datë 08.04.2024, “Për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Riskut në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A; urdhri nr. 208, datë 21.06.2024 “Për miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

2.2. Rekomandim: *Nga Administratori i shoqërisë të merret të gjitha masat e nevojshme për rinovimin e licencave për faqen zyrtare dhe postën elektronike si dhe pajisjen e tyre me certifikatë sigurie, me qëllim mirëfunksionimin e tyre dhe ruajtjen e të dhënave konfidenciale të institucionit.*

Përgjigja e institucionit:

Është krijuar faqja e re zyrtare dhe janë rinovuar të gjitha licencat përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

6.1.Rekomandim: *Administratori i Albpetrol ShA, Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure, për rastin konkret dhe në vazhdimësi t'i kërkojnë shoqërisë “T O” Sha të marrë masa të menjëhershme për:*

- Të mos lejuar shkarkimin në ambientet të H₂O të lirë.
- Ngritjen e argjinturës mbrojtëse në grupe për të siguruar derdhjet e mundshme në rast të çarjes së ndonjë depoje, për të mos shkaktuar ndotje mjedisore.
- Eliminimin e ndotjeve të vjetra në puse dhe në afërsi të grupeve.
- Të pastrohen dhe sistemohen sheshet e grupeve të puseve.

Përgjigja e institucionit:

Kontraktorit i është kërkuar marrja e masave për eliminimin e problematikave të mësipërme. Aktualisht nuk kemi një problematikë të tillë në këtë vendburim.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së provave (fakte apo dokumentacion i ri) të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

8.1.Rekomandim: *Albpetrol ShA në bashkëpunim me MIE të marrin masa që të hartohet një rregullore e qartë mbi procedurat e dhënies së marrëveshjeve hidrokarbure, ku të përcaktohen kriteret e domosdoshme ekonomik, teknik e të tjera, që duhet të plotësojnë operatorët pjesëmarrës dhe këto kritere të jenë baza për vlerësimin dhe shpalljen e fituesit.*

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr.11/183, datë 20.10.2023, i është kërkuar MIE zhvillimi i një takimi të përbashkët me qëllim diskutimin e veprimeve që do të ndiqen për zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

9.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa konkrete për kryerjen e investimeve në sektorët strategjik të Shoqërisë me qëllim maksimizimin e prodhimit të naftës si burimi i saj kryesor i të ardhurave dhe uljen e kostove për nxjerrjen e saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e institucionit të bëjnë dhe një analizë të thelluar për arsyet e mos realizimit të zërave kryesor të programuara në fillim viti.

Përgjigja e institucionit:

Programi i Zhvillimit Ekonomik i shoqërisë, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, është dokumenti strategjik në të cilin paraqitet analiza e treguesve kryesorë teknikë dhe ekonomiko-financiarë të shoqërisë në vitin paraardhës, si dhe parashikimi, përfshirë investimet në sektorë të ndryshëm, sipas prioriteteve të zhvillimit, me fokus rritjen e efektivitetit të prodhimit të naftës bruto, në vitin për të cilin hartohet Programi. (Vendimi nr. 1, i Këshillit Mbikëqyrës, datë 20.02.2024, dhe vendimi nr. 2155/1, i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, datë 08.03.2024). Këshilli Mbikëqyrës merr dhe shqyrton analizat periodike (3, 6, 9 mujore dhe vjetore) me treguesit kryesorë të të ardhurave e shpenzimeve, si dhe të kushteve teknike që ndikojnë në ecurinë e realizimit të treguesve të parashikuar të prodhimit në Programin e miratuar. (*Projekti strategjik – Zharrez*)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

11.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë dhe të gjitha drejtoritë që marrin pjesë në hartimin e programit ekonomiko financiar, në të ardhmen të merren masa, për kryerjen e parashikimeve realiste, të studiuara dhe të arritshme për zërat kryesorë të shoqërisë, duke u bazuar në rezultatet e vitit paraardhës.

Përgjigja e institucionit:

Programi i Zhvillimit Ekonomik i shoqërisë, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, është dokumenti strategjik në të cilin paraqitet analiza e treguesve kryesorë teknikë dhe ekonomiko-financiarë të shoqërisë në vitin paraardhës, si dhe parashikimi, përfshirë investimet në sektorë të ndryshëm, sipas prioriteteve të zhvillimit, me fokus rritjen e efektivitetit të prodhimit të naftës bruto, në vitin për të cilin hartohet Programi. (Vendimi nr. 1, i Këshillit Mbikëqyrës, datë 20.02.2024, dhe vendimi nr. 2155/1, i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, datë 08.03.2024). Këshilli Mbikëqyrës merr dhe shqyrton analizat periodike (3, 6, 9 mujore dhe vjetore) me treguesit kryesorë të të ardhurave e shpenzimeve, si dhe të kushteve teknike që ndikojnë në ecurinë e realizimit të treguesve të parashikuar të prodhimit në Programin e miratuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***

15.1.Rekomandim: *Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i shoqërisë të marrin masa që në të ardhmen, përgatitja dhe hartimi i pasqyrave financiare të kryhet me vërtetësi, duke pasqyruar situatën financiare dhe performancën ekonomike, për disponimin në kohë të informacioneve nga palët e interesuara, për vendim- marrjet përkatëse.*

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Pasqyrat financiare të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A janë miratuar brenda afateve ligjore. Aktualisht, për vitin 2023, pasqyrat financiare janë miratuar me vendimin nr. 10, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 11.07.2024, dhe vendimin nr. 6060/1, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, datë 25.07.2024. Në vijim do të bëjmë ngarkimin e tyre ne QKB .

Komenti i grupit të auditimit:

Rekomandimi i mësipërm i referohet përgatitjes së pasqyrave financiare, të cilat cilësohen si një fotografi e situatës ekonomiko-financiare të entitetit në një moment të caktuar kohe, me vërtetësi dhe transparencës në kohë reale në përdoruesit e tretë dhe jo miratimit të tyre brenda afateve kohore të cilat janë të rregulluara me akt ligjor.

Në kushtet e mungesës së evidencave të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar dhe Statusi i plotë i zbatueshmërisë së tij ngelet për tu verifikuar në auditimet e ardhshme me auditimin e pasqyrave financiare.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe është ***pazbatuar***.

16.1.Rekomandim: *Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues duhet të marrin masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që shoqëria zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.*

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 3502/3 prot, datë 09.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/2 prot, datë 13.08.2024 z. E D ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Janë dërguar në format elektronik regjistri i AAM-ve pra nga Albpetrol Sh.A është plotësuar regjistri elektronik i Aktiveve.*

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e paraqitjes së evidencave të reja justifikuese përmes observacioneve të paraqitura me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024 të cilat të provojnë statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

17.1.Rekomandim: *Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të merren masa që në të ardhmen jetëgjatësia e aktiveve të përcaktohet mbështetur në manualët përkatëse, ekspertiza të specialistëve të fushës, me përgjegjshmëri dhe besueshmëri.*

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***

19.1.Rekomandim: *Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të merren masat për të kryer pagesat e detyrimeve ndaj të tretëve në afatet e duhura, për të evituar penalitetet nga mos shlyerja e detyrimeve.*

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***

20.1.Rekomandim: *Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe detyrimeve e të drejtave për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.*

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Me urdhër të Administratorit të shoqërisë nr. 7587 prot., datë 03.10.2023 janë ngritur Komisionet për kryerjen e Inventarizimit të përgjithshëm të pasurive të shoqërisë. Janë kryer inventarët për vitin 2022 dhe për vitin 2023 është në proces realizimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

21.1.Rekomandim: *Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa që Drejtoria Ekonomike gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.*

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 3502/3 prot, datë 09.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/2 prot, datë 13.08.2024 z. E D ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Me vendimin e Administratorit të shoqërisë nr. 10195/1 prot., datë 11.12.2023 është ngarkuar Departamenti Administrativ dhe Drejtoria e Financës për krijimin e provizioneve dhe sistemeve në pasqyrat financiare të shoqërisë.*

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar dhe statusi i

plotë i zbatueshmërisë së tij ngelet për tu verifikuar në auditimet e ardhshme me auditimin e pasqyrave financiare.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe është ***pazbatuar***.

22.1.Rekomandim: *Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për të ngritur dhe miratuar procedura të monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve sipas kontratave përkatës, me qëllim shmangien e penaliteteve për mos pagesa në afat.*

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe i ***pazbatuar***.

23.1.Rekomandim: *Administratori i shoqërisë Albpetrol ShA duhet të ngrejë dhe të bëjë funksional autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave, për të mbajtur dhe përditësuar regjistrin e deklarimit të konfliktit të interesave të punonjësve të shoqërisë Albpetrol ShA. Në rastet e anulimit të procedurës së ankandit, të analizohen dhe përcaktohen arsyet që kanë ndikuar në anulimin e ankandit për shitjen e naftës bruto.*

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Administratori i shoqërisë Albpetrol ShA ka miratuar urdhrin nr. 101, datë 19.04.2023, “Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A”, të ndryshuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga ana e Albpetrol Sh.A është ndërmarr nisma për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave dhe ngelet për tu verifikuar në auditimet e ardhshme funksionaliteti i tij.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

24.1.Rekomandim: *Drejtorja e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik duhet të koordinoj dhe të bashkëpunoj me Drejtorinë e Prodhimit, të Shitjes, QFSHAG dhe sektorët e monitorimit të marrëveshjeve hidrokarbure, për të planifikuar sasi të naftës bruto sipas vendburimeve të Albpetrol ShA, në mënyrë që të optimizojë kapacitetet e veta të magazinimit e stokimit, për të rritur të ardhurat e shoqërisë nga realizimi i shitjes së naftës bruto nëpërmjet procedurave të ankandit.*

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Programi i Zhvillimit Ekonomik i shoqërisë, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, është dokumenti strategjik në të cilin paraqitet analiza e treguesve kryesorë teknikë dhe ekonomiko-financiarë të shoqërisë në vitin paraardhës, si dhe parashikimi, sipas prioriteteve të zhvillimit në vitin për të cilin hartohet Programi. Procedurat e Ankandit, bazohen në urdhrin nr. 83, datë 10.02.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, të ndryshuar, dhe nisin me urdhrin e Administratorit “Për vlerësimin e të dhënave mbi gjendjen e naftës bruto që mund të shitet, për fillimin e procedurave të ankandit të shitjes së saj”, në të cilin ngarkohen Drejtorja e

Programimit dhe Zhvillimit Strategjik, QASHNG, Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe është ***zbatuar***.

25.1.Rekomandim: *Administratori i Albpetrol ShA të miratoj tarifat e magazinimit dhe të lëvizjes së produktit naftë bruto në pikat e lëvrimit në dy portet e vendit, mbi bazën e ofertave të operatorëve që ofrojnë këto shërbime, të cilat të shërbejnë si referencë për komisionin e ekspertëve gjatë përcaktimit të çmimit minimal të shitjes së naftës bruto.*

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

26.1.Rekomandim: *Administratori i Albpetrol ShA të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga institucion i KLSH, APP, etj., përsa i përket çështjes së mësipërme.*

Komenti i grupit të auditimit:

Sikundër më lartë trajtuar, në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

28.1. Rekomandim: *Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshirë ata që kanë mjete në ngarkim) i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë gjendjen teknike të mjeteve dhe më pas të caktojë normativat mbi konsumin e karburantit për mjetet që ushtrojnë aktivitetin në Shoqëri pa normativa të miratuara.*

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

28.2.Rekomandim: *Nga Drejtoria e Ekonomike dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.*

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Çdo Qendër është e pajisur tashmë me kartelat përkatëse të automjeteve ku janë të pasqyruar të gjitha të dhënat e lëvizjes dhe shpenzimeve të mjetit.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***zbatuar***.

28.3.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës ku të vendosen në gjendje pune të gjithë GPS duke kryer riparimet teknike dhe instalimet e aplikacioneve ku të përfshihet e gjithë harta në të cilën lëvizin mjetet, matjen e konsumit të gazoilit, orët e punës për mjetet teknologjike dhe kilometrat e përshkruara nga mjeti raportet mujore mbi realizimin apo tejkalimin e konsumit të karburantit për secilin mjet. Për mjetet të cilat kanë jashtë funksionit treguesin e furnizimit me karburant të kryhen riparimet përkatëse.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Administratori i shoqërisë ka miratuar urdhrin nr. 168, datë 01.06.2023, “Për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve monitoruese GPS në automjetet dhe mjetet teknologjike të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e Albpetrol Sh.A (personat përgjegjës të nga ngarkuar) rezulton se, është ndërmarr nisma e nxjerrjes së urdhrin dhe më tej nuk ka asnjë gjurmë justifikuese të vijimit të zbatueshmërisë së rekomandimit. Mbajtur në konsideratë edhe se, periudha kohore nga nxjerrja e urdhërit e deri në verifikimin e statusit të rekomandimit është e gjatë (1 vit) ndodhemi në kushtet e moszbatimit të rekomandimit nga ana e njësisë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***

28.4. Rekomandim: Nga organet drejtuese të Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për hartimin e rregullave në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet, makineritë-pajisjet e shoqërisë si dhe në të të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve në administratën qendrore dhe qendrat e prodhimit.

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

29.1. Rekomandim: Nga organet drejtuese të Shoqërisë në të ardhmen të merren masat e duhura për miratimin e nivelin të pagave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore dhe statutoe.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Struktura aktuale e pagave të punonjësve të shoqërisë, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 11, datë 04.10.2023, “Për miratimin e pagave të punonjësve të shoqërisë “Albpetrol” sh.a” dhe nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit me vendimin nr. 8441/1, datë 07.11.2023, “Për miratimin e vendimit nr. 11, datë 04.10.2023, të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Albpetrol” sh.a”, përfshin të gjithë elementët e pagës të parashikuar në legjislacionin në fuqi (Kodi i Punës, Statusi i Naftëtarit)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe është ***zbatuar***.

30.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat e duhura që emërimi i punonjësve të rinj dhe lëvizjet brenda institucionit të bëhet në bashkëpunim dhe konsultim me

Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe në përputhje me kuadrin rregullator të rekrutimeve në punë.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Procedurat e rekrutimit dhe të lëvizjeve të punonjësve të shoqërisë bëhen në mbështetje dhe zbatim të legjislacionit në fuqi (Kodi i Punës, Kontrata Kolektive e Punës, Rregullore e Organizimit të Brendshëm të shoqërisë).

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, por citimit nga ana e Albpetrol Sh. A (personat përgjegjës të ngarkuar) të bazës ligjore funksionale nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe i ***pazbatuar***.

30.2. Rekomandim: *Drejtoria e Burimeve Njerëzore në rastet e emërimeve të reja, më parë të përcaktojë vendosjen e kriterëve përkatëse për çdo pozicion pune sipas strukturës organizative. Gjithashtu të marrë masat e duhura mbi plotësimin e dosjeve personale të punonjësve me dokumentacionin përkatës.*

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Nga ana e grupit të auditimit, u përzgjedhën 3 (tre) raste për tu shprehur mbi statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit. Referuar rasteve rezultojë se, rekomandimi është marr në konsideratë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe i ***zbatuar***.

31.1. Rekomandim: *Këshilli Mbikëqyrës të analizojë largimet e punonjësve nga puna dhe të monitorojë të mënyrë të vazhdueshme procesin e shpërndarjeve të marrëdhënieve të punës duke kërkuar informacione periodike mbi vendimmarrjen e Administratorit të Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë të marrë masat e duhura që gjatë largimit të punonjësve nga puna ky proces të kryhet në përputhje me kuadrin rregullator ligjor për të shmangur pasojat e mundshme financiare që vijnë nga proceset gjyqësore.*

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, pas analizës së plotë të paraqitur nga administrata e shoqërisë, miratoi strukturën organizative dhe organigramën e funksionimit të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, me vendimin nr. 10, datë 04.10.2023, të ndryshuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe është ***zbatuar***.

34.1.Rekomandim: *Nga Albpetrol ShA të merren masa në mënyrë që në të gjitha rastet e propozimeve për marrje vendimi nga Këshilli Mbikëqyrës, projekt vendimet të shoqërohen me dokumentacionin mbështetës për çdo çështje.*

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, në çdo rast shqyrton propozimet e administratës së shoqërisë me projekt-vendime të shoqëruara me relacion dhe dokumentacion ligjor justifikues/argumentues, në varësi të çështjes që shqyrtohet.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe është *zbatuar*.

35.1.Rekomandim: *Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masa për krijimin e Komiteteve sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë Albpetrol ShA.*

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe i *pazbatuar*.

38.1.Rekomandim: *Nga Administratori i Albpetrol ShA, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, të merren masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për marrjen në administrim nga institucioni të gjitha pronat e zëna nga posedues të paligjshëm. Gjithashtu të zgjidhet çështja e pronave me mbivendosje.*

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Shoqëria “Albpetrol” sh.a. në zbatim të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-së nr. 28, datë 27/01/2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, po kryen procedurat e përditësimit dhe regjistrimit të pasurive të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Ky proces qartëson kufijtë real të pasurive të shoqërisë, dhe zgjidh problemet e mbivendosjes.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

39.1.Rekomandim: *Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës të merren masa që në të ardhmen për secilën kontratë qiraje të zbatohen të gjitha etapat e përshkruara në kuadrin ligjor, për lidhjen dhe zbatimin e tyre. Të kryhet publikimi në faqen zyrtare të shoqërisë i pronave që jepen me qira, me qëllim informimin e publikut dhe rritjen e interesit prej tij për këto prona.*

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Shoqëria ka evidentuar dhe ka hartuar regjistrin e pronave në administrim, duke bërë analizë të plotë për vlefshmërinë e tyre në aktivitetin prodhues dhe administrativ të saj, për t’i dhënë me qira pronat e lira, pa cenuar aktivitetin e shoqërisë.

Në faqen e vet zyrtare shoqëria “Albpetrol” Sh.A ka publikuar pronat e lira që mund të kenë interes nga subjekte fizike e juridike, apo qytetarë, për t’i marrë me qira, në përputhje me dispozitat ligjore.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe i *zbatuar*.

40.1.Rekomandim: *Drejtimi i shoqërisë të marrë masat për vlerësimin e situatës dhe të vazhdojë me veprimet e mëtejshme për anulimin e detyrimit që pretendon shoqëria A O ShA,*

për sasinë e produktit naftë prej 15.418 ton. Drejtimi i shoqërisë të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për kundërshtimin e veprimeve të përmbauesit privat, të cilat kanë çenuar aktivet e shoqërisë.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

42.1.Rekomandim: *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në cilësinë e pronarit aksionar) të marrë masa për analizimin e situatës së krijuar me detyrimet e Albpetrol SHA ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA për energjinë elektrike. Të vlerësojë kalimin e rrjetit transmetues të energjisë elektrike tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ShA dhe Furnizuesin e Shërbimit Universal ShA në mënyrë që kontraktorët e marrëveshjeve hidrokarbure të lidhin kontrata direkt me furnizuesin kryesor të energjisë elektrike mbi bazën e kuadrit rregullator përkatës, duke eliminuar në këtë mënyrë mosmarrëveshjet që Albpetrol ShA ka me OShEE për çështjen e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit, si dhe mosmarrëveshjet midis kontraktorve të marrëveshjeve hidrokarbure me Albpetrol ShA.*

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Janë përfunduar procedurat për hartimin dhe miratimin e akt-marrëveshjeve me shoqëritë koncesionare për furnizimin me energji nga FSHU dhe për pagesën e tarifës së shërbimit të mirëmbajtjes së rrjetit nga Albpetrol.

Është vlerësuar dhe diskutuar mundësia e kalimit të rrjetit të transmetimit të Albpetrol në administrim të FSHU, por nuk është pranuar (refuzuar) nga FSHU.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga ana e grupit të auditimit, pas marrjes së draft akt-marrëveshjes me shoqëritë koncesionare për furnizimin me energji nga FSHU dhe për pagesën e tarifës së shërbimit të mirëmbajtjes së rrjetit nga Albpetrol së hartuar, vlerësohet se ky rekomandim është pjesërisht i zbatuar dhe statusi i plotë i tij ngelet të vlerësohet në auditimet e ardhshme.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

43.1. Rekomandim: *Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë, të marrë masat e duhura për të revokuar vendimin e marrë mbi reduktimin e pagave ndaj punonjësve të administratës qendrore dhe administratës së qendrave të prodhimit. Gjithashtu në përmbushje të detyrimeve të kontratave me punonjësit, të marrë masat e duhura për të kompensuar pagat e reduktuara.*

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

A.1 MASA ORGANIZATIVE

Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kaluar të lëna me Vendimin nr.133 datë 28.07.2023 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, statusi i zbatimit të së cilave është si më poshtë vijonë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se deklarimi në sistem për mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021 është bërë me datë 31.03.2022. Me shkresën nr. 1528.prot, datë 14.02.2022 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka caktuar audituesit ligjorë për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2021, me të cilët është lidhur kontratë shërbimi me nr. 4726 prot., datë 23.06.2022 nga Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe shtesë kontrate nr. 4726/3 pro., datë 22.08.2022 me afat shtyrje deri me datë 18.09.2022.

Me vendimin nr. 21, datë 08.11.2022, Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar pasqyrat financiare të shoqërisë dhe me vendimin nr. 9393/1, datë 30.12.2022, Asambleja e Ortakëve ka miratuar rezultatin e vitit ushtrimorë në vlerën 10,857 mijë lekë, procedurë kjo e kryer jashtë afatit të caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1. Për pasojë depozitimi i pasqyrave financiare të periudhës 2021, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, është kryer jashtë afateve ligjore dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46, pika 1. Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t’i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1. **1.1.Rekomandimi:** Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa që në të ardhmen pasqyrat financiare të hartohen, të aprovohen dhe të depozitohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë e vlerësimin e performancës ekonomike, në interes të vendim-marrjeve që duhet të marrin palët e interesuara, si asambleja e ortakëve, institute kredi dhënie etj.

Menjëherë dhe në vijmë

Përgjigja e institucionit:

Pasqyrat financiare të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A janë miratuar brenda afateve ligjore. Aktualisht, për vitin 2023, pasqyrat financiare janë miratuar me vendimin nr. 10, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 11.07.2024, dhe vendimin nr. 6060/1, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, datë 25.07.2024. Në vijim do të bëjme ngarkimin e tyre ne QKB .

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se nga pronat të kaluara me VKM nr. 219/2004, datë 16.04.2004 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në administrim Albpetrol sh.a Patos.”, VKM nr.784/2006, datë 15.09.2006 “Për Ristrukturimin e Shoqërive Tregtare me Kapital Shtetëror Albpetrol sh.a Patos, “S” sh.a dhe “T” sh.p.k”, VKM nr. 275/2010, datë 26.04.2010 “Për përthithjen nga Albpetrol sh.a Patos të “Uzina Mekanike Kuçovë” dhe “Uzina Mekanike Patos” shpk, Urdhri nr. 1480/2016, datë 29.02.2016 për zbatimin e Vendimit të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.2037/2017, datë 04.07.2017 të “Për kalimin e pronësisë së sendit të pranuar si blerje e kreditorit” të Shoqërisë Përmbarimore private “T G” shpk, shoqërisë Albpetrol sh.a Patos kanë kaluar në pronësi Troje për 10 962 126 m² (*Ndërtesa dhe Truall funksional me sipërfaqe për 2*

029 038 m², Puse me sipërfaqe për 4 198 588 m² dhe Rrugë për 4 198 588 m²) të pasqyruara në kontabilitet për vlerën 9, 533,519 mijë lekë. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka certifikuar 3 950 459 m² (Ndërtesa dhe Truall funksional me sipërfaqe për 1 207 108 m², Puse me sipërfaqe për 2 448 000 m² dhe Rrugë për 295 351 m²) ose 36% e totalit dhe nuk ka certifikatë 6 958 117 m² (Ndërtesa dhe Truall funksional me sipërfaqe për 821 930 m², Puse me sipërfaqe për 2 232 950 m² dhe Rrugë për 3 903 237 m²) ose 64% e totalit ose nga 6497 prona janë certifikuar 3799 prona ose 58% e totalit, janë në proces për regjistrim 870 prona. **Rezultojnë që ka 28 prona me mbivendosje dhe 440 prona të zaptuara nga të tretë të cilat shfrytëzohen pa asnjë detyrim financiar ndajë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, duke krijuar të ardhura të munguara.**

Sa më lart kontabilizimi i tyre nuk është mbështetur në dokumente hipotekore në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kapitulli III, pika 35 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për evidentimin e gjendjes fizike të pronave të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të kaluara me VKM dhe regjistrim në ASHK Drejtoria Fier.

Gjithashtu, Drejtoria e Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Përgjigjja e institucionit:

Nga Albpetrol është përgatitur dosja me dokumentacionin me urdhër të Administratorit. Urdhri nr. 89, datë 11.04.2023 “Për ngritjen e Strukturës së Posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A dhe pajisjen me certifikatë pronësie të çdo pasurie të saj”, ndryshuar me urdhrin nr.120, datë 05.04.2024. Nga ana e Albpetrol sh.a. është mbajtur komunikimi me ASHK Tiranë, ku nëpërmjet shkresës nr. 3124 prot., datë 25.05.2023, “Kërkesë për bashkëpunim”, është kërkuar në zbatim të VKM nr. 28, datë 27.01.2023, “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, ngritja e grupeve të punës në ASHK Fier, Vlorë dhe Kuçovë, të dedikuara për përditësimin dhe regjistrimin e pronave të shoqërisë. Në përgjigje të kësaj shkrese është ngritur grupi i punës në ASHK Fier, ku është bërë dhe aplikimi për përditësimin dhe regjistrimin e 10 pronave të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Ky proces pritet të vazhdojë për të gjitha pronat e shoqërisë. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. në zbatim të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-së nr. 28, datë 27/01/2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, po kryen procedurat e përditësimit dhe regjistrimit të pasurive të shoqërisë “Albpetrol” sh.a.

Aktualisht jemi në procedura për 10 pasuri. Ky proces po ecën me bashkëpunimin e ASHK.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet i *pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

2.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, në bashkëpunim me Drejtorinë e Auditit të Brendshëm të marrë mision auditimi të veçantë në të gjitha Asetet në përdorim/pronësi të kaluara me VKM të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për evidentimi e tyre mbi gjendjen fizike, si dhe shfrytëzimin e tyre të tretë.

Për rastet e konstatuara për shfrytëzim nga të tretë të kërkohet lidhja e kontratës së qirave për rastet e objekteve me certifikatë pronësie ose bllokimi i pronës dhe marrja në përdorim nga vetë shoqëria Abpetrol sh.a

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Nga administratori i shoqërisë “Albpetrol” Sh.A është miratuar urdhri nr. 231, datë 15.07.2024, “Për verifikimin e pronave të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A të dhëna me qera palëve të treta, subjekte fizike dhe juridike, sipas kontratave aktive të nënshkruara”.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se në grupin e “Aktive Afatgjata Materiale” të pasqyruara në bilanc në vlerën 31,115,579 mijë lekë është e përfshirë dhe vlera prej 344,365 mijë lekë që i përket banesave të cilat janë ndërtuar nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos por që nuk administrohen më për arsye se në zbatim të VKM nr. 97, datë 03.02.2008 “Për procedurat privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe i ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, kanë kaluar në administrim të Bashkive respektive me qëllim privatizimin e tyre nga qytetarë të cilët i përdorin. Sa më sipër shoqëria Albpetrol sh.a Patos **nuk ka zbatuar kërkesat e SNK 16 duke njohur vlerën prej 344,365 mijë lekë në paksim** të “Aktive Afatgjata Materiale” dhe paraqitjen e tyre në vlerën sipas inventarit fizik dhe Udhëzimin të MF nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kapitulli III, pika 28 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos nëpërmjet Drejtorisë së Financës, të marrë masa për transferimin e objekteve të kthyera në banesa që administrohen nga Bashkitë, me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur nga “Aktive Afatgjata Materiale” vlerën 344,365 mijë lekë.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Kjo çështje është shqyrtuar edhe në Këshillin Mbikëqyrës dhe po vijojnë procedurat për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm ligjor për paraqitjen e projekt-vendimit dhe materialeve shoqëruese për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Mbikëqyrës. Për shkak se informacioni është shumë i hershëm, Drejtoria e Finances nuk mund te heqë me iniciativen e saj nga inventari AAM pa vendimarrje të Keshillit Mbikqyres, por janë evidentuar procedura shkresore nga 2014 dhe korespodencë me Entin e Banesave dhe është programuar nga ana e shoqërisë që ky proces të mbyllet me pasqyrat financiare të vitit 2024.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se zëri kontabël “*Aktivet afatgjata materiale*”, me kosto historike në fund të periudhës 31.12.2021 paraqitet në vlerën 32,017,937 mijë lekë (viti 2020: 31,894,548 mijë lekë). Nga procesi i inventarizimit të kryer në zbatim të Urdhrit nr. 203, datë 21.09.2021 “Për inventarizimin e përgjithshëm të pasurisë për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos për vitin 2021”, kanë rezultuar makineri e pajisje, mjete transporti dhe pajisje zyre dhe informatike të cilat nga grupet e inventarizimit sipas Qendrave janë vlerësuar si inventarë jashtë përdorimit.

Me vendim nr. 378, datë 13.09.2022 të Komisionit Qendror i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos pas shqyrtimit të procesverbaleve të përgatitura nga Komisionet e Vlerësimit të Qendrave për makineri e pajisje, mjete transporti dhe pajisje zyre dhe informatike të cilat janë vlerësuar dhe propozuara për jashtë përdorimit, ka vendosur të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të **2214 copë** makineri e pajisje, mjete transporti dhe pajisje zyre dhe informatike me **vlerë të mbetur 96,264,022 lekë**.

Sa më sipër për “*Aktivet afatgjata materiale*”, të vlerësuara për jashtë përdorimit për periudhën objekt auditimi u konstatua se **nuk është ngritur komision për asgjësimin dhe vlerësimin si mbeturinë**, skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27/12/2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” me ndryshime, pikat 109, 110 dhe 111 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos t’i kërkojë Këshillit Mbikëqyrës të, të marrë masa që për “*Aktivet afatgjata materiale*”, vlerësuara për jashtë përdorimit për vlerën 96,264,022 lekë, të ngrejë komisionin për asgjësimin dhe vlerësimin si mbeturinë, skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Shoqëria me mbylljen e inventareve të vitit 2023 po përgatit materialin për Këshillin Mbikëqyrës për AAM që janë propozuar për jashtë përdorimit. Me shkresën nr. 1114/1 prot., datë 13.06.2024 nga ana e grupit të punës është bërë realacion përmbledhës për nxjerrjen jashtë përdorimit të AAM-ve të Albpetrol sha, paskëtij procesi do ti propozohet Këshillit Mbikëqyrës për miratim.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se shoqëria në regjistrat e saj ka materiale të cilat janë stok ose me qarkullim të ngadalshëm për shkak të ndryshimit të teknologjisë apo kalimit të afatit të skadencës në vlerën **1,306,029 mijë lekë** për të cilat shoqëria ka njohur zhvlerësime vetëm për vlerën **137,487 mijë lekë** në periudha të mëparshme, **pra sipas SNK 2 “Inventarët”**, duhet të njihen dhe të pasqyrohen në kontabilitet për vlerën më të vogël.

Nga drejtimi i shoqërisë nuk janë kryer analiza për periudhat kur janë bërë hyrje në magazinë si dhe përqindjet e shfrytëzimit të tyre, si dhe pasojat e mos mbajtjes së të dhënave të kontabilitetit me programe kompjuterike, nuk mundësojnë vlerësime të detajuara për rritjen e mallrave stok. Rritja e vlerave të mallrave stok dhe e mallrave me qarkullim të ngadalshëm ka ardhur si pasojë e përlllogaritjeve jo me saktësi e përgjegjshmëri të sasive të artikujve të kërkuar, duke krijuar material stok, që përveç se ka alokuar fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme,

duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe eficient të burimeve financiare të shoqërisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, pika 103, 107, 108 dhe 109 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse Qendrave kërkues të mallit/aktivitetit, të llogarisin me kujdes nevojat për blerje të materialeve teknologjike e tjera, duke evidentuar më parë gjendjen ekzistuese në magazinë dhe nevojat reale mbi këtë gjendje. Kërkesat për mall të shoqërohen me argumentim dhe relacion përkatës, duke përcaktuar saktë nevojën e përdorimit të tyre përdorimin e mallit dhe jo lënien në magazinë dhe daljen jashtë funksioneve.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigjja e institucionit:

Ky rekomandim pranohet dhe është procedurë që zbatohet në vazhdimësi. Çdo vit, me urdhër të Administratorit të shoqërisë ngrihen Komisionet për kryerjen e Inventarizimit të përgjithshëm të pasurive të shoqërisë, ku përfshihet dhe Komisioni për inventarizimin, evidentimin dhe dokumentimin e elementëve të pasurisë për t’u hequr nga përdorimi dhe ato që nuk i nevojiten shoqërisë (Urdhri nr. 317, datë 3.10.2023)

Për AAM të vlerësuar për jashtë përdorimit, shoqëria “Albpetrol” Sh.A ka bërë im në vlerën **1,306,029 mijë lekë, në masën 60%.**

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se me datë 31.12.2020 debitorët janë deklaruar në vlerën 18,671,912 mijë lekë dhe me datë 31.12.2021 janë deklaruar për vlerën 18,887,733 mijë lekë, (“A” sh.a në vlerën 11,464,502 mijë lekë, Subjekte Privatë në vlerën 6,835,836 mijë lekë, Subjekte Shtetërore në vlerën 331,858 lekë dhe OSHE në vlerën 255,535 mijë lekë), me rritje gjatë vitit 2021, në **vlerën 215,821 mijë lekë** debitorë privat, ku sipas moshës së krijimit debitorë mbi 5 vite janë në vlerën 16,086,667 mijë lekë ose 85 % e debitorëve në total.

Për detyrimin që “A” sh.a, ka ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a Patos e cila është në proces gjyqësor, shoqëria Albpetrol sh.a Patos, ka detyrime ndaj shoqërisë “A” sh.a, për shumën 6,312,329 mijë lekë, konstatohet se për diferencën 5,152,172 mijë lekë (11,464,502 - 6,312,329), janë krijuar provigjone në vitin 2021.

Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e “Llogarive të arkëtueshme tregtare” në vlerën **13,174,589 mijë lekë**. Në pasqyrat financiare janë paraqitur të drejta që i përkasin periudhave të mëparshme duke iu kaluar dhe afatet e parashkrimit, të drejta për të cilat nuk disponojnë dokumente ligjore, subjekte që kanë falimentuar etj. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, pika 3, germa “g” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit dhe Drejtorisë së Financës, të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën **18,887,733 mijë lekë**, si dhe gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca

të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigjja e institucionit:

Nga Drejtoria e Financës janë evidentuar debitorët ndarë sipas vjetërsisë në: deri në 5 vjet, 5 deri në 10 vjet, dhe mbi 10 vjet, dhe procedurat shkresore. Drejtoria Juridike është në ndjekje të procedurave ligjore për arkëtimin e debitorëve. Shumat e provigjonuara dalin si përlllogaritje e përafërt e detyrimeve të mundshme që ka pala debitore, por, në asnjë rast nuk mund të flitet për shifra të sakta, sepse është vetëm Gjykata ajo që do të shprehë shifrën e saktë me vendimin përfundimtar. Po kështu, pas vendimit të gjykatës, mund të vendosen shifra të sakta në pasqyrat financiare.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se “*Të drejta ndaj të tretëve për kontrata hidrokarbure*”, në vlerën 3,679,529 mijë lekë (2020: 3,408,472 mijë lekë). Këto vlera përfaqësojnë vlerën neto përkatëse të sasisë së produktit, që është llogaritur sipas parashikimeve të kontratave hidrokarbure, por që nuk është lëvruar fizikisht në depozitat e Albpetrol sh.a Patos.

Këto vlera në tërësi nuk konfirmohen si detyrim nga ana e kontraktorëve, janë të kontestuar ose janë kundërshtuar në rrugë ligjore prej tyre, për këto shoqëria ka njohur zhvlerësim lidhur me këto të drejta për vitin 2021 në vlerën 400,000 mijë lekë (2020: 200,000 mijë lekë).

-*Të drejta ndaj të tretëve për huadhënie*, në vlerën 652,634 mijë lekë (2020: 652,634 mijë lekë). Këto vlera përfaqësojnë huatë e dhëna për shoqëri që kanë pushuar aktivitetin e tyre, shoqëria ka njohur zhvlerësim për këto të drejta vetëm për vlerën 112,800 mijë lekë.

-*Aktive të tjera mbi një vit*, në vlerën 1,440,564 mijë lekë(2020: 1,438,450 mijë lekë). Këto vlera përfaqësojnë, debitorë të tjerë në vlerën 1,365,728 mijë lekë dhe Akcizë në vlerën 74,836 mijë lekë, shoqëria ka njohur zhvlerësim për këto të drejta vetëm për vlerën 983,254 mijë lekë. Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e “*Llogarive të arkëtueshme të tjera*” në vlerën 4,276,594 mijë lekë. Në pasqyrat financiare janë paraqitur të drejta që i përkasin periudhave të mëparshme duke iu kaluar dhe afatet e parashkrimit, të drejta për të cilat nuk disponojnë dokumente ligjore, subjekte që kanë falimentuar etj. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, neni 12, pika 3, germa “g” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit dhe Drejtorin e Financës, të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve që lindin nga kontratat e hidrokarbureve dhe debitorëve të tjerë, si dhe gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigjja e institucionit:

Ky detyrim ndiqet dhe kërkohet në rrugë administrative në mënyrë të vazhdueshme. Kontraktorëve, me të cilët kemi lidhur marrëveshje hidrokarbure, çdo 3 muaj u kërkohen detyrimet e prapambetura. Për sa i përket rrugëve ligjore, është e pamundur ndjekja në gjykatat

shqiptare, pasi detyrimi është në natyrë (naftë) dhe ky detyrim ka lindur që nga fillimi i marrëveshjeve hidrokarbure, është e pamundur caktimi i një vlere, pasi çmimi i naftës ka qenë i ndryshueshëm.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se “Llogari të pagueshme tregtare” (Furnitorët) me datë 31.12.2020 janë deklaruar në vlerën 10,307,953 mijë lekë dhe me datë 31.12.2021 janë deklaruar për vlerën 10,043,406 mijë lekë, (“A” sh.a në vlerën 6,312,329 mijë lekë, Subjekte Privatë në vlerën 1,583,255 mijë lekë, Subjekte Shtetërore në vlerën 147,504 mijë lekë dhe OSHE në vlerën 2,000,317 mijë lekë), me paksim gjatë vitit 2021, në vlerën 264,547 mijë lekë (furnitor privat në vlerën 188,976 mijë lekë, furnitorë shtetërorë në vlerën 101,254 mijë lekë dhe furnitorë OSHE në vlerën 25,930 mijë lekë), sipas moshës së detyrimeve furnitorët mbi 5 vite janë në vlerën 8,606,957 mijë lekë ose 86 % e furnitorëve në total.

Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë marrë masat për një vlerësim real të gjendjes së “Llogari të pagueshme tregtare” (Furnitorët) në vlerën **10,043,406 mijë lekë** në të cilat janë të përfshira dhe llogari kreditore të subjekteve të cilët kanë kaluar afatin më shumë se 10 vite. Aktualisht prej disa viteve ka kaluar afati i parashkrimit të detyrimeve, nuk ekziston asnjë kërkesë e subjekteve kreditore për shlyerje detyrimi dhe njëkohësisht është parashkruar afati për tu kërkuar në rrugë gjyqësore. Për më tepër qendrat nuk zotërojnë dokumentacionin provë për detyrimin e lindur. Nga drejtimi i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nuk janë vlerësuar risqet për pagesat e kreditorëve në afat për të shmangur kamatëvonesat apo penalitetet të cilat rëndojnë rezultatin e shoqërisë. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, pika 3, germa “gj” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masat për të kryer pagesat e detyrimeve ndaj të tretëve në afatet e duhura, për të shmangur kamatëvonesat apo penalitetet të cilat rëndojnë rezultatin e shoqërisë.

Brenda datës 31.12.2023

Pergjigje nga institucioni:

Nga ana e shoqërisë Albpetrol sha janë marrë masat për likuidimin në kohë të faturave rast pas rasti.

Komenti i grupit të auditimit:

Statusi i plotë i zbatueshmërisë së këtij rekomandimi ngelet për tu verifikuar në auditimet e ardhshme.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se shoqëria Albpetrol sh.a Patos. për muajt Shtatorë, Tetor, Nëntor dhe Dhjetorë 2022, ka blerë energji elektrike me TVSH në vlerën 863,819,525 lekë, me TVSh të zbritshme në shumën **143,969,921 lekë**, nga ku rezulton se kjo sasi e energjisë elektrike nuk është faturuar për konsumatorët fundor shoqëritë koncesionare, private dhe qendrat e vetë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Në deklaratimet mujore të TVSH, rezultoi se kjo sasi është deklaruar si TVSh e zbritshme, gjë e cila çon që situata e TVSH në shitje në muajt përkatës të mos jetë reale për pasojë vlera e TVSH së pagueshme nuk është e saktë, pasi nga shoqëria nuk është deklaruar TVSh e shitje së energjisë së këtyre muajve në adresë të koncesionarëve.

Nga të dhënat e FDP-ve për muajt Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2022, shitjet e tatueshme janë deklaruar në vlerën 3,625,810,585 lekë me TVSH të llogaritur në vlerën 681,690,817 lekë, kur në fakt shitje të tatueshme duhej të deklaroheshin në vlerën 4,489,630,110 lekë, me TVSH të llogaritur në vlerën 825,660,768 lekë, pra nuk janë deklaruar të ardhura nga shitje të energjisë elektrike, minimalisht llogaritur sipas çmimit të blerjes në vlerën **863,819,525 lekë** me TVSH, me TVSH të llogaritur në vlerën **143,969,921 lekë**, veprime të cilat çojnë në deformim të situatës për TVSH e zbritshme dhe TVSH së pagueshme.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, neni 97 “Lëshimi i faturave”, pika 1. Personi i tatueshëm duhet të sigurohet për lëshimin e faturës nga ai vetë ose nga blerësi i tij ose në emrin e tij dhe për llogari të tij nga të tretët, në rastet e mëposhtme, germa “a” për çdo furnizim malli ose shërbimi që kryen kundrejt një personi tjetër të tatueshëm ose një personi juridik të patatueshëm (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masat për faturimin e energjisë së blerë dhe të përdorur nga konsumatorët fundor për të shmangur penaltete që lindin nga mos deklarimi i shitjeve nga organet fiskale, të cilat rëndojnë rezultatin e shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në janar 2023 janë bërë faturimet për 2022, pas vendimit të ERE. Jane bërë faturat nga QFSHE dhe efekti tyre është marrë me pasqyrat financiare 2022.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

10. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit për blerë karburanti për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022, u konstatua se sasia e përcaktuar për blerje dhe fondi limit përkatës nuk është llogaritur në përputhje me dispozitat ligjore, kjo për sasinë 820 000 litra vitit 2021 dhe sasinë 1 150 000 litra vitit 2022, pasi:

Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se nga shoqëria *Albpetrol sh.a* nuk është të argumentuar me analizë të hollësishme referuar mbi sasinë e karburantit gazoil/benzinë, gjendje në magazinë, me analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (*motogjenerator, kaldaja, etj.*) në qarkullim e gjendje pune inventar i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, apo gjendje inventar në njësitë shpenzuese vartësi e bashkisë, mbi sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit Administrativ, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit, veprime në kundërshtim me neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu II “Rregullat e Përgjithshme të prokurimit” neni 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës” i ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve dhe Furnizimit, të marrë masa për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Gjatë procesit të hartimit të Programit të Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, 2024, miratuar në Këshillin Mbikëqyrës me vendimin nr. 1, datë 20.02.2024. Planifikim i nevojave për gazoil është bërë duke u bazuar në nevojat e mjeteve dhe volumeve të punës së parashikuar për t’u kryer. Ky plan është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

11. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi me zgjedhje në lidhje me konsumin e karburantit dhe pjesëve të ndërrimit në Qendrën e Furnizimit dhe Transportit (QFT) u konstatua se, për katër mjete KIA me targë AA305BE, KIA me targë AA184AI, KIA me targë AA439AT dhe KIA me targë AA892AL, për vitin 2021 janë kryer shpenzime për riparim, konkretisht:

- a- Për mjetin KIA me targë AA892AL, në vlerën 41,900 lekë.
- b- Për mjetin KIA me targë AA184AI, në vlerën 70,000 lekë nga kjo (goma në 56,000 lekë).

Për vitin 2022 janë kryer shpenzime vetëm për mjetin KIA me targë AA184AI, në vlerën 211,500 lekë.

Për konsumin e karburantit rezultoi se qendrat bëjnë kërkesë për furnizim pranë Drejtorisë së Shërbimeve dhe Furnizimit. Nga auditimi në lidhje me kërkesat për karburant nga QFT për katër mjete KIA me targë AA305BE, KIA me targë AA184AI, KIA me targë AA439AT dhe KIA me targë AA892AL rezultoi se për vitin 2021 janë furnizuar me 6990 litra karburant (*KIA me targë AA184AI, për 3065 litra dhe KIA me targë AA892AL, 3925 litra*).

Nga të dhënat e marra nga kartelat e harxhimit të karburantit të QFT rezultoi se, për mjetet KIA me targë AA184AI dhe KIA me targë AA892AL, sipas flet udhëtimeve janë harxhuar 7745 litra (*KIA me targë AA184AI, për 3485 litra dhe KIA me targë AA892AL, për 4260litra*), **më shumë 755 litra.**

Për periudhën objekt auditimi rezultoi se nuk ka rakordim midis Drejtorisë së Shërbimeve dhe Furnizimit dhe Qendrën e Furnizimit dhe Transportit (QFT) për sasinë e karburantit të furnizuar dhe shpenzimit faktik sipas fletë udhëtimeve.

Gjithashtu rezultoi se fletë udhëtimeve, e plotësuar për harxhimin e karburantit nuk janë plotësuar saktë për km e përshkruara, nuk kanë emirin e personit që kanë firmosur për shërbimin e kryer, nuk janë të qarta për km dhe volumet e punëve të kryera, nuk janë nënshkruar nga nëpunësi urdhërues, janë plotësuar me shkrim të pakuptueshëm, nuk është mbajtur Procesverbal për konsumin e karburantit për çdo muaj, daljet e karburantit nga magazina nuk janë shoqëruar me urdhër dorëzimi dhe me flet kërkesë, pra dokumentacioni për argumentimin e konsumit të karburantit mungon, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27/12/2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikën 36 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marri masa për hartimin e dokumentacionit ligjor në menaxhimin e karburantit,

duke evidentuar me dokumentacion të saktë sasitë e harxhuar nga çdo Qendër e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos që është përdoruese e gazoilit në veprimtaritë vjetore.

Pergjigje e Institucionit:

Shoqëria “Albetrol” Sh.A ka hartuar dhe ndjek një procedurë ligjore shoqëruar me dokumentacion shkresor për konsumin e karburantit mbi bazë mujore. Daljet e karburantit nga magazina shoqërohen me urdhër dorëzimi (autorizim për furnizimin mujor) dhe me fletë-kërkesë (autorizimin me nënshkrimin e Drejtorit dhe kryeinxhinierit) të Qendrës. Në fillim të muajit pasardhës paraqitet nga Qendra evidenca mujore ku pasqyrohet konsumi i karburantit.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

11.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të nxjerrë mision auditimi për Drejtorinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e një kontrolli të thelluar të dokumentacionit ligjorë të përdorimit të gazoilit, të gomave dhe pjesëve të këmbimit të mjeteve nga çdo Qendër për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022 nga momenti i furnizimit të tyre. Në rast të konstatimit të diferenca të pashoqëruara me dokumentacion ligjorë të evidentohen përgjegjësit dhe të merren masa për shpërblim të dëmit.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Në vazhdimësi Strukturat përgjegjëse për realizimin e procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kërkesave nga qendrat, si dhe dokumentacionit shkresor që e shoqëron këtë proces janë: Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik dhe Drejtoria e Prodhimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

12. Gjetje nga auditimi: Ndryshimet e shpeshta në drejtimin e Albpetrol sh.a Patos, për periudhën objekt auditimi janë emëruar dhe shkarkuar 6 administratorë, dhe kjo ka sjellë për pasojë emërimin dhe shkarkimin nga detyra të 35 drejtorëve të drejtorive të kësaj shoqërie për vitin 2021 dhe 24 drejtorë drejtorie për vitin 2022.

Po ashtu për vitin 2021 janë emëruar 172 punonjës dhe janë larguar 179 punonjës. Për vitin 2022 janë emëruar 115 punonjës dhe janë larguar 154 punonjës.

Për vitin 2021 shkaqet e largimeve nga detyra janë: largime nga puna me motivacion shkelje disiplinore / mungesë në vendin e punës 21%, dalje në pension 41%, dhe dorëheqje 15%.

Për vitin 2022 shkaqet e largimeve nga detyra janë: largime nga puna me motivacion shkelje disiplinore / mungesë në vendin e punës 24%, dalje në pension 51%, dhe dorëheqje 20%.

Ndryshimet e shpeshta të Administratorëve dhe të drejtorëve të shoqërisë Albpetrol sh.a, rrezikojnë të sjellin pasiguri dhe performancë të ulët te punonjësit e shoqërisë për shkak të paqëndrueshmërisë në vendin e punës. Vihet re trendi rritës i pushimeve nga puna dhe dorëheqjeve, që për pasojë ka rezultuar në kosto shtesë në procese gjyqësore, dëmshpërblime për largimin e padrejtë nga puna, duke rënduar kështu situatën ekonomiko - financiare të kësaj shoqërie (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të analizohet situata e lëvizjeve të shumta të punonjësve dhe të strukturave drejtuese dhe të

merren masa lidhur me qëndrueshmërinë e punonjësve duke përmirësuar performancën e shoqërisë Albpetrol sh.a.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Struktura aktuale e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A është miratuar me vendimin nr. 10, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 4.10.2023 (i ndryshuar).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe është *i zbatuar*.

13. Gjetje nga auditimi: Sipas programit ekonomik në Albpetrol sh.a Patos për vitin 2021, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 1,790 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezultoi se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2021 është realizuar 1,745 punonjës. Fondi i pagave është 1,222,944 mijë lekë, pra **61,125 mijë lekë** më pak se programi.

Sipas programit ekonomik në Albpetrol sh.a për vitin 2022, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezultoi se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2022 është realizuar 6,156 punonjës. Fondi i pagave është 1,272,792 mijë lekë, pra **179,741 mijë lekë** më pak se programi.

Mos plotësimi i nevojave të shoqërisë me numrin e parashikuar të punonjësve ndikon në performancën dhe në rezultatin e saj financiar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e nevojave për punonjës të shoqërisë referuar parashikimeve të programit ekonomik.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Struktura aktuale e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A është miratuar me vendimin nr. 10, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 4.10.2023 (i ndryshuar).

Numri mesatar i punonjësve të shoqërisë është parashikuar mbi bazë të një analize të hollësishme, në programin e Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë, 2024, miratuar me vendimin nr. 1, datë 20.02.2024, të Këshillit Mbikëqyrës. Në vazhdimësi nga strukturat e menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën qendrore dhe qendrat e varësisë bëhen analiza për rritjen e performancës së punës së burimeve njerëzore ekzistuese dhe kërkesës për rekrutime të punonjësve të rinj, sipas nevojave që krijohen.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

14. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi konstatohet se në Albpetrol sh.a:

-Nuk është hartuar “Procedura e lëvizjeve të stafit”, “Rregullore për emërimet”.

-Nuk është bërë për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve.

-Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë, nga Burimet Njerëzore, pranë Albpetrol sh.a nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura.

Po ashtu procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhjes nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.

-Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 188 masa disiplinore, nga këto 35 masa “Tërheqje vëmendje”, 18 masa “Vërejtje me gojë”, 58 masa “Vërejtje me shkrim”, 8 masa “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, 6 masa “Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët”, dhe 63 masa “Pushim nga puna”. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka komision apelimi (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe hartimi dhe miratimi i rregulloreve për emërimin dhe procedurat e lëvizjeve të stafit të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos

Përgjigja e institucionit:

Struktura aktuale e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A është miratuar me vendimin nr. 10, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 4.10.2023 (i ndryshuar). Procedurat për emërimin dhe lëvizjet e stafit të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos janë parashikuar në Kontratën Kolektive të Punës nr. 1026 prot., datë 10.02.2023, dhe amendimeve të saj, nr. 2347 prot., datë 22.04.2024. Po kështu, është miratuar me vendimin nr. 8, datë 2.05.2024 të Këshillit Mbikëqyrës, Rregullorja për Programin “Punësimi i Profesionistëve të Rinj në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

14.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me masat disiplinore në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Me nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës nr. 1026 prot, datë 10.02.2023, dhe amendimeve të saj, nr. 2347 prot., datë 22.04.2024.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

15. Gjetje nga auditimi: -Për vitin 2022 Albpetrol sh.a ka arritur një rezultat financiar bruto rreth 412.2 milion lekë. Ndikim në përmirësimin e situatës kanë patur: *rritja e çmimit të naftës Brut nga 37,169 lekë/ton në 51,893 lekë/ton*, pra me një rritje prej 139,6%.

-Për vitin 2022 është realizuar një volum shitje prej 95,883 ton, kundrejt 108,736 ton të programuar ose 88.2%

-Nga aktiviteti i shoqërisë prodhimi i naftës është realizuar 70,570.5 ton kundrejt 75,920 ton të programuar ose 93%, me mosrealizim prej 5,350 ton naftë. Mosrealizimi vjetor i prodhimit të naftës nga shoqëria, vendburimet në administrimin e saj ka ardhur kryesisht për pasojë të 6 mujorit të parë, me një defiçit ndaj programit -6,577 ton naftë dhe një bazë ditore prej 171.7 ton/ditë kundrejt 208 ton/ditë të programuar.

-Detyrimet e mbetura pa shlyera deri më 31 Dhjetor 2022 ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a nga kompanitë konçesionare për naftën bruto rezultojnë 134,401 ton naftë duke u rritur me rreth 17,557 ton krahasuar me fundin e vitit 2021.

-Gazi i prodhuar nga vet Albpetrol është gaz shoqërues dhe për vitin 2022 është realizuar 110 mijë N/m³ nga 270 mijë N/m³ programuar ose 40.8 %.

-Investimet për vitin 2022 janë realizuar në vlerën 243,602 mijë lekë nga 836,126 mijë lekë të programuar ose rreth 29.1 %.

-Janë realizuar të ardhura rreth 6.59 miliardë lekë dhe janë kryer shpenzime rreth 7.6 miliardë lekë. Duke filluar nga muaji Shkurt 2022, në evidencën e bilancit të grumbullimit dhe shpërndarjes të naftës për kompaninë, nuk janë përpunuar të dhënat për vitin 2022, referuar faktit që bilanci i dërguar nga Qendra e Administrim Shitjeve të Naftës dhe Gazit ka patur problematika të cilat janë bërë prezente zyrtarisht nga Drejtoria e Programimit, pasi nevojitet vendimmarrje e shoqërisë.

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit sipas pasqyrës PASH të bilancit kontabël të shoqërisë janë realizuar 6,587,574 mijë lekë.

Krahasuar me ato të programuara 5,851,206 mijë lekë janë realizuar 112.6 % ose me tejkallim prej 736,367 mijë lekësh, kryesisht nga tejkallimi i të ardhurave nga shitja e naftës.

Për vitin 2022 në Regjistrin e prokurimeve publike janë parashikuar për tu prokuruar 167 procedura, detajuar për Investime 78 procedura, Materiale 48 procedura dhe Shërbime 41 procedura.

Nga monitorimi i elementeve të Regjistrit të Prokurimeve për vitin 2022, rezulton se nga 167 elementë të parashikuar në regjistër 54 elementë ose 33 % e totalit kanë vijuar me procedurat, ndërsa 113 elemente ose 67 % e totalit janë me statusin të pazhvilluar (ose anuluar).

Nga procedurat e parashikuara për tu prokuruar në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2022, është arritur të realizohen procedura me kontratë gjithsej 54 procedura me vlerë totale të kontratave 564,227,021 lekë.

-Gazi i prodhuar nga vet Albpetrol është gaz shoqërues dhe për vitin 2022 është realizuar 110 mijë N/m³ nga 270 mijë N/m³ programuar ose 40.8 %. Detyrimet e kontraktorëve për prodhimin e gazit ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a rezultojnë në sasinë 24,426,313 Nm³. Sa më sipër bie në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat e tjera të shoqërisë, të marrë masa konkrete për kryerjen e investimeve në sektorët strategjik të shoqërisë me qëllim maksimizimin e prodhimit të naftës si burimi i saj kryesor i të ardhurave dhe uljen e kostove për nxjerrjen e saj dhe në bashkëpunim me drejtorinë e institucionit të bëjnë dhe një analizë të thelluar për arsyet e mos realizimit të zërave kryesor të programuara në fillim viti.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Programi i Zhvillimit Ekonomik i shoqërisë, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, është dokumenti strategjik në të cilin paraqitet analiza e treguesve kryesorë teknikë dhe ekonomiko-financiarë të shoqërisë në vitin paraardhës, si dhe parashikimi, përfshirë investimet në sektorë të ndryshëm, sipas prioriteteve të zhvillimit, me fokus rritjen e efektivitetit të prodhimit të naftës bruto, në vitin për të cilin hartohet Programi. (Vendimi nr. 1, i Këshillit Mbikëqyrës, datë 20.02.2024, dhe vendimi nr. 2155/1, i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, datë 08.03.2024).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pjesërisht zbatuar*.

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, rezulton se:

Nga 74 procedura me fond limit 1,170,945 mijë lekë, janë zhvilluara procedura prokurimi me 1 OE, gjithsej 32 procedura me fond limit 449,105 mijë lekë ose 38% e fondit të prokuruar, nga e cila: të vitit 2021 janë 17 procedura me fond limit 365,722 mijë lekë ose 50.9 % e fondit dhe të vitit 2022 janë 15 procedura me fond limit 83,383 mijë lekë ose 18.3% e fondit të prokuruar.

Kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me llojin e procedurës dhe të mirë argumentuara, gjë e cila ka çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, veprime këtë që çojnë në përdorimin e fondeve pa efektivitet si rezultat u mungesë së konkurrencës në garë.

Për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022 në 8 procedura me fond limit 254,111 mijë lekë u konstatua vendosja e kriterëve të paargumentuara jo në përputhje me procedurat e zhvilluara, të cilat kanë ndikuar në mos pjesëmarrjen e OE ose në skualifikimin e OE me oferta të leverdishme, konkretisht:

- Për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit, etj.

- Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim, është kërkesë e tejkualuar e nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar. Gjithashtu në zbatim të nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, konstatohet se nga AK në të gjitha rastet është kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për periudha të ndryshme.

- Është kërkuar certifikatë ISO 3834-2:2005 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, kërkesë e gabuar pasi shërben për prodhimin me saldim.

Veprime këto në shkelje të neneve 1, 2, pika 1 e nenit 21, neni 78 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve dhe 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, në bashkëpunim me Drejtorinë e Prokurimit Publik, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojnë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Administratori i shoqërisë “Albpetrol” sh.a bashkëpunon me Drejtorinë e Prokurimit, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në vijim, duke diskutuar mënyrën e përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, në mënyrë që të mbahet parasysh në çdo rast tipologjia e objektit të kontratës, vlera limit e planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në

preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike, me qëllim për të garantuar trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

Statusi i plotë i zbatueshmërisë së këtij rekomandimi ngelet për tu verifikuar në auditimet e ardhshme.

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit rezulton se:

- Nuk është hartuar dhe miratuar plani i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

-Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen, ngritjen dhe zhvillimin profesionale të stafit. Mungojnë programe për trajnimin e stafit, si dhe u konstatuan mangësi në njohjen e ligjit 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar

- Nuk është kryer vlerësimi i punës për çdo punonjës dhe ky vlerësim mungon në dosjeve personale të punonjësve.

-Nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik, nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e riskut, regjistri i riskut, gjurma e auditimit, lista e proceseve, si dhe nuk janë përcaktuar persona përgjegjës për monitorimin dhe zvogëlimin e risqeve, duke mos u identifikuar dhe vlerësuar risqet që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit.

-Nuk ka procedura të përcaktuara anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullive.

-Nuk është plotësuar pyetëtori i vetëvlerësimit, deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ku të përcaktohen pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi, nevoja për përmirësim, si dhe kjo deklaratë nuk është raportuar në MFE.

-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

-Nuk ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Aktualisht Shoqëria ka faqe zyrtare e cila është e dedikuar për aktivitetin e kërkimit, prodhimit të naftës dhe gazit. Për periudhën nga 03.09.2019, deri më datën 31.12.2020, posta elektronike zyrtare dhe faqja e shoqërisë kanë pasur mungesë të certifikatës së sigurisë, mungesë rinovimi licencash, duke çuar në pasigurinë e funksionim të sistemit të komunikimit në faqen zyrtare.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, germa “a” dhe “b”, neni 15, pikat 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 18, pika 1, neni 21, pikat 1-3, neni 27, pika 2, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli IV, pika 4.2.8, Kapitulli II, pika 2.5.2, pika 3.2, Kapitulli IV, Shtojca 2, dhe Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe Raportit Përfundimtar vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa për të rritur performancën e saj në drejtim të përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, të personelit, pasurive dhe buxhetit sipas planeve të biznesit, që menaxhmenti i kësaj shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve, por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë dobiprurëse.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Është hartuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut (Urdhri 25, datë 30.01.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A; urdhri nr. 125, datë 08.04.2024, “Për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Riskut në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A; urdhri nr. 208, datë 21.06.2024 “Për miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A. Pyetësi i vetëvlerësimit, deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ku përcaktohen pikat e forta dhe të dobëta, si dhe deklarata janë plotësuar dhe raportuar në MF. Delegimi i detyrave bazohet në ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” dhe zbatohet rast pas rasti me vendim apo urdhër të Administratorit të shoqërisë. Rregullorja për Programin “Punësimi i Profesionistëve të Rinj në shoqërinë “Albpetrol” Sh.A është miratuar me vendimin nr. 8, datë 2.05.2024 të Këshillit Mbikëqyrës.

Faqja zyrtare e shoqërisë është rindërtuar, me të gjithë elementët e sigurisë, dhe në përputhje me standardet bashkëkohore, duke i dhënë një rëndësi të veçantë rubrikës “Programi i Transparencës”, i realizuar mbi direktivat dhe rekomandimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

17.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë të gjitha masat e nevojshme për rinovimin e licencave për faqen zyrtare dhe postën elektronike si dhe pajisjen e tyre me certifikatë sigurie, me qëllim mirëfunksionimin e tyre dhe ruajtjen e të dhënave kofidenciale të vetë institucionit

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Është krijuar faqja e re zyrtare dhe janë rinovuar të gjitha licencat përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se mungojnë dokumentacionet ose projekt vendimet e propozuara në Këshillin Mbikëqyrës të cilat kanë çuar në marrjen e vendimeve. Mungojnë procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Albpetrol sh.a për vendimet e datave 08.11.2022, 24.01.2022, 04.02.2022, 08.04.2022, 27.05.2022, 16.05.2022, 02.08.2022, 08.11.2022 dhe 15.12.2022.

-Nuk është nënshkruar kontratë pune midis Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorëve të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, veprim në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë.

Është nënshkruar kontratë individuale pune nga Këshilli Mbikëqyrës, z. I.Gj., Kryetar i Këshillit dhe Administratorit aktual z. E. D., u konstatua se kontrata e nënshkruar është e pa protokolluar në shoqërinë Albpetrol sh.a (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. **18.1.Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që në të gjitha rastet e propozimeve për marrje vendimi nga Këshilli Mbikëqyrës, projekt vendimet të shoqërohen me dokumentacionin mbështetës për çdo çështje.

Këshillit Mbikëqyrës të marrë masa për lidhjen e kontratës së punës me Administratorin e Shoqërisë sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Përgjigjja e institucionit:

Për çdo proces vendimmarrjeje nga Këshilli Mbikëqyrës. Projektvendimet e propozuara nga Administratori në Këshillin Mbikëqyrës në çdo rast shoqërohen me relacion shoqërues dhe dokumentacion ligjor plotësues, sipas natyrës së çështjes për të cilën kërkohet vendimmarrje. Ky dokumentacion administrohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Kompetencat e Administratorit janë të përcaktuara në Ligj dhe në Statutin e shoqërisë. Rrjedhimisht, Kontrata e punës së Administratorit nuk parashikohet në kompetencat që parashikojnë punën e Këshillit Mbikëqyrës.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë Nr.6245, datë 01.09.2021 i lidhur me subjektin “K” sh.p.k. u konstatua se në dosje nuk ka procesverbal të dorëzimit të objektit të dhënë me qira, si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës, si dhe për arkëtimin e të ardhurave, gjithashtu në dosje ndodhet dhe një procesverbal ku është konstatuar që subjekti përdor 53.184 m² sipërfaqe ndërtimi më shumë se sa kontrata, dhe 4610.816 m² sipërfaqe funksionale më shumë se sa kontrata dhe duhet të bëhet arkëtimi i detyrimit mujor 142,186 lekë.

- Nga auditimi i kontratës së qirasë Nr.9030, datë 12.11.2021 i lidhur me subjektin “B.” shpk, dhe kontratës së qirasë Nr.9030, datë 12.11.2021 i lidhur me subjektin “G. sh.p.k. me objekt kontrate “ish-Remonti Kapital në ish-QPN Marinëz” në administrim nga QAKP Patos, janë dy kontrata qiraje me të njëjtin numër protokolli, por me dy subjekte të ndryshme, në dosje nuk ka procesverbal të dorëzimit të objektit të dhënë me qira, si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës, si dhe për arkëtimin e të ardhurave, gjithashtu në dosje ndodhet dhe një procesverbal nga 4 punonjës të Albpetrol sh.a Patos ku është konstatuar që subjekti “B” sh.p.k. përdor 2466.89 m² sipërfaqe funksionale më shumë se sa kontrata dhe duhet arkëtuar detyrimi mujor 69,073 lekë nga subjekti, si dhe të përcaktohet periudha që është përdorur objekti padrejtësisht nga subjekti. Për të njëjtin objekt janë dy kontrata qiraje me të njëjtin numër protokolli, por me dy subjekte të ndryshme, nuk ka proces verbal të dorëzimit të objektit si dhe foto të objektit të dorëzuar, nuk ka raportime me shkrim mbi realizimin e kushteve të kontratës. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 1 dhe pikën 7 të nenit 5 të Kontratës së Qirasë.

- Kontratë qiraje me nr.671 prot , datë 24.01.2022 ndërmjet qiradhënësit “Albpetrol “ sh.a dhe qiramarrësit Z. A M, për dhënien me qira të objektit “*Ish guzhina Vllahinë*” me sipërfaqe 48 m², në administrim të Qendrës Prodhimit të Naftës Gorisht. Çmimi i kontratës nr.671 prot , datë 24.01.2022 është llogaritur në përputhje me pika 5 të kreut III te VKM nr.54, datë 05/02/2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar (48m² x 75 lekë/m² = 3600 lekë /muaj pa t.v.sh). Në shumën prej 3600 lekë/muaj nuk është e përfshirë konsumi i energjisë elektrike dhe ujit nga qiramarrësi. Subjekti A M në rolin e qiramarrësit objektin me sipërfaqe 48 m² do e përdor për ushtrim aktiviteti privat (Bar – kafe). Në nenin 2 të kontratës nr.671 prot, datë 24.01.2022 nuk është përcaktuar kohëzgjatja e kontratës të nënshkruar nga palët “Albpetrol” sh.a dhe subjektit A M, në kundërshtim me VKM nr.54, datë 05/02/2014 germa “a”, pika 5, kreu I në të cilën citohet “*dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m² të jepen me afat deri në 1 vit*”.

- Kontratë qiraje me nr.1132 prot, datë 04.02.2022 ndërmjet qiradhënësit “Albpetrol” sh.a dhe qiramarrësit dhe shoqërisë “A” shpk, për dhënien me qira të makinerisë “Vinç Cjap 5 Ton”. Çmimi i kontratës nr.1132 prot, datë 04.02.2022 është llogaritur në përputhje me kreun III,

pika 5 e VKM nr.54, datë 05/02/2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira , enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Makineria “ Vinç Cjap 5 Ton “ është dhënë me qira shoqërisë “A” shpk , mbështetur në kreu I, pika 5, germa b të VKM nr.54 , datë 05/02/2014 ku citohet: “*makineritë dhe pajisjet e shkëputura jepen me qira për një afat 1 vjeçar*”. Kontrata nr.1132 prot , datë 04.02.2022 është nënshkruar më 04.02.2022 , por në nenin 2 të saj nuk është përcaktuar afati i skadimit të saj. Makineria “Vinç Cjap 5 Ton” është në administrim të Q.F.T Patos dhe nuk është e nevojshme për ushtrimin e aktivitetin e kësaj qendre , per pasojë është dhënë në gëzim të përkohshëm shoqërisë “Arditi – 06 “ shpk me çmimin e përcaktuar në nenin 3 të kontratës nr.1773 prot , datë 24.02.2022. Për makineritë dhe pajisjet vlera e detyrimit mujor të qirasë përcaktohet sa 1/10 e vlerës aktuale minimale të llogaritur si diferencë e vlerës fillestare të kontabilizuar minus amortizimin në vite, mbështetur në Vendimin nr. 401 , datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave (pjesa për investime) shumëzuar me indeksin e çmimeve të muajit përkatës publikuar nga INSTAT-i . Në pikën 2 të nenit 3 të kontratës cilësohet se detyrimi mujor i qiramarrësit “Arditi – 06 “ sh.p.k është në vlerën 2000 lekë.

Nga auditimi u konstatua se dhënia me qira e objekteve, në përgjithësi nuk iniciohet sipas rregullave të vendosura dhe disiplinuar në VKM 54, datë 5.02.2014, “*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”. Shoqëria nuk ka ndjekur procedura ligjore komunikimi me publikun dhe i mungon informacioni online për publikun në faqen e saj mbi objektet që ajo është e interesuar të lëshojë me qira, pasi Albpetrol ka shumë objekte të tilla që nuk kryejnë asnjë funksion por që administrohen nga qendrat e saj. Zakonisht procedimi i dhënies me qira kryhet nëpërmjet të interesuarve që bëjnë konstatim fizik mbi objektet jashtë funksioni në pronësi të Shoqërisë Albpetrol (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 144-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës të marrë masa që në të ardhmen për secilën kontratë qiraje të zbatohen të gjitha etapat e përshkruara shumë qartë në kuadrin ligjor, për lidhjen dhe zbatimin e tyre.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Administratori i shoqërisë ka nxjerrë urdhrin nr. 190, datë 29.06.2023, “Për ndjekjen dhe zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë”, për marrjen e masave mbi zbatimin e kuadrin ligjor dhe kushteve të kontratave të qirasë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

19.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës dhe Drejtorinë e Programimit dhe Zhvillimit Strategjik, të ndërmarrë një plan konkret masash për rritjen e efikasitetit për lëshimin e objekteve me qira, veçanërisht në fushën e marketingut të shoqërisë.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Shoqëria ka evidentuar dhe ka hartuar regjistrin e pronave në administrim, duke bërë analizë të plotë për vlefshmërinë e tyre në aktivitetin prodhues dhe administrativ të saj, për t'ë dhënë me qera pronat e lira, pa cenuar aktivitetin e shoqërisë.

Në faqen e vet zyrtare shoqëria "Albpetrol" Sh.A ka publikuar pronat e lira që mund të kenë interes nga subjekte fizike e juridike, apo qytetarë, për t'i marrë me qera, në përputhje me dispozitat ligjore.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

20. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Administrimit dhe Ruajtjes Pronave, në bashkëpunim me Qendrat e Shoqërisë dhe me ZVRPP-të e rretheve, ka të listuar dhe të përditësuara të gjitha pronat e zëna nga posedues të paligjshëm si dhe pronat me mbivendosje. Këto prona janë zënë gjatë një periudhe të gjatë përpara periudhës së auditimit dhe megjithëse dhe nga grupet e mëparshme të KLSH-së është rekomanduar që të ndërmerren hapa ligjorë për këtë problematik, nga ana e Albpetrol sh.a ende nuk është marrë një veprim i tillë.

Administratori i shoqërisë i kërkon të gjitha Qendrave që në rast të konstatimit të poseduesve të paligjshëm në asetet e shoqërisë duhet ti kallëzojnë ato pranë organeve ligj zbatuese. Ky urdhër ka mbetur thjesht si një procedurë burokratike pasi ende nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret që këto objekte apo pasuri truall të zaptuara, apo sipërfaqe të Shoqërisë me mbivendosje në ZVRPP të rikthehen e gëzohen në përdorim e pronësi të Shoqërisë.

Shoqëria Albpetrol Sh.a ka të dokumentuara 3,500 puse nga të cilat ka 160 puse me vërtetime hipotekore dhe 3,340 puse me certifikate pronësie që do të thotë se ende 4,5% e kësaj lloji prone nuk zotërohet e regjistruar me certifikate pronësie.

Objektet e dokumentuara në ZRPP vendore gjithsej 454 objekte, nga të cilat 25 janë me vërtetim hipotekor ndërsa 429 janë të dokumentuara me certifikate pronësie.

Pra, janë regjistruar gjithsej 3,954 pasuri, puse dhe objekte të shoqërisë nga të cilat 185 pasuri janë me vërtetim hipotekor dhe 3,769 pasuri të shoqërisë janë me certifikate pronësie të rregullta. Pronat e regjistruara me vërtetim hipotekor zënë rreth 4,7% të pronave të regjistruara me certifikate pronësie.

Konstatohet se janë të pa regjistruara në ZVRPP vendore përkatëse 1,776 puse dhe 21 objekte të Shoqërisë ose në total 1,797 pasuri të shoqërisë janë të paregjistruara.

Nga auditimi rezulton se, pasuritë e patundshme të shoqërisë janë gjithsej 5,751 pasuri. Numri i pronave të paregjistruara zë një peshë prej 31,2% por duke llogaritur edhe 4,7% të pronave që janë regjistruar me vërtetim hipotekor, pasuritë pa dokumentin ligjor të vërtetimit të pronësisë, certifikatën e pronësisë, shkon në 39% të numrit total të pronave që tregon për një punë të dobët të stafit drejtues të Shoqërisë dhe Ministrisë së linjës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 144-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit dhe Ruajtjes së pronës të ndërmarr hapa konkret duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në bashkëpunim me organet kompetente ligj zbatuese për marrjen në dorëzim të pronave të ligjshme të shoqërisë.

Përgjigjja e institucionit:

Administratori i shoqërisë ka nxjerrë urdhrin nr. 89, datë 11.04.2023, "Për ngritjen e Strukturës së Posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme të shoqërisë "Albpetrol"

Sh.A dhe pajisjen me certifikatë pronësie të çdo pasurie të saj”. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. u ka dërguar qendrave në varësi të saj shkresën nr. 7370 prot, datë 20.09.2023, “*Mbi zbatimin e urdhrin nr. 265, datë 31.08.2023*”, ku është kërkuar marrja e masave për verifikimin dhe listimin e pronave të zëna nga individë apo subjekte të ndryshme, si dhe është kërkuar të merren në dorëzim këto prona. Në rastet e mos dorëzimit, do të ndiqet rruga ligjore nëpërmjet Drejtorisë Juridike. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. në zbatim të ligjit nr. 20/2020 “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*” dhe VKM-së nr. 28, datë 27/01/2023 “*Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve*”, po kryen procedurat e përditësimit dhe regjistrimit të pasurive të saj.

Për këtë është mbajtur komunikimi me ASHK (shkresa e fundit është me nr. 4209 prot., datë 11.07.2024)

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

20.2. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë hapa konkret për regjistrimin e aseteve të pa regjistruara. Regjistrimi dhe certifikimi i tyre sa më shpejtë ndikon në mënyrë direkte në rritjen e vlerës së shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Shoqëria “Albpetrol” sh.a. në zbatim të ligjit nr. 20/2020 “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*” dhe VKM-së nr. 28, datë 27/01/2023 “*Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve*”, po kryen procedurat e përditësimit dhe regjistrimit të pasurive të shoqërisë “Albpetrol” sh.a.

Për këtë është mbajtur komunikimi me ASHK (shkresa e fundit është me nr 4209 prot., datë 11.07.2024).

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

21.1 Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 4546 prot., datë 14.06.2022, drejtuar KLSH, Administratori i Albpetrol sh.a ka dërguar informacion (Planin e Masave) mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së, brenda afatit 20 ditor.

Albpetrol sh.a nuk i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 50 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 8 masa, janë në proces realizimi 8 masa dhe 31 masa nuk janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 10 masa për shpërbllim dëmi, në vlerën 346,696,708 lekë, nga të cilat 2 masa janë zbatuar dhe 7 masa nuk janë zbatuar,

-Janë rekomanduar 22 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, nga të cilat janë në proces realizimi 1 masa, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 14 masa nuk janë zbatuar.

-Është rekomanduar 1 masë Administrative, e cila nuk është zbatuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.11 faqe 300-350, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marri masat për zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pa zbatuara, dhe të zbatuara pjesërisht. Ndërsa për të gjitha rekomandimet e tjera, që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2023.

Përgjigja e institucionit:

Shoqëria “Albpetrol” sh.a. në zbatim të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-së nr. 28, datë 27/01/2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, po kryen procedurat e përditësimit dhe regjistrimit të pasurive të shoqërisë “Albpetrol” sh.a.

Për këtë është mbajtur komunikimi me ASHK (shkresa e fundit është me nr 4209 prot., datë 11.07.2024).

Komenti i grupit të auditimit:

Situata mbi statusin e rekomandimeve të kaluara gjendet e reflektuar rast pas rasti sipas çështjeve përkatëse në material, referuar totalit të masave të lëna, nga grupi auditimit gjykohen pjesërisht të zbatuara

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

22. Gjetje nga auditimi: Shoqëria Albpetrol sh.a, bazuar në Aktin Normativ Nr. 2, datë 16.06.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28/07/1993 “Për hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim)”, të ndryshuar, mund të tregtojë produktet hidrokarbure për tregun vendas, apo për eksport sipas çmimit të bursës ndërkombëtare për hidrokarburet, ku Ministria përgjegjëse që drejton veprimtarinë, miraton procedurat e tregtimit të hidrokarbureve, të parashikuara në Urdhrin nr. 83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve Hidrokarbure” të ndryshuar.

Shoqëria Albpetrol, naftën bruto të prodhuar vetë, dhe sasinë e naftës bruto të përfituar nga kushtet e zbatimit të marrëveshjes me kontraktorët e ndryshëm, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës dhe gazit, e shet nëpërmjet ankandeve publike për tregun e brendshëm ose për eksport. Në lidhje me realizimin e procedurave të shitjes së naftës me ankand, grupi auditues kreu verifikimet mbi zbatimin e bazës ligjore në fuqi dhe përgjegjësisive të parashikuara në aktet rregullatorë për strukturat përgjegjëse në shoqërinë Albpetrol sh.a, për të evidentuar problematikat kryesore si mos saktësime në Urdhrin nr. 83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve Hidrokarbure” të ndryshuar, si dhe zbatimin e tij.

-Në udhëzimin e mësipërm në lidhje me përcaktimin e çmimit të shitjes janë pikat 6 e 7, ku citohet:

6-Çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes përcaktohet nga autoriteti shitës, nëpërmjet çmimit të produktit të publikuar në bursë për Brentin, në momentin e përlllogaritjes, duke marrë në konsideratë koeficientin e konvertimit të këtij çmimi sipas cilësisë së produktit të prodhuar, dhe përcaktohet gjithmonë përpara fillimit të procedurës së shitjes. Në çdo rast, çmimi/njësi minimal fillestar i shitjes duhet të jetë më i lartë se çmimi i shitjes i programuar nga Albpetrol sh.a Patos për vitin përkatës.

7. Për nxjerrjen e të dhënave, sipas pikës 6, krijohet grup ekspertësh të fushës, të propozuar nga Albpetrol sh.a Patos, dhe të miratuar nga Ministri. Grupi i ekspertëve duhet të përbëhet nga 3 deri në 5 persona.

Nga verifikimet e bëra për koeficientin e konvertimit të çmimit Brent sipas cilësisë së produktit të prodhuar u konstatua se grupi i ekspertëve të propozuar nga Albpetrol sh.a Patos, përbëhet nga katër anëtar të shoqërisë si dhe një anëtar i MIE. Për sa më sipër grupi i eksperteve, për përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar të shitjes së naftës bruto bazohet në studimin e faktorëve që ndikojnë në vendosjen e korrespondencës së cilësisë së naftës së prodhuar nga secili vendburim, duke e krahasuar me karakteristikat e naftës bruto me emrin “Brent”.

Nafta “Brent” është nafta që grumbullohet nga 15 vendburime të ndryshme në Detin e Veriut në portin Sullom Voe, me karakteristikat, *densiteti 37.5 gradë API, përmbajtja e squfurit 0.4% dhe aciditeti 0.07 TAN mg KOH/g.*

-Grupi i auditimit u kërkoi specialistëve të Albpetrol sh.a Patos se në cilën metodologji, referencë, ose manuale të tregjeve botërore që kuotojnë çmimin Brent, bazohet formula e mësipërme e cila përcakton se luhatjet nga norma të disa komponentëve kanë efekt në uljen e çmimit.

Dokumenti kryesor dhe i vetëm për përcaktimin e çmimit është një raport që ka bërë Banka Botërore në tetor të vitit 2004, për parashikimet e çmimeve të naftës bruto nga qeveritë e vendeve në zhvillim, të cilët nuk përfshijnë në komponentët e cilësisë dhe faktorin e aciditetit. Pa pretenduar të vlerësojmë përllogaritjet specifike të kryera nga specialistët, konstatojmë se veprohet me një model që nuk i korrespondon tregut të naftës bruto, por është një relacion i Bankës Botërore në vitin 2004, për efekte parashikimi. Ky model nuk është testuar me tregun, nuk është i studiuar për karakteristikat e naftës që nxirret në vendburimet tona si dhe nuk është aprovuar nga organet përkatëse. Nga verifikimet e kryera në shitjet që kanë kryer shoqëritë koncesionare, u konstatua se çmimet e shitjes që ka në tregun e jashtëm ose të brendshëm janë rreth 7-15 % më të larta.

-Grupi i auditimit konstatoi se në të gjitha procedurat e ankandit ftesat për ofertë, dokumentet me të dhënat dhe kriteret e kualifikimit janë dërguar për botim vetëm në gazetën kombëtare si dhe në gazetën e botuar në gjuhën angleze “Albanian Daily News”, dhe jo në gazeta të huaja me shpërndarje në Evropë. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën b, të kreut III, të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar dhe me nenin 16 të Ligjit Nr. 9874, datë 14/02/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 10 346, datë 04.11.2010, dhe Ligjin Nr. 12/2017, ku citohet: *Metodat e përllogaritjes së vlerës fillestare në ankandin publik. Përcaktimi i vlerës fillestare të një objekti ankandi bazohet në Vlerën Aktuale Monetare (VAM), çmimet e tregut, të dhënat e INSTAT-it apo të organeve të tjera shtetërore. Në vlerën fillestare përfshihen edhe detyrimet fiskale që lidhen me natyrën e objektit. Mënyra e përllogaritjes së vlerës fillestare do të përcaktohet në rregullat e ankandit publik.*

Sa më sipër është në kundërshtim me pikën b, të kreut III, të VKM nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar, ku citohet:

“b) Ftesa për ofertë
Ftesa për ofertë sipas nenit 25 të LAP-së, përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t’u krijojë mundësinë ofertuesve/kandidatëve të plotësojnë dhe dorëzojnë ofertat e tyre. Ky informacion përfshin: një referencë për njoftimin e botuar; kriteret e shpalljes së fituesit; vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertës dhe vendin, datën dhe orën për hapjen e tyre; gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve; ndonjë informacion të mëtejshëm, që është vlerësuar i dobishëm nga autoriteti shitës. Në rastet kur objekte e shitjes janë mallra të një rëndësie të veçantë dhe me vlerë fillestare shitje mbi 100.000.000 lekë, ftesa do të botohet edhe në një gazetë të huaj me shpërndarje në Evropë.”

Në kontratën për sasinë 40,000 ton për shitje brenda vendit e fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Shoqëria “R.B” sh.a., Elbasan, me NUIS L.....A dhe “A G” sh.a., Tiranë me NUIS

L.....P, u konstatua diferenca nga çmimet e shitjes së shoqërive koncesionare me çmimet e llogaritura nga Albpetrol në vlerën 54,900 mijë lekë.

Më datë 07.04.2021 është bërë njoftim ankandi për shitje naftë bruto me sasi 100,000 ton. Më datë 19.04.2021 është shpallur fitues Operatori ekonomik “E” sh.a. me NUIS K.....N. Në zbatimin e kontratës prej 100,000 ton nga krahasimi i çmimeve të shitjes me ato të shoqërive koncesionare u konstatuan diferenca në vlerën 235,500 mijë lekë.

Më datë 29.04.2022 është bërë njoftim ankandi për shitje naftë bruto me sasi 120,000 ton. Më datë 03.06.2022 është lidhur kontrata me afat 12 muaj, me Kontraktori, BOE “E” sha. dhe “R.”. Në zbatimin e kontratës prej 120,000 ton nga krahasimi i çmimeve të shitjes me ato të Bankers Petroleum u konstatuan diferenca në vlerën **536,300 mijë lekë**.

Modelet e llogaritjeve mund të përdoren për orientime ose për parashikime por është tregues që vendos se sa është çmimi i produktit (nafta bruto), dhe në rastin kur ky produkt naftë bruto nga shoqëritë koncesionare që menaxhojnë burimet hidrokarbure në Shqipëri e shesin me çmim më të lartë është tregues se modeli ekzistues nuk është i saktë dhe i K humbje financiare shoqërisë për një vlerë prej **826,750 mijë lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. **22.1.Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që në të ardhmen procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandëve të shitjes së naftës, të kryhet duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko financiare.

4. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë të botohen në gazetata e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Shoqëria Albpetrol sh.a, është bazuar në Aktin Normativ Nr. 2, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim)”, të ndryshuar, mund të tregtojnë produktet hidrokarbure për tregun vendas, apo për eksport sipas çmimit të bursës ndërkombëtare për hidrokarburet, ku Ministria përgjegjëse që drejton veprimtarinë, miraton procedurat e tregtimit të hidrokarbureve, të parashikuara në Urdhrin nr. 83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve Hidrokarbure” të ndryshuar. Sipas këtij Urdhri, janë zbatuar në vijimësi procedurat e Ankandit dhe pikerisht mbi keto procedura të parashikuara, caktohet edhe çmimi i shitjes.

Grupi i Ekspertëve për përcaktimin e çmimit njësi minimal fillestar i shitjes së sasisë së parashikuar të naftës bruto, miratuar me urdhër të Administratorit, paraqet një raport përmbledhës me analizë të detajuar të të gjitha kostove, duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve / institucioneve shtetërore për të maksimizuar të ardhurat. Gjithë procedura e vlerësimit dhe analizës është e dokumentuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i papranuar* nga subjekti.

23. Gjetje nga auditimi: Në procesin e shqyrtimit të kontratave të ankandëve u konstatuan përlllogaritje të penalteteve për vonesa jo në përputhje me dokumentet e ankandit.

-Në kontratën e lidhur nga Albpetrol sh.a Patos, me shoqërinë Europetrol sh.a., me nr. 2815 Prot., datë 04.05.2021, për shitjen e sasisë 100,000 ton u konstatua se:

-Në Dokumentet Standarde të Ankandit Publik të përdorura në procedurën e ankandit për shitje, në pjesën kushtet e përgjithshme, neni nr. 1.1, “Qëllimi”, citohet: Këto kushte të përgjithshme

të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen/shitjen e Mallrave/objekteve/ me anë të ankandit të hapur. Neni 24: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore: *b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.*

Neni 25: Negociatat dhe Amendamentet, 25.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së ofertuesit fitues. Në kontratën e lidhur mes palëve neni 5.9, përcakton :” Në rast të mos kryerjes së pagesës sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë apo në rast të mos tërheqjes së sasisë së mallit sipas mënyrës së përcaktuar (siç përcaktohet në aneksin nr. 1, bashkëlidhur), blerësi është dakord me penalitetet ditore që do të llogariten sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”. Kontrata është lidhur bazuar në Urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, i ndryshuar. Kontrata mes palëve nuk ka pasqyruar kushtet e përgjithshme të procedurës së ankandit.

Këto mospërputhje kanë pasur efektet në përlllogaritjen e penaliteteve ditore për vonesat në tërheqjen e sasive të mallit. Albpetrol sh.a ka përlllogaritur 25 ditë vonesë për vlerën 403,212 lekë penalitete, kur sipas nenit 24 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës, ku vlera totale e kontratës është 4,594,332,577 lekë, pra 25 % është 1,148,583,144 lekë dhe 2/1000 është 2,297,166 lekë është penalteti ditor, për 25 ditë në total prej 57,025,938 lekë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos

-Në kontratën e lidhur nga Albpetrol sh.a Patos, me BOE shoqërinë E sh.a., dhe “R” sh.a., me nr. 3493/15 Prot., datë 03.06.2022, për shitjen e sasisë 120,000 ton u konstatua se: -Në Dokumentet Standarde të Ankandit Publik të përdorura në procedurën e ankandit për shitje, në pjesën kushtet e përgjithshme, neni nr. 1.1, “Qëllimi”, citohet: Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen/shitjen e Mallrave/objekteve/ me anë të ankandit të hapur. Neni 24: Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës. Neni 25: Negociatat dhe Amendamentet, 25.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së ofertuesit fitues.

Në kontratën e lidhur mes palëve neni 5.9, përcakton: ” Në rast të mos kryerjes së pagesës sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë apo në rast të mos tërheqjes së sasisë së mallit sipas mënyrës së përcaktuar (siç përcaktohet në aneksin nr.1, bashkëlidhur), blerësi është dakord me penalitetet ditore që do të llogariten sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”. Kontrata është lidhur bazuar në Urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, i ndryshuar.

Kontrata mes palëve nuk ka pasqyruar kushtet e përgjithshme të procedurës së ankandit.

Këto mospërputhje kanë pasur efektet në përlllogaritjen e penaliteteve ditore për vonesat në tërheqjen e sasive të mallit. Albpetrol ka përlllogaritur vonesa në vlerën 66,211 lekë penalitete, kur sipas nenit 24, Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar; 24.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore: Për kontratat me periudhë

zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës, ku vlera totale e kontratës është 4,769,065,763 lekë, pra 25 % është 1,192,266,441 lekë dhe 2/1000 është 2,384,533 lekë është penalteti ditor, për shoqërinë Europetrol sh.a., janë llogaritur 66,211 lekë, kur penaltetet janë 26,229,863 lekë dhe për shoqërinë “R” sh.a., janë llogaritur 89,110 lekë, kur penaltetet janë 54,844,259 lekë.

Vlera 80,918,801 lekë e pa llogaritur si penaltet për vonesat në tërheqjen e sasive të produktit naftë bruto përbën dëm ekonomik për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin Nr. 9874, datë 14/02/2008 “Për ankandin publik” i ndryshuar me Ligjin Nr. 10 346, datë 04.11.2010, dhe Ligjin Nr. 12/2017, Kreu VI, zbatimi i kontratës, Neni 40.

Vlerat **80,918,801 lekë dhe 57,025,938 lekë** të pa-llogaritura si penaltet për vonesat në tërheqjen e sasive të produktit naftë bruto përbëjnë të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1.Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrësi i shoqërisë Albpetrol sh.a, Patos, të analizojë situatën në lidhje me të ardhurat e munguara të shoqërisë në vlerat **80,918,801 lekë dhe 57,025,938 lekë, si dhe** të marrë masa që në të ardhmen të llogarisë penaltetet për vonesa në tërheqjen e produktit naftë bruto nga OE fitues sipas dokumenteve standarde të procedurës së ankandit.

Përgjigja e institucionit:

Sa i perket llogaritjes së Kamatë-Vonesave, baza ligjore së cilës i referohemi është Urdhri Nr. 398, datë 30.11.2016, “Për një ndryshim në Urdhrin nr.83, datë 10.02.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure (naftë bruto)”, të ndryshuar, për të gjitha arsytet e parashtruara mbi përjashtimin nga zbatimi i ligjit “Për Ankandin...”

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet *i papranuar* nga subjekti.

24. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e lëvizjeve të produktit naftë bruto nga qendrat e prodhimit në qendrën e shitjeve u konstatua se produkti naftë në shumë raste dorëzohet jashtë standardit teknologjik S SH 51:1986 (Naftë bruto – Karakteristikat). Sipas standardit sasia e ujit nuk duhet të tejkalojë në përqindje për sektorët Ballsh 2%, Visokë 3%, Kasnicë 5%, Marinëz 2%, Marinëz sektorët 5,6,7 3%, Gorisht Amenicë 2% dhe Kuçovë 3 %. Në fletë hyrjet e Qendrës së Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit, QASHNG, u konstatuan raste të pranimit të produktit naftë në kushtet kur tejkalohet sasia e pranuar e ujit.

-Në lidhje me sasitë e ujit që tejkalojnë normat teknologjike në produktin naftë argumentimet e specialistëve të QASHNG, Qendra e Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit, janë se nafta vjen jashtë standardeve nga qendrat e tjera, dhe për këtë fakt janë njoftuar administratorët, të cilët kanë lëshuar urdhra për pranimin e produktit naftë bruto dhe jashtë standardeve teknologjike, (me ujë mbi 3%, deri në 14 %). Urdhrat nr. 182 datë 07.09.2021, “Për procedurë e inspektimit dhe kontrollit të qarkullimit të produktit Naftë Bruto”, 182/2 datë 16.12.2021, dhe 182/3 datë 17.12.2021.

Argumentet e sjella nga qendrat janë se nuk kanë pajisjet për të bërë ndarjen e plotë të ujit dhe se nuk mund të ndalojnë punën në puse. Në momentin kur produkti i gatshëm i shitet kompanive fituese të ankandeve, në depozitat e shitjes nafta bruto ngrohet dhe përgatitet në parametrat teknologjikë me përqindje uji më të vogël se 3%, ndërkohë që pjesa tjetër është

produkt i gatshëm në mungesë. QASHNG Patos është magazinë fiskale stokimi dhe nuk lejohen shkarkime uji teknologjik pas përgatitjes, si trajtim me sistem ngrohje me kaldajë mbi vlerën e lejuar.

Mos marrja e masave për zgjidhjen e problemeve për pasjen e produktit të gatshëm naftë bruto sipas standardeve teknike nga ana e administratorëve ka sjellë diferenca të produktit të gatshëm të kaluar në sistemin e doganës me kontabilitetin e mbajtur në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos Laboratorët e përdorur në Albpetrol sh.a për analizat e produktit naftë bruto nuk janë të akredituar nga autoritetet përkatëse.

Shoqëria Albpetrol sh.a, nuk ka përmbyllur investimet për të ngritjen e strukturave teknologjike të cilat do të mundësojnë heqjen e sasive të ujit mbi normë.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me VKM Nr. 612, datë 2.9.2012 i ndryshuar, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, aneksi nr.17 matjet e produkteve, dhe me Standardet kombëtare të produktit naftë bruto.

Duke qenë se produkti naftë lëvizet nga vendburimet në stacionin e shitjes me tubacione dhe autobote, verifikimi në depozitë për përqindjen e ujit dhe zbritja në kontabilitet si produkt i gatshëm shton riskun e abuzimeve në produktin e gatshëm (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a, të analizojë me kujdes situatën dhe të marrë masa për përfundimin e investimeve që do të mundësojnë përgatitjen e produktit naftë sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare për të rritur performancën dhe të ardhurat si dhe uljen e riskut të abuzimeve dhe cenimeve të aktiveve të shoqërisë.

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigja e institucionit:

Programi i Zhvillimit Ekonomik i shoqërisë, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, është dokumenti strategjik në të cilin paraqitet analiza e treguesve kryesorë teknikë dhe ekonomiko-financiarë të shoqërisë në vitin paraardhës, si dhe parashikimi, përfshirë investimet në sektorë të ndryshëm, sipas prioriteteve të zhvillimit, me fokus rritjen e efektivitetit të prodhimit të naftës bruto, në vitin për të cilin hartohet Programi. (Vendimi nr. 1, i Këshillit Mbikëqyrës, datë 20.02.2024, dhe vendimi nr. 2155/1, i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, datë 08.03.2024). Këshilli Mbikëqyrës merr dhe shqyrton analizat periodike (3, 6, 9 mujore dhe vjetore) me treguesit kryesorë të të ardhurave e shpenzimeve, si dhe të kushteve teknike që ndikojnë në ecurinë e realizimit të treguesve të parashikuar të prodhimit në Programin e miratuar. Aktualisht, investimi për këte rekomandim ka filluar. Në këte periudhë është hapur procedura e prokurimit për “Investimet në Sektorin e Zharrzes”.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

25. Gjetje nga auditimi: Qendra e Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit menaxhon shitjen e produktit naftë bruto tek Operatori Ekonomik fitues i procedurave të ankandit. Procedurat e marrjes së kampioneve dhe analiza e naftës kryhet sipas nenit 6 të Udhëzimit nr. 83 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, i ndryshuar. Faturat bëhen për çdo autobus në bazë të peshës dhe duke marrë të dhënat e analizave të kryera në fillim të procesit dhe duke ju referuar temperaturës 15%.

Gjendja e strukturave dhe pajisjeve nga ku realizohet lëvrimi tek klientët është jashtë standardeve përkatëse. Depozitat e naftës, pajisjet matëse nuk janë certifikuar nga Drejtoria e

Përgjithshme e Metrologjisë, laboratorët që kryejnë analizat e mostrave nuk janë të akredituar nga institucionet përkatëse.

Nga kontrollet periodike të ushtruara nga Dega e Doganës Fier kanë rezultuar diferenca materiale të produktit naftë bruto të rezultuar nga matjet faktike me atë kontabël të mbajtur nga Albpetrol sh.a Patos

Grupet e kontrollit të Degës së Doganës Fier, në kontrollet në lidhje për pagesat për akcizën, procedurat për matjen e sasive të naftës bruto në rezervuare, i kanë të përcaktuar në VKM nr. 612, datë 02.09.2012, ndryshuar, të cilat ndryshojnë nga metodologjia që përdor Albpetrol sh.a Patos

Kjo metodologji që përdor shoqëria nuk është e saktë dhe korrekte pasi kryhen tre matje të temperaturës dhe densitetit për një depozitë 5000 ton, dhe ndërkohë lëvrimi i sasisë mund të zgjasë deri në një javë si dhe depozita nuk zbrazet plotësisht.

Komisionet e caktuara për kryerjen e analizave të densitetit, bazohen në pikën 6.9, të Urdhrit nr. 83, ku citohet: *“Densiteti i kampionit do të përcaktohet sipas metodës SSH 33, duke përdorur një aerometër të përshtatshëm dhe të kontrolluar. Temperatura dhe densitetet e matura dhe të korrektuara do të regjistrohen në “Raportin e analizave të naftës bruto” të përgatitur për kampionimi.”* Ky standard është shfuqizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve dhe është zëvendësuar me SSH EN ISO 3675:1998. Ky standard në lidhje me marrjen e mostrave i referohet ISO 3170 (SSH EN ISO 3170:2004 59 faqe, KT 19, Produkte të lëngëta të naftës - Marrjen e mostrave manualisht), ose ISO 3171 (SSH EN ISO 3171:1999 59 faqe, KT 19, Metodatat e provës për naftën dhe produktet e saj - Lëngjet e naftës -Marrja automatike e mostrave me tubacion) .

Mos përcaktimi i saktë i dendësisë së naftës bruto, në momentin e shitjes ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në çmimin e shitjes dhe reflekton në të ardhurat e shoqërisë. Në elementët e llogaritjes së çmimit të shitjes, pjesa më e madhe është përcaktuar nga faktorë të tjerë si çmimi në bursë, kursi i këmbimit të dollarit, etj., që janë të kontrolluar dhe pas faktit. Dy elementët që variojnë dhe maten për çdo shitje janë peshat e autoboteve që transportojnë produktin që shitet dhe densiteti i naftës bruto i cili përcaktohet një herë për një depozitë prej 5000-8000 m³. Në përcaktimin e riskut për dëmtimin e aseteve të shoqërisë si vjedhje ose mashtrime këto dy elementë kanë riskun më të madh.

Veprimet më sipër janë në kundërshtim me ligjin Nr. 10 296, datë 08/07/2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 22,

VKM nr. 612, datë 02.09.2012, ndryshuar me: Vendimin Nr. 128 datë 20.2.2013, Vendimin Nr. 501, datë 22.5.2013, Vendimin Nr. 30, datë 14.1.2015, Vendimi nr. 38, date 21.01.2016, Vendimi nr. 28, date 18.01.2017 Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”. Neni 96, Neni 99 Pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të analizojë situatën në të cilën kryhet procesi i shitjes së naftës bruto, të vlerësojë procedurat përkatëse të kontrollit, të evidentojë zonat me risk në cenimin e produktit të gatshëm, si dhe të krijojë grupe pune që në procesin e matjes së naftës bruto në shitjet që kryen shoqëria, të garantohet zbatimi i standardeve kombëtare e ndërkombëtare.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Administratori i shoqërisë ka mitratuar Udhëzimin nr. 342, datë 16.11.2022, “Për miratimin e procedurës për shitjen dhe lëvrimin e naftës bruto nga shgoqëria “Albpetrol” Sh.A tek blerësit dhe nga kontraktorët”. Për çdo procedurë të shitjes së naftës bruto, në pikat e lëvrimin, sipas kontratës së shitjes, Administratori i shoqërisë miraton urdhër të veçantë, në të cilin

parashikohet vendi / stacioni i shitjes, sasia, vlera dhe personat përgjegjës, që garantojnë kryerjen e të gjitha proceseve teknike e teknologjike sipas standardeve shtetërore. Zbatimi i këtij rekomandimi tashme ka nisur së bashku me nisjen e investimit në Zharrez.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tre procedurave të ankandëve të shitjes së naftës u konstatua se grupi i eksperteve, për përcaktimin e çmimit/njësi minimal fillestar të shitjes së naftës bruto ka bërë ulje shpenzimesh nga çmimi i shitjes së përcaktuar të ankandit, duke presupozuar shpenzime për vënien e produktit në kushtet FOB sipas kushteve të Bursës Ndërkombëtare për hidrokarburet (Bursës Ndërkombëtare Brent), bazuar në udhëzimin 83, datë 10.02.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, pika 5, Të dhënat e bursës “Platts”, kuotojnë çmimin Naftë Bruto-Brent (Ddl), në dollarë dhe me kushte lëvrimi FOB (Free on Board), pra lëvrimi deri kuvertën e anijes në një port të caktuar. Grupi i ekspertëve ka bërë përllogaritje të ndryshme për transportin me autobote në porte të caktuara, ngrohjen e naftës gjatë rrugës, siguracionin, magazinimin në port, shpenzime shkarkimi etj, duke rezultuar me një ulje në çmimin që duhet të paguajë Operatori Ekonomik fitues i ankandit të shitjes së naftës. Pjesa më e madhe e shpenzimeve të përllogaritura në çmimet e shitjes nuk ndodhin pasi shitjet e naftës janë kryer me operatorë ekonomikë vendas. Relacionet për përllogaritjen e çmimit fillestar, pas aprovimit nga administratori, janë dërguar për miratim te Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës.

-Në procedurën për sasinë 40,000 ton e fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Shoqëria “R” sh.a., Elbasan, dhe “A G” sh.a., Tiranë, vlera e shpenzimeve të pa kryera janë 3.55 USD/bbl për sasinë 40,000 ton, arrijnë në shumën 859,000 USD.

-Në procedurën për shitje naftë bruto me sasi 100,000 ton, me fitues “E”, vlera e shpenzimeve të pa kryera janë 3.6 USD/bbl, për sasinë 100,000 ton, arrijnë në shumën 2,307,000 USD.

-Në procedurën për shitjen e 120,000 ton naftë bruto, me fitues BOE “E” sha, dhe “R” sha, vlera e shpenzimeve të pa kryera arrin në shumën 2,630,000 USD.

Vlera 5,797,000 USD përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 296, datë 08/07/2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 2., Neni 3, udhëzimit 83, datë 10.02.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure” Pika 5, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

26.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që procesi i përcaktimit të çmimit të shitjes së naftës bruto të kryhet bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të kostove të shoqërisë, të çmimit të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të kostove reale që mund të dalin gjatë procesit të shitjes së produktit, për të shmangur mungesën e të ardhurave nga një proces jo transparent dhe jo efektiv.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Shoqëria Albpetrol sh.a, është bazuar në Aktin Normativ Nr. 2, datë 16.06.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28/07/1993 “Për hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim)”, të ndryshuar, mund të tregtojë produktet hidrokarbure për tregun vendas, apo për eksport sipas çmimit të bursës ndërkombëtare për hidrokarburet, ku Ministria përgjegjëse që drejton veprimtarinë, miraton procedurat e tregtimit të hidrokarbureve, të parashikuara në Urdhrin nr. 83, datë 10.02.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve

Hidrokarbure” të ndryshuar. Sipas këtij Urdhëri, janë zbatuar në vijimësi procedurat e Ankandit dhe pikerisht mbi keto procedura të parashikuara, caktohet edhe çmimi i shitjes. Grupi i Ekspertëve për përcaktimin e çmimit njësi minimal fillestar i shitjes së sasisë së parashikuar të naftës bruto, ngritur me urdhër të Administratorit, paraqet një raport përmbledhës me analizë të detajuar të të gjitha kostove, duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve / institucioneve shtetërore për të maksimizuar të ardhurat. Gjithë procedura e vlerësimit dhe analizës është e dokumentuar.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i papranuar* nga subjekti.

27. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “B P” Ltd., rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 *vërehet se, Prodhimi i Përgjithshëm* i deklaruar nga shoqëria BP është realizuar, madje është tejkaluar. Gjatë vitit 2021 prodhimi ishte 3,786.19 MBbl, shifër kjo e cila është mbi parashikimin e bërë në PP&B 2021. *Shpenzimet Operative (OPEX)*. Shpenzimet operative kapin vlerën 54,344 M\$ nga 60,659 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 6,315 M\$ ose 10%. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi me një diferencë relativisht të vogël. Shpenzimet Administrative (G&A): Realizimi i G&A për vitin është realizuar mesatarisht në masën 69%.

Investimet Kapitale (CAPEX): Realizimi i Capex për vitin është realizuar mesatarisht në masën 60%. Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për vitin 2022: Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria BP është realizuar vetëm në masën 86%. Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 prodhimi ishte 2,520 Mbbl, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021.

Shpenzimet Operative (OPEX): Shpenzimet operative kapin vlerën 44,394 M\$ nga 46,692 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 2,298 M\$ ose 2%. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2022 janë më të ulta sesa parashikimi me një diferencë relativisht të vogël. Shpenzimet Administrative (G&A): Realizimi i G&A për vitin është realizuar mesatarisht në masën 74%.

Investimet Kapitale (CAPEX): Realizimi i Capex për vitin është realizuar mesatarisht në masën 50%. Cost Recovered: Në vitin 2022, sipas Faktit të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

27.1.Rekomandimi: Administratori në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol sh.a Patos, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, si duke i kërkuar respektimin e planit të miratuar, duke bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Programi i Punës dhe Buxheti për vitet 2021 dhe 2022 për këto kontraktor nuk janë miratuar pikerisht për shkak të uljes së nivelit të prodhimit. Albpetrol e monitoron në mënyrë të vazhdueshme aktivitetin hidrokarbur të këtij kontraktori. Theksojmë se këtij kontraktori në ACM e zhvilluara nga Albpetrol i është kërkuar konsistenca me POD lidhur me nivelin e prodhimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

28. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “B P” Ltd. ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetroli ka kryer auditet vjetore dhe rezultat e tyre në vite janë kontestuar nga Bankers dhe janë çuar për gjykim në Gjykatën e Arbitrazhit. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim te Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinëz” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:

Vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperushme për vitin 2020 për B P LTD është 2,913,868 (dy milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) USD

Në bazë të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure” "Albpetroli do të ketë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj nga marrja e secilës deklaratë të Llogarisë Kosto në përputhje me Procedurën Llogaritëse në të cilën për të audituar dhe ngritur objeksione përsa i përket ndonjë deklarate të tillë të Llogarisë Kosto, me kusht që Albpetroli nuk do të titullohet të kryejë më shumë se dy audite të librave të Llogarisë, regjistrimeve dhe llogarive në një Vit Fiskal. Albpetroli dhe Kontraktori do të bien dakord për çdo rregullim të kërkuar. Dokumente shtesë dhe llogarie do të bëhen të disponueshme për Albpetrolin gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore në fjalë. Nëse brenda kohës kufi të periudhës tre (3) mujore në vijim të kalimit të periudhës së mësipërme prej dymbëdhjetë (12) muaj Albpetroli nuk ka -këshilluar Kontraktorin me kundërshtimin e tij për këtë deklaratë, kjo deklaratë do të konsiderohet e aprovuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën **2,913,868 USD** të konstatuar për vitin 2020.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit:

Albpetrol ne perfundim te procesit te auditimit, i ka kerkuar ketij kontaktori qe te zbrese shpenzimet e perfshira si kosto hidrokarbure nga llogaria kosto. Nga ana e ketij kontraktori nuk ka asnje reagim.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

29. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i korrespondencës mes palëve u konstatua mos prezenca e Albpetrol gjatë kryerjes së procesit të inventarizimit nga kontraktorët e marrëveshjeve hidrokarbure. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos me shkresën me Nr. 10641 Prot., datë 24.12.2021 ka dërguar njoftim në lidhje me personat që do të marrin pjesë në procesin e inventarizimit të fund vitit 2021. (inventarizimin e materialeve dhe atë të naftës bruto). Shoqëria Albpetrol sh.a Patos, me shkresën me Nr. 1051 Prot., datë 03.02.2022, ka kërkuar nga BPAL që të dërgojnë inventarin e materialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2021, për vendburimin Patos-Marinëz. Në mungesë të një përgjigje nga ana e shoqërisë “B P” Ltd, me shkresën me Nr. 1051/1 Prot., datë 22.04.2022, shoqëria “Albpetrol” Sh.A ka dërguar një

kërkesë të përsëritur. Shoqëria “B P” Ltd., me shkresën me Nr. 9145 Prot., datë 20.12.2022, njofton për procesin e inventarizimit të fundvitit 2022.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos, me shkresën me Nr. 1067 Prot., datë 13.2023, ka kërkuar nga BP që të dërgojnë inventarin e materialeve dhe të naftës bruto në fundin e viti 2022, për vendburimin Patos-Marinëz.

Strukturat drejtuese të Albpetrol sh.a me anë të mosveprimit të tyre kanë lenë në mungesë monitorimi gjendjen e aseteve të dhëna në përdorim si dhe blerjen e aseteve të reja nga kontraktori si dhe ecuria e jetëgjatësisë së tyre.

Pika 2.4.2 e Marrëveshjes Hidrokarbure “Në intervale të arsyeshme, të paktën çdo vit, do të bëhen nga Kontraktori inventarë për të gjithë Materialet e Kontrollueshëm, dhe në vijim të çdo inventari, do të rregullohen librat e llogarive dhe regjistrimet për të reflektuar rezultatet e inventarit. Kontraktori do të njoftojë me shkrim tridhjetë (30) ditë për qëllim të inventarëve të tillë për të lejuar Albpetrolin për të zgjedhur nëse do të përfaqësohet apo nuk do të përfaqësohet kur të kryhet inventari.

Kjo situatë është konstatuar me të gjithë kontraktorët e Marrëveshjeve Hidrokarbure (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

29.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa që në çdo proces inventarizimi të kontraktorëve të Marrëveshjeve Hidrokarbure të dërgojë përfaqësues të Albpetrol sh.a Patos dhe të evidentohet me përgjegjësi ekzistenca e aseteve të dhëna në përdorim dhe statusi i përdorimit të tyre.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Në lidhje me këtë rekomandim sqarojmë se shoqëria “Albpetrol” Sh.a. u ka dërguar shkresat kontraktorëve, me Nr. 7903, 7904, 7905, 7906, 7907 dhe 7908 Prot., datë 18.10.2023, në lidhje me inventarin e aseteve dhe materialeve në fundin e 3-mujorit III të vitit 2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

30. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “AG” SH.A. rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se, **Prodhimi i Përgjithshëm** i deklaruar nga shoqëria A është 27,733.99 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 29,678 Ton, pra me një mosrealizim prej 7%. Ky është prodhimi më i lartë i realizuar në vendburimin Ballsh-Hekal.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 2,214.96 M\$ nga 1,899.7 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 315.26 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të larta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një realizim në masën 17% më shumë se parashikimi.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qenë 527.95 M\$ nga 410 M\$ të parashikuara në PP&B 2021 Realizimi i G&A për vitin është realizuar madje është tejkaluar në masën 29% nga parashikimi.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë vitit 2021 janë kryer 1,893.74 M\$ Investime nga 3,628 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021. Sipas kontraktorit, kjo ka ardhur kryesisht prej mosrealizimit të investimeve që kërkojnë leje dhe që janë ende pezull.

Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për 9-Mujorin e vitit 2022 vërehet se:

Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria Anio është 19,982.09 Ton , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 21,940.35 Ton, pra me një mosrealizim prej 9%. *Shpenzimet Operative (OPEX)*. Shpenzimet operative kapin vlerën 1,130.88 M\$ nga 1,693 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 562.12 M\$. Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022, me një mosrealizim në masën 33% më pak se parashikimi. Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e vitit 2022, kanë qenë 381.97 M\$ nga 366.75 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Realizimi i G&A për vitin është realizuar madje është tejkaluar në masën 4% nga parashikimi.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 janë kryer 1,605.51 M\$ Investime nga 2,597 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për 9-Mujorin e vitit 2022, janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022.

Cost Recovered: Për 9-Mujorin e vitit 2022, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive. Shoqëria Anio Oil & Gas sha, megjithëse ka pasur rritje të të ardhurave nuk ka realizuar investimet e parashikuara në Planin e Punës

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol sh.a Patos, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, duke kërkuar respektimin e planit të miratuar, bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Albpetrol Sh.a. do të vazhdojë të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme aktivitetin hidrokarbur të Kontraktorëve, duke përcjellë me shkresa zyrtare cdo problematikë që nuk përputhet me Marrëveshjen Hidrokarbure.

Pretendim i sjellë nga ana e Albpetrol përmes observacioneve të paraqitura me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 3502/3 prot, datë 09.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/2 prot, datë 13.08.2024 z. E. D. ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Nga Shoqëria Albpetrol sha është bërë monitorimi nga sektori i monitorim-supervizimit të Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure me konkretisht janë mbajtur relacionet përkatëse me nr.10576 prot., datë 28.12.2023, nr. 8166 prot., 02.11.2023, nr. 7202 prot., datë 12.09.2023, nr. 3117 prot., datë 25.05.2023 dhe nr. 2311 prot., datë 13.04.2023.*

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e paraqitjes së evidencave të reja justifikuese përmes observacioneve të paraqitura me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024 të cilat të provojnë statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i zbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

31. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “AG” SH.A. ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim te Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e

hidrokarbureve në vendburimin Ballsh-Hekal” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar:

Vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020 për A. O. & Gas Sh.A është **71,306.21 USD** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t’i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën **71,306.21 USD** të konstatuar për vitin 2020.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit:

Me anë të shkresës me Nr. 6491 Prot., datë 31.07.2023, shoqërisë “A. Oil & Gas: Sh.a. i është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditit për periudhën Q1-Q4-2020, në të cilën kërkojmë që vlera prej 32,290.99 USD të zbritet nga Llogaria Kosto, në zbatim të Marrëveshjes Hidrokarbure per Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve ne venndburimin Ballsh-Hekal.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** dhe ***pjesërisht zbatuar***.

32. Gjetje nga auditimi: Kontraktori DG Ltd., rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se *Prodhimi i Përgjithshëm* i deklaruar nga shoqëria “DG” Ltd., është 0 Ton naftë kondesat dhe 0 Nm3 Gaz, ndërkohe që në Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2021 kishin parashikuar 3,550 Ton naftë kondesat dhe 25,680,000 Nm3 Gaz. Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 657 M\$ nga 778.52 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 121.52 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një mosrealizim prej 16%. Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qenë 368 M\$ nga 426.6 M\$ të parashikuara në PP&B 2021, me një mosrealizim prej 14%. Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë vitit 2021 janë kryer 5,701 M\$ Investime nga 19,842.88 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një mosrealizim prej 71%. Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, shpenzimet kapin vlerën 7,293 M\$, duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për 9-Mujorin e vitit 2022 vërehet se Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria “DG” Ltd., është 112.26 Ton kondesat dhe 0 Nm3 Gaz, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 3,881 Ton kondesat dhe 288,080,000 m3.

Shpenzimet Operative (OPEX). Shpenzimet operative kapin vlerën 761 M\$ nga 2,196.31 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 1,435.31 M\$. Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022, me një mosrealizim prej 65%.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e Vitit 2022, kanë qenë 406 M\$ nga 1,178.1 M\$ të parashikuara në PP&B 2022, me një mosrealizim prej 66%

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 janë kryer 1,922 M\$ Investime nga 8,970 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për 9-Mujorin e vitit 2022 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022, me një mosrealizim gati 79%. Cost Recovered: Në 9-Mujorin e vitit 2022 sipas Faktit,

shpenzimet kapin vlerën prej 3,091 M\$, duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol sh.a Patos, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, si duke i kërkuar respektimin e planit të miratuar, duke bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol sh.a Patos

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Ky rekomandim është ndjekur dhe zbatuar në vazhdim nga Sektori i Monitorimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure pranë shoqërisë Albpetrol sha, i cili e ka detyrë funksionale monitorimin e operacioneve hidrokarbure të kryera nga kontraktorët me të cilët shoqëria “Albpetrol” sh.a ka lidhur Marrëveshje Hidrokarbure.

Pretendim i sjellë nga ana e Albpetrol përmes observacioneve të paraqitura me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 3502/3 prot, datë 09.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/2 prot, datë 13.08.2024 z. E. D. ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Nga Shoqëria Albpetrol sha është bërë monitorimi nga sektori i monitorim-supervizimit të Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure me konkretisht janë mbajtur relacionet përkatëse me nr.10576 prot., datë 28.12.2023, nr. 8166 prot., 02.11.2023, nr. 7202 prot., datë 12.09.2023, nr. 3117 prot., datë 25.05.2023 dhe nr. 2311 prot., datë 13.04.2023.*

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar***.

33. Gjetje nga auditimi: Kontraktori DG Ltd, ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Delvinë” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar se vlera totale kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020 për shoqërinë “D. G. Company” LTD është 161,373.29 USD *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

33.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t’i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën **161,373.29 USD** të konstatuar për vitin 2020.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Me shkresën Nr. 7162 prot., datë 11.09.2023, shoqërisë “DG” Ltd. i është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditit për periudhën Q1-Q4-2020, në të cilën kërkojmë që vlera prej 96,124.97 USD të zbritet nga Llogaria Kosto, në zbatim të Marrëveshjes Hidrokarbure.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

34. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “T O” SH.A., rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se, *Prodhimi i Përgjithshëm* i deklaruar nga shoqëria “T O” SH.A. është 14,827.3 Ton , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 27,228 Ton, pra me një mosrealizim prej 46%. Kjo diferencë përgjithësisht i atribuohet faktit që pavarësisht se të parashikuara në Buxhet 4-Projektet e përmirësimit të puseve ekzistuese nuk kanë dhënë akoma impaktin e parashikuar në Prodhim. *Shpenzimet Operative (OPEX)*, shpenzimet operative kapin vlerën 2,779 M\$ nga 3,689.73 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 910.73 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021. Peshën me të madhe e zënë shpenzimet për energji elektrike dhe për holluesin teknologjik për shkak të karakteristikave që ka nafta e Vb. Visokë. *Shpenzimet Administrative (G&A)*: Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qenë 1,582 M\$ nga 688 M\$ të parashikuara në PP&B 2021 Realizimi i G&A për vitin është realizuar madje është tejkalar. *Investimet Kapitale (CAPEX)*: Gjatë vitit 2021 janë kryer 866 M\$ Investime nga 3,173.13 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021. *Cost Recovered*: Në vitin 2021, sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për 9-Mujorin e vitit 2022, vërehet se, *Prodhimi i Përgjithshëm* i deklaruar nga shoqëria TO është 9,947 Ton, shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 16,962 Ton, pra me një mosrealizim prej 41%. Kjo diferencë përgjithësisht i atribuohet faktit që pavarësisht se të parashikuara në Buxhet 4-Projektet e përmirësimit të puseve ekzistuese nuk kanë dhënë akoma impaktin e parashikuar në Prodhim. *Shpenzimet Operative (OPEX)*. Shpenzimet operative kapin vlerën 1,766 M\$ nga 3,122.92 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 1,356.92 M\$. Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022. Peshën me të madhe e zënë shpenzimet për energji elektrike dhe për holluesin teknologjik për shkak të karakteristikave që ka nafta e Vb. Visokë. *Shpenzimet Administrative (G&A)*: Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e Vitit 2022, kanë qenë 1,130 M\$ nga 560 M\$ të parashikuara në PP&B 2022 Realizimi i G&A për vitin është realizuar madje është tejkalar. *Investimet Kapitale (CAPEX)*: Gjatë 9-Mujorit të vitit 2022 janë kryer 936 M\$ Investime nga 2,232.8 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për 9-Mujorin e vitit 2022 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022. *Cost Recovered*: Në 9-Mujorin e vitit 2022 sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim te Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Visoke” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar se vlera totale prej 20,569 USD nuk njihet si Kosto Hidrokarbure dhe duhet të zbritet nga Llogaria Kosto (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

34.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t’i kërkojnë

Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën **20,569 USD** të konstatuar për vitin 2020.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Me anë të shkresës me Nr. 6492 Prot., datë 31.07.2023, shoqëria “T. Oil Sëiss” Sh.a. i është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditit për periudhën Q1-Q4-2020, në të cilën kërkojmë që vlera prej 9,219 USD duhet të zbriten nga Llogaria Kosto, në zbatim të Marrëveshjes Hidrokarbure.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

35. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “FP” SH.A., rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se, *Prodhimi i Përgjithshëm* i deklaruar nga shoqëria FP, është 944.85 Ton, shifër kjo e cila është mbi parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 370.8 Ton. *Shpenzimet Operative (OPEX)*. Shpenzimet operative kapin vlerën 100.82 M\$ nga 22 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të larta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qenë 12.21 M\$ shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej nga 26.49 M\$.

Investimet Kapitale (CAPEX): Gjatë vitit 2021 nuk janë kryer Investimet, ndërkohë që në Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2021 ishin programuar 18 M\$.

Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për 9-Mujorin e vitit 2022, për Vendburimin Pekisht-Murriz, vërehet se Prodhimi i Përgjithshëm i deklaruar nga shoqëria FP, është 1,056.32 Ton, shifër kjo e cila është mbi parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej 287 Ton. *Shpenzimet Operative (OPEX)*. Shpenzimet operative kapin vlerën 312.97 M\$ nga 28.9 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, Pra, shpenzimet Operative për 9-Mujorin e vitit 2022 janë më të larta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022. *Shpenzimet Administrative (G&A):* Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e vitit 2022, kanë qene 6.14 M\$ shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2022 prej nga 12 M\$. *Investimet Kapitale (CAPEX):* Investimet për 9-Mujorin e vitit 2022 kapin vlerën 12.73 M\$ ndërkohë që në Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2022 ishin programuar 9.5 M\$. *Cost Recovered:* Në 9-Mujorin e vitit 2022, sipas Faktit, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet duke gjeneruar një fitim për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

35.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol sh.a Patos, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, si duke i kërkuar respektimin e planit të miratuar, duke bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol sh.a Patos.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Ky rekomandim është ndjekur dhe zbatuar në vazhdim nga Sektori i Monitorimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure pranë shoqërisë Albpetrol sha, i cili e ka detyrë funksionale të tij monitorimin e operacioneve hidrokarbure të kryera nga kontraktorët me të cilët shoqëria “Albpetrol” sh.a ka lidhur Marrëveshje Hidrokarbure

Pretendim i sjellë nga ana e Albpetrol përmes observacioneve të paraqitura me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 3502/3 prot, datë 09.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/2 prot, datë 13.08.2024 z. E D ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Nga Shoqëria Albpetrol sha është bërë monitorimi nga sektori i monitorim-supervizimit të Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure me konkretisht janë mbajtur relacionet përkatëse me nr.10576 prot., datë 28.12.2023, nr. 8166 prot., 02.11.2023, nr. 7202 prot., datë 12.09.2023, nr. 3117 prot., datë 25.05.2023 dhe nr. 2311 prot., datë 13.04.2023.*

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe është *i zbatuar*.

36. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “FP” Sh.a, ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Nga kontrolli që grupi auditit të “Albpetrol” Sha, ka kryer mbi kompaninë “FP” Sh.a për periudhën Q1,Q2,Q3 dhe Q4 2020 si dhe pas kërkesave të shumta që u ka dërguar përfaqësuesve të kësaj kompanie nëpërmjet postës elektronike dhe verbale, për dërgimin e një CRS-je të detajuar, fatura TVSH-je dhe statement banke, grupit të auditit nuk i është vënë në dispozicion asnjë nga dokumentet e kërkuara. Për sa më sipër, shoqëria “Albpetrol” Sha, ka kërkuar të procedohet me zbritjen e të gjitha kostove me vlerën 77,977 USD dhe shpenzimeve nga Llogaria Kosto, për vitin 2020, të cilat nuk janë kualifikuar si kosto hidrokarbure në zbatim të të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Finiq-Kranë dhe Pekisht-Murriz” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

36.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t’i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën **77,977 USD** të konstatuar për vitin 2020.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Me shkresën nr. 6505 prot., datë 31.07.2023, shoqërisë “FP” Sh.a. i është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditit për periudhën Q1-Q4-2020, në të cilën kërkojmë që vlera prej 43,982.4 USD të zbritet nga Llogaria Kosto, në zbatim të Marrëveshjes Hidrokarbure.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *zbatuar pjesërisht*.

37. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “Sh P” Ltd., rezulton me mos realizim të programit të punës dhe buxhetit për vitin 2021 dhe vitin 2022. Për vitin 2021 vërehet se, *Prodhimi i Përgjithshëm* i deklaruar nga shoqëria Sh P është 7,000 Bbl , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 9,909 Bbl, pra me një mosrealizim prej 29%. *Shpenzimet Operative (OPEX)*. Shpenzimet operative kapin vlerën 428 M\$ nga 481 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 53 M\$. Pra, shpenzimet

Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një mosrealizim prej 11%.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për Vitin 2021, kanë qenë 173 M\$ nga 281 M\$ të parashikuara në PP&B 2021 Pra, Shpenzimet Administrative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021, me një mosrealizim prej 38%. *Investimet Kapitale (CAPEX)*: Gjatë vitit 2021 janë kryer 88 M\$ Investime nga 322 M\$ të parashikuara në PP&B 2021. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2021 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2021.

Cost Recovered: Në vitin 2021, sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive.

Për 9-Mujorin e vitit 2022 vërehet se, *Prodhimi i Përgjithshëm* i deklaruar nga shoqëria SIPL është 4130.2 Bbl , shifër kjo e cila është nën parashikimin e bërë në PP&B 2021 prej 8324 Bbl, pra me një mosrealizim prej 50%. *Shpenzimet Operative (OPEX)*. Shpenzimet operative kapin vlerën 351 M\$ nga 407 M\$ të parashikuara në Programin e Punës dhe Buxhetin, me një diferencë prej 56 M\$. Pra, shpenzimet Operative për vitin 2021 janë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e 9-Mujorit te vitit 2022, me një mosrealizim prej 14%.

Shpenzimet Administrative (G&A): Shpenzimet Administrative për 9-Mujorin e vitit 2022 kanë qene 153 M\$ nga 114 M\$ të parashikuara në PP&B 2022 Pra, Shpenzimet Administrative për vitin 2021 janë mbi parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022. *Investimet Kapitale (CAPEX)*: Gjatë 9-Mujorit te vitit 2022 janë kryer 83 M\$ Investime nga 309 M\$ të parashikuara në PP&B 2022. Pra, Investimet Kapitale për vitin 2022 janë shumë më të ulta sesa parashikimi në Programin e Punës dhe buxhetin e vitit 2022. Cost Recovered: Në vitin 2022, sipas Faktit, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat duke gjeneruar një humbje për kompaninë, e cila ndikon në kostot e rikuperueshme progresive

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

37.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve pranë Albpetrol sh.a Patos, duhet të rrisë monitorimin e aktivitetit hidrokarbure të Kontraktorit në të gjitha aspektet, si duke i kërkuar respektimin e planit të miratuar, duke bërë inspektime të prodhimit faktik të puseve të naftës, inspektimin e makineri pajisje që furnizohen, sasinë e holluesit, ujin e përdorur etj., me synim rritjen e eficiencës së operacioneve hidrokarbure dhe rritjen e fitimit të Albpetrol sh.a Patos.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Ky rekomandim është ndjekur dhe zbatuar në vazhdim nga Sektori i Monitorimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure pranë shoqërisë Albpetrol sha, i cili e ka detyrë funksionale të tij monitorimin e operacioneve hidrokarbure të kryera nga kontraktorët me të cilët shoqëria “Albpetrol” sh.a ka lidhur Marrëveshje Hidrokarbure.

Pretendim i sjellë nga ana e Albpetrol përmes observacioneve të paraqitura me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024:

Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 3502/3 prot, datë 09.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/2 prot, datë 13.08.2024 z. E D ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Nga Shoqëria Albpetrol sha është bërë monitorimi nga sektori i monitorim-supervizimit të Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure me konkretisht janë mbajtur relacionet përkatëse me nr.10576 prot., datë 28.12.2023, nr. 8166 prot., 02.11.2023, nr. 7202 prot., datë 12.09.2023, nr. 3117 prot., datë 25.05.2023 dhe nr. 2311 prot., datë 13.04.2023.*

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe është *i zbatuar*.

38. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “Sh P” Ltd., ka përfshirë shpenzime në llogarinë kosto hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen. Albpetrol ka kryer Auditet Vjetore në Zbatim të Nenit 25 “Auditet” të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Kucovë” ka kryer auditimin e raporteve të tremujorit Q1,Q2,Q3, Q4 të vitit 2020, auditim i cili është kryer në 2021 dhe ka rezultuar se, vlera totale e kostove që nuk njihen si të rikuperueshme për vitin 2020, për SIPL është 248,807 USD (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqe 252-293, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

38.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t’i kërkojnë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure në vlerën **248,807 USD** të konstatuar për vitin 2020.

Menjëherë dhe vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Shoqëria “Albpetrol” SH.A, ne perfundim te procesit te auditit, i ka kerkuar ketij kontaktori qe te zbrese shpenzimet e perfshira si kosto hidrokarbure nga llogaria kosto. Nga ana e tij nuk ka patur asnje reagim, kjo vjen pasi referuar nenit 25 te MH, rekomandimet e dala nga auditet e Albpetrol jane keshilluese dhe kontraktori nuk ka detyrim t’i zbatoje ato. Keto veprime per nxjerrjen e detyrimeve kryhen ne vazhdimesi. Nga praktika e deri perpara pak muajve, kerkesat per ekzekutim detyrimesh qe shkonin ne gjykate, “deshtonin”, pasi subjekti “njoftohej” ne rruge informale per detyrimin dhe nderkohe kryente nje pagese minimale. Per kete fakt, kur hapej procesi, debitoret tregonin qe kishin bere pagesen perpara dites se gjykimit, cka Kte si pasoje anulimin e veprimeve dhe “rifillimin” e ketyre procedurave ne kohe me vonë. Per kete arsye, Drejtoria Juridike, me urdher te Administratorit, ka filluar tashme dhe i depoziton keto kerkesa (ne menyre konfidenciale dhe dorazi, duke bashkepunuar edhe me personat kompetente prane Gjykates se Juridiksionit te Pergjithshem Fier), duke i perfunduar llogaritjet e demeve ne bashkepunim me specialiste te finances pikerisht ne ditën qe hartohet shkresa. Ndjekja e ketyre debitoreve eshte proces ne vijimesi.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe është *zbatuar pjesërisht*.

Referuar observacioneve të sjella nga Albpetrol sh.a me shkresën nr. 3502/5 prot., datë 10.10.2024 dhe protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr. 792/15 prot., datë 14.10.2024, të cilat rezultojnë të jenë të njëjta me ato të sjella për fazën e Projekt Raportit të Auditimit rezulton se, në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese dhe provuese, të cilat do të ndryshojnë statusin e zbatueshmërisë së rekomandimeve vijon të mbahet i njëjti qëndrim.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kaluar të lëna me Vendimin nr.76 datë 15.05.2022 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, statusi i zbatimit të së cilave është si më poshtë vijonë

-Rekomandimet për masat për shpërblim dëmi me vlerë 346,696,708 lekë, respektivisht:

1.1.Rekomandim: Nga administratori i shoqërisë Albpetrol sha të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **328,107,588 lekë**, nga personat të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe i **pazbatuar**.

2.1.Rekomandim: Nga administratori i shoqërisë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës **5,737,500 lekë**, nga znj. E M, znj. G A, znj. K M, znj. L Rr, znj. D A, znj. J N, znj. E A. z. A M.

Menjëherë

Pretendimet e subjektit të audituar:

Pretendim i sjellë nga ana e Albpetrol përmes observacioneve të paraqitura me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024: Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 3502/3 prot, datë 09.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/2 prot, datë 13.08.2024 z. Eltar Deda ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Nga Shoqëria Albpetrol sha është bërë njoftim për shlyerje vullnetare të detyrimit me shkresën nr. 160 prot., datë 10.01.2024.*

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e Albpetrol Sh.A (personat përgjegjës të nga ngarkuar) rezulton se, është ndërmarr nisma e nxjerrjes së urdhrit dhe më tej nuk ka asnjë gjurmë justifikuese të vijimit të zbatueshmërisë së rekomandimit.

Mbajtur në konsideratë edhe se, periudha kohore nga nxjerrja e urdhërit e deri në verifikimin e statusit të rekomandimit është e gjatë (1 vit) ndodhemi në kushtet e moszbatimit të rekomandimit nga ana e njësisë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pazbatuar**

3.1.Rekomandim: Nga administratori i shoqërisë Albpetrol ShA të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,369,495 lekë**, nga personat të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe i **pazbatuar**.

4.1. Rekomandim: Nga Administratori i Albpetrol ShA dhe Drejtoria Ligjore të merren masat e duhura duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e

gjykimit, për arkëtimin i shumës **2,408,353 lekë** nga ish-punonjësit përfitues të kontratave të huave pa interes.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

5.1.Rekomandime: Administratori i Shoqërisë të marri masat për arkëtimin e vlerës **2,126,154 lekë** nga personat përgjegjës të cilët kanë tërhequr karburantin si dhe nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët bazuar në urdhrin e Administratorit vërtetohet se kanë konsumuar karburantin, sipas normativave të miratuara.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

6.1.Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat e duhura dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës **2,121,091 lekë** nga punonjësit përfitues të administratës qendrore dhe qendrave të prodhimit (sipas listës në tabelën nr. 8 dhe 8/1, në aksin nr. 2, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit). Gjithashtu nga Administratori i Shoqërisë të nxjerrë akt administrativ për të revokuar vendimin nr. 365, datë 02.12.2013, të ish-Administratorit, me qëllim mos vazhdimin më tej të këtyre shpërblimeve.

Menjëherë

Pretendimet e subjektit të audituar:

Pretendim i sjellë nga ana e Albpetrol përmes observacioneve të paraqitura me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024: Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 3502/3 prot, datë 09.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/2 prot, datë 13.08.2024 z. E.D. ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Nga Shoqëria Albpetrol sha është bërë njoftim për shlyerje vullnetare të detyrimit me shkresën nr. 160 prot., datë 10.01.2024.*

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e Albpetrol Sh.A (personat përgjegjës të nga ngarkuar) rezulton se, është ndërmarr nisma e nxjerrjes së urdhrin dhe më tej nuk ka asnjë gjurmë justifikuese të vijimit të zbatueshmërisë së rekomandimit.

Mbajtur në konsideratë edhe se, periudha kohore nga nxjerrja e urdhrin e deri në verifikimin e statusit të rekomandimit është e gjatë (1 vit) ndodhemi në kushtet e moszbatimit të rekomandimit nga ana e njësisë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***

7.1.Rekomandim: Administratori i Shoqërisë të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,878,527 lekë**, nga personat të cilët kanë bërë tërheqjen e karburantit në magazinën e Albpetrol ShA, sipas listës së lënë nga KLSH në tabelën nr.1, aneksi 6/1, bashkangjitur Raportit Përfundimtar

të Auditimit. Nëse në vijim vetë Albpetrol ShA nëpërmjet strukturës së auditit të brendshëm, apo dokumenteve të tjera, evidenton se vlera e mësipërme është përdorur edhe nga punonjës të tjerë, të marrë masa që prej tyre të zhduket vlera e përdorur, duke i shtuar këta persona në listën e lënë nga KLSH.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

7.2. Rekomandim: Nga Administratori i shoqërisë, të merren masa që për çdo urdhër të nxjerrë për furnizim me karburant, të përcaktohet qartë qëllimi i përdorimit, i cili të jetë i argumentuar dhe të lidhet drejtpërdrejtë me domosdoshmërinë e kryerjes së aktivitetit të shoqërisë. Të përcaktohen rregulla të shkruara për furnizimin me karburant (procesi fillon me kërkesën nga struktura përkatëse për nevojën për karburant etj.), si dhe pas konsumit të plotësohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që vërteton shpenzimin e sasisë së tërhequr.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

B.1 MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kaluar të lëna me Vendimin nr.133 datë 28.07.2023 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, statusi i zbatimit të së cilave është si më poshtë vijonë:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Administratori i Albpetrol sh.a Patos, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi Zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 4,416,935,188 lekë si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se detyrimet e koncesionarëve ndajë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për energjinë e shitur/faturuar me dhe pa kontrata janë në shumën 1,429,616 mijë lekë, nga e cila kamatëvonesë për mos pagim në afat për vlerë 1,583,865 mijë lekë. Nga ana e sajë shoqëria Albpetrol sh.a Patos, ka vijuar me pagesat sipas akt-marrëveshjes datë 03.10.2022, midis FSHU sh.a dhe shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për pagesë me 24 këste të detyrimeve, duke paguar në mënyrë të padrejtë dhe për detyrimet e koncesionarëve. Gjithashtu, shoqëria Albpetrol sh.a Patos, nga ana e sajë nuk ka marrë asnjë masë shtrëngues për arkëtimin e detyrimeve të energjisë elektrike të konsumuar nga shoqëritë koncesionarëve. Ky veprim përben risk të lartë për shoqërinë “ALBPETROL” sha me efekt financiar me dëm

në shumën 3,013,481,000 lekë së bashku me kamatëvonesat, pasi në rast falimentimi ose largimi të ndonjë prej shoqërive koncesionare detyrimet për energjisë mbesin për likuidim shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, gjë e cila bëhet akoma dhe më e vështirë për ato shoqëri koncesionare që nuk kanë kontratë shitje energjie për të kërkuar në gjykatë detyrimet, duke rënduar situatën financiare të shoqërisë Albpetrol.

Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 3, Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës shkronja “g”, ku citohet:

Garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mbledhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta.

si dhe neni 10 i kontratës me OSHEE për jo familjar, kamatëvonesa për pagesë të vonuar, ku citohet:

“Pas kalimit të afatit të pagesës caktuar në nenin 9.1, Klienti është i detyruar të paguajë një kamatë vonesë të barabartë me 0.1 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera totale e vetë faturës.”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 122-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të njoftoj Këshillin Mbikëqyrës dhe të nxjerrë përgjegjësitë për detyrimet që shoqëritë koncesionare kanë ndajë shoqërisë Albpetrol sh.a Patos për energjinë e shitur/faturuar me dhe pa kontrata, si dhe të ndjek të gjithë rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,013,481,000 lekë** (principlial në vlerën 1,429,616,000 lekë dhe kamatëvonesë në vlerën 1,583,865,000 lekë), për të shmangur lindjen e borxhit të keq.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Vendimi nr. 1, i Këshillit Mbikëqyrës, datë 20.02.2024, dhe vendimi nr. 2155/1, i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, datë 08.03.2024. Aktualisht Albpetrol Sh.A ka nënshkruar marrëveshje me kontraktorët për shlyerjen e energjisë së shitur/faturuar, mbështetur në vendimin e ERE për përcaktimin e çmimit të energjisë. Me shkresën nr. 7250 prot., datë 14.09.2023 i është dërguar kompanive për rillogaritjen e kamatvonesave për energjinë elektrike për periudhën 01.01.2018 deri me 31.08.2023. Me shkresat nr. 7469 prot., datë 26.09.2023, nr. 7468 prot., datë 26.09.2023 dhe shkresën 7467 prot., datë 26.09.2023 janë njoftuar kompanitë për takim mbi rillogaritjen e kamatvonesave dhe janë kryer takimet përkatëse në ambjentet e shoqërisë Albpetrol sha.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit justifikues vendosur në dispozicion, rezulton se nga ana e Albpetrol janë ndërmarr disa hapa përsa i përket shlyerjes së së energjisë elektrike të shitur/faturuar (marrëveshja me kontraktorët) dhe rillogaritje e kamatvonesave (shkresat nr. 7250 prot., datë 14.09.2023 , nr. 7469 prot., datë 26.09.2023, nr. 7468 prot., datë 26.09.2023 dhe nr.7467 datë 26.09.2023) por nuk është ndërmarr asnjë masë për ndjekjen dhe arkëtimin e vlerës prej 3,013,481,000 lekë. Sa më sipër konsiderohet i pazbatuar ky rekomandim.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pjesërisht zbatuar***.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “Përmirësim i infrastrukturës së stacionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos”, me fond limit 59,970,906 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur shoqëria “Z” shpk me vlerë kontrate (pa TVSh) prej 59,955,454 lekë, rezulton se nuk janë zbatuar kushtet e kontratës nr. 2905/9, datë 22.6.2021 të lidhur midis shoqërisë “Z” shpk dhe Autoritetit Kontraktor Albpetrol sh.a Patos, për përfundimin e punimeve brenda afatit të 4 muajve, ose nga data 22.6.2021 deri me datë 21.10.2021.

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Financës në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, është likuiduar shuma totale 71,944,212 lekë.

Nga shoqëria “Z” shpk janë paraqitur fatura për likuidimin e situacioneve jashtë afatit të zbatimit të kontratës (data 21.10.2021), konkretisht fatura nr. 5/2022, datë 15.3.2022 në shumën 10,473,575 lekë me TVSh ose në vlerën 8,727,979 lekë pa TVSh, për të cilën nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos (*personat përgjegjës*) nuk janë llogaritur penalitetet në referencë të nenit 9 të kontratës, kjo për 144 dite vonesë.

Gjithashtu nga shoqëria “Z” shpk nuk është bërë i mundur që në momentin e deklarimit të përfundimit të punimeve dhe akt-marrjes së përkohshme të depozitohet dhe fatura e shoqëruar me situacion përfundimtar për punimet e mbyllura, duke lënë jashtë afateve vlerën e mësipërme, për të cilën nga personat përgjegjës duhej të llogaritej penaliteti në vlerën 8,633,585 lekë $\{(59,955,454 \text{ lekë} \times 25\%) = (14,988,863 \text{ lekë} \times 4/1000 \text{ ditë vonesë} \times 144 \text{ ditë})\}$, vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, në kundërshtim me nenin 9 të kontratës nr. 2905/9, datë 22.6.2021 për “Përmirësim i infrastrukturës së Stacionit të shitjes së naftës, Zharrës në QASHNG, Patos” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **8,633,585 lekë**, për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 2905/9, datë 22.6.2021 nga shoqëria “Z” shpk.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Me shkresën nr. 1205 prot., date 22.02.2024, dhe fatura nr. 917/2024, date 12.03.2024, është njoftuar subjekti Z. për shlyerje vullnetare të detyrimit për 144 ditë vonesa, në vlerën 8.633.585 lekë. Operatori Ekonomik Z shpk e ka kundërshtuar faturën me nr. 917/2024, datë 12.03.2024. Nga ana e Albpetrol sha nuk janë marrë masa për ndjekjen e procedurave ligjore për realizimin e rekomandimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion ashtu sikundër edhe vet nga njësia specifikohet ... *Nga ana e Albpetrol sha nuk janë marrë masa për ndjekjen e procedurave ligjore për realizimin e rekomandimit.*

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “Blerje kalimatës nafte (*flow-meter*)”, me fond limit 37,936,920 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur shoqëria “V” me vlerë kontrate (pa TVSh) 37,178,181 lekë, rezulton se nuk janë zbatuar kushtet e kontratës nr. 1079/9, datë 19.4.2022 të lidhur midis shoqërisë “V” shpk dhe Autoritetit Kontraktor shoqërisë Albpetrol sh.a për përfundimin e punimeve brenda afatit 4 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës ose nga data 19.4.2022 deri me datë 19.8.2022.

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Financës në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, konstatohet se është paraqitur për likuidim vlera 44,613,816 lekë, nga e cila likuiduar në masën 80% sipas

pikës 3.2 të nenit 3 të kontratës në vlerën 35,691,053 lekë dhe nuk është likuiduar vlera prej 8,922,763 lekë ose 20% e kontratës po sipas nenit 3 të kontratës, pika 3.2, pasi 20% do likuidohet pasi pajisja të jetë instaluar në vend.

Mallrat janë bërë hyrje në magazinë e QFT Patos, kjo sipas pikës 4.8/a të nenit 4 të kontratës, konstatuar kjo dhe nga komisioni i marrjes në dorëzim me PV nr. 472/2, datë 16.9.2022, sipas urdhrit datë 20.4.2022.

Konstatohet se nuk është bërë instalimi i kalimatasve, vënia në punë dhe realizimi i asistencë teknike, siç përcaktohet në pikën 2.4.3 të nenit 4 të kontratës me 180 ditë vonesë, ku megjithëse nga shoqëria *Albpetrol sh.a Patos* është kërkuar me urgjencë për shitjen e naftës sipas kërkesave të doganës, akoma edhe sot qëndrojnë të pamontuara në magazinë dhe të pa vënë në punë, duke bërë që nafta të matet me sasi/ton, duke e klasifikuar këtë shpenzim një shpenzim paefektivitet për shoqërinë me fond 37,936 mijë lekë nga mosvënia në punë e kalimatasve për të cilën është realizuar procedura e prokurimit.

Nga sa trajtuam kontrata nuk ka përfunduar sipas kushteve të përcaktuara në nenin 9 të kontratës, brenda periudhës 4 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës së bashku me shtesën ose nga data 19.4.2022 deri me datë 31.8.2022, pasi mallrat qëndrojnë akoma në magazinë pa u vënë në funksion për të cilën shoqëria “ALBPETROL” sha ka kryer shpenzimin.

Kështu për vlerën 8,922,763 lekë, që korrespondon 20% të vlerës së kontratës e cila nuk është zbatuar, penaliteti përllëgaritet në vlerën 1,606,096 lekë ($8,922,763 \text{ lekë} \times 25\% = (2,230,690 \times 4/1000 \times 180 \text{ ditë vonesë})$), veprime me dëm në buxhetin e shoqërisë *Albpetrol sh.a Patos*.

Gjithashtu konstatohet se pavarësisht faktit se nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 6774 prot, datë 24.9.2020 dhe shkresës së Drejtorisë së Doganës Fier nr. 2399 prot, datë 7.6.2021 i është kërkuar shoqërisë *Albpetrol sh.a Patos* për pajisjen e pikave fundore të shitjes së naftës bruto me paisje për matjen (kalimatas), nga shoqëria *Albpetrol sh.a Patos* megjithëse procedura është zhvilluar dhe lidhur kontrata me subjektin fitues “V.” shpk, nuk është bërë i mundur vënia në punë e këtyre aparaturave sipas kushteve të kontratës ose nga data 23.8.2022, megjithëse këto paisje janë bërë hyrje në magazinë, duke e bërë këtë një shpenzim jo me efektivitet dhe që pengon procesin e shitjes së naftës, në kundërshtim me nenin 20 të ligjit nr. 61/2012 “Për AKCIZAT në RSH”, i ndryshuar dhe kushtet e kontratës nr. 10790/10, datë 19.4.2022 për realizimin e blerjes me objekt “*Blerje Kalimatas naftë (flow-metër)*” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë *Albpetrol sh.a* të ngrejë një grup pune dhe të analizojë përgjegjësinë e personave përgjegjës në mos zbatimin e kushteve të kontratës me objekt “*Blerje Kalimatas naftë (flow-metër)*”, ku për personat përgjegjës të kërkohet shpërblymimi i dëmit në vlerën **1,606,096 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

Të marra masa të menjëhershme për vënien në punë të kalimatasve sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e zbatimit.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Lidhur me këtë rekomandim mbi zbatimin e kontratës me objekt blerje kalimatas naftë floë-meter, Qendra e Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit ka dorëzuar relacionin nr.438/4 datë 08.09.2023, me anë të cilit shpjegon gjithë procedurën e ndjekur deri në montimin përfundimtar dhe vënien në punë të kalimatasve.

Sipas relacionit të sipërpërmendur theksohet se kontrata nga ana teknike është realizuar konform neneve të saj më datë 24.08.2022. Për montimin e kalimatasve janë hartuar programet e punës nr. 7219 prot., datë 05.10.2022 “Për kryerjen e punimeve për pregatitjen e tubacioneve në stacionet e naftës Zharrëz, Kucovë, Usojë, dhe Visokë ku do të montohen kalimatasat.

Më tej pas problematikave të konstatuara lidhur me kompleksitetin e punës që do të kryhej Administratori i Albpetrol sha ka nxjerre urdhrin nr. 67, datë 06.03.2023, “Për zbatimin e Programit të punës për kryerjen e punimeve për përgatitjen e tubacioneve në stacionet e naftës Zharrëz, Kucovë, Usojë, dhe Visokë ku do të montohen kalimatësat. Pasi u siguroa e gjithë baza materiale dhe u bënë gati punimet parapërgatitore, u montuan dhe u vunë në punë të katër kalimatësat. Theksojmë se dëmi i përlllogaritur nga KLSH nuk ka një bazë përlllogaritje të saktë bazuar në kushtet e kontratës, pasi malli ka hyrë në magazinën e Albpetrol sha brenda afatit të kontratës si dhe në përputhje me të gjitha kërkesat teknike të përcaktuara në kontratë. Procesi i montimit dhe vënies në punë të kalimatësave është një proces kompleks i cili ka marrë kohën e vet dhe në fund të procesit parapërgatitor janë montuar, janë certifikuar dhe vënë në punë kalimatësat.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i papranuar* nga subjekti.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “Zëvendësim i mbulesave ekzistuese “Eternit” i çative të repartit Mekanik dhe reparti Elektrik në QMN Kuçovë”, me fond limit 9,953,982 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur shoqëria “A” me vlerë kontrate (pa TVSh) 9,187,380 lekë, rezulton se:

Preventivi është hartuar nga specialistët *ing. R G*, bazuar në çmimet sipas VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar. Nga verifikimi i çmimeve sipas manualit, konstatohet se ato janë nuk janë në zbatim me VKM nr. 629, datë 15.7.2015, i ndryshuar, *konkretisht:*

Nr. An	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi sipas preventivit	Çmimi sipas manualit	Vlera sipas preventivit	Vlera sipas manualit	Diferenca
2/214+256/b	Riparim catie + mbulim me sanduic	m2	476	4911	3816	2,337,636	1,816,416	521,220

Nga sa trajtuam mësipërm vlera e preventivit është rënduar më shumë prej **521,220 lekë**, veprime me efekt negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, në kundërshtim VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjor për arkëtimin e vlerës **521,220 lekë**, ndajë *ing. R G* si personi përgjegjës për hartimin e disa prej zërave të projektit në kundërshtim VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Albpetrol Sh.A, me shkresen Nr. 203 date 11.01.2024 ka shpallur debitor *ing. R. G*.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion, nga ana e Alpetrol Sh.A është iniciuar procesi dhe ka ndaluar menjëherë pas shpalljes debitor të Znj. R G.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “Zëvendësim i mbulesave ekzistuese “Eternit” i çatave të repartit Mekanik dhe repartit Elektrik në QMN Kuçovë”, me fond limit 9,953,982 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur shoqëria “A” me vlerë kontrate (pa TVSh) 9,187,380 lekë, rezulton se nuk janë zbatuar kushtet e kontratës nr. 8489/9, datë 3.3.2022 të lidhur midis shoqërisë “A” Shpk dhe Autoritetit Kontraktor Albpetrol sh.a Patos, për përfundimin e punimeve brenda afatit të 8 javëve, ose nga data 29.3.2022 (data e fillimit të punimeve), deri me datë 4.5.2022.

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria Financës, rezulton se nuk është likuiduar asnjë vlerë e situacionuar, kjo pasi sipas znj. A B në dosjen teknike të përcjell për likuidim nuk është bashkëlidhur situacioni përfundimtar i punimeve.

Me shkresën nr. 134/6, datë 15.12.2022 të Drejtorit të Qendra Mekanike e Naftës QMN Kuçovë përcjellë në adresë të Drejtorisë së Financës shkresa me lëndë “Dërgim dokumentacioni”, në të cilën janë listuar dhe dokumentacioni që shoqëron. Në këtë liste është dhe situacioni përfundimtar.

Me MEMO nr. 9218/1, datë 22.12.2022 të Drejtorisë së Programimit në adresë të z. E D me detyrë Administrator, është përcjellë informacion mbi zbatimin e kontratës me nr. 8449/12, datë 3.3.2022, duke informuar administratorit mbi fazat e zbatimit të kontratës nga momenti i përfundimit të punimeve datë 4.5.2022 deri në hartimin e akt kolaudimit. Në këtë MEMO në pikën 3 thuhet se situacioni përfundimtar është në përputhje me projekt preventivit.

Me shkresën nr. 134/7, datë 22.12.2022 (prot ALBPETROL nr. 9218, datë 22.12.2022), DMN Kuçovë kërkesë për likuidim, duke rreshtuar gjithë dokumentacionin e plotë.

Pas ballafaqimit të problematikës mbi arsyet e moslikuidimit nga znj. A B u rishpjegua se dokumentacioni shoqërues nuk është i saktë. Për këtë me MEMO datë 17/01/2023 (e pa protokolluar në instuticioni) dhe panëshkruar nga personat se kujt i është adresuar, thuhet se me anë të kësaj shkrese kërkohet plotësimi i praktikës me dokumentacion me argumentin se “Nuk mund të vijohet me procedurën e likuidimit pasi kjo kontratë është e paplotësuar me dokumentacioni justifikues dhe kërkohet plotësimi i saj”.

Në këtë MEMO për veç faktit se nuk është e protokolluar dhe pa nënshkruar nga personat të cilëve ju është adresuar MEMO në instuticioni, në kundërshtim me rregulloren e Albpetrol sh.a Patos (miratuar me vendimit nr. 20, datë 3.12.2022), por nuk është e specifikuar se cilat nga dokumentacioni justifikues nuk është paraqitur ose është i parregullt.

Me shkresën nr. 1081, datë 13.2.2023 Drejtoria e Programimit për dijeni dhe Administratorit z. E D i përcjellë Drejtorisë së Financës dokumentacionin e plotë për zbatimin e kontratës nr. 1081, datë 13.2.2023, duke listuar të gjithë dokumentat, ku bë pjesë dhe situacioni përfundimtar (nr. 27 i listës).

Nga znj. A B për sqarimin e situatës është paraqitur situacioni i cili është pa datë por i nënshkruar nga gjithë peronat përgjegjës, situacion i cili në dosjen e zbatimit dhe dokumentacioni shoqërues për likuidim mungonte. Pretendimi i Drejt/Financës se situacioni është i panëshkruar nuk qëndron, pasi ai është nënshkrua nga subjekti, mbikëqyrë si dhe z. E D në cilësinë e Administratorit.

Referuar sa mësipërm fatura nr. 35/2022, datë 29.6.2022 në shumën 11,024,856 lekë e cila është depozituar në Drejtorinë e Financës me datë 22.12.2022 nuk është mundësuar likuidimi i saj deri në datë 31.3.2023, në kundërshtim me nenin 29 pika 5 e kontratës nr. 8489/9, datë 3.3.2022.

Sipas dokumentacionit në financë, shoqëria “A” shpk ka paraqitur për likuidim faturën nr. 35/2022, datë 29.6.2022 në shumën 11,024,856 lekë me TVSh (vlera e plotë e kontratës).

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se nga shoqëria fatura është paraqitur jashtë afatit të zbatimit dhe kjo e pashoqëruar me situacion përfundimtar (data 29.6.2022), dokumentacion bazë që tregon përfundimin e punimeve për të cilën nga shoqëria Albpetrol sh.a Patos nuk janë

llogaritur penalitet në masën 4/1000 në ditë jo më pak se 25% e vlerës së kontratës, kjo në referencë të nenit 33 të kontratës, për ditëvonesat përlllogaritjen prej 55 dite vonesë nga data 4.5.2022 deri datë 29.6.2022.

Nga sa trajtuam mësipërm shoqëria “A” shpk nuk ka plotësuar kushtet e kontratës për mbylljen e sajë brenda afatit ligjorë duhet të llogaritet penaliteti në shumën **505,305 lekë** $\{(9,187,380 \times 25\% = (22,96,845 \text{ lekë} \times 4/1000 \text{ ditë vonesë} \times 55 \text{ ditë})\}$, vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **505,305 lekë**, për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 8489/9, datë 3.3.2022 nga shoqëria “A” shpk.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigjja e institucionit:

Operatorit ekonomik i janë mbajtur 55 ditë vonesa, sipas fatures nr. 3344/2023, datë 09.08.2023, me vlerë të penaltetit 603,367 leke. Shuma është likuiduar dhe janë mbajtur edhe penaltetet.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe është *i zbatuar*.

6. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i procedurës me objekt: *“Shërbime për punime me autosondë me kullë me kapacitet ngritës > 70 ton”*, me fond limit 15,900,000 lekë për vitin 2021, ku fitues është shpallur fitues shoqëria “S” shpk me vlerë kontrate (pa TVSh) prej 14,900,000 lekë, rezulton se:

Nga shoqëria nuk janë plotësuar kushtet e kontratës nr. 6081/11, datë 30.9.2021 të lidhur midis shoqërisë “S” shpk dhe AK (Albpetrol sh.a), me vlerën 14,900,000 lekë pa TVSh ose vlera 17,880,000 lekë me TVSh për zbatimin e afatit brenda 12 muajve ose nga data 30.9.2021 deri me datë 30.9.2022.

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria Financës në shoqërinë *Albpetrol sh.a Patos*, shoqëria ka paraqitur për likuidim fatura në shumën totale 6,339,710 lekë, vlerë e cila është likuiduar nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos deri me datë 16.9.2022.

Nga ana e shoqërisë “S” shpk nuk është mbyllur kontrata për vlerën 17,880,000 lekë, kjo deri me datë 30.9.2022, duke mbetur pa zbatuar vlerën 11,540,290 lekë $(17,880,000 - 6,339,710)$, për ditë vonesat janë 180 ditë vonesë nga data kur duhej mbyllur kontrata..

Për zbatimin e kësaj kontrate është ngarkuar z. I C *me profil ing. Naftë pranë Drejt/Prodhimit*, në zbatim të urdhrin nr. 6081/12, datë 30.9.2021.

Konstatohet se nuk ka asnjë dokument justifikues mbi vonesat e mos mbylljes në afat të kontratës, veprime në shkelle të nenit 14 të kontratës 6081/11, datë 30.9.2021, ku deri me datë 30.3.2023 detyrimi për kamatëvonesën e pallogaritur përlllogaritet në shumën **2,682,000 lekë** $(14,900,000 \times 25\%) = (3,725,000 \text{ lekë} \times 4/1000 \times 180 \text{ ditë vonesë})$, vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në shoqërinë Albpetrol sh.a Patos (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, të marrin të gjitha masat për ndjekjen e procedurave administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës **2,682,000 lekë** nga shoqëria “S” shpk, si dhe marrjen e masave ndajë personave përgjegjës në mos ndjekjen e kontratës sipas afateve.

Përgjigja e institucionit:

Është njoftuar subjekti me shkresën nr. 1206 prot., datë 22.02.22, dhe i është prerë fatura me nr. 948/2024, datë 18.03.2024. Nga ana e Albpetrol sha nuk janë marrë masa për ndjekjen e procedurave ligjore për realizimin e rekomandimit.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion ashtu sikundër edhe vet nga njësia specifikohet ... *Nga ana e Albpetrol sha nuk janë marrë masa për ndjekjen e procedurave ligjore për realizimin e rekomandimit.*

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “*Ndërtim RVM 1500 m3 në parkun Dekantim Gorisht*”, me fond limit 14,666,892 lekë pa TVSh viti , në të cilën kanë marrë pjesë 2 OE, fitues është shpallur shoqëria “A” shpk me ofertë 13,976,934 lekë më të lartë se OE i skualifikuar, *rezulton se:*

Me shkresën nr. *Ska*, datë *ska* të Drejtorisë Financës i është kërkuar Administratorit që në zbatim të kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021 dhe amendament kontrate nr. 605, datë 20.01.2022 likuidimin e shumës 16,772,320 lekë me TVSh ndaj shoqërisë “A” shpk.

Sipas kontratës fillestare afati i përfundimit të punimeve është 3 muaj ose nga datë 15.10.2021 deri me datë 15.01.2022. Sipas të dhëna të Sektorit të Menaxhimit të Kontratave punimet kanë filluar me datë 21.10.2021. Nisur nga fakti se kjo kontratë ka shtesë afati për një periudhë 30 ditë, afati i punimeve është nga data 20.10.2021 deri me datë 22.02.2022.

Me shkresën nr. 3183, atë 19.4.2022 Drejt/Programimit dhe zhvillimit me autorizim zj. V. S. i është drejtuar Drejt/Financës për dijeni administratores znj. A H për likuidim situacioni përfundimtar, kjo në referencë të shkresë së QPN Gorisht nr. 282, datë 12.4.2022 (*prot Albpetrol nr. 3183, datë 15.4.2022*).

Sipas kësaj shkrese me datë 6.4.2022 nr. 2862prot, është protokolluar në Albpetrol sh.a dokumentacioni nga kolaudatori i punimeve shoqëria “V” shpk.

Me shkresën nr. 3921prot, datë 20.5.2022 të znj. A B me detyrë Drejt/Financës i është kërkuar interpretim Drejt/Çështjeje ligjor në lidhje me mangësitë e dokumentacionit shoqërues të faturës për likuidim, duke theksuar se dokumentacioni nuk është nënshkruar nga ish-administratori, pasi situacioni nuk është nënshkruar nga AK (Albpetrol sh.a), por është nënshkruar nga komisioni i ngritur nga qendra e QPN Gorisht (persona që ndjekin kontratën). Për këtë është kërkuar interpretimi juridik që bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2021 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve” që dokumentacioni i përcjellë juridikisht është i rregullt ose jo.

Nga Drejt/ Çështjeje ligjore me shkresën nr. 3921/1, datë 6.6.2022 i kthen përgjigje Drejt/Financë që situacioni përfundimtar i datës 30.3.2022 i cili rezulton i nënshkruar nga sipërmarrës, mbikëqyrësi i punimeve dhe komisioni i QPN Gorisht në cilësinë e përfaqësuesit të AK Albpetrol sh.a Patos sh, në zbatim të kreut II pika 7, pikën 17 dhe 18 të udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2021 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, dokumentacioni është i rregullt. Me shkresën nr. 4462prot, datë 106.2022 Drejt/Financës i drejtohet Drejt/ Programimit se vlera e faturës për likuidim nuk përputhet me vlerën e situacionit përfundimtarë. Me shkesën nr. 4462/1prot, datë 13.6.2022 Drejt/Programimit i drejtohet Drejt/Financës se fatura tatimore elektronike është pranuar nga Sektori i Financës në QNP Gorisht, me faturën elektronike të korrigjuar nr. 384, datë 10.6.2021.

Me shkresën nr. 282, datë 12.4.2022 të Q.P.N Gorisht (*financiari S D dhe Drejtori N B*), i është drejtuar Drejt/Financës Albpetrol sh.a për likuidimin e situacioni përfundimtar sipas faturës 109, datë 10.6.2022 në shumën 16,770,640 lekë me TVSh e cila është likuiduar me datë 23.6.2022 në shumën 15,932,108 lekë me TVSh, duke zbritur garancinë 5%.

Me shkresën nr. *Ekstra* datë 01.4.2022 të shoqërisë “A” shpk është depozituar dokumentacioni për likuidimin e kontratës së punimeve nr. 6082/10, datë 15.10.2021.

Nga të dhënat e mësipërme punimet nuk kanë përfunduar në afatin e caktuar në kontratë dhe amendament kontratë, pra nga datë 22.10.2021 deri me datë 22.02.2022, pasi ato janë mbyllur me datë 30.3.2022 (data situacioni përfundimtar) ose datë fatura 8.4.2022.

Në zbatim të nenit 33 pika 33.1 germa (a), ndaja shoqërisë ‘A shpk nga Sektori Financës QPN Gorisht (S D) dhe Drejt/Financës Albpetrol sh.a Patos (A B) duhej të ishin llogaritet penalitetet për mos respektim të kushteve të kontratës për afatet e zbatimit në vlerën 223,630 lekë ($13,976,934 \times 25\% = 3,494,233$ pa TVSh $\times 4/1000 \times 16$ ditë vonesë), në kundërshtim me nenin 33 pika 33.1 germa (a) e kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021 të lidhur midis shoqërisë “A.shpk dhe shoqërisë Albpetrol sh.a Patos (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **223,630 lekë pa TVSh** ndaj shoqërisë “A” shpk për mos zbatimin e kushteve të kontratës nr. 6082/10, datë 15.10.2021.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Është njoftuar subjekti me shkresën nr. 1207 prot., datë 22.02.2024, dhe ka arkëtuar detyrimin **223,630 lekë** në datë 05.03.2024, pranë C. B.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i zbatuar*.

8. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit konstatoi se bazuar në listë pagesat e periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 janë paguar dieta për trajtim ushqimor në masën 500 lekë ndërkohë që me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar në masën 300 lekë. Në lidhje me këtë VKM rezulton se nga Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit nuk është marrë asnjë iniciativë për implementimin dhe zbatimin e saj, si dhe vënien në dijeni të Administratorit dhe aparatit të shoqërisë, për përmirësimet ligjorë, duke qenë një detyrë funksionale e kësaj drejtorie.

-Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultoi se me VKM nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, Drejtorisë së Burimeve njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjorë për caktimin e dietës ushqimorë në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë

rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet përkatëse për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive.

Nga llogaritja e listpagesave të periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 rezulton se ky përfitim është në masën 425,231,740 lekë, nga 255,231,740 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej **170,092,696 lekë** e cila konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë. (Shënim: Llogaritja është kryer në bazë të shumës totale të përfituar, pjesëtuar me vlerën prej 500 lekë/ditë, dhe më pas është shumëzuar me 200 lekë/ditë, e cila është shuma e përfituar më tepër). Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a) (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masat dhe të ndiqen procedurat administrative e ligjore ndaj personave përgjegjës për arkëtimin e shumës **170,092,696 lekë**, për mos përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive rekomanduara kjo dhe në auditimet e tjera të KLSH.

Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit të marrë masat e duhura dhe të kryejë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, duke nxjerrë aktet përkatës për mos vazhdimin e dietës ushqimore më tepër nga përcaktimet ligjore.

Menjëherë

Përgjigja e Institucionit:

Në lidhje me zbatimin e Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 7.2.2018 nga ALBPETROL SH.A., në referim të përmbajtjes së VKM, përcaktohet në pikën 2 se “*Vlera, mënyrat dhe kriteret e dhënies së pagës në natyrë do të jenë, si më poshtë vijon: a) Kufiri i vlerës së shpërblimit në formën e pagës në natyrë do të jetë deri në masën 300 (treqind) lekë për një vakt dhe deri në masën 500 (pesëqind) lekë, kur trajtohet me më shumë se një vakt për ditë pune; b) Në kontratën kolektive apo individuale të punës, palët mund të përcaktojnë edhe trajtime të tjera, si dhe ndryshimin e kufijve të pagës në natyrë, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit; c) Shpërblimi në formën e pagës në natyrë mund të jepet në trajtim ushqimor, kupon dhe mall. Në raste të veçanta, kur nuk ekzistojnë mundësitë për dhënien e shpërblimit në asnjë nga këto forma, punonjësit i jepet shpërblimi në para dhe ky shpërblim, për efekte fiskale, trajtohet si paga; Pra referuar parashikimit të VKM është mjaft e qartë që punëdhënësi në kontratën kolektive të nënshkruar me përfaqësuesit e punëmarrësve kanë të drejtë të ndryshojnë kufijtë e pagës në natyrë. Duke qenë se Kodi i Punës apo aktet nënligjore që gjejnë zbatim në marrëdhëniet e punës nuk mund të parashikojë çdo detaj të një marrëdhënieje pune, nëpërmjet parashikimeve të Kodit të Punës - u është dhënë mundësi palëve që të ndërtojnë kontratë kolektive, kontratë individuale pune, duke u treguar se cilët janë elementet e detyrueshëm që duhet të vendosin në të dhe cilat janë kufijtë, të cilat palët nuk mund të kalojnë sa i takon aspekteve minimale të mbrojtjes në punë, pagës, kushteve të punës, pushimeve vjetore, shpërblimeve, pagesës për orët e punës jashtë kohës normale të punës, afateve të njoftimit etj.. Të gjitha këto dhe shumë të tjera, mund të parashikohen nga palët në një kontratë kolektive, kontratë individuale pune apo rregullore. Veçanërisht, në Kontratën Kolektive të nënshkruar nga ALBPETROL SH.A. me përfaqësuesit e punëmarrësve janë parashikuar rregullat e marrjes në punë të punonjësve, kontratat e punës, sigurimin e kushteve të nevojshme të punës për punëmarrësit, sigurimin dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, mënyrën dhe kohën e dhënies së pagës, shpërblimet e veçanta për rezultatet në punë, kohën e punës dhe të pushimit, masat disiplinore, si dhe mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve etj. Pra një rregullim ligjor ky, i kryer në përputhje me parashikimet e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës. Për*

më tepër referuar dispozitave ligjore të Kodit të Punës, konkretisht neni 11 “Përparësia e normave të së drejtës parashikohet se:1. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës rregullohen në mënyrë përparësie nga këto burime:a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë b) Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë c) Ky Kod dhe aktet e tij nënligjore d) Kontrata kolektive e punës e) Kontrata individuale e punës f) Rregullorja e brendshme g) Zakonet lokale dhe profesionale. 2. Aktet nënligjore dalin në plotësim dhe zbatim të dispozitave të parashikuara nga ky Kod. Ato mund të përcaktojnë kushte pune më pak të favorshme për punëmarrësit sesa ato të parashikuara nga ky Kod vetëm kur kjo parashikohet shprehimisht në këtë të fundit. 3. Çdo dispozitë që shkel një dispozitë të një shkalle më të lartë, është e pavlefshme. Megjithatë, janë të vlefshme vetëm ato dispozita që përmirësojnë pozitën e punëmarrësit. 4. Punëmarrësi nuk mund të heqë dorë nga të drejtat, që rrjedhin nga dispozitat urdhëruese të këtij Kodi ose të kontratave kolektive të punës. Janë të vlefshme marrëveshjet e bëra në praninë të inspektorit të punës ose në formën e parashikuar në kontratën kolektive të punës, që kanë si qëllim të mënjanojnë me pajtim një konflikt, duke bërë lëshime të dyanshme, të pranuar me vullnet të lirë nga të dyja palët. Marrëveshjet e sipërpërmendura nuk zbatohen për pushimet vjetore të paguara. 5. Zakonet profesionale zbatohen vetëm kur mungojnë dispozitat ligjore, parashikimet në marrëveshje, kontratë, si dhe kur dispozitat ligjore i referohen shprehimisht zakoneve profesionale. Pra jo pa qëllim ligjvënësi ka parashikuar në VKM nr.68/2018, ka referuar parashikimin për *ndryshimin e kufijve të pagës në natyrë*, me anë të kontratës kolektive, e cila është ndër burimet kryesore (vjen direkt pas Kodit të Punës) për rregullimin e të drejta dhe detyrime ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve. Po në këtë nen (neni 11, pika 3) parashikohet se “Çdo dispozitë që shkel një dispozitë të një shkalle më të lartë, është e pavlefshme. *Megjithatë, janë të vlefshme vetëm ato dispozita që përmirësojnë pozitën e punëmarrësit*” dhe pika 4 *Punëmarrësi nuk mund të heqë dorë nga të drejtat, që rrjedhin nga dispozitat urdhëruese të këtij Kodi ose të kontratave kolektive të punës*. Referuar parashikimeve të mësipërme, pagesa e përfituar në natyrë nga punonjësit e ALBPETROL SH.A. për një periudhë kohore mbi 10 vjet ka qenë në masën 500 lek në ditë, aplikimi i masës 300 lek në ditë për pagesën në natyrë ndaj punonjësve të ALBPETROL SH.A., do të cenonte përparësinë që ka kontrata kolektive e punës ndaj akteve të tjera, në rregullimin e marrëdhënieve punëdhënës-punëmarrës, por njëkohësisht do të sillte humbjen e një të drejtë të fituar prej vitesh nga ana e punëmarrësve në kundërshtim dhe në shkelje kjo me parashikimet e nenit 11 të Kodit të Punës. Për më tepër që në kontratën kolektive të nënshkruar në vitin 2019 palët sërisht kanë rënë dakord që masa e pagës në natyrë do të jetë 500 lekë për ditë pune, pra punëdhënësi dhe përfaqësuesit e punëmarrësve kanë respektuar detyrimin e vendosur në VKM 68/2018 duke vendosur kufirin e pagës në natyrë. Pra konstatimi i KLSH se punonjësit e ALBPETROL SH.A. kanë përfituar pagesën në natyrë në masën 500 lekë bje ndesh me VKM nr.68/2018 dhe për rrjedhojë ka sjellë efekt negative në buxhetin e Shoqërisë është një konstatim i gabuar dhe në kundërshtim me parashikimet ligjore të Kodit të Punës dhe të vetë VKM nr. 68/2018.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

9. Gjetje nga auditimi: Referuar situatës së krijuar të pandemisë COVID-19 procesi i ristrukturimit është pezulluar me Vendimin nr. 6, datë 29.04.2020, të Këshillit Mbikëqyrës

duke e shtyrë afatin e njoftimit deri në një vendim të dytë dhe sipas vendimit punonjësit të cilët preken nga procesi do të trajtohen me pagën e luftës.

Me shkresën nr. 1821 prot., datë 30.03.2020, Administratori i Shoqërisë E M ka hartuar një plan masash shtrënguese në kuadër të shpalljes së gjendjes emergjente për shkak të pandemisë së COVID-19. Me shkresën nr. 1821/1 prot., datë 01.04.2020, nga Administratori i Shoqërisë E M janë njoftuar Drejtoritë dhe qendrat e prodhimit në varësi të Shoqërisë “Albpetrol” Sh.a për zbatimin e planit të masave sipas përcaktimeve përkatëse.

Reduktimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore (brenda datës 06.04.2020), reduktimi i shpenzimeve për dieta dhe orët jashtë orarit (nga data 01.04.2020), aplikimi i lejes së zakonshme për vitin 2020 (brenda datës 03.04.2020), pezullimi i këshillave teknik dhe ndalimi i pagesave të tyre (duke filluar nga data 01.04.2020), shfuqizimi i dhënies së shtesave mbi pagë për komisionet e drejtoritë përkatëse (menjëherë), reduktimi i konsumit të karburantit të programuar për muajin prill (duke filluar nga data 01.04.2020), kryerjen e inventarit fizik të mallrave gjendje në magazinë (brenda datës 10.04.2020), etj.

-Punonjësit e Albpetrol sh.a kanë hapur padi ndaj shoqërisë dhe për periudhën objekt auditimi kanë fituar çështje gjyqësore si më poshtë:

-Pagat e fituara me vendime gjyqësore në vlerën **2,438,069 lekë**,

-Shpenzime gjyqësore në vlerën **658,520 lekë**,

-Tarifa e shërbimit përbarimor plus TVSH në vlerën **361,200 lekë**.

Sa më sipër për shkak të vendimeve të kundër ligjshme, dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar, vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe tarifa e shërbimit përbarimor plus TVSH rezulton në vlerën **1,019,720 lekë** dhe konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Për këtë rekomandimë: Këshilli Mbikëqyrës në bashkëpunim me Administratorin e shoqërisë Albpetrol sh.a, të analizojë situatën dhe të marrin masa për ndjekjen e rrugëve ligjore lidhur me arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **1,019,720 lekë** nga personat përgjegjës.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigjja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

10. Gjetje nga auditimi: Me vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021, administratori i shoqërisë ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil/benzine, ku tërheqja e kësaj sasive do të behej me tollona pranë magazinës së Albpetrol nga drejtoria e përfaqësimit dhe koordinimit me institucionet. Në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për 7 muaj të vitit 2021.

Me vendimin nr. 5132 datë 28.07.2021, administratori ka shfuqizuar vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021 duke përcaktuar si kuotë mujore, për këshillin mbikëqyrës sasinë prej 1000 litra/gazoil/benzinë, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për një muaj.

Me vendimin nr. 5256 prot., datë 03.08.2021, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për muaj të vitit 2021. Me vendimin nr. 2529 prot., datë 24.03.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 250 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 5256/1 prot., datë 04.06.2022, ka

miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 7911 prot., datë 31.10.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 1000 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës.

Të gjithë vendimet e sipërcituara baza ligjore e përdorur për dhënien e këtyre vendimeve nuk citon për miratimin e dhënies së kuotës mujore me karburant për llogari të Këshillit Mbikëqyrës. Gjithashtu nuk është përcaktuar arsyeja e dhënies së sasisë së karburantit për Këshillin Mbikëqyrës dhe si do të justifikohet nga ana e Këshillit konsumi i karburantit të dhënë. Nga auditimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura nga Sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës nuk konstatohet të jenë kryer mbledhje në selinë e Shoqërisë Albpetrol sh.a por të gjitha mbledhjet ku Këshilli ka marrë vendime për shoqërinë janë mbajtur në Tiranë.

Pra vendimet e administratorit për periudhën respektive të ushtrimit të funksionit brenda periudhës së auditimit. Për sa me lart, vlera e karburantit e përfituar nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës është në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi, dhe nuk është parashikuar në asnjë akt rregullator, të shoqërisë Albpetrol. Nga ana e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe anëtarëve të tij, nuk është mbajtur ose administruar pranë shoqërisë Albpetrol sh.a asnjë dokumentacion justifikues ligjorë mbi dokumentimin e konsumit të karburantit. Vlera prej 3,320,276 lekë do të konsiderohet shpenzim për të cilat mungon dokumentacioni justifikues ligjor dhe përbën dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol sh.a, dëm i cili duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit përfitues (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **3,320,276 lekë** nga personat përgjegjës.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigjja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

10.2 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të analizojë me kujdes vlerën **3,320,276 lekë** e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara për mos plotësimin me dokumentacion plotësues dhe justifikues të konsumit të karburantit nëpërmjet tollonave nga Këshilli Mbikëqyrës, si dhe marrjen e masave për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigjja e institucionit:

Me vendimin nr. 192, datë 04.04.2024, të Administratorit të Shoqërisë, është ndërprerë furnizimi i Këshillit Mbikëqyrës me karburant. Përsa i përket arkëtimit të vlerës **3,320,276 lekë** nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk është ndërmarrë asnjë hap administrativ apo ligjor për arkëtimin e kësaj vlere.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion ashtu sikundër edhe vet nga njësia specifikohet ... *Nga ana e Albpetrol sha nuk janë marrë masa për ndjekjen e procedurave ligjore për realizimin e rekomandimit.*

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë pagesave të administratës së shoqërisë Albpetrol sh.a për periudhën Maj-Shtator 2022, u konstatua se për këtë periudhë janë trajtuar me dieta z. K C, me detyrë ish-administrator i shoqërisë dhe L L, me detyrë ish-shofer i Administratorit.

Vlerat e përfituara padrejtësisht janë si më poshtë:

Muaji	Klejdi Cenmurati	Luftar Liko
Qershor	17,000 lekë	18,600 lekë
Korrik	20,000 lekë	26,200 lekë
Gusht	20,000 lekë	26,300 lekë
Shtator	20,000 lekë	22,800 lekë
Tetor	4,000 lekë	
TOTALI	81,000 lekë	93,900 lekë

Vlera prej 174,900 lekë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol sh.a, dëm i cili duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit përfitues (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marri masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **174,900 lekë** nga personat përgjegjës.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigjja e institucionit:

Pretendim i sjellë nga ana e Albpetrol përmes observacioneve të paraqitura me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024: ...Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 3502/3 prot, datë 09.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/2 prot, datë 13.08.2024 z. E. D. ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Nga Shoqëria Albpetrol sha është bërë njoftim për shlyerje vullnetare të detyrimit me shkresën nr. 160 prot., datë 10.01.2024.*

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e Albpetrol Sh.A (personat përgjegjës të nga ngarkuar) rezulton se, është ndërmarr nisma për kërkesë të shlyerjes vullnetare të detyrimit dhe më tej nuk ka asnjë gjurmë justifikuese të vijimit të zbatueshmërisë së rekomandimit. Mbajtur në konsideratë edhe se, periudha kohore nga nisja e kërkesës e deri në verifikimin e statusit të rekomandimit është e gjatë (nga 10.01.2024 në 03.07.2024) ndodhemi në kushtet e moszbatimit të rekomandimit nga ana e njësisë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***

12. Gjetje nga auditimi: Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar shpërblim për anëtarët e vet, në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit.

Punonjësit të cilët kanë përfutuar nga 1 pagë mujore të njëvleftshme me pagën e Administratorit të Albpetrol sh.a shpërblim janë:

Zj. E B për vlerën 226,100 lekë.

Zj. E M për vlerën 226,100 lekë.

Z. I Gj për vlerën 226,100 lekë.

Zj. L O për vlerën 226,100 lekë

Zj. R B për vlerën 226,100 lekë.

Për vlerën totale prej 1,130,500 lekë të përfituar nga Këshilli Mbikëqyrës në trajtën e shpërblimit financiar, nuk provohet plotësisht bazueshmëria ligjore e përfitimit të tij. Vlera prej 1,130,500 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht dëmi i shkaktuar nga secili është në vlerën 226,100 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,130,500 lekë** nga personat përgjegjës.

Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

14. Gjetje nga auditimi: Vendimi nr. 1796 prot., datë 12.03.2021 "*Mbi miratimin e pagesës së shpërblimit të disa punonjësve të Albpetrol sh.a*". Ky vendim është marrë pas propozimit me shkresën nr. 1795 prot., datë 12.03.2021 mbi këtë shpërblim nga ana e 3 Drejtorive, Prokurimeve, Organizative dhe Juridike.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë shpërblim janë:

Z. M B për vlerën 195,760 lekë,

Zj. A B për vlerën 140,000 lekë,

Zj. E V për vlerën 95,000 lekë,

Zj. B N për vlerën 95,000 lekë,

Zj. A D për vlerën 80,000 lekë

Zj. Xh H për vlerën 95,000 lekë.

Vlera prej 700,760 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 2 paga shpërblim janë: z. F M për vlerën 280,000 lekë, z. R C për vlerën 280,000 lekë, z. D H për vlerën 210,000 lekë, z. E B për vlerën 280,000 lekë, zj. E T për vlerën 230,000 lekë, z. S K për vlerën 380.000 lekë, zj. A H për vlerën 280,000 lekë, z. A L për vlerën 280,000 lekë, z. D F për vlerën 230,000 lekë dhe zj. O F për vlerën 230,000 lekë.

Vlera prej 2,680,000 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.

Vendimi nr. 3238 prot., datë 21.05.2021 "*Mbi miratimin e pagesës së shpërblimit të disa punonjësve të Albpetrol sh.a*".

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 2 paga shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1	M B	195,760
2	A B	140,000
3	E V	95,000
4	B N	95,000
5	A D	160,000
6	S S	230,000
7	A P	380,000
8	R C	0
9	D H	210,000
10	H Gj	280,000
11	E T	0
12	S K	0
13	A H	0
14	R P	280,000
15	O F	0
16	F S	230,000
17	Sh H	230,000
	TOTALI	2,525,760

Vlera prej 2,525,760 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.

Vendimi nr. 5129 prot., datë 27.07.2021 “Në kushtet e një pune intensive nga punonjësit e QEMNG Patos”.

Punonjësit të cilët kanë përfituar nga 1 pagë shpërblim janë si më poshtë:

	Punonjësit përfitues	Vlera e përfituar
1	H L I	80,000
2	D K	50,000
3	T S	50,000
4	A R r	50,000
5	P K	45,000
6	T Sh	50,000
7	G P	50,000
8	Y B	45,000
9	E M	45,000
	TOTALI	465,000

Vlera prej 465,000 lekë do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit e sipërcituar.

Vlera totale e përfituar padrejtësisht nga ana e punonjësve të shoqërisë Albpetrol sh.a është 6,371,520 lekë vlerë e cila do të konsiderohet dëm ekonomik për shoqërinë. Pasi personat përfitues nuk kanë kryer asnjë detyrë jashtë detyrave funksionale të tyre të mirpërcaktuara në rregulloren e shoqërisë (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **6,371,520 lekë** nga personat përgjegjës.

Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigjja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe i *pazbatuar*.

15. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 7605 prot., datë 06.10.2021, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për paradhënie për pjesëmarrjen në konferencën me temë Wage delivering for the energy challenge today and tomorrow” në Amsterdam. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë : znj. A H, z. I M, z. R C, z. S K, znj. R B. Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për 7 ditë qëndrimi, dy ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 400 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 48,640 lekë në total për 5 punonjësit. *Vlera prej 400 € do të konsiderohet si efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, me konkretisht nga secili është në vlerën 80€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 9,728 lekë.*

-Me shkresën nr. 831 prot., datë 27.01.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje në kurset e trajnimit Leadership & People Managment Skills dhe International Oil and Gas Exploitation Contracts” në Londër. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë: znj. A H , z. R C, z. D B, znj. A Z, z. I K dhe z. Y S. Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për periudhën 20-28.03.2022, katër ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 960 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 117,504 lekë në total për 6 punonjësit. *Vlera prej 960 € do të konsiderohet si efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht nga secili është në vlerën 160€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 19,584 lekë.*

-Me shkresën nr. 2054 prot., datë 04.03.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje në kursin e trajnimit Corrosion Control Oil and Gas Exploration Industry” në Londër. Punonjësit të cilët kanë marrë pjesë në këtë konferencë janë : z. E Dh, z. A Rr, z.S Ll, z. N B dhe znj. R B. Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit janë trajtuar me dietë për periudhën 05-12.06.2022, pesë ditë më tepër se urdhri i nxjerrë, veprim i cili bie në kundërshtim me vendimin e Administratorit, me specifikisht vlera e likuiduar më tepër është 1000 € ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 120,600 lekë në total për 5 punonjësit. *Vlera prej 1000 € do të konsiderohet si dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, shkaktuar nga punonjësit e sipërcituar, me konkretisht dëmi i shkaktuar nga secili është në vlerën 200€ ose konvertuar me kursin valutor të asaj periudhe është 24,120 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **286,744 lekë** nga personat përgjegjës.

Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe i *pazbatuar*.

16. Gjetje nga auditimi: Bazuar në e mailin e dërguar pranë Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure me datë 04.11.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje e punonjësve të shoqërisë Albpetrol sh.a, në takimin që do të zhvillohet me avokatët e studios ligjore Curtis, në kuadër të Arbitrazhit Ndërkombëtar kundër shoqërisë Bankers Petroleum Albania” në Milano, Itali, drejtuar Administratorit. Nga ana e Administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a është marrë vendimi me nr. 8219 prot., datë 10.11.2022 për marrjen pjesë në këtë takim, në emailin e dërguar nga studio ligjore C specifikohet se punonjësit që janë ftuar për të marrë pjesë janë z. I K, z. J S dhe znj. A Z. Punonjësit do të qëndrojnë nga data 29.11.2022 deri me 03.12.2022.

Nga auditimi i kësaj praktike rezulton se punonjësit të cilët kanë udhëtuar për në Milano janë: z. A B, z. I K, z. J S dhe znj. A Z, znj. A H, dhe znj. R B.

Për punonjësit z. A B, znj. A H dhe znj. R B, pjesëmarrja në këtë takim nuk është e justifikuar pasi jo vetëm që nuk kanë qenë të ftuar në këtë takim por as nuk kanë qenë pjesë përbërëse e grupit i cili është marrë me këtë proces për të cilin është zhvilluar takimi, nuk arsyetohet nga ana e Administratorit të shoqërisë arsyeja e marrjes pjesë në këtë takim. Për këto arsye udhëtimi i kryer nga këto punonjës ka renduar buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a duke i shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 96,726 lekë.

Nga auditimi i të gjithë praktikave të udhëtimeve jashtë vendit nuk vërtetohet nëse është paguar tarifa e regjistrimit në konferenca, nuk vërtetohet pjesëmarrja nga ana dokumentare dhe nuk vërtetohet nëse këta punonjës janë trajtuar financiarisht nga bonuset e trajnimit siç është specifikuar në vendimin e Administratorit, ku janë ngarkuar për dokumentimin e plotë të praktikës me kompanitë koncensionare Drejtoria e Marrëveshjeve, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Kabinetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 56-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **96,726 lekë** nga personat përgjegjës.

Të merren masa urgjente për korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe i *pazbatuar*.

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në marrëdhëniet tregtare me kontraktorin “B P”, u konstatuan shkelje të menaxhimit financiar.

Me shkresën Nr.10826 prot. datë 31.12.2021, nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ku është kërkuar lëshim Urdhër

Ekzekutimi për faturat dhe pas lëshimit të Urdhrit të Ekzekutimit, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit i është drejtuar Zyres së Përbarimit Privat “E G” shpk për vënien në ekzekutim të titujve ekzekutiv Fatura Tatimore Shitje.

Midis Zyres së Përbarimit “E G” shpk përfaqësuar nga përbaruesi gjyqësor z. E M dhe shoqërisë “Albeptrol” sh.a. përfaqësuar nga Administratori z. F M, është lidhur Kontrata e Shërbimit Nr.1113 prot. datë 04.02.2022 dhe Nr.27 prot. datë 04.02.2022, e cila është likuaduar në datë 09.02.2022 në shumën 14,613,456 lekë.

Nga auditimi i kartelës financiare dhe ditarit të bankës në Drejtorinë e Financës u konstatua se faturat me nr.08, datë 17.02.2021, fatura nr.38, datë 23.03.2021, fatura nr.108 dhe nr.109, datë 17.05.2021 janë likuaduar plotësisht nga kompania “B P”.

-Nga Drejtoria e Financës nuk është kthyer përgjigje shkresore nëpërmjet arkivës, shkresës Nr.9401, datë 23.11.2021 “Kërkesë për dokumentacion” të DÇLP, si dhe nuk ka akt rakordimi për detyrimet e ndërsjella me kompaninë “B P”, ku të pasqyrohet shuma e detyrimit e dokumentuar me dokumente justifikues.

Shkeljet e konstatuara në menaxhimin financiar janë:

Drejtorja e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit ka kryer veprime mbështetur në vlerën e saldos totale 948,890,551 lekë, të një shkresë të marrë nga Drejtoria e Financës për një kontraktor tjetër, dhe ka kryer veprime për nxjerrje titull ekzekutiv pa pasur një aprovim nga kjo drejtori. Ndërkohë që drejtorit i Drejtorisë së Financës A B, sipas sektorit të protokollit, kjo shkresë i është dërguar në email sipas praktikave të aprovuara. Emailin e datës 23.11.2021, drejtori i DF A B, ja ka dërguar specialistes së financës së administratës për nxjerrjen e kartelës financiare të kontraktorit deri më 30.09.2021, si dhe specialistes së Qendrës së Furnizimit dhe Shërbimit Elektrik, për të dërguar faturat që kishin diskutuar në telefon tek DÇLP.

Në shkresën nr. 527 Prot., datë 24.11.2021, drejtori i QFSHE, ka miratuar shkresën e specialistes për faturat dhe i ka dërguar Drejtorisë së Financës kopjet origjinale të faturave për muajt janar, shkurt e prill 2021. Në shkresë është cituar se pas aprovimit nga Drejtoria e Financës, faturat ti përcillen DÇLP. Në observacionin e z. R Ç kjo shkresë bashkë ciklimin e Drejtorit të Departamentit, dhe citimin se faturat janë origjinale dhe për tu përdorur për procedurat gjyqësore, pretendohet se provojnë se faturat ishin aprovuar nga Drejtoria e Financës dhe se nuk mban përgjegjësi për veprimet e mëtejshme por shkresa e QFSHE i ishte drejtuar Drejtorisë së Financës dhe i kërkonte atyre verifikimin e faturave. Nga Drejtoria e Financës nuk ka pasur aprovim shkresor për faturat e cipërcituara. E pyetur për këtë çështje znj. A B me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës ka deklaruar se i ka dërguar dorazi Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit kartelën financiare të kompanisë “B P”, por nuk i ka dërguar faturat tatimore të shitjes”.

Gjykimi i grupit të auditimit është se Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, drejtori i Drejtorisë së Financës dhe ish-administratori i shoqërisë me veprime ose mosveprime kanë sjellë në dëmin ekonomik nga shoqërisë Albpetrol sh.a në vlerën 14,613,456 lekë me TVSh.

Së pari, ish drejtori i DÇLP z. R Ç dhe kryespecialista zj. A Ll, kanë kërkuar në shkresën Nr. 9401 prot. datë 23.11.2021, një database ku të jenë të listuara faturat me numër dhe datë, për të cilat do të kërkohen librat e blerjes së deklaruar nga shoqëria, fatura tatimore shitjeje, të cilat duhet të jenë të nënshkruara rregullisht nga të dyja palët dhe të dorëzohen me procesverbal në origjinal pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, ditarin/kartelën financiare/akt rakordimin e klientit, që është mbajtur nga kreditori dhe provon rakordimit midis palëve si dhe masën e detyrimit që përbën titull ekzekutiv.

Nga këto dokumente të kërkuara Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit, ka pasur katër fatura dhe një saldo totale të detyrimit, si dhe nga specialistja e financës i është dorëzuar dhe kartela financiare. Nga shqyrtimi i kartelës financiare konstatohet se katër faturat (nr. 8, 38, 108 e 109) që janë bërë objekt i veprimeve gjyqësore janë likuiduar të gjitha deri më datë

16.07.2021, dhe të regjistruara në sistemin e kontabilitetit të shoqërisë. Z. R Ç dhe znj. A Ll mund të bënin verifikimet në kartelë se faturat tatimore ishin likuiduar.

Së dyti, drejtori i Drejtorisë së Financës, për çështje si likuidimin nga klientët ku është përgjegjës direkt, kërkesës së DÇLP për detyrimet e kontraktorit duhet ti përgjigjej me përgjegjshmëri, qartësi dhe saktësi. Gjendja debitoare në një datë të caktuar nuk jep informacion të plotë dhe të saktë por nga kjo drejtori duhet të plotësojë një informacion i qartë shkresor me faturat e palikuiduara shoqëruar me detajet si dhe kamatëvonesat përkatëse të llogaritura. Drejtori i Drejtorisë së Financës A B në momentin e pagesës së shumës 14,613,456 lekë me TVSh duhet të bënte verifikimet nëse ekzistonin kushtet për pagesën e tarifës dhe nëse faturat ishin të likuiduara ose të palikuiduara.

Së treti, ish administratori në momentet që ka urdhëruar procedurat gjyqësore si dhe ka firmosur në lidhjen e kontratës me përmbaruesin gjyqësor duhet të sigurojë me nëpunësen zbatuese për vërtetësinë e shkresave që firmoste.

Nga shoqëria Albpetrol sh.a është likuiduar në llogarinë bankare të Zyrës së Përmbarimit “E G” shpk shuma 14,613,456 lekë me TVSH në datën 09.02.2022, sipas Kontratës së Shërbimit Nr.1113 prot. datë 04.02.2022 dhe Nr.27 prot. datë 04.02.2022, e lidhur midis Zyrës së Përmbarimit “E G” shpk. dhe shoqëria “Albpetrol” sh.a.. Ky likuidim është kryer nga Drejtoria e Financës pa u verifikuar shlyerja e faturave tatimore të shitjes për të cilat ka dalë urdhri ekzekutiv dhe është në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12 , pika 3 germa “e” ku citohet: “Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: “pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi”.

Në kushtet e pagesës së kontratës nuk janë përcaktuar pjesë si pagesa pas mbledhjes së detyrimit siç është bërë në kontrata të tjera, por është përcaktuar pagesë vetëm me paraqitjen e faturës tatimore nga ana zyrës përmbarimor.

Nga veprime e mosveprimet e ish drejtorit të DÇLP R Ç dhe kryespecialistes A Ll, drejtorit të DF Arta Beshaj dhe ish administratorit Florian Muçaj shoqërisë Albpetrol sh.a i është krijuar një dëm ekonomik prej **14,613,456 lekë**.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10 296, datë 08/07/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me Rregulloren e Brendshme të shoqërisë e miratuar me Vendimin Nr.20, datë 03.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës neni 64, paragrafi I Sektori i Financës, pika 37 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandimi: Nga Albpetrol sh.a, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **14,613,456 lekë, nga R Ç, A Ll, A B dhe F M.**

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigjja e institucionit:

Nga ana e ALBPETROL SH.A. është depozituar Kallezimi Penal për dëmin e shkaktuar në masën **14,613,456 lekë** pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, me Nr. 6560 Prot, dt. 09.09.2022, ku palë e paditur janë z. R Ç dhe znj. A Ll.

Komenti i grupit të auditimit:

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit është rekomanduar arkëtimi i vlerës nga punonjësit **R Ç, A Ll, A B dhe F M** të cilët nga veprimet dhe mosveprimet i kanë krijuar shoqërisë Albpetrol sha një dëm ekonomik prej 14,613,456 lekë. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se shoqëria Albpetrol sha i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier vetëm për dy punonjës duke mos përfshirë të gjithë punonjësit përgjegjës për dëmin e shkaktuar.

Statusi i zbatimit të këtij rekomandimi ngelet të vlerësohet në auditimin e rradhës dhe pas nxjerrjes së vendimit nga ana e instancave ligjore.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

18. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës 2021-2022, kompania B P nuk ka kryer pagesat për energjinë elektrike. Për këto mospagesa Albpetrol sh.a Patos ka maturuar penaltete e kamatëvonesa. Gjatë vitit 2022 Albpetrol ka ndërmarrë veprime administrative duke marrë vendime gjykate si tituj ekzekutiv për faturat e papaguara. Gjithashtu është marrë si titull ekzekutiv dhe një faturë penaltitësh për mospagesat e faturave të energjisë elektrike. Llogaritja e kamatëvonesave është kryer sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”. Llogaritja bazuar në këtë ligj është më e vogël se kamatëvonesa që ka aplikuar OSHEE për faturat e papaguara nga Albpetrol sh.a Patos Vlera e kamatëvonesës së aplikuar nga OSHEE me atë që ka llogaritur Drejtoria Ekonomike e Albpetrol sh.a Patos, përbën dëm ekonomik për shoqërinë. OSHEE sh.a. ka bërë një akt-rakordimi për detyrimet që ka Albpetrol sh.a Patos, për principalin dhe kamatë vonesat.

Ligji Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Neni 19, Përgjegjësitë e ERE-s, citon se është *ERE* që miraton dhe publikon, në përputhje me parimin e transparencës, metodologjitë e llogaritjes së tarifave të transmetimit, shpërndarjes, si dhe metodologjitë e tjera të aplikueshme si dhe kontratat mes palëve si dhe kamatëvonesat e aplikuar për çdo ditë vonesë.

Shoqëria Albpetrol sh.a nuk ka pasqyruar në marrëdhëniet me shoqëritë koncesionare të gjitha detyrimet që i lindin nga kontratat që ka me Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Albpetrol sh.a ka kërkuar kamatëvonesa për pagesat me vonesë të B P në vlerën 175,458,324 lekë, kur detyrimi që Albpetrol ka ndaj FSHU sha, për kontratat përkatëse për kamatëvonesa është 1,356,345,939 lekë. **Vlera 1,180,887,615** përbën shpenzime jo të justifikuara nga Albpetrol sh.a (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 233-252, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandimi: Nga Albpetrol sh.a, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **1,180,887,615 lekë** nga shoqëria B P.

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigjja e institucionit:

Referuar Rekomandimit të KLSH, është njoftuar Administratori në Memo dt. 14.09.2023 dhe me dt. 26.09.2023 me nr. 7496/ 7468 dhe 7467 Prot janë nisur njoftimet për debitoret. Jane depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Kërkesa për Ekzekutimin e Kamatë Vonesave.

Komenti i grupit të auditimit:

Nuk u vendosën në dispozicion kërkesat e paraqitura në Gjykatë.

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, por citimit nga ana e Albpetrol Sh. A (personat përgjegjës të ngarkuar) të shkresave të nisjes së njoftimeve nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

19. Gjetje nga auditimi: - Në auditimin e lëvizjeve të produktit natë bruto u konstatuan parregullsi në mes gjendjes fizike dhe kontabël. Më datë 05.01.2022, Dega e Doganës Fier me shkresën nr. 5087/3, i ka dërguar Albpetrol njoftimin e proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative. Si rezultat i verifikimit në vend të magazinave fiskale u

konstatuan mangësi të pajustificuara mes gjendjes fizike dhe gjendjes kontabël në sistem. Referuar nenit 90 dhe 90/12 të Ligjit nr. 61/2012, “Për Akcizat në RSH”, i ndryshuar, për mangësitë e konstatuar e cila tejkalon 2% firot e krahasuar me regjistrat kontabël, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me trefishin e detyrimeve të akcizës së munguar. Sasia e gjetur në mungesë është 1,486,742 kg. Detyrimi i papaguar është në vlerën 37,168,557 lekë plus penalitetet në vlerën 111,505,672 lekë, në total **148,674,230 lekë**.

-Albpetrol sh.a Patos, më datë 03.03.2022 ka lidhur me shoqërinë A shpk, kontratën me objekt “Riparim pjesor dhe pastrim i mbetjeve të RVM 5000/8 m3 në stacionin e shitjes së naftës në Zharrëz. Grupi i punës nga Albpetrol për përgatitjen e depozitës i përbërë nga D H, A Z, E C dhe A D, në relacionin me nr. 428 prot., datë 13.05.2022, pas procedurës së hapjes për efekt pastrimi, kanë kryer operacionet si largim uji dhe mbetje inerte ranore, është zhvendosur masa volumore e rezervuarit prej 311.1 ton, në gropën ekologjike pranë stacionit Zharrëz. Në këtë masë pas analizave kanë rezultuar 24.33 ton ujë i lirë, 53.62 ton ujë i lidhur, 145.1 ton mbeturina mekanike dhe 88.04 ton naftë. Kjo sasi naftë është propozuar për tu ulur nga bilanci i muajit prill 2022. Sasinë prej 311.1 ton që Albpetrol sh.a e ka hedhur si mbetje e ka pasur në bilancin e naftës si produkt gjendje. Grupi i inxhinierëve sa më sipër ka dhënë argumente lidhur me naftën që vjen në depozitë jo me standardet e përcaktuara.

Lidhur procesin e pastrimit të depozitës nga Albpetrol sh.a, i është dërguar një shkresë Doganës Fier, por në procesin e hapjes së depozitës si dhe në hedhjen e mbetjeve ranore në gropën ekologjike nuk ishte prezent asnjë përfaqësues i Doganës apo inspektor i Tatimeve për të certifikuar heqjen nga produkti i gatshëm naftë sasinë prej 311.1 ton.

Vlera e naftës 311.1 ton është 17,923,404 lekë. Gjoha nga organet tatimore është në vlerën 100% plus dhe 15%, 2,688,510 lekë, pra në total 20,611,914 lekë.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me pikën 3.6 të Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar VKM Nr. 612, datë 2.9.2012 i ndryshuar, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat” Neni 23, Mangësitë/diferencat Neni 25, Humbjet aksidentale dhe avaritë në magazinën fiskale 1. Si parim, depozituesit e miratuar duhet të paguajnë detyrimet për sasi të humbura aksidentalisht apo nga avaritë në magazinat fiskale Neni 101 Punimet dhe ndërhyrjet për riparime në depozita .

Nga mosveprimet e shoqërisë Albpetrol sh.a janë evidentuar efekte ekonomike negative me dëm në vlerën 20,611,914 lekë dhe shpenzime jo të justifikuara në vlerën **148,674,230 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 233-252 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa për të analizuar rastet kur nuk janë marrë masat për lajmërimet e detyrueshme të institucioneve doganore dhe tatimore, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për gjohat relative, si dhe marrjen e masave që në të ardhmen nëpunësi autorizues të identifikojë detyrimet doganore e fiskale të shoqërisë, dhe ndjekjen me përgjegjësi dhe profesionalitet nga personat përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Ne zbatim të rekomandimit të mesiperm, vihen në dispozicion materialet shkresore nr. 2129 Prot “Mbi kryerjen e punimeve për riparimin dhe pastrimin e mbetjeve në RVM 5000/8 Magazina Fiskale Zharrëz, dhe shkresa me nr. 5615 “Mbi përfundimin e punimeve për riparimin e mbetjeve në RVM 5000/8 Magazina fiskale Zharrëz.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

20. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit konstatohet se në pesë raste punonjësit (në pozicione drejtuese) janë shkarkuar nga detyra me urdhër Administratori. Këta punonjës kanë ngritur padi dhe kanë nisur procese gjyqësore kundër Albpetrol sh.a, duke detyruar shoqërinë të paguajë *dëmshpërblim* ndaj tyre në vlerën **11,977,746 lekë**, si dhe *shpenzime gjyqësore dhe tarifë përmbarimi*, me urdhër sekuestro në vlerën **1,887,270 lekë**.

Këta punonjës janë ripunësuar në Albpetrol sh.a (në pozicione drejtuese), përgjithësisht gjatë proceseve gjyqësore. Në asnjë rast nuk ka qenë objekt padie rikthimi i tyre në punë.

-Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, nga ku janë humbur 25 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, si dhe janë humbur e janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë.

-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet **42,600,758 lekë**, nga ku shpenzimet përmbarimore rezultojnë **3,931,821 lekë** dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën **2,146,912 lekë**.

-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet **61,851,420 lekë**, nga ku shpenzimet përmbarimore rezultojnë **6,272,200 lekë** dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën **2,172,200 lekë**.

Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **104,452,178 lekë** e cila konsiderohet *efektit financiar negativ* për buxhetin e shoqërisë.

Vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe vlera shpenzimeve përmbarimore lidhur me ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatave dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar për çdo rast, duke rezultuar në pagesë të këtyre vlerave me urdhër sekuestro bankare, prej **14,486,894 lekë** konsiderohet *dëm ekonomik* në buxhetin e shoqërisë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015, neni 155, pika 3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 233-252 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

20.1. Rekomandim: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të analizohet dëmi ekonomik në vlerën **14,486,894 lekë**, dhe të marrë masa të menjëhershme për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore lidhur me dëmin ekonomik .

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pazbatuar*.

21. Gjetje nga auditimi: Lidhur me “Detyrimin për tatimin mbi të ardhurat personale” dhe “Kontributin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, rezulton se për periudhën objekt auditimi janë paguar gjoba dhe interesa për pagesa të vonuara në vlerën **726,099 lekë**, vlerë kjo që konsiderohet *dëm ekonomik* në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos

Afatet e deklarimit dhe pagesës se kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës.

Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Mos likuidimi sipas afateve ligjore të detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ka sjellë pasojë dem ekonomik në vlerën **726,099 lekë** (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 233-252 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandim: Nga Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria e Financës të merren të analizohet situata dhe të ndiqen të gjitha procedurat lidhur me dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën **726,099 lekë**.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e institucionit:

Sqaruar dhe analizuar situata, si dhe konkluduar qe likuidimi me vonese ka ardhur si pasoje e mungeses se likuiditeteve.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pazbatuar***.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE, SI DHE MUNGESË TË ARDHURASH.

Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kaluar të lëna me Vendim nr. 76 datë 18.05.2022 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, statusi i zbatimit të së cilave është si më poshtë vijonë

-Rekomandimet për 14 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, respektivisht:

2.1.Rekomandim: Administratori i Shoqërisë Albpetrol ShA dhe Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe Drejtoria Juridike, të kërkojnë me të gjitha rrugët e mundshme ligjore shlyerjen e detyrimit prej 6,247.809 ton/naftë në vlerën 199,929,888 lekë nga kontraktori “T O” ShA

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe i ***pazbatuar***.

3.1.Rekomandim: Nga Administratori i Albpetrol ShA dhe drejtoritë përkatëse sipas natyrës ku do të përdoret aktivi, të merren masa për vënien në përdorim të aktiveve të blera dhe të pa përdorura, sipas destinacionit të përcaktuar në momentin e hartimit të kërkesave për blerje. Të nxirren përgjegjësitë për persona konkretë për mos vendosjen në eficientë deri tani të këtyre

aktiveve, si dhe nëse ka aktive të cilat nuk kanë mundësi përdorimi për shkak të blerjeve të pa nevojshme.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

3.2.Rekomandim: Në rastet hartimit të kërkesave për blerjeve të aktiveve, nga kërkuesi i mallit të argumentohet saktë nevoja e blerjes, ndërsa nga drejtimi i shoqërisë, përpara miratimit të kërkesave, të analizohen këto kërkesa nëse janë në përputhje të plotë me nevojat reale të shoqërisë Albetrol ShA. Çdo kërkesë për blerje malli të shoqërohet me situatën e gjendjes së magazinës për këtë mall.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

5.1.Rekomandim: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Albpetroli ShA të marrin të gjitha masat për kryerjen e pagesës prej **92,254,000 lekë** ndaj ortakut të vetëm, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

6.1.Rekomandim: Administratori i Albpetroli ShA në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për monitorimin e marrëveshjeve me kontraktorin, duhet t'i kërkojnë B P zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure, në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure, në vlerën **3,232,161 USD** të konstatuar për vitin 2018 dhe **3,605,196.79 USD** të konstatuar për vitin 2019.

Administratori të ngrejë një grup pune dhe të marrë masa për reflektimin e situatës së detyrimeve reale të BPAL ku të përfshihet edhe situata e ri llogaritjes së faktorit R dhe detyrimit prej **57,541,649 USD**.

Menjëherë

Pretendimet e subjektit të audituar:

Pretendim i sjellë nga ana e Albpetroli përmes observacioneve të paraqitura me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024: ...Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 3502/3 prot, datë 09.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/2 prot, datë 13.08.2024 z. E. D. ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Ju bëjmë me dije se i vetmi mekanizëm që parashikon çdo marrëveshje hidrokarbure për të verifikuar dhe kontrolluar nivelin e Faktorit R është auditimi. Në nenin 25 auditet të çdo marrëveshje hidrokarbure parashikohet procedura e auditimit, duke*

përcaktuar një periudhë prej 12+3 muajsh nga data e marrjes së çdo deklarate të llogarisë kosto për të ushtruar auditimin dhe për të ngritur objeksionet. Objeksionet i dërgohen secilit kontraktor në formën e listës së pretendimeve duke evidentuar të gjitha shpenzimet të cilat nuk janë kualifikuar si kosto hidrokarbure dhe që konsiderohen si kosto të parikuperueshme. Gjithashtu, theksojmë se me shoqërinë "B P" Ltd., kemi qënë në proces arbitrazhi ku një ndër çështjet kryesore ishin dhe auditet e zhvilluara nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a. Për këtë arsye është pritur vendimi i Tribunalit për veprime të mëtejshme. Theksojmë se në datë 18.06.2024, Gjykata Ndërkombëtare njoftoj palët lidhur me vendimin final në çështjen kundër shoqërisë BPAL në të cilat tribunali pranoi pretendimet e Albpetrol në lidhje me mosnjohjen si kosto hidrokarbure të disa shpenzimeve të kryera nga BP. Me zbardhjen e vendimit të Arbitrazhit shoqëria Albpetrol sh.a do të marrë të gjitha masat për zbritjen e të gjitha kostove hidrokarbure që janë pranuar nga Tribunali dhe do të bëhet rillogaritja e faktorit R.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

7.1.Rekomandim: *Administratori i shoqërisë Albpetrol ShA të marrë masa për tërheqjen e sasisë 59,599.264 ton naftë bruto, për llogari të prodhimit para-ekzistues (PPE) dhe të pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31.12.2020, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit, të përcaktoj sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure, ose të kërkojë vlerën ekuivalente të saj prej 18,580,070 USD (59,599.264 ton * 311.75 USD/ton) nga kontraktori, sipas kuadrit ligjor dhe mbështetur në dokumentacion justifikues. Kjo vlerë është llogaritur me çmimin mesatar të vitit 2019 si vit i pa ndikuar nga pandemia por që çmimi duhet rillogaritur nga një grup pune i Albpetrol ShA mbështetur në dokumentacionin e marrë nga kontraktori.*

Menjëherë

Pretendimet e subjektit të audituar:

Pretendim i sjellë nga ana e Albpetrol përmes observacioneve të paraqitura me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024: ... Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 3502/3 prot, datë 09.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/2 prot, datë 13.08.2024 z. E. D. ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: Shoqëria Albpetrol sh.a dërgon në mënyrë periodike çdo tremujor kalendarik njoftime shoqërisë BP në lidhje me detyrimet të prapambetura në naftë bruto dhe/ose gaz natyror për llogari të Prodhimit para-ekzistues dhe pjesës së prodhimit të Albpetrol. Shkresat e fundit që i janë dërguar shoqërisë BP në lidhje me shlyerjen e detyrimeve në naftë bruto janë shkresat nr. 6308 prot., datë 20.07.2023, nr. 7897 prot., datë 18.10.2023, nr. 868 prot., datë 07.02.2023, nr. 2607 prot., datë 08.05.2024 dhe nr. 4338 prot., datë 18.07.2024. gjithashtu Albpetrol sh.a ka dërguar edhe shkresën nr. 6429 prot., datë 27.07.2023 në të cilën kërkojmë nga kontraktori BP një plan lëvrimit ku përveç detyrimit mujor të përfshijnë edhe një pjesë të detyrimit të prapambetur. Gjithashtu theksojmë se, një pjesë e këtij detyrimi ka qënë pjesë e procesit të arbitrazhit.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar evidencave të sjella përmes observacioneve me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024 rezulton se, nga ana

e Albpetrol Sh.A është ndërmarr nisma dhe janë nisur disa shkresa (*shkresat nr. 6308 prot., datë 20.07.2023, nr. 7897 prot., datë 18.10.2023, nr. 868 prot., datë 07.02.2023, nr. 2607 prot., datë 08.05.2024 dhe nr. 4338 prot., datë 18.07.2024. gjithashtu Albpetrol sh.a ka dërguar edhe shkresën nr. 6429 prot., datë 27.07.2023 në të cilën kërkojmë nga kontraktori BPAL një plan lëvrimi*) por nuk ka asnjë masë konkrete të ndërmarr referuar dhe afatit të zbatimit (i cili ka qenë menjëherë) dhe ngelet për tu verifikuar në auditimin e radhës statusi i zbatueshmërisë së rekomandimit

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

7.2.Rekomandim: Nga Administratori i Albpetrol ShA të marre masa për arkëtimin e vlerës **21,354,950 lekë** nga kontraktori “A G” ShA dhe vlerës **420,277 lekë** nga kontraktori F P ShA, si dhe të lidh marrëveshje/kontrata me kontraktorët subjekt të blerjes se energjisë elektrike, duke përcaktuar te drejtat dhe detyrimet e palëve dhe duke parashikuar dhe aplikuar kamatë vonesa për faturat e energjisë elektrike të pa likuiduara.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

8.1.Rekomandim: Administratori të marre masa për kryerjen e pagesës së energjisë elektrike në shumën **1,099,475,784 lekë** nga Kontraktori BP, si dhe lidh marrëveshje/kontratë me kontraktorët subjekt të blerjes se energjisë elektrike, duke përcaktuar te drejtat dhe detyrimet e palëve dhe duke parashikuar dhe aplikuar kamatë vonesa për faturat e energjisë elektrike të pa likuiduara.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

8.2.Rekomandim: Referuar problematikave të dala gjatë auditimit në lidhje me detyrimet e kontraktorëve të marrëveshjeve hidrokarbure për pagesën energjisë elektrike, detyrimet e akumuluarra të Albpetrol ndaj OSHEE dhe kamat vonesat për energjinë elektrike, i rekomandojmë MIE kalimin e asetëve për transmetimin e energjisë elektrike nga Albpetrol ShA, në pronësi të së cilit janë aktualisht, tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, si dhe lidhjen e kontratave të shërbimit të energjisë elektrike me Furnizuesin e Shërbimit Universal ShA.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

9.1.Rekomandim: Administratori dhe Drejtoria e Marrëveshje Hidrokarbure të marrin masa për ngritjen e një grupi pune, analizimin e situatës dhe kërkimin e dokumentacioneve përkatëse

nga shoqëria "A G" ShA me qëllim verifikim e shumës 1,132,595 USD. Në rast se vlera është e mbështetur në dokumentacion justifikues, të kërkohet arkëtimi i saj, si një e ardhur e munguar për shoqërinë Albpetrol ShA.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

10.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA dhe Drejtoria Juridike të negociojë dhe të vërë në kushte ligjore kontratën e furnizimit me gaz për kontraktorin "AG" ShA, duke vendosur çmimin e shitjes 50 lekë për N/m³, sipas përcaktimit të këtij çmimi të shitjes në programin ekonomik të Albpetrol Sha, duke eliminuar të ardhurat e munguara të cilat për periudhën objekt auditimi janë 5,208,333 lekë.

Albpetrol është në proces gjyqësor me subjektin dhe ndiqet ceshtja në Gjykatën e Shkalles së Pare të Juridiksionit të Pergjithshëm Fier (bashkëngjitur deklarata e mbrojtjes)

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

Menjëherë

11.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA dhe Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure, të marrin të gjitha masat e duhura ligjore me qëllim që kontraktori "A G" ShA dhe "F P ShA të bëjë respektivisht derdhjen e shumës 20,000 USD dhe 10,000 USD për trajnimin e stafit me qëllim rritjen e aftësisë profesionale të tyre.

Menjëherë

Pretendimet e subjektit të audituar:

Pretendim i sjellë nga ana e Albpetrol përmes observacioneve të paraqitura me shkresën nr.3502/5 prot., datë 10.10.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.792/15 datë 14.10.2024: ... Për sa më sipër është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 02.08.2024 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 3502/3 prot, datë 09.08.2024, administruar në KLSH me nr. 792/2 prot, datë 13.08.2024 z. E D ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht: *Sqarojmë se bonusi i trajnimit vjetor nuk arkëtohet nga Albpetrol por shpenzohet nga Kontraktori në bazë të faturave që lëshojnë subjekte të treta të cilat ofrojnë trajtimet e personelit të Albpetrol nëse dhe për sa kërkohet nga ky i fundit brenda vleres maksimale prej 20 mijë USD dhe 10 mijë USD të llogaritur për çdo vit kontraktual dhe që akumulohet në rast se nuk shpenzohet.*

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

12.1.Rekomandimi: Nga Albpetrol ShA të ndërpriten praktikat e natyrës së shpenzimeve të cilat nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe jashtë natyrës së aktivitetit të shoqërisë.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

13.1.Rekomandim: Nga Administratori i shoqërisë të merren masa që në rastet e sigurimit të punonjësve për vendet e punës që kanë risk të lartë, specifikimet teknike dhe kontrata të parashikojnë që sigurimi mbulon punonjësën si dhe vendin e punës, pavarësisht emrit të punonjësit në rastet kur punonjësi aktual zëvendësohet me një tjetër.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

13.2. Rekomandim: Për vendet e punës bosh në momentin e zhvillimit të tenderit, në specifikime teknike dhe në kontratë të përcaktohet se pavarësisht se këto vende janë përfshirë në fondin limit, pagesa për sigurim do të bëhet vetëm për atë periudhë që këto vende do të jenë të plotësuara konkretisht me punonjës dhe nuk do të kryhet pagesë për periudhën kur vendi është bosh.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

14.1. Rekomandim: Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Programimit të merren masat e duhura që në të ardhmen të respektohet numri i fuqisë punëtore në punë në përputhje me strukturën e miratuar dhe legjislacionin në fuqi, me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

Menjëherë

15.1.Rekomandim: Administratori i Albpetrol ShA, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna, me qëllim uljen e efekteve

negative financiare në buxhet. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga institucioni të zbatohen të gjitha procedurat e duhura ligjore që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

16.1. Rekomandim: *Nga organet drejtuese të shoqërisë Albpetrol ShA të merren masat e duhura për përditësimin e kontratës së punës me legjislacionin në fuqi. Pagesa e dietës ushqimore të vijojë sipas vlerën 300 lekë për ditë pune dhe jo 500 lekë për ditë pune.*

Menjëherë

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i papranuar*** nga subjekti.

C.1 MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCËS DHE EFEKTIVITETIT

Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kaluar të lëna me Vendimin nr.133 datë 28.07.2023 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, statusi i zbatimit të së cilave është si më poshtë vijonë:

1. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i dokumentacionit në dosjet e procedurave dhe sistemin SPE, rezulton se në **3** procedurave OE e shpallur fitues nga KVO nuk janë në kushtet e plotësisimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK. Gjithashtu gjatë auditimit të këtyre procedurave është konstatuar fakti se disa nga mangësitë e evidentuara në mos plotësimin e kriterëve nga OE të shpallur fitues, KVO i ka përdorur si element skualifikues në OE e skualifikuar por me ofertë ekonomike më të leverdishme se OE e shpallur fitues (qëndrim me dy standarte), veprime me efekt financiar negativ në vlerën **10,364,872 lekë** (diferenca midis dy OE), *respektivisht:*

a- Procedura me objekt “Blerje goma automjetesh”, me fond limit 12,815,800 lekë për vitin 2022, ku fitues është shpallur shoqëria “S” shpk me ofertë 12,402,000 lekë pa TVSH, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, *konkretisht:*

Nuk përmbushet kriteri i përcaktuar ne DST, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik” nen pika 2.3.1, ku përcaktohet se: “Furnizime te mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës” pasi faturat e paraqitura dhe dokumentacioni per te vërtetuar furnizime te ngjashme është ne nje vlere me te vogël se 40 % e fondit limit, pasi sipas dokumentacionit të paraqitur paraqet një xhiro prej 5,525,260 lekë nga vlera 6,151,584 lekë që duhet të paraqisje. Nga të dhënat e kontratave/faturave të ngjashme, rezulton se jo të gjitha faturat/kontrat kanë shitje gomash, pasi kanë dhe shitje pjesë këmbimi. Gjithashtu fatura nr. 10/2021 datë 3.12.2021 në shumën 381,000 lekë e paraqitur si shitës, shoqëria “S” shpk është blerës dhe jo shitës.

Gjithashtu nuk plotëson pikën 2.2.2 të DST, ku kërkohet kopje te certifikuar te bilancit për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, te konfirmuar nga administrata tatimore, pasi

pasqyrat financiar të viteve 2019, 2020 dhe 2021 nuk janë të të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël.

Nga sa trajtuar më sipër shoqëria “S” shpk nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST dhe se gjatë auditimit është evidentuar fakti se disa nga kriteret e konstatuara nga gripi i KLSH për mos plotësim, KVO i ka përdorur si kriterë skualifikuse për shoqërinë “S” me ofertë më të leverdishme, veprime me efekt negativ financiar në shumën **2,066,000 lekë**.

b- Procedura me objekt “Ndërtim RVM 1500 m³ në parkun Dekantim Gorisht”, me fond limit 14,666,892 lekë pa TVSh viti 2021, në të cilën kanë marrë pjesë 2 OE, fitues është shpallur shoqëria “A” shpk me ofertë 13,976,934 lekë më të lartë se OE i skualifikuar, rezulton se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “A” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, shoqëria nuk plotëson disa nga kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

a- Nga shoqëria nuk është deklaruar në shtojcën 8, ing. Mjedisit N S sipas kontratës nr. 4151/2261, datë 31.12.2019, kërkesë në mos plotësim të pikës 2.3.3 të DST, për të cilën është skualifikuar shoqëria “SH” me ofertë më të leverdishme.

b- Nuk plotësohet kriteri për 2 shofer dhe 3 manovratorë, gjithsej 5, pasi z. E H një herë deklarohet si shofer dhe njëherë si manovratorë dhe një herë si shofer, duke lënë një numër mangat.

c- Asnjë nga certifikatat ISO të kërkuara dhe paraqitura nga subjekti nuk dalin aktive të faqen e interneti të shoqërisë që i lëshoni ato.

Nga sa trajtuar më sipër shoqëria “A” shpk nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST dhe se gjatë auditimit është evidentuar fakti se disa nga kriteret e konstatuara nga gripi i KLSH për mos plotësim, KVO i ka përdorur si kriterë skualifikuse për shoqërinë “SH” me ofertë më të leverdishme, veprime me efekt negativ financiar në shumën **1,476,934 lekë**.

c- Procedura me objekt “Shërbimi i transportit të naftës Bruto”, me fond limit 46,771,938 lekë për vitin 2021, në të cilën kanë marrë pjesë 2 OE, ku OE me ofertë ekonomike më të leverdishme është skualifikuar duke kualifikuar shoqërinë “E” shpk me ofertë 46,771,938 lekë më të lartë se OE i skualifikuar, rezulton se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “E” shpk në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, kjo shoqëri është në kushtet e mos plotësimit të ligjit nr. 162, date 21.12.2020 "Per Prokurimin Publik", neni 82, pika 5, si dhe VKM nr.285, datë 19/05/2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 26, pika 6 “Mbi paraqitjen e dokumentacionit administrativo ligjor per procedurat e prokurimit “, pasi nga ofertuesi nuk deklaruar në sistemin SPE, këto dokumente:

1- Nuk plotëson pikën mbi numrin për 15 mjete me kapacitet nga 28-33 m³. Kështu nga auditimi rezulton se shoqëria ka paraqitur 14 mjete nga 15 që kërkohen, pasi mjeti me targë AA672DA është paraqitur dy herë dokumentacioni në sistem. Gjithashtu disa nga mjetet nuk janë të deklaruara nga shoqëria dhe nuk janë në pronësi, pasi nuk dalin as në QKB dhe as në inventarin e pasqyrave financiare, konkretisht mjetet me targë: AA318JU, AGR667, AA880HN, FR4553D.

2- Gjithashtu kapaciteti i tyre nuk është sipas kapacitet që kërkohet në DST nga 28-33 m³.

3- Mjetet e mara me qira nga shoqëria “IZVOR 99” me nr. 2750/1812, datë 16.6.2021, konstatohet se kontrata nuk ka të përcaktuar afatin e përdorimit se për sa periudhë është afati i kontratës.

Nga sa trajtuar më sipër shoqëria “E” shpk nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST dhe se gjatë auditimit është evidentuar fakti se disa nga kriteret e konstatuara nga gripi i KLSH për mos plotësim, KVO i ka përdorur si kriterë skualifikuse për shoqërinë “B” me ofertë më të leverdishme, veprime me efekt negativ financiar në shumën 1,476,934 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albeptorl sh.a, Patos, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për vlerësimin e fakteve të konstatuara nga grupi i KLSH dhe nxjerrjen e përgjegjësi të personave përgjegjës për vlerësimin e gabuar të procedurës në shpalljen fitues të OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të miratuara nga AK, si dhe trajtimin e dy standarte në vlerësim, duke skualifikuar OE me mangësi të njëjta dhe mos vlerësuar kriterin kryesorë “çmimi më i leverdishëm”, veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e shoqërisë Albpetrol sh.a, Patos, për vlerën **10,364,872 lekë pa TVSh**.

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

2. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi i procedurës me objekt “*Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2022*”, rezulton se fondi limit është përcaktuar në vlerën 22,330,000 lekë për sigurimin e 1400 punonjësve sipas pozicioneve të punës, duke mos i përcaktuar sipas vështirësive të punës në terren.

Gjithashtu nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore por dhe nga observacioni i paraqitur nga z. E L me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore me shkresën nr. 11/103, datë 28.4.2023, në lidhje me numrin e punonjësve të siguruar sipas pozicioneve të renditura për vështirësi dhe sigurim jetë, ky numër nuk është 1400 pozicione por është 1338 pozicione, pra numri i punonjësve për të cilën është kërkuar të sigurohen është më i lartë për 62 punonjës duke rënduar padrejtësisht fondin limit për vlerën **928,388 lekë** $\{(1400 - 1338) \times 14,917 \text{ primë sigurimi}\}$, veprime në kundërshtim me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

- Nga auditimi i procedurës me objekt “*Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2021*”, rezulton se fondi limit është përcaktuar në vlerën 22,330,000 lekë për sigurimin e 1400 punonjësve sipas pozicioneve të punës, duke mos i përcaktuar sipas vështirësive të punës në terren.

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në lidhje me numrin e punonjësve të siguruar sipas pozicioneve të renditura për vështirësi dhe sigurim jetë, ky numër nuk është 1400 pozicione por është 1388 pozicione, konkretisht si vijon:

Operator te remontit nëntokësor, ndihmës operator te remontit, sondist, traktorist remonti, janë 75 punonjës.

Elektracist te fushës ose terrenit, janë 43 punonjës.

Saldator, janë 24 punonjës

Drejtues Mjetesh Transporti Mallrash si dhe drejtuesit e mjeteve janë 72 punonjës

Manovratorë Mjetesh, vinçier, skrepist, buldozerist, e te ngjashëm janë 40 punonjës.

Punonjësit e stacioneve Kuçovë, Zharrëz, Gorisht, Usoje, Visoke, Stacioni i Gazit Fier janë 77 punonjës.

Punonjësit e avarisë ne QEMNG janë 30 punonjës.

Reparti i fonderisë, kovacanes, prodhimit te detaleve prej gome janë 13 punonjës.

Brigada e likujdimit te avarive elektrike dhe ajo e linjave elektrike si dhe brigada e mjedisit janë 99 punonjës.

Përgjegjës Turni, Operator Prodhimi, Ndhimës Operator Prodhimi, Operator Studimi, janë 486 punonjës Dekantimi e të ngjashëm..

Fugist, Tornitor, Axhustator, Xhenerik, Mekanik Fushe dhe Mekanik Mjetesh janë 219 punonjës.

Stafi inxhiniero-teknik janë 174 punonjës.

Dega e Monitorimit te Brendshëm janë 18 punonjës

Kontrolloret e pajisjeve te naftës, pranë qendrave te prodhimit janë 18 punonjës

Nga të dhënat evidentohet fakti se numri i punonjësve për të cilën është kërkuar të sigurohen është më i lartë për 12 punonjës (1400 – 1388) x 15,950 primë sigurimi), duke rënduar padrejtësisht fondin limit për vlerën 191,400 lekë, në kundërshtim me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës për llogaritje jo të saktë të fondit limit të procedurës me objekt “Shërbimi i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim i shëndetit nga aksidentet në punë, VITI 2022”, duke rënduar padrejtësisht për vlerën **1,129,788 lekë**, nga e cila për vitin 2022 në vlerën 928,388 lekë dhe në vitin 2021 për vlerën 191,400 lekë.

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigjja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të listpagesave në muaj të caktuar, rezulton se:

Pagesa e orëve shtesë lidhur me ditët normale të punës, dhe në ditët e pushimit/festive, hartohet duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

-Kryespecialisti i secilës drejtori konceptohen shkresë për punën e kryer nga punonjësi/t e shoqërisë Albpetrol sh.a,

-Drejtori i Drejtorisë pranon dhe konfirmohet nga Drejtori Organizativ ose Drejtori Teknik (sipas varësive të eprorëve përkatës),

-Miratohet nga Administratori i shoqërisë.

Pas kontrollit të dokumentacionit dhe rakordimit të formularëve me listëprezencën e orëve jashtë orarit (kopjet origjinale të firmosura nga eprorët përkatës), orët për çdo punonjës hidhen në sistemin e pagave, të ndara në ditë feste, të diela dhe orët normale.

-Përlllogaritja për orët shtesë të punës që punëdhënësi duhet t'i paguajë punëmarrësit është shtesa prej 25% mbi pagën normale.

Orët shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompensohen me një shtesë prej 50% mbi pagë normale.

Vlera totale e orëve jashtë orarit për periudhën objekt auditimi rezulton në vlerën **4,412,419 lekë** dhe konsiderohet *efektit financiar negativ* për buxhetin e shoqërisë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me Urdhri e Administratorit nr.5620 prot, datë 12.08.2021, ku përcaktohet se:

“2.Kërkesat për miratimin e pagës për orët jashtë kohës normale të punës do t'i nënshtrohen procedurës së mëposhtme:

-Qendra e Transportit dhe Furnizimit Patos, në çdo rast të marrjes së konfirmimit me e-mail nga QASHNG Patos, për çdo lëvizje mbas orarit 15:00 të produktit “Naftë Brut” me mjetet e shoqërisë, do të njoftojë për numrin e mjeteve dhe drejtuesit përkatës nëpërmjet e-mail zyrtar po atë ditë të marrjes së kërkesës Drejtorin Teknik, Drejtorin Organizativ dhe Administratorin.

-Çdo javë QFT Patos do të përcjellë një evidencë për orët e kryera jashtë kohës normale të punës duke e shoqëruar dhe me dokumentacionin provues.

-Mbas kryerjes së kësaj procedure konfirmimi, drejtoria e financës do të kryejë pagesën.

3.Ndalimn e aplikimit për orë jashtë kohës normale të punës për punonjësit e Administratës për të cilët, në zbatim të Kodit të Punës, akteve nënligjore dhe Kontratës Kolektive në fuqi, do të trajtohen me ditë pushimi rast pas rasti.

4.Përgjashtime do të ketë vetëm për punonjësit që do të angazhohen në detyra specifike, me Urdhër të posaçëm të Administratorit të shoqërisë.”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të analizojë efektin financiar prej **4,412,419 lekë**, si rezultat i kryerjes së pagesave në kundërshtim me urdhrin e Administratorit të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos nr. 5620 prot, datë 12.8.2021 dhe korrigjimin e pagesave për orët shtesë sipas orëve dhe ditëve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se në pesë raste punonjësit (në pozicione drejtuese) janë shkarkuar nga detyra me urdhër Administratori. Këta punonjës kanë ngritur padi dhe kanë nisur procese gjyqësore kundër Albpetrol sh.a, duke detyruar shoqërinë të paguajë **dëmshpërblim** ndaj tyre në vlerën **11,977,746 lekë**, si dhe **shpenzime gjyqësore dhe tarifë përmbarimi**, me urdhër sekuestro në vlerën **1,887,270 lekë**.

Këta punonjës janë ripunësuar në Albpetrol sh.a (në pozicione drejtuese), përgjithësisht gjatë proceseve gjyqësore. Në asnjë rast nuk ka qenë objekt padie rikthimi i tyre në punë.

-Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, nga ku janë humbur 25 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, si dhe janë humbur e janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë.

-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet **42,600,758 lekë**, nga ku shpenzimet përmbarimore rezultojnë **3,931,821 lekë** dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën **2,146,912 lekë**.

-Për vitin 2021 vlera dëmshpërblimeve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës paraqitet **61,851,420 lekë**, nga ku shpenzimet përmbarimore rezultojnë **6,272,200 lekë** dhe shpenzime për procese gjyqësore në vlerën **2,172,200 lekë**.

Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera 104,452,178 lekë e cila konsiderohet efektit financiar negativ për buxhetin e shoqërisë.

Vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe vlera shpenzimeve përmbartimore lidhur me ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatave dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse për Ekzekutim Vullnetar për çdo rast, duke rezultuar në pagesë të këtyre vlerave me urdhër sekuestro bankare, prej 14,486,894 lekë konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shoqërisë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015, neni 155, pika 3”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 71-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të analizojnë efekti financiar negativ në shumën prej 104,452,178 lekë, si dhe të merren masa ndajë personave përgjegjës për shkëputjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, pasojë e sëcilës janë vendimet gjyqësore për dëmshpërblimet që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigjja e institucionit:

Ne proceset gjyqësore që janë celur në dy vitet e fundit e ne vijimesi (për diskriminim dhe/ose ndërprerje marrëdhëniesh të punës), Albpetrol ka dale fitues në më të shumtën e rasteve. Për të gjitha rastet e mëparshme, Administratori i shoqërisë, ka nxjerrë urdhrat përkatës, ku për të gjithë personat që janë rimarrë në punë, vjetërsia në punë konsiderohet “0” lekë deri në likuidimin e shumës që ka akorduar gjykata si “penalitet”.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit në dosjet e procedurave dhe sistemin SPE, është konstatuar se në 7 procedura me fond limit 318,476 mijë lekë, OE të shpallur fitues nga KVO nuk janë në kushtet e plotësimit të kriteve të DST të miratuara nga AK. Nga KVO këto OE nuk duhej të ishin shpallur fitues dhe lidhur kontrata shërbimesh/punimesh, por duhej anuluar dhe zhvilluar procedura të tjera me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE në procedura për një përdorim me efektiv të fondeve të prokura për vlerën 318,476 mijë lekë, konkretisht procedurat:

Nr/R	Emertimi	Fondi limit leke pa TVSh
Procedura viti 2021		
1	Sigurim I jetës se punonjësve ,sig. shëndeti nga aksidentet ne pune	22,330,000
2	Tube naftësjellësi	17,797,600
3	Blerje Purteka (16 mm, 22 mm,25mm)	17,585,000
4	Riparim pjesore+ pastrim RVM 5000/8 dhe pastrim i mbeturinave mekanike te dy RVM 700 m3 /3/4 ne stacionin Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	18,337,055
Procedura viti 2022		
5	Sigurim i jetës se punonjësve ,sig. shëndeti nga aksidentet ne pune	20,883,330
6	Gazoil 10 ppm	182,692,600
7	Tube pompe kompresori TS	38,854,800

Veprime në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si

dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 150-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, të marrë masa të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

6. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “BP” Ltd., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të PPE&PPA, sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021, nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se, detyrimi që shoqëria “BP” Ltd., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të PPE&PPA sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 24,939.596 (njëzet e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë pikë pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Ton naftë bruto.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të PPE&PPA, për vitin 2021, sasinë prej 21,100.41 (njëzet e një mijë e njëqind pikë dyzet e një) Ton naftë bruto.

Pra, janë tërhequr rreth 3,839.186 (tre mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë pikë njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për PPE&PPA, për vitin 2021.

Shoqëria “BP” Ltd., me anë të shkresës me Nr. 329 Prot., datë 15.04.2022, protokolluar në Albpetrol me Nr. 3249 Prot., datë 20.04.2022 ka dërguar Llogaritjen e Faktorit R në fund të tremujorit të katërt të vitit 2021 (Q4-2021).

Në bazë të përlllogaritjeve, Faktori R, për zonën “Main/Kryesore” rezulton më i madh se 1 (një) në fund të tremujorit të katërt të vitit 2021.

Përsa më sipër, në përputhje me Nenin 9.2 të Marrëveshjes Hidrokarbure “Për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinëz” dhe Nenit 3.2 dhe 3.3 të Amendimit të Marrëveshjes Hidrokarbure, duke nisur nga Tremujori i katërt i vitit 2021, Pjesa e Prodhimit të Albpetrol (PPA), do të llogaritet nga 1% që është aktualisht, në 3% të naftës së disponueshme.

Për vitin 2022, nga të dhënat e vëna në dispozicion konstatohet se, detyrimi që shoqëria “BP” Ltd., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të PPE&PPA sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 29,884.163 (njëzet e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëqind e gjashtëdhjetë e tre) Ton naftë bruto.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të PPE&PPA, për vitin 2022, sasinë prej 14,407.612 Ton naftë bruto. Pra, janë tërhequr rreth 15,476.551 (pesëmbëdhjetë mijë e

katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë pesëqind e pesëdhjetë e një) Ton naftë bruto *më pak nga detyrimi për PPE&PPA, për vitin 2022.*

Detyrimi që shoqëria “BP” Ltd ka ndaj Albpetrol sh.a Patos ne naftë bruto për llogari te Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe te Pjesës se Albpetrol (PPA) për periudhën nga data efektive deri me 31/12/2022 është 78,915.002 ton naftë bruto, me vlerë 39,247,000 USD. Këto veprime kanë sjellë ulje të të ardhurave nga kompania Albpetrol për sasinë e naftës bruto e cila nuk është tërhequr për pamundësi depozitimi.

Për tu theksuar është dhe problemi se kur këto sasi të tërhiqen nga Albpetrol sh.a, çmimi mund të ulet duke sjellë dëm ekonomik për shoqërinë ” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 252-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa për tërheqjen e sasisë **78,905.002** ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe te Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. Vlera e sasisë 78,905.002 ton me çmimet e deklaruara nga kontraktori është 39,247,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.

Përgjigjja e institucionit:

Shoqëria “Albpetrol” Sh.a. dërgon në mënyrë periodike, çdo tremujor kalendarik, njoftime shoqërisë “BP” Ltd., në lidhje me detyrimet të prapambetura në naftë bruto dhe/ose gaz natyror për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol (PPA). Shkresat e fundit që i janë dërguar shoqërisë “Bankers Petroleum Albania” Ltd në lidhje me shlyerjen e detyrimeve në naftë bruto janë shkresat me Nr. 6308 Prot., date 20.07.2023, Nr. 7897 Prot., datë 18.10.2023 (Q2-2023), Nr. 868 Prot., datë 07.02.2023 (Q3-2023), Nr. 2607 Prot., datë 08.05.2024 (Q4-2023) dhe Nr. 4338 Prot., datë 18.07.2024 (Q1-2024). Gjithashtu, shoqëria “Albpetrol” Sh.a. ka dërguar edhe shkresën me Nr. 6429 Prot., datë 27.07.2023, në të cilën kërkojmë nga kontraktori “BP” Ltd., një Plan Lëvrimit ku përveç detyrimit mujor të përfshijnë edhe një pjesë të detyrimit të prapambetur. Pavarësisht kësaj, shoqëria “Albpetrol” do të vazhdojë të angazhohet maksimalisht për përmbushjen e këtij rekomandimi, duke ndjekur gjendjen e detyrimeve dhe duke kërkuar nga shoqëria “BP” Ltd., të lëvrojë sasi më të mëdha të naftës bruto, krahas detyrimit periodik për llogari të Prodhimit të Gjykuar (PPE) dhe Pjesës së Albpetrol (PPA), në mënyrë që të reduktohet detyrimi i akumuluar brenda një kohe sa më të shkurtër. Gjithashtu, theksojmë se, një pjesë e këtij detyrimi është pjesë e procesit të arbitrazhit.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

6.2. Rekomandimi: Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigjja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***pazbatuar***.

7. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “AG” SH.A., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të PPE&PPA, sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021, detyrimi që shoqëria “AG” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të PPE&PPA dhe naftës gjendje në vendburim sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 10,773.49 (dhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre pikë dyzet e nëntë) Ton naftë bruto. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të PPE&PPA, për vitin 2021, sasinë prej 7,816.946 (shtatë mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë nëntëqind e dyzet e gjashtë) Ton naftë bruto. Pra, *janë tërhequr rreth 2,956.544* (dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë pesëqind e dyzet e katër) Ton naftë bruto *më pak nga detyrimi për PPE&PPA, për vitin 2021.*

Për vitin 2022, detyrimi që shoqëria “AG” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të PPE&PPA dhe naftës gjendje në vendburim sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 9,794.455 (nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër pikë katërqind e pesëdhjetë e pesë) Ton naftë bruto.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të PPE&PPA, për vitin 2022, sasinë prej 8,570.083 (tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë pikë zero tetëdhjetë e tre) Ton naftë bruto. Pra, *janë tërhequr rreth 1,224.372* Ton naftë bruto *më pak nga detyrimi për PPE&PPA, për vitin 2022.*

Detyrimi që shoqëria “AG” SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për periudhën nga 02.05.2018 deri më 31/12/2022 është 29,103.96 (njëzet e nëntë mijë e njëqind e tre pikë nëntëdhjetë e gjashtë) ton naftë bruto. Vlera e sasisë 29,103.96 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është **14,476,000 USD**, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë ”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 252-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa, për tërheqjen e sasisë **29,103.96** ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. **Vlera e sasisë 29,103.96 ton** me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është **14,476,000 USD**, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigjja e institucionit:

Shoqëria “Albpetrol” Sh.a. dërgon në mënyrë periodike, çdo tremujor kalendarik, njoftime shoqërisë “AG” Ltd., në lidhje me detyrimet të prapambetura në naftë bruto dhe/ose gaz natyror për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol (PPA). Shkresat e fundit që i janë dërguar shoqërisë “AG” Ltd në lidhje me shlyerjen e detyrimeve në naftë bruto janë shkresat me Nr. 6311 Prot., date 20.07.2023, Nr. 7899 Prot., datë 18.10.2023, (Q2-2023), Nr. 867 Prot., datë (Q3-2023), Nr. 2612 Prot., datë 08.05.2024 (Q4-2023) dhe Nr. 4340 Prot., datë 18.07.2024 (Q1-2024). Pavarësisht kësaj, shoqëria “Albpetrol” do të vazhdojë të angazhohet maksimalisht për përmbushjen e këtij rekomandimi, duke ndjekur gjendjen e detyrimeve dhe duke kërkuar nga shoqëria “AG” Ltd., të lëvrojë sasi më të mëdha të naftës bruto, krahas detyrimit periodik për llogari të Prodhimit të Gjykuar (PPE) dhe Pjesës së Albpetrol (PPA), në mënyrë që të reduktohet detyrimi i akumuluar brenda një kohe sa më të

shkurtër. Gjithashtu, theksojmë se detyrimet për shoqërinë “AG” SH.A. janë përlllogaritur nga data 31.05.2018, datë që përkon me Instrumentin e Transferimit nga shoqëria “T” Ltd tek “AG” SH.A.. dhe detyrimi prej rreth 16,000 Ton (që shoqëria Albpetrol ka marrë tepër nga TransAtlantic, për vendburimin Ballsh-Hekal nuk është përlllogaritur më lart për shkak se çështja vazhdon të mbetet pezull).

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e Albpetrol Sh.A (personat përgjegjës të nga ngarkuar) rezulton se, ngelemi në trajtën e përgjigjeve narrative shpjeguese të situatës dhe mos marrjes së masave konkrete për rekomandimin e lënë. Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

7.2. Rekomandimi: Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

8. Gjetje nga auditimi: - Kontraktori DG Ltd., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të PPE&PPA, sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Detyrimi që DGLtd. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos, në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më 31 Dhjetor 2022, për vendburimin Delvinë Kondesat është 2,902.86 (dy mijë e nëntëqind e dy pikë tetëdhjetë e gjashtë) Ton naftë bruto.. Detyrimi që DG Ltd. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos, në gaz natyror për llogari të Prodhimit Para Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më 31 Dhjetor 2022, për vendburimin Delvinë Gaz është 23,630,398.320 (njëzet e tre milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë pikë treqind e njëzet) Nm3 Gaz. Vlera e sasisë 2,902.86 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 1,443,000 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 252-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa, për tërheqjen e sasisë 2,902.86 ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, dhe 23,630,398.320 Nm3 Gaz, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha nafte të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure. Vlera e sasisë 2,902.86 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është **1,443,000 USD**, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë.

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigja e institucionit:

Shoqëria “Albpetrol” Sh.a. dërgon në mënyrë periodike, çdo tremujor kalendarik, njoftime shoqërisë “DG” Ltd., në lidhje me detyrimet të prapambetura në naftë bruto dhe/ose gaz natyror për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol (PPA). Shkresat e fundit që i janë dërguar shoqërisë “DG” Ltd në lidhje me shlyerjen e detyrimeve në naftë bruto janë shkresat me Nr. 6306 Prot., date 20.07.2023, Nr. 7896 Prot., datë 18.10.2023 (Q2-2023), Nr.865 Prot., datë 07.02.2024 (Q3-2023), Nr. 2611 Prot., datë 08.05.2024 (Q4-2023) dhe Nr.4339 Prot., datë 18.07.2024 (Q1-2024). Pavarësisht kësaj, shoqëria “Albpetrol” do të vazhdojë të angazhohet maksimalisht për përmbushjen e këtij rekomandimi, duke ndjekur gjendjen e detyrimeve dhe duke kërkuar nga shoqëria “DG” Ltd., çfarë rruge do ndjekë për shlyerjen e detyrimeve.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e Albpetrol Sh.A (personat përgjegjës të nga ngarkuar) rezulton se, ngelemi në trajtën e përgjigjeve narrative shpjeguese të situatës dhe mos marrjes së masave konkrete për rekomandimin e lënë. Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

8.2. Rekomandimi: Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

9. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “TO” SH.A., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të PPE&PPA, sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021 vërehet se, detyrimi që shoqëria “TO” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të PPE&PPA dhe naftës gjendje në vendburim sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 2,825.802 (dy mijë e tetëqind e njëzet e pesë pikë tetëqind e dy) Ton naftë bruto.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të PPE&PPA, për vitin 2021, sasinë prej 657.793 Ton naftë bruto.

Pra, janë tërhequr rreth 2,168.009 Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për PPE&PPA, për vitin 2021.

Për vitin 2022 vërehet se, detyrimi që shoqëria “TO” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të PPE&PPA dhe naftës gjendje në vendburim sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 2,558.788 (dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë pikë shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) Ton naftë bruto.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të PPE&PPA, për vitin 2022, sasinë prej 2,011.008 Ton naftë bruto.

Pra, janë tërhequr rreth 547.78 (pesëqind e dyzet e shtatë pikë shtatëdhjetë e tetë) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për PPE&PPA, për vitin 2022.

Detyrimi që shoqëria “TO” SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në nafte bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për periudhën nga data efektive deri më 31/12/2022 është 10,332.89 (dhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy pikë tetëdhjetë e nëntë) ton nafte bruto.

Vlera e sasisë 10,332.89 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është 5,139,553 USD, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a ” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 252-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos të marrë masa, për tërheqjen e sasisë 10,332.89 ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha nafte të përfutur nga marrëveshja hidrokarbure. Vlera e sasisë 10,332.89 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është **5,139,553 USD**, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigja e institucionit:

Shoqëria “Albpetrol” Sh.a. dërgon në mënyrë periodike, çdo tremujor kalendarik, njoftime shoqërisë “TO” Sh.a., në lidhje me detyrimet të prapambetura në naftë bruto dhe/ose gaz natyror për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol (PPA). Shkresat e fundit që i janë dërguar shoqërisë “TO” Sh.a. në lidhje me shlyerjen e detyrimeve në naftë bruto janë shkresat me Nr. 6309 Prot., date 20.07.2023, Nr. 7901 Prot., datë 18.10.2023 (Q2-2023), Nr. 866 Prot., datë 07.02.2024 (Q3-2023), Nr. 2608 Prot., datë 08.05.2024 (Q4-2023) dhe Nr. 4335 Prot., datë 18.07.2024 (Q1-2024). Pavarësisht kësaj, shoqëria “Albpetrol” do të vazhdojë të angazhohet maksimalisht për përmbushjen e këtij rekomandimi, duke ndjekur gjendjen e detyrimeve dhe duke kërkuar nga shoqëria “TO” Sh.a. të lëvrojë sasi më të mëdha të naftës bruto, krahas detyrimit periodik për llogari të Prodhimit të Gjykuar (PPE) dhe Pjesës së Albpetrol (PPA), në mënyrë që të reduktohet detyrimi i akumuluar brenda një kohe sa më të shkurtër.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e Albpetrol Sh.A (personat përgjegjës të nga ngarkuar) rezulton se, ngelemi në trajtën e përgjigjeve narrative shpjeguese të situatës dhe mos marrjes së masave konkrete për rekomandimin e lënë. Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

9.2. Rekomandimi: Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

10. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “FP” SH.A., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të PPE&PPA, sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021 vërehet se, detyrimi që shoqëria “FP” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të PPE&PPA dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. Pekisht-Murriz sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 75.997 (shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) Ton naftë bruto. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos nuk e ka tërhequr këtë sasi naftë gjatë vitit 2021.

Për vitin 2022 vërehet se, detyrimi që shoqëria “FP” SH.A., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të PPE&PPA dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. Pekisht-Murriz sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 81.246 (tetëdhjetë e një pikë dyqind e dyzet e gjashtë) Ton naftë bruto. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të PPE&PPA, për vitin 2022, sasinë prej 41.201 (dyzet e një pikë dyqind e një) Ton naftë bruto. Pra, janë tërhequr rreth 40.045 (dyzet pikë zero dyzet e pesë) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për PPE&PPA, për vitin 2022.

Detyrimi që shoqëria “FP” SH.A. ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA) dhe naftës gjendje në vendburim, për Vb. Pekisht-Murriz, për periudhën deri më 31/12/2022 është 52.185 (pesëdhjetë e dy pikë njëqind e tetëdhjetë e pesë) ton naftë bruto ” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 252-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Albpetrol sh.a Petrol të marrë masa, për tërheqjen e sasisë **52.185** ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfutur nga marrëveshja hidrokarbure. Vlera e sasisë 52.185 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është **25,954 USD**, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigjja e institucionit:

Shoqëria “Albpetrol” Sh.a. dërgon në mënyrë periodike, çdo tremujor kalendarik, njoftime shoqërisë “FP” Ltd., në lidhje me detyrimet të prapambetura në naftë bruto dhe/ose gaz natyror për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol (PPA). Shkresat e fundit që i janë dërguar shoqërisë “FP” Ltd.. në lidhje me shlyerjen e detyrimeve në naftë bruto janë shkresa me Nr. 6310 Prot., date 20.07.2023, Nr. 863 Prot., datë 07.02.2024 (Q3-2023), Nr.2610 Prot., datë 08.05.2024 (Q4-2023) dhe Nr. 4336 Prot., datë 18.07.2024 (Q1-2024). Pavarësisht kësaj, shoqëria “Albpetrol” do të vazhdojë të angazhohet maksimalisht për përmbushjen e këtij rekomandimi, duke ndjekur gjëndjen e detyrimeve dhe duke kërkuar nga shoqëria “FP” Ltd. të lëvrojë sasi më të mëdha të naftës bruto, krahas detyrimit periodik për llogari të Prodhimit të Gjykuar (PPE) dhe Pjesës së Albpetrol (PPA), në mënyrë që të reduktohet detyrimi i akumuluar

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e Albpetrol Sh.A (personat përgjegjës të nga ngarkuar) rezulton se, ngelemi në trajtën e përgjigjeve narrative shpjeguese të situatës dhe mos marrjes së masave konkrete për rekomandimin e lënë. Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

11. Gjetje nga auditimi: Kontraktori “SHP” Ltd., ka detyrime ndaj Albpetrol në naftë bruto për llogari të PPE&PPA, sipas Marrëveshjes Hidrokarbure. Për vitin 2021 vërehet se, detyrimi që shoqëria “SHP” Ltd., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të PPE&PPA sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2021 është 606.437 (gjashtëqind e gjashtë pikë katërqind e tridhjetë e shtatë) Ton naftë bruto. Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të PPE&PPA, për vitin 2021, sasinë prej 590.068 (pesëqind e nëntëdhjetë pikë zero gjashtëdhjetë e tetë) Ton naftë bruto. Pra, janë tërhequr rreth 16.369 (gjashtëmbëdhjetë pikë treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) Ton naftë bruto më pak nga detyrimi për PPE&PPA, për vitin 2021.

Për vitin 2022 vërehet se, detyrimi që shoqëria SIPL., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto, për llogari të PPE&PPA sipas Marrëveshjes Hidrokarbure, për vitin 2022 është 548.17 (pesëqind e dyzet e tetë pikë shtatëmbëdhjetë) Ton naftë bruto.

Shoqëria Albpetrol sh.a Patos ka tërhequr për llogari të PPE&PPA, për vitin 2022, sasinë prej 567.949 (pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë nëntëqind e dyzet e nëntë) Ton naftë bruto.

Pra, janë tërhequr rreth 19.779 (nëntëmbëdhjetë pikë shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) Ton naftë bruto më shumë nga detyrimi për PPE&PPA, për vitin 2022.

Detyrimi që shoqëria “SHP” Ltd., ka ndaj Albpetrol sh.a Patos në naftë bruto për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE), të Pjesës së Albpetrol (PPA), për periudhën nga data efektive deri më 31/12/2022 është 581.683 (pesëqind e tetëdhjetë e një pikë gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) ton naftë bruto”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqe 252-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa, për tërheqjen e sasisë **581.683** ton naftë bruto, për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe të Pjesës së Albpetrol (PPA) e krijuar nga data efektive deri me 31/12/2022, duke vendosur si prioritetet që gjatë planifikimit të shitjes së naftës bruto me procedurat e ankandit të përcaktoj një sasi të mëdha naftë të përfituar nga marrëveshja hidrokarbure.

Vlera e sasisë 581.683 ton me çmimet e shitjes së periudhës 31/12/2022 është **289,300 USD**, dhe përbën të ardhura të munguara për shoqërinë Albpetrol sh.a Patos

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigja e institucionit:

Shoqëria “Albpetrol” Sh.a. dërgon në mënyrë periodike, çdo tremujor kalendarik, njoftime shoqërisë “SHP” Ltd., në lidhje me detyrimet të prapambetura në naftë bruto dhe/ose gaz natyror për llogari të Prodhimit Para-Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Prodhimit të Albpetrol (PPA).

Shkresat e fundit që i janë dërguar shoqërisë “SHP” Ltd., në lidhje me shlyerjen e detyrimeve në naftë bruto janë shkresat me Nr. 6307 Prot., datë 20.07.2023, Nr. 7900 Prot., datë 18.10.2023 (Q2-2023), Nr. 864 Prot., datë 07.02.2024 (Q3-2023), Nr. 2609 Prot., datë 08.05.2024 (Q4-2023), dhe Nr. 4337 Prot., datë 18.07.2024 (Q1-2024)

Pavarësisht kësaj, shoqëria “Albpetrol” do të vazhdojë të angazhohet maksimalisht për përmbushjen e këtij rekomandimi, duke ndjekur gjendjen e detyrimeve dhe duke kërkuar nga shoqëria “SHP” Ltd., të lëvrojë sasi më të mëdha të naftës bruto, krahas detyrimit periodik për llogari të Prodhimit të Gjykuar (PPE) dhe Pjesës së Albpetrol (PPA), në mënyrë që të reduktohet detyrimi i akumuluar brenda një kohe sa më të shkurtër.

Komenti i grupit të auditimit:

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e Albpetrol Sh.A (personat përgjegjës të nga ngarkuar) rezultoi se, ngelemi në trajtën e përgjigjeve narrative shpjeguese të situatës dhe mos marrjes së masave konkrete për rekomandimin e lënë. Në kushtet e mungesës së evidencave të reja

justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

11.2. Rekomandimi: Shoqëria Albpetrol të caktojë grupe pune për llogaritjen e dëmit përkatës, që i krijohet nga diferenca e çmimit real të shitjes, (në rastet kur vërtetohet), me çmimin e produktit në momentin e lindjes së detyrimit kontraktor për tu lëvruar në depozitat e shoqërisë.

Brenda datës 30.10.2023

Përgjigja e institucionit:

Nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e këtij rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit:

Në kushtet e mungesës së evidencave të reja justifikuese të cilat do të provonin statusin e zbatueshmërisë së rekomandimit, nga grupi i auditimit ky rekomandim do të cilësohet si i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni nr.37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe neni 14 të kontratës kolektive për punonjësit e shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, i rekomandojmë Këshillit Mbikëqyrës i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos, fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore për punonjësit të cilët janë konstatuar me shkelje nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për 8 punonjës si më poshtë:

a- Ndërprerje të marrëdhënies së punës, sipas neni 14 pika (c) e kontratës.

1. Z. E D, me detyrë Administrator i shoqërisë Albpetrol sh.a Patos.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Në lidhje me sasi të e ujit që tejkalojnë normat teknologjike në produktin naftë argumentimet e specialistëve të QASHNG, Qendra e Administrimit të Shitjes së Naftës dhe Gazit, janë se nafta vjen jashtë standardeve nga qendrat e tjera, dhe për këtë fakt janë njoftuar administratorët, të cilët kanë lëshuar urdhra për pranimin e produktit naftë bruto dhe jashtë standardeve teknologjike, (me ujë mbi 3%, deri në 14 %). Urdhrat nr. 182 datë 07.09.2021, “Për procedurë e inspektimit dhe kontrollit të qarkullimit të produktit Naftë Bruto”, 182/2 datë 16.12.2021, dhe 182/3 datë 17.12.2021.

Argumentet e sjella nga qendrat janë se nuk kanë pajisjet për të bërë ndarjen e plotë të ujit dhe se nuk mund të ndalojnë punën në puse. Në momentin kur produkti i gatshëm i shitet kompanive fituese të ankandeve, në depozitat e shitjes nafta bruto ngrohet dhe përgatitet në parametrat teknologjikë me përqindje uji më të vogël se 3%, ndërkohë që pjesa tjetër është produkt i gatshëm në mungesë.

Nga mosveprimet e shoqërisë Albpetrol sha janë evidentuar efekte ekonomike negative me dëm në vlerën 20,611,914 lekë.

-Albpetrol sha në lidhje me veprimet që ka kryer për riparimin e depozitës RMV 8000/8 në Zharrëz nuk ka zbatuar udhëzimet në lidhje me ligjin për akcizën, ku citohen qartë lajmërimet që duhet të kryente si dhe detyrimin për prezencën e përfaqësuesve të Doganës në momentin e fillimit të riparimeve si dhe në momentin e groposjes së masës volumore 311.1 ton naftë bruto.

-Gjatë periudhës 2021-2022, kompania Bankers Petroleum nuk ka kryer pagesat për energjinë elektrike. Për këto mospagesa Albpetrol sh.a Patos ka maturuar penaltitete e kamatëvonesa. Gjatë vitit 2022 Albpetrol ka ndërmarrë veprime administrative duke marrë vendime gjyqate si tituj ekzekutiv për faturat e papaguara. Gjithashtu është marrë si titull ekzekutiv dhe një faturë penaltitësh për mospagesat e faturave të energjisë elektrike. Llogaritja e kamatëvonesave është kryer sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Llogaritja bazuar në këtë ligj është më e vogël se kamatëvonesa që ka aplikuar OSHEE për faturat e papaguara nga Albpetrol sh.a Patos Vlera e kamatëvonesës së aplikuar nga OSHEE me atë që ka llogaritur Drejtoria Ekonomike e Albpetrol sh.a Patos, përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

OSHEE sh.a. ka bërë një akt-rakordimi për detyrimet që ka Albpetrol sh.a Patos, për principalin dhe kamatë vonesat.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Albpetrol sha ka kërkuar kamatëvonesa për pagesat me vonesë të Bankers Petroleum në vlerën 175,458,324 lekë, kur detyrimi që Albpetrol ka ndaj FSHU sha, për kontratat përkatëse për kamatëvonesa është 1,356,345,939 lekë.

Vlera 1,180,887,615 lekë përbën shpenzime jo të justifikuara nga Albpetrol sha.

1. Bazuar në e-mailin e dërguar pranë Drejtorisë së Marrëveshjeve Hidrokarbure me datë 04.11.2022, është kryer kërkesa me lëndë “Kërkesë për pjesëmarrje e punonjësve të shoqërisë Albpetrol sha, në takimin që do të zhvillohet me avokatët e studios ligjore Curtis, në kuadër të Arbitrazhit Ndërkombëtar kundër shoqërisë “BP” në Milano, Itali, drejtuar Administratorit. Nga ana e Administratorit të shoqërisë Albpetrol sha është marrë vendimi me nr. 8219 prot., datë 10.11.2022 për marrjen pjesë në këtë takim, në e-mailin e dërguar nga studio ligjore Curtis specifikohet se punonjësit që janë ftuar për të marrë pjesë janë z. I K, z. J S dhe znj. A Z. Punonjësit do të qëndrojnë nga data 29.11.2022 deri me 03.12.2022.

Nga auditimi i të gjithë praktikave të udhëtimeve jashtë vendit nuk vërtetohet nëse është paguar tarifa e regjistrimit në konferenca, nuk vërtetohet pjesëmarrja nga ana dokumentare dhe nuk vërtetohet nëse këta punonjës janë trajtuar financiarisht nga bonuset e trajnimit siç është specifikuar në vendimin e Administratorit, ku janë ngarkuar për dokumentimin e plotë të praktikës me kompanitë koncesionare Drejtoria e Marrëveshjeve, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Kabinetit.

2. Për mos marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

3. Në shumicën e udhëtimeve jashtë vendit pjesëmarrëse është edhe sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës znj. R B, pjesëmarrja e znj. B nuk është e justifikuar pasi nuk është punonjëse e shoqërisë Albpetrol sha por është punonjëse e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu detyra e saj funksionale është e përcaktuar qartë se nuk është përfaqësuese e Këshillit Mbikëqyrës, përfaqësues të Këshillit Mbikëqyrës janë vetëm anëtarët e tij siç është përcaktuar qartë në Statutin e shoqërisë Albpetrol sha. Nuk ka asnjë arsye përse Administratori i shoqërisë urdhëron që sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës të marrë pjesë në konferenca të ndryshme me shpenzimet e shoqërisë Albpetrol sha përderisa sekretarja e Këshillit ka vetëm detyrën e mbajtjes së dokumentacionit mbi Këshillin Mbikëqyrës dhe asnjë detyrë apo kontribut tjetër në shoqërinë Albpetrol sha, caktimi i sekretares së Këshillit rëndon shpenzimet e shoqërisë Albpetrol sha.

4. Me vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021, administratori i shoqërisë ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil/benzine, ku tërheqja e kësaj sasive do të behej me tollona pranë magazinës së Albpetrol nga drejtoria e përfaqësimit dhe koordinimit me institucionet. Në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për 7 muaj të vitit 2021.

Me vendimin nr. 5132 datë 28.07.2021, administratori ka shfuqizuar vendimin nr. 9865 datë 06.12.2021 duke përcaktuar si kuotë mujore, për këshillin mbikëqyrës sasinë prej 1000 litra/gazoil/benzinë, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për një muaj.

Me vendimin nr. 5256 prot., datë 03.08.2021, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës, në bazë të këtij urdhri janë marrë sasi karburanti për muaj të vitit 2021. Me vendimin nr. 2529 prot., datë 24.03.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 250 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 5256/1 prot., datë 04.06.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 500 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës. Me vendimin nr. 7911 prot., datë 31.10.2022, ka miratuar kuotën mujore prej 1000 litra/gazoil për Këshillin Mbikëqyrës.

Të gjithë vendimet e sipërcituara baza ligjore e përdorur për dhënien e këtyre vendimeve nuk citon për miratimin e dhënies së kuotës mujore me karburant për llogari të Këshillit Mbikëqyrës. Gjithashtu nuk është përcaktuar arsyeja e dhënies së sasisë së karburantit për Këshillin Mbikëqyrës dhe si do të justifikohet nga ana e Këshillit konsumi i karburantit të dhënë. Nga auditimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura nga Sekretarja e Këshillit Mbikëqyrës nuk konstatohet të jenë kryer mbledhje në selinë e Shoqërisë Albpetrol sh.a Patos por të gjitha mbledhjet ku Këshilli ka marrë vendime për shoqërinë janë mbajtur në Tiranë.

Përgjigjja e institucionit:

Zbatimi i këtij rekomandimi është kompetence e Këshillit Mbikëqyrës. Në proces verbalin e mbajtur në mbledhjen e këtij Këshilli, vete ky organ shprehet në faqen 12 të tij që "...në mënyrë unanime shpreh qendrimin kundër rekomandimit..."

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i papranuar* nga subjekti dhe është *i pazbatuar*.

2. Znj. A B, në cilësinë e anëtarit të grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto dhe të Drejtorit të Financës.

Për shkeljet e mëposhtme:

Procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandëve të shitjes së naftës, nuk është kryer duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko-financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë nuk janë botuar në gazetatat e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

-Më datë 05.01.2022, Dega e Doganës Fier me shkresën nr. 5087/3, i ka dërguar Albpetrol njoftimin e proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative. Si rezultat i verifikimit në vend të magazinave fiskale u konstatuan mangësi të pajustificuara mes gjendjes fizike dhe gjendjes kontabël në sistem. Referuar nenit 90 dhe 90/12 të Ligjit nr. 61/2012, "Për Akcizat në RSH", i ndryshuar, për mangësitë e konstatuar e cila tejkalon 2% frot e krahasuar me regjistrat kontabël, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me trefishin e detyrimeve të akcizës së munguar. Sasia e gjetur në mungesë është 1,486,742 kg.

Detyrimi i papaguar është në vlerën 37,168,557 lekë plus penalitetet në vlerën 111,505,672 lekë, në total 148,674,230 lekë.

Vlera 148,674,230 lekë përbën shpenzime jo të justifikuara për shoqërinë Albpetrol sha.

-Albpetrol sha., më datë 03.03.2022 ka lidhur me shoqërinë A.shpk, kontratën me objekt "Riparim pjesor dhe pastrim i mbetjeve të RVM 5000/8 m3 në stacionin e shitjes së naftës në Zharrëz. Grupi i punës nga Albpetrol për përgatitjen e depozitës në relacionin me nr. 428 prot.,

datë 13.05.2022, pas procedurës së hapjes për efekt pastrimi, kanë kryer operacionet si largim uji dhe mbetje inerte ranore, është zhvendosur masa volumore e rezervuarit prej 311.1 ton, në gropen ekologjike pranë stacionit Zharrëz. Në këtë masë pas analizave kanë rezultuar 24.33 ton ujë i lirë, 53.62 ton ujë i lidhur, 145.1 ton mbeturina mekanike dhe 88.04 ton naftë. Kjo sasi naftë është propozuar për tu ulur nga bilanci i muajit prill 2022. Sasinë prej 311.1 ton që Albpetrol sha e ka hedhur si mbetje e ka pasur në bilancin e naftës si produkt gjendje. Lidhur procesin e pastrimit të depozitës nga Albpetrol sha, i është dërguar një shkresë Doganës Fier, por në procesin e hapjes së depozitës si dhe në hedhjen e mbetjeve ranore në gropën ekologjike nuk ishte prezent asnjë përfaqësues i Doganës apo inspektor i Tatimeve për të certifikuar heqjen nga produkti i gatshëm naftë sasinë prej 311.1 ton.

Vlera e naftës 311.1 ton është 17,923,404 lekë. Gjoha nga organet tatimore është në vlerën 100% plus dhe 15%, 2,688,510 lekë, pra në total 20,611,914 lekë.

Nga mosveprimet e shoqërisë Albpetrol sha janë evidentuar efekte ekonomike negative me dëm në vlerën 20,611,914 lekë.

-Albpetrol sha në lidhje me veprimet që ka kryer për riparimin e depozitës RMV 8000/8 në Zharrëz nuk ka zbatuar udhëzimet në lidhje me ligjin për akcizën, ku citohen qartë lajmërimet që duhet të kryente si dhe detyrimin për prezencën e përfaqësuesve të Doganës në momentin e fillimit të riparimeve si dhe në momentin e groposjes së masës volumore 311.1 ton naftë bruto. Veprime në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe me Rregulloren e Brendshme të shoqërisë e miratuar me Vendimin Nr.20, datë 03.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës neni 66, gërma A, pika 6.

Nga mos kryerja e detyrave funksionale është krijuar një dëm ekonomik prej 14,613,456 lekë.

-Gjatë periudhës 2021-2022, kompania BP nuk ka kryer pagesat për energjinë elektrike. Për këto mospagesa Albpetrol sh.a Patos ka maturuar penalitete e kamatëvonesa. Gjatë vitit 2022 Albpetrol ka ndërmarrë veprime administrative duke marrë vendime gjykate si tituj ekzekutiv për faturat e papaguara. Gjithashtu është marrë si titull ekzekutiv dhe një faturë penaltetesh për mospagesat e faturave të energjisë elektrike. Llogaritja e kamatëvonesave është kryer sipas Ligjit nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuar në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Llogaritja bazuar në këtë ligj është më e vogël se kamatëvonesa që ka aplikuar OSHEE për faturat e papaguara nga Albpetrol sh.a Patos Vlera e kamatëvonesës së aplikuar nga OSHEE me atë që ka llogaritur Drejtoria Ekonomike e Albpetrol sh.a Patos, përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

OSHEE sh.a. ka bërë një akt-rakordimi për detyrimet që ka Albpetrol sh.a Patos, për principalin dhe kamatë vonesat.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Albpetrol sha ka kërkuar kamatëvonesa për pagesat me vonesë të BP në vlerën 175,458,324 lekë, kur detyrimi që Albpetrol ka ndaj FSHU sha, për kontratat përkatëse për kamatëvonesa është 1,356,345,939 lekë.

Vlera 1,180,887,615 lekë përbën shpenzime jo të justifikuara nga Albpetrol sha.

Nga auditimi i listë pagesave të administratës së shoqërisë Albpetrol sha për periudhën Maj-Shtator 2022, u konstatua se për këtë periudhë janë trajtuar me dieta z. K C, me detyrë ish-Administrator i shoqërisë dhe L L, me detyrë ish-shofer i Administratorit.

Vlerat e përfituara padrejtësisht janë si më poshtë:

Muaji	Klejdi Cenmurati	Luftar Liko
Qershor	17,000 lekë	18,600 lekë
Korrik	20,000 lekë	26,200 lekë
Gusht	20,000 lekë	26,300 lekë
Shtator	20,000 lekë	22,800 lekë
Tetor	4,000 lekë	

TOTALI	81,000 lekë	93,900 lekë
---------------	--------------------	--------------------

Burimi: Të dhënat Albpetrol sha

Vlera prej **174,900 lekë** përbën dëm ekonomik për Shoqërinë Albpetrol sh.a Patos, dëm i cili duhet të dëmshpërblehet nga punonjësit përfitues.

- Për mos marrjen e masave për reflektimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimore në përputhje me VKM nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune., dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet përkatëse për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive.

Nga llogaritja e listpagesave të periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 rezulton se ky përfitim është në masën 425,231,740 lekë, nga 255,231,740 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej *170,092,696 lekë e cila konsiderohet dëm ekonomik* për buxhetin e shoqërisë Albpetrol SHA.

- Për shkak të vendimeve të kundër ligjshme, dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse, të cilat janë shpallur palë fituese nga gjykatat e Republikës të Shqipërisë, për Ekzekutim Vullnetar, vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe tarifa e shërbimit përmbartimor plus TVSH rezulton në vlerën *15,506,614 lekë* dhe konsiderohet *dëm ekonomik* në buxhetin e Shoqërisë Albpetrol SHA.

- Situata e krijuar lidhur me “Detyrimin për tatimin mbi të ardhurat personale” dhe “Kontributin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, rezulton se për periudhën objekt auditimi janë paguar gjopa dhe interesa për pagesa të vonuara në vlerën *726,099 lekë*, vlerë kjo që konsiderohet *dëm ekonomik* në buxhetin e shoqërisë Albpetrol SHA.

- Mos zbatimi i urdhrorit të Administratorit nr.5620 prot, datë 12.08.2021, lidhur me orët e punës jashtë orarit për periudhën objekt auditimi rezulton në vlerën *4,412,419 lekë* dhe *konsiderohet efektit financiar negativ* për buxhetin e shoqërisë.

Përgjigjja e institucionit:

Me Vendimin nr. 484, datë 11.10.2023 është dhënë masë disiplinore “*Vërejtje me shkrim*” për znj. A B.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

3. Z. A T, me detyrë Drejtor i Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit në Albpetrol SHA, për periudhën objekt auditimi 2021 – 2022.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos marrjen e masave për reflektimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimore në përputhje me VKM nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune., dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet përkatëse për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive.

Nga llogaritja e listpagesave të periudhës 01.01.2021 – 31.12.2022 rezulton se ky përfitim është në masën 425,231,740 lekë, nga 255,231,740 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër

shuma prej 170,092,696 lekë e cila konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë Albpetrol SHA.

-Për shkak të vendimeve të kundër ligjshme, dhe mos zbatimit të kërkesës të palës paditëse, të cilat janë shpallur palë fituese nga gjykatat e Republikës të Shqipërisë, për Ekzekutim Vullnetar, vlera e shpenzimeve gjyqësore dhe tarifa e shërbimit përmbartimor plus TVSH rezulton në vlerën 15,506,614 lekë dhe konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e Shoqërisë Albpetrol sh.a.

Përgjigjja e institucionit:

Z. A T ka levizur nga kjo detyre me vendimi nr. 463, 22.09.2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

4. Zj. E V, në cilësinë e anëtarit të grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto.

Përgjigjja e institucionit:

Me Vendimin nr. 485, datë 11.10.2023 Zj. E V ka levizur nga kjo detyre.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

Për shkeljet e mëposhtme:

Procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandëve të shitjes së naftës, nuk është kryer duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë nuk janë botuar në gazetata e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

5. Z. P Dh, në cilësinë e anëtarit të grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto.

Për shkeljet e mëposhtme:

Procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandëve të shitjes së naftës, nuk është kryer duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë nuk janë botuar në gazetata e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

Përgjigjja e institucionit:

Z. P Dh ka levizur nga kjo detyre me Vendimin nr. 486, datë 11.10.2023.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

6. Zj. B N, në cilësinë e anëtarit të grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto.

Për shkeljet e mëposhtme:

Procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandëve të shitjes së naftës, nuk është kryer duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko-financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë nuk janë botuar në gazetatat e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

Përgjigjja e institucionit:

Zj. B N ka levizur nga kjo detyre me vendimin nr. 41, 25.01.2024.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

7. Zj. A D, në cilësinë e anëtarit të grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto.

Për shkeljet e mëposhtme:

Procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandëve të shitjes së naftës, nuk është kryer duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko-financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë nuk janë botuar në gazetatat e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

b- Vërejtje me shkrim për paralajmërim për largim nga puna sipas nenit 14 pika (c), e kontratës.

Përgjigjja e institucionit:

Zj. A D ka levizur nga kjo detyrë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

1. Zj. M B në cilësinë e anëtarit të grupit të ekspertëve për përcaktimin e çmimit të naftës bruto.

Për shkeljet e mëposhtme:

Procesi i përcaktimit të vlerës fillestare të ankandëve të shitjes së naftës, nuk është kryer duke bërë vlerësime për vlerën aktuale monetare, në çmimet e tregut, ose në të dhënat e organeve të tjera shtetërore për të maksimizuar të ardhurat dhe përmirësimin e situatës ekonomiko-financiare. Procedurat standarde të ankandit, ftesat për ofertë nuk janë botuar në gazetatat e huaja me shpërndarje në tregjet e produktit naftë bruto, me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes me operatorë të specializuar të sektorit, për të përfituar çmimet reale të tregjeve ndërkombëtare.

E.1. Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional.

a. Për 8 ish drejtuesit dhe punonjësit, për të cilët nuk kemi adresim institucional për marrëdhënie pune në administratën publike, masa disiplinore e propozuar nga ana jonë, në bazë

të shkeljeve të konstatuara në raportin përfundimtar do të ishte rekomanduar masa “Ndërprerje e Marrëdhënieve të punës”, sipas shkallës së përgjegjësisë, respektivisht:

1. Z. B Z, ish Administrator i Albpetrol sh.a, për periudhën janar – mars 2021,
2. Z. F M, ish Administrator i Albpetrol sh.a, për periudhën mars – korrik 2021,
3. Z. F M, ish Administrator i Albpetrol sh.a, për periudhën korrik 2021 – mars 2022,
4. Z. K C, ish Administrator i Albpetrol sh.a, për periudhën maj – tetor 2022.
5. Z. R Ç , me detyrë ish-Drejtor i Çështjeve Ligjore dhe Përfaqësimit në Albpetrol sh.a:
6. Z. A L, me detyrë ish-Drejtor i Financës në Albpetrol sh.a:
7. Z. R Ç , në cilësinë e ish drejtorit të DÇLP
8. Zj. A Ll, në cilësinë e ish kryespecialistes së DÇLP

F. MASA ADMINISTRATIVE:

F/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me nenet 3- “Parimet e përzgjedhjeve”, 98- “Anulimi i një procedure”, 76- “Kriteret detyruese për skualifikim” dhe 92- “Shqyrtimi i ofertave” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 67- “Klasifikimi i ofertave”, 82- “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” dhe 83- “Njoftimi i fituesit” të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit (*pikën 2.7 faqen 160-247*).

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; nenin 132 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (*dënim me gjobë*) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (*për marrjen e masave disiplinore*), për 27 (njëzeteshtatë) punonjësve, si më poshtë:

1. Z. E Gj, me profil ing. Mekanik/QFT Patos.
2. Z. V Sh, me profil ing. Mekanik/QFT Patos.
3. Z. A P, me profil Ekonomist/Drejt. Prodhimit.
4. Z. F S, me detyrë Drejtor Drejtoria e Prokurimeve.
5. Zj. O F, me profil ing. Gjeologe, Drejt Prokurimit
6. Z. K N, me detyrë specialist Drejtoria e Logjistikes.
7. Z. R P, me detyrë specialist Drejtoria e prokurimeve.
8. Z. E L, me profil Drejt. i Burimeve Njerëzore.
9. Z. J S, me profil Kryeinspektor i Kontrollit Shëndetësore, QEMNG Patos.
10. Zj. E C, me profil ing. Naftë, Drejt e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurimit teknik.
11. Zj. G L, me profil Krye – Specialist, Sektori i Projekteve
12. Z. D H, me detyrë Kryeinxhinier QASHNG Patos.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) dhe ose specifikimeve teknike, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen

e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *konkretisht në praktikat:*

Nr/R	Emertimi	Fondi limit leke pa TVSh	Njësia e prokurimit dhe specifikimeve teknike
Procedura viti 2021			
1	Sigurim I jetës se punonjësve ,sig. shëndeti nga aksidentet ne pune	22,330,000	E C; J S; O F
2	Autobote 30-33 m3 per Q.F.&T. Patos	61,200,000	R P; E Gj; F S
3	Permiresimi i infrastrukturës se Stacionit te Shitjes se Naftës Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	59,970,906	R P; R G; M P
4	Riparim pjesore+ pastrim RVM 5000/8 dhe pastrim i mbeturinave mekanike te dy RVM 700 m3 /3/4 ne stacionin Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	18,337,055	F S; R G; O F
5	Zëvendësim i mbulesave ekzistuese "Eternit" i çatave te reparit Mekanik dhe reparit Elektrik ne Q.M.N. Kuçove	9,953,982	R G; G L
6	Sherbim per transport nafte bruto	46,771,938	R P; D H; F S
7	Ndertim RVM 1500 m3 ne parkun e vjetër Dekantimin Gorisht (trajtim nafte ne te ftohte me servo)	14,666,892	F S; K N; R P
Procedura viti 2022			
8	Sigurim i jetës se punonjësve ,sig. shëndeti nga aksidentet ne pune	20,883,330	E L; J S

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit, etj.

- Vendosja si kriteret e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht cënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit “*Për prokurimin publik*”, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.

- Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim, kërkesë kjo e tejkualuar e nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar. Gjithashtu në zbatim të nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021.

- Kërkesa për certifikatë ISO 3834-2:2005 “Per sistemin e menaxhimit te cilësisë se saldimit”, kërkesë e gabuar pasi shërben për prodhimin me saldim, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e cilësisë për prodhuesit që merren me prodhimin e produkteve me metodën e shkrirjes me saldim.

13. Zj. M P, me profil Kryespecialist, Sektori i Prokurimeve Publike dhe Ankandeve

14. Zj. R G, me detyrë ish-specialist Drejtoria e Logjistikës.

Përgjigja e institucionit:

Vendimi nr. 85, i APP, datë 27.12.2023 “Për verifikimin e zbatimit të ligjshmëerisë së procedurave të audituara”, u zbatua me vendimin nr. 8, datë 11.01.2024, “Për zbatimin e vendimit nr. 85, datë 27.12.202, të Agjencisë së Prokurimit Publik, “Për verifikimin e zbatimit të ligjshmëerisë së procedurave të audituara”.

Ne zbatim te vendimit nr. 85, datë 27.12.2023, te APP “Mbi verifikimin e zbatimit te ligjshmerise se procedurave te audituara”, per te gjithë personat e rekomanduar per masa dhe per “shlyerje demi” ka nisur tashme ekzekutimi i demeve.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* dhe *i zbatuar*.

Në cilësinë e anëtarit të NJP, për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) dhe ose specifikimeve teknike, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 –*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *konkretisht në praktikat:*

Nr/R	Emertimi	Fondi limit leke pa TVSh	Njësia e prokurimit dhe specifikimeve teknike
Procedura viti 2021			
1	Permiresimi i infrastrukturës se Stacionit te Shitjes se Naftës Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	59,970,906	R P; R G; M P
2	Riparim pjesore+ pastrim RVM 5000/8 dhe pastrim i mbeturinave mekanike te dy RVM 700 m3 /3/4 ne stacionin Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	18,337,055	F S; R G; O F
3	Zëvendësim i mbulesave ekzistuese “Eternit” i çative te repartit Mekanik dhe repartit Elektrik ne Q.M.N. Kuçove	9,953,982	R G; G L

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit, etj.

- Vendosja si kriteret e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht cënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit “*Për prokurimin publik*”, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.

- Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim, kërkesë kjo e tejkualuar e nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar. Gjithashtu në zbatim të nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021.

- Kërkesa për certifikatë ISO 3834-2:2005 “Per sistemin e menaxhimit te cilësisë se saldimit”, kërkesë e gabuar pasi shërben për prodhimin me saldim, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e cilësisë për prodhuesit që merren me prodhimin e produkteve me metodën e shkrirjes me saldim.

Në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm: për një përdorim më efektiv të fondeve të prokuruar, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, konkretisht në praktikat:

Nr/R	Emertimi	Fondi limit leke pa TVSh	Anëtarët e KVO
Procedura viti 2021			
1	Sigurim I jetës se punonjësve ,sig. Shëndeti nga aksidentet ne pune	22,330,000	F A ; S M; M P.
2	Tube naftësjetllësi	17,797,600	E B ; V M; M P;
3	Blerje Purteka (16 mm, 22 mm,25mm)	17,585,000	A V; V H; M P.
4	Riparim pjesore+ pastrim RVM 5000/8 dhe pastrim i mbeturinave mekanike te dy RVM 700 m3 /3/4 ne stacionin Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	18,337,055	B C; A P; M P
6	Ndertim RVM 1500 m3 ne parkun e vjeter Dekantimin Gorisht (trajtim nafte ne te ftohte me servo)	14,666,892	R G; A P; MP
Procedura viti 2022			
7	Sigurim i jetës se punonjësve ,sig. Shëndeti nga aksidentet ne pune	20,883,330	A V; V H; M P
8	Gazoil 10 ppm	182,692,600	Th M; E B; M P
9	Tube pompe kompresori TS	38,854,800	A B; V H; M P

15. Zj. V M me profil ing. Mekanik

16. Z. A V, me detyrë Drejtor, Drejtoria e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurimit Teknik,

17. Z. V H, me detyrë specialist, Sektori Monitorimit Ndjekjes dhe Administrimit te Kontratave

18. Z. B C, me detyrë drejtues punimesh, Sektori Zbatimit Investimeve & Mjedisit

19. Z. A P, me detyrë specialist, Sektori Pagave Organizimit dhe Zhvillimit

20. Z. S K, me detyrë Drejtor QPN Kuçovë.

21. Z. V Sh, me detyrë ing. Mekanik/QFT Patos

22. Z. D F, me detyrë Kryespecialist Drejtoria e Marveshjes së Hidrokarbureve.

23. Zj. F A, me detyrë Drejtor Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

24. Z. S M, me detyrë specialist, Sektori i Blerjeve me Vlera te Vogla.

25. Z. R C, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike.

26. Z. S Z, me profil ing. Mekanik, APN Fier/administrata Qendrore.

27. Zj. J B, me detyrë specialist, Sektori i Përfaqësimit.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm: për një përdorim më efektiv të fondeve të prokuruar, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”,

neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, konkretisht në praktikat:

Nr/R	Emertimi	Fondi limit leke pa TVSh	Anëtarët e KVO
Procedura viti 2021			
1	Sigurim I jetës se punonjësve ,sig. Shëndeti nga aksidentet ne pune	22,330,000	F A; S M; M P.
2	Tube naftësjiellësi	17,797,600	E B; V M; M P;
3	Blerje Purteka (16 mm, 22 mm,25mm)	17,585,000	A V; V H; M P.
4	Riparim pjesore+ pastrim RVM 5000/8 dhe pastrim i mbeturinave mekanike te dy RVM 700 m3 /3/4 ne stacionin Zharrez ne Q.A.SH.N.G. Patos	18,337,055	B C; A P; M P
5	Sherbim per transport naftë bruto	46,771,938	S K; V Sh; D F.
6	Ndertim RVM 1500 m3 ne parkun e vjeter Dekantimin Gorisht (trajtim naftë ne te ftohte me servo)	14,666,892	R G; A P; M P
Procedura viti 2022			
7	Sigurim i jetës se punonjësve ,sig. Shëndeti nga aksidentet ne pune	20,883,330	A V; V H; M P.
8	Gazoil 10 ppm	182,692,600	Th M; E B; M P
9	Tube pompe kompresori TS	38,854,800	A B; V H; M P
10	Blerje Goma Automjetesh	12,815,800	R C; S Z; J B

- Mungesa e akt-ekspertizave të pasqyrave financiare, sipas kërkesave të DST.
- Mos plotësimi I kriterit për punë të ngjashme sipas kërkesave të DST.
- Mos plotësimi I formularit të vetdeklarimit (shtojca 8), sipas kërkesave të ligjit nr. 162, datë 21.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 82 pika 5, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 26, pika 6.
- Mangësi në paraqitjen e vërtetimit mbi pagesën e energjisë elektrike.
- Mos paraqitja e certifikatës së marrjen në dorëzim të punimeve të punimeve.
- Mos plotësimi i kapaciteteve teknike, për mjetet e kërkuara sipas DST, etj.

Përgjigja e institucionit:

Vendimi nr. 85, i APP, datë 27.12.2023 “Për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të audituara”, u zbatua me vendimin nr. 8, datë 11.01.2024, “Për zbatimin e vendimit nr. 85, datë 27.12.202, të Agjencisë së Prokurimit Publik, “Për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të audituara”. Ne zbatim te vendimit nr. 85, datë 27.12.2023, te APP “Mbi verifikimin e zbatimit te ligjshmerise se procedurave te audituara”, per te gjithë personat e rekomanduar per masa dhe per “shlyerje demi” ka nisur tashme ekzekutimi i demeve.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe është *i zbatuar*.

KONKLuzioni I Auditimit

Nga verifikimi i dokumentacionit kryer prej grupit të auditimit të KLSH-së rezulton se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:
a. 33 Masa Organizative me 33 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht 33 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit; 10 zbatuar, 8 pjesërisht zbatuar dhe 15 pa zbatuar;

a/1 44 Rekomandime me karakter organizativ të mbartura nga auditimi i kaluar, nga të cilat janë pranuar plotësisht 41 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit; 11 zbatuar, 29 pjesërisht zbatuar dhe 1 pa zbatuar

b. 21 masa për shpërblim dëmi në vlerën 4,567,928,206 lekë me 21 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht 20 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit; 3 zbatuar, 16 pa zbatuar, dhe 2 pjesërisht zbatuar.

b/1 8 Rekomandime me karakter shpërblim dëmi të mbartura nga auditimi i kaluar, nga të cilat janë pranuar plotësisht 8 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit; 8 pa zbatuar

c. 11 Masa për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficiencës dhe Efektivitetit me 16 rekomandime, nga të cilat janë pranuar plotësisht 16 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit 14 pazbatuar dhe 2 pjesërisht zbatuar.

c/1 18 Rekomandime me karakter përdorimi jo me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve publike të mbartura nga auditimi i kaluar, nga të cilat janë pranuar plotësisht 17 dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit; 17 pa zbatuar

d. 1 Masë disiplinore, pranuar plotësisht 1 rekomandim dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit pjesërisht zbatuar.

e. 1 masë administrative, pranuar plotësisht 1 rekomandim dhe ka statusin e ecurisë së zbatimit 1 zbatuar.

Kërkojmë që, Albpetrol SHA të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuar si dhe pjesërisht zbatuar brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.

Si dhe kërkojmë marrjen e masave disiplinore për zyrtarët përgjegjës, në lidhje me rekomandimet e KLSH të pranuar prej institucionit dhe që efektivisht rezultojnë të pazbatuara.

4. ANEKSE

ANEKS 1

EVIDENCA PËR NDRYSHIMET LIGJORE DHE MASAT ORGANIZATIVE

Formulari nr.1

Subjekti	Respektimi afatit		Gjithsej	Ndryshime e përmirësime ligjore					Gjithsej	Masa organizative				
	20 ditë	6 muaj		Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar				Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar		
				Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
Universiteti Mjekësisë, Tiranë	PO	JO	2	2	-	-	2	-	37	37	-	17	16	4
Universiteti Sporteve, Tiranë	PO	PO	-	-	-	-	-	-	6	6	-	4	2	-
Operatori Sistemit të Transmetimit Sh. A	PO	PO	-	-	-	-	-	-	14	14	-	3	11	-
Spitali Universitar i Traumës	PO	JO	-	-	-	-	-	-	54	54	-	26	20	8
Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	PO	PO	-	-	-	-	-	-	12	12	-	9	3	-
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	PO	PO	-	-	-	-	-	-	23	23	-	17	6	-
Posta Shqiptare Sh. A	PO	JO	-	-	-	-	-	-	29	29	-	18	9	2
Albpetrol Sh. A	PO	JO	-	-	-	-	-	-	77	74	3	21	37	16
Hekurudha Sh. A	PO	JO	-	-	-	-	-	-	19	19	-	7	10	2
OSHEE Sh. A	PO	PO	-	-	-	-	-	-	43	42	1	10	24	9

ANEKS 2

EVIDENCA PËR MASAT SHPËRBLIM DËMI

Formulari nr.2

Masa për shpërblim dëmi në lekë												
Subjekti	Gjithsej		Nga këto				Nga rekomandimet e pranuar					
			Pranuar		Pa pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Universiteti Mjekësisë, Tiranë	1	513,552	1	513,552	-	-	-	-	1	513,552	-	-
Universiteti Sporteve, Tiranë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Operatori Sistemit të Transmetimit Sh. A	2	1,040,000	2	1,040,000	-	-	1	237,600	1	802,400	-	-
Spitali Universitar i Traumës	3	1,877,155	3	1,877,155	-	-	1	138,000	2	101,739,155	-	-
Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	1	1,235,213	-	-	1	1,235,213	-	-	-	-	-	-
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Posta Shqiptare Sh. A	7	14,135,799	6	2,145,410	1	11,990,389	2	458,663	4	1,686,747	-	-
Albpetrol Sh. A	29	4,915,283,010	28	4,913,676,914	1	1,606,096	2	728,935	2	3,162,155,230	24	1,750,792,749
Hekurudha Sh. A	7	10,785,552	7	10,785,552	-	-	-	-	7	10,785,552	-	-
OSHEE Sh. A	14	9,831,719	14	9,831,719	-	-	7	1,984,077	3	4,338,646	4	3,508,996
Totali	64	4,954,702,000	61	4,939,870,302	3	14,831,698	13	3,547,275	20	3,282,021,282	28	1,754,301,745

ANEKS 3

EVIDENCA PËR MASAT PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE NEGATIVE

Formulari nr.3

Masa për eliminimin e efekteve financiare negative në mijë lekë												
Subjekti	Gjithsej		Nga këto				Nga rekomandimet e pranuar					
			Pranuar		Pa pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Universiteti Mjekësisë, Tiranë	3	34,230,119.8 lekë	3	34,230,119.8 lekë	-	-	1	3,426,419.8 lekë	-	-	2	30,803,700 lekë
Universiteti Sporteve, Tiranë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Operatori Sistemit të Transmetimit Sh. A	1	-	1	-	-	-	-	-	1	-	-	-
Spitali Universitar i Traumës	11	221,118,996 lekë	11	221,118,996	-	-	5	598,460 lekë	6	44,648,596	-	-

				lekë					lekë			
Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	3	65,125,210 lekë	3	65,125,210 lekë	-	-	2	1,875,210 lekë	1	63,250,000 lekë	-	-
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	2	43,312,111 lekë	2	43,312,111 lekë	-	-	-	-	2	43,312,111 lekë	-	-
Posta Shqiptare Sh. A	15	216,820,630 lekë 9,579 Euro	15	216,820,630 lekë 9,579 Euro	-	-	9	39,160,330 lekë 9,579 Euro	3	146,009,900 lekë	3	31,650,400 lekë
Albpetrol Sh. A	34	1,512,439,206 lekë 60,620,807 \$	33	1,512,439,206 lekë 60,620,807 \$	1 masë				2	104,452,178 lekë 39,247,000 \$	31	16,225,555 1,407,987,028 lekë 21,373,807 \$
Hekurudha Sh. A	6	44,367,188 lekë	6	44,367,188 lekë	-	-	2	-	2	30,787,598	2	13,579,590 lekë
OSHEE Sh. A	5	271,805,699 lekë	5	271,805,699 lekë	-	-	1	189,165,595 lekë	2	63,843,433 lekë	2	761,245,412.8 lekë
Totali	80	2,409,219,159.8 lekë 9,579 Euro	79	853,467,842.8 0	1		20	234,226,014.8 lekë 9,579 Euro	19	496,303,816 lekë 39,247,000 \$	40	2,261,491,685.8 lekë 21,373,807 \$

ANEKS 4 EVIDENCA E MASAVE DISIPLINORE DHE ADMINSTRATIVE

Formulari nr.4

Subjekti	Gjithsej	Masa Disiplinore					Gjithsej	Masa Administrative				
		Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar				Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar		
		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar		Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
Universiteti Mjekësisë, Tiranë	2	1	1	1	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Sporteve, Tiranë	1	1	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Operatori Sistemit të Transmetimit Sh. A	1	1	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Spitali Universitar i Traumës	1	1	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	1	1	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-
Posta Shqiptare Sh. A	1	1	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-
Albpetrol Sh. A	1	1	-	-	1	1	1	1	1	1	-	-
Hekurudha Sh. A	1	1	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-
OSHEE Sh. A	1	1	-	-	1	1	1	1	-	-	-	1
Totali	11	10	1	2	6	2	2	2	-	1	-	1

Aneksi 5 Shkalla e pranueshmërisë dhe zbatimit të rekomandimeve sipas llojit të masës për secilin subjekt të audituar

Formulari nr.5

Nr.	Subjektet dhe lloji i masave	Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar		
			Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Pa zbatuar
	Totali	474	465	9	168	185	112
	Përmirësime për ndryshime ligjore	2	2	-	-	2	-
	Masa organizative	314	310	4	132	138	41
	Masa Administrative	2	2	-	1	-	1
	Masa për shpërblim dëmi	64	61	3	13	20	28
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	80	79	1	20	19	40
	Masa disiplinore	11	10	1	2	6	2
1	Universiteti Mjekësisë, Tiranë	45	44	1	19	19	6
	Përmirësime për ndryshime ligjore	2	2	-	-	2	-
	Masa organizative	37	37	-	17	16	4
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	1	1	-	-	1	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	3	3	-	1	-	2
	Masa disiplinore	2	1	1	1	-	-
2	Universiteti Sporteve, Tiranë	7	7	-	4	3	-
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	6	6	-	4	2	-
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	-	-	-	-	-	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	-	-	-	-	-	-
	Masa disiplinore	1	1	-	-	1	-
3	OST Sh. A	18	18	-	4	14	-
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	14	14	-	3	11	-

	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	2	2	-	1	1	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	1	1	-	-	1	-
	Masa disiplinore	1	1	-	-	1	-
4	Spitali Universitar i Traumës	69	69	-	32	29	8
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	54	54	-	26	20	8
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	3	3	-	1	2	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	11	11	-	5	6	-
	Masa disiplinore	1	1	-	-	1	-
5	QKUM	17	16	1	12	4	-
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	12	12	-	9	3	-
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	1	-	1	-	-	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	3	3	-	2	1	-
	Masa disiplinore	1	1	-	1	-	-
6	DPSHTRR	26	26	-	17	8	1
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	23	23	-	17	6	-
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	-	-	-	-	-	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	2	2	-	-	2	-
	Masa disiplinore	1	1	-	-	-	1
7	Posta Shqiptare Sh.A	52	51	1	29	17	5
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	29	29	-	18	9	2
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	7	6	1	2	4	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	15	15	-	9	3	3
	Masa disiplinore	1	1	-	-	1	-
8	Albpetrol Sh. A	142	137	5	24	42	51
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	77	74	3	21	37	16
	Masa Administrative	1	1	-	1	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	29	28	1	2	2	24
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	34	33	1	-	2	31
	Masa disiplinore	1	1	-	-	1	-
9	Hekurudha Sh.A	33	33	-	9	19	5
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	19	19	-	7	10	2
	Masa Administrative	-	-	-	-	-	-
	Masa për shpërblim dëmi	7	7	-	-	7	-
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	6	6	-	2	2	2
	Masa disiplinore	1	1	-	-	-	1
10	OSHEE Sh. A	64	64	-	18	30	16
	Përmirësime për ndryshime ligjore	-	-	-	-	-	-
	Masa organizative	43	43	-	10	24	9
	Masa Administrative	1	1	-	-	-	1
	Masa për shpërblim dëmi	14	14	-	7	3	4
	Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	5	5	-	-	2	2
	Masa disiplinore	1	1	-	-	1	-

5. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

- Akt Verifikim nr.1 datë 02.08.2024 “Zbatimi i rekomandimeve në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.A (OSHEE)” me nr.5081/2 prot., datë 02.08.2024
- Akt Verifikim nr.1 datë 02.08.2024 “Zbatimi i rekomandimeve në Hekurudhën Shqiptare” me nr.401/5 prot., datë 02.08.2024
- Akt Verifikim nr.1 datë 02.08.2024 “Zbatim i rekomandimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR) me nr.13056/1 prot., datë 02.08.2024
- Akt Verifikim nr.1 datë 02.08.2024 “Zbatim i rekomandimeve në Albpetrol Sh. A” me nr.3502/2 prot., datë 02.08.2024
- Akt Verifikim nr.1 datë 02.08.2024 “Zbatim i rekomandimeve në Universitetin e Sporteve Tiranë” me nr. 3608/3 prot., datë 02.08.2024
- Akt Verifikim nr.1 datë 02.08.2024 “Zbatim i rekomandimeve në Operatorin e Sistemit të Transmetimit” me nr.3402/2 prot., datë 02.08.2024

- Akt Verifikim nr.1 datë 02.08.2024 “Zbatim i rekomandimeve në Universitetin e Mjekësisë Tiranë” me nr. 1712/4 prot., datë 02.08.2024
- Akt Verifikim nr.1 datë 02.08.2024 “Zbatim i rekomandimeve në Spitalin universitar të Traumës” me nr.2902 prot., datë 02.08.2024
- Akt Verifikim nr.1 datë 02.08.2024 “Zbatim rekomandimesh në Posta Shqiptare Sh. A” me nr.1241/2 prot., datë 02.08.2024
- Akt Verifikim nr.1 datë 02.08.2024 “Zbatim rekomandimesh në Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore” me nr.327/2 prot., datë 02.08.2024

KONTROLI I LARTË I SHTETIT